



# PLANI ZHVILLIMOR I KOMUNËS SË KAMENICËS 2013 - 2023<sup>+</sup>



## Hyrja e Dokumentit Komuna e Kamenicës

Dokument i përgatitur nga Komuna e Kamenicës

Drejtoria Për Urbanizëm dhe Planifikim Hapsinor në bashkëpunim me drejtoritë dhe sektorët tjerë të komunës e përkrahur në mënyrë profesionale nga “Logos Inter Cooperation” dhe “INSI” ShPK

Kamenicë , Nëntor, 2013



## PARATHËNIE

Duke e konsideruar Planin Zhvillimor Komunal si dokument për rregullimin, shfrytëzimin dhe zhvillimin e hapësirës së komunës, në mbarim të vitit 2010 kemi marrë vendimin për hartimin e këtij plani dhe kemi filluar procesin për hartimin e tij.

Ky vendim u mbështet në dy arsye kryesore:

- Në nevojën për trajtimin (mbrojtjen dhe zhvillimin) e planifikuar të Komunës së Kamenicës dhe të vendosjes së bazave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe afatgjatë në funksion edhe të ndaljes së zhvillimeve ilegale.
- Dhe arsyeja e dytë për përgatitjen e këtij dokumenti mbështetet në obligimet ligjore që kishim ne si komunë qysh nga aprovimi i Ligjit për Planifikim Hapësinor në vitin 2003, ku lidhur me këtë mund të numërojmë edhe dhjetëra arsye tjera siç janë: nevoja për përcjelljen e rrjedhave dhe standardeve në këtë fushë si dhe në krijimin e një strukture të planifikuar që do të sigurojë efikasitet dhe cilësi për gjeneratat e tanishme pa i kërcënuar edhe gjeneratat që do të vijnë.

Unë jam i bindur se arritja e vizionit dhe objektivave strategjike që janë definuar në këtë dokument do të kontribuojë në shumë aspekte, ku unë do të kisha veçuar tri aspekte:

- aspektin social
- aspektin ekonomik dhe
- aspektin mjedisor.

Procesi i hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Kamenicës u zhvillua në kohë dhe rrethana jo të lehta, duke marrë parasysh të gjitha aspektet. Pra, shpresoj se zbatimi i tij do të bëhet në rrethana të tjera dhe ne të gjithë së bashku do të kemi privilegjin, por edhe përgjegjësinë, për zbatimin sa ma të përpiktë të këtij plani, i cili do të jetë udhërrëfyes në fazën e zhvillimit dhe të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe të arritjes së standardeve evropiane.

Pas shumë analizave dhe studimeve, ne tani të gjithë pajtohemi se niveli dhe ritmi i zhvillimit ekonomik dhe social i komunës sonë do të bazohet në këtë plan, si dhe varet nga niveli i dijes së akumuluar e reflektuar nga ekspertët tanë në komunë por edhe të tjerët që kanë ndihmuar këtë proces. Përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal, ne kemi arritur një konsensus të gjerë politik, qytetar e profesional. Një qasje e tillë ka bërë që në plan të përfshihen interesat dhe specifikat e të gjitha grupeve të shoqërisë në komunë, ku është një bazë e mirë që edhe në procesin e zbatimit të ketë një përkrahje të gjerë nga të gjitha palët e interesit. Komuna ka mirëpritur angazhimin e të gjithë aktorëve që kanë marrë pjesë në këtë proces, të cilët me vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet e tyre kanë pasuruar draftin e Planit Zhvillimor Komunal të përgatitur fillimisht nga ekspertët.

Me këtë rast, dëshiroj të shpreh mirënjohjen dhe falënderimin tim dhe të komunës për grupet punuese, Këshillin e ekspertëve, përfaqësuesit e shoqërisë civile, sektorin privat, lidhësit e të gjitha partive politike si dhe të gjithë ata që kanë marrë pjesë në përgatitjen e këtij dokumenti të rëndësishëm.

Një mirënjohje të veçantë për bartësit kryesor të planit zhvillimor, për të gjitha mediat që krijuan hapësirë për paraqitjen e këtij dokumenti strategjik para qytetarëve.

Komuna pret nga institucionet, donatorët, partnerët dhe miqtë e komunës që të ndihmojnë zbatimin e këtij dokumenti në mënyrë që, bashkërisht të hapim perspektiva të reja për zhvillim të qëndrueshëm të Kamenicës.

Me punën tonë të përbashkët në implementim të këtij plani do të kontribuojmë që qytetarët tanë të jetojnë me dinjitet. Besoj thellësisht se, bashkërisht mund të sigurojmë energjitë dhe burimet për të zbatuar këtë plan.

## **PËRMBAJTJA**

|   |     |
|---|-----|
| HYRJE   | 11  |
| PROFILIN E ZHVILLIMIT HAPËSINOR DHE ANALIZËN E GJENDJES   | 20  |
| DEMOGRAFIA DHE ZHVILLIMI SOCIAL   | 22  |
| RASTET SOCIALE  | 26  |
| PAPUNËSIA NË KOMUNËN E KAMENICËS  | 28  |
| STRUKTURA E PUNËKËRKUESVE NË KOMUNËN E KAMENICËS  | 34  |
| PUNËKËRKUESIT NË ASISTENC SOCIALE   | 36  |
| BANIMI, SHPËRNDARJA E LOKALITETEVE  | 36  |
| TIPOLOGJIA E VENDBANIMEVE SIPAS MADHËSISË   | 36  |
| ARSIMI NË KOMUNËN E KAMENICËS   | 50  |
| MJEDISI DHE SHFRYTIZIMI I TOKËS   | 57  |
| FATKEQESIT NATYRORE DHE TE TJERA  | 164 |
| ZHVILLIMI EKONOMIK  | 173 |
| INFRASTRUKTURA TEKNIKE  | 194 |
| POZITA, RËNDËSIA DHE ÇËSHTJE SPECIFIKE PËR TERRITORIN E KOMUNËS SË KAMENICËS  | 214 |
| PËRFSHIRJEN E INFORMATAVE KYÇE TË RAPORTEVE DHE STRATEGJIVE SEKTORIALE  | 217 |
| ÇËSHTJE KYÇE TË KONTEKSTIT MË TË GJERË HAPËSINOR  | 229 |
| VLERËSIMI I GJENDJES NË KOMUNË  | 237 |
| ANALIZËN E CILA TREGON PËRPARËSITË, MANGËSITË, MUNDËSITË DHE KËRCËNIME  | 247 |
| ANALIZËN E NDËRLIDHJEVE NË MES TË ÇËSHTJEVE, POLITIKAVE DHE PROGRAMEV   | 256 |
| VLERËSIMIN E KAPACITETEVE INVESTIVE KOMUNAL   | 261 |
| Sfidat Kryesore zhvillimore të komunës së KAMENICËS   | 270 |
| VIZIONI, PARIMET DHE CAQET  | 274 |
| KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR KOMUNAL  | 283 |
| STRUKTURAT DHE LOKACIONET HAPËSINORE PËR ZHVILLIMIN DHE ORGANIZIMIN NE TE ARDHMEN   | 422 |
| INFRASTRUKTURA- TRANSPORTI KOMUNAL, KOMUNIKIMET   | 447 |
| FUSHA TEMATIKE POPULLSIS, BANIMIT, VENDBANIMEVE, QESHTJEVE SOCIALE  | 464 |
| MJEDISI, PËRFSHIRË TRASHËGIMIN NATYRORE, RESURSET, PEJZAZHET  | 485 |
| SHËNJIMIN E ZONAVE URBANE EKZISTUESE DHE TË PROPOZUARA  | 501 |
| SHËNIMI I NDËRTIMEVE TË RËNDËSISHME   | 502 |
| VLERËSIMIN E NDIKIMIT SOCIO-EKONOMIK DHE MJEDISOR TË KORNIZËS   | 505 |
| STRATEGJITË DHE VEPRIMET PËR ZBATIM   | 510 |
| FUSHA TEMATIKE E ZHVILLIMIT EKONOMIK  | 510 |
| STRATEGJITË DHE VEPRIMET PËR INFRASTRUKTURËN TEKNIKE  | 522 |
| FUSHA TEMATIKE E DEMOGRAFIA DHE ÇËSHTJET SOCIALE  | 528 |
| STRATEGJITË DHE VEPRIMET PËR SHFRYTËZIMIT TË TOKËS DHE MJEDISIT   | 539 |
| VLERËSIMET E STRATEGJIVE BAZUAR NË KRITERET E PËRCAKTUARA ME PARIME POLITIKA DHE LIGJE                                    | 546 |
| AFATET KOHORE, IMPLIKIMET FINANCIARE, KORNIZËN INSTITUCIONALE   | 554 |
| DISPOZITAT PËR ZBATIM   | 589 |
| UDHËZIME MBI ÇËSHTJET E INTERPRETIMIT TË PLANIT   | 589 |
| KUSHTET TE PERCAKTUARA NGA QEVERIA LOKALE MBI QESHTJE<br>TE RENDESISHME PER ZHVILLIMIN DHE SHFRYTEZIMIN E TOKES NE KOMUNE | 591 |
| MASAT PËR MBROJTJEN E PEJZAZHEVE, VLERAVE NATYRORE DHE TËRËSIVE KULTURO-HISTORIKE   | 597 |
| MËNYRA E TRAJTIMIT TË HEDHURINAV  | 598 |
| MASAT PËR PENGIMIN E NDIKIMEVE TË DËMSHME NË MJEDIS   | 599 |
| DETYRIMI PËR HARTIMIN E PLANIT  | 602 |
| APLIKIMI I MASAVE ZHVILLIMORE DHE I MASAVE TJERA  | 602 |
| REKONSTRUKTIMI I NDËRTESAVE   | 602 |
| DISPOZITAT LIDHUR ME BASHKËPUNIM  | 602 |
| DISPOZITAT MBI RENDIN KRONOLOGJIK APO ETAPAT E IMPLEMENTIMIT  | 603 |
| ELEMENTET DHE UDHËZIMET PËR HULUMTIM TË MËTUTJESHËM   | 603 |
| DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE  | 604 |
| SHTOJCAT E DOKUMENTIT   | 604 |
| REFERENCAT  | 605 |

## HARTAT

(Harta 1 Pozita Gjeografike e Kamenicës në Hartën e Republikës së Kosovës, fq. 21.)

(Harta 2 Dendësia e popullsisë së Kamenicës, fq.25)

(Harta 3. Shkalla e varfërisë në Komunën e Kamenicës, fq 27).

(Harta 4. Papunësia-struktura e punëkërkuesve, fq.33).

(Harta 5. Popullsia e Kamenicës nga viti 1948-2011- fq. 40)

(Harta 6. Migrimi (depopullimi) i popullsisë në Komunën e Kamenicës, fq. 49)

(Harta 7. Hapësira shkollore dhe sportive në Komunën e Kamenicës fq. 54).

(Harta 8. Shfrytëzimi i tokës në Komunën e Kamenicës, fq. 60)

(Harta 9. Harta hidrologjike në Komunën e Kamenicës, fq. 64)

(Harta 10. Biodiverziteti në Komunën e Kamenicës fq,10)

(Harta 11.Pedologjike në Komunën e Kamenicës, fq.104.

(Harta 12. Harta e bonitetit të tokave në Komunën e Kamenicës, fq.105)

(Harta 13. Pyjet në Komunën e Kamenicës, fq 108)

(Harta 14. Reshjet në Komunën e Kamenicës, fq 111)  
 (Harta 15. Relivi në Komunën e Kamenicës, fq112)  
 (Harta 16. Gjeologjia në Komunën e Kamenicës, fq.117)  
 (Harta 17. Resurset minerale në Komunën e Kamenicës, fq122)  
 (Harta 18. Trashëgimia kulturore në Komunën e Kamenicës, fq.162).  
 (Harta 19. Monumentet kulturpre në Komunën e Kamenicës, fq163)  
 (Harta 20. Zonat e rrezikuara në Komunën e Kamenicës, fq 166)  
 (Harta 21. Vërshimet dhe erozionet në Komunën e Kamenicës, fq.172)  
 (Harta 22. Zonat Bujqësore në Komunën e Kamenicës, fq.182)  
 (Harta 23. Shtrirja hapësinore e bizneseve në Komunën e Kamenicës, fq.193)  
 (Harta 24. Infrastruktura e transportit në Komunën e Kamenicës, fq 196)  
 (Harta 25. Rrjeti rrugor në Komunën e Kamenicës, fq. 197)  
 (Harta 26. Infrastruktura e furnizimit me ujë në Komunën e Kamenicës, fq 199)  
 (Harta 27. Infrastruktura, kanalizimi në Komunën e Kamenicës, fq 201)  
 (Harta 28. Telekomunikimi në Komunën e Kamenicës, fq.203)  
 (Harta 29. Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Kamenicës, fq.211)  
 (Harta 30. Shërbimet sociale në Komunën e Kamenicës, fq.214)  
 (Harta 31. Zgjerimi hapësinor i qytetit të Kamenicës 246)  
 (Harta 32. Ndarja hapësinore e Kamenicës-"Koncepti i Diellit" Fq.285)  
 (Harta 33. Organizimi hapësinor i Komunës së Kamenicës, Fq.286)  
 (Harta 34. Vendbanimet në Komunën e Kamenicës, fq 300)  
 (Harta 35. Vendbanimet joformale në Komunën e Kamenicës, fq 420)  
 (Harta 36. Zonat e zhvillimit ekonomik në Komunën e Kamenicës, fq.426)  
 (Harta 37. Zonat bujqësore në Komunën e Kamenicës, fq429)  
 (Harta 38. Masat për vërshimet dhe erozionin në Komunën e Kamenicës, fq.431)  
 (Harta 39. Pyjet në Komunë të Kamenicës, fq.438)  
 (Harta 40. Zonat turistike në Komunën e Kamenicës, fq.445)  
 (Harta 41. Infrastruktura e transportit në Komunën e Kamenicës, fq.448)  
 (Harta 42. Rrjeti rrugor në Komunën e Kamenicës, fq.449)  
 (Harta 43. Telekomunikimi në Komunën e Kamenicës, fq.451)  
 (Harta.44 Rrjeti energjetik në Komunën e Kamenicës, fq. 453)  
 (Harta 45. Infrastruktura e furnizimit me ujë në Komunën e Kamenicës, fq.456)  
 (Harta 46. Ndjeshmëria e ujërave në Komunën e Kamenicës, fq.457)  
 (Harta 47. Kanalizimi në Komunën e Kamenicës, fq. 459)  
 (Harta 48. Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Kamenicës, fq. 461.)  
 (Harta 49. Masat mbrojtëse nga vërshimet në Komunën e Kamenicës, fq.463)  
 (Harta 50. Hapësirat shkollore dhe sportive në Komunën e Kamenicës, fq.474)  
 (Harta 51. Shërbimet sociale në Komunën e Kamenicës, fq.477)  
 (Harta 52. Trashëgimia Kulturore- arkeologjike në Komunën e Kamenicës, fq.483)  
 (Harta 53. Trashigimia natyrore në Komunën e Kamenicës, fq.484.)  
 (Harta 54. Resurset ujore në Komunën e Kamenicës, fq.487)  
 (Harta 55. Biodiversiteti në Komunën e Kamenicës, fq.490)  
 (Harta 56. Destinimi i tokës në Komunën e Kamenicës, fq.492).  
 (Harta 57. Ndjeshmëria e tokës në Komunën e Kamenicës, fq.493)  
 (Harta 58. Zonat e rrezikuara në Komunën e Kamenicës, fq.500)

## TABELAT

Tab.1. Regjistrimi i popullsisë sipas viteve (i tërë territori pa decentralizim),fq.22.  
 Tab.2. Regjistrimi i popullsisë sipas viteve (i tërë territori me decentralizim), fq.23.  
 Tab.3. Struktura e popullsisë sipas moshës, fq.23  
 Tab.4. Struktura e punëkërkuësve sipas grupmoshës, fq.34  
 Tab .5. Struktura e punëkërkuësve sipas kualifikimit dhe kohëzgjatjes së pritjes për punë, fq.35  
 Tab. 6. Struktura nacionale e punëkërkuësve në Komunën e Kamenicës, fq.35  
 Tab. 7. Struktura e vendbanimeve sipas madhësisë së popullsisë në periudhën 2011 - fq.38  
 Tab. 8. Numri i banorëve, ekonomive familjare, tipi i vendbanimit, fq.43  
 Tab. 9. Numri i institucioneve shkollore në Komunën e Kamenicës sipas nivelit të arsimit , fq. 50  
 Tab.10. Të punësuarit në arsim, fq.51  
 Tab. 11. Numri i nxënësve në shkolla fillore, shkolla të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, fq. 52  
 Tab.12. Proporcioni nxënës-shkollë në arsimin e obligueshëm (1-9), fq.52  
 Tabela.13. Personeli arsimor në arsimin e obligueshëm, fq. 52  
 Tab.14. Proporcioni nënës-shkollë, fq.53  
 Tab.15. Personeli arsimor në arsimin e mesëm sipas pozitës, fq. 53  
 Tab.16. Raporti në mes hapësirave shkollore dhe nxënësve, fq.56  
 Tab.17. Llogaritja e sasisë së ujit, fq.58  
 Tab.18. Ndarja e tokave sipas kulturave, fq. 101  
 Tab.19. Përcaktimi i klasave të bonitetit të tokës në Komunën e Kamenicës, fq.102  
 Tab.20. Vlerat mesatare të reshjeve për vitin 2002 në Komunën e Kamenicës, fq.109  
 Tab.21. Vlerat mesatare të reshjeve për vitin 2008 në Komunën e Kamenicës, fq.109  
 Tab.22. Lista e monumenteve – objekteve me vlerë trashëguese në Komunën e Kamenicës, fq.156  
 Tab.23. Lapidarët e dëshmorëve të Luftës së UÇK-së, fq.157  
 Tab.24. Shkalla e erozionit, fq.169

Tab.25. Shfrytëzimi i tokës në **ha**, fq.174  
 Tab.26. Sipërfaqet bujqësore dhe malore, fq.175  
 Tab.27. Prodhimtaria e grurit dhe e misrit në Komunën e Kamenicës 2011 - fq.176  
 Tab.28. Lloji i kafshëve dhe sasia, fq.176  
 Tab.29. Lloji i fermave dhe numri i tyre, fq.177  
 Tab.30. Numri i ekonomive bujqësore në Komunën e Kamenicës, fq.177  
 Tab.31. Ujitja e tokës së kultivuar në Komunën e Kamenicës, fq.177  
 Tab.32. Ndarja e tokës sipas kulturave, fq.181  
 Tab.33. Lloji i kulturës dhe rendimenti, fq.183  
 Tab.34. Prodhimtaria e grurit, fq.183  
 Tab.35. Sipërfaqet e mbjella dhe rendimenti, fq.183  
 Tab.36. Resurset minerale në Komunën e Kamenicës, fq.184  
 Tab.37. Struktura e subjekteve afariste, fq.186  
 Tab.38. Zejtaria, profili i aktiviteteve dhe shpërndarja, fq.187  
 Tab.39. Bizneset në komunë, fq.189-190  
 Tab.40. Tokat pjellore në komunë, fq.191  
 Tab.41. Numri dhe lloji i kafshëve në Komunën e Kamenicës, fq.192  
 Tab.42. Regjistrimi i popullsisë sipas viteve (tërë territori i komunës pa decentralizim), fq.287  
 Tab.43. Regjistrimi i popullsisë sipas viteve (tërë territori i komunës me decentralizim), fq.288  
 Tab.44. Struktura e popullsisë sipas moshës, fq.288  
 Tab.45. Numri i banorëve sipas viteve, fq.289  
 Tab.46. Pyllëzimi në Komunën e Kamenicës, fq.434  
 Tab.47. Masat e planifikuara në pyje, fq.435  
 Tab.48. Masat që duhet të merren në pyje të reja artificiale, fq.435  
 Tab.49. Pyllëzimi melorativ, fq.436  
 Tab.50. Tretmani i sip. tokësore, fq.436  
 Tab.51. Faktori gjinor, fq.467  
 Tab.52. Trashëgimia arkeologjike, fq.481

## GRAFIKONET

Graf.1. Numri i banorëve në tërë territorin e komunës (tërë territori pa decentralizim), fq.22.  
 Graf.2. Numri i banorëve në tërë territorin e komunës (tërë territori me decentralizim), fq.23.  
 Graf.3. Numri i popullsisë në Komunën e Kamenicës, fq.24.  
 Graf.4. Struktura e punëkërkuarve sipas grupmoshës, fq.34  
 Graf.5. Numri i vendbanimeve sipas madhësisë së popullsisë për vitin 2011 -fq.39  
 Graf.6. Numri i institucioneve shkollore në Komunën e Kamenicës sipas nivelit të arsimit, fq.51  
 Graf.7. Numri i të punësuarve në arsim, fq.51  
 Graf.8. Numri i nxënësve në shkolla fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta dhe të mesme, fq.52  
 Graf.9. Shpërndarja e tokës, fq.101  
 Graf.10. Shfrytëzimi i tokës në **ha**, fq.101  
 Graf.11. Ndarja e tokave sipas bonitetit (përqindje), fq.106  
 Graf.12. Klasifikimi i pyjeve sipas përqindjes, fq.107  
 Graf.13. Shkalla e erozionit në Komunën e Kamenicës, fq.171  
 Graf.14. Ndarja e tokave sipas bonitetit (përqindje) sipas FAO-s, fq.175  
 Graf.15. Sipërfaqja e mbjellë dhe rendimenti, fq.176  
 Graf.18. Numri i kafshëve nëpër vendbanime, fq.177  
 Graf.19. Ndarja e tokës sipas kulturave, fq.181  
 Graf.20. Dinamika e rritjes së popullsisë, fq.287  
 Graf.21. Numri i banorëve në tërë territorin e komunës (i tërë territori me decentralizim), fq.288  
 Graf.22. Numri i banorëve në tërë territorin e komunës (i tërë territori me decentralizim), fq.290  
 Graf.23. Te ardhurat në euro, për kokë banori për disa komuna të Kosovës, fq.297  
 Graf.24. Faktori gjinor në përqindje, fq.468

## FIGURAT

Fig.1. Trëndafili i erës në Komunën e Kamenicës, fq.110  
 Fig.2. Skema njëpolarshë 400/220/110 kv në hartën gjeo. të Kosovës, fq.209

## Bartësit e Hartimit të PZHK-së

Bartësi kryesor



KOMUNA E KAMENICËS

Përkrahje profesionale



QEVERIA ZVICERANE

Përkrahje profesionale



INSTITUTI PËR SHKENC DHE TEKNOLOGJI "INSI"

Menaxhimi

**Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor –Kamenicë**

Koordinator i projektit

**Ilir Kastrati - ID i arkitekturës drejtor: Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor - Kamenicë**

Menaxherët e projektit

**Lulzim Leci - Nënkyetar i KK Kamenicë**

### BARTËSIT KRYESOR NË HARTIMIN E PZHK-së

1. Ilir Kastrati, master i SH.A. – drejtor i D.U.P.H
2. Mehmet Thaçi, master i SH.A. – përgjegjës për planifikim D.U.P.H
3. Muhamet Thaçi, master i SH.I.M – drejtor i D.I.
4. Nexhmije Kallaba, ecc.dipl. - zyrtare për integ. Evro.
5. Enver Ajvazi, jur.dipl. -- drejtor i Adm. Pergj.
6. Jakup Cakolli, ing.nd. – insp. i ndërt.
7. Ramush Ismajli, gjeometër – përgj. i sekt. gjeo.

Komiteti drejtues

|                       |   |
|-----------------------|---|
| <b>Bajram Dërmaku</b> | <b>shf i grupit parlamentar / PDK /</b>   |
| <b>Shqipe Maliqi</b>  | <b>shefe e grupit parlamentar / AAK /</b> |
| <b>Jeton Biqkaj</b>   | <b>shf i grupit parlamentar / LDK /</b>   |
| <b>Nebi Sylejmani</b> | <b>shf i grupit parlamentar / AKR /</b>   |

## EKIPI KOMUNAL I PLANIFIKIMIT

### I. EKUPI PËR VLERËSIMIN E KAPACITETEVE INVESTIVE

1. Nexhmije Kallaba, ecc.dipl.
2. Mustafë Borovci ,ecc.dipl.
3. Shaban Kastrati ,ing.dipl
4. Naser Hashani, ecc.dipl.
5. Raif Ramabaja, mr. i ekonomisë
6. Ramiz Kryeziu ,ecc.dipl.
7. Agim Hoda ,ecc.dipl.
8. Bujar Kastrati ,ecc.dipl.
9. Fatmir Krasniqi, jur.dipl., prodhim
10. Ilmi Dërmaku, tregti
11. Nehat Bixhaku ,ecc.dipl, prodhim
12. Dejan Blagojevic, kom.serb

### II. EKUPI KOMUNAL I PROFILIMIT

1. Mehmet Thaçi , master i SH.A.– përgjegjës për planifikim D.U.P.H
2. Tasim Rexha, prof.gjeog.
3. Sali Canaj, ecc.dipl
4. Nebi Sylejmani, mjek
5. Bektesh Dërmaku, ing bujqësisë
6. Shaban Tahiri, mr.gjeologjisë
7. Fehmi Jakupi, ing nd.
8. Ismet Ahmeti, ecc.dipl
9. Zijadin Thaqi, gjeodet

### III. EKUPI KOMUNAL PËR PLANIFIKIM (EKP)

#### Ekipii certifikuar i planerëve komunal

1. Mehmet Thaci, master i SH.A.– përgjegjës për planifikim D.U.P.H
2. Jakup Cakolli , ing nd.
3. Fehmi Jakupi , ing nd.
4. Tajar Dërmaku, ing.nd.
5. Ruzhdi Basha, ing.dipl.
6. Ramush Ismajli, gjeometër

Në vitin 2003, 2004, 2005 – kanë bërë përgatitjen e profilit urban në bashkpunim me MMPH-së

**Koordinator per grupet punuese I-III është Ilir Kastrati, arq dipl, drejtor**



#### IV. ARSIMI, SHËNDETËSIA, DEMOKRAFIA DHE ÇESHTJA SOCIALE

##### Arsimi

1. **Fahrije Kryeziu ,prof.,drejtore e arsimit**
2. **Nexhat Rexha,prof**
3. **Rexhep Vranja,prof**
4. **Sabri Morina,prof**
5. **Bajram Dërmaku,prof**
6. **Shyhrete Kastrati,pedagoge**
7. **Biljana Niçiq -kom.serb**

##### Shëndetësia

1. **Fehmi Kastrati,prof, drejtor per shëndëtesi dhe çështje sociale**
2. **Ismet Morina,mjek**
3. **Rabit Dërmaku,mjek**
4. **Sinan Sadiku,jur.dipl, Zyra e punësimit**
5. **Rifat Hajdari,jur.dipl,Qendra sociale**

##### Popullimi –Banimi

1. **Enver Ajvazi ,jur.dipl, drejtor**
2. **Abdullah Hashani,prof**
3. **Nijazi Kastrati,prof**

##### Trashëgimia

1. **Hazir Berisha ,prof- drejtor**
2. **Shaban Berisha,prof**
3. **Milit Thaçi,prof**

#### V. ZHVILLIMI EKONOMIK

##### Bujqësia

1. **Gani Sadiku,ing bujq.- drejtor**
2. **Imer Dërmaku,ing bujq.**
3. **IbrahimBunjaku,ing bujq.**
4. **Dobrivoje Milkoviq - kom.serb**

##### Ekonomia

1. **Rabit Halili ,arq.dipl- drejtor**
2. **Halit Sylaj,ecc.dipl**
3. **Vojislav Jevtiq - kom serb**

##### Industri

1. **Salih Canaj ,ecc.dipl**

##### Tregtia

2. **Naser Hashani ,ecc.dipl**

##### Turizmi

1. **Hazir Berisha - drejtor**

#### VI. MJEDISI DHE SHFRYTËZIMI I TOKËS

##### Resurset natyrore

1. **Muhamet Thaçi master iSH.I.M– drejtor DI**
2. **Shaban Tahiri,mr. gjeologjisë**
3. **Shaip Hyseni,ing. gjeologjisë**

Mjedisi

**1. Ibrahim Kastrati, ing bujq.**

Ndotje dhe degradim

**1. Musah Ismajli  
2. Ibrahim Bunjaku**

#### VII. INFRASTRUKTURË

**1. Hysen Jerliu, drejtor  
2. Ruzhdi Qehaja, drejtor  
3. Shaban Kastrati  
4. Bu rim Krasniqi  
5. Afrim Muja – drejtor I ujësjellësit  
6. Isuf Rrudhani – drejtor I higjienës  
7. Selami Spahiu – KEK  
8. Ejup Kastrati**

#### VIII. KËSHILLI I EKSPERTËVE KOMUNAL

- Kryetari i Komunes së Kamenicës Shaip Surdulli
- Nënkryetari i Komunes së Kamenicës Lulzim Leci
  
- **mr.id.n Kadri Morina**
- **mr.id.hidr. Shiqeri Dërmaku**
- **agr.d. Islam Isufi**
- **i.d.gjeol. Xhelal Hoda**
- **i.d.a. Fadil Dalipi**
- **gjeogr. Shpend Agaj**
- **mjek. Avdush Kastrati**
- **i.d. kom. Arsim Dërmaku**

#### IX. KËSHILLI JO FORMAL – SHOQËRI CIVILE

- **D. Press-Valmir Klaiqi**
- **OVL UCK-se -Milaim Limani – baçelor i kriminalistikes**
- **FORTESA –Sanije Jahiri**
- **CDKD –Aleksandra Saviq**
- **JEKIPE –Bajrus Kriezi**
- **HANDIKOS**
- **Shoq. e Gjuetarëve-Rexhep Bugaqku**
- **Shoq. e Bletarëve- Halil Dërmaku, etj.**

#### X. LEKTOROI:

- **Sabri Morina prof.**

## 1.0 HYRJE

Komuna e Kamenicës, përkundër traditës në fushën e planifikimit në të kaluarën, në periudha të ndryshme është ballafaquar me probleme të mëdha hapësinore dhe urbane.

Pjesëmarrja joadekuarte e grupeve të interesit dhe ekspertëve vendës në procesin e hartimit dhe tëmiratimit të planeve, sidomos në periudhën (1981-1999) ka rezultuar me kufizimet në ngritjen profesionale dhe ushtrimin e veprimtarisë së planifikimit hapësinor dhe urban.

Në periudhën e pas vitit 1999 zhvillimi i planifikuar është bazuar në zgjatjen e afatit të Planit të Përgjithshëm të PZHK-së të Kamenicës, bazuar edhe në rregulloret e UNMIK-ut për zbatueshëmerin e ligjeve dhe akteve tjera në Kosovë.

Me themelimin e autoritetit qendror për planifikim hapësinor, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) pas zgjedhjeve të para nacionale, kërkesa për plane të reja u shtua dukshëm. MMPH filloi reformën e sistemit të planifikimit hapësinor dhe urban në Kosovë me miratimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor 2003/14 të Kuvendit të Kosovës të datës 05 korrik 2003, të shpallur me 10 shtator 2003 nga ana e PSSP dha amandamentimin e këtij me hyrje në fuqi të Ligjit L-03/L-106 për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor.

Rëndësia e këtij akti qëndron në detyrimet që komunat brenda afatit prej 18 muajsh të miratojnë planet e tyre zhvillimore komunale dhe urbane, duke aplikuar parimet ndërkombëtare të qeverisjes së mirë ndër të cilat gjithëpërfshirja, transparencë dhe krijimi i ndjenjës së pronësisë së planit ishin ndër kryesoret.

### PROCESI I HARTIMIT TË PZHK NË KAMENICË

Të ballafaquar me kufizimet buxhetore të komunës nga njëra anë dhe kërkesat e përditshme të qytetarëve për rindërtim dhe për ndërtime të reja, interesat për zhvillim të qëndrueshëm dhe krijimin e ofertës në kushtet e sistemit me ekonomi të lirë të tregut, nga ana tjetër përkundër edhe afatit të paraparë me ligj për hartimin e këtyre dokumente ve deri me 2010 nuk kishte filluar procesi i hartimit të PZHK-së.

Shumë faktorë ndikuan që Kuvendi Komunal i Kamenicës (KKK) më datë 04. 10. 2010 të marrë vendim nr 01.-139 për hartimin e PZHK-së, ku si bartës të kësaj detyre përcakton **Drejtorinë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinorë (DUPH)** të Komunës së Kamenicës. Më 20.07.2010 në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse, Komuna e Kamenicës themeloi me vendim Këshillin e Ekspertëve të Planifikimit (KEP), si organ profesional i pavarur këshillëdhënës për Kuvendin Komunal (KK) të Kamenicës për fushën e Planifikimit Hapësinor dhe Urban.

Aktivitetet në fillim janë përqendruar në mobilizimin e drejtorive të Komunës së Kamenicës dhe aktorëve tjerë në proces, formimi i (EKP) Ekipit Komunal për Planifikim, Ekipit për Profilim, Grupeve Punuese Tematike (GPT), Shfrytëzim të Tokës dhe Mjedis(SHTM), Demografi e Çështje Sociale(DÇS) , Zhvillim Ekonomik(ZhE), dhe të Infrastrukturës(I), por edhe Komitetit Drejtues për Planifikim i përbërë nga lidershipi i të gjitha partive politike.

Komuna e Kamenicës, gjithashtu kishte konstatuar se **DUPH** me staf profesional e të çertifikuar dhe i ngarkuar me punë të përditshme nuk mund të marrë tërë ngarkesën mbi vete për të përgatitur PZHK-në dhe PZHU-në, prandaj u kërkuar nga bordi i drejtorëve (BD) dhe më

vonë nga Kuvendi Komunal i Kamenicës (KKK) që të sigurohet përkrahja teknike e profesionale gjatë hartimit të planeve. Kështu KKK merr vendim për shpalljene tenderit për kontraktimin e punëve profesionale për përpilimin e planeve.

Gjatë vitit 2010 u bënë përgatitjet në këtë drejtim, ku filloi hartimi i detyrës projektuese të dy planeve të bazuara në Ligjin e Planifikimit Hapësinor, të nxjerrë nga MMPH në vitin 2003 dhe të udhëzimeve administrative të nxjerra më vonë sipas këtij ligji, shpalli tenderin. Në rrethin e 3 kompanive, komisioni për vlerësimin e tenderit është përcaktuar për kompaninë “**INSI**” **Sh.P.K**, me të cilën kompani pas procedurës së rregullt të prokurimit dhe përzgjedhjes së fituesit, është nënshkruar kontrata për bashkëpunim.

U fillua me profilin e zhvillimit hapësinor të pjesës komunale dhe Urbane. Nga drejtoritë komunale, grupet punuese dhe kompanitë publike u siguruan dhe grumbulluan të gjitha të dhënat gjeografike, fizike, mjedisore dhe socio-ekonomike për komunën. Në proces janë përfshirë në mënyrë intensive të gjitha drejtoritë, e sidomos stafi profesional i tyre, si dhe ekipi komunal i planifikimit, i formuar më parë.

Në vazhdimësi, janë përgatitur raportet dhe strategjitë sektoriale nga drejtoritë në bashkëpunim edhe me kompanitë publike, ku është paraqitur gjendja aktuale nëpër drejtori; mandej janë specifikuar sfidat, problemet dhe nevojat, është bërë SWOT-analiza, në nivelin e drejtorive, është formuar vizioni për të ardhmen dhe prioritet strategjike në fusha tematike. Raportet e tilla janë të protokolluara dhe të regjistruara nga secila drejtori dhe si të tilla janë pjesë e dokumentacionit shtesë të këtij procesi.

Gjatë gjithë kohës grupet punuese në përbërje profesionale dhe multisektorale dhe të udhëhequra nga të emëruarit, kanë bërë punët e tyre të ndara në këto fusha tematike.

- I. Demografi dhe Çështje Sociale,
- II. Shfrytëzimit të Tokës dhe Mjedisit,
- III. Infrastrukturës Teknike,
- IV. Zhvillimit Ekonomik,
- V. Sinergjia dhe Interkomunikimi.

Që nga fillimi i procesit e deri para shpalljes së shqyrtimit publik të dy dokumenteve, janë mbajtur dhe evidentuar një seri takimesh, kuptohet të niveleve të ndryshme.

Pas mbledhjes së të gjitha shënimeve, propozimeve, vërejtjeve, si dhe komenteve nga këto takime, në mënyrë intensive u fillua me analizën e gjendjes me metodën SWOT, njëherë nga grupet punuese, debatet profesionale deri te organizimi i Punëtorisë treditore me këto grupe i cili është mbajtur në Prevallë “**Vizioni i Kamenicës 2023+**”.

Kjo Punëtori kontribuoj që dokumenti edhe më tej të pasurohet pasi në të morën pjesë së bashku përfaqësues të shoqërisë civile, ekipi i planerëve komunal i organizuar dhe i përkrahur materialisht dhe profesionalisht nga **KKK**-ja, **Logos Inter Cooperation** dhe **INSI**.

Komuna e Kamenicës në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe udhëzimin administrativ mori vendimin nr 01/2247 që të organizojë Shqyrtimin Publik për PZHK-në, informatë e cila u publikua në tri gazeta ditore dhe në mediat lokale. Shqyrtimi Publik është mbajtur në periudhën kohore prej 60 ditë prej datë 10.08.2012 - 10.10.2012

Shqyrtimi publik u mbajt në holin e Shtëpisë së Kulturës „ISA KASTRATI“ në Kamenicë, me një qasje transparente të punës së ekipeve punuese ndaj qytetareve dhe krijoi hapësira për të gjitha shtresat e popullatës, që të japin sugjerime, vërejtje, këshilla ndaj planit. Për mbajtjen e shqyrtimit publik dhe aktivitetet gjatë kësaj periudhe, banorët e Komunës së Kamenicës janë njoftuar përmes mënyrave të ndryshme të informimit, si: është hartuar broshura për shqyrtim publik, e cila përmbante shkëputje të pjesëve të rëndësishme të planit dhe informatat për aktivitetet e shqyrtimit publik.

Duke marrë parasysh kufizimet financiare të cilat i ka pasur Komuna e Kamenicës, mund të konstatojmë se organizmi i shqyrtimit publik ishte një aktivitet i suksesshëm dhe me pjesëmarrje të kënaqshme. Prandaj me këtë konstatojmë edhe një shkallë më të lartë të validitetit të rekomandimeve dhe vërejtjeve të adresuara.

Menjëherë, pas përfundimit të shqyrtimit publik për planin, është konsoliduar raporti i shqyrtimit publik duke marrë parasysh të gjitha vërejtjet sugjerimet dhe komentet me arsyeshmëri profesionale dhe të interesave të përgjithshme.

Përfundimisht, **INSI Shpk, Logos Inter Cooperation** dhe **Komuna e Kamenicës** kanë organizuar takime për konsolidimin e dokumentit përfundimtar ku e ka dorëzuar këtë version final për procedim të më tejshëm.

Dokumenti si i tillë iu nënshtrua procedurës së rregullt për marrjen e pëlqimit nga MMPH. Më tutje Kuvendi Komunal i Kamenicës mori vendimin me nr.....**datë**..... **dhe** zyrtarisht aprovojë PZHK-në e Kamenicës.

## **QËLLIMI I PROJEKTIT**

– Qëllimi kryesor i këtij projekti është që Komuna e Kamenicës të ketë një Plan Zhvillimor Komunal real dhe të zbatueshëm por edhe modern, efikas dhe të bazuar në norma e standarde evropiane. Ky projekt do të jetë në harmoni të plotë me kërkesat dhe obligimet e Ligjit për Planifikim Hapësinor 2003/14 dhe Ligji për ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor L-03/L-106 si dhe në pajtueshmëri me Draft Planin Hapësinor të Kosovës.

Plani Zhvillimor Komunal do të sigurojë bazat për një zhvillim të qëndrueshëm për qytetin e Kamenicës, pra duke krijuar bazat për:

- Shfrytëzim racional, mbrojtje dhe rregullimi të hapësirës së komunes;
- Ruajtja e vlerave natyrore dhe vlerave të krijuara me punë;
- Realizim të planifikimit hapësinor me përgatitjen e bazave për nxjerrjen e planeve të niveleve më të ulëta;
- Rregullim i hapësirës duke ua përshtatur hapësirën nevojave;
- Nxjerrjes së planit si plan afatgjatë të zhvillimit hapësinor dhe harmonizimi i ndërsjellë i këtij plani, duke u nisur nga parimet e planifikimit të njëkohshëm dhe të vazhduar me dokumentet e nivelit qendror;
- Përgatitjes dhe nxjerrjes së planit sipas mënyrës dhe procedurës së caktuar me ligj;
- Pjesëmarrjes së të gjithë shfrytëzuesve të hapësirës në procesin e përcaktimit të politikës së organizimit, rregullimit dhe shfrytëzimit të hapësirës.

Zhvillimi i qëndrueshëm do të jetë i baraspeshuar në kuptimin e zhvillimit hapësinor dhe i mbështetur në tri shtyllat bazë, ekonomik, social dhe mjedisor. Ky zhvillim do të promovojë shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve për gjeneratat e tanishme pa kërcënuar edhe gjeneratat e ardhshme dhe do rikoordinojë kërkesat sociale, ekonomike dhe mjedisore për hapësirën dhe funksionet e saj.

Plani Zhvillimor Komunal do të jetë një dokument që hartohet për territorin e Komunës të Kamenicës, për periudhën e 2012 – 2022<sup>+</sup> dokument i cili prezanton gjendjen e analizuar në komunë, prezanton vizionin për të ardhmen, kornizën e zhvillimit hapësinor, strategjitë dhe masat për zbatim, për më shumë ofron udhëzime konkrete për veprimet që duhet të ndërmerren: Pse duhet ndërmarrë ato veprime? Po ashtu, sqaron se si duhet të realizohen veprimet e tilla.

Veprime këto që do të ndikonin në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Kamenicës duke ndikuar në ngritjen e kualitetit social, ekonomik, mjedisor dhe fizik të hapësirës përkatëse.

Qëllimi i projektit është të hartojë një plan, i cili jep orientimin e zhvillimit afatgjatë por është edhe fleksibil në ndryshimet që mund të paraqiten si kërkesë e zhvillimeve në të ardhmen.

Plani i orientuar kah procesi dhe veprimi i bazuar në një vizion realist dhe i qëndrueshëm i cili për bazë të punës do ta ketë konsensusin me aktorët e planifikimit për çështjet, ku përmes procesit të konsultimeve publike dhe i bazuar në vlerësimin e gjendjes ekzistuese, resurseve potenciale, duke identifikuar çështje apo fusha ku duhet ndërmarrë veprime urgjente, me qëllim të mbrojtjes, kultivimit dhe zhvillimit të vlerave socio-ekonomike dhe mjedisore të Komunës së Kamenicës.

Në përfundim të këtij projekti me aprovimin e dokumentit i cili do të jetë i hartuar, do të strukturohen bazuar në aktin nënligjor për PZHK-në :Informata përmbajtjesore për gjendjen sociale, ekonomike të infrastrukturës dhe mjedisit, shtrirja hapësinore e dukurive, do të definohen qartë caqet e zhvillimit të qytetit, Prioritetet strategjike dhe zonat me prioritet për intervenim, zhvillimet e dëshiruara hapësinore, aktivitetet për zbatimin e kornizës së parashikuar (rruga se si do të arrihet ky zhvillim) por edhe masat përfundimtare dhe kaluese.

**Një ndër qëllimet e projektit është të lëvizet drejt një strukture të planifikimit të integruar-**Planifikimi i integruar konsiderohet si një strukturë e artit në Evropë, e cila fillimisht integron planifikimin hapësinor dhe zhvillimor; më tutje përfshinë integrimin e çështjeve zhvillimore në fushat relevante dhe përcakton bartësit e veprimeve të tyre. Përfshinë bashkimin e niveleve të ndryshme të planifikimit. Pra, për këtë planifikimi i integruar e përmirëson apo ngrit efikasitetin e planifikimit zhvillimor Komunal.

Plani Zhvillimor Komunal (PZHK), do të luanë një rol vendimtar në ofrimin e bazës për inkurajimin apo tërheqjen dhe orientimin e investimeve.

## SISTEMI I PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Sistemi i planifikimit në nivel të Komunës së Kamenicës, bazohet në sistemin e ligjeve që janë të lidhura me fushën e planifikimit e në mënyrë të veçantë në bazë të Ligjit për Planifikim Hapësinor 2003/14 dhe Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor L-03/L-106.

Sistemi i planifikimit hapësinor është i organizuar në dy nivele të planifikimit, në nivel të Kosovës dhe në nivel të komunave ku bëhet planifikimi për territorin e komunave. Llojet e planeve në bazë ligjit që përgatiten në nivelin e komunës dhe zonave urbane janë:

1. Plani Zhvillimor i Komunës
2. Plani Zhvillimor Urban
3. Planet Rregulluese Urbane.

Në bazë të ligjit, secila komunë është përgjegjëse për përgatitjen e Planit Zhvillimor të Komunës në tërë territorin e saj. Ky plan është strategjik dhe multi-sektorial, i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe hapësinor.

Ligji përcakton që komunat brenda të cilave ekzistojnë zona të veçanta të mbrojtura, implementojnë dispozitat e ligjit për zona të veçanta të mbrojtura gjatë hartimit të Planeve Zhvillimore të Komunës dhe Urbane.

Bazuar në sistemin e planifikimit në Kosovë, Plani Zhvillimor Komunal përbëhet prej pesë kapitujve kryesor dhe zhvillohet në po këto pesë faza:

- **Profili i zhvillimit hapësinor dhe analiza e gjendjes ekzistuese**– Në këtë kapitull përfshihet pjesa informative e planit, e cila përshkruan gjendjen ekzistuese në Komunë dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese
  - **Vizioni, Parimet dhe Caqet** – përfshinë fazën e dytë, ku përcaktohet vizioni për të ardhmen si dhe caqet strategjike të zhvillimit hapësinor të Komunës.
  - **Korniza e Zhvillimit Hapësinor** – Kjo fazë përcakton parashikimet e dëshiruara të zhvillimeve afatgjata hapësinore për tërë zonës urbane.
  - **Strategjitë dhe veprimet për zbatim** - Kjo fazë formulon pakon e strategjive dhe veprimet për realizimin e qëllimeve brenda kornizës hapësinore, afatet kohore, implikimet financiare dhe kornizën institucionale.
  - **Dispozitat për zbatim** – përfshijnë elementet e zbatimit obligativ (të obligueshëm) që ndërliken me nivelin komunal.
- Pas përgatitjes së Planit Zhvillimor Komunal, shqyrtimit publik, Plani Zhvillimor Urban aprovet në kuvendin komunal.



**TABELA E SHKURTESAVE:**

**TABELA E SHKURTESAVE:**

|           |   |
|-----------|---|
| AKP       | Agjencia Kosovare i Privatizimit  |
| AKK       | Asociacioni i Komunave të Kosovës   |
| BB        | Banka Botërore  |
| BE        | Bashkimi Evropian   |
| BPV (GDP) | Bruto Produkti i Vendit (Gross Domestic Product)                                  |
| BKK       | Buxheti i Konsoliduar i Kosovës   |
| ESK       | Enti Statistikor i Kosovës  |
| FMN (IMF) | Fondi Monetar Ndërkombëtar  |
| GND       | Të ardhurat nacionale në dispozicion  |
| KKK       | Kuvendi Komunal i Kamenicës   |
| MMPH      | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor                                   |
| IPH       | Instituti për Planifikim Hapësinor  |
| ZHEL      | Zhvillimi Ekonomik Lokal  |
| NVM       | Ndërmarrje të vogla dhe të mesme  |
| MTPT      | Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit                               |
| OBSH      | Organizata Botërore e Shëndetësisë  |
| OJQ       | Organizata joqeveritare   |
| OSBE      | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë                                   |
| PZHK      | Plani Zhvillimor Komunal  |
| PZHU      | Plani Zhvillimor Urban  |
| UNDP      | United nation Development program<br>Programi i kombeve të Bashkuara për zhvillim |



|               |  |
|---------------|--|
| UNHCR         | United Nations High Commissioner for refugees<br>Komisioni i lartë i kombeve të bashkime për refugjatë |
| IVE           | Indeksi i varfërisë më ekstreme  |
| IZhNj         | Indeksi i zhvillimit njerëzor  |
| NVM           | Ndërmarrje të vogla dhe të mesme   |
| OBSH          | Organizata Botërore e Shëndetësisë   |
| OJQ / NGO-të; | Organizata joqeveritare  |
| RZHNJ         | Raporti i Zhvillimit Njerëzor  |
| ZKL           | Zyra e Komuniteteve Lokale   |
| VJF           | Vendbanime Jo Formale  |
| IKMN          | Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Natyrës  |
| QRTK          | Qendra Regjionale e Tr   |

## INDEKSI I TERMINOLOGJISË

|                            |  |
|----------------------------|--|
| “Plani Zhvillimor Komunal” | Nënkupton planin për rregullimin, shfrytëzimin dhe zhvillimin e hapësirës siç është: territori i komunës, i zonës së veçantë dhe territorit të Kosovës. Plani hapësinor është Plani Hapësinor i Kosovës, Planet Hapësinore për Zona të Veçanta dhe Plani Zhvillimor i Komunës. Ky plan përshkruan afatet kohore dhe përfshinë projeksionet reale të investimeve  |
| “Plan Zhvillimor Urban”    | Nënkupton planin e përcaktuar në nenin 14 të ligjit për planifikim   |
| “Vendbanim”                | Nënkupton zonën me karakter urban, toka bujqësore, qyteti dhe vendbanimi tjetër të cilin kuvendi i komunës e ka shpallur me karakter banimi;   |
| “Vendbanim jo Formal”      | Janë vendbanime njerëzore, të cilat nuk u mundësojnë banorëve të gëzojnë të drejtat e tyre për një standard të përshtatshëm të jetesës, në veçanti banim të përshtatshëm. Si të tilla, vendbanimet joformale mund të kenë karakteristikat si në vijim: zotërim joformal i pronësisë, qasje joadekuate ose privim në shërbime elementare, pjesëmarrje joadekuate ose mospjesëmarrje në qeverisje dhe rrezikshmëri të lartë. |
| “Qytet”                    | Nënkupton vendbanimin të cilin kuvendi i komunës, duke marrë për bazë shkallën e ndërtimit, veprimtaritë dhe karakteristikat tjera të karakterit urban, e kanë përcaktuar si të tillë;   |
| ”Plani rregullues urban”   | Plani i cili cakton kushtet për rregullimin e hapësirës si dhe rregullat e lokacionit të objekteve dhe ngastrat tokësore urbane. Plani i cili do të definojnë zonat e ndërtimit dhe do të përfshijnë vijat e rregullimit, vijat e ndërtimit, normat teknike urbanistike dhe kushtet tjera lidhur me lokacionin e ndërtesave dhe ndërtimet tjera në ngastrat tokësore urbane.   |
| “Shfrytëzimi i tokës”      | Nënkupton destinimin ekzistues ose të propozuar për të cilën ngastra e tokës shfrytëzohet;   |
| “Zonë urbane”              | Është toka me kufij të përcaktuar brenda suazave të së cilës është planifikuar ndërtimi urbanistik;  |
| “Fshati”                   | Është vendbanimi në të cilin popullsia, kryesisht merret me veprimtari bujqësore;  |
| “Tokë bujqësore            | Është toka e destinuar për kultivimin e kulturave bujqësore;   |
| “Plani i infrastrukturës ” | Është paraqitja me plan e instalimeve dhe objekteve ekzistuese dhe të planifikuara nëntokësore dhe mbitokësore nga lëmi i: transportit, instalimeve elektrike, gazsjellësit, naftësjellësit, furnizimit me ujë dhe sistemet e ujërave të përdorura, telekomunikacionit dhe i instalimeve tjera;  |
| “Toka ndërtimore”          | Është toka në të cilën janë ndërtuar objektet në përputhje me planin rregullativ, përkatësisht urbanistik, ose me aktin tjetër të nxjerrë në bazë të këtij ligji është paraparë për ndërtimin e objekteve;   |
| “Sipërfaqe e mbrojtur”     | Janë sipërfaqet e vlerave të mbrojtura natyrore dhe mjedisore si dhe sipërfaqet bujqësore, trashëgimia e paluajtshme kulturore dhe arkeologjike;   |

|   |   |
|---|---|
| <b>“Zonë e mbrojtur”</b>                  | Është pjesa e hapësirës e cila caktohet me qëllim të ruajtjes të vlerave natyrore, kulturore-historike dhe arkeologjike, të mbrojtjes nga ndotja e mjedisit jetësor ose sigurimi i kushteve hapësinore për ushtrimin pa pengesë të veprimtarisë dhe siguria e banorëve dhe e hapësirës për rreth; |
| <b>“Kushtet e ndërtimit”</b>              | Janë kushtet që e përcaktojnë llojin, madhësinë, mënyrën e ndërtimit, kushtet e sigurisë dhe çdo kusht tjetër për ndërtimin e objekteve;  |
| <b>Vlerësimi i kapaciteteve investive</b> | Analizë e cila përshkruan të gjitha kapacitetet për investim në të ardhmen, përfshirë të gjitha aspektet dhe mundësitë e investimit duke filluar nga resurset ekzistuese natyrore, resurset humane, buxheti vendës, sektori privat, organizatat ndërkombëtare financiare;                         |
| <b>SWOT Analiza</b>                       | Analiza e përparësive, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve (PDMK), ndihmon që çështjet e shfaqura (të identifikuar) të klasifikohen në njërin nga këto katër grupe dhe të menaxhohen më lehtë në procesin e planifikimit;   |
| <b>Analiza e ndër-lidhjeve</b>            | Analizë përmes së cilës kërkohen lidhjet e mundshme në mes të dy çështjeve politikave dhe programeve për temën e është duke u shqyrtuar;  |
| <b>GIS / SIGJ</b>                         | Sistemi gjeografik i informatave.   |
| <b>Grupet punuese</b>                     | Janë grupe të themeluara me iniciativën e komunës dhe përbehen nga numri i ekspertëve të drejtorive dhe kompanive publike, që duhet të punojnë në zhvillimin e elementeve kryesore të PZHK-së;  |
|   |   |
| <b>Vizioni</b>                            | Deklaratë për të ardhmen e dëshiruar në bazë gjendjes ekzistuese;   |
| <b>Planifikimi Strategjik</b>             | Planifikim i orientuar në zgjedhjen e problemeve kryesore, planifikim i përqendruar në numër të kufizuar të çështjeve, promovon proces proaktiv lidhur me zhvillimet etj.;  |
| <b>Konceptet</b>                          | Mënyrë e të menduarit për të arritur deri te një gjendje e dëshiruar. Koncepti i idesë ndihmon në kërkimin e zgjidhjes së problemit. Konceptet mund të jenë tema ose fraza të përvetësuara të cilat mund të sigurojnë hulumtime më të fokusuar;   |
| <b>Plani i Veprimit</b>                   | Rrjedhë e aktiviteteve që përshkruan veprimet, përgjegjësit për ato veprime, rezultatet e pritura, implikimet kohore, organizative dhe financiare;  |
| <b>Rritja urbane</b>                      | Aspekte të ndryshme të rritjes së njësisë së vendbanimit - qytetit, aspekti territorial/fizik, socio/demografik, ekonomik;  |
| <b>Zhvillimi i qëndrueshëm Komunal</b>    | Zhvillim social ekonomik dhe mjedisor i një komune e cila shfrytëzimin e resurseve e konsideron si pasuri, që duhet të shfrytëzohet për gjeneratat e tanishme pa kërcënuar (duke u ruajtur edhe për) gjeneratat e ardhshme;   |

|                                      |  |
|--------------------------------------|--|
| <b>Zhvillimi policentrik Komunal</b> | Zhvillim i cili konsiston në zhvillimin e më shumë se një qendre të fortë në një territor të një komune , dhe insiston në shpërndarje të barabartë/komplementare të funksioneve themelore të zhvillimit;   |
| <b>Zonat – brezat e gjelbër</b>      | Zonat të cilat kanë një kontroll rigoroz të zhvillimit. Qëllimi i brezave të gjelbër, është të kontrollojë shtrirjen jo të kufizuar të zonave të ndërtimit, të pengojnë bashkëngjitjen e qyteteve fqinje, të pengojnë cënimin e peizazhit, të ruajnë mjedisin dhe karakterin specifik të qyteteve historike dhe të ndihmojë rigjenerimin urban duke inkurajuar rishfrytëzimin e tokës së braktisur dhe llojeve tjera të tokës; |
| <b>Zonat e Veçanta të Mbrojtura</b>  | Është një zonë e përcaktuar me hartë, ose me një zonë të përcaktuar që rrethon një monument, ndërtesë, grup ndërtesash, tërësi, fshat ose qendër historike të qytetit që mbrohet nga çdo zhvillim apo aktivitet i cili mund të dëmtojë kontekstin e tij historik, kulturor, arkitektural apo arkeologjik, mjedisin natyror apo kuadrin vizual estetik.   |

## 1.1.0 PROFILIN E ZHVILLIMIT HAPËSINOR DHE ANALIZËN E GJENDJES

Kjo është pjesa informative e planit, e cila përshkruan gjendjen ekzistuese në komunë dhe duhet të përmbajë:

### 1.1.1 INFORMATAT PËRMBAJTËSORE PËR SITUATËN GJEOGRAFIKE, FIZIKE, MJEDISORE DHE SOCIO-EKONOMIKE NË KOMUNËN E KAMENICËS

Komuna e Kamenicës shtrihet në Lindje të Kosovës, ku kufizohet në jugperëndim me Komunën e Ranillugut, në perëndim me Komunën Novobërdës, në veriperëndim me Prishtinën, në veri me Komunën e Medvegjës dhe të Leskocit, në lindje me Vranjën, si dhe në lindje dhe juglindje me Bujanocin. Sipërfaqja e K.Kamnenicës është **417 km<sup>2</sup>**, numri i banorëve është **36204** rezidentë dhe **4020** jorezidentë, gjithsej banorë në Komunën e Kamenicës janë **40224**, pozita e mirë gjeografike mund të konsiderohet si një mundësi për lidhje të mira rajonale dhe ndërshtetërore.

### 1.1.2 HISTORIKU I KOMUNËS

Emri i qytetit “Kamenica”, përmendet në librin e borxhlinjve të Mikel Llukarit në vitet '30-të të shek XV me emrin Chameniza. Pastaj, përmendet në defterëin turk të Vilajetit Vëllk të vitit 1455.

Gjatë luftës së dytë botërore ishte pjesë e zonës okupuese bullgare, ndërsa në nëntor të vitit 1944 ripushtohet nga Jugosllavia komuniste.


Në vitin 1959 Kamenica fiton statusin “Komunë”, si njësi e barabartë me komunat tjera në vend.

### **1.1.3 TË DHËNAT THEMELORE**

#### **Pozita gjeografike**

Komuna e Kamenicës shtrihet në lindje të Kosovës. Kufizohet në jugperëndim me Komunën e Ranillugut, në perëndim me komunën Novobërdës, në veriperëndim me Prishtinën, në veri me Komunën e Medvegjës dhe Leskocit, në lindje me Vranjën, si dhe në lindje e juglindje me Bujanocin. Sipërfaqja e K.Kamnenicës është 417 km<sup>2</sup>.

Pozita gjeografike e K.Kamenicës është periferike dhe në skajin me lindor të Kosovës, por është urë lidhëse në mes të Kosovës dhe komunave të Serbisë Jugore, kryesisht të banuara me shqiptarë. Përmes magjistrales Gjilan -Bujanoc, lidhet me qendrat tjera të Kosovës. Gjilani ndodhet në largësi 30 km, ndërsa Prishtina 75 km nga Kamenica. Me Prishtinën mund të lidhet edhe me rrugë më të shkurtëra, duke e shfrytëzuar rrugën nëpër Novobërdë dhe Llabjan. Pra, në të dy drejtimet rruga shkurtohet për 50-55 km. Stacioni më i afërt Hekurudhor është në Ferizaj dhe Bujanoc. Aeroporti më i afërt është ai i Prishtinës 90km dhe i Shkupit 130km.



Harat 1. Pozita Gjeografike e Kamenicës në Hartën e Republikës së Kosovës.

## 1.1.4 DEMOGRAFIA DHE ZHVILLIMI SOCIAL


Bazuar në rrjedhën e zhvillimit të komponenteve të zhvillimit demografik, më realisht mund të planifikohen kërkesat edhe për të tashmen edhe për të ardhmen. Të dhënat për numrin e popullsisë, kryesisht i japin regjistrimet e popullsisë. Përkitazi për këtë, në periudhën kohore 1948 – 1981<sup>1</sup> janë të dhënat, për numrin e popullsisë së Komunës së Kamenicës sipas regjistrimeve të popullsisë.

Gjithashtu, janë shfrytëzuar të dhënat e regjistrimit 1991 që na japin edhe një vlerësim për faktin se, në atë kohë kishte manipulime, por megjithatë **konsiderohen si relativisht të sakta. Të dhëna mjaft të rëndësishme për popullsinë e komunës, konsiderohen ato të vitit 2004** kur Komuna e Kamenicës kishte bërë një regjistrim për nevojat e brendshme komunale. Janë shfrytëzuar edhe të dhëna nga institucione të tjera dhe hulumtimet që janë realizuar në fushën e zhvillimit demografik në Kosovë dhe komunë.

Mbi 34 % të popullsisë së përgjithshme në komunë, janë me moshë të re 0 deri 19 vjeç; ndërsa grup-moshat mbi 65 vjeç kanë pjesëmarrje të vogël, rreth 5% të popullsisë së përgjithshme.

| Viti regjistrimit | 1948  | 1953  | 1961  | 1971  | 1981  | 1991  | 2009(vler) |
|-------------------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|------------|
| Nr. i banorëve    | 36676 | 39977 | 43058 | 46506 | 48320 | 52152 | 54000      |


Tab1. Regjistrimi i popullsisë sipas viteve(tërë territori pa decentralizim)



Graf 1. Numri i banoreve ne tërë territorin e komunes pa decentralizim.

|                   |       |       |       |       |       |       |       |
|-------------------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|
| Viti regjistrimit | 1948  | 1953  | 1961  | 1971  | 1981  | 1991  | 2011  |
| Nr. i banorëve    | 29937 | 32305 | 34064 | 37474 | 38934 | 40884 | 40224 |

Tab. 2. Regjistrimi i popullsisë sipas viteve(tërë territori me decentralizim 2011)



Graf.2. Numri i banoreve ne territorin e komunes me decentralizim.

| Mosha         | Nr. i popullsisë | %           |
|---------------|------------------|-------------|
| Prej 0 – 6    | 6821             | 16.95%      |
| Prej 7 – 15   | 6092             | 15.15%      |
| Prej 16 – 19  | 2483             | 6.19%       |
| Prej 20 – 40  | 10756            | 26.74%      |
| Prej 41 – 65  | 12256            | 30.46%      |
| Mbi 65        | 1816             | 4.51%       |
| <b>Totali</b> | <b>40224</b>     | <b>100%</b> |

Tab. 3. Struktura e popullsisë sipas moshës



| Nr. Rendor | Vendbanimet              | Nr. I banorëve |
|------------|--------------------------|----------------|
| 1          | Kamenicë                 | 7303           |
| 2          | Berivojë                 | 1555           |
| 3          | Bllatë                   | 35             |
| 4          | Bratillo                 | 31             |
| 5          | Busavatë                 | 818            |
| 6          | Dajkoc                   | 378            |
| 7          | Dazhnicë                 | 80             |
| 8          | Desivojë                 | 177            |
| 9          | Firiqevë                 | 61             |
| 10         | Gmicë                    | 85             |
| 11         | Gogollof                 | 10             |
| 12         | Gragjenik                | 2              |
| 13         | Grezimë                  | 457            |
| 14         | Gjyrishec                | 58             |
| 15         | Hajnoc                   | 353            |
| 16         | Hodonoc                  | 2443           |
| 17         | Hogosht                  | 1700           |
| 18         | Huboc                    | 86             |
| 19         | Karaqeva e epërme        | 1412           |
| 20         | Karaqeva e poshtme       | 943            |
| 21         | Kollolëq                 | 176            |
| 22         | Kopërnice                | 1258           |
| 23         | Koretin                  | 3478           |
| 24         | Kostadinca               | 48             |
| 25         | Kranidell                | 131            |
| 26         | Kremenatë 1              | 7              |
| 27         | Kremenatë 2              | 0              |
| 28         | Krilevë                  | 586            |
| 29         | Laçiq                    | 160            |
| 30         | Leshtar                  | 449            |
| 31         | Lisock                   | 98             |
| 32         | Marocë                   | 64             |
| 33         | Meshtinë                 | 114            |
| 34         | Moçar                    | 139            |
| 35         | Muçivërc                 | 1520           |
| 36         | Novosellë                | 311            |
| 37         | Petroc                   | 1252           |
| 38         | Pollqë                   | 217            |
| 39         | Qarakoc                  | 60             |
| 40         | Rahovicë                 | 42             |
| 41         | Rogoçicë                 | 2651           |
| 42         | Ruboc                    | 386            |
| 43         | Sedllar                  | 22             |
| 44         | Shahiq                   | 47             |
| 45         | Strezoc                  | 276            |
| 46         | Sfirc                    | 59             |
| 47         | Shahiq                   | 34             |
| 48         | Shipashnicë e epërme     | 1261           |
| 49         | Shipashnicë e poshtme    | 771            |
| 50         | Tërsten                  | 100            |
| 51         | Topanicë                 | 2061           |
| 52         | Tugjoc                   | 130            |
| 53         | Vaganesh                 | 10             |
| 54         | Velegllavë e epërme      | 73             |
| 55         | Velegllavë e poshtme     | 0              |
| 56         | Vriqec                   | 78             |
| 57         | Zajqec                   | 46             |
| 58         | Zhuj                     | 42             |
| 59         | Gjithësej Rezident       | 36204          |
| 60         | Gjithësej Rezident       | 4020           |
| 61         | Nr. I Banorëve në Komunë | 40224          |



Graf 3. Numri i popullsisë në Komunën e Kamenicës (viti 2011)



### 1.1.5 RASTET SOCIALE

Territori i Komunës së Kamenicës është kodrinoro-malorë (70%) dhe rrafshinor (30%), me disa lugina rreth lumenjëve Krivarekë, Desivojcë dhe Hogosht që shtrihen në veri – Lindje dhe veri - Perëndim. Toka është kryesisht pjellore, e pasur edhe me kullosa, e përshtatshme për zhvillim të pemëtarisë, perimtarisë, lavërtarisë dhe blegtorisë.

Kamenica ka klimë të mesme kontinentale, me verëra të nxehta dhe dimëra të ftohtë. Reshjet atmosferike mesatarisht sillen prej 499 – 675 l/m<sup>2</sup>.

Banimi, është funksion bazë i vendbanimeve që ndikon në rrjedhën e zhvillimit të gjithmbarshëm të shoqërisë, si dhe është çështje vendimtare për stabilitet social, ambient, shëndet dhe zhvillimin kualitativ të mirëqenies njerëzore, njëherazi është komponentë e rëndësishme e zhvillimit ekonomiko-social, respektivisht të standardit jetësor të qytetarëve në përgjithësi.

Banimi është ndër problemet esenciale për zhvillimin social, ekonomik dhe politik të vendit, andaj është me rëndësi krijimi i mekanizmave të cilët do të ofronin zgjidhjen e kushteve adekuate për banim për të gjithë qytetarët, në veçanti për kategoritë më të rrezikuara sociale.

Qëllimi i këtij punimi është të mobilizohen faktorët relevantë për krijimin e kornizës ligjore, institucionale, ekonomike dhe skemave të ndryshme të banimit si dhe të propozohen masat adekuate për të përmirësuar situatën e rëndë të banimit në komunën e Kamenicës.

Nga analiza e të dhënave vlerësohet se në Kamenicë ka mungesë të njësive për banim.

Pas luftës migrimi i familjeve drejt qyteteve të mesme dhe të mëdha si dhe nataliteti i lartë janë faktori kryesor që ka rritur kërkesat për banim.

Mungesa e aktiviteteve ekonomike dhe standardeve të tjera të jetës shoqërore ka ndikuar në migrimin e familjeve fshat-qytet.

Përkundër numrit të madh të papunëve, të ardhurave të ulëta, mesatares së lartë të anëtarëve për familje, çmimeve të larta të banesave dhe të qiradhënies, është i domosdoshëm krijimi i mekanizmave dhe angazhimit të institucioneve lokale në lehtësimin dhe afrimin e kushteve për banim sa më të adekuat.

Në shërbimin e asistencës sociale janë të përfshira dy lloj të kategorive të shfrytëzuesve të ndihmave sociale , kategoria e parë dhe kategoria e dytë .

Në kategorinë e parë janë të përfshirë 344 familje me gjithsej 1353 anëtarë , ndërsa në kategorinë e dytë janë të përfshirë 238 familje me 1130 anëtarë , që do të thotë se në asistencë janë të përfshirë 582 familje.

Numri i shfrytëzuesve variron (lëvizë) prej muajit në muaj, varësisht prej kriterëve që janë të përcaktuara me ligj.


Vlen të theksohet se numri i shfrytëzuesve të ndihmave sociale gjatë këtij viti është në rritje si pasojë e papunësisë dhe rritjes së varfërisë së popullatës në komunë.



**SHKALLA E VARFËRSË  
SCALE OF POVERTY  
STOPA SIROMAŠTVA**

**LEGJENDA / LEGEND / LEGENDA**

- Kufi komunal
- Zonë kadastrale
- Shkalla e Varfërsë**
- Nuk ka të dhëna
- Shkalla e ulët e Varfërsë
- Shkalla mesatare e Varfërsë
- Shkallë e lartë e Varfërsë
- Vendbanimet



3,600 1,800 0 3,600 Meters

Shkalla / Scale / Razmera  
1:150,000

Burimi i të dhënave: Agjencia Kadastrale e Kosovës  
Institucionet e Komunës së Kamenicës  
Grupi për Demografi dhe Çështje Sociale  
Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale

Projected Coordinate System: KosovaRef01  
Projection: Transverse\_Mercator  
Geographic Coordinate System: GCS\_ETRS\_1989  
Datum: D\_ETRS\_1989  
Prime Meridian: Greenwich  
Angular Unit: Degree



Harta. 3. Shkalla e varfërisë në Komunën e Kamenicës

### **Pas konsultimeve me stafin e QPS-së, në lidhje me planin zhvillimor , ne propozojmë:**

1. Të parashihet një objekt për banim social, këtë propozim e bëjmë duke e ditur nga terreni se shumë familje nuk i kanë as kushtet minimale për jetesë. Këtu mund të përfshihen familjet që kanë nevojë, invalidëve dhe familjarëve të dëshmorëve të luftës së **UÇK**-së, si dhe kategoritë tjera familjare.
2. Në kuadër të këtij objekti, QPS-së i nevojitet edhe një banesë që të jetë e lirë për strehim të përkohshëm të ndonjë rasti ( dhuna familjare , të miturit që mund të hasen në rrugë gjatë natës etj. ).
3. Siç jemi duke e vërejtur, në komunën tonë kategoria e personave të moshuar pa përkujdesje është në rritje e sipër, prandaj në të ardhmen duhet të parashihet një objekt rezidencial për këtë kategori .
4. Shërbimit social , për shkak të natyrës së punës që ka, i nevojitet një fond i posaçëm (mjete financiare) për të intervenuar në raste të jashtëzakonshme . Këtë e arsyetojmë nga se ndodhë, shpesh herë të hasim në familje që u mungon edhe ushqimi, e ne nuk kemi mundësi që në mënyrë urgjente ti dalim në ndihmë. Për të ndihmuar raste të tilla, ndonjëherë mund të zgjasin procedurat deri në një muaj.

#### **1.1.5.1. PAPANËSIA NË KOMUNËN E KAMENICËS**

Për shkak të nivelit të ulët të zhvillimit ekonomik popullata e Komunës së Kamenicës brengën më të madhe e ka papunësinë, e cila është rreth 45%. Në fund të tetorit të vitit 2010 në Zyrën Komonale për Punësim në Kamenicë ishin të regjistruar 6079 punëkërkues, prej të cilëve 3330 ose 54,78.22% meshkuj dhe 2749 ose 45.22% femra.

Qëllimi apo synimi i këtij punimi është, paraqitja e shtresëzimit të papunësisë mes gjinive, moshave, të hendikepuarëve dhe komuniteteve në Komunën e Kamenicës. Në epiqendër të këtij punimi është çështja e punësimin të qytetarëve të Kamenicas dhe shtresëzimi i papunësisë si dhe pasojat e saj.

Shtresëzimi i shoqërisë ka ekzistuar dhe vazhdon të ekzistojë në të gjitha shoqëritë e botës. Në vendet me zhvillim të madh ekonomik dhe në vendet demokratike stratifikimi i shoqërisë është në dozë më të vogël. Ndërsa në vendet që janë në fazën e tranzicionit, ka ndryshim më të madh të shoqërisë dhe stratifikimi i shoqërisë ekziston në masë më të madhe. Në vijim po i japim këto të dhëna:

5722 ose 64,82% janë të pakualifikuar

232 ose 2,63% janë gjysmë të kualifikuar

232 ose 2,62% janë të kualifikuar

2536 ose 28,73% janë me shkollë të mesme

31 ose 0,35 % janë me shkollë të lartë

75 ose 0,85 % janë me fakultet.

Të pakualifikuar, konsiderohen ata punëkërkuesë që e kanë të kryer ose jo shkollën fillore apo edhe ndonjë vit të shkollës së mesme, mirëpo që nuk kanë ndonjë dëshmi se e zotërojnë deri diku ndonjë profesion. Fakti se i kemi mbi 64,82% të punëkërkuesve të pakualifikuar, flet për nevojën e madhe që

ata të dërgohen në aftësime të ndryshme profesionale. Tani për tani, në kuadër të institucioneve në mund të dërgojmë në aftësime në Qendrën për Aftësim Profesional në Gjilan. Aty aftësimi është pa pagesë, mirëpo shpenzimet e rrugës, humbja e kohës dhe fakti se aftësimi mund të kryhet vetëm në pesë profesione, ka ndikuar që vetëm një numër i vogël i punëkërkuarëve të komunës sonë të shkojnë në ato aftësime.

Qasja dhe konceptimi i këtij punimi përshkohet jo vetëm nga përpjekja për ta pasqyruar temën e trajtuar, por edhe për ti shqyrtuar ato nga aspekti i mendimit sociologjik. Me rastin e hartimit të punimit, jam përpjekur që të bëj një trajtim të çështjes sa më objektive dhe reale, pra paraqitjen sa më të saktë të mundshme të shtresëzimit shoqëror, duke përdorur statistika lidhur me papunësinë dhe punësimin e qytetarëve Kamenicës.

Punimi ngërthen në vete tri qasje kryesore metodologjike: prezantuese- me të cilën jepet pasqyrimi i çështjes së caktuar; analiza- apo zbërthimi i çështjes dhe shtjellimi i saj; konkluzionet-dhënia e mendimit dhe nxjerrja e përfundimit për çdo çështje të trajtuar.

Gjithë punimi përmban shtresëzime, statistika, mendime, konkluzione mbi çështjen e shtresëzimit të papunësisë në Komunën e Kamenicës. Të gjitha statistikat për shtresëzimin e shoqërisë që janë paraqitur në këtë punim, janë marrë në Qendrën për Punësim në Kamenicë. Punimi përmban në vete dy tema të trajtuara: papunësinë dhe efektet e papunësisë në komunën e Kamenicës, si dhe temën shtresëzimin për statistikat komunale të papunësisë.

Punimi është punuar duke u munduar që çështjet ti paraqesë në mënyrë sistematike dhe koncize, pra duke i parashtruar të gjitha problemet esenciale (thelbësore) të temës së trajtuar në punim. Veçanërisht, është bërë përpjekje që këto çështje të shpjegohen dhe të shtjellohen në mënyrë të kuptueshme dhe të qartë.

#### **1.1.5.2. PAPUNËSIA DHE EFEKTET E PAPUNËSISË NË KOMUNËN E KAMENICËS**

Termi papunësi është fenomeni kryesor, i cili bënë shtresëzimin e shoqërisë në të gjithë botën. Këto dy fenomene (papunësia dhe shtresëzimi social), sot paraqesin sfidën kryesore të shoqërisë kosovare dhe luftën prioritare të Qeverisë së Kosovës. Papunësia sot në Kosovë ka marrë përmasa të gjera, e cila është vazhdimisht në rritje. Pra, do të thotë se shtresëzimi social dhe klasat në Kosovë, vazhdojnë të jenë në masë të madhe. Fenomeni papunësisë shkakton edhe të keqën më të madhe të një shoqërie, varfërinë-ndarjen e shoqërisë në klasa sociale; ndërsa varfëria në Kosovë është në stadin ndoshta më të lartë në Evropë. Në Kosovë jetojnë rreth 40% e popullsisë në varfëri, ndërsa rreth 16% në varfëri të skajshme, pra njëkohësisht këto janë edhe shifrat më të larta të varfërisë në rajon. Papunësia dhe shtresëzimi i shoqërisë janë dy tërëme që karakterizojnë shtetet në tranzicion siç është edhe Kosova, por nëse ato nuk luftohen me të gjitha masat, atëherë do të jetë vështirë që shteti të dalë nga tranzicioni dhe që të reformohet, dhe këto dy "fenomene" të një shoqërie do ta përcjellin atë për një periudhë të gjatë kohore. Të gjitha shtetet që kanë kaluar nëpër procesin e tranzicionit janë përballur me papunësi dhe shtresëzim social. Disa nga këto shtete e kanë përballuar me sukses këtë gjendje dhe sot janë shtete të zhvilluara e të industrializuara, në të cilat natyrisht që ekziston shtresëzimi social, por jo në masë të madhe sa në vendet në tranzicion, ndërsa shtetet të cilat nuk e kanë përballuar me sukses këtë gjendje sot ende ndodhen në procesin e tranzicionit dhe reformimit politik e ekonomik. Prandaj në këto shtete ndodhin shtresëzime të shumta e të mëdha shoqërore. Pra, edhe Kosova sot, është në një proces të

tranzicionit ku duhet ti përballojë këto dy sfida me sukses. Diku më shumë e diku më pak, shtresëzimi është i shtrirë në të gjithë territorin e Kosovës pa bërë përjashtime ndaj asnjë komune brenda saj.

Kur flitet për fenomenin e papunësisë dhe shtresëzimit, atëherë edhe Komuna e Kamenicës nuk mund të anashkalohet. Ajo gjendet në pjesën lindore të Kosovës, ku i ka 40224 banorë dhe afërsisht 6500 familje. Së bashku me Gjilanin dhe Vitinë, është pjesë e rajonit të Anamoravës. Kamenica ka territor kodrinor –malor, e pasur me pyje, por dhe me tokë të përshtatshme për bujqësi. Kamenicasit janë kryesisht bujq, ndërsa një pjesë më e vogël e banorëve merren edhe me tregti, me biznese të vogla dhe të mesme. Mirëpo mungesa e subvencioneve dhe stimulimeve qeveritare për bujqësinë e kësaj pjese të Kosovës, e bën Kamenicën një prej rajoneve më të varfëra të Kosovës.

Edhe në Komunën e Kamenicës si edhe në të gjithë Kosovën, problemi i varfërisë dhe i shtresëzimit social është shumë i theksuar.

Në kategorinë e parë janë të përfshira 344 familje me gjithsej 1353 anëtarë , ndërsa në kategorinë e dytë janë të përfshira 238 familje me 1130 anëtarë , që d.m.th. se në asistencë janë të përfshira 582 familje.

Rreth 60% e qytetarëve Kamenicas jetojnë në varfëri, ndërsa prej tyre 517 familje me rreth 2950 anëtarë janë në varfëri të skajshme, d.m.th. në mjerim. Kjo kategori e qytetarëve, mbështetjen e tyre për ndihmë e gjejnë në Organizatën Komunale të Kryqit të Kuq të Kamenicës dhe në Qendrën për Ndihma Sociale në Kamenicë. Nga Organizata e Kryqit të Kuq ndihma ushqimore dhe jo ushqimore marrin 517 familje me 2950 anëtarë. Por skamnorëve Kamenicas, në ndihmë shumë herë u dalin edhe bizneset private , si dhe disa qytetarë të cilët solidaritetin dhe humanitetin e vet e kanë shprehur, sidomos gjatë festave të ndryshme fetare. Gjithashtu ka raste, ku prore atyre u ofrohet ndihma për mbijetesë (me gjëra ushqimore, veshmbathje, etj. Përkitazi për skamnorët e Kamenicës, Kryqi i Kuq i Kosovës ka treguar një kujdes të madh. Është për t'u lavdëruar shpeshherë edhe bashkë-humaniteti i banorëve Kamenicas, të cilët shpesh herë kanë ditur ta shprehin atë ndaj kategorisë me gjendjen më të rëndë sociale.

Në Komunën e Kamenicës në të kaluarën janë evidentuar probleme edhe me vet organizatat humanitare, të cilat ndodhen në këtë komunë. Fatkeqësisht, disa organizata ndërkombëtare humanitare, të cilat vepruan në komunë pas lufte u larguan duke kryer misionin e tyre emërgjent, ndërkaq përgjegjësia dhe pësia për organizatat vendëse humanitare u shtua. Si pasojë e këtij largimi problemet e familjeve skamnore u thelluan, sepse u ndërpreu ndihmat nga ato (organizatat humanitare ndërkombëtare). Fakti ishte se organizatat e vendëse, sa po kishin lindur dhe nuk kishin fonde për të mbuluar gjitha nevojat që kishin familjet skamnore që tashti mbetën pa përkujdesje. Këtë ikje të organizatave ndërkombëtare humanitare e pësoi edhe Shoqata Humanitare Bamirëse “Nëna Tërëzë”, e cila kishte krijuar një traditë, në kohën e viteve 90-ta, kishte mbeti pa fonde. Mirëpo falë donacioneve nga kompanitë e ndryshme si Caritasi dhe KFOR-i amerikan, deri diku ka arritur ti përballojë kërkesat e shumta për ndihma nga ana e familjeve skamnore.

Këto rrethana të vështira në të cilat jetojnë banorët e Kamenicës kanë krijuar edhe një shtresë tjetër duke shtyrë që ambicia kryesore e të rinjve Kamenicas të jetë emigrimi në ndonjë nga shtetet e Evropës Perëndimore për të ndryshuar sa do pak gjendjen sociale duke u mundur që të zhdukin klasat dhe mos të ketë shtresëzime të shoqërisë. Gjë e cila edhe është shprehur në një masë të madhe sidomos pas vitit 2000 e këndej.

### 1.1.5.3. SHITESËZIMI PËR STATISTIKAT KOMUNALE TË PAPUNËSISË

Në komunën e Kamenicës sikur në të gjitha komunat e Kosovës, ekziston shtresëzimi social, sepse është një numër i madh i banorëve të pa punësuar, ku kurrë nuk reshtën së kërkuari punë. Në Qendrën për Punësim në Kamenicë, është regjistruar një numër i madh i qytetarëve të papunësuar, si femra ashtu edhe meshkuj. Mirëpo krahas numrit e të regjistruarve në këtë qendër, ka edhe një numër më të madh të personave të cilët nuk janë të punësuar por njëkohësisht edhe nuk janë të regjistruar në të. Kjo ndodhë për shumë arsye, ku njëra prej kryesoreve është mosbesimi qytetar ndaj institucioneve, përkatësisht ndaj Qendrës për Punësim se, ata do të mund të kryenin rolin ndërmjetësuesit në lidhjen e kontratave të punës për ndonjë qytetar të vetëm. Midis qytetarëve është krijuar bindja se Qendra për Punësim është vetëm një institucion, i cili shërben për nxjerrjen e statistikave për personat e pa punësuar dhe assesi si një institucion, i cili mund ta mënjanojë problemin e papunësisë. Megjithëse, Qendra për Punësim nuk e ka fuqinë e mënjanimit të tërësishëm të papunësisë dhe zhdukjen e klasave, ajo kontribuon mjaft në zbutjen e shtresave sociale dhe uljen e numrit e të pa punësuarve. Qendra për Punësim, para së gjithash ka një rëndësi të madhe në aftësimin ose kualifikimin për një profesion të caktuar të personave pa kualifikim.

Për shkak të nivelit të ulët të zhvillimit ekonomik, popullata e Komunës së Kamenicës brengën më të madhe e ka papunësinë e cila është rreth 45%. Në fund të tetorit të vitit 2010 në Zyrën Komunale për Punësim në Kamenicë ishin të regjistruar 6079 punëkërkuesë, prej të cilëve 2749 ose 45.22% femra., ndërsa meshkuj janë 3330 ose rreth 55% .

Sipas nacionaliteteve (përkatësisë etnike), prej këtyre nga nacionaliteti serb janë gjithsej 592 të paraqitur për punë, prej tyre meshkuj janë 396 dhe femra 196 pra këtu shihet shtresëzimi i shoqërisë mes gjinive dhe komuniteteve.

Sipas statistikave komunale për punësimin në Komunën e Kamenicës, në sektorin publik (shërbimin civil) janë të punësuar gjithsej 1193 qytetarë, prej tyre meshkuj janë 842 dhe femra 351 ndërsa në sektorin privat të punësuar janë gjithsej 3234 persona, prej të cilëve 2250 meshkuj dhe 984j femra.

Pra, sipas këtyre statistikave vërehet qartë punësimi dhe punëkërkuesit sipas shtresave të ndryshme të shoqërisë, sipas përkatësisë gjinore, grupmoshave (moshore), përkatësisë etnike, shkallës së përgatitjes shkollore, akademike etj. Sipas këtij punimi vërehen edhe shtresëzime të tjera në Kamenicë, siç është shtresa e të rinjve të cilët synim kanë Evropën.

Në Komunën e Kamenicës në shërbimin e asistencës sociale janë të përfshira dy lloje të kategorive të shfrytëzuesve të ndihmave sociale: kategoria e parë dhe kategoria e dytë .

Në kategorinë e parë janë të përfshira 344 familje me gjithsej 1353 anëtarë , ndërsa në kategorinë e dytë janë të përfshira 238 familje me 1130 anëtarë , që do të thot se në asistencë janë të përfshira 582 familje.

Shuma mujore që marrin këto familje është 38,420 euro.

Numri i shfrytëzuesve variron (lëvizë) prej muajit në muaj, varësisht prej kritereve që janë të përcaktuara me ligj.

Vlen të theksohet se numri i shfrytëzuesve të ndihmave sociale gjatë këtij viti është në rritje si pasojë e papunësisë dhe rritjes së varfërisë së popullatës në Komunën e Kamenicës.



Ajo që vlen të theksohet është se, një numër i madh i familjeve janë larg institucioneve shkollore, shëndetësore si dhe shërbimeve administartive, prandaj në të ardhmen duhet të punohet për një mirëqenje më të mirë për qytetarët e komunës sonë.

Sektori i shërbimeve sociale është një shërbim mjaft me rëndësi për qytetarët tanë.

Ky shërbim ka të bëjë me një numër të madh të punëve, të cilat janë mjaft të ndjeshme, të cilat do ti thksojmë më poshtë:

- Kategoria e fëmijëve jetim ose pa përkujdesje prindore
- Fëmijët me aftësi të kufizuara
- Fëmijët e prindërve të shkurorë apo të ndarë
- Fëmijët e keqtrajtuar
- Adoptimet
- Vendosija e fëmijëve nën kujdestari
- Martesat e të miturve
- Fëmijët me sjellje asociale , delikuenca e të miturve
- Trafikimi i qenieve njerëzore, sidomos kur janë në pyetje personat e mitur apo fëmijë
- Dhuna në familje , çrregullimi i marrëdhënieve familjare
- Sanimi i marrëdhënieve familjare dhe bashkëshortore
- Asistenca sociale, sidomos për personat e moshuar – vendosja e tyre në shtëpinë e pleqëve .


Në bazë të asaj që është theksuar shihet se, kemi të bëjmë me një kategori mjaft të ndjeshme të qytetarëve që presin ndihmën tonë.



**PAPUNËSIA  
UNEMPLOYMENT  
NEZAPOSLENOST**

**LEGJENDA / LEGEND / LEGENDA**

- Kufi komunal
- Zonë kadastrale
- Struktura e Papunësisë**
- Nuk ka të dhëna
- Shkalla e ulët e papunësisë
- Shkalla mesatare e papunësisë
- Shkallë e lartë e papunësisë
- Vendbanimet



3,700 1,850 0 3,700 Meters

Shkalla / Scale / Razmera  
1:150,000

Burimi i të dhënave: Agjencia Kadastrale e Kosovës  
Institucionat e Komunës së Kamenicës  
Grupi për Demografi dhe Çështje Sociale  
Ministria e Punës dhe Mirënjës Sociale  
Zyra për Punësim Kamenicë

Projected Coordinate System: KosovaRef01  
Projection: Transverse\_Mercator  
Geographic Coordinate System: GCS\_ETRS\_1989  
Datum: D\_ETRS\_1989  
Prime Meridian: Greenwich  
Angular Unit: Degree




Harta. 4. Struktura e papunësisë në Komunën e Kamenicës  
**1.1.1 STRUKTURA E PUNËKËRKUESVE NË KAMENICË**

Për shkak të nivelit të ulët të zhvillimit ekonomik popullata e Komunës së Kamenicës brengën më të madhe e ka papunësinë, e cila është rreth 45%. Në fund të tetorit të vitit 2010 në Zyrën Komonale për Punësim në Kamenicë ishin të regjistruar 6079 punëkërkesë, prej të cilëve 2749 ose 45.22% femra.

| Grupmosha                     | Struktura kualifikuese |      |                       |    |                |   |                     |     |                     |   |             |    |             |             |
|-------------------------------|------------------------|------|-----------------------|----|----------------|---|---------------------|-----|---------------------|---|-------------|----|-------------|-------------|
|                               | Të Pakualifikuar       |      | Gjysmë të kualifikuar |    | Të kualifikuar |   | Me shkollë të mesme |     | Me shkollë të lartë |   | Me fakultet |    | Gjithsej    |             |
|                               | M                      | F    | M                     | F  | M              | F | M                   | F   | M                   | F | M           | F  | M           | F           |
| <b>Prej 15-24</b>             | 1056                   | 620  | 30                    | 15 | 37             | 0 | 828                 | 317 | 5                   | 2 | 23          | 8  | <b>1979</b> | <b>962</b>  |
| <b>Prej 25-39</b>             | 1886                   | 1120 | 106                   | 31 | 117            | 4 | 829                 | 197 | 5                   | 2 | 24          | 5  | <b>2967</b> | <b>1359</b> |
| <b>Prej 40-54</b>             | 671                    | 358  | 31                    | 10 | 56             | 1 | 256                 | 44  | 13                  | 1 | 12          | 0  | <b>1039</b> | <b>414</b>  |
| <b>Mbi 55</b>                 | 7                      | 4    | 8                     | 1  | 15             | 2 | 58                  | 7   | 3                   | 0 | 3           | 0  | <b>94</b>   | <b>14</b>   |
| <b>Gjithsej</b>               | 3620                   | 2102 | 175                   | 57 | 225            | 7 | 1971                | 565 | 26                  | 5 | 62          | 13 | <b>6079</b> | <b>2749</b> |
| <b>TOTALI I PUNËKËRKUESVE</b> |                        |      |                       |    |                |   |                     |     |                     |   |             |    | <b>8828</b> |             |

**Tab. 4. Struktura e punëkërkesve sipas kualifikimit dhe moshës**



**Graf. 4. Struktura e punëkërkesve sipas grupmoshës**

Siç po shihet nga tabela nga gjithsej 6079 punëkërkesë 3620 ose 59.54% janë të pakualifikuar. Të pakualifikuar konsiderohen ata punëkërkesë që e kanë të kryer ose jo shkollën fillore apo edhe ndonjë vit të shkollës së mesme, por që nuk posedojnë ndonjë dëshmi se e zotërojnë deri diku ndonjë profesion. Nga 3620 punëkërkesë të pakualifikuar 2102 ose 58% janë femra. Fakti se i kemi mbi 59% të punëkërkesve të pakualifikuar flet për

nevojën e madhe që ata të dërgohen në aftësime të ndryshme profesionale. Tani për tani, në kuadër të institucioneve ne mund t'i dërgojmë në aftësime në Qendrën për Aftësim Profesional në Gjilan. Aty aftësimi është pa pagesë, por shpenzimet e rrugës, humbja e kohës dhe fakti se aftësimi mund të kryhet vetëm në pesë profesione' ka ndikuar që vetëm një numër i vogël i punëkërkuësve të komunës sonë të shkojnë në ato aftësime.

Po ashtu, nga tabela shihet se numrin më të madh të punëkërkuësve e përbëjnë të rinjtë, edhe atë prej moshës 16 deri në moshën 24 vjeç janë 1979 punëkërkuësë, ndërsa prej moshës 25 deri në 39 vjeçare janë 2967. Nëse i mbledhim punëkërkuësit e këtyre dy grupmoshave numri arrinë në 4946 që e përbën mbi 81% të numrit të përgjithshëm.

| Koha e pritjes  | Struktura kualifikuese |             |                       |           |                |          |                     |            |                     |          |             |           |             |             |
|---|------------------------|-------------|-----------------------|-----------|----------------|----------|---------------------|------------|---------------------|----------|-------------|-----------|-------------|-------------|
|   | Të Pakualifikuar       |             | Gjysmë të kualifikuar |           | Të kualifikuar |          | Me shkollë të mesme |            | Me shkollë të lartë |          | Me fakultet |           | Gjithsej    |             |
|   | M                      | F           | M                     | F         | M              | F        | M                   | F          | M                   | F        | M           | F         | M           | F           |
| <b>Mbi një vit</b>                                    | 3300                   | 1933        | 170                   | 54        | 200            | 6        | 1802                | 501        | 23                  | 4        | 52          | 11        | 5547        | 2509        |
| <b>6 muaj deri në një vit</b>                         | 166                    | 87          | 3                     | 2         | 15             | 1        | 89                  | 34         | 2                   | 1        | 6           | 1         | 281         | 126         |
| <b>3 deri në 6 muaj</b>                               | 154                    | 82          | 2                     | 1         | 10             | 0        | 80                  | 30         | 1                   | 0        | 4           | 1         | 251         | 114         |
| <b>Gjithsej</b>                                       | <b>3620</b>            | <b>2102</b> | <b>175</b>            | <b>57</b> | <b>225</b>     | <b>7</b> | <b>1971</b>         | <b>565</b> | <b>26</b>           | <b>5</b> | <b>62</b>   | <b>13</b> | <b>6079</b> | <b>2749</b> |
| <b>Numri i përgjithshëm i punëkërkuësve në komunë</b> |                        |             |                       |           |                |          |                     |            |                     |          |             |           | <b>8828</b> |             |

**Tab. 5 Struktura e punëkërkuësve sipas kualifikimit dhe kohëzgjatjes së pritjes për punë**

Nga kjo tabelë shihet se 5547 ose 91% e punëkërkuësve janë persona që presin për punë një vit e më shumë. Pra, janë punëkërkuës afatgjatë.

| Nacionaliteti    | Struktura kualifikuese |             |                       |           |                |          |                     |            |                     |          |             |           |             |             |
|------------------|------------------------|-------------|-----------------------|-----------|----------------|----------|---------------------|------------|---------------------|----------|-------------|-----------|-------------|-------------|
|                  | Të Pakualifikuar       |             | Gjysmë të kualifikuar |           | Të kualifikuar |          | Me shkollë të mesme |            | Me shkollë të lartë |          | Me fakultet |           | Gjithsej    |             |
|                  | M                      | F           | M                     | F         | M              | F        | M                   | F          | M                   | F        | M           | F         | M           | F           |
| <b>Shqiptarë</b> | 3303                   | 1917        | 175                   | 57        | 221            | 6        | 1794                | 511        | 23                  | 4        | 60          | 13        | 5576        | <b>2508</b> |
| <b>Serbë</b>     | 220                    | 142         | 0                     | 0         | 3              | 1        | 168                 | 52         | 3                   | 1        | 2           | 0         | 396         | <b>196</b>  |
| <b>Rom</b>       | 94                     | 42          | 0                     | 0         | 1              | 0        | 9                   | 2          | 0                   | 0        | 0           | 0         | 104         | <b>44</b>   |
| <b>Të tjerë</b>  | 3                      | 1           | 0                     | 0         | 0              | 0        | 0                   | 0          | 0                   | 0        | 0           | 0         | 3           | <b>1</b>    |
| <b>Gjithsej</b>  | <b>3620</b>            | <b>2102</b> | <b>175</b>            | <b>57</b> | <b>225</b>     | <b>7</b> | <b>1971</b>         | <b>565</b> | <b>26</b>           | <b>5</b> | <b>62</b>   | <b>13</b> | <b>6079</b> | <b>2749</b> |

**Tab 6. Struktura nacionle e punëkërkuësve në Komunën e Kamenicës**

Pas shkëputjes së 18 fshatrave të banuara me serbë struktura etnike e punëkërkuësve duket si më lartë, ku 5576 ose 91.72% janë shqiptarë.

### **1.1.2 PUNËKËRKUESIT NË ASISTENCË SOCIALE**

Në asistencë sociale janë dy kategori, kategoria e I-rë dhe e II-ë. Në kategorinë e parë bëjnë pjesë personat të pa aftë për punë, kurse për kategorinë e dytë bëjnë pjesë punëkërkuesit që nuk kanë kurrfarë të ardhura dhe kanë fëmijë nën moshën 5 vjeçare.

Punëkërkuesit të cilët janë shfrytëzues të ndihmës sociale të kategorisë së II-të janë të obligueshëm që ti marrin deklaratën për papunësinë e tij destinuar për ndihmë sociale ku e plotësojnë, ndërsa i vërteton dhe mban evidencë Zyra Komunale për Punësim. (Harta. Papunësia/Struktura e punëkërkuesve ).

### **1.1.3 BANIMI, SHPËRNDARJA E LOKALITETEVE**

Komuna e Kamenicës shtrihet në lindje të Kosovës. Kufizohet në jugperëndim me komunën e Ranillugut, në perëndim me komunën Novobërdës si dhe në veriperëndim me Prishtinën, në veri me Komunën e Medvegjës dhe të Leskocit, në lindje me Vranjën, si dhe në lindje dhe juglindje me Bujanocin. Sipërfaqja e K.Kamnenicës është 417 km<sup>2</sup>. Gjatësia e vijës kufitare e komunës është 166,8 km.

#### **1.1.8.1 Tipologjia e vendbanimeve sipas madhësisë**

Trajtimi i vendbanimeve në planet zhvillimore komunale është i domosdoshëm dhe thelbësor, ngase i tërë aktiviteti dhe organizimi i jetës së shoqërisë njerëzore ka qenë dhe është i lidhur për to. Tipizimi i vendbanimeve sipas madhësisë është njëra ndër metodat më të rëndësishme për të pasqyruar karakteristikat e sistemit të popullsisë të hapësirës së caktuar si dhe mënyrën dhe cilësinë e jetës në vendbanimet e asaj hapësire, sepse vendbanimi më i madh nënkupton mënyrën e jetës më cilësore në shumë aspekte. Në anën tjetër vendbanimi më i vogël zakonisht tregon të kundërtën e asaj të parës. Pikërisht, nga kjo arsye vendbanimet kategorizohen sipas madhësisë së popullsisë dhe në bazë të shumë analizave të kësaj problematike përcaktohen pikat strategjike për zhvillim të mëtejshëm të komunës apo edhe më gjerë.

Vendbanimet sipas madhësisë demografike në Komunën e Kamenicës mund ti kategorizojmë në:

- vendbanimet rurale pa banorë
- vendbanimet e vogla rurale,
- vendbanimet e mesme rurale,
- vendbanimet e mëdha rurale dhe
- vendbanimet e karakterit urban.

Në bazë të të dhënave të fundit nga grupet punuese për përgatitjen e Planit Zhvëllimor Komunal (grupit për demografi dhe çështje sociale) në komunën e Kamenicës për vitin 2011 vendbanimet kategorizohen:

- Në kategorinë e parë të vendbanimeve të madhësisë 0–0 banorë janë 2 vendbanime, nga 58 sa janë në territorin e komunës, Velegllava e Poshtme dhe Kremenata II janë pa asnjë banor.

- Në kategorinë e dytë të vendbanimeve të madhësisë 0 – 100 banorë janë 25 vendbanime, nga 58 sa janë gjithsej në territorin e komunës; Gragjeniku 02 banorë, Kremenata I 07 banorë. Vaganeshi dhe Gogolloci nga 10 banorë, Sedllari 22 banorë, Bratilloci 31 banorë, Shahiqi 34

banorë, Billata 35 banorë, Rahovica dhe Zhuja nga 42 banorë, Zajçeci 46 banorë, Stralica 47 banorë, Kostadinca 48 banorë, Gjyrisheci 58 banorë, Svirçea 59 banorë, Qarakoci 60 banorë, Firiqeva 61 banorë, Maroca 64 banorë, Velegllava e Epërme 73 banorë, Vriçeci 78 banorë, Dazhnica 80 banorë, Gmica 85 banorë, Huboci 86 banorë, Lisocka 98 banorë, Tërstena 100 banorë.

- Në kategorinë e tretë të vendbanimeve të madhësisë 101-1000 banorë janë 19 vendbanime;

Meshina 114 banorë, Tugjeci 130 banorë, Kranidelli 131 banorë, Moçari 139 banorë, Lajçiçi 160 banorë, Kolloleqi 176 banorë, Desivojca 177 banorë, Poliçka 217 banorë, Strezoci 276 banorë, Novosella 311 banorë, Hajnoci 353 banorë, Dajkoci 378 banorë, Ruboci 386 banorë, Leshtari 449 banorë, Grizimja 457 banorë, Krileva 586 banorë, Shipashnica e Poshtme 771 banorë, Busavata 818 banorë, Karaçeva e Poshtme 943 banorë.

- Në kategorinë e katërt të vendbanimeve të madhësisë, prej 1001-2000 banorë janë 07 vendbanime: Petriti 1252 banorë, Kopërnica 1258 banorë, Shipashnica e Epërme 1261 banorë, Karaçeva e Epërme 1412 banorë, Muçivërci 1520 banorë, Berivojca 1555 banorë, Hogoshti 1700 banorë.

- Në kategorinë e pestë të vendbanimeve të madhësisë 2001- 5000 banorë janë 4 vendbanime: Topanica 2061 banorë, Hodonoci 2443 banorë, Rogaçica 2651 banorë dhe Koretini 3478 banorë.

Në kategorinë e gjashtë të vendbanimeve të madhësisë mbi 5000 banorë është 01 vendbanim: Kamenica (Qyteti) 7363 banorë.

Kamenica si qendër komunale, shtrihet përgjatë lumit “Kriva Reka” – në veri të Moravës së Poshtme dhe ka një sipërfaqe prej **701 hektarësh**. Në veriperëndim të këtij vendbanimi janë dëshmuar gjurmët e vjetra te lokalitetit ilir “KULINA”.

Më 1981 Kamenica pati 896 shtëpi me 4487 banorë. Pas vitit 1999 një pjesë bukur e madhe e popullatës serbe, shpërngulen në Serbi. Aktualisht në Kamenicë jetojnë 213 familje serbe dhe 56 familje Rome, si dhe rreth 1151 familje shqiptare.

Numri i banorëve të Kamenicës në raport me numrin e përgjithshëm të komunës, ka ndryshuar dukshëm pas luftës së UÇK-së nga viti 1999 e deri sot. Kamenica në vitin 2011 ka përafërsisht 7363 banorë, duke mos e llogaritur Diasporën

#### **1.1.8.2. Shtrirja hapësinore e vendbanimeve sipas madhësisë së popullsisë**

Shtrirja hapësinore e vendbanimeve sipas madhësisë së popullsisë është e një rëndësie të veçantë për planifikimin dhe rregullimin e hapësirës. Në bazë të kësaj analize, mund të përcaktohen kahet e zhvillimit dhe organizimit të mëtejshëm shoqëroro-ekonomik në hapësirën e caktuar. Madhësia mesatare e vendbanimeve në Komunën e Kamenicës është 820 banorë, ndërsa nëse llogarisim vetëm numrin e popullsisë së vendbanimeve rurale pa

qytetin e Kamenicës, atëherë madhësia mesatare e vendbanimeve për nga numri i popullsisë është rreth 580 banorë. Dallimet në numrin e popullsisë të disa vendbanimeve janë

të konsiderueshme, ndërsa nëse bëjmë krahasimet pa vendbanimin e Kamenicës dhe të Koretinit, atëherë dallimet sillen në mes maksimumit 1250 banorë (Petroci) dhe minimumit 2 banorë (Gragjeniku), që është dallim shumë i madh. Këto dallime janë të kushtëzuara nga pozita e vendbanimit dhe gjeomorfologjia e terrenit, por edhe nga imigrimi që ndodhi gjatë viteve 1990 – 1999 dhe pas vitit 1999.

Përfaqësimi i disa vendbanimeve të kategorive të mëdha në rrjetin e vendbanimeve ka ndikim të rëndësishëm në organizimin e hapësirës dhe sistemin funksional të vendbanimeve. Karakteristikë e rrjetit të vendbanimeve në Komunën e Kamenicës është numri më i madh i vendbanimeve, i kategorisë së parë të madhësisë 0 janë 2 vendbanime, kurse prej 0– 100 banorë gjithsej 25 gati gjysma e vendbanimeve; kurse gjysma tjetër përfshinë vendbanimet e kategorisë tretë dhe të katërt, 26 vendbanime, në kategorin e katërt të vendbanimeve i përkasin 2 vendbanime prej 1001 – 2000 ndërsa sa i përket kategorisë së pestë prej 2001-5000 banorë janë 4 vendbanime, si dhe në kategorinë e gjashtë të vendbanimeve të mëdha, është vetëm një vendbanim urban, pra ky është qyteti i Kamenicës.

Është me rëndësi edhe analiza e shtrirjes së vendbanimeve sipas zonave të lartësisë mbidetare, ku territori i Komunës së Kamenicës ndahet në tri zona:

- zona e ulët 400 – 650 m
- zona e mesme 651 – 900 m dhe
- zona e lartë mbi 901 m


Zona e ulët, përfshinë 30 vendbanime, ku marrë në përqindje kemi 51.72% të territorit të vendbanimeve të Komunës së Kamenicës.

Zona e mesme, përfshinë 19 vendbanime, marrë në përqindje kemi 32.76 % të vendbanimeve të tërësishme.

Zona e lartë, përfshinë 9 vendbanime, marrë në përqindje kemi 15.52% të vendbanimeve të tërësishme.

| numri i banorëve          | Numri i Vendbanimeve |        |
|---------------------------|----------------------|--------|
|                           | Viti 2011            | %      |
| <b>0 – 100 banorë</b>     | 25                   | 43,103 |
| <b>101 – 1000 banorë</b>  | 26                   | 44,827 |
| <b>1001 – 2000 banorë</b> | 2                    | 3,448  |
| <b>2001 – 5000 banorë</b> | 4                    | 6,898  |
| <b>Mbi 5000 banorë</b>    | 1                    | 1,724  |
| <b>Gjithsej</b>           | 58                   | 100.0  |

**Tabela 7.** Struktura e vendbanimeve sipas madhësisë së popullsisë në periudhën 2011



**Grafiku 5.** Numri i vendbanimeve sipas madhësisë së popullsisë për vitin 2011

Nga tabela dhe grafikoni shihet se, vendbanimet e kategorisë së parë prej 0 – 1000 banorë kanë rënie për 2 vendbanime, duke krahasuar me vitin 1998 me 76 vendbanime, me vitin 2010 në 74 vendbanime, të shprehur në përqindje kemi 20 % rënie të numrit të banorëve.

Te vendbanimet e kategorisë 001 – 100 banorë kemi rënie në numër, nga 35 sa ishin në vitin 1998 në vitin 2010, pra kemi rënie për 10 vendbanime, të shprehur në përqindje kemi 28.57 %

Kategoria e tretë e vendbanimeve të madhësisë prej 101 – 1000 banorë, ka rënie të dukshme, nga 24 që ishin në vitin 1998 kemi rënie në 19, pra kemi rënie për 5 vendbanime, të shprehur në përqindje kemi 20.83 % rënie.

Në kategorinë e katërt të vendbanimeve mbi 1001 - 2000 banorë në vitin 1998 kemi pasur 13 vendbanime, kurse në vitin 2010 kemi vetëm 7 vendbanime, dmth. kemi rënie për 6 vendbanime.

Në kategorinë e pestë të vendbanimeve mbi 2001 - 5000 banorë, në vitin 1998 kemi pasur 5 vendbanime, kurse në vitin 2010 kemi 4 vendbanime, dmth. se kemi rënie për 1 vendbanim.

Nga e tërë kjo shihet se, ndryshimet në strukturën e vendbanimeve sipas madhësisë janë shprehur dukshëm. Shkaku kryesor është decentralizimi i komunës, ku për pasojë disa fshatra iu shkëputën komunës sonë, duke iu bashkangjitur Novo Bërdës dhe komunës së re të Ranillugut.






**HARTA E POPULLËSISË SË KAMENICËS**  
**KAMENICA POPULATION MAPS**  
**KAMENICU STANOVNIŠTVA KARTE**

**LEGJENDA / LEGEND/ LEGENDA**

- Kufiri Komunal
- Zonat kadastrale

**Popullsia e Kamenicës nga viti 1948 deri 2011**

- |           |           |
|-----------|-----------|
| Viti 1948 | Viti 1961 |
| Viti 1953 | Viti 1991 |
| Viti 1961 | Viti 2011 |
| Viti 1971 |           |



Shkalla / Scale / Razmera  
1:150,000

3,600 1,800 0 3,600 Meters

Burimi i të dhënave: Agjencia Kadastrale e Kosovës  
 Institucionet e Komunitetit të Kamenicës  
 Grupi i Demografisë dhe Qëndrësive Sociale

Projected Coordinate System: KosovaRef01  
 Projection: Transverse\_Mercator  
 Geographic Coordinate System: GCS\_ETRS\_1989  
 Datum: D\_ETRS\_1989  
 Prime Meridian: Greenwich  
 Angular Unit: Degree



**Harta. 5.** Popullsia e Kamenicës nga viti 1948 - 2011

### 1.1.8.3. Karakteristikat morfologjike dhe urbanistike të vendbanimeve

Kamenica si vendbanim urban me një pjesë të saj mund të konsiderohet me plan, ndërsa të gjitha vendbanimet e Komunës së Kamenicës janë formuar në mënyrë spontane. Forma e tyre e parregullt është si pasojë e kushteve natyrore në terren, por edhe faktorëve shoqëror-historik. Shikuar në aspektin e strukturës morfologjike-urbanistike, dallohen këta tipa të vendbanimeve:

- tipi kompakt
- tipi i shpërndarë dhe
- tipi i shtrirë (linear).

Tipi kompakt i vendbanimeve – Karakteristikë strukturale e këtyre vendbanimeve është koncentrimi i të gjitha objekteve ndërtimore, oborreve ekonomike, rrugëve, etj. Kurse numri më i madh i ngastrave për nga madhësia e sipërfaqeve është më e vogël se në tipet tjera të vendbanimeve. Ky tip i vendbanimeve, kryesisht është prezent në zonën e ulët të fushës, ku oborret ekonomike janë të madhësive të ndryshme, ku zakonisht karakterizohen me sipërfaqe të vogla. Ndërsa ato janë të shfrytëzuara në mënyrë maksimale, qoftë në pjesën e përparme (kah rruga) apo në pjesën e mesme të tyre: Kamenica, Berivojca, Hodonoci, Koretini, Kopërnica, Muçivërci, Petroci, Rogaçica, Ruboci, Shipashnica e Epërme, Shipashnica e Poshtme, Topanica, Dajkoci, Kolloleqi dhe Vriçeci.

Nga dendësia e madhe e objekteve dhe ekonomive familjare që mbretëron në këto vendbanime, shpesh paraqiten vështirësi në mirëmbajtjen dhe sigurimin e higjienës. Në këto vendbanime është e theksuar qartë zona e ndërtimit. Në bazë të konsultimit të një numri të hartave topografike dhe kadastrale të territorit të komunës, është vlerësuar se shumica e këtyre vendbanimeve kanë pozitë të përshtatshme në raport me zonat e tyre kadastrale, sepse rrugët publike i prekin shumicën e këtyre vendbanimeve ose janë afër tyre, prandaj ato janë të lidhura mjaft mirë mes veti, si dhe me qendrat tjera të rendit më të lartë.

Te këto vendbanime kohët e fundit vërehet një formë e re e ndërtimit, sidomos përgjatë rrugëve të asfaltuara të fshatit me karakter rendor të objekteve. Kjo ndodhë jo për arsye ekonomike (zgjerim apo avancim i ekonomive bujqësore), por kryesisht për t'u liruar nga dendësia e madhe dhe afrimi në rrugën kryesore. Ky proces mund të quhet transferimi i fshatit nga tipi grumbullor në tip rendor ose zbritja e fshatit në rrugë.

Te këto vendbanime në disa raste vërehet edhe procesi i bashkimit të tyre për shkak të zgjerimit dhe afërsisë së tyre mes veti, varësisht nga kushtet gjeomorfologjike të terrenit: Kamenicë – Grizime ; Kamenicë – Berivojcë; Berivojcë – Koretin; Koretin - Topanicë; Hodonoc - Rogaçicë ; Rogaçicë – Novosellë; Novosellë – Karaçevë e Poshtme; Karaçevë e Poshtme – Karaçevë e Epërme; Rogaçicë – Muçiverc, Muçiverc – Shipashnicë e Poshtme.

Për shkak të zgjerimit të formës aglomerative në hapësirë, këto vendbanime në të ardhmen nuk mund ta ruajnë kuptimin e fshatit.

Lidhur me vendbanimet e tipit të dendur mund të konstatohet se ky tip i vendbanimeve në krahasim me tipin e shpërndarë të fshatit, është shumë më i përshtatshëm, sepse ato paraqesin mundësitë për përmirësimin e kushteve dhe cilësisë së jetës me pajisje urbane dhe objekte të standardit shoqëror.

**1.1.8.4. Tipi i shpërndarë i vendbanimeve** – Vendbanimet e tipit të shpërndarë janë prezent, kryesisht në viset kodrinore-malore. Karakteristikë themelore e këtyre vendbanimeve është ndarja e tyre në lagje të banimit në tërë territorin e fshatit.

Këto vendbanime nuk posedojnë elemente të centralitetit, ndërsa dendësia e popullsisë është e vogël. Vendbanime të këtij tipi janë: Rahovica, Leshtari, Busavata, Tërstena, Desivojca, Dazhnica, Feriqeva, Velegllava e Epërme dhe Velegllava e Poshtme, Sedllari, Poliçka, Lajçiçi, Lisocka, Gmica, Tugjeci, Svirca, Kremenata I dhe II, Meshina, Moçari, Novosellë, Grizima, Graxheniku, Gogolloci, Gjyrisheci Bratilloci, Shahiqi, Bllata, Kostadinca, Kranidelli, Maroca, Qarakoci, Vaganeshi, Zajçeci, Zhuja (të gjitha këto vendbanime të organizuara në lagje, me më tepër se dy lagje, të ndara nga njëra tjetra). Numri i ekonomive familjare për një lagje arrinë nga 5 e më shumë shtëpi, ndërsa lagjet janë të ndara nga njëra tjetra.

| Nr. | Vendbanimet        | Nr.i banorëve | Siperfaqja Km <sup>2</sup> | Dendësia ban/km <sup>2</sup> | Tipi i vendbanimit               |
|-----|--------------------|---------------|----------------------------|------------------------------|----------------------------------|
| 1   | Berivojcë          | 1555          | 8.115421                   | 191.6105153                  | Kompakt me shtrirje lineare      |
| 2   | Bllatë             | 35            | 1.186628                   | 29.49534311                  | I shpërndarë                     |
| 3   | Bratilloc          | 31            | 4.349885                   | 7.126625187                  | I shpërndarë                     |
| 4   | Busavatë           | 818           | 10.653814                  | 76.78001512                  | I shpërndarë me shtrirje lineare |
| 5   | Dajkoc             | 378           | 3.707495                   | 101.9556331                  | Kompakt me shtrirje lineare      |
| 6   | Dazhnicë           | 80            | 10.481246                  | 7.632680313                  | I shpërndarë                     |
| 7   | Desivojcë          | 177           | 3.12756                    | 56.59363849                  | I shpërndarë                     |
| 8   | Firiqevë           | 61            | 4.14176                    | 14.72803832                  | I shpërndarë                     |
| 9   | Gjyrishec          | 58            | 16.142503                  | 3.592999177                  | I shpërndarë                     |
| 10  | Gmicë              | 85            | 6.358235                   | 13.36848984                  | I shpërndarë                     |
| 11  | Gogolloc           | 10            | 8.911719                   | 1.122117966                  | I shpërndarë                     |
| 12  | Gragjenik          | 2             | 12.127329                  | 0.164916776                  | I shpërndarë                     |
| 13  | Grizime            | 457           | 2.349624                   | 194.499205                   | I shpërndarë                     |
| 14  | Hajnoc             | 353           | 6.032826                   | 58.51320757                  | I shpërndarë me shtrirje lineare |
| 15  | Hodonoc            | 2443          | 4.092323                   | 596.9714512                  | Kompakt me shtrirje lineare      |
| 16  | Hogosht            | 1700          | 13.731064                  | 123.806866                   | I shpërndarë me shtrirje lineare |
| 17  | Huboc              | 86            | 14.81333                   | 5.805581864                  | I shpërndarë me shtrirje lineare |
| 18  | Kamenicë           | 7363          | 15.473378                  | 475.8495527                  | Kompakt me shtrirje lineare      |
| 19  | Karaçevë e Epërme  | 1412          | 4.419454                   | 319.4964808                  | I shpërndarë me shtrirje lineare |
| 20  | Karaçevë e Poshtme | 943           | 7.010237                   | 134.5175634                  | I shpërndarë me shtrirje lineare |
| 21  | Kolloleq           | 176           | 11.268339                  | 15.61898342                  | Kompakt me shtrirje lineare      |
| 22  | Kopernicë          | 1258          | 4.322778                   | 291.0165639                  | Kompakt me shtrirje lineare      |
| 23  | Koretin            | 3478          | 8.129088                   | 427.8462725                  | Kompakt me shtrirje lineare      |
| 24  | Kostadincë         | 48            | 8.333422                   | 5.759938714                  | I shpërndarë                     |
| 25  | Kranidell          | 131           | 11.27237                   | 11.62133606                  | I shpërndarë                     |
| 26  | Kremenatë 1        | 7             | 5.260993                   | 1.330547294                  | I shpërndarë                     |
| 27  | Kremenatë 2        | 0             | 9.855769                   | 0                            | I shpërndarë                     |
| 28  | Krilevë            | 586           | 6.886285                   | 85.0966813                   | I shpërndarë me shtrirje lineare |
| 29  | Lajçiç             | 160           | 2.160081                   | 74.0712964                   | I shpërndarë                     |
| 30  | Leshtar            | 449           | 16.857095                  | 26.63566884                  | I shpërndarë                     |
| 31  | Lisockë            | 98            | 9.189153                   | 10.66474788                  | I shpërndarë                     |
| 32  | Marocë             | 64            | 4.90866                    | 13.0381815                   | I shpërndarë                     |
| 33  | Meshinë            | 114           | 7.951436                   | 14.33703296                  | I shpërndarë                     |
| 34  | Moçar              | 139           | 2.275842                   | 61.07629616                  | I shpërndarë                     |
| 35  | Muçivërc           | 1520          | 8.072984                   | 188.2823006                  | Kompakt me shtrirje lineare      |
| 36  | Novosellë          | 311           | 6.29993                    | 49.36562787                  | I shpërndarë me shtrirje lineare |
| 37  | Petroc             | 1252          | 7.085287                   | 176.7042041                  | Kompakt me shtrirje lineare      |

|    |  |       |            |             |                                  |
|----|--|-------|------------|-------------|----------------------------------|
| 38 | Poliçkë                                    | 217   | 1.528216   | 141.9956341 | I shpërndarë me shtrirje lineare |
| 39 | Qarakoc                                    | 60    | 3.608177   | 16.62889598 | I shpërndarë me shtrirje lineare |
| 40 | Rahovicë                                   | 42    | 9.813091   | 4.279996996 | I shpërndarë                     |
| 41 | Rogaçicë                                   | 2651  | 4.817508   | 550.2845039 | Kompakt me shtrirje lineare      |
| 42 | Ruboc                                      | 386   | 11.555842  | 33.40301814 | Kompakt me shtrirje lineare      |
| 43 | Sedllar                                    | 22    | 3.753131   | 5.861772477 | I shpërndarë                     |
| 44 | Svirçë                                     | 59    | 5.611355   | 10.51439447 | I shpërndarë                     |
| 45 | Shahiq                                     | 34    | 1.561293   | 21.77682216 | I shpërndarë                     |
| 46 | Shipashnicë e Epërme                       | 1261  | 9.409059   | 134.0197782 | Kompakt me shtrirje lineare      |
| 47 | Shipashnicë e Poshtme                      | 771   | 3.826494   | 201.4899279 | Kompakt me shtrirje lineare      |
| 48 | Stralicë                                   | 47    | 2.796358   | 16.80757614 | I shpërndarë me shtrirje linear  |
| 49 | Strezoc                                    | 276   | 8.046657   | 34.29995836 | I shpërndarë me shtrirje linear  |
| 50 | Tërstenë                                   | 100   | 9.967121   | 10.03298746 | I shpërndarë                     |
| 51 | Topanicë                                   | 2061  | 8.238859   | 250.1559985 | Kompakt me shtrirje lineare      |
| 52 | Tugjec                                     | 130   | 13.702752  | 9.487145356 | I shpërndarë                     |
| 53 | Vaganesh                                   | 10    | 4.394195   | 2.275729684 | I shpërndarë                     |
| 54 | Velegllavë e Epërme                        | 73    | 2.968961   | 24.58772614 | I shpërndarë                     |
| 55 | Velegllavë e Poshtme                       | 0     | 8.151753   | 0           | I shpërndarë                     |
| 56 | Vriçec                                     | 78    | 4.181814   | 18.65219257 | Kompakt                          |
| 57 | Zajçec                                     | 46    | 8.407201   | 5.471499968 | I shpërndarë                     |
| 58 | Zhujë                                      | 42    | 2.937194   | 14.29936191 | I shpërndarë                     |
|    | Shuma e banorëve rezidentë                 | 36204 | 416.632374 | 86.89675181 |                                  |
|    | Shuma e banorëve residentë dhe jorezidentë | 40224 | 416.632374 | 86.89675181 |                                  |

Tab. 8. Numri i banorëve, ekon. familjare, tipi i vendbanimit

Disa prej vendbanimeve i ka përfshirë procesi i depopullimit, siç janë: Kremenata I dhe Velegllava, por afër depopullimit janë edhe disa fshatra tjera të rrezikuara të cilat po shkojnë shpejt drejt depopullimit të plotë si; Gragjeniku, Gogolloci, Sedllari, Bratilloci, Kremenata, Shahiqi, Blata, Rahovica, Zhuja, Zajçeci, Kostadinca, Firiqeva, Maroca, Velegllava, Dazhnica, Gmica, Huboci etj.. Prandaj, një numër i tyre në të ardhmen do të mbeten vetëm si toponime në hartat gjeografike. E vetmja mënyrë për ti shpëtuar këto vendbanime nga shuarja e plotë do të ishte ndërtimi i rrugëve dhe lidhja e tyre në sistem, formimi i qendrës në ndonjë lagje apo në terren të hapur, e kjo do të ndikonte pozitivisht dhe moralisht tek popullsia e këtyre viseve që të mbeten aty.

**1.1.8.5. Tipi i shtrirë (linear)** – Vendbanimet e këtij tipi në formë të zgjatur i takojnë tipit të dendur dhe pak të dendur që shtrihen, kryesisht përgjatë luginave dhe rrugëve lokale në zonat e ulëta. Busavata, Hajnoci, Hogoshti, Huboci, Karaçeva e Poshtme, Karaçeva e Epërme, Krileva, Novosella, Poliçka, Qarakoci, Stralica, Strezoci.

Këto vendbanime karakterizohen me ngastra më të vogla ndërtimore (oborret), ndërsa anën e tyre të ngushtë, në të shumtën e rasteve, e kanë të orientuar duke ndërtuar objektet buzë rrugës. Karakteristikë e këtyre vendbanimeve është se, kanë tendenca të zgjerimit dhe bashkëngjijtes duke krijuar kështu korridore ndërtimore përgjatë rrugës. Një proces i tillë ka marrë hov sidomos kohëve të fundit, përkundër faktit se një trend i tillë në aspektin urbanistik dhe hapësinor është i pavolitshëm, ngase ato i përcjellin një mori problemesh e konfliktesh si dhe paraqesin pengesë në zhvillimin normal të komunikacionit.

Një numër i vendbanimeve të tipit linear shtrihen në skajin e fushave pjellore me objekte të ndërtuara në dy fronte dhe me rrugën në mes, të cilat janë shembull i ruajtës së sipërfaqeve bujqësore dhe njëherazi më të përshtatshme në aspektin ekologjik:

#### **1.1.8.6. Funksionaliteti i vendbanimeve**

Sistemin e vendbanimeve në Komunën e Kamenicës e përbëjnë 57 vendbanime rurale dhe një qendër urbane të organizuara në 58 komuna kadastrale. Funksionaliteti i këtij sistemi mbështet aktivitetin në arritjen e zhvillimit ekonomik dhe koncentrimin (përqendrimin) e popullsisë.

Vendbanimet e Komunës së Kamenicës mund ti klasifikojmë sipas funksioneve themelore në këto tipe:

- vendbanimet rurale primare,
- vendbanimet me qendrën rurale,
- qendra komunale.

Në grupin e vendbanimeve rurale primare të komunës hyjnë ato vendbanime, në të cilat jetojnë prodhuesit bujqësorë dhe pa kurrfarë funksione eksterne ndaj vendbanimeve për rreth. Në këto vendbanime zhvillohen vetëm ato funksione interne, të cilat shërbejnë për përmbushjen e nevojave të përditshme të popullsisë së atij vendbanimi. Këto vendbanime paraqesin tërësinë e objekteve banuese dhe ekonomike të prodhuesve bujqësorë, në këto vendbanime bëjnë pjesë: Koretini, Topanica, Petroci, Hajnoci, Stralica, Hodonoci, Rogaçica, Karaçeva e Epërme, Karaçeva e Poshtme, Muçivërci, Shipashnica e Poshtme, Shipashnica e Epërme, Hogoshti, Kopërnica, Kolloleqi, Krileva. Shumica e këtyre vendbanimeve janë të vendosura më larg qendrës dhe në viset kodrinore-malore, të cilat janë fshatra tipike bujqësore. Karakteristikë e këtyre vendbanimeve është shkalla e lartë e autonomisë, transformimi i vogël, lidhjet me qendrën dhe stabiliteti i tyre. Këto vendbanime në të ardhmen do të përcjellin ndryshimet e mëdha, kuptohet në aspektin pozitiv, sepse në shumicën prej tyre do të ketë zhvillime në fusha të ndryshme edhe në ndërtim.

Procesi i zbrazjes së territoreve kodrinore-malore në mënyrë spontane, sidomos në periudhën e pasluftës dhe zgjerimi i vendbanimeve dhe koncentrimi i popullsisë në zonat e rrafshhta, të cilat edhe ashtu kanë dendësi të madhe të popullsisë, mund të ketë pasoja negative në aspektin strategjik dhe konvencional për të ardhmen e komunës dhe të Kosovës në tërësi. Prandaj nga kjo konsiderojmë se, pa tjetër duhet gjetur forma dhe mënyra për të ndaluar këtë proces. Kjo mund të realizohet me zhvillimin e turizmit rural, stimulimin e prodhimtarisë bujqësore, blegtorinë me organizim dhe teknologji bashkëkohore. Lidhjen e vendbanimeve me ndërtimin e rrugëve ( rruga është parakusht për ekzistencën e këtyre vendbanimeve), etj. Ndryshimin e skemës së organizimit funksional përmes organizimit dhe zhvillimit të qendrave dhe bashkësive rurale. Pastaj, pajisjen e këtyre vendbanimeve me funksione të domosdoshme me të cilat do të përmbushin nevojat e përditshme të popullsisë.

Si vendbanime primare janë edhe një numër i fshatrave pranë qytetit me numër të konsiderueshëm të popullsisë jobujqësore, që punojnë në qytet dhe funksionojnë të lidhura me qytetin.

**1.1.8.7. Vendbanimet me qendrën rurale.-** Janë bërthama initiale organizative, të cilat i bashkojnë dy e më tepër vendbanime primare në një tërësi shoqëro-ekonomike dhe hapësinore. Në këto vendbanime, përveç funksioneve interne, janë të zhvilluara edhe funksionet eksterne, të cilat u shërbejnë edhe popullsisë së vendbanimeve përreth. Këto vendbanime, njëherazi paraqesin njësitë polarizuese të zonës në hapësinë.

**Nga funksionet shoqërore, në këto vendbanime ndodhet bashkësia lokale dhe zyra e vendit, shkolla fillore, ambulanca, shitoret me shumicë e pakicë për furnizimin e popullsisë, ndonjë veprimtari zejtare, etj. Këto vendbanime paraqesin tip kalimtar nga ato tradicionale-bujqësore, në të përziera, sepse në to jeton një numër i konsiderueshëm i popullsisë bujqësore, zejtare etj. Një numër i konsiderueshëm i këtyre vendbanimeve ndodhet jo larg qyteteve. Ato i karakterizon një shkallë mjaft e lartë e transformimit, prandaj mund të konsiderohen edhe vendbanime urbane. Numri i këtyre vendbanimeve në komunë arrinë 25% nga numri i përgjithshëm i vendbanimeve.**

Në këto vendbanime vetëm se janë paraqitur shenjat e semi-urbanizimit si pasojë e veprimit të faktorëve urbanë, në një anë dhe prodhimtarisë së modernizuar të bujqësisë në anën tjetër. Këto vendbanime i takojnë kategorisë së madhësisë së lartë mbi 2400 banorë, Koretini, Topanica, Hodonoci, Rogaçica. Në këto vendbanime gravitojnë rreth 10000 banorë. Sa i përket vendbanimeve pranë-qytezës ato, paraqesin zona sub-urbane (të pa urbanizuara) me karakteristika të veçanta:

karakterizohen me shkallë të lartë të transformimit, kanë shkallë të ulët të autonomisë për shkak të varësisë nga qendra urbane, mandej tek ato shkalla e deagrarizimit të popullsisë është mjaft e shprehur.

Këtij grupi i takojnë vendbanimet; Busavata, Poliçka, Krileva, Tugjeci, Hajnoci si dhe disa vendbanime më të vogla.

Prandaj, këto vendbanime nuk duhet ti lihen stihisë siç ka ndodhur deri më tash, sepse ato shndërrohen në barriera të cilat do të paraqesin pengesa në zgjerimin e mëtejshëm të qytetit.

Në grupin e vendbanimeve urbane bën pjesë Kamenica si qendër komunale, Hogoshti dhe Muçivërci në të cilat janë të vendosura funksionet shoqërore-ekonomike.

#### **1.1.8.8. Rrjeti i vendbanimeve**

**Rrjetin e vendbanimeve** në Komunën e Kamenicës e përbëjnë 58 vendbanime prej të cilave qyteti është vendbanim i karakterit urban, Kamenica me 7363 banorë ose 18.3 %, të popullsisë së përgjithshme.

Vendbanimet tjera janë rurale, me numrin e popullsisë prej rreth 32861 banorë ose 81.7 % të popullsisë, në vitin 2011. Madhësia mesatare e vendbanimeve është 693.517 banorë, në vitin 2011, ndërsa dendësia mesatare e popullsisë arrinë në 96.46 banorë në km<sup>2</sup>, por me dallime të mëdha, varësisht nga karakteristikat gjeo-morfologjike të terrenit. (shiko hartën dhe tabelën).

Dendësia më e lartë e popullsisë është në fshatin Hodonoc, ku mesatarisht jetojnë rreth 596.97 banorë në një km<sup>2</sup>, Rogaçicë me 550.28 banorë për km<sup>2</sup> dhe më pas vjen qyteti i Kamenicës me 475.85 banorë në një km<sup>2</sup>.

Vendbanimet me shkallë më të vogël të dendësisë së popullsisë prej 0 – 50 banorë /km<sup>2</sup> janë: Velegllava e Poshtme 0 banorë /km<sup>2</sup> , Kremenata II 0 banorë /km<sup>2</sup>, Gragjeniku 0.16 banorë /km<sup>2</sup>, Bllata 29,495 banorë /km<sup>2</sup>, Bratilloci 7.13 banorë /km<sup>2</sup>, Dazhnica 7.63 banorë /km<sup>2</sup>, Feriqeva 14.73 banorë /km<sup>2</sup>, Gjyrisheci 3,59 banorë /km<sup>2</sup>, Gmica 13,37 banorë /km<sup>2</sup>, Gogolloci 1,12 banor /km<sup>2</sup> Huboci 5,81 banorë /km<sup>2</sup>, Kolloleqi 15,62 banorë /km<sup>2</sup>, Kostadinca 5.76 banorë /km<sup>2</sup> , Kranidelli 11,62 banorë /km<sup>2</sup>, Kremenata I 1.33 banorë /km<sup>2</sup>, Leshtari 26,63 banorë /km<sup>2</sup>, Lisocka 10,66 banorë /km<sup>2</sup> Maroca 13,04 banorë /km<sup>2</sup>, Meshina 14,34 banorë /km<sup>2</sup>, Novosella 49,37 banorë /km<sup>2</sup>, Qarakoci 16,63 banorë /km<sup>2</sup>, Rahovica 4.28 banorë /km<sup>2</sup>, Ruboci 33,4 banorë /km<sup>2</sup>, Sedllari 5,86 banorë /km<sup>2</sup>, Svirca 10,51 banorë /km<sup>2</sup>, Shahiqi 21,78 banorë /km<sup>2</sup>, Stralica 16,81 banorë /km<sup>2</sup>, Strezoci 34,30 banor /km<sup>2</sup> , Tërstena 10,03 banorë /km<sup>2</sup>, Tugjeci 9,49 banor /km<sup>2</sup>, Vaganeshi 2,28 banorë /km<sup>2</sup> Velegllava e Epërme 24,59 banorë /km<sup>2</sup>, Vriçeci 18,65 banorë /km<sup>2</sup>, Zajqeci 5,47 banorë /km<sup>2</sup> Zhuja 14,29 banorë /km<sup>2</sup>. Këto vendbanime ndodhen më larg qendrës urbane të Kamenicës, shtrihen në lartësi më të mëdha mbidetare, kanë mungesë të shërbimeve dhe të infrastrukturës së nevojshme, andaj edhe numri i popullsisë është më i vogël si dhe rreziku nga depopullimi është më i madh.

Vendbanimet që kanë dendësi të popullsisë prej 50 – 100 banorë /km<sup>2</sup> janë: Busavata 76,78 banorë /km<sup>2</sup> , Desivojca 56.59 banorë /km<sup>2</sup>, Hajnoci 58,51 banorë /km<sup>2</sup>, Krileva 85,1 banorë /km<sup>2</sup>, Lajçiçi 74,07 banor /km<sup>2</sup>, Moçari 61,07 banorë /km<sup>2</sup>. Këto vendbanime gjenden larg qendrës urbane të Kamenicës, shtrihen në lartësi të mëdha mbidetare, kanë mungesë të shërbimeve dhe infrastrukturës së nevojshme, andaj edhe numri i popullsisë është më i vogël si dhe rreziku nga depopullimi .

Vendbanimet që kanë dendësi prej 100 – 200 banorë /km<sup>2</sup> janë: Berivojca 191.61 banorë /km<sup>2</sup>, Dajkoc 101,96 banorë /km<sup>2</sup>, Grizime 194,5 banorë /km<sup>2</sup>, Karaçevë e Poshtme 134,52 banorë /km<sup>2</sup>, Muçivërc 188.28 banorë /km<sup>2</sup>, Petroc 176,7 banorë /km<sup>2</sup>, Poliçkë 141,99 banorë /km<sup>2</sup>, Shipashnicë e Epërme 134,02 banorë /km<sup>2</sup>.

Vendbanimet që kanë dendësi mbi 200 banorë /km<sup>2</sup> janë: Hodonoc 596,97 banorë /km<sup>2</sup>, Kamenicë 475,85 banorë /km<sup>2</sup>, Karaçevë e Epërme 319,496 banorë /km<sup>2</sup>, Koretin 427,846 banorë /km<sup>2</sup>, Rogaçicë 550,28 banorë /km<sup>2</sup>, Shipashnicë e Poshtme 201.49 banorë /km<sup>2</sup>, Topanicë 250.16 banorë /km<sup>2</sup>,

Vendbanimet të cilat shtrihen në zonën e ulët nën 450 – 650 metra të lartësisë mbidetare kanë arritur një shkallë mjaft të lartë të zhvillimit dhe transformimit të tyre. Vendbanimet të cilat shtrihen në viset kodrinore-malore kanë mbetur të pazhvilluara, pa institucione dhe shërbime elementare, e me tendenca të zbrazjes së tyre.

#### **1.1.8.9. Karakteristikat e vendbanimeve sipas zonave**

Në këtë rast, e një rëndësie të veçantë do të ishte diferencimi morfologjik i territorit të caktuar, përmes të cilës komponentë pasqyrohen mundësitë dhe kahet e zhvillimit të më tejme. Hapësirën e komunës e përbëjnë tri tërësi morfologjike që dallojnë nga njëra-tjera në bazë të kaakteristikave gjeografike natyrore:

zona fushore-bregore 450 - 650 metra lartësi mbidetare, me sipërfaqe prej 217,339 km<sup>2</sup> ose 52,12 % të hapësirës së gjithmbarshme të komunës;

zona kodrinore-malore 651 – 900 metra të lartësisë mbidetare, e cila përfshinë sipërfaqen prej 118,052 km<sup>2</sup> ose 28,31 % të komunës dhe

zona malore 900 metra lartësi mbidetare, me sipërfaqe prej 81,609 km<sup>2</sup> ose 19,57 %.

Zona kodrinore-malore zë pozitën verilindore dhe veriperëndimore të komunës, është kryesisht e pazhvilluar, me kaakteristika të shpopullzimit ose stagnuse. Zona e ulët fushore shtrihet në juglindje dhe verilindje të qytetit të Kamenicës, që kufizohet në juglindje dhe verilindje me malet e Rodopit, e cila ka veçori tjera demografike dhe kushte më të volitshme për zhvillim. Këta parametra tregojnë edhe për pozitën e territorit të ekspozuar veri-perëndimit, që është një komponentë e rëndësishme për planifikimin hapësinor.

Për të vërtetuar konstatimin e mëparshëm se hapësira kodrinore-malore është pjesa më e pazhvilluar e komunës, do të analizojmë më hollësisht vendbanimet në aspektin demografik dhe funksional sipas shtrirjes zonale, ngase sa më atraktive që do të jetë një hapësirë, ajo do të jetë edhe më e populluar dhe anasjelltas.

Që në fillim duhet theksuar se zona e ulët karakterizohet me dendësi të madhe të popullsisë, në të cilën dominojnë vendbanimet e kategorisë së mesme dhe të mëdha prej 500 deri në mbi 3000 banorë. Kjo tërësi hapësinore në kuptimin demografik është më stabile, sepse procesi i shpërnguljes së popullsisë së këtyre vendbanimeve drejt qendrave urbane është në rrjedhat normale. Në anën tjetër, rritja popullore e vendbanimeve dhe transformimi fizik i tyre është shumë më i shpejtë në krahasim me vendbanimet kodrinore-malore.

## **Harta . Shtrirja e vendbanimeve sipas lartësisë mbidetare në Komunën e Kamenicës**

Duhet theksuar se vendbanimet mbi 651metra janë lënë anash në aspektin e zhvillimit ekonomik, kurse qyteti dhe qendrat e zhvilluara ndodhen në hapësirën nën 650 metra të lartësisë mbidetare. Prandaj, shumica e objekteve ekonomike dhe të funksioneve qendrore janë përqendruar në qytet. Gjithashtu, edhe potenciali demografik është më i lartë rreth qytetit, ndërsa duke shkuar nga periferia ky potencial zvogëlohet. Në këtë mënyrë, bërthamat urbane me potencialin e tyre demografik paraqesin "kupa" në "profilin popullativ" të regjionit. Duke u larguar nga qendra, potenciali popullativ gjithnjë e më tepër arrin vlerat më të ulëta dhe në këtë mënyrë përfundon ndikimi i qendrës, ku mund të tërhiqet vija ndarëse e regjionit të qytetit në bazë të parimit të gravitetit popullativ.

Nga hulumtimet është vërtetuar se, vendbanimet të cilat ndodhen sa më afër qendrës komunale, aq më i madh është ndikimi i kësaj qendre në rritjen e popullsisë së tyre. Me rritjen e distancës prej qendrës komunale kryesisht vjen deri te zvogëlimi i indeksit të rritjes së popullsisë. Kjo rregull është më e shprehur në komunat, të cilat njëkohësisht kanë qendër më të madhe urbane. Nga këto shkaqe një numër i konsiderueshëm i vendbanimeve pranë-qytetit e kanë rritur dukshëm numrin e popullsisë së tyre, nga arsyeja se nuk kanë pasur emigrim të shprehur të popullsisë në drejtim të qendrave tjera ose kanë pranuar emigrantë nga vendbanimet kodrinore-malore.

### **1.1.8.10. Banimi në Komunën e Kamenicës**

Në Komunën e Kamenicës, sipas regjistrimit të 2011 të siguruara nga grupet punuese për përgatitjen e Planit Zhvillimor Komunal jetojnë 40224 banorë në sipërfaqe prej 417 km<sup>2</sup>. Pjesa dërmuese e popullsisë në këtë komunë jeton në fshat 81,69 % . Vetëm 18,31 % e saj jeton në qendrën e vetme urbane të kësaj komune, me qendër në Kamenicë.



Në këtë komunë, gjithashtu dominon banimi i karakterit individual, pasi që, vetëm në qendrën urbane janë të ndërtuar një numër i vogël i banesave shumfamiljare, të karakterit kolektiv. Numri i përgjithshëm i objekteve të banimit në kuadër të komunës së Kamenicës, është rreth 8230 nga e cila shumë, 6896 objekte, ose 83,79 % janë të ndërtuara në zonat rurale, 1334 objekte të banimit, ose 16,21 % e tyre janë të ndërtuara në zonën urbane.

Raporti i banimit individual me atë kolektiv në qytet është 94/6%. Në zonën e ulët të fushës vendbanimet, zakonisht janë të tipit të kompakt me shtrirje lineare, prandaj edhe dendësia e banimit është më e madhe. Në viset kodrinore-malore, shumica e tyre janë të tipit të shpërndarë, të organizuara në lagje. Pra, faktorët natyror (relievi), kanë ndikuar dukshëm në formën dhe dendësinë e vendbanimeve. Te vendbanimet që ndodhen afër qendrës urbane dhe atyre afër rrugëve, vërehen tendencat e zhvillimit linear, duke i përcjellë vijat komunikative, për këtë arsye objektet e banimit dhe ato të bizneseve shtrihen në formë lineare. Kjo arsyetohet edhe me faktin se popullsia, vazhdimisht po heq dorë nga bujqësia.

Numri më i madh i objekteve të banimit është ndërtuar në zonën e ulët të fushës, që njëkohësisht është edhe hapësira më e banuar. Për nga cilësia e materialit ndërtimor, sipërfaqes së ndërtuar dhe pajisjes së hapësirës banuese, kjo hapësirë gjithashtu, disponon me një fond më cilësor banesor.

Objekte të vjetra banimi ka pak, sepse materiali i dobët i tyre nuk ka mundur ti përballojë kohës. Objektet e banimit dhe oborret kanë dallime, varësisht nga vendi i ndërtimit, si: qyteti, vendbanimet pranë qytetit, vendbanimet kodrinore-malore. Shumica e objekteve të banimit janë të rrethuara me mure, në oborre dallohen edhe objektet tjera ekonomike bujqësore.

Deri vonë objektet e banimit ndërtoheshin me material të dobët; qerpiç(tulla të pa pjekura), tulla e pjekur në mënyrë klasike dhe druri, që zakonisht forma e objekteve i ngjante shkronjës L dhe T. Në këto katër (4) dekadat e fundit objektet e banimit ndryshuan tërësisht, si në formë ashtu edhe në cilësi. Tani objektet e banimit ndërtohen me një e më shumë kate, ndërsa me material ndërtimor si; tulla, blloka të pjekur, betoni e hekuri, konstruksione çeliku, druri. Kështu, që objektet e ndërtuara të banimit në fshat fare pak dallojnë me ato në qytet. Nuk ka ndonjë stil unik të ndërtimit të objekteve të banimit.

Dendësia e banimit në zonën e ndërtuar, në vendbanimet rurale, është dukshëm më e ulët, në raport me qendrën komunale .

Gjendja e banimit në vendbanimet rurale dhe në vet qytetin e Kamenicës, u dëmtua rëndë në Luftën e **UÇK-së** kundër Serbisë, gjatë së cilës u shkatërruan një numër i madh i objekteve të banimit dhe ekonomike, ndërsa pasojat po evitohen ngadalë.

Hapësira e banimit në raport me sipërfaqet e ndërtuara është dominante, me 90 % në raport me zonën e ndërtuar në nivelin komunal, në vet qytetin e Kamenicës, ajo dominon me rreth 85 %. Kjo tregon se, aktivitetet tjera janë në nivel shumë të ulët të zhvillimit të tyre.

Numri i anëtarëve për ekonomi familjare variron (lëvizë) nga 7 anëtarë në vendbanimet rurale, në 5.5 anëtarë në qendrën urbane, ndërkaq mesatarja e numrit të anëtarëve për ekonomi familjare në nivelin komunal sillet në 6.7 anëtarë. Kjo është si pasojë e jetës së përbashkët të dy e më shumë gjeneratave në një ekonomi familjare, ku kjo gjendje e rëndon standardin jetësor.



**DENDËSIA E POPULLËSISË  
DENSITY OF POPULATION  
GUSTOÇA STANOVNIŠTVA**

**LEGJENDA / LEGEND / LEGENDA**

Kufiri Komunal


Zonat kadastrale

**Depopullimi i vendbanimeve**

Depopullimi i lartë

Depopullimi mesatar

Depopullimi i ulët



3,100 1,550 0 3,100 Meters

Burimi i të dhënave: Agjencia Kadastrale e Kosovës  
Institucionet e Komunës së Kamenicës  
Grupi i Demografisë dhe Qështjeve Sociale

Shkalla / Scale / Razmera  
1:150,000

Projected Coordinate System: KosovaRe01  
Projection: Transverse\_Mercator  
Geographic Coordinate System: GCS\_ETRS\_1989  
Datum: D\_ETRS\_1989  
Prime Meridian: Greenwich  
Angular Unit: Degree



**Harta. 6. Migrimi (depopullimi) i popullsisë në Komunën e Kamenicës  
1.1.9.0 ARSIMI NË KOMUNËN E KAMENICËS**

Komuna e Kamenicës, veçohet prej shumë komunave tjera të Kosovës. Është e tillë për shkak të relievit, strukturës etnike (92% shqiptarë, të tjerë serbë dhe rreth 300 romë), prandaj planprogrami i punës së DKA-së është mbështetur në këta faktorë, pastaj në kompetencat dhe përgjegjësitë e mbështetura në ligj dhe në statutin e komunës. Zhvillimin e institucioneve arsimore komunale, e bazon edhe në Strategjinë e Zhvillimit të Arsimit i hartuar nga MASHT-i. Planprogrami i DKA-së, nuk do të jetë i ngurtë por gjithnjë do të përshtatet me proceset e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe Urban të Komunës së Kamenicës.

Procesi mësimor dhe edukativ në Komunën e Kamenicës zhvillohet në këto nivele: parashkollor (qerdhe), parafillos, fillor, i mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë. Mësimi zhvillohet në dy gjuhë, shqipe dhe serbe. Nxënësit romë mësimet i ndjekin në shkollat serbe.

### 1.1.9.1. Institucionet arsimore

- 1 20 paralele parafillore 319 fëmijë, 302 shqiptarë, 14 serbë dhe 3 romë;
- 2 Shkolla fillore: 17 (gjuhë shqipe), 3 (gj. serbe, ) me 5451 nxënës;
- 3 Shkolla të mesme: 2 (gjuhë shqipe), 2 gjuhë serbe me 2265 nxënës.

Në qytet është qerdhja e fëmijëve, ku janë vendosur 34 fëmijë, 7 edukatore dhe 8 punëtorë teknikë dhe administrativë. Objekti është shumë i përshtatshëm dhe ka një ambient të bukur.


- **Infrastruktura:** ligjore dhe rregulloret, respektohen dhe zbatohen me përpikëri. Nxënësit në mësimin e obliguar kl. I-IX e vijojnë të gjithë duke përfshirë edhe nxënësit me aftësi të kufizuara – një paralele në ShFMU “Fan s. Noli” në Kamenicë dhe një paralele në ShFMU “Metush Krasniqi” në Rogaçicë.

- **Numri dhe lokacioni i objekteve shkollore**

Në kuadër të Komunës së Kamenicës në shkollat me mësim në gjuhë shqipe dhe serbe ekzistojnë 52 objekte, për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët janë 19 shkolla amë dhe 18 paralele të ndara me 5451 nxënës, 4 shkolla të mesme me 3 paralele të ndara me 2864 nxënës. Për të gjitha këto, qartësohen më së miri në pasqyrat (tabelat):

| Ndarja e institucioneve | Shkolla amë shqiptarë | Paralele të ndara shqiptarë | Shkolla amë serbë | Paralele të ndara serbë |
|-------------------------|-----------------------|-----------------------------|-------------------|-------------------------|
| Institucionet parashk.  | 1                     |                             | 1                 |                         |
| ShFMU                   | 17                    | 18                          | 3                 | 7                       |
| ShML                    | 2                     | 3                           | 2                 | -                       |
| Gjithsej                | 19                    | 21                          | 6                 | 7                       |


**Tabela.9 .Numri i institucioneve shkollore në Kamenicë sipas nivelit të arsimit**



Graf.6 . Numri i institucioneve shkollore në Komunën e Kamenicës sipas nivelit të arsimit

| Nacionaliteti   | Mësimdhënës |  | Punëtorë administrativ | Punëtorë ndimes | gjithsej   |
|-----------------|-------------|--|------------------------|-----------------|------------|
|                 |             |  |                        |                 |            |
| Shqiptarë       | 552         |  | 30                     | 108             | <b>690</b> |
| Serbë           | 109         |  | 6                      | 24              | <b>139</b> |
| <b>Gjithsej</b> | <b>661</b>  |  | <b>36</b>              | <b>132</b>      | <b>829</b> |


Tabela.10 . Të punësuar në arsim



Graf.7 . Numri i të punësuarve në arsim

| Nacionaliteti   | I.P.       | ShFMU       | ShML        | Gjithsej    |
|-----------------|------------|-------------|-------------|-------------|
| Shiptarë        | 107        | 5022        | 2124        | 7253        |
| Serbë           | 14         | 429         | 141         | 584         |
| <b>Gjithsej</b> | <b>121</b> | <b>5451</b> | <b>2265</b> | <b>7837</b> |

Tabela.11 . Numri i nxënësve ne shkolla fillore dhe te mesme



Graf.8. Numri i nxënësve në shkolla fillore në ShFMU dhe ShML

### Normat për vendosje dhe kategorizim

Përmes tabelës së më poshtme, shihet gjendja ekzistuese e objekteve shkollore në tërë territorin e komunës, ku përmes saj dhe të dhënave tjera shtesë me të cilat disponon DKA-ja, ndikon në vendosjen e normave apo kritereve për investime për objektet shkollore.

Në Komunën e Kamenicës ekzistojnë 24 shkolla amë dhe 28 paralele të ndara fizike (shkolla vartëse) të arsimit të obliguar fillor në gjuhën shqipe dhe serbe. Në këtë kategori të edukimit dhe arsimit janë të përfshirë 5451 nxënës prej klasës I-IX dhe 2265 nxënës në shkollat e mesme të larta (klasa X-XIII). Me ta punojnë 661 mësimdhënës dhe 168 punëtorë administrativ dhe teknik.

#### 1.1.9.2. Arsimi fillor

| Numri i shkollave           | Numri i nxënësve | Proporcioni nxënës-shkollë |
|-----------------------------|------------------|----------------------------|
| A (34+10) paralele të ndara | 5451             | 124                        |

. Tabela 12. Numri i shkollave fillore dhe të mesme të ulëta (ShFMU), nxënësit dhe proporcioni nxënës-shkollë në arsimin e obligueshëm (klasat 1–9), 2011

| Mësimdhënësit |       | Personeli administrativ |      | Personeli ndihmës |       | Gjithsej personel arsimor |     |
|---------------|-------|-------------------------|------|-------------------|-------|---------------------------|-----|
| Numri         | %     | Numri                   | %    | Numri             | %     | Numri                     | %   |
| 661           | 79.78 | 36                      | 4.32 | 132               | 15.90 | 829                       | 100 |

Tabela 13. Personeli arsimor në arsimin e obligueshëm sipas pozitës (klasat 1-9) 2011

### 1.1.9.3. Arsimi i mesëm i lartë

Arsimi i mesëm i lartë përfshinë tri apo katër vite të shkollimit për nxënësit e grupmoshës 15 deri 18 vjeç.

Në Komunën e Kamenicës janë 2 shkolla të mesme të larta me 2265 nxënës.<sup>1</sup> Gjimnazi "Ismail Qemali" dhe Shkolla e mesme e Lartë Profesionale (ShMLP) "Andrea Durrsaku", të cilat në qytet i kanë objektet e veta, ndërkaq paralelja e ndarë e ShMLP në Rogaçicë nuk ka objekt të vetin, mësimi zhvillohet në objektin e shkollës fillore dhe të mesme të ulët (ShFMU). Gjithashtu, paralelet e ndara të gjimnazit në Hogosht dhe në Rogaçicë nuk kanë objekte të veta, por punojnë në objektet e ShFMU. Shkollat e mesme në gjuhën serbe punojnë në objektin e shkollës fillore në qytet. Shkollat e lartëshënuara edhe pse i kanë objektet e veta shkollore, atyre u nevojiten objektet ndihmëse si punëtori, kabinete e laboratorë por edhe disa dhoma mësimi.

Tabela 9. Numri i shkollave të mesme, nxënësit dhe proporcioni nxënës/shkollë në arsimin e mesëm (klasat(X-XIII), 2011

| Numri i shkollave    | Numri i nxënësve | Proporcioni nxënës/shkollë |
|----------------------|------------------|----------------------------|
| A (4+3 par. e ndarë) | 2265             | 324/ shkolla               |

Tab. 14. Proporcioni nxënës/shkollë

| Mësimdhënësit |      | Personeli administrativ |     | Personeli ndihmës |      | Gjithsej personel arsimor |     |
|---------------|------|-------------------------|-----|-------------------|------|---------------------------|-----|
| Numri         | %    | Numri                   | %   | Numri             | %    | Numri                     | %   |
| 130           | 84.3 | 6                       | 2.9 | 20                | 12.8 | 156                       | 100 |

Tabela.15. Personeli arsimor në arsimin e mesëm sipas pozitës (klasat (X-XIII) 2011

### 1.1.9.4. Hapësira shkollore në institucionet arsimore

Rritja dhe përmirësimi i hapësirës shkollore me qëllim të arritjes së standardeve evropiane, si dhe hulumtimi i standardit ekzistues është një proces i vazhdueshëm.

Lëmi i arsimit në Kamenicë zhvillohet në 46 objekte shkollore. Disa prej tyre janë të dëmtuara nga vjetërsia, kushtet atmosferike apo edhe nga neglizhenca e mirëmbajtjes (6 objekte), kështu që shumë objekte kanë nevojë për rindërtim, riparim, rehabilitim, instalim të ngrohjes, instalim të energjisë elektrike, rregullim të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe mirëmbajtje të objektit.

Sektori i infrastrukturës është përgjegjës për vlerësimin e nevojave të hapësirës shkollore, planifikimin, bashkërendimin, inspektimin dhe realizimin e projekteve me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës shkollore.

Për planifikimin dhe projektimin e objekteve shkollore së pari duhet të kemi kujdes në zhvillimin psiko-fizik të fëmijëve. Prejardhja gjenetike, mjedisi shoqëror dhe aktiviteti i fëmijëve në atë moshë ndikon në formimin e karakterit të tyre. Ky proces i ndërlikuar kërkon zgjedhje adekuate të hapësirës në kuptimin funksional dhe formal. Përceptimi i hapësirës për fëmijë është mjaft i ndryshueshëm nga ajo për të rritur, për këtë arsye këtë duhet gjithmonë ta kemi para sysh.


<sup>1</sup> Drejtoria e Arsimit Kamenic



**HAPËSIRAT SHKOLLORE DHE SPORTIVE  
AREAS FOR SPORTS AND EDUCATION  
ŠKOLE I SPORTSKE PROSTORE**

**LEGJENDA  
LEGEND  
LEGENDA**

-  Kufi komunal
-  Zonë kadastrale
-  Stadium sportive



Shkalla / Scale / Razmera  
1:150,000

3,700 1,850 0 3,700 Meters

Burimi i të dhënave: Agjencia Kadastrale e Kosovës  
Institucionet e Komunës së Kamenicës  
Fotografisë ajrore të vitit 2009  
Grupi për Demografi dhe Çështje Sociale

Projected Coordinate System: KosovoRef01  
Projection: Transverse\_Mercator  
Geographic Coordinate System: GCS\_ETRS\_1989  
Datum: D\_ETRS\_1989  
Prime Meridian: Greenwich  
Angular Unit: Degree



Harta.7. Hapësira shkollore dhe sportive

| Nr.             | Emir I shkollës      | Vendbanimi            | Nr.i nxën. | Nr.i arsim. | Sip.e objektit | Siperf. nx/ m2 | Nx. / Ars. |
|-----------------|----------------------|-----------------------|------------|-------------|----------------|----------------|------------|
| 1               | SHFMU,,F. Noli"      | Kamenicë              | 1241       | 72          | 2667           | 2.1490733      | 17.2361111 |
| 2               | SHFMU,,M. Krasniqi"  | Rogaçicë              | 467        | 33          | 3012           | 6.4496788      | 14.1515152 |
| 3               | SHFMU,,17 Shkurti"   | Muçivërc              | 242        | 21          | 2800           | 11.570248      | 11.5238095 |
|                 | --/--                | Dajkoc                | 27         | 0           | 200            | 7.4074074      | #DIV/0!    |
|                 | --/--                | Kranidell             | 17         | 0           | 200            | 11.764706      | #DIV/0!    |
| <b>Gjithsej</b> |                      |                       | 286        | 21          | 3200           | 11.188811      | 13.6190476 |
| 4               | SHFMU,,A. Krashnica" | Koretin               | 545        | 35          | 1627           | 2.9853211      | 15.5714286 |
| 5               | SHFMU,,Skënderbeu"   | Hogosht               | 224        | 49          | 1969           | 8.7901786      | 4.57142857 |
|                 | --/--                | Kopërnice             | 159        | 0           | 700            | 4.4025157      | #DIV/0!    |
|                 | --/--                | Lisockë               | 50         | 0           | 800            | 16             | #DIV/0!    |
|                 | --/--                | Dazhnicë              | 9          | 0           | 60             | 6.6666667      | #DIV/0!    |
|                 | --/--                | Gjyrishec             | 7          | 0           | 200            | 28.571429      | #DIV/0!    |
| <b>Gjithsej</b> |                      |                       | 449        | 49          | 3729           | 8.3051225      | 9.16326531 |
| 6               | SHFMU,,K. Zeka"      | Desivojcë             | 85         | 35          | 1900           | 22.352941      | 2.42857143 |
|                 | --/--                | Poliçkë               | 73         | 0           | 0              | 0              | #DIV/0!    |
|                 | --/--                | Tërstenë              | 11         | 0           | 0              | 0              | #DIV/0!    |
|                 | --/--                | Lajçiq                | 10         | 0           | 0              | 0              | #DIV/0!    |
|                 | --/--                | Velegllavë            | 4          | 0           | 0              | 0              | #DIV/0!    |
|                 | --/--                | Sedllar               | 3          | 0           | 0              | 0              | #DIV/0!    |
| <b>Gjithsej</b> |                      |                       | 186        | 35          | 1900           | 10.215054      | 5.31428571 |
| 7               | SHFMU,,N. Berisha"   | Tugjec                | 62         | 20          | 700            | 11.290323      | 3.1        |
|                 | --/--                | Gmicë                 | 2          | 0           | 0              | 0              | #DIV/0!    |
|                 | --/--                | Feriqevë              | 2          | 0           | 0              | 0              | #DIV/0!    |
|                 | --/--                | Svircë                | 0          | 0           | 0              | #DIV/0!        | #DIV/0!    |
|                 | --/--                | Zajçec                | 2          | 0           | 0              | 0              | #DIV/0!    |
|                 | --/--                | Meshinë               | 2          | 0           | 0              | 0              | #DIV/0!    |
| <b>Gjithsej</b> |                      |                       | 70         | 20          | 700            | 10             | 3.5        |
| 8               | SHFMU,,R. Mala"      | Topanicë              | 295        | 26          | 1277           | 4.3288136      | 11.3461538 |
| 9               | SHFMU,,S. Misini"    | Shipashnicë e Epërme. | 300        | 27          | 1400           | 4.6666667      | 11.1111111 |
|                 | --/--                | Shipashnicë e Poshtme | 112        | 0           | 385            | 3.4375         | #DIV/0!    |
| <b>Gjithsej</b> |                      |                       | 412        | 27          | 1785           | 4.3325243      | 15.2592593 |
| 10              | SHFMU,,A. Rustemi"   | Karaçevë e Epërme     | 173        | 14          | 963.74         | 5.5707514      | 12.3571429 |
| 11              | SHFMU,,A. Thaçi"     | Karaçevë e Poshtme    | 195        | 13          | 1070           | 5.4871795      | 15         |



|   |                      |           |      |     |          |           |            |
|---|----------------------|-----------|------|-----|----------|-----------|------------|
| 12  | SHFMU"XH. Ahmeti"    | Hodonoc   | 298  | 22  | 1367.85  | 4.5901007 | 13.5454545 |
| 13  | SHFMU,,H. Prishtina" | Busavatë  | 159  | 14  | 200      | 1.2578616 | 11.3571429 |
| 14  | SHFMU,,I. Seferi"    | Strezoc   | 133  | 13  | 966      | 7.2631579 | 10.2307692 |
|   | --/--                | Kremenatë | 4    | 0   | 128      | 32        | #DIV/0!    |
| <b>Gjithsej</b>   |                      |           | 137  | 13  | 1094     | 7.9854015 | 10.5384615 |
| 15  | SHF,,7 Shtatori"     | Krilevë   | 109  | 17  | 330      | 3.0275229 | 6.41176471 |
| <b>Gjithsej<br/>arsimi<br/>illor e I<br/>mesëm<br/>I ulët</b> |                      |           | 5022 | 411 | 24922.59 | 4.9626822 | 12.2189781 |
| 1   | Gjimnazi,,I. Qemali" | Kamenicë  | 783  | 75  | 1719     | 2.1954023 | 10.44      |
|   | --/--                | Rogaçicë  | 406  | 0   | 0        | 0         | #DIV/0!    |
|   | --/--                | Hogosht   | 144  | 0   | 0        | 0         | #DIV/0!    |
| <b>Gjithsej</b>   |                      |           | 1333 | 75  | 1719     | 1.2895724 | 17.7733333 |
| 2   | ShMLP,,A. Durrsaku"  | Kamenicë  | 388  | 55  | 1750     | 4.5103093 | 7.05454545 |
|   | --/--                | Rogaçicë  | 403  | 0   | 0        | 0         | #DIV/0!    |
| <b>Gjithsej</b>   |                      |           | 791  | 55  | 1750     | 2.2123894 | 14.3818182 |
| <b>Gjithsej arsimi I mesem I lartë</b>                        |                      |           | 2124 | 130 | 3469     | 1.6332392 | 16.3384615 |
| <b>Gjithsej</b>   |                      |           | 7146 | 541 | 28391.59 | 3.9730744 | 13.2088725 |

**Tab. 15. Raporti në mes hapësirave shkollore dhe nxënësve**

### **1.1.10.0 MJEDISI DHE SHFRYTËZIMI I TOKËS**

**1.1.10.1 Ajri** – sa i përket çështjes së ajrit, për shkak të mungesës së monitorimit, mund të konstatojmë se mesatarja e ndotjes së ajrit është përafërsisht e ngjashme me ndotjen në komunat tjera të territorit të Kosovës

Vendosja e brezave dhe shiritave të gjelbër me kapacitete për absorbim të aerosolëve, gazrave azotike, të sulfurit dhe karbonike, metaleve të rënda për gjatë rrugëve kryesore siç shihet në hartë.

Rivitalizimin e parqeve ekzistuese dhe ngritjen e parqeve të reja në hapësirat e identifikuar si të lira dhe të mundshme për ngritjen e këtyre parqeve.

Mbrojtja, zhvillimi e sidomos kultivimi i pyjeve të reja edhe me kapacitete për thithje të gazrave dhe ajrosolëve të ndryshme.

Përcaktimin e kriterëve për sipërfaqet e gjelbra të detyrueshme në lejet e reja të ndërtimit, me prioritet në qytetin e Kamenicës dhe nënqendrat.

Përmirësimin e qarkullimit rrugor për shmangien e fluksit të madh të makinave nëpër qendra të vendbanimeve, ku është e përqendruar dhe pjesa më e madhe e popullsisë;

Pengimi i shkarkimeve të ndotësve në ajër nga industria dhe makinat lëvizëse me vendosjen e katalizatorëve dhe rregullimeve tjera në aspektin teknik dhe largimin e të vjetrave nga trafiku.

Shfrytëzimin e energjive alternative (kryesisht energjia diellore, rrjedhat e ujit, e erës dhe energjia gjeotermale).

Minimizimin e shfrytëzimit të automjeteve dhe shfrytëzimin e transportit publik.

Promovimin e lëvizjeve jo të motorizuara, duke planifikuar edhe stazat për çiklistë dhe ecje në këmbë, siç shihet në hartë.

Planifikimi i nivelit të tolerueshëm të ndotjes dhe zhurmës sidomos në zonat me veprimtari të ndjeshme (afër shkollave, spitaleve etj).

Rikonstruktimi rrugëve (qarkoreve dhe bajpaseve në qendrën urbane, kanalizimeve dhe mënjanimi i deponive të mbeturinave, të cilat janë burim i ndotjes së ajrit nga djegiet dhe oksidimet e mbeturinave) etj.

### **1.1.10 .2. Uji**

#### **Nevojat Orientuese të Komunës së Kamenicës për Ujë Deri në Vitin 2023+**

Në kuadër të nevojave për ujë janë paraparë: nevojat për ujë të popullsisë, industrisë , bujqësisë etj.

##### **➤ Nevojat për ujë të pijes**

Sigurimi dhe furnizimi me ujë i popullsisë dhe i vendbanimeve në Komunën e Kamenicës paraqet detyrë afatgjatë. Tash për tash, qendra dhe pjesa më e madhe e fshatrave nuk e kanë të zgjidhur çështjen e furnizimit me ujë. Për zgjidhje afatgjatë të furnizimit të popullsisë me ujë është diskutuar edhe më parë , në kuadër të programit të Kombeve të Bashkuara për zhvillim (UNDP), e nëpërmes të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (WHO) ku ishte hartuar projekti "Furnizimi i vendbanimeve me ujë", mënjanimi i mbeturinave dhe kontrolli i ndotjeve në Kosovë. Në kuadër të Rajonit të Anamoravës, ishte trajtuar edhe furnizimi me ujë i Komunës së Kamenicës , për qytetin dhe një numër të konsiderueshëm fshatrash, të cilat gjenden në afërsi të qytetit.

Për fat të keq deri tani përkundër projekteve ekzistuese të parapara më parë, nuk kemi një zgjidhje të qëndrueshme për komunën e Kamenicës, Projekti i pendës në lumin e Kremenatës nuk është realizuar dhe tani duhet të hartohen studimet dhe projektet përkatëse edhe për

lumenjtë tjerë, kështu që furnizimi i çdo vendbanimi me ujë të zgjidhet në mënyrë sa më racionale dhe i mjaftueshëm.

Varësisht nga madhësia, karakteri, funksioni i vendbanimit dhe studimeve të bëra, janë paraparë standardet e konsumit të ujit për një banor për vitet 2011 - 2021, pra janë përcaktuar sasi të nevojshme të ujit. Sasi të nevojshme të ujit për një ditë, dhe në mënyrë të njëjtë mund të kalkulohen për një vjet, varësisht nga madhësia dhe karakteri i qytetit, nevojiten 230 - 320 litra/ditë – për banorë, ose 1693490 -2356160 litra/ditë - për qytetin, ose 19,6 - 27,3 litra /sekondë - për qytetin; ndërkaq për të gjitha vendbanimet e komunës, prej 230 - 320 litra/banorë/ditë = 9251520 - 12871680 litra/ditë 107 - 149 litra /sekondë apo 3376804800 - 4698163200 litra /vit,. Për studime të mëtejshme të këtij problemi duhet llogaritur shtimin e popullsisë dhe nevojat për çdo vit.

➤ **Nevojat e industrisë**

Nevojat e industrisë për ujë do të varen nga madhësia dhe struktura e kapaciteteve industriale si dhe nga procesi teknologjik në kohe dhe hapësire të caktuar. Nga kjo arsye, vështirësohet mjaft përcaktimi me i hollësishëm i sasive të nevojshme të ujit, që do të nevojitej industrisë së kësaj komune deri në vitin 2021. Duke i marrë parasysh indikatorët global si dhe disa vlerësime që janë bërë mbi trendet e mundshme për të ardhmen, atëherë sasi të përgjithshme orientuese të ujit për nevoja të industrisë për një vit dhe njëjtë mund të kalkulohet deri në vitin 2021 do të jenë rreth 150 - 200 litra/sek 3356640000 - 4475520000 litra/Vit ( për 259 ditë pune brenda vitit) . Për studime të mëtejshme të këtij problemi duhet llogaritur industrinë dhe nevojat për çdo vit.

➤ **Sasi të nevojshme të ujit për ujitje në bujqësi**

Sasi të nevojshme të ujit për ujitje në bujqësi do të varen nga sipërfaqet bujqësore dhe nga struktura e sipërfaqeve të mbjella. Sipas dokumentacionit të hartuar deri tash, janë shqyrtuar mundësitë për ujitjen e rreth 5 - 6 mijë hektarëve të sipërfaqes së punueshme. Duke i llogaritur rreth 3200 m<sup>3</sup> ujë për një hektar gjatë vitit me thatësi mesatare, atëherë nevojat e përgjithshme do të ishin rreth 16000000000 - 19200000000 litra/vit . Mirëpo, në bazë të studimit të mëtejshëm të këtij problemi duhet llogaritur se këto sipërfaqe do të rriten në rreth 50 hektarë për çdo vjet.

➤ Bilanci i sasive të përgjithshme të nevojshme të ujit për një vjet dhe njëjtë mund të kalkulohet deri në vitin 2021, që duhet mundësuar realizimin orientues të prodhimit në të gjitha fushat ekonomike dhe t'i plotësojë nevojat e popullsisë së Komunës së Kamenicës, është si vijon:

| Destinimi      | Sasia për Sekondë (litra/sek) | Sasia për Vit (litra /Vit) |
|----------------|-------------------------------|----------------------------|
| Për popullsinë | 107,1 – 149                   | 3376804800 - 4698163200    |
| Për industri   | 150 - 200                     | 3356640000 - 4475520000    |
| Për bujqësi    | 507,3 – 608,8                 | 16000000000 - 19200000000  |
| Gjithsej:      | 764,4 – 957,8                 | 22733444800 – 28373683200  |

Tab. 17. Llogaritja e sasisë së ujit

Komuna jonë është mjaft e pasur me ujë, mirëpo në mungesë të mjeteve për rregullimin e ujësjellësit pjesa më madhe e banorëve të komunës sonë që jetojnë në zonat rurale, furnizohet me ujë të pijshëm nga burimet e ndryshme individuale (puse të hapura, kroje malore, lumenjve), që nuk trajtohet në aspektin e analizave laboratorike dhe nuk është i verifikuar profesionalisht nga Instituti i Shëndetit Publik, përveç ujësjellësit të qytetit. Komuna jonë është e pasur me rezerva të ujit falë tri pellgjeve ujore: (pellgu i lumit të Strezovcit, të Hogoshtit dhe lumit të Desivojcës), si dhe pellgjeve të tjera më të vogla të cilat kanë konfiguracion më të vogël, por me kualitet (cilësi) të mirë për ujë të pijshëm. Po ashtu, kemi një numër të vogël të fshatrave që e kanë ujësjellësin, si Topanica, Karaçeva e Poshtme, Iagjeja e Muhaxherëve në Rogaçicë dhe në Reçan. Në ndërtim e sipër janë: Shipashnica e Epërme, Kopërnica, Kolloleqi dhe Koretini.

#### **Burimet ujore sipërfaqesore dhe nëntokësore në territor dhe cilësia e tyre**

Në Komunën e Kamenicës ka shumë lumenj, por më të rëndësishmit janë: Lumi "Kriva Reka", Lumi i Hogoshtit dhe Lumi i Desivojcës. Të gjithë këta lumenj derdhën në Lumine "Morava". Në këtë komunë ekziston edhe liqeni në fshatin Ruboc. Lumenjtë e Kamenicës rrjedhje më të mëdha shfaqin gjatë muajit shkurt, mars dhe maj, kurse rrjedha më të vogla gjatë muajit gusht dhe shtator. Sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm, pjesa më e madhe e banorëve të Komunës së Kamenicës furnizohen me ujë nga puse të hapura, kroje malore, lumenj etj. Momentalisht, në funksion janë këta ujësjellës: në Kamenicë, në Topanicë, në Karaçevë të Poshtme dhe në Reçan. Në ndërtim e sipër janë në: Shipashnicë të Epërme, në Kopërnice, në Kolloleq dhe në Koretin.

#### **Sistemi i Ujësjellësit në Komunën e Kamenicës**


Në qytetin e Kamenicës dhe në disa fshatra ka sisteme të instaluar të ujësjellësve. Përkundër kësaj sipas informative të organeve kompetente në Kamenicë vetëm 77% e popullatës urbane dhe 15% e asaj rurale është e përfshirë në rrjetin publik të furnizimit me ujë. Rreth 85% e popullatës rurale përdorë ujin e puseve të cekëta dhe të pambrojtura. Siç shihet nga lartë, vetëm banorët, të cilët janë duke banuar në qytet furnizohen me ujë nga rrjeti qendror i ujësjellësit dhe sipas informatave jo të gjithë banorët e qytetit. Humbjet teknike dhe administrative në sistemin e ujësjellësit janë shumë evidente.



**SHFRYTËZIMI I TOKËS  
LAND USE  
KORISCENJA ZEMLJISTA**

**LEGJENDA  
LEGEND  
LEGENDA**

- Kufi komunal
- Zonë kadastrale
- Lumë, rrjedhë, përrua
- Rrugë
- Varrezat
- Shkollat
- Hapës Shëndetsore
- Hapëirat Sportive
- Tokat bujqësore
- Tokë ndërtimore
- Pyjet



Burimi i të dhënave: Agjencia Kadastrale e Kosovës  
Institucionet e Komunës së Kamenicës  
Fotografë ajrore të vitit 2009  
Grupi për Shfrytëzimin e Tokës dhe Mjedisit

Shkalla / Scale / Razmera  
1:150,000

Projected Coordinate System: KosovaRef01  
Projection: Transverse\_Mercator  
Geographic Coordinate System: GCS\_ETRS\_1989  
Datum: D\_ETRS\_1989  
Prime Meridian: Greenwich  
Angular Unit: Degree



Harta 8. Shfrytëzimi i tokës

### **1.1.10.2. Shfrytëzimi i ujit**

Aktualisht në Komunën e Kamenicës, në mënyrë institucionale menaxhohet vetëm ujësjellësi i Qytetit të Kamenicës nga Kompania Rajonale për Ujë "Hidromorava" SH.A-Gjilan, Njësia Kamenicë. Ky ujësjellës është themeluar në vitin 1966, nga i cili bëhet furnizimi i qytetit me ujë të pijshëm.

Për kundër investimeve të donatorëve të ndryshëm, sistemi i furnizimit të qytetit me ujë të pijshëm ballafaqohet me probleme të shumta si:

Sasia e pamjaftueshme e burimeve të ujit për një furnizim të qëndrueshëm të qytetarëve me ujë të pijshëm;

Amortizimi i rrjetit shpërndarës të ujit për shkak të vjetërsisë dhe materialit ( pjesa më e madhe e gypave shpërndarës është nga Azbesti dhe Zinku)

Amortizimi i pajisjeve prodhuese (pompave, gjeneratorëve, klorinatorëve, ndërtesave përcjellëse ujore etj.);

Pjesa më e madhe e banorëve të Komunës së Kamenicës që jetojnë në zonat rurale, furnizohet me ujë të pijshëm nga burime të ndryshme individuale (puse të hapura, kroje malore, lumenj etj.), i cili nuk trajtohet profesionalisht dhe nuk është i verifikuar nga institucionet zyrtare;

Momentalisht, në funksion janë këta ujësjellës: në Topanicë, në Karaçevë të Poshtme dhe në Reçan, kurse në ndërtim e sipër janë: në Shipashnicë të Epërme, në Kopërnice, në Kolloleq dhe në Koretin.

Komuna e Kamenicës është e pasur me rezerva hidrike falë 3 (tri) pellgjeve ujore: (pellgu i Lumit të Strezocit, pellgu i Lumit të Hogoshtit dhe pellgu i Lumit të Desivojcës) si dhe pellgje tjera më të vogla të cilat kanë konfiguracion të përshtatshëm, cilësi të mirë, dhe sasi të mjaftueshme për shfrytëzimin e tij për ujë të pijshëm.

#### **Furnizimi i qytetit me ujë të pijshëm**

KRU "Hidromorava" ShA-Gjilan, Njësia – Kamenicë, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi që ka, bën furnizimin e qytetit të Kamenicës me ujë të pijshëm dhe menaxhon me ujëra të zeza. Procesi i prodhimit, trajtimit dhe distribuimit të ujit të pijshëm realizohet në dy (2) stacione pompimi në lokacione të ndara mes veti por të integruara në sistemin e shpërndarjes e ujit të pijshëm.

#### **Stacioni i Pompimit Nr.1**

Sasia më e madhe e ujit në këtë stacion vjen nga sistemi i drenazhimit i vendosur nën shtratin e Lumit "KRIVA REKA", i cili bën furnizimin e pesë (5) puseve të hapura dhe tri (3) puseve të shpuara nga të cilët përmes pompave horizontale dhe zhytëse mbushet rezervuari me kapacitet prej 142 m<sup>3</sup> dhe pastaj me anë të pompave tjera bëhet distribuimi në rrjetin kryesor të ujit. Aktualisht, është në përfundim e sipër projekti për furnizim me ujë të pijshëm në një pjesë të Lagjes "MALËSIA" në Kamenicë nga një rezervuar me kapacitet prej 300 m<sup>3</sup>.

#### **Stacioni i Pompimit Nr.2**

Uji i pijshëm në këtë stacion vjen nga dy puse të shpuara në thellësi prej 54 m, të cilët e mbushin një pus të hapur dhe nga këtu përmes pompave horizontale bëhet distribuimi i ujit në rrjetin kryesor të qytetit.

### **Kapaciteti prodhues i ujit të pijshëm**

Kapaciteti instalues i prodhimit të ujit në Stacionin e Pompimit Nr.1 është 28 litra/sec kurse në Stacionin e Pompimit Nr.2. është 14 litra/sec d.m.th kapaciteti total mund të jetë 42 litra/sec. Nga kjo mund të llogaritet se bilanci vjetor i prodhimit të ujit mund të jetë  $1.306.368 \text{ m}^3$  ujë. Mirëpo ky kapacitet nuk mund të arrihet, asnjëherë për disa shkaqe të ndryshme e më kryesoret janë:

1. Mungesa e ujit të pijshëm në vendburime të ujit, sidomos gjatë stinës së verës;
2. Ndërprerja e energjisë elektrike;
3. Mirëmbajtja e pajisjeve prodhuese të ujit,(ndërrimi i pjesëve rezervë, lubrifikimi i pompave etj.
4. Ndërprerja e procesit të prodhimit me rastin e riparimeve në rrjetin kryesor të ujit si dhe defektet tjera të natyrave të ndryshme.

Kur kemi parasysh këtë situatë mund të konstatojmë se, për vitin 2010 mund të prodhojmë  $601.652 \text{ m}^3$  ( 19.34 litra/sec) ujë ose shprehur në përqindje 46.05 % nga sasia që mund të prodhohet nëse, paraprakisht nuk do të ndikonin faktorët e cekur më lartë.

### **Distribuími i ujit të pijshëm**

Uji i pijshëm nga stacionet prodhuese deri te konsumatorët shpërndahet përmes gypave transmetuesë (bartës) të profileve dhe materialeve të ndryshme. Profili më i gjerë i gypave shpërndarës të ujit është Fi-225 mm, kurse më i ngushti Fi-16 mm (zakonisht në objekte të veçanta banimi). Gypat shpërndarës janë nga këto materiale: AC (azbest çimento) ZN (Zing) dhe HPDE (polietilen).

Ndër sfidat më serioze që ballafaqohet kompania e ujit, është gjendja e pavolitshme e gypave të ujit për shkak të amortizimit dhe materialit të dobët të tyre, ku për këtë shkak humbjet teknike dhe komerciale janë shumë të mëdha. Në vitin 2009 kemi arritur të faturojmë vetëm 56.67 % ujë nga sasia e përgjithshme e ujit të prodhuar kurse diferenca prej 43.33 % llogaritet si humbje teknike dhe komerciale.

### **Cilësia e ujit**

Siç cekëm më lartë, uji për qytetin e Kamenicës, merret nga burime nëntokësore dhe për këtë arsye turbulencat sipërfaqësore nuk ndikojnë në të. Në stacionet e pompimit bëhet trajtimi i tij me sistemin e gaztë të klorifikimit e në mungesë të tij më hipoklorit. Uji kontrollohet, vazhdimisht nga punëtorët tanë përgjegjës për kualitetin por edhe nga IKSHP ( Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik); bëhen analiza të rregullta periodike dhe mund të themi se uji i qytetit në bazë të rezultateve të përhershme që dalin nga ky institut, i plotëson të gjitha standardet e parapara me ligj për ujin e pijshëm.

#### **1.1.10.3. Regjimi i ujërave**

Shikuar në tërësi, gjendja e rregullimit të ujërrjedhave dhe mbrojtja nga vërshimet në territorin e Kamenicës është e pavolitshme. Edhe pse në periudhën e kaluar janë bërë disa punë për rregullimin e ujërrjedhave të shumta, përsëri kohë pas kohe kanë

ndodhur vërshime të intensiteteve të ndryshme, të cilat kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme në amvisni dhe shumë degë të ekonomisë.

Kjo gjendje është pasojë, para së gjithash e faktit se gjatë aktiviteteve për rregullimin e ujërrjedhave dhe mbrojtjes nga vërshimet, më shumë janë bërë punë të karakterit parcial.

Mirëpo, intensiteti i realizimit të këtyre punëve edhe më tutje është i pavolitshëm. Situatën më së shumti e rëndon mirëmbajtja e dobët dhe kontrolli i pamjaftueshëm i objekteve mbrojtëse përgjatë lumenjve, si dhe puna e pamjaftueshme hulumtuese dhe studimore.

Lumi dhe përroskat në Kamenicë nuk janë të rregulluar ashtu, që të mund ti pranojnë prurjet (rritje e pakontrolluar e nivelit të ujit) dhe si pasojë janë përmbytjet me përmasa të mëdha. Në bazë të shënimeve të sistematizuara (master planit të vitit 1986), gjatësia e lumit dhe përroskave që rrezikojnë të vërshojnë është 94.36km. Prej këtyre deri më tani, janë rregulluar vetëm rreth 3 km apo rreth 3.17 %.

#### **1.1.10.4. Ndotja e ujërave**

Territori i Komunës së Kamenicës ka një rrjet hidrografik, i cili i takon pellgut të Detit të Zi. Në komunë janë tre lumenj: Krivareka me degët e saja lumë burimor, Lumi i Hogoshtit dhe Lumi i Desivojcës. Lumi “Kriva Reka” buron në malet e Gollakut dhe deri në hyrje të fshatit Hajnoc, i takon lumenjve me ndotje të kategorisë së parë (lum i pastër). Prej fshatit Hajnoc e deri në hyrje të Kamenicës, i takon shkallës së dytë. (ndotje e lehtë) Pas daljes nga vendbanimi i Kamenicës e deri në bashkimin me Lumin “Morava”, shndërrohet në lumë me ndotje të kategorisë dytë (ndotje e lartë). Shkarkimi i ujërave të zeza dhe industriale pa asnjë trajtim paraprak leshohen në Lumin “Kriva Reka” dhe rritë shkallën e ndotjes së lumit. Lumi i Hogoshtit është i pastër deri në hyrje të vendbanimeve (ujra burimore), pas shkarkimit të ujërave të zeza dhe hudhjeve të mbeturinave në shtretërit e lumenjve kalon në shkallën e ndotjes dytë.

Lumi i Desivojcës deri në vendbanimin e Shipashnices së Epërme i takon shkallës së parë të pastërtisë, nga aty e deri në Moravë i takon shkallës më të lartë të ndotjes.

Shkarkimi i ujërave të zeza në rrjedhjet lumore pa trajtim paraprak, rritë shkallën e ndotjes së lumenjve. Çdo banor shkarkon 16.46m<sup>3</sup> ujëra të zeza.

Vetëm Kamenica si qytet me 7334 banorë, shkakton 6.5 l/s ose 47671 m<sup>3</sup>/vit ujëra të zeza të patrajtuara në lumë brenda vitit, pa llogaritur këtu objektet shoqërore, industriale etj.

Përveç shkarkimit të ujërave të zeza, lumenjtë ndoten dhe degradohen edhe nga mbeturinat që i hedhë popullata lokale, nxjerrja ilegale e rërës, shkatërrimi i florës pranë brigjeve të lumenjve, shpërlarja e tokës gjatë reshjeve atmosferike, nga objektet industriale etj.

Rekomandohet për Komunën e Kamenicës që të përcaktohet për variantin e parë, ku komuna të ndajë sipërfaqe tokësore për ndërtimin e një impianti në mes të fshatit Korminjan dhe Dheut të Bardhë. Arsye është, përshkak të konfiguracionit të terrenit.





**HARTA HIDROGJEOLOGJIKE E KAMENICËS**  
**HIDROGEOLOGICAL MAP OF KAMENICA**  
**HIDROGEOLOŠKA KARTA KAMENICA**

**LEGJENDA / LEGEND / LEGENDA**


**Njësitë Hidrologjike**

- Grumbullim i ujrave nëpër pore dhe çarje të shkëmbinjëve nëntokësorë me përkueshmëri të mesme-ulejt
- Grumbullim i ujrave nëpër pore të shkëmbinjëve nëntokësorë me përkueshmëri të mesme-lartë
- Grumbullim i ujrave nëpër çarje dhe pore karstike të shkëmbinjëve nëntokësorë me grumbullim të madhë lokal me përkueshmëri në për mes të frakturave
- Ujëmbajtës pa pa porozitet ose çarje të konsiderueshme

**Burimet e ujit**

- Burim i pazhvilluar
- Shpellhapje
- Shqim
- Pikë Hidroakumuluese

**Kufiri Komunal**  
**Zonat kadastrale**



Burimi i të dhënave: Agjencia Kadastrale e Kosovës  
 Institucionet e Komunës së Kamenicës  
 Komisioni i Përvanur i Minerave dhe Mineraleve  
 Grupi i Shtyrtimit të Tokës

Projected Coordinate System: KosovaRef01  
 Projection: Transverse\_Mercator  
 Geographic Coordinate System: GCS\_ETRS\_1989  
 Datum: D\_ETRS\_1989  
 Prime Meridian: Greenwich  
 Angular Unit: Degree



Harta.9. Harta hidrologjike e Komunës së Kamenicës

## **Analiza e gjendjës në nivel komunal në lumenjtë e komunës, në funksion të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe Urban**



### **Analiza e gjendjës**

Për këtë analizë kemi shfrytëzuar të gjitha të dhënat nga burimet e më parshme, ku në ndërkohë edhe kemi realizuar vizita të shtretërve të lumenjve dhe përrojeve, në Komunën e Kamenicës, si : në Berivojcë, në Koretin, në Topanicë, në Hodonoc, në Rogaçicë, në Novosellë , Karaçevë të Poshtme, në Muçivërc, në Dajkoc , në Shipashnicë të Poshtme, në Shipashnicë të Epërme, në Velegllavë, në Lajçiq , në Kolloleq, në Kopernicë, në Hogosht, në Hajnoc, në Meshinë, në Kremenatë, në Strezoc, në Krilevë dhe në Kamenicë.

Komuna e Kamenicës vite me radhë ballafaqohet me problemin e vërshimeve si të lokaliteteve të banuara, ashtu edhe të tokave bujqësore. Po ti bëhej një analizë të kësaj gjendjeje të shkaktuar nga këto vërshime, mund të vijmë deri te këto konkluzione:

- 1. Dëmet ekonomike**
- 2. Rrezikimi i shëndetit të njeriut**

### **3. Ndotje përmanente e amibientit**

#### **4. Përhapje e epidemive, etj.**

Faktorët që ndikuan në paraqitjen e kësaj gjendjeje janë të shumtë, si pasojë e moskujdesit instutucional, si dhe vetëdija e ulët e popullates për kujdesin ndaj këtyre shtretërve, të ciët me veprimet e veta (ngushtim, hedhje mbeturinash) në kanale ndikojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë në mbylljen e tyre.

Pasojat ma të mëdha paraqiten në dy stinët e vitit, në vjeshtë dhe në pranverë. Pra, si pasojë e rritjes së reshjeve atmosferike (borës ,shiu) shkaktjnë daljen nga shtretërit e lumenjve dhe përrojeve, duke vërshuar siëpërfaqe të mëdha si të ekonomive familjare ashtu edhe të tokës bujqësore.

Asnjë nga shtretërit e lumenjve të Komunes së Kamenicës, nuk mirëmbahen nga dora e njeriut, e as ndonjë ndërmarrje komunale. Ato janë lënë në mëshirën e vet natyrës dhe në shumicën e rasteve shërbejnë si deponi te mbeturinave. Më shumë se 70% të shtretërve të lumenjve në Komunën e Kamenicës, kanë nevojë për ndërhyrje (murosje me gurë, mbjellje të drunjve, betonim, ngritjen e nivelit te mureve te shtratit) dhe pastrim nga mbeturinat e hedhura në lumenj, siç janë mbeturinat shtëpiake , ambalazhet plastike, najloni, drunjte e rrëzuar dhe të mbetur si prurje nga lartë, etj. Problem në vete vite me radhë, ishte deponimi i prurjeve erozive nga gërryerjet, te cilat përveç mbeturinave janë ndër shkaktarët kryesor të vërshimeve në Komunën e Kamenicës.

#### **Lumi „Kriva Reka”**

Sot si pika më rrezikuar nga vërshimet, është indentifikuar pjesa e territorit të qytetit duke filluar nga ura te stacioni i autobusëve e deri në dalje të fshatit Topanicë.

Pjesa në hyrje dhe në dalje të qytetit është rregulluar , kurse pjesa tjetër kërkon ndërhyrje të menjëhershme për arsye se, në atë pjesë ka shumë mbeturina, mandej duhet bërë zgjerimin e shtratit te lumit dhe rregullimin me gurë e me dhe , mbjelljen e drunjve pasi që ai është shumë i ngushtë, ku në rast të vërshimeve nuk e përballon ngritjen e nivelit të ujit të Lumit “Kriva Reka”.

Në atë zonë, në rast vërshimesh, të gjitha shtëpitë majtas dhe djathtas Lumit “Kriva Reka” e deri në dalje të fshatit Topanicë janë te rrezikuara nga vërshimet. Në atë zonë jetojnë afër 1649 familje, me afer 7103 banorë.

Mbeturinat në shtratin e Lumit “Kriva Reka”, fillojnë nga fshati Krilevë dhe vazhdojnë përgjatë gjithë shtratit te lumit . Edhe vetë shtrati nga Krileva e deri ne dalje të fshatit Topanicë është i lënë nën mëshirën e natyrës. Problem i veçantë, është edhe paraqitja e erozioneve në disa pjesë të këtij lumi, si pasojë e shkulljes së drunjve nga uji, si dhe degradimi eksploatimi i zhavorrit nga qytetarë të pa përgjegjshëm .

Gjatësia e shtratit të lumit nga fshati Krilevë e deri në dalje të fshatit Topanicë, është afër 31.695 km.

Pjesa e tokës nga ana e djadhtë dhe e majtë në drejtim të rrjedhjes së lumit, përgjatë tij bëhet hedhja ilegale e mbeturinave të ndryshme, si dhe derdhja e ujërave të zeza pa i trajtuar. Këto hedhje-derdhje janë rrezik i përhershëm për Lumin “Kriva Reka” në atë pjesë, si dhe për shëndetin e popullatës e cila lëvizë në atë zonë.



## 2. Berivojcë

Rrjedhja e Lumit “Kriva Reka” kalon përmes fshatit, rreth një zone të banuar (i bashkon ura), vazhdon në drejtim të fshatit Koretin dhe derdhet në lumin e Moravës. Pjesa e tokës nga ana e djadhtë dhe e majtë në drejtim të rrjedhjes së lumit (përgjatë lumit) bëhet hedhja ilegale e mbeturinave të ndryshme, si dhe derdhja e ujërave të zeza pa i trajtuar. Të gjitha këto janë rrezik i përhershëm për Lumin “Kriva Reka” në atë pjesë, si dhe për shëndetin e popullatës e cila levizë në atë zonë. Problem i veçantë, është edhe paraqitja e erozioneve në disa pjesë të Lumit “Kriva Reka” si pasojë e shkuljes së druve nga uji si dhe degradimi, eksploatimi i zhavorrit nga qytetarë të pa përgjegjshëm.

Kjo pjesë e lumit kërkon ndërhyrje të menjëhershme, për arsye se në atë pjesë ka shumë mbeturina, pra duhet bërë zgjerimin e shtratit të lumit dhe rregullimin me gurë e me dhe. Gjithashtu, është shumë e nevojshme të mbëltohen dru, pasi që shtrati është shumë i ngushtë, ku në rast të vërshimeve nuk e përballon dot ngritjen e nivelit të ujit të Lumit “Kriva Reka”.



a). Përroi i cili kalon përmes fshatit Berivojcë, domosdo kërkohet që shtrati i tij të pastrohet dhe të vendosen gypa (tuba) ose të rregullohet me gurë për të shmangur problemet që janë krijuar. Përroi është bërë një lloj deponie ilegale e mbeturinave të ndryshme, ku nga ato e sjellin në rrezik të përhershëm shëndetin e popullatës e cila lëvizë në atë rrugë dhe zonë. Përkitazi për këtë, duhet të rregullohet kullimi i ujit në atë përrua nga dy anët e rrugës së fshatit, sepse uji është i bllokuar në rrugë dhe ka krijuar puseta dhe baltë, e cila pengon qarkullimin normal të banorëve dhe automjeteve në fshat. Ky përrua derdhet në Lumin “Kriva Reka”.

Nga ajo që theksuam më lartë, vijmë të konstatimi se sikurse të lumi edhe të ky përrua duhet ndërhyrja për pastrimin e shtratit, duke filluar mbi fshatin Berivojcë e për ta vazhduar me pastrimin e mbeturinave dhe hendeqeve deri në pikën ku bëhet derdhja në Lumin "Kriva Reka"



## 4. Koretini

Rrjedhja e Lumit “Kriva Reka” kalon edhe nëpërmes të fshatit, kalon nën urat dhe vazhdon në drejtim të fshatit Topanicë, ku derdhet në Lumin e “Morava”. Pjesa e tokës nga ana e djathtë dhe e majtë në drejtim të rrjedhjes së lumit, ku përgjatë tij bëhet hedhja ilegale e mbeturinave të ndryshme, si dhe derdhja e ujërave të zeza pa i trajtuar. Të gjitha ato janë rrezik i përhershëm për Lumin “Kriva Reka” në atë pjesë, si dhe për shëndetin e popullatës e cila levizë në atë rrugë dhe zonë. Problem i veçantë është edhe paraqitja e erozioneve në disa pjesë të Lumit “Kriva Reka” si pasojë e shkuljes së druve nga uji, si dhe degradimi e eksploatimi i zhavorrit nga qytetarë të pa përgjegjshëm.

Kjo pjesë e lumit kërkon ndërhyrje të menjëhershme, për arsye se në atë pjesë ka shumë mbeturina, pra duhet bërë zgjerimin e shtratit të lumit dhe rregullimin me gurë e me dhe pastaj duhet të bëhet mbëltimi i druve pasi që ai (shtrati) është shumë i ngushtë, ku në rast të vërshimeve nuk e përballon ngritjen e nivelit të ujit të Lumit “Kriva Reka”.



### 3. Topanicë

Rrjedhja e Lumit “Kriva Reka” kalon edhe nëpër mes fshatit Topanicë, kalon nën urat dhe vazhdon në drejtim të fshatit Domaroc dhe derdhet në Lumin “Morava”. Pjesa e tokës nga ana e djadhtë dhe e majtë në drejtim të rrjedhjes së lumit, përgjatë lumit bëhet hedhja ilegale e mbeturinave të ndryshme si dhe derdhja e ujërave të zeza pa i trajtuar, ku edhe ato janë rrezik i përhershëm për Lumin “Kriva Reka” në atë pjesë, si dhe për shëndetin e popullatës e cila levizë në atë rrugë dhe zonë. Problem i veçantë është edhe paraqitja e erozioneve në disa pjesë të Lumit “Kriva Reka”, si pasojë e shkuljes së druve nga uji, si dhe degradimi e eksploatimi i zhavorrit nga qytetarë të pa përgjegjshëm.

Kjo pjesë e lumit kërkon ndërhyrje të menjëhershme për arsye se, në atë pjesë ka shumë mbeturina. Pra, duhet bërë zgjerimin e shtratit të lumit dhe rregullimin me gurë e me dhe, pastaj mbëltimin e druve pasi që ai është shumë i ngushtë, dhe në rast të vërshimeve nuk e përballon ngritjen e nivelit të ujit të Lumit “Kriva Reka”.





#### 4.Hodonoc

Rrjedhja e lumit të Hogoshtit dhe Desivojcës bashkohen në fshatin Dajkoc dhe kalojnë nëpër fshatrat Muçivërc, Rogaçicë, nga drejtimi tjetër Lumit “Katushnica”, ku bashkohen e duke kaluar në pjesen perëndimore të fshatit Hodonoc, kalon nën urat dhe vazhdon në drejtim të fshatit Domaroc dhe derdhet në lumin e Moravës. Pjesa e tokës nga ana e djathtë dhe e majtë në drejtim të rrjedhjes së lumit, përgjatë lumit bëhet hedhja ilegale e mbeturinave të ndryshme si dhe derdhja e ujërave të zeza pa i trajtuar. Të gjitha ato janë rrezik i përhershëm për lumin e Hogoshtit e të Desivojcës në atë pjesë, si dhe për shëndetin e popullatës e cila levizë në atë rrugë dhe zonë. Problem i veçantë është edhe paraqitja e erozioneve në disa pjesë të lumit të Hogoshtit dhe Desivojcës, si pasojë e shkuljes së druve nga uji si dhe degradimi- eksploatimi i zhavorrit nga qytetarë të pa përgjegjshëm .

Kjo pjesë e lumit kërkon ndërhyrje të menjëhershme për arsye se, në atë pjesë ka shumë mbeturina, prandaj duhet bërë zgjerimin e shtratit të lumit dhe rregullimin me gurë e me dhe. Gjithashtu, duhet bërë mbëltime të druve pasi që ai është shumë i ngushtë, ku në rast të vërshimeve nuk e përballon ngritjen e nivelit të ujit të Lumit të Hogoshtit, Desivojcës dhe Katushnicës.



a). Përroi i cili kalon përmes fshatit Hodonoc kërkon që shtrati i tij të pastrohet, të vendosen gypa ose të rregullohet me gurë për të shmangur problemet, të cilat janë krijuar si deponi ilegale e mbeturinave të ndryshme, duke qenë rrezik i përhershëm për shëndetin e popullatës e cila lëvizë në atë rrugë dhe zonë. Duhet që në të, të rregullohet kullimi i ujit nga të dy anët e rrugës së fshatit, sepse uji është i bllokuar në rrugë dhe ka krijuar puseta dhe baltë, e cila e pengon qarkullimin normal të banorëve dhe automjeteve në fshat. Ky përroi derdhet në lumin e Hogoshtit, Desivojcës.

Edhe te ky përroi duhet të bëhen ndërhyrje në pastrimin e shtaratit, duke filluar mbi fshat dhe duhet vazhduar me pastrimin e mbeturinave, hendeqeve deri në pikën ku bëhet derdhja në lumin e Hogoshtit, Desivojcës.



## 5. Rogaçicë

Rrjedhjet e lumit të Hogoshtit dhe të Desivojcës bashkohen në fshatin Dajkoc, ku si një lumë i vetëm kalon nëpër fshatrat Muçivërc, Rogaçicë, duke kaluar në pjesën jugperendimore të fshatit Rogaçicë, kalon nën urat dhe vazhdon në drejtim të fshatrave Hodonoc, Domaroc dhe derdhet në lumin e Moravës. Pjesa e tokës nga ana e djadhtë dhe e majtë në drejtim të rrjedhjes së lumit, përgjatë lumit bëhet hedhja ilegale e mbeturinave të ndryshme, si dhe derdhja e ujërave të zeza pa i trajtuar. Gjithashtu, ato janë rrezik i përhershëm për lumin e Hogoshtit dhe të Desivojcës në atë pjesë, si dhe për shëndetin e popullatës e cila levizë në atë rrugë dhe zonë. Problem i veçantë është edhe paraqitja e erozioneve në disa pjesë të lumit të Hogoshtit dhe të Desivojcës, si pasojë e shkuljes së druve nga uji si dhe degradimi- eksploatimi e zhavorrit nga qytetarë të pa përgjegjshëm.

Kjo pjesë e lumit kërkon ndërhyrje të menjëhershme, për arsye se në atë pjesë ka shumë mbeturina, ku duhet bërë zgjerimin e shtratit të lumit dhe rregullimin me gurë e me dhe. Gjithashtu, duhet bërë mbëltimi i druve pasi që ai është shumë i ngushtë dhe në rast të vërshimeve nuk e përballon ngritjen e nivelit të ujit të lumit të Hogoshtit, Desivojcës dhe Katushnicës.



b). Përroi i cili kalon përmes fshatit Rogaçicë kërkon që shtrati i saj të pastrohet, të vendosen gypa ose të rregullohet me gurë për të shmangur problemet të cilat janë krijuar, pra si deponi ilegale e mbeturinave të ndryshme. Ato janë rrezik i përhershëm për shëndetin e popullatës, e cila levizë në atë rrugë dhe zonë. Mandej duhet, që të rregullohet kullimi i ujit në atë përrua nga dy anët e rrugës se fshatit, sepse uji është i bllokuar në rrugë dhe ka krijuar puseta dhe baltë, ku pengon lëvizjen normale të banorëve dhe qarkullimin po normal të automjeteve në fshat. Ky përrua derdhet në lumin e Hogoshtit, Desivojcës.

Edhe te ky përrua duhet të bëhen ndërhyrje në pastrimin e shtratit, duke filluar mbi fshatin Rogaçicë e duke vazhduar me pastrimin e mbeturinave dhe hendeqeve deri në pikën ku bëhet derdhja në lumin e Hogoshtit, Desivojcës .



## 6. Novosellë

Rrjedhja e Lumit "Katushnica", kalon në pjesen veriperëndimore të fshatit Novosellë, kalon nën urat dhe vazhdon në drejtim të fshatit Rogaçicë , bashkohet me lumin e Hogoshtit dhe të Desivojcës dhe derdhet në lumin e Moravës. Pjesa e tokës nga ana e djadhtë dhe e majtë në drejtim të rrjedhjes së lumit, përgjatë lumit bëhet hedhja ilegale e mbeturinave të ndryshme, si dhe derdhja e ujërave të zeza pa i trajtuar. Ato janë rrezik i përhershëm për Lumin e "Katushnica" në atë pjesë, si dhe për shëndetin e popullatës e cila lëvizë në atë rrugë dhe zonë. Problem i veçantë është edhe paraqitja e erozioneve në disa pjesë të lumit të i cili kalon nëpër fshat, sepse si pasojë e shkulljes së druve nga uji si dhe degradimi- i zhavorrit nga qytetarë të pa përgjegjshëm .

Kjo pjesë e lumit kërkon ndërhyrje të menjëhershme për arsye se, në atë pjesë, ka shumë mbeturina, prandaj duhet bërë zgjerimin e shtratit të lumit dhe rregullimin me gurë dhe me dhe , mbëltime të druve pasi që ai është shumë i ngushtë, dhe në rast të vërshimeve nuk e përballon ngritjen e nivelit të ujit të lumit.



## 7.Karaçevë e Poshtme

Rrjedhja e Lumit “Katushnica” kalon në mes të fshatit , kalon nën urat dhe vazhdon në drejtim të fshatrave Novosellë, Rogaçicë , bashkohet me lumin e Hogoshtit dhe Desivojcës dhe derdhet në lumin e Moravës. Pjesa e tokës nga ana e djathtë dhe e majtë në drejtim të rrjedhjes së lumit, përgjatë lumit bëhet hedhja ilegale e mbeturinave të ndryshme, si dhe derdhja e ujërave të zeza pa i trajtuar. Pra, ato janë rrezik i përhershëm për Lumin “Katushnica” në atë pjesë, si dhe për shëndetin e popullatës e cila levizë në atë rrugë dhe zonë. Problem i veçantë është edhe paraqitja e erozioneve në disa pjesë të lumit, si pasojë e shkuljes së druve nga uji si dhe degradimi-eksplotimi zhavorrit nga qytetarë të pa përgjegjshëm .

Kjo pjesë e lumit kërkon ndërhyrje të menjëhershme, për arsye se në atë pjesë ka shumë mbeturina, prandaj duhet bërë zgjerimin e shtratit të lumit dhe rregullimin me gurë e me dhe. Gjithashtu, duhet bërë mbëltime i druve pasi që ai është shumë i ngushtë, ku në rast të vërshimeve nuk e përballon ngritjen e nivelit të ujit të Lumit “Katushnica”.



## 8. Muçivërc

Rrjedhjet e lumit të Hogoshtit dhe Desivojcës bashkohen në fshatin Muçivërc , ku tash më si një lumë kalon në pjesën jugperëndimore të fshatit duke vazhduar nëpër të, kalon urat dhe vazhdon në drejtim të fshatrave Rogaçicë , Hodonoc , Domaroc dhe derdhet në lumin e Moravës. Pjesa e tokës nga ana e djathtë dhe e majtë në drejtim të rrjedhjes së lumit, ku përgjatë tij bëhet hedhja ilegale e mbeturinave të ndryshme si dhe derdhja e ujërave të zeza pa i trajtuar. Pra, ato janë rrezik i përhershëm për lumin e Hogoshtit dhe Desivojcës në atë pjesë, si dhe për shëndetin e popullatës e cila levizë në atë rrugë dhe zonë. Problem i veçantë është edhe paraqitja e erozioneve në disa pjesë të lumit të Hogoshtit dhe të Desivojcës, si pasojë e shkuljes së druve nga uji si dhe degradimi- marrja e zhavorrit nga qytetarë të pa përgjegjshëm .

Kjo pjesë e lumit kërkon ndërhyrje të menjëhershme, për arsye se në atë pjesë ka shumë mbeturina, ku duhet bërë zgjerimin e shtratit të lumit dhe rregullimin me gurë e me dhe. Gjithashtu, duhet bërë mbëltimi i druve, pasi që ai është shumë i ngushtë, ku në rast të vërshimeve nuk e përballon ngritjen e nivelit të ujit të lumit të Hogoshtit, të Desivojcës.



a). Përroska (vada e mullinjve) e cila kalon përmes fshatit Muçivërc, kërkon që shtrati i saj të pastrohet, të vendosen gypa ose të rregullohet me gurë për ti shmangur problemet të cilat janë krijuar si deponi ilegale e mbeturinave të ndryshme, dhe ato janë rrezik i përhershëm për shëndetin e popullatës e cila levizë në atë rrugë dhe zonë. Duhet që të rregullohet kullimi i ujit në ate përroskë nga dy anët e rrugës së fshatit, sepse uji është i bllokuar në rrugë, ku ka krijuar puseta dhe baltë e cila e pengon lëvizjen normale të banorëve dhe automjeteve në fshat. Kjo përroskë derdhet në lumin e Hogoshtit, të Desivojcës.

Edhe te kjo përroskë duhet të bëhen ndërhyrje në pastrimin e shtaratit, duke filluar mbi fshatin Muçivërc dhe për ta vazhduar me pastrimin e mbeturinave dhe hendeqeve deri në pikën ku bëhet derdhja në lumin e Hogoshtit, të Desivojcës .





## 9. Dajkoc

Rrjedhjet e lumit të Hogoshtit dhe të Desivojcës bashkohen në fshatin Dajkoc dhe kalojnë nëpër fshatrat Muçivërc, Rogaçicë dhe kalon në pjesën verilindore të fshatit Dajkoc. Ky lumë është i pasur me peshq, vjedulla të ujit etj, ku derdhet në Lumin e Moravës së Binqës. Pjesa e tokës nga ana e djathtë dhe e majtë në drejtim të rrjedhjes së lumit, përgjatë lumit bëhet hedhja ilegale e mbeturinave të ndryshme si dhe derdhja e ujërave të zeza pa i trajtuar. Pra, ato janë rrezik i përhershëm për lumin e Hogoshtit dhe të Desivojcës në atë pjesë, si dhe për shëndetin e popullatës e cila levizë në atë rrugë dhe zonë. Problem i veçantë është edhe paraqitja e erozioneve në disa pjesë të lumit të Hogoshtit dhe të Desivojcës, si pasojë e shkuljes së druve nga uji, si dhe degradimi- eksploatimi i zhavorrit nga qytetarë të pa përgjegjshëm .

Kjo pjesë e lumit kërkon ndërhyrje të menjëhershme, për arsye se në atë pjesë ka shumë mbeturina, derdhje të ujërave të zeza. Duhet bërë zgjerimin e shtratit të lumit dhe rregullimin me gurë e me dhe. Gjithashtu, duhet bërë mbëltimi i druve, pasi që ai është shumë i ngushtë, ku në rast të vërshimeve nuk e përballon ngritjen e nivelit të ujit të lumit të Hogoshtit, të Desivojcës.





## 10. Shipashnicë e Poshtme

Rrjedhja e lumit të Desivojcës kalon nëpër fshatrat Muçivërc, Rogaçicë dhe në pjesën verilindore të fshatit Shipashnicë e Poshtme. Kalon nën urat dhe vazhdon në drejtim të fshatrave Muçivërc, Rogaçicë, Hodonoc, Domaroc, ku derdhet në lumin e Moravës. Pjesa e tokës nga ana e djathtë dhe e majtë në drejtim të rrjedhjes së lumit, ku përgjatë bëhet hedhja ilegale e mbeturinave të ndryshme si dhe derdhja e ujërave të zeza pa i trajtuar. Ato janë rrezik i përhershëm për lumin e Desivojcës në atë pjesë, si dhe për shëndetin e popullatës e cila lëvizë në atë rrugë dhe zonë. Problem i veçantë, është edhe paraqitja e erozioneve në disa pjesë të lumit të Desivojcës, si pasojë e shkuljes së druve nga uji si dhe degradimi- eksploatimi i zhavorrit nga qytetarë të pa përgjegjshëm.

Kjo pjesë e lumit kërkon ndërhyrje të menjëhershme, për arsye se në atë pjesë ka shumë mbeturina, derdhje të ujërave të zeza. Prandaj duhet bërë zgjerimin e shtratit të lumit dhe rregullimin me gurë e me dhe. Gjithashtu, duhet bërë mbëltimi i druve, pasi që ai është shumë i ngushtë, dhe në rast të vërshimeve nuk e përballon ngritjen e nivelit të ujit të lumit Desivojcës.



## 11. Shipashnicë e Epërme

Rrjedhja e lumit të Desivojcës kalon nëpër fshatrat Muçivërc, Rogaçicë dhe kalon në pjesën verilindore të fshatit Shipashnicë e Epërme ( është i pasur me peshq) , kalon nën urat dhe vazhdon në drejtim të fshatrave Shipashnicë e Poshtme, Muçivërc, Rogaçicë , Hodonoc , Domaroc dhe derdhet në lumin e Moravës. Pjesa e tokës nga ana e djathtë dhe e majtë në drejtim të rrjedhjes së lumit, ku përgjatë tij bëhet hedhja ilegale e mbeturinave të ndryshme, si dhe derdhja e ujërave të zeza në atë pjesë. Këto veprime janë të dëmshme edhe për shëndetin e popullatës, e cila levizë në atë rrugë dhe zonë. Problem i veçantë, është edhe paraqitja e erozioneve në disa pjesë të lumit të Desivojcës, si pasojë e shkuljes së druve nga uji si dhe degradimi- eksploatimi i zhavorrit nga qytetarë të pa përgjegjshëm.

Kjo pjesë e lumit kërkon ndërhyrje të menjëhershme, për arsye se në atë pjesë ka shumë mbeturina e derdhje të ujërave të zeza. Pra, duhet bërë zgjerimin e shtratit të lumit dhe rregullimin me gurë e me dhe , mbëltrimin e druve pasi që ai është shumë i ngushtë, ku në rast të vërshimeve nuk e përballon ngritjen e nivelit të ujit të lumit të Desivojcës.





## 12 Velegllavë

Rrjedhja e lumit të Desivojcës kalon nëpër fshatrat Muçivërc, Rogaçicë dhe kalon në pjesen verilindore të fshatit Velegllavë (është i pasur me peshq) , pastaj kalon nën urat dhe vazhdon në drejtim të fshatrave Shipashnicë e Epërme, Shipashnicë e Poshtme, Muçivërc, Rogaçicë , Hodonoc, Domaroc dhe derdhet në lumin e Moravës. Pjesa e tokës nga ana e djathtë dhe e majtë në drejtim të rrjedhjes së lumit, ku përgjatë tij bëhet hedhja ilegale e mbeturinave të ndryshme si dhe derdhja e ujërave të zeza pa i trajtuar. Pra, ato janë rrezik i përhershëm për lumin e Desivojcës në atë pjesë, si dhe për shëndetin e popullatës e cila levizë në atë rrugë dhe zonë. Problem i veçantë është edhe paraqitja e erozioneve në disa pjesë të lumit të Desivojcës, si pasojë e shkuljes së druve nga uji si dhe degradimi- eksploatimi i zhavorrit nga qytetarë të pa përgjegjshëm .

Kjo pjesë e lumit kërkon ndërhyrje të menjëhershme, për arsye se në atë pjesë ka shumë mbeturina, derdhje të ujërave të zeza pa trajtim. Pra, duhet bërë zgjerimin e shtratit të lumit si dhe rregullimin me gurë e me dhe. Gjithashtu, duhet bërë mbëltrimin e druve, pasi që ai është shumë i ngushtë, ndërsa në rast të vërshimeve nuk e përballon ngritjen e nivelit të ujit të lumit të Desivojcës.



### 13. Lajçiq

Rrjedhja e lumit të Desivojcës kalon nëpër fshatrat Muçivërc, Rogaçicë dhe në pjesën verilindore të fshatit Lajçiq (është i pasur me peshq), gjithashtu kalon nën urat dhe vazhdon në drejtim të fshatrave Velegllavë, Shipashnicë e Epërme, Shipashnicë e Poshtme, Muçivërc, Rogaçicë , Hodonoc , Domaroc dhe derdhet në lumin e Moravës. Pjesa e tokës nga ana e djathtë dhe e majtë në drejtim të rrjedhjes së lumit, ku përgjatë lumit bëhet hedhja ilegale e mbeturinave të ndryshme si dhe derdhja e ujërave të zeza pa i trajtuar. Pra, ato janë rrezik i përhershëm për lumin e Desivojcës në atë pjesë, si dhe për shëndetin e popullatës e cila levizë në atë rrugë dhe zonë. Problem i veçantë është edhe paraqitja e erozioneve në disa pjesë të lumit të Desivojcës, si pasojë e shkuljes së druve nga uji si dhe degradimi- eksploatimi i zhavorrit nga qytetarë të pa përgjegjshëm .

Kjo pjesë e lumit kërkon ndërhyrje të menjëhershme, për arsye se në atë pjesë ka shumë mbeturina, derdhje të ujërave të zeza. Gjithashtu, duhet bërë zgjerimin e shtratit të lumit dhe rregullimin me gurë e me dhe , mbëltime të druve, pasi që ai është shumë i ngushtë, ku në rast të vërshimeve nuk e përballon ngritjen e nivelit të ujit të lumit Desivojcës.



#### 14. Kolloleq

Rrjedhja e lumit të Hogoshtit dhe Kopërnicsës kalon në pjesën lindore të fshatit Kolloleq, mandej kalon nën urat dhe vazhdon në drejtim të fshatrave Shipashnicë e Poshtme, Muçivërc, Rogaçicë, Hodonoc, Domaroc dhe derdhet në lumin e Moravës. Pjesa e tokës nga ana e djathtë dhe e majtë në drejtim të rrjedhjes së lumit, ku përgjatë tij bëhet hedhja ilegale e mbeturinave të ndryshme si dhe derdhja e ujërave të zeza pa i trajtuar. Pra, ato janë rrezik i përhershëm për lumin e Hogoshtit dhe të Kopërnicsës në atë pjesë, si dhe për shëndetin e popullatës e cila levizë në atë rrugë dhe zonë. Problem i veçantë është edhe paraqitja e erozioneve në disa pjesë të lumit të Hogoshtit dhe Kopërnicsës si pasojë e shkuljes së druve nga uji si dhe degradimi –eksploatimi i zhavorrit nga qytetarë të pa përgjegjshëm.

Kjo pjesë e lumit kërkon ndërhyrje të menjëhershme, për arsye se në atë pjesë ka shumë mbeturina, derdhje të ujërave të zeza pa trajtim. Gjithashtu, duhet bërë zgjerimin e shtratit të lumit dhe rregullimin me gurë e me dhe. Për të shmangur këto rreziqe përfundimisht duhet bërë mbëltimi i druve, pasi që ai është shumë i ngushtë, dhe në rast të vërshimeve nuk e përballon ngritjen e nivelit të ujit të lumit të Hogoshtit dhe Kopërnicsës.



## Kopërnice

Rrjedhja e lumit të Kopërnices kalon në pjesën jugperëndimore të fshatit Kopërnice, mandej kalon nën urat dhe vazhdon në drejtim të fshatrave Kolloleq, Shipashnicë e Poshtme, Muçivërc, Rogaçicë , Hodonoc , Domaroc dhe derdhet në lumin e Moravës. Pjesa e tokës nga ana e djathtë dhe e majtë në drejtim të rrjedhjes së lumit, gjithashtu përgjatë lumit bëhet hedhja ilegale e mbeturinave të ndryshme si dhe derdhja e ujërave të zeza pa i trajtuar. Pra, ato janë rrezik i përhershëm për lumin e Kopërnices në atë pjesë, si dhe për shëndetin e popullatës e cila levizë në atë rrugë dhe zonë. Problem i veçantë është edhe paraqitja e erozioneve në disa pjesë të lumit të Kopërnices si pasojë e shkuljes së druve nga uji, si dhe degradimi- eksploatimi i zhavorrit nga qytetarë të pa përgjegjshëm .

Kjo pjesë e lumit kërkon ndërhyrje të menjëhershme, për arsye se në atë pjesë ka shumë mbeturina, derdhje pa trajtim të ujërave të zeza. Pra, duhet bërë zgjerimin e shtratit të lumit dhe rregullimin me gurë e me dhe. Gjithashtu, duhet bërë mbëltimi i druve, pasi që ai është shumë i ngushtë, ku në rast të vërshimeve nuk e përballon ngritjen e nivelit të ujit të lumit të Kopërnices.





## 16. Hogosht

Rrjedhja e lumit të Hogoshti kalon përmes fshatit dhe është i pasur me peshq, gjithashtu kalon nën urat dhe vazhdon në drejtim të fshatrave Kolloleq, Shipashnicë e Poshtme, Muçivërc, Rogaçicë , Hodonoc , Domaroc dhe derdhet në lumin e Moravës. Pjesa e tokës nga ana e djathtë dhe e majtë në drejtim të rrjedhjes së lumit, përgjatë tij bëhet hedhja ilegale e mbeturinave të ndryshme si dhe derdhja e ujërave të zeza pa i trajtuar. Pra, ato janë rrezik i përhershëm për lumin e Hogoshtit në atë pjesë, si dhe për shëndetin e popullatës e cila levizë në atë rrugë dhe zonë. Problem i veçantë është edhe paraqitja e erozioneve në disa pjesë të lumit të Hogoshtit, si pasojë e shkuljes së druve nga uji, si dhe mospastrimi i pendave që janë të mbushura me lym.

Kjo pjesë e lumit kërkon ndërhyrje të menjëhershme, për arsye se në atë pjesë ka shumë mbeturina, derdhje pa trajtim të ujërave të zeza. Pra, duhet bërë zgjerimin e shtratit të lumit, pastrimin e pendave nga lymet dhe rregullimin me gurë e me dhe. Domosdo duhet bërë mbëltrimin e druve, pasi që ai është shumë i ngushtë, ku në rast të vërshimeve nuk e përballon ngritjen e nivelit të ujit të lumit të Hogoshtit.





## 17. Hajnoc

Rrjedhja e Lumit “Kriva Reka” kalon edhe nëpërmes të fshatit Hajnoc (është i pasur me peshq), pastaj kalon nën urat dhe vazhdon në drejtim të qytetit të Kamenicës dhe përshkon fshatrat Berivojcë, Koretin, Topanicë dhe derdhet në lumin e Moravës. Pjesa e tokës nga ana e djathtë dhe e majtë në drejtim të rrjedhjes së lumit, përgjatë tij bëhet hedhja ilegale e mbeturinave të ndryshme si dhe derdhja e ujërave të zeza pa i trajtuar. Pra, ato janë rrezik i përhershëm për Lumin “Kriva Reka” në atë pjesë, si dhe për shëndetin e popullatës e cila levizë në atë rrugë dhe zonë. Problem i veçantë është edhe paraqitja e erozioneve në disa pjesë të lumit, si pasojë e shkuljes së drunjve nga uji si dhe degradimi- eksploatimi i zhavorrit nga qytetarë të pa përgjegjshëm.

Kjo pjesë e lumit kërkon ndërhyrje të menjëhershme, për arsye se në atë pjesë ka shumë mbeturina; prandaj duhet bërë zgjerimin e shtratit të lumit dhe rregullimin me gurë e me dhe. Gjithashtu, duhet bërë mbëltime të druve, pasi që ai është shumë i ngushtë, ku në rast të vërshimeve nuk e përballon ngritjen e nivelit të ujit të Lumit “Kriva Reka”.



## 18. Meshinë

Rrjedhja e lumit të Meshinës kalon përmes fshatit, po ashtu kalon nën urat dhe vazhdon në drejtim të Lumit “Kriva Reka” ku derdhet në të. Pjesa e tokës nga ana e djathtë dhe e majtë në drejtim të rrjedhjes së lumit, ku përgjatë tij bëhet hedhja ilegale e mbeturinave të ndryshme, si dhe derdhja e ujërave të zeza pa i trajtuar. Pra, ato janë rrezik i përhershëm për lumin e Meshinës në atë pjesë, si dhe për shëndetin e popullatës e cila lëvizë në atë rrugë dhe zonë. Problem i veçantë, është edhe paraqitja e erozioneve në disa pjesë të lumit të Meshinës, si pasojë mosmirëmbajtjes si dhe hedhjes së mbeturinave nga qytetarë të pa përgjegjshëm .

Kjo pjesë e lumit kërkon ndërhyrje te menjëhershme, për arsye se në atë pjesë, ka shumë mbeturina; prandaj duhet bërë zgjerimin e shtratit të lumit dhe rregullimin me gurë e me dhe. Gjithashtu, duhet bërë , mbëltimein e druve, pasi që ai është shumë i ngushtë, ku në rast të vërshimeve nuk e përballon ngritjen e nivelit të ujit të Lumit ‘Kriva Reka’.



## 19. Kremenatë

Rrjedhja e lumit të Meshinës kalon përmes fshatit, ku vazhdon në drejtim të Lumit “Kriva Reka” dhe derdhet në të. Pjesa e tokës nga ana e djathtë dhe e majtë në drejtim të rrjedhjes së lumit, ku përgjatë tij bëhet hedhja ilegale e mbeturinave të ndryshme, si dhe derdhja e ujërave të zeza pa i trajtuar; prandaj ato janë rrezik i përhershëm për lumin e Kremenatës në atë pjesë, si dhe për shëndetin e popullatës e cila lëvizë në atë rrugë dhe zonë. Problem i veçantë është edhe paraqitja e erozioneve në disa pjesë të lumit të Kremenatës, si pasojë e jo mirëmbajtjes si dhe hedhjes së mbeturinave nga qytetarë të pa përgjegjshëm .

Kjo pjesë e lumit kërkon ndërhyrje të menjëhershme, për arsye se në atë pjesë ka shumë mbeturina, prandaj duhet bërë zgjerimin e shtratit të lumit dhe rregullimin me gurë e me dhe. Gjithashtu, duhet bërë mbëltrimin e druve pasi që ai është shumë i ngushtë, ku në rast të vërshimeve nuk e përballon ngritjen e nivelit të ujit të Lumit “Kriva Reka”.



## 20. Strezoc

Rrjedhja e Lumit “Kriva Reka” kalon edhe nëpërmes të fshatit Strezoc, gjithashtu kalon nën urat dhe vazhdon në drejtim të qytetit të Kamenicës, pastaj përshkon fshatrat Berivojcë, Koretin, Topanicë dhe derdhet në lumin e Moravës. Pjesa e tokës nga ana e djathtë dhe e majtë në drejtim të rrjedhjes së lumit, përgjatë tij bëhet hedhja ilegale e mbeturinave të ndryshme, si dhe derdhja e ujërave të zeza pa i trajtuar. Pra, ato janë rrezik i përhershëm për Lumin “Kriva Reka” në atë pjesë, si dhe për shëndetin e popullatës e cila lëvizë në atë rrugë dhe zonë. Problem i veçantë është edhe paraqitja e erozioneve në disa pjesë të Lumit “Kriva Reka” si pasojë e shkuljes së druve nga uji si dhe degradimi- eksploatimi i zhavorrit nga qytetarë të pa përgjegjshëm.

Kjo pjesë e lumit kërkon ndërhyrje të menjëhershme, për arsye se në atë pjesë ka shumë mbeturina; prandaj duhet bërë zgjerimin e shtratit të lumit dhe rregullimin me gurë e me dhe. Gjithashtu, duhet bërë mbëltrimin e druve pasi që ai është shumë i ngushtë, ku në rast të vërshimeve nuk e përballon ngritjen e nivelit të ujit të Lumit “Kriva Reka”.



a). Përroi i cili kalon përmes fshatit Strezoc kërkon, që shtrati i tij të pastrohet, të vendosen gypa ose të rregullohet me gurë për të shmangur problemet të cilat janë krijuar, pra si deponi ilegale e mbeturinave të ndryshme. Ato janë rrezik i përhershëm për shëndetin e popullatës e cila levizë në atë rrugë dhe zonë. Duhet, që të rregullohet drenazhimi i ujit në atë përrua nga dy anët e rrugës së fshatit, sepse uji është i bllokuar në rrugë, ku ka krijuar puseta dhe baltë, e cila pengon lëvizjen normale të banorëve dhe të automjeteve në fshat. Ky përrua derdhet në Lumin “Kriva Reka”.

Edhe te ky përrua duhet të bëhen ndërhyrje në pastrimin e shtratit, duke filluar mbi fshatin Strezoc e duhet vazhduar me pastrimin e mbeturinave dhe hendeqeve deri në pikën ku bëhet derdhja në Lumin “Kriva Reka”.



## 21. Krilevë

Rrjedhja e Lumit “Kriva Reka” dhe lumit që vie nga flotacioni, bashkohen në fshatin Krilevë, pra kalon edhe nëpërmes të këtij fshati, rrjedhë nën urat dhe vazhdon në drejtim të qytetit të Kamenicës; pastaj përshkon fshatrat Berivojcë, Koretin, Topanicë dhe derdhet në lumin e Moravës. Pjesa e tokës nga ana e djathtë dhe e majtë në drejtim të rrjedhjes së lumit, përgjatë tij bëhet hedhja ilegale e mbeturinave të ndryshme, si dhe derdhja e ujërave të zeza pa i trajtuar. Pra, ato janë rrezik i përhershëm për Lumin “Kriva Reka” në atë pjesë, si dhe për shëndetin e popullatës e cila lëvizë në atë rrugë dhe zonë. Problem i veçantë është ndotja e lumit nga miniera e Artanës dhe paraqitja e erozioneve në disa pjesë të Lumit “Kriva Reka”, si pasojë e shkuljes së druve nga uji, si dhe degradimi- eksploatimi i zhavorrit nga qytetarë të pa përgjegjshëm .

Kjo pjesë e lumit kërkon ndërhyrje të menjëhershme, për arsye se në atë pjesë ka shumë mbeturina; prandaj duhet bërë zgjerimin e shtratit të lumit dhe rregullimin me gurë e me dhe. Gjithashtu, duhet bërë mbëltrimin e druve pasi që ai është shumë i ngushtë, dhe në rast të vërshimeve nuk e përballon ngritjen e nivelit të ujit të Lumit “Kriva Reka”.





## Vlerësimi i komisionit

Komisioni në vlerësimin e bërë në kapitullin e parë, ka parqitur një pasqyrë të gjendjes ekzistuese dhe rrethanat, të cilat kanë ndikuar në paraqitjen e kësaj gjendjeje. Në mënyrë të hollësishme kemi bërë përshkrimin e shtretërve të lumenjve dhe të gjithë përrrenjve në komunën tonë.

Detyra e komisionit ka qenë, të bëhen vizitat në terren dhe konstatimi i gjendjes momentale.

Kemi përdorur edhe metoden e fotografimit, duke ofruar dëshmi përmes objektivit për këtë gjendje .

### **Propozimet e komisionit**

Vlerësimi i këtij komisioni është se, jemi shumë të vetëdijshëm se vëllimi i këtij projekti do jetë shumë i madh dhe se mundësitë ekonomike për intervenim në të gjithë shtretërit e përrrenjve nuk do të mund të bëhet për një herë, por vlersëojmë se kjo punë duhet të bëhet në disa periudha kohore apo vjetore.

Pra, kemi për qëllim që shteti këtë projekt ta përdorë si strategji afatgjate të intervenimit të këtyre pikave të identikuara.

Ne mendojmë se, në fazën e parë duhet të intervenohet në ato pika të cilat për momentin janë duke shkaktuar dëmet më të mëdha në bujqësi si dhe te ekonomitë familjare.

Duke u bazuar në ankesat e shumë qytetarëve, të cilët m[ë shumë peticione të ndryshme u janë drejtuar organeve komunale se, nga vërshimet e shkaktuara në pronat e tyre po pamundësohet shfrytëzimi i këtyre pronave dhe njëkohsisht dëmet ekonomike janë të mëdha.

Duke i pasur parasysh këto ankesa, komisioni është i mendimit që për këtë fazë të intervenohet në rregullimin e këtyre përrrenjve dhe një pjesë të shtretërve të lumenjve.

- ❖ **Rregullimi i shtratit të Lumit “Kriva Reka” nga fshati Krilevë e gjer në dalje të fshatit Topanicë, sip.S=1278282 m<sup>2</sup>.**
- ❖ **Rregullimi i shtratit të Lumit “Katushnica” e gjer në fshatin Hodonoc, sip.S=161029 m<sup>2</sup>.**
- ❖ **Rregullimi i shtratit të lumit të Desivojcës e gjer në fshatin Muçivërc. sip.S=369146 m<sup>2</sup>.**
- ❖ **Rregullimi i shtratit të lumit të Hogoshtit e gjer në fshatin Muçivërc.**
- ❖ **Rregullimi i shtratit të lumit të Desivojcës dhe Hogoshtit nga fshati Muçivërc e gjer në fshatin Domaroc (fshatin Bajram Curr).**
- ❖ **Rrregullimi i shtratit të lumit të Kopërnicsës e gjer në bashkimin me lumin e Hogoshtit sip.S=106309 m<sup>2</sup>.**
- ❖ **Rrregullimi i shtratit të lumit të Rubocit nga penda e gjer në qytetin e Kamenicës sip.S=51454 m<sup>2</sup>.**
- ❖ **Rrregullimi i shtratit të lumit të Meshinës e gjer në fshatin Hajnoc sip.S=101855 m<sup>2</sup>.**

- ❖ Rrregullimi i shtratit të lumit të Kremenatës e gjer në rrjedhjen e Lumit “Kriva Reka”. sip.S= 33957 m<sup>2</sup>.
- ❖ Rregullimi i kanalit të ujitëjes nga fshati Shipashnicë e Poshtme e gjer në dalje të fshatit Muçivërc.
- ❖ Rregullimi i përroit i cili e përshkon tërë fshatin Rogaçicë sip.S=63732 m<sup>2</sup>
- ❖ Rregullimi i përroit i cili e përshkon tërë fshatin Berivojcë sip.S= 83156 m<sup>2</sup>.
- ❖ Rregullimi i përrrenjve dhe përroskave, sipas nevojës në tërë territorin e Komunës së Kamenicës.

**Parallogaritja e punëve të cilat duhet të kryhen gjatë hapjes dhe pastrimit të kanaleve të caktuara si prioritete nga ana e komisionit.**

Para se të llogarisim parallogarinë duhet të kihet parasyshë se matja e gjatësisë së kanaleve, është bërë përmes hartave gjeodezike të komunës dhe se të dhënat për gjatësinë e kanaleve janë të përafërta .

| Nr. | Përshkrimi i punëve sipas pozicionit   | Njësia         | Gjatësia M <sup>2</sup> | Çmimi i njësisë m <sup>2</sup> € | Gjithsej € |
|-----|--|----------------|-------------------------|----------------------------------|------------|
|     | Pastrim ,rregullimi dhe planifikimi i pjerrtësive anash si dhe transportimi i dheut të tepërt nga vendpunishtja deri në vendin e caktuar . | M <sup>2</sup> | 2776405                 | 2.5                              | 6941012,5  |

Tab. Nr. 17. Paramasa dhe parallogaria për pastrimin dhe rregullimin e rrjedhave të lumenjve, përrrenjve dhe përroskave.

**Vlera totale e propozuar me prioritete të këtij projekti kap shumën prej ;**

**6941012,5 € .**

## P Ë R F U N D I M E T

Me realizimin e këtij projekti konsiderojmë se, do të arrihen këto qëllime:

- Mbrojtjen e tokës bujqësore
- Zvogëlimin e dëmeve ekonomike
- Mbrojtjen e ambientit
- Pengimin e shfaqjes së epidemive
- Trajtimin e kanalizimeve.

### 1.1.10.5 BIODIVERSITETI

- Pas hulumtimeve të bëra në fitodiversitetin e Kamenicës, parashikohet që disa lloje të mbrohen, ruhen dhe konservohen pasi që është konstatuar se ekzistojnë fitocenoza, të cilat janë mjaft të begatshme dhe interesante në aspektin ekonomik, shkencor dhe mjekësor.
- Sa i përket zoodiversiteti, sipas të dhënave nga IKMN<sup>2</sup> dhe analizave të ekipit punues, territori i Komunës së Kamenicës është i pasur me shtazë të egra në mesin e të cilave ka edhe lloje që konsiderohen si të rrezikuara. Në këtë drejtim parashikohet mbrojtja e zonave ku jetojnë dhe veprojnë këto kafshë si dhe mbrojtja e tyre si specie.

#### ➤ **Humbja e Biodiversitetit në Kamenicë**

Edhe Kamenica si edhe shumica e vendeve të Kosovës po përballet me problemin e humbjes së biodiversitetit. Faktori kryesor që ka shkaktuar kërcënim serioz për ekzistencën e shumë llojeve bimore dhe shtazore, padyshim është faktori njeri; ndërkaq shpyllëzimet masive, shfrytëzimi intensiv i tokës, ndotjet e ajrit dhe ujit, si dhe gjuetia e pa kontrolluar janë vetëm disa nga faktorët tjerë që vazhdojnë të rrezikojnë biodiversitetin. Nga të gjitha këto, humbja e sipërfaqeve pyjore që ka përfshirë me të madhe ekosistemin natyror, është një nga problemet më emergjent për natyrën e Kamenicës. Reduktimi i sipërfaqeve pyjore dhe degradimi i vazhdueshëm i tyre ka ardhur, kryesisht si pasojë e shfrytëzimit pa kritere të zonave pyjore. Si pasojë e këtyre ndikimeve rrjedh edhe kërcënimi për zhdukje të shumë llojeve bimore dhe shtazore. Kafshët e rralla në vendin tonë si: ujku, derri i egër, kaprolli, dhelpra, vjedulla, dreri, dhia e egër, macja e egër, lepuri, ketri, thëllëza, shqiponja, petriti, pata e egër, lejleku etj. janë rrezikuar të pakësohen si pasojë e dëmtimit dhe ndryshimeve të habitateve të tyre, si gjuetisë së pakontrolluar, varfërimit dhe degradimit të ekosistemeve, erozionit dhe shpyllëzimit. Për llojet shtazore është shqetësuese, sidomos gjuetia e ushtruar gjatë periudhës së riprodhimit, ndërsa për llojet bimore grumbullimi i tyre gjatë fazës së lulëzimit dhe nxjerrja me rrënjë.

---

- **Domosdoshmëria e ruajtjes se biodiversitetit**
- Ruajtja e biodiversitetit është e rëndësishme dhe e domosdoshme për shumë arsye, por me këtë rast do të përmendim vetëm disa prej tyre.
- Ruajtja e biodiversitetit është detyrim i yni moral që t'u lëmë pasardhësve një mjedis po aq të pasur, sa kemi trashëguar nga paraardhësit tanë.
- Çdo qenie e gjallë ka të drejtë të jetojë, ashtu si dhe vetë njeriu; qeniet e gjalla që kanë jetuar dhe evoluar në mijëra milionë vjet mund të zhduken shumë shpejt, por nuk mund të krijohen përsëri.
- Shumë lloje bimore kanë vlera të jashtëzakonshme shëndetësore, andaj zhdukja e tyre do të thotë zhdukje e kësaj vlere.
- Proceset natyrore biologjike janë rregullatorët më të mirë të ruajtjes së mjedisit të pastër dhe të jetës në komunën tonë.
- Biodiversiteti dhe llojlojshmëria biologjike e natyrës, paraqet një potencial të lartë për zhvillimin e turizmit dhe rekreacionit të një vendi.
- Zhvillimi ekonomik i një vendi mund të sigurohet përmes ruajtjes dhe përdorimit të qëndrueshëm të pasurive natyrore e biologjike.
- **Dhe mbi të gjitha, vetë jeta e njerëzimit në tokë është e varur nga biodiversiteti- shfrytëzimit të bimëve dhe kafshëve.**
- Në fushën e biodiversitetit parashihen projekte për **mbrojtjen dhe zhvillimin e zonave:** Tugjeci, Kremenata 1 dhe Kremenata 2, Krileva, Pllanika-Kranidelli, Kika, Guri i Zi, Lumi “Kriva Reka”, lumi i Desivojcës dhe lumi i Hogoshtit.
- Parashihet pasurimi i florës dhe faunës në të gjithë territorin e komunës, duke specifikuar çka duhet të mbrohet dhe çka mund shfrytëzohet .
- Parashikohet një rezervat për ruajtjen e kaprrollit (capreolus), areali i të cilit është mjaft i rrezikuar dhe që do të shtrihet në zonën ndërkuftare në fshatrat Tërstenë – Desivojcë –Lajçiq – Kranidell - Sedllar etj.
- Parashikohet ruajtja e racës autoktone të buallicës dhe lopës bushe( qumështi i së cilës ka një vlerë të lartë ushqyese dhe mjekuuese) kryesisht në fshatrat kufitare Tugjec, Gjyrishec, Lisockë, Poliçkë, Desivojcë, Kranidell etj.
- Parashikohet rivitalizimi i ekosistemeve pyjore për parandalimin e shkatërrimit të habitateve të shumë llojeve bimore dhe shtazore në territorin e komunës së Kamenicës. Pra, duke e konsideruar të rëndësishme edhe ruajtjen e habitateve të fluturave, shpezëve mishngrënës etj. Shih hartën e biodiversitetit.




**BIODIVERSITETI**  
**BIODIVERSITY**  
**BIODIVERZITI**

**LEGJENDA/  
LEGEND/  
LEGENDA**

- Kufiri komunal
- Zonat kadastrale  
Dardanës (Kamenicës)

**Biodiversiteti**

- Habitata natyrore dhe Pika të rxehta të Biodiversitetit
- Lumë, rrjedhë, përrua



Burimi i të dhënave: Agjencia Kadastrale e Kosovës  
Institucionet e Komunës Kamenicës  
Grupi për Shfrytëzim të Tokës dhe Mjedis  
Plani Hapësiror i Kosovës

Projected Coordinate System: KosovaRef01  
Projection: Transverse\_Mercator  
Geographic Coordinate System: GCS\_ETRS\_1989  
Datum: D\_ETRS\_1989  
Prime Meridian: Greenwich  
Angular Unit: Degree




Harta 10. Biodiversiteti

### 1.1.10.6 TOKA

Me tepër se 60 % të popullatës jetojnë në zonat rurale, ku në Komunën e Kamenicës mendohet se janë rreth 4500 ekonomi familjare që merren me bujqësi. Territori i Komunës së Kamenicës shtrihet në një sipërfaqe prej 417 km<sup>2</sup>, me rreth 40224 banorë të grupuar në 58 Vendbanime. Numri i ekonomive familjare-bujqësore sillet rreth 4500 sish. Nga e gjithë sipërfaqja e cekur më lartë, sipërfaqe bujqësore janë 39199.830 ha. (ara 12284ha, kullosa 7365.3691 ha). 54.4 % dhe pyje 16510.1305 ha ose 39.6% , (pjesa tjetër është tokë e papunuar 6%)

|                        |                     |
|------------------------|---------------------|
| Tokë e punueshme – Ara | 12284 ha            |
| Kullosa                | <b>7365.3691ha</b>  |
| Livadhet               | <b>2842.3312ha</b>  |
| Pemë dhe perime        | 197 ha              |
| Vreshta                | 1.0 ha              |
| Male                   | <b>16510.1305ha</b> |
| <b>Totali</b>          | <b>39199.8308ha</b> |

Tab. 18 ndarja e tokave sipas kulturave



Graf. 9. Shpërndarja e Tokës (burimi: Agjenisa Kadastrale e Kosovës).

Nga sipërfaqja e përgjithshme rreth 54.4% është tokë bujqësore derisa pjesa tjetër shfrytëzohet për qëllime tjera.

Raporti përmbljedhës i shfrytëzimit të tokës për Komunën e Kamenicës



Grafi.10 Shfrytëzimi i tokës në (ha)

**Përcaktimi i klasave të bonitetit** -Klasifikimi i klasave të bonitetit për tokat e Komunës së Kamenicës është bërë sipas udhëzimeve të FAO (1976, 2007) dhe kritereve të propozuara në bazë të hulumtimeve të kryera në Komunën e Klinës (Zogaj, 2010). (Harta Pedologjike Harta e bonitetit të tokave) .

|   | boniteti |
|---|----------|
| 100, Tokë e kafenjtë teltyrore mbi argjilë liqeni   | IV       |
| 101, Tokë e kafenjtë mbi argjilë liqeni   | III      |
| 105, Tokë e kafenjtë e cektë mbi substrat gëlqeror i fortë                                      | V        |
| 107, Tokë e kafenjtë e cektë mbi filish   | VII      |
| 108, Tokë e kafenjtë, mesatarisht e thellë mbi filish   | VI       |
| 100, Tokë e kafenjtë teltyrore mbi argjilë liqeni   | IV       |
| 101, Tokë e kafenjtë mbi argjilë liqeni   | III      |
| 105, Tokë e kafenjtë e cektë mbi substrat gëlqeror i fortë                                      | V        |
| 107, Tokë e kafenjtë e cektë mbi filish   | VII      |
| 108, Tokë e kafenjtë mesatarisht e thellë mbi filish  | VI       |
| 12, Litosol mbi formacione shkëmbinjësh gurë-grill (gnais, mikashisti, filiti, argjiloshi etj.) | V        |
| 120, Tokë e kafenjtë e cektë mbi substrat gurë - grill ( filiti, mikashisti etj. )              | VI       |
| 121, Tokë e kafenjtë mesatarisht e thellë mbi substrat gurë-grill (filiti,mikashisti etj)       | V        |
| 129, Tokë e kafenjtë e cekët mbi shkëmbinj acidik (kvarcit, konglomerat, etj.)                  | VI       |
| 130, tokë e kafenjtë mesatarisht e thellë mbi shkëmbinj acidik (dacid, etj.)                    | VII      |
| 16, Aluvium ranor-teltyror  | II       |
| 2, Regosol mbi argjil liqenesh  | III      |
| 23, Deluvium teltyror   | III      |
| 26, Alovionale-delovionale ranoro-teltyrorë   | III      |
| 4, Regosol mbi shkëmbij të flishtë  | V        |
| 61, Ranker tipik mbi gurë-grill (filiti, etj.)  | V        |
| 70, Smonicë e pakarbonizuar   | III      |
| 71, Smonicë në proces të kafenjzimit  | IV       |
| 72, Smonicë e kafenjzuar  | III      |
| 74, Smonicë e lesivuar me pseudogleje   | IV       |
| 77, Smonicë e eroduar   | IV       |
| 78, Smonicë e kafenjt me glej   | IV       |
| 8, Litosol mbi formacione shkëmbinjsh acidik (granit, dacid, etj.)                              | V        |
| 89, Tokë e kuqe e kafenjzuar mbi formacion gëlqeror të fortë                                    | V        |
| 12, Litosol mbi formacione shkëmbinjësh gurë-grill (gnais, mikashisti, filiti, argjiloshi etj.) | V        |
| 120, Tokë e kafenjtë e cektë mbi substrat gurë - grill ( filiti, mikashisti etj. )              | VI       |
| 121, Tokë e kafenjtë mesatarisht e thellë mbi substrat gurë-grill (filiti,mikashisti etj)       | V        |
| 129, Tokë e kafenjtë e cekët mbi shkëmbinj acidik (kvarcit, konglomerat, etj.)                  | VI       |
| 130, tokë e kafenjtë mesatarisht e thellë mbi shkëmbinj acidik (dacid, etj.)                    | VII      |
| 16, Aluvium ranorë-teltyrorë  | II       |

|  |     |
|--|-----|
| 2, Regosol mbij argjil liqenesh                                    | III |
| 23, Deluvium teltyrorë   | III |
| 26, Alovionale-Delovionale Ranoro-teltyrorë                        | III |
| 4, Regosol mbij shkëmbij të flishtë                                | V   |
| 61, Ranker tipik mbi gurë-grill (filiti, etj.)                     | V   |
| 70, Smonicë e pakarbonizuar  | III |
| 71, Smonicë në proces të kafenjzimit                               | IV  |
| 72, Smonicë e kafenjzuar   | III |
| 74, Smonicë e lesivuar me pseudogleje                              | IV  |
| 77, Smonicë e eroduar  | IV  |
| 78, Smonicë e kafenjt me glej                                      | IV  |
| 8, Litosol mbi formacione shkëmbinjsh acidik (granit, dacit, etj.) | V   |
| 89, Tokë e kuqe e kafenjzuar mbi formacion gëlqerorë të fortë      | V   |

Tabela.19 Përcaktimi i klasave të bonitetit të tokës në K. Kamenicë


Tiparet themelore të regjionit të Anamoravës janë krijuar në kohën e oligomiocenit, respektivisht gjatë kohës së krijimit të sistemit të maleve Dinarike dhe të maleve të Sharit. Ç'rregullimet e atëhershme tektonike, janë përcjellë me shkarje të fuqishme dhe me uljen e terrenit e që kanë vazhduar edhe në fazen vijuese gjeologjike të formimit të relievit pasakullnajor. Pas rrjedhave të liqeneve neogjenë, që sipas hipotezave ka ndodhur kah fundi i deliviumit dhe pas tharjeve të sipërfaqeve të cilat i ka përfshirë liqeni i Kosovës, relievi i parë i formuar i regjionit të Anamoravës me ndikimin e faktorëve të jashtëm, veçanërisht me veprimin e lumenjve dhe të përrenjve si dhe të reshjeve atmosferike, është sjellë në gjendje të tanishme. Në regjionin e Kamenicës – Anamoravës nga aspekti gjeografik dhe ai morfologjik mund të veçohet: Zona bregore valore me lugina lumenjsh, që me veprimin e lumenjve dhe të përrenjve është ndarë në disa pllaja të vogla ose të mëdha dhe zona e rajonit kodrinoro- malore, që nga aspekti gjeomorfologjik, gjenetik dhe ai klimatik dallohen në mes tyre. Për nga përbërja dhe vlera që kanë për prodhimin bujqësorë, tokat në tërësi dallohen në mes tyre. Në luginat e lumenjve dhe në pllajat e ndryshme si dhe në tarracën abrazive nëpër kindet e zonave kodrinoro malore dominon tokë e thellë, më kompakte dhe për prodhime bujqësore më e përshtatshme, kurse në zonën kodrinoro malore dominon, kryesisht tokë e cekët dhe për bujqësi e pa përshtatshme , respektivisht e përshtatshme për zhvillimin e kullosave dhe pylltarisë. Pra, regjioni i Anamoravës dallohet nga regjionet tjera me një pedologji më homogjene.





## HARTA PEDOLOGJIKE SOIL MAP PEDOLOŠKA KARTA

### LEGJENDA / LEGEND/ LEGENDA



2,000,000 0 2,000 Meters


Shkalla / Scale / Razmera  
1:150,000

Burimi / të dhëna: Agjencia Kadastrale  
e Kosovës  
Institucionet e Komunës së Kamenicës  
Grupi i Shfrytëzimit të Tokës dhe Mjedisit  
Plani Hapësinor i Kosovës  
Plani Zhvillimor Komunal i Gjilanit

Projected Coordinate System: KosovaRef01  
Projection: Transverse\_Mercator  
Geographic Coordinate System: GCS\_ETRS\_1989  
Datum: D\_ETRS\_1989  
Prime Meridian: Greenwich  
Angular Unit: Degree




Harta. 11. Pedologjia në Komunën e Kamenicës



Harta.12. Ndarja e tokave sipas bonitetit në përqindje (%) dhe hektar (ha) në K. e Kamenicës sipas udhëzimeve të FAO-s (1976, 2007).

Në Grafik 7 është dhënë shkalla e bonitetit të tokave të Komunës së Kamenicës, ku sipas këtij grafikoni shihet se pjesa më e madhe e tokës përbëhet nga boniteti i klasës VI 46 %, pastaj klasa V dhe VII me 14%, kurse tokë më pjellore të klasit II ka 5%.



Graf.11. Ndarja e tokave sipas bonitetin në përqindje (%) dhe hektar (ha) në K. e Kamenicës sipas udhëzimeve të FAO (1976, 2007)

#### 1.1.10.5 PYJET

Sipërfaqet me pyje:

|                              |           |
|------------------------------|-----------|
| Toka pyjore dhe pyje private | 9.623 ha  |
| Toka pyjore dhe pyje publike | 9118 ha   |
| Shuma                        | 18.741 ha |

Sektori i pylltarisë, ngjashëm me sektorët tjerë për kohë të gjatë, është ballafaquar me probleme dhe sfida të shumta, shumë prej të cilave nuk janë zgjidhur deri në këtë kohë. Pyjet dhe resurset pyjore me pjesëmarrjen e tyre afro 41.2% në sipërfaqen e përgjithshme të Komunës së Kamenicës kanë rëndësi të madhe ekologjike, sociale, shëndetësore dhe ekonomike. Struktura pyjore ekzistuese, sasia e sipërfaqeve të zhveshura, nevoja e shpalljes së zonave të mbrojtura, nevoja e ruajtjes së tokave pyjore, zhvillimi i infrastrukturës pyjore, ndërrimi i destinimit të tokave pyjore etj. imponojnë qasje serioze të trajtimit të këtij sektori si komponentë e rëndësishme e planifikimit hapësinor.

Sipërfaqja e tërësishme e mbuluar me pyje në Komunën e Kamenicës është afërsisht rreth 18.741 ha, që i përgjigjet rreth 41.2% të sipërfaqes së tërësishme të Komunës së Kamenicës.

Prej tyre rreth 9.623 ha. ndërsa 9.118 ha janë pronë publike-shtetërore.

- Pyjet e ulëta (trungishte), përbëjnë pjesën më të madhe, duke mbuluar kështu më se 40% të zonës pyjore.

- Rreth 31% vlerësohen si pyje të larta (trungishte).


- Kultura pyjore 2.%
- Ndërsa të tjerat janë klasifikuar si të degraduara dhe shkurre.
- Përveç këtyre zonave, ekzistojnë toka pyjore rreth 1093 ha ose 6 %.
- Masa drusore e përgjithshme në pyjet shoqërore, është vlerësuar rreth

942.092 m<sup>3</sup>, po aq supozohet edhe në sektorin privat. Etati vjetor në bazë të parametrave, sillet rreth 56.220 m<sup>3</sup>. me rreth 2.2 m<sup>3</sup>/ha. Në pylltari duhet të merren masa restauruese, në mënyrë që të jenë produktive. Rreth 1853 ha klasifikohen si shkurre dhe toka të varfëra, të cilat duhet pyllëzuar.

#### **MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR**

Për nga shtrirja hapësinore llojet kryesore drunore në Komunën e Kamenicës janë dushku dhe ahu . Llojet tjera drunore janë: frashëri, shkoza, lajthia, plepi i egër, shelgu etj.

Prej sipërfaqes së përgjithshme të pyjeve të kësaj komune,  
 Pyje të larta 5810 ha ose 31%  
 Shkurre 11057 ha ose 59%  
 Pyje të ulëta 1874 ose 10 %




Graf.12. Klasifikimi i pyjeve sipas %



**PYJET NË KOMUNËN E KAMENICËS**  
**FORESTS IN THE MUNICIPALITY OF KAMENICA**  
**SUME U OPSTINI KAMENICA**

**LEGJENDA/LEGEND/LEGENDA**

-  Lumë, rrjedhë, përria
-  Kufiri Komunal
-  Zonat kadastrale
- Pyjet**
-  Pyjet e larta
-  Pyjet e ulëta
-  Pyjet Shkorre



2,200 1,100 0 2,200 Meters

Shkalla / Scale / Razmera  
1:150,000

Burimi i të dhënave: Agjencia Kadastrale e Kosovës  
Institucionet e Komunës së Kamenicës  
Grupi i Shfrytëzimit të Tokës dhe Mjedisit  
Plani Hapësiror i Kosovës

Projected Coordinate System: KosovaRef01  
Projection: Transverse\_Mercator  
Geographic Coordinate System: GCS\_ETRS\_1989  
Datum: D\_ETRS\_1989  
Prime Meridian: Greenwich  
Angular Unit: Degree



Harta.13. Pyjet në Komunën e Kamenicës

## KUSHTET KLIMATIKE, VALORIZIMI KLIMATIK, KARAKTRISTIKAT

Komuna e Kamenicës ka klimë të mesme kontinentale, me verëra të nxehta dhe dimëra të ftohtë. Temperatura mesatare e janarit është  $-1^{\circ}\text{C}$ , ndërsa ajo e korrikut  $21.50^{\circ}\text{C}$ . Temperaturat maksimale absolute janë në muajin gusht  $+37^{\circ}\text{C}$ , kurse minimale absolute janë në janar  $-32^{\circ}\text{C}$ . Reshjet atmosferike mesatarisht sillen prej 499 – 675 l/m<sup>2</sup>. Lartësia më e ulët mbidetare është 380m te Dheu i Bardhë, kurse ajo më e larta është 1223 m te Guri i Zi (f.Tërstenë).

Lagështia e ajrit – vlera mesatare vjetore e lagështirës relative është 76.8%. Muaji më i thatë është gushti 66%, kurse më me lagështi janë nëntori dhe dhjetori 84 %.

Reshjet – sasitë mesatare vjetore të të reshurave në komunën e Kamenicës arrijnë 596l/m<sup>2</sup>, ndërkaq në zonën malore shtohen në 800 l/m<sup>2</sup>.

Muajt më të pasur me shi, janë nëntori dhe maji me 76.1 dhe 71.9 l/m<sup>2</sup>, kurse në viset malore muaji i dhjetorit me 101.0 l/m<sup>2</sup>. Muaji më i thatë është korriku dhe gushti. **Erërat** – Në Komunën e Kamenicës erërat më të shpeshta janë ato veriore dhe më të rrallat janë ato jug – përendimore, kurse shpejtësia mesatare e erës është 3m/sek.


| 2002              | I           | II          | III         | IV          | V           | VI          | VII         | VIII         | IX          | X            | XI          | XII          | m.vjet.      |
|-------------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|--------------|-------------|--------------|-------------|--------------|--------------|
| <b>Tmax .</b>     | 1.3         | 10.2        | 13.2        | 15.0        | 21.5        | 25.6        | 27.4        | 24.8         | 20.5        | 16.4         | 11.6        | 3.6          | <b>15.9</b>  |
| <b>Tmin.</b>      | -6.1        | -2.1        | 3.1         | 4.4         | 10.2        | 12.7        | 15.3        | 13.7         | 9.6         | 5.7          | 2.2         | 0.4          | <b>5.6</b>   |
| <b>Tmes.</b>      | -3.6        | 4.5         | 8.0         | 10.0        | 16.0        | 19.4        | 23.5        | 19.6         | 14.5        | 10.9         | 5.6         | 1.4          | <b>10.9</b>  |
| <b>Lagësh %</b>   | 87          | 79          | 74          | 78          | 78          | 73          | 68          | 80           | 85          | 83           | 84          | 91           | <b>80</b>    |
| <b>Shtypja at</b> | 954.1       | 949.6       | 938.4       | 942.6       | 948.5       | 950.1       | 948.4       | 948.2        | 948.6       | 948.6        | 948.7       | 948.6        | <b>947.9</b> |
| <b>Era/ms.</b>    | 1.0         | 1.5         | 2.5         | 2.7         | 1.9         | 2.4         | 2.2         | 1.9          | 1.8         | 1.8          | 2.2         | 2.6          | <b>2.0</b>   |
| <b>Reshjet.</b>   | <b>31.6</b> | <b>38.1</b> | <b>55.7</b> | <b>56.0</b> | <b>93.9</b> | <b>23.3</b> | <b>85.4</b> | <b>113.3</b> | <b>94.6</b> | <b>170.0</b> | <b>32.1</b> | <b>115.8</b> | <b>909.8</b> |

Tab.20 .Vlerat mesatare të reshjeve për vitin 2002 në Komunën e Kamenicë, tem. mesatare, lagështisë. % shtypja atmosferike, era m/s

Në pjesët malore të Kamenicës ku lartësitë mbidetare janë mbi 1000 metra, temperaturat janë më të ulëta dhe periudha vegetative është më e vonshme. Klima në Komunën e Kamenicës ndryshon edhe në pjesët e ndryshme të vendit, në pjesët verilindore dhe veri-perndimore të Kamenicës kemi temperatura më të ulëta (për  $3.0^{\circ}\text{C}$ ) e të reshura më shumë, kurse në pjesën jugore ku shtrihet lugina e lumenjve, parametrat klimatik ndryshojnë.

| 2008              | I           | II          | III         | IV          | V           | VI          | VII         | VIII       | IX          | X           | XI          | XII         | m.vjet.      |
|-------------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|------------|-------------|-------------|-------------|-------------|--------------|
| <b>Tmax.</b>      | 3.4         | 10.0        | 13.0        | 17.0        | 22.2        | 26.5        | 28.0        | 30.3       | 21.2        | 18.4        | 11.6        | 6.6         | <b>18.7</b>  |
| <b>Tmin.</b>      | -2.3        | -1.9        | 1.7         | 5.9         | 8.0         | 12.2        | 13.9        | 13.8       | 8.9         | 6.2         | 2.7         | -1.8        | <b>5.6</b>   |
| <b>Tmes.</b>      | 0.8         | 3.5         | 7.2         | 11.6        | 15.7        | 19.8        | 21.0        | 21.9       | 14.8        | 11.8        | 6.9         | 3.4         | <b>11.5</b>  |
| <b>Lagësh. %.</b> | 86          | 78          | 72          | 67          | 70          | 73          | 66          | 59         | 73          | 80          | 82          | 82          | <b>74</b>    |
| <b>Shtypja.at</b> | 950.7       | 953.6       | 938.2       | 947.6       | 946.0       | 946.6       | 946.0       | 942.2      | 946.5       | 950.3       | 947.1       | 947.3       | <b>946.8</b> |
| <b>Era/ms.</b>    | 0.9         | 0.7         | 1.5         | 1.3         | 0.8         | 0.7         | 0.7         | 0.4        | 0.5         | 0.8         | 1.1         | 2.1         | <b>0.9</b>   |
| <b>Reshjet.</b>   | <b>13.5</b> | <b>21.7</b> | <b>88.8</b> | <b>25.2</b> | <b>46.5</b> | <b>64.8</b> | <b>64.1</b> | <b>5.3</b> | <b>50.4</b> | <b>23.5</b> | <b>59.7</b> | <b>94.8</b> | <b>46.5</b>  |

Tab.21.Vlerat mesatare të reshjeve për vitin 2008 në Kamenicë, temp. mesatare, lagështisë. % shtypja atmosferike, era m/s.



**SHPEJTËSIA MESATARE E ERËS NË ‰ NGA 8 DREJTME**  
**PËR PJESA 1mm=2‰**




Fig.1. Trëndafili i erës në Komunën e Kamenicës.




## RESHJET NË KOMUNËN E KAMENICËS

### LEGJENDA LEGEND LEGENDA

- Kufi komunal
- Zonë kadastrale

#### Zonat e Sipas Reshieve

- 600 mm
- 700 mm
- 800 mm
- 900 mm



Shkalla / Scale / Razmera  
1:150,000

3,700 1,850 0 3,700 Meters

Projected Coordinate System: KosovaRef01  
Projection: Transverse\_Mercator  
Geographic Coordinate System: GCS\_ETRS\_1989  
Datum: D\_ETRS\_1989  
Prime Meridian: Greenwich  
Angular Unit: Degree

Burimi i të dhënave: Agjencia Kadastrale e Kosovës  
Institucionet e Komunës së Kamenicës  
Grupi për Shtytëzim Tokës dhe Mjedis  
Atlasi Hidroekonomik / AKMM



Harta.14 Reshjet në Komunën e Kamenicës





# RELIJEVI I KAMENICËS KAMENICA RELIEF KAMENICA RELJEF

## LEGJENDA / LEGEND/ LEGENDA

Kufiri Komunal

Zonat kadastrale


### Lartësitë Mbidetare

272 - 608 m

608.0000001 - 855 m

855.0000001 - 1,213 m

1,213 - 1,213.0000001 m



Burimi i të dhënave: Agjencia Kadastrale  
e Kosovës  
Institucionet e Komunës së Kamenicës  
Grupi për Shfrytëzim të Tokës dhe Mjedis

Projected Coordinate System: KosovaRef01  
Projection: Transverse\_Mercator  
Geographic Coordinate System: GCS\_ETRS\_1989  
Datum: D\_ETRS\_1989  
Prime Meridian: Greenwich  
Angular Unit: Degree



Harta. 15. Relievi në Komunën e Kamenicës

### 1.1.10.8 PASURIA NËNTOKËSORE

Komuna e Kamenicës në bazë të hulumtimeve gjeologjike ka këto pasuri nëntokësore :

**Resurset natyrore** -Komuna e Kamenicës sipas vëllimit dhe llojlojshmërisë së xeheve minerale, bënë pjesë në radhën e komunave të pasura dhe paraqet faktorin kryesor për zhvillimin e komunës. Xehet më të rëndësishme minerale të metaleve dhe jometaleve janë:

**Hekuri (Fe)** –në Komunën e Kamenicës në Sedllar hasen (ndodhen) vendburime xeherore te hekurit , rezerva të konstatuara të klasës **B** dhe **C** ku përmbajnë mbi **700 mijë tonelata**, ndërsa vlerësohet se mund të zbulohen edhe mbi **500 mijë tonelata**

- **Magnezitet** – në lokalitetin Strezoc në largësi prej 14 km nga Kamenica, ndodhet vendburimi i xehes së magnezitit. Në këtë vendburim dallohen magnezitet masive, ku deri para luftës janë eksploatuar magnezitet nyjore dhe në formë shiriti – hulumtimi i të cilave është në vijim e sipër. Rezervat e magnezitit janë rreth 1.3 milion tonelata, kurse ato nyjore dhe në formë shiriti rreth 4.5 milion tonelata. Kanë zbatim të madh në industri, si pleh artificial, në industrinë e letrës si ushqim i kafshëve dhe si material izolues.

-**Granitet e kaolinizuara ( kaolini )** – i vetmi vendburim i xehes së granitit të kaolinizuar në Kosovë ndodhet në fshatin Karaçevë. Rezervat e kësaj xehe janë rreth 3.5 milion tonelata . Përdorimi i kaolinit është treguar shumë i përshtatshëm për prodhimin e pllakave të qeramikes dhe për enë porcelani.

-**Bentonitet** – paraqiten në këto lokalitete Drenoc, Karaçevë, Rogaçicë, Kolloleq, Tomancë. Rezervat e bentonitit në Karaçevë janë rreth 1.2 milion tonelata. Kanë përdorim të gjerë në industrinë ushqimore, si dhe për prodhimin e tullave, tjegullave, blloqeve e tjera.

- **Kuarcitet** – shfaqen në lokalitetin e Strezocit, në afërsi të xeherores së magnezitit. Rezervat e konstatuara janë rreth 2.5 milion tonelata.

-**Tufet** – shfaqjen e tufëve kemi në lokalitetet e Karaçevës dhe të Topanicës rreth 5 km në afërsi të Kamenicës. Gjejnë aplikim të përshtatshëm në industrinë e çimentos, për prodhimin e agregateve të lehtë dhe për blloqe të zgavruara cilësore të betonit, tullave, tjegullave, blloqeve etj. Rezervat janë rreth 665.000 tonelata.

-**Deltina**- në komunën tonë kemi vendburimin e deltinës në fshatin Korminjan të Poshtëm, ku ka qenë i vendosur edhe seperacioni.

-**Gëlqerorët** – vendburime të gëlqerorit takohen në komunën tonë, të cilat mund të shfrytëzohen dhe përdoren si agregate gurore për mbushje të rrugëve. Gëlqeror kemi në lindje , verilindje, juglindje etj, me përbërje të CaCO<sub>3</sub> nga i cili përfitohet gëlqerja e shuar ose gëlqere në formë të pluhurit?

-**Mermerët** – masa relativisht të mëdha të mermerit janë hasur në veri-perëndim të Kamenicës. Kanë veti të mira fiziko-mekanike. Përbëhen nga kalçiti dhe mikat. Kanë

ngjyrë të bardhë deri në të përhimë të çelur. Gjejnë aplikim në industrinë e ndërtimit për mbushjen e rrugëve, si agregat betoni etj.

**-Granitet** – në veri të fshatit Hogosht ndeshet vendburimi i granitit. Rezervat e vlerësuara janë rreth 1.800 tonelata.

**-Feldshpatet** – shfaqjet e feldshpateve janë konstatuar në afërsi të fshatit Vriçec dhe Shipashnicë e Epërme. Hulumtimet orientuese kanë dëshmuar se ka rezerva të kësaj lënde cilësore.

**- Andezitet** – në fshatin Krilevë kemi vendburimin e andeziteve të cilat kanë rëndësi të madhe në industrinë e ndërtimit. Lokacioni karakterizohet me rezerva të mëdha, ndërsa të hulumtuara janë rreth 635.000 m<sup>3</sup>.

**-Rërat dhe zhavorret** – luginat aluviale të Komunës së Kamenicës janë të pasura me rërë dhe zhavorre. Rëra e përzier me lym duhet të pastrohet dhe i plotëson kushtet për shfrytëzim në ndërtimtari. Për atë, është investuar në seperacione. Lënda e parë për rërë dhe zhavorr është e përqendruar në brigjet e lumenjve të Kriva Rekës, të Hogoshtit dhe të Desivojcës.

**-Granatet** – takohen në bashkëshoqërim me mikashistët dhe shumë lehtë ndahen nga to. Madhësia e kokërrzave sillet prej disa cm deri në 4 cm. Mostrat kanë treguar se granatet përbërjen më të madhe e kanë nga almandini. Vendburimi i granateve të fshatit Lisockë është eksploatuar për firmën „Katran” nga Zagrebi.

**-Antimoniti** – është konstatuar në rrethinën e Kranidellit dhe te Muçivërcit. Xeheja e antimonitit lajmërohet i lidhur me damarët kuarcitë, të cilët janë të lokalizuar në zonat me altërim të fortë të graniteve, respektivisht kaolines. Trashësia e damarëve kuarcitë, sillet prej disa cm deri në 4 m. Xehen e antimonitit, përveç damarëve kuarcitë e përcjellin edhe bariti dhe kalciti. Përbërja kimike e xehes së antimonitit është : Sb-14.04, Pb-gjurmë, Zn-0.38, As-1.02. Rajoni paraqet perspektivë për hulumtimet e ardhshme.

## **NDËRTIMI GJEOLOGJIK I RAJONIT TË GJERË**

Rajonin e gjerë të vendburimit e ndërtojnë këto njësi litologjike:

1. Rreshpet kristalore të grupit të parë
2. Formacionet terciare-miocene
3. Granite, pegmatite dhe aplite
4. Tufet andezito-dacite
5. Mermerët dhe gëlqerorët e mermerizuar
6. Produktet e quatërënarit

## **NDËRTIMI TEKTONIK**

Territori i Komunës së Kamenicës i takon zonës qendrore të maleve të vjetra Rodope. Sikur në çdo vend edhe këtu, kanë ndikuar dhe ndikojnë fuqitë tektonike endogjene dhe ekzogjene. Me ndikimin e këtyre fuqive, janë krijuar trajtat themelore të relievit, ultësirat e lartësirat. Në mbarim të Paleozoikut, gjatë periodave të kembrianit dhe permit me ndikimin e

fuqive tektonike, korja e tokës është qarë, ku prej pjesëve të saja të ngritura janë formuar malet e vjetra. Prej këtyre,

dallohen malet me lartësi të mesme : Guri i Zi 1274 m, Maja e Velegllavës 1181m, Rrafshi i Lajthive 1163 m, Kika 1154 m, Tepja 1081 m, Pllania 1066 m etj. Në gjysmën e Tercierit, në periudhën e oligocenit kanë ndodhur lëvizjet e reja tektonike, ku disa prej këtyre maleve janë fundosur, e disa janë ngritur por nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim të madh në formën e tyre. Këto qarje në këtë kohë, kanë shërbyer si zona për shpërthime të fuqishme vullkanike. Këto vullkane kanë pushuar gjatë kohërave të ndryshme gjeologjike, kurse kupat e kratërët e tyre janë shkatërruar nga fuqitë e jashtme. Si argumentim i ekzistimit të vullkaneve na vërtetojnë shkëmbinjët e ndryshëm vullkanikë (efuziv), si tufet në veri të fshatit Topanicë deri në fshatin Koretin, dacite-andezite që gjenden në V.P të pellgut në lokalitetin e Krilevës. Në pjesët e fundosura është krijuar pellgu i Lumit “Kriva Reka” (tërëcier-miocen) me relief kodrinoro-malor, me lartësi mbidetare deri në 600 m. Këtë pellg e përbëjnë edhe disa lugina të lumenjve, siç janë: lugina e lumit të Hogoshtit, Desivojcës, Kremenatës dhe ajo e Moravës së Binqës. Në bazë të këtyre fuqive është pjerrëtësuar terreni dhe zbret kah luginat.

Territori i hulumtuar karakterizohet me dislokacione regjionale të shkallës së lartë, në drejtimin e të cilave janë kryer lëvizje orogjene. Përveç kristalinitetit të lartë në reshpet kristalore, kemi edhe serinë rrudhosëse, strukturat thyerëse. Vijëzimi i strukturës tektonike të pellgut është ndërtuar nga tri dislokacione kryesore. Dislokacioni i parë përfshinë ultësirën e lumit të Kriva Rekës në drejtim VP- JL, kurse i dyti lumin e Hogoshtit në drejtim VJ. Linja e tretë dislokative shtrihet prej Karaçevës së Epërme kah rreshpet kristalore deri në grykën e lumit të Hogoshtit në drejtim VL- JP ( fig.2.). Përveç këtyre linjave kryesore dislokative, janë të njohura edhe shkarje të tjera, të cilat sipas gjatësisë janë të vogla. Në përroin Karabat (Karaçevë e Poshtme), janë vërtetuar dy shkarje në largësi prej 70 m, të cilat ndërprejnë ranorët në këtë pjesë. Pellgu Terciar i Kriva Rekës, përveç shkarjeve dhe rrudhosjeve posedon edhe disa forma antiklinale dhe sinklinale. Shtrirja gjenerale e krahëve të shtresave është e orientuar në drejtim JJP. Përveç këtyre hulumtimeve, përgjatë shtratit të lumit të Hogoshtit dhe Kriva Rekës, sedimentet Terciare janë të rrudhosura. Si pasojë e këtyre faktorëve janë formuar dy sinklinale: njëra sinklinale në JL të Bllatës –Trojës, kurse në VP sinklinalja Berivojcë – Koretin – Çuka e Vajzave, të cilat janë të ndara me antiklinale të Koretinit – Jurishtes. Ndërmjet këtyre antiklinaleve dhe sinklinaleve të Çuka e Vajzave, është vërtetuar shkarja. Gjithashtu, në mes të Hodonocit dhe Domarocit gjendet një sinklinale e ndërtuar nga mergelet, krahët e së cilës në kontaktin tektonik janë me rreshpet kristalore. Me shkarjen e lumit të Hogoshtit, është e ndarë kjo sinklinale nga sinklinalja e Bllatës-Trojës.

Depresioni i Moravës është regjion tektonik i ulur, i cili është i mbushur me sedimente shtresore dhe transgresive të miocenit, sedimente liqenore me qymyr të kohës së pliocenit. Pellgu i Moravës është zhytur, përgjatë shkarjeve anësore në fillim të miocenit.

**Karaktristikat themelore**-Komuna e Kamenicës, kryesisht ka qenë e njohur për nga industria e materialit ndërtimor, pllakave të qeramikës dhe sintermagnezitet. Mirëpo eksitojnë edhe kushte të volitshme për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, bletarisë, pemëtarisë, zejtarisë, tregtisë etj.

Karakteristikat kryesore të komunës janë:

- Një sipërfaqe prej 523 km<sup>2</sup>;
- Terren kodrinor-malor (60%), dhe të rrafshta (40%)
- Përshkohet nga lumenjtë: Kriva Reka, lumi i Hogosht dhe Morava e Binçës
- Sipërfaqe të mjaftueshme për zhvillimin e bujqësisë me rreth 29 304 ha me kullosa dhe livadhe 12543ha
- Lidhje e mirë rrugore me magjistralen Gjilan-Bujanoc;
- Numri i banorëve në Komunën e Kamenicës vlerësohet të jetë 57000 banorë.
- Në qytet jetojnë rreth 10200 banorë
- Në fshatra jetojnë rreth 46800 banorë
- Dendësia mesatare e popullsisë është 109 ban/km<sup>2</sup>
- Rritja mesatare vjetore e popullsisë në këtë komunë është 0.29%.
- Ekziston dallim i vogël në strukturën gjinore (51 % meshkuj dhe 49% femra)
- Etnitetet që jetojnë në këtë komunë janë: shqiptarë 82.5, serb 16.6%romë 0.8% (vlerësim OSBE para decentralizimit)

Vlerësohet se në Komunën e Kamenicës, nga pjesa e popullsisë aktive 60-65% (mosha16-65 vjeç.




**HARTA GJEOLGJIKE E KAMENICËS**  
**GEOLOGICAL MAP OF KAMENICA**  
**GEOLOŠKA KARTA KAMENICA**

**LEGJENDA / LEGEND/ LEGENDA**

**Gjeologjia e Kamenicës**

- |  |   |  |  |
|--|---|--|--|
|  | Ranë+shkemb. te perzier+Guri gëlqeror/Marlstone |  | Shkëmbinjë vulkanik të pa ndashëm          |
|  | Shkëmbinj konglomerat                           |  | Guri gëlqeror                              |
|  | Skëmbinjë Piroklastik, të pa ndashëm            |  | Gurë me baltë+Ranë+Guri gëlqeror/Marlstone |
|  | Skëmbinjë Plutonik, të pa ndashëm               |  | Mermer                                     |
|  | Skëmbinjë metamorfik, të pa ndashëm             |  |  |

- |  |                       |
|--|-----------------------|
|  | Kufiri Komunal        |
|  | Zonat kadastrale      |
|  | Lumë, rrjedhë, përroi |



Burimi i të dhënave: Agjencia Kadastrale e Kosovës  
Institucionet e Komunës së Kamenicës  
Komisioni i Pavarur i Minerave dhe Mineraleve  
Grupi i Shfrytëzimit të Tokës

Projected Coordinate System: KosovaRef01  
Projection: Transverse\_Mercator  
Geographic Coordinate System: GCS\_ETRS\_1989  
Datum: D\_ETRS\_1989  
Prime Meridian: Greenwich  
Angular Unit: Degree



Harta 16. Gjeologjia ne Komunen e Kamenicës

## 1. RRESHPET KRISTALORE TË GRUPIT TË PARË

Pjesa periferike e pellgut Terciar të Kriva Rekës, ndërtohet nga rreshpet kristalore të masës së Rodopeve. Seria e rreshpeve kristalore është shumë hetërëogjene dhe në ndërtimin e saj marrin pjesë rreshpe të ndryshme me kristalizim të ulët, si: rreshpet sericitike, kuarc-sericitike, albito – mikore dhe rreshpet e gjelbra të cilat përbëjnë shkëmbinjtë themelor të rajonit të gjerë. Në to në formë të damarëve ose thjerrëzave të dimensioneve të ndryshme janë ndërfutur mermerët, granitet dhe amfibolitet. Moshë e shkëmbinjve kristalor të kësaj serie, është diskutabile.

Në analogji me formacionet përreth ka mendime se shkëmbinjtë e kësaj serie i përkasin moshës Paleozoike. Rreshpet kristalore paraqesin, shkëmbinjtë më të vjetër në territorin e Kosovës dhe shtrihen në pjesët e skajshme lindore të saj. Rreshpet kristalore të këtij grupi, paraqesin pjesën më të vjetër të këtij terreni. Në aspektin litologjik, paraqesin ortoshkëmbinjtë dhe parashkëmbinjtë.

Ortoshkëmbinjtë janë të përfaqësuar nga ortognajset, rreshpet amfibolike, amfibolet, rreshpet epidot-amfibolike dhe eklogitet.

Parashkëmbinjtë u takojnë paragnajset, metakuarцитet, mikashistet dhe leptinolitet. E gjithë seria e rreshpeve kristalore, është e përshkruar nga stoqet granite dhe apofize.

Në tërë territorin e hulumtuar rreshpet kristalore lajmërohen në forma të vogla ose të mëdha të masave pykëzore dhe thjerrëzore të cilat janë të futura në plutonin granitik.

Paragnajset së bashku me mikashistet përbëjnë pjesën kryesore të masës kristalore të parashkëmbinjëve. Kjo seri e rreshpeve kristalore, përfaqësohet nga gnajset kokërrmëdha mikore dhe nga gnajset kokërrmëdha biotitike, metakuarciteve, leptinoliteve dhe mikashiste. Të gjithë këta shkëmbinj, në aspektin horizontal dhe vertikal pësojnë ndryshime.

Gnajset kokërrmëdha rëndom janë të përhimëta me përbërje kuarci, feldshpati dhe mika; ndërsa nga përbërësit me ngjyrë lajmërohen hornblenda. Strukturat janë granoblastike dhe porfiroblastike.

Metakuarцитet janë shkëmbinj të fortë me ngjyrë hiri, të cilët janë të lidhur me gnajset amfibolike. Në këta dominojnë, shpeshherë kuarci dhe biotiti, nga njëherë edhe feldshpati.

Mikashistet dhe leptinolitet shtrihen në anën veriperendimore të terrenit. Në por vetëm ndërtim të zonave të gjata të cilat ndërrohen me rreshpet kristalore .

Rreshpet amfibolike dhe amfibolitet kanë shpërndarje më të vogla se sa gnajset. Ndërmjet tyre, dallohen rreshpet amfibolike, eklogitet, rreshpet epido-amfibolike. Përbërësit kryesor janë hornblenda e gjelbër, kuarci, pllagjiokllazi me shumë granate, sfeni dhe apatiti. Prej mineraleve në eklogite takohet granati, afër të cilit takohet hornblenda dhe biotiti. Ndërsa rreshpet epido-amfibolike përmbajnë epidot me sasi të madhe, shumë herë më shumë se hornblenda .

Shkëmbinjtë amfibolik, paraqesin shkëmbinj magmatik bazik të metamorfizuar dhe gjithëherë, përcillen në pjesën periferike të masivit granit. Këta shkëmbinj më së shpeshti lajmërohen në formë thjerrëzore, trashësia e të cilëve sillet rreth disa dhjetra metrave. Sikur ortognajset edhe këta shkëmbinj, kanë origjinë magmatike. Të gjitha rreshpet kristalore të cekura, kanë kristalinitet dhe shkallë të lartë të metamorfizimit .

## 2. FORMACIONET E TERCIERIT-MIOCENIT

Sedimentet e Terciarit të ujërave të ëmbla, përfshijnë hapësirën e madhe në territorin e hulumtuar. Ato mbushin një depresion tektonik të formuar me shkarjen e pjesën veriore ndodhen tipat e mikashisteve me pak feldspat ose pa të. Mikashistet në afërsi të masës granite kalojnë në leptinolite, të cilat përbëhen nga muskoviti, biotiti, kuarci dhe pak feldshpat. Në to dominojnë biotiti për ndryshim nga mikashistet.

Ortoshkëmbinjëve i takojnë ortognajset dhe shkëmbinjët amfibolik. Ortognajset përbëhen nga kuarci, feldspati, biotiti dhe muskoviti. Kuarci, shpeshherë dominon mbi mineralet tjera. Feldspati përbëhet nga pllajjiokllazet dhe mikrokлина. Strukturat janë granoblastike dhe porfiroblaste. Këto gnajse nuk paraqesin trupa individual,

Terrenit, përgjatë drejtimit dislokativ në pjesën periferike të pellgut. Në bazë të të dhënave mbi këto formacione nga autor të ndryshëm (M. Protiqi, B. Millovanoviqit ) kanë ardhur në përfundim se, këto formacione ndahen në dy pjesë: në të poshtme dhe të sipërme. Këto shtresa janë identike me disa shtresa të basenit të Tercierit të Vranjës, në të cilat janë gjetur mbeturinat micromarix fluorensismus-Lartët, të cilat i takojnë miocenit të mesëm dhe të sipërm. Pellgu sedimentar i terciarit të Kriva Rekës në aspektin litologjik ndahet në tri pjesë:

- të poshtme ose bazale
- të mesme dhe të sipërme.

Pjesa e poshtme dhe e sipërme janë të ndërtuara nga rëra, zhavorri dhe mbeturinat të cilat janë të lidhura me argjilë ranore. Pjesën e mesme e ndërtojnë mergelet me përbërje të shkëmbinjve ranor.

Sedimentet Terciare të serisë së poshtme – bazale ndërtojnë pjesën periferike të pellgut. Në pjesën veriore dhe lindore në periferi të pellgut, shfaqen edhe rreshpet kristalore. Marrëdhënia e serisë bazale, përkundër formacioneve periferike është transgresive dhe pjesërisht, është e përshkuar me konglomerate bazale. Kjo pjesë e serisë në Karaçevën e Poshtme – Epërme, fillon me konglomerate bazale të cilat pjesërisht janë të zbuluara, ndërsa në kontaktin direkt me rreshpet gjenden rërat dhe zhavorret kokërrmëdhenj. Konglomeratet janë të çimentuara dobët.

Në shumë pjesë të poshtme, ekziston materiali i pastër, rërat plotësisht kalojnë në argjilë ranore kokërrimët . Nganjëherë, edhe rërat janë të lidhura dobët dhe pjesërisht kalojnë në ranor argjiloro-mergelor. Shfaqen me ngjyrë të verdhë apo të verdhë në të gjelbër. Në pjesën perëndimore të këtij territori, seria bazale është e ndërtuar nga aglomeratet të cilat dominojnë në pjesën veriore, për ndryshim nga ajo jugore, në të cilët lajmërohen rërat kokërr imëta dhe kokërrmëdhatëpastërta ose argjilore, përkatësisht konglomeratet dhe ranorët. Kjo përbërje më së miri shihet në mes të Topanicës dhe Koretinit. Shtrirjet kryesore të serisë bazale, janë të orientuara kah JL dhe VP. Pjesa e mesme e serisë Terciare, është e ndërtuar nga shtresat e holla të përhimëta të mergeleve pllakëzore, të cilat janë të ndërtuara në rrethinën e Karaçevës së Poshtme dhe të Epërme .

Ndërimi i mergeleve dhe ranorëve si dhe zhdukja graduale e këtyre të fundit, tregon kalimin nga pjesa e mesme në të sipërmen e serisë terciare, që më së miri shihet mes Topanicës dhe Billatës së Vjetër. Shtrirja gjenerale e serisë mergelore është kah V.P. në disa zona me drejtim të shtrirjes kah JP, JL dhe VL.

Mergelet ndërtojnë zonën në drejtim VL dhe JP me gjerësi mesatare prej 3-3,5 km. Kjo është, në të vërtet zona në mes të Karaçevës së Epërme dhe Breznicës në VL si dhe



Topanicës e Domarocit në JP. Në mes të Karaçevës së Poshtme – Epërme dhe Rogaçicës. Mergelët shtrihen mbi pjesën bazale të serisë terciare, me të cilën ndërtohet sinklinalja. M.Pavloviqi në mergele ka gjetur faunën OSTRAKODA në mes të Topanicës dhe Bllatës .

Pjesa e sipërme e serisë Terciare, në pikëpamje litologjike është e paraqitur nga argjilat, rërat kokërrimëta dhe kokërrmëdha me ngjyrë të verdhë dhe të verdhë në të kuqe, në të cilat lajmërohen shtresat e argjilave ranore, përkatësisht ranorëve dhe mergelëve . Në pjesën më të lartë, lajmërohet zhavorri dhe mbeturina të cilat ndërrohen me rërat dhe argjilat kokërrmëdha. Ky material i gjerë, paraqet aglomeratet të cilat tregojnë për mbushjen e shpejt të pellgut dhe fazën përfundimtare të regresionit.

Pjesa e sipërme e serisë së miocenit, shumë mirë është e zhvilluar në mes të lumit të Hogoshtit dhe Desivojcës, si dhe në veri të Kolloleqit e Desivojcës. Në këtë seri takohen ranorët e bardhë të stratifikuar të cilët përdoren si material ndërtimor .

Në pellgun e sedimenteve të Tercierit të Krivarekës në disa vende, lajmërohet thëngjilli .Në Karaçevën e Poshtme në përroi e Karabateve kemi shfaqje të thëngjillit, ku shtresa është me trashësi 0.8 m dhe shtrihet mbi ranorët e përhimtë (gri) dhe të gjelbër.

Shfaqja tjetër e thëngjillit, lajmërohet në fshatin Bosce (Huboc) dhe në gjirin mbi Maltënoc. Në këtë lokalitet trashësia e thëngjillit sillet deri në 2 m. Shfaqje të këtilla kemi edhe në Shipashnicën e Epërme te Përroi i Barës dhe i Stanit, te përroi i Muqivërcit etj. Përgjatë periferisë së pellgut të Tercierit, relativisht lajmërohet zona e gjerë nyjore, shpeshherë me lëvizje intensive e cila në disa pjesë prezantohet me argjilën bentonite. Në këtë Terciar, janë karakteristike kënetat e izoluara, të cilat kanë qenë të vërshuara nga ujërat e pellgut Terciar të Kriva Rekës. Në vendet ku kanë qenë kushtet e mira, është kryer kaolinizimi i graniteve nën ndikimin e ujërave kënetor.

### **3. GRANITET, PEGMATITET DHE APLITET**

Granitet kanë shtrirje konkordante në serinë e rreshpeve kristalore. Këta shkëmbinj, shpeshherë përbëhen nga kuarci, feldspatet dhe mikat. Kanë strukturë granitike, shpeshherë edhe porfiroide, ndahen në dy tipa:

- Granitet e vjetra
- Granitet e reja

**Granitet e vjetra** janë të gnajsifikuara, kokërr mesme me ngjyrë të verdhë. Rreshpëzimi në shumicën e rasteve është i shprehur mirë. Në shumë vende në ta shihet foliacioni primar me elemente të rënies 90/30°. Këto granite pjesërisht janë intruzive, ndërsa pjesa më e vogël paraqet granite që kanë mbetur me granitizimin e rreshpeve. Prej përbërësve kryesor janë: kuarci, feldspatet dhe mikat. Strukturat janë granitike, shpeshherë edhe porfiroide.

**Granitet e reja** - i takojnë kompleksit magmatik të intruzionit granitik. Meqenëse, masa e granitit intruziv nuk ka përfunduar me ngurtësimin e masës kryesore, mirëpo edhe më vonë kanë ndodhur edhe faza të mëvonshme, të cilat si produkt kanë formimin e graniteve të reja. Këto granite janë kokërrimët me ngjyrë të përhimtë dhe parreshpëzim. Analizat mikroskopike tregojnë për prezencën e feldshpatit, kuarcit, me sasi të vogël të biotitit dhe muskovitit.

Shpëtëzimi shpeshherë është planar. Kufiri në mes të graniteve të reja dhe të vjetra, gjithëherë është i qartë. Vjetërsia e këtyre graniteve është e lidhur për fazën orogjene.

Plutoni granitik i Bujanocit është i pasur me komponente, të cilat janë të afërta me pegmatite dhe të damarëve aplite si damarë ekuivalentë të magmës granite. Këta trupa planarë shfaqen në formë damarore, si dhe në forma jo të rregullta të zgjatura. Trashësia e tyre sillet disa metra. Pegmatitet përfaqësohen: nga kuarci, feldshpati dhe muskoviti. Damarët aplite, janë më të hollë se pegmatitet dhe kuarcitet. Janë me trashësi më të vogël se 0.2 m dhe depërtojnë në drejtime të ndryshme. Strukturat janë kokërrimëta, ngjyra e graniteve është zakonisht e bardhë deri në të verdhë.

#### **4. TUFET ANDEZITO-DACITE**

Në rrethinën e Topanicës janë vërtetuar dukuri të tufeve, të cilat eksploatohen dhe përpunohen në industrinë e çimentos. Shfaqja e tufeve në këtë pjesë të pellgut të Terciarit të Kriva Rekës, na tregon se ka ndodhur aktivitet vullkanik. Tufet kanë trashësi mbi dy metra, dhe janë të lidhur me pjesën e sipërme të serisë së miocenit, respektivisht për facien e ranorëve, argjilave, mergeleve dhe zhavorreve. Përveç tufeve, të cilat janë të interstratifikuara në shtresat sedimentare të miocenit lajmërohen edhe argjilat tufore dhe ranore. Tufet e Topanicës, janë me ngjyrë të bardhë të fortë dhe kompakte. Në këto tufe shihen shpetëzimet dhe plasaritjet, përgjatë së cilave lajmërohet limoniti, për çka ndonjëherë kanë ngjyrë të verdhë-kuqe.

Në rrethinën e fshatit Topanicë, tufet lajmërohen në dyshtemenë argjilore mbi të cilën janë zhavorret. Në rrethinën e fshatit Koretin lajmërohen tufet me ngjyrë të verdhë – kuqe me gjatësi 5-10 m.

#### **5. MERMERËT DHE GËLQERORËT E MERMERIZUAR**

Mermerit dhe gëlqerorët e mermerizuar, gjendet në veri-perëndim të Kamenicës. Mermerët janë të fortë, kanë strukturë kokërrzore. Përbëhen prej kalciti dhe me sasi të mikave dhe kuarcit. Kanë teksturë bankovite, rrallë rreshpëzore. Mermerët e kësaj ane me anë të vrojtimeve makroskopike, shfaqen me përmasa dhe trashësi të ndryshme më së shumti deri në 10 m. Zakonisht, janë të shoqëruar me rreshpet amfibolike dhe sericit – biotike. Përbëhen, kryesisht prej kalcitit dhe shoqërohen me paraqitje të vogla të kalkshisteve. Kanë ngjyrë të bardhë, por paraqiten edhe me ngjyrë të përhimtë në të çelur. Kanë strukturë kokërrzore. Kryesisht, përmbajnë kalcit dhe shumë pak minerale të tjera. Kalkshistet paraqiten në mermere me trashësi më të madhe deri 1m. Përbëhen prej kuarcit kokërrimët, sericitit dhe masës karbonatike.

#### **6. PRODUKTET E KUATERNARIT (Q)**

Në fushën e Moravës së Binçës, produktet e KUATERNARIT kanë shtrirje të madhe. Gjeneza dhe litologjia e këtyre depozitimeve është e ndryshme. Përveç krijimeve kontinentale, janë të pranishme edhe sedimentet liqenore. Këto produkte mbulojnë pjesët e rrafshta dhe lugina, si dhe janë të ndërtuara nga sedimentet aluviale, proluvioneve dhe deluvioneve.



# RESURSET MINERALE MINERAL RESOURCE MINERALNI RESURSI

## LEGJENDA / LEGEND/ LEGENDA


- Kufiri Komunal
- Zonat kadastrale
- Lumë, rrjedhë, përrua

### Depozitimet minerale

- |                   |                                       |
|-------------------|---------------------------------------|
| bentoniti         | zhavorr dhe rërë                      |
| kuarc dhe kuarcit | kaolinë dhe kaolinë argjilë           |
| shkëmb andezit    | shkëmb gëlqeror                       |
| Shkëmb argjilor   | shkëmb mermër                         |
| shkëmb dolomit    | Shkëmb migmatik                       |
| shkëmb gnais      | shkëmb: piroklastik material vulkanik |
| shkëmb granit     | Zonat e Ni, Pb, Zn, Ag                |
| Thëngjill         |                                       |

### Mineralet

- |    |    |
|----|----|
| Fe | cl |
| Pb | gs |
| Sb | li |
| Sn | mg |
| ba | sh |



Harta.17. Resurset minerale në Komunën e Kamenicës

#### **1.1.10.9 TRASHËGIMIA KULTURORE DHE NATYRORE**

Vendbanimet e Kosovës ekzistojnë që nga kohërat e hershme. Shumë vendbanime gjatë historisë janë shkatërruar nga luftërat në periudha të ndryshme kohore, ku si pasojë e tyre ishte shkatërrimi i banimit e po ashtu edhe të objekteve tjera përcjellëse si: kalatë, kishat, xhamitë, tyrbet etj. që e përbëjnë të kaluarën apo trashëgiminë kulturore të një treve.

Vendbanimet në Komunën e Kamenicës datojnë nga kohërat e hershme, falë kushteve natyrore të begatshme (male me pyje të dendura, kullosa dhe fusha pjellore, vend i pasur me florë, faunë si dhe xehe të shumta – ari? argjendi, plumbi, hekuri etj.), klimë e përshtatshme e mesme kontinentale e gërshetuar me atë mesdhetare, si dhe pozitë e përshtatshme gjeografike dhe gjeostrategjike.

#### **1.1.10.10 SHËNIME PËR MONUMENTET KULTURORE – HISTORIKE**

Komuna e Kamenicës është një vend i pasur me monumente kulturore-historike të lashtësisë. Monumentet e lashtësisë, siç janë : kalatë, gjytetet, varrezat, xhamitë, kishat etj. që ndodhen në Kamenicë: sipas disa studimeve dhe materialit arkeologjik që është gjetur në to, i përkasin dy periudhave të historisë së vjetër:

1. Periudha Ilire
2. Periudha gjatë Sundimit Romak deri në shek.V.

Në bazë të vendngjarjeve, vërehet se territori i Kamenicës është i pasur me trashëgiminë e të kaluarës historike, të cilat dëshmojnë kulturën e popullit tonë. Për një numër të madh të tyre dihet vend ndodhja, ndërkaq një numër të madh të tilla, mbetet për ti hulumtuar. Këto monumente janë të tipit të kalave, fortifikatave dhe gjyteteve. Gjendja e tyre momentale është shumë e keqe, sepse gjatë periudhës së më vonshme është bërë shkatërrim sistematik i tyre, ato si të tilla nuk kanë hyrë në mbrojtje deri tash, prandaj disa mure gati janë shkatërruar nga fshatarët dhe janë përdorur për ndërtimin e shtëpive private.

## Lokalitetet arkeologjik



Gotë vere, shek II p.e.s Topanicë

## Monumente epigrafike




Pllaka orientuese e bujtinës në Kulinë



Gurë varri i vajzes 6.vjeçare ilire me emrin Didije

**Fotografi e arkivit „Dëbimi Masiv i Fshatit Berivojcë“ më 1934  
Falja e xhumasë së fundit në fushë**



## Objektet e kultit



## Manastiri në Moçar, Periudha:IlIRO-bizantine

## Kisha e Shën Mërisë –Vaganesh







Kisha e vjetër iliro-bizantine dhe kisha e re ortodokse - Hajnoc



**Xhamia e Zajçecit**



**Xhamia e Svircës**



**Xhamia e Kamenicës**



**Xhamia e Hodonocit**



**Xhamia e Rogaçicës**



**Xhamia e Hogoshtit**



**Xhamia e Zhujës**



**Xhamia e Desivojcës**



**Teqeja e Topanicës**



**Tyrbja e Dazhnicës**



**Tyrbja e Rogaçicës**

## Objektet Qytetare

- Objektet qytetare të banimit në fushëgropën e Kosovës dhe të Kamenicës (Dardanës) në veçanti, krahasuar me ndërtimin e objekteve të banimit në Dukagjin në zgjedhjen kompozicionale, në përgjithësi janë të përafërta. Ato dallojnë, kryesisht për materialet e përdorura për ndërtim.
- **Arkitektura e banimit në rajonin e Kosovës, edhe pse kishte influencë prej arkitekturës otomane, me galeritë dhe ballkonet të ndërtuara nga druri, ajo është e “ndërtuar përgjithësisht nga shqiptarët dhe e banuar përgjithësisht nga shqiptarët” (\*\*cituar nga ligjërata e prof. dr. EMIN RIZA).**
- Gjatë inventarizimit të vlerave kulturore, në sektorin e trashëgimisë së paluajtshme, në listën e objekteve të evidentuara, përveç të tjerave janë përfshirë objektet në vijim: një pjesë e të cilave sot nuk ekzistojnë ose janë në shkatërrim e sipër:

## Shtëpia e Sinanit, Rogaçicë





**Shtëpia e Sylë Haskut, Kremenatë**





**Shtëpia e hoxhë Mahmutit – Strezoc**



**Objekt banimi në Vriçec, pronar: Bajram Murseli**



Shtëpi banimi – Moçar



Objekte banimi në Vriçec, pronar: Hevzi Murseli



**Shtëpi banimi e Demush Feriz Hajdarit - Zhujë**



**Shtëpi banimi në Dazhnicë, pronar: Isuf Rama**



**Shtëpi e vjetër në Kopërnice, pronar: Hevzi Beqiri**



**Mulli binjak - Hogosht**



Mulli në Shipashnicë



**Përmendore – Kopernicë, Kulla e Rahim Beqirit – Roki**



**Shtëpia Muze “Kadri Zeka” Poliçkë ( në ndërtim e sipër)**



**Shpata (v 1210 sipas Hixhrit)**



**Kultura krishtere Poliqë**



**NUMIZMATIKË**

**Filipi I (244 – 249)**



**Maksimianus(286 – 305)**



**Gardianus III (238 – 244)**



**Teodosius (379 – 395)**





### Veshjet tradicionale



Trashëgimia Kulturore – kërkime të shumta klandestine

## Objekte të natyrës – gurë



Në popull njihet si “Koka e gjarpnit” (ndodhet në Rogaçicë)



Ndodhen në Rogaçicë



Dy figura të njerëzve . Ndodhett brenda lagjes së Gurë Natyrorë në formën e karrigës apo sipërme të Kështjellës së Kopërnices



Guri i Gjatë mbi Hogosht, ky gurë ruan një mbishkrim (dëshmi) të ndarjes së pasurisë së dy vëllezërve ILIRË **GEORGEOS DHE KABASHIOS**



Guri i Qapiles ndodhet mbi Hogosht. Paraqet një kompleks objektësh me forma natyrore të përpunuara, në këta gurë janë paraqitur fëtyra njerëzore që përcillen me mbishkrimin ilir :O S O HYU YN, O S O ZOTI YN



Në popull njihet si Guri i Sahatit. Ndodhet mbi Hogosht pranë rrugës përballë fshatit Dazhnicë, në pjesën e përparme është paraqitur disku i diellit dhe dy vrima në të. Pjesa e pasme duket që është një pllakë mbi varr.



Është një gur i rrallë i cili ndodhet në malësinë e mbi Hogoshtit. Në këtë gur janë paraqitur dy figura njerëzish. Me rastin e deshifrimit që i ka bërë këtijë guri **Shaban Berisha, prof.**




Gurë që ndodhet në kompleksin e gurëve të QAPILES. Duket qartë se janë paraqitur dy figura njerëzore të burrit dhe të gruas.



Gurë pranë rrugës, afër ambulancës në fshatin Kopërmicë. Ruan një shkrim të kohës ILIRE, ku përmendet HYU ZOTI.



Gurë masiv rrëzë kodrës së Kulinës. Në këtë gur është gdhendur fytyra e një sundimtari të Kulinës me mjekërr të gjatë. Ky njeri i përket familjes sunduese të Kulinës ZGUROS. Me rastin e deshifrimit që i ka bërë prof. Shaban Berisha këtij objekti, ka konstatuar se ky është ILOS ZGUROS.



Në fshatin Gyrishec ndodhet topogërmadha, GJYTETI. Ky gjytet është përmendur në shkrimet romake me emrin GURASANT. Në bazë të pamjes së vendit dhe pozitës prof. Shaban Berisha ka bërë rikonstruktimin e përafërt të gjytetit, foto lartë. Gjyteti ka pasur dy lagje, e sipërme dhe e poshtme. Kishte po ashtu, oborrin e lagjes së poshtme dhe oborrin e lagjes së epërme. Gjyteti kishte edhe ujësjellësin, i cili ende rrjedh në lagjen e poshtme.



Kulina është një objekt i kulturës urbane iliro- dardane. Kulina ka qenë një kështjellë shumë e fortifikuar, ka pasur tri mure rrethuese. Në brendinë e saj pos objekteve tjera ka qenë edhe një bujtinë, për të cilën flet pllaka e gjetur në afërsi të Kulinës. Planimetria e Kulinës ka formën e shkronjës D. Kulina paraqet një pjesë të një vendbanimi shumë më të madh. Emërtimi i parë i qytetit të Kamenicës është Kulinë.



KOPRA- Kështjella në Kopernicë, objekt i kulturës urbane iliro-dardane mbi dymij vjeçare. Ka pasur vetëm një murë rrethues dhe dy hyrje, hyrja nga ana perëndimore dhe nga ana lindore. Kopra ka një planimetri mjaft të avancuar. Kulla ka pasur vetëm te hyrjet, ndërsa muri rrethues është mbajtur me anën e urave që ka qenë një zgjidhje gjeniale për kohën. Porta e anës lindore është lidhur me oborrin. Oborri është lidhur me akropolin me shkallë të gjata.



Ulanishti (Llanishta), vend i burimeve të ujit. Pamjet paraqesin themelet e një objekti të kohës së vjetër.

## OBJEKTET MUZEALE



Pllakë varrezore e gruas së re ilire, e gjetur në lokalitetin e vjetër Berkoc në Hogosht. Këtë objekt e ka deshifruar dhe skicuar prof. Shaban Berisha. Në bazë të deshifrimit është konstatuar se bëhet fjalë për gruan ilire BERA GUROS. Në kornizë është shënuar moshja e të ndjerës M COH XXXX.



Kokë burri ilir e gjetur në Kopër (Kopërnice), nga fondi i muzeut.



Gur varri i njërit nga sundimtarët e Kulinës të Familjes ZGUROS. Në bazë të deshifrimit që i ka bërë këti objekti prof. Shaban Berisha, ky është HOLOS ZGUROS në pjesët anësore përmendet HYU, ZOTI.



Gur varri i burrit dhe gruas ilire i gjetur në Gugulloc. Në bazë të deshifrimit të bërë nga prof. Sh. Berisha fjala është për bashkshortët GERA dhe ILOS ZOTOS.





Gurë varri i një familje ilire, i gjetur në lokalitetin ARNICA- Hogosht. Në këtë gur janë gdhendur katër gurë. Gjithashtu, janë gdhendur katër fytyra të familjarëve, të dy prindërve, të të birit dhe nuses së tij. Forma e gurit nuk paraqet ulësen, por vendin ku janë lënë pijet dhe ushqimet për të vdekurit.



Pllakë varri me kryq e gruas ilire të krishterë, e gjetur në afërsi të Kishës së Makushit mbi fshatin Hogosht . E ka gjetur Arsim Latifaj nga Hogoshti. Në bazë të deshifrimit të bërë nga prof. Sh. Brisha, ka të bëjë me gruan e re ilire me emrin GURA MOZEOS. Në pllakë është shënuar moshja e vdekjes M COH XXX tridhjetë vjeçare.



Gur varri i njeriut të moshuar ilir, i gjetur në lokacionin Gugulloc. Skicën dhe deshifrimin e bëri prof. Sh. Berisha. Në anë e përparme është shënuar emri e mbiemri i të ndjerit HOLOS ZOTOS. Ndodhet në fondin e muzeut.



Kokë gruaje ilire nga fondi I muzeut. Skicuar dhe deshifruar nga prof. Sh. Berisha. Emri I saj është ZOTA HOLOS.



Koke e gruas ilire me temijnën e gjetur Pllakë guri me fytyrë njeriu nga fondi i muzeut Në lokalitetin Arnica, në Hogosht. Skicën e bëri prof. Sh. Berisha.



Përmendore e luftëtarit ilir e gjetur në afërsi të komunës. Skicën dhe deshifrimin e ka bërë prof. Sh. Berisha. Në bazë të deshifrimit duket se është paraqitur fytyra e një luftëtari ilir në pjesën ballore, në anën e majtë është gdhendur shpata e tij, ndërsa në anën e djathtë është shënuar emri e mbiemri i tij: HOLOS ILOS BUR

### **Kështjella në veriperëndim të qytetit**

Në një kodër në pozitën strategjike afër së cilës kalon lumi, në pjesën veriperëndimore ndodhet kështjella. Materiali ndërtimor është marrë nga qytetarët, kryesisht kanë mbetur gjurmët themelore të saj. Ky objekt asnjëherë, nuk është hulumtuar nga arkeologët.

Në afërsi të kësaj kështjelle janë gjetur stella të shekullit të II. Këta gurë va rrezor kanë një rëndësi të veçantë arkeologjike, sepse tregojnë një varrezë lliro –dardane.

Në **figurën 1a**, paraqitet një gur varrezor i shekullit të II-të, në të cilin thuhet se, nënës PIRUSTES në moshën 6 vjeçare i ka vdekur vajza e saj MËKASTA DIDIA.

Dhe për nder të saj në shekullin e II e ngritën këtë monument varrezor .

**Figura 1b**, paraqet gjithashtu, një gurë varrezor të shek.II-të, ku një mbretëri lliro varrosë fëmijën në një varrezë **tumale**. Një gur i tillë nuk është gjetur askund në Kosovë .

**Figura 1c**, Gjithashtu, paraqet një varrezë të shek. III-të, ku këtu paraqitet një stellë e fëmijes.

I gjithë ky vend, mbetet të hulumtohet nga arkeologët në të ardhmen.

### **Fshati Kopërnice**

Në kodrën që ndodhet në veri të këtij fshati, që është pjesë e vargmaleve të Gallapit ndodhet një objekt i lashtësisë. Ky objekt edhe pse është dëmtuar në mënyrë të konsiderueshme, duken qartë vijat e mureve të këtij objekti në përmasa të mëdha; gjë që dëshmon se nuk ka qenë vetëm një “Kala” siç quhet në popull, por i përgjigjet formës së objektit që është e njohur me emrin “Gjytet”.Ky objekt ka pasur disa hyrje. Hyrja kryesore ka qenë në pjesën e poshtme ose në lindje, ku lidhet oborri, aty janë një varg shkallësh të pandërprera që përballojnë pjerrtësinë e kalasë. Është njëri prej vendbanimeve monumentale arkeologjike i pa gjurmuar .

Në pjesën perëndimore, është vendi që quhet “Gradinë” , i cili është në majë të kodrës në afërsi të drejtpërdrejt të kalasë. Në pjesën jugore të fshatit ishte kisha, ku dallohen muret edhe pse shumë janë të dëmtuara. Afër kishës ndodhen varreza shumë të vjetra.

### **Fshati Krilevë**

Në pjesën perëndimore të këtij fshati ndodhet kalaja, e cila dëshmon për kohën shumë të vjetër .

Në pjesën e poshtme të kalasë ndodhet rrjedhja e dy lumenjve, e vendit që quhet “Rapuh”.

Në bazë të mureve të gjetura do të ishte tempull fetar. Muret tregojnë një vjetërsi shumë të madhe, sepse gurët janë të vendosur në mure të pa gdhendur.

Afër saj, në pjesën lindore ndodhen varrezat. Vlen të përmendet se kjo kala ka lidhje me kalanë e Novobërdës . Xhamia e fshatit është ndërtuar në vitin 1846 nga banorët e fshatit .Në vendin e quajtur “Te Kisha”, ka qenë një kishë e ngritur në shek.XIII.

### **Fshati Topanice**

Mbi kodrën që gjendet në jug të këtij fshati, vërehen qartë gjurmët e një objekti të lashtësisë e që banoret e këtushëm e quajnë “Gradec”.

Ky objekt ka një pozitë interesante dhe strategjike, materiali ndërtimor është marrë nga fshatarët megjithatë, mundet të haset vetëm në muret nëntokësore të cilat janë të mbuluara me dhe .

Në afërsi të Gradecit, sipas pohimeve të fshatarëve, janë edhe varrezat shumë të vjetra. Në këtë fshat ndodhet Teqeja e Sheh Zenel Abedinit, shek.XVIII,nr.v.E.K.02-156/80.

Po ashtu, është edhe xhamia e fshatit e ngritur nga vet banorët .

### **Fshati Busavatë**

Në këtë fshat gjendet një shpellë, Kisha e vjetër , Manastiri ku ka mbishkrime ilire, te guri ku ndodhen varrezat e vjetra ilire.

Në këtë fshat është xhamia e ndërtuar nga banorët e fshatit

### **Fshati Hodonoc**

Në këtë fshat në pjesën jugperëndimore ka ekzistuar një objekt i kohës antike si pas gojëdhënave të fshatarëve.

Një dëshmitë tjetër e cila tregon vjetërsinë e fshatit, është edhe xhamia që është ngritur në vitin 1597 në kohën e sundimit Osman. Mikrotoponimi, Ara e Pamukut gjithashtu, është toponim që tregon vjetërsinë e këtij fshati.

### **Fshati Hogosht**

Edhe në këtë fshat janë gjetur gjurmët e një lokaliteti të kohës antike, sipas banorëve të fshatit, ekzistojnë shumë objekte arkeologjike.

Në vendin e quajtur “Te Makushovi”, janë gërmadhat e një objekti të rëndësishëm arkeologjik.

### **Fshati Rogaçicë**

Edhe në këtë fshat janë gjetur gjurmët e një lokaliteti të kohës antike, sipas banorëve të fshatit ekzistojnë shumë objekte arkeologjike.

Në vendin e quajtur, “Te Kasha” (te varrezat e reja të Katushnicës) janë gërmadhat e një objekti të rëndësishëm arkeologjik (kishë ilire)

### **Fshati Muçivërc**

Edhe në këtë fshat janë gjetur gjurmët e një lokaliteti të kohës antike, sipas banorëve të fshatit, ekzistojnë shumë objekte arkeologjike.

Në vendin e quajtur “Te shpatet”, janë gërmadhat e një objekti të rëndësishëm arkeologjik (kishë ilire).

### **Fshati Gjyrishec**

Në këtë fshat ndodhet një lokalitet i kohës së vjetër, i periudhës Romake e që është i njohur në popull me emrin “Gjytet”.

Në vijën ajrore është i lidhur në mënyrë të drejtëpërdrejtë me Kalanë e Kopërnices .

Të gjitha këto shënime janë marrë nga Dr.Rexhep Doqi, që thotë se ky fshat është quajtur Gurasant.

|   |  |
|---|--|
| 1 | Vaganesh – Kisha e dëftimit të Shën Mërisë.shek.XIV-VI,nr.v.E.K.474/55                     |
| 2 | Hajnovc- Manastir Burg ,shek .XIV nr.v.E.K.476/55  |
| 3 | Moçar-Manastir Rgjavc,shek.XIV nr.E.K .478/55  |
| 4 | Berivojcë- Kisha e Shën Gjonit shek.XIV-XVI,nr.v.E.K.02-338/63                             |
| 5 | Koretin-Nekropolë e hershme shek.VI-VIII,nr.v.E.K.02-278/70                                |
| 6 | Hogosht –Mbeturinat e varrit të antikës së vonë,shek.V-VI,nr.v.E.K.02-329/72               |
| 7 | Topanicë –Teqeja e Sheh Zenelit Abedinit shek.XVIII.nr.v.E.K.02-156/80                     |
| 8 | Karaçevë e Epërme –Lokaliteti arkeologjik në pjesën „Ordine” shek.IV-VI,nr.v.E.K.01-130/81 |
| 9 | Objektet e kultit mysliman dhe të krishtere në Komunën e Kamenicës                         |

**Tab. 22. Lista e Monumenteve-objekteve me vlerë trashëguese në Komunën e Kamenicës**

| Nr. | Përshkrimi i pozicioneve  | njësia | Siperfaqja |
|-----|---|--------|------------|
| 1   | Varrezat e Dëshmorëve-kompleksi, Kamenicë   | m2     | 5277       |
| 2   | Lapidari – Sheshi i dëshmorëve në Hogosht   | m2     | 55         |
| 3   | Kompleksi i shtabit dhe lapidari i brigades së UÇK-së “172 Isa Kastrati” Hogosht-Bujnoc | m2     | 1000       |
| 4   | Lapidari i dëshmorit Asllan Thaçi – Karaçevë e Poshtme                                  | m2     | 1997       |
| 5   | Lapidari i dëshmorit Ismajl Ismajl – Kopërnice  | m2     | 52         |
| 6   | Lapidari i dëshmorit Rahim Beqiri në Kopërnice  | m2     | 3268       |
| 7   | Lapidari i dëshmorit Ramadan Kastrati - Kamenicë  | m2     | 32         |
| 8   | Lapidari i dëshmorit Ramadan Kastrati – Karaçevë e Epërme                               | m2     | 30         |
| 9   | Kompleksi Memorial – Kadri Zeka në Poliçkë  | m2     | 12932      |
| 10  | Lapidari i dëshmorit Xhelal Sopi në Petroc  | m2     | 45         |
| 11  | Lapidari i dëshmorëve në Ghyrishec  | m2     | 3392       |
| 12  | Lapidari i dëshmorit Basri Canolli në Leshtar   | m2     | 480        |
| 13  | Lapidari i dëshmorit Rafet Isufi në Koretin   | m2     | 290        |
| 14  | Lapidari i dëshmorëve Selver dhe Emin Kryeziu në Rogaçicë                               | m2     | 332        |
| 15  | Lapidari i dëshmorit Arsim Isufi në Rahovicë  | m2     | 203        |
| 16  | Lapidari i dëshmorit Musli Imeri në Zajçec  | m2     | 630        |
| 17  | Lapidari i dëshmorëve , qendër afër Tregut të gjelbër - Kamenicë                        | m2     | 281        |
| 18  | Varri i Dëshmorit Metush Krasniqi në Dajkoc   | m2     | 15         |
| 19  | Sheshi i NDSH-s në Topanicë   | m2     | 10         |
| 20  | Shtëpia Muze Nuhi Berisha në Svirçë   | m2     | 1100       |
| 21  | Sheshi i NDSH-së në Shipashnicë të Epërme   | m2     | 60         |

**Tab.23. Lapidarët e Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së**

Dëshmitë e ekzistimit të vendbanimeve të hershme janë:

- Shumë kështjella
- Gytete
- Kisha
- Manastire

## **Trashëgimia arkeologjike**

### Gjetjet arkeologjike

1. Lokaliteti arkeologjik Gjyteti në Gjyrishec
2. Lokaliteti arkeologjik në Kranidell
3. Lokaliteti arkeologjik në Topanicë
4. Lokaliteti arkeologjik në Strezoc
5. Lokaliteti arkeologjik në Busavatë
6. Lokaliteti arkeologjik në Hogosht
7. Lokaliteti arkeologjik në Kopërnice
8. Lokaliteti arkeologjik në Rogaçicë
9. Lokaliteti arkeologjik në Hodonoc
10. Lokaliteti arkeologjik në Vaganesh
11. Lokaliteti arkeologjik në Hajnoc
12. Lokaliteti arkeologjik në Moçar
13. Lokaliteti arkeologjik në Berivojcë
14. Lokaliteti arkeologjik në Koretin
15. Lokaliteti arkeologjik në Karaçevë e Epërme
16. Lokaliteti arkeologjik në Muçivërc
17. Lokaliteti arkeologjik në Kamenicë
18. Lokaliteti arkeologjik në Strezoc
19. Lokaliteti arkeologjik në Krilevë

### Kalatë

1. Kalaja e Kamenicës (Dardanës)
2. Kalaja e Kopërnice – periudha romake
3. Kalaja e Kranidellit – periudha romake

### Objektet e kultit të krishterë

1. Manastiri në Moçar – periudha romake
2. Kisha në Vaganesh
3. Kisha e vjetër romake dhe kisha e re ortodokse – Hajnoc
4. Kisha në Kamenicë (Dardanë)

### Objektet e kultit islam

1. Xhamia e Zajçecit
2. Xhamia Hodonocit
3. Xhamia e Kopërnice
4. Xhamia në Kamenicë (Dardanë)
5. Xhamia e Desivojcës
6. Xhamia e Zhujës
7. Teqeja e Topanicës
8. Tyrbja e Dazhnicës
9. Tyrbja e Rogaçicës

### **Objektet e banimit- Shtëpitë**

1. Shtëpi në qytet, komuna pas vitit 1945
2. Shtëpia e Sylë Haskut, Kremenatë
3. Shtëpia ku qëndroi Mulla Idriz Gjilani, për disa vjet - Ilegalisht
4. Shtëpia e Hoxhë Mahmutit – Srezoc
5. Shtëpi banimi – Moçar, periudha :Shek:XIX, mjeshtri popullor, pronë private
6. Shtëpi banimi e Demush Feriz Hajdarit - Zhujë
7. Shtëpi banimi në Dazhnicë
8. Shtëpi e vjetër në Kopërnice
9. Objekt banimi në Vriçec
10. Objekte banimi në Shipashnicë të Epërme

### **Objektet bujqësore**

1. Plevicë e Shillovëve të Srezocit
2. Mulli binjak - Hogosht
3. Mulli në Shipashnicë
4. Kosh në Koretin

### **Trashëgimia e Luajtshme**

1. Shpata (v 1210 sipas Hixhrit)
2. Kultura krishtere- Poliçkë

### **Numizmatikë (tërësi e monedhave të një periudhe historike)**

1. NUMIZMATIKË Filipi I (244 – 249), monedha
2. Maksimianus (286 – 305), monedha
3. Gardianus III (238 – 244), monedha
4. Teodosius (379 – 395), monedha

### **Trashëgimia ambientale**

Nga vizita në terren e bërë më datën 06.02.2011 janë marrë këto opinione:

- Në monumentet e vizituara, vërehet që nuk ka kurrfarë kontrolli dhe kujdesi institucional;
- Infrastruktura rrugore nuk është në gjendje të mirë në të gjitha monumentet kulturore dhe historike;
- Mungon shenjëzimi i këtyre monumenteve.



1. Manastiri Burg, shek XIV. – Hajnoc



Manastiri ishte në gjendje të mirë, nuk kishte dëmtime dhe dukej se ishte i përdorshëm.



### 1. Teqeja e Sheh Zenel Abedinit, shek.XVIII.

– Topanicë – monument i lënë tërësisht pas dore. Nuk është i mbikqyrur nga askush. Nëse vazhdohet në këtë mënyrë, kjo teqe do të dëmtohet edhe më tepër.

Disa përshkrime të shkurta për VB e Komunës së Kamenicës lidhur me të kaluarën, pra trashëgiminë e tyre.

**Bozheci** - Është VB mjaft i vjetër, ndoshta VB iliro-dardan. Ekzistojnë gërmadha të gjetitit në vendin “Guri i Hoxhës”. Dedikimi i kështjellës ishte që të mbrojë VB dhe shkritoren.

**Busavata** - Në këtë fshat ka kaluar rruga e vjetër që ka lidhur Novo Bërdën, Kamenicën, Bujanocin e Vranjën. Ka kaluar rruga Kamenicë- Busavatë- Përlepnice- Gjilan. Në bazë të disa materialeve arkeologjike të gjetura në një shpellë dëshmohet se, ky fshat daton që nga koha e paleolitit. Ekziston kalaja e cila daton që nga shekulli II, themelet e një kisha dhe një shpellë, varre etj.

**Svirca** - VB me gurë miniere, popullata e quan “Rudniku i Ilirëve”.

**Kamenica** - Në një kodër të qytetit, afër së cilës kalon lumi, ndodhet kështjella (Kulina ose Gradisha), tani gjenden muret e një qyteti të shkatërruar. Janë gjetur në afërsi të saj stella (pllaka guri mbivarrore) të shek. II.

**Dërmaku** - VB i vjetër iliro-shqiptar, në të cilin ekzistojnë varret e vjetra dhe themelet e kishës.

**Desivojca** - Në lokalitetin e këtij fshati që nga koha e romakëve, thuhet se është eksploatuar xehet e plumbit, zinkut etj. Pra, ka ekzistuar xeherorja në atë kohë, e ndërtuar gjatë sundimit romak, ka ekzistuar Kisha e Hajdukut e kohës iliro-arbëreshe.

**Firaja (Firiqeva)** - VB i vjetër, ku dëshmohet me një kishë të vjetër e quajtur Kisha Thyme, e periudhës së sundimit Romak (kishë ilire).

**Gardheshi (Gragjeniku)** - VB i vjetër në të cilin jetonte popullata ilire-dardane, e cila qysh herët e kishte pranuar krishtërimin, kjo dëshmohet edhe në gjurmët e kishës, e cila në popull njihet si Kisha e Rimit. Në kohën e mesjetës në këto anë është bërë shkrirja e metaleve (në popull quhet, samakovë). Në këtë kishë në mënyrë tradicionale çdo vjet më datën 5Maj mbahen gara sportive (me kuaj, gjuajtje të gurit, mundje etj.), saktësisht nuk dihet prej kur daton kjo traditë.

**Gmicë** - Në bazë të mikrotoponimeve, Mali i Kishës, Kroni Maks, dëshmohet se, kanë ekzistuar kisha të vjetra shqiptare.

**Grizime** - Në këtë fshat gjenden muret e manastirit mesjetar, që edhe sot janë të ruajtura.

**Gugolloci** - Ekziston një kishë e vjetër.

**Gurabardhi (Strezoci)** - Është VB i grupit kulturor dardan (shek.VII–IV-p.e.s) të tipit kodrinor i vendosur në një kodrinë. Mbi Strezoc ndodhet një “Fortesë” parahistorike, në të cilën përpos materialit të periudhës romake, ka material edhe të periudhës së hershme romake.

**Hajnoci** - Ekziston kalaja ilire, që në popull quhet “Kulina” dhe kisha e quajtur, “Kisha e Rimit”. Është gjetur një bazilikë disangjyrëshe bizantine. Sot kjo kishë është e përvetësuar nga serbët.

**Hodonoci** - Në këtë Vendbanim ndodhet një kishë iliro-romake, ku edhe sot ekzistojnë themelet e saj.

**Kopra (Kopërnica)** - Një ndër fshatrat më të lashta të kësaj ane, me kala e cila ndodhet në veri të fshatit, ku edhe sot kanë mbetur gjurmët e vijave të mureve që flasin jo vetëm për kala por për Gjytet.

**Koretini** - Lokalitet i vjetër. Dëshmohet me gjetjet e ndryshme dhe me një kishë shqiptare, të cilën serbët në themelet e saj ndërjuan kishën e tyre. Pra, kjo dëshmon se ishte lokalitet i vjetër iliro-dardan.

**Krileva** - VB i vjetër iliro-dardan, e cila ka pasur kalanë e quajtur, “Kulla” e cila ishte e lidhur me kalanë e Novo Bërdës, me shkritore të xehes dhe gjurmë të një kishe.

**Vaganesh** - VB i vjetër, ndoshta ilir i periudhës antike të vonë, të mesjetës së hershme e përvetësuar nga serbët.

Nga kjo pasqyrë e vështrimit historik të kësaj ane, na jep të konkludojmë se, përkundër sfidave të ndryshme që e kapluan këtë territor si luftërat, dyndjet e detyrueshme të banorëve, sëmundjet, vërshimet, tërmetet etj., populli shqiptar arriti ta mbajë dhe ruajë identitetin e tij kombëtar në këto hapësira.

Në mungesë të listës së monumenteve kulturore të viteve të mëparshme dhe të atyre të sotme, nuk kemi qenë në gjendje ti bëjmë analizat lidhur me çështjen, e cila po e mundon tërë Kosovën e po ashtu edhe komunën e Kamenicës; pra sa dhe ku është i shprehur degradimi i trashëgimisë kulturore.

Monument karakteristik natyror ne Komunën e Kamenicës është edhe Guri i Madh në Busavatë, shih foton:



Në vitin 2005 nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, janë evidentuar 21 monumente të natyrës, prej tyre 15 janë të propozuara për mbrojtje. Pra, monumente natyrore botanike janë 9, monumente natyrore hidrologjike janë 3 dhe monumente natyrore gjeomorfologjike.<sup>3</sup>

<sup>3</sup> Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Natyrës




**TRASHËGIMIA KULTURORE  
CULTURAL HERITAGE  
ISTORISKE NASLEDE**

**LEGJENDA / LEGEND / LEGENDA**

- Kufi komunal
- Zonat kadastrale

**Monumentet e mbrojtura  
kulturore**

- Kish
- Lokalitet arkeologjik
- Manastir
- Teqe
- Varrezë



Burimi i të dhënave: Agjencia Kadastrale e Kosovës  
Institucionet e Komunës së Kamenicës  
Fotografië aërore të vitit 2009  
Grupi për Shfrytëzimin e Tokës dhe Mjedisit  
Grupi për Demografinë dhe Qeshëje Sociale  
Instituti Arkeologjik i Kosovës

Projected Coordinate System: KosovaRef01  
Projection: Transverse\_Mercator  
Geographic Coordinate System: GCS\_ETRS\_1989  
Datum: D\_ETRS\_1989  
Prime Meridian: Greenwich  
Angular Unit: Degree




Harta.18. Trashëgimia kulturore në Komunën e Kamenicës..



**MONUMENTET KULTURORE  
CULTURAL MONUMENTS  
KULTURNIH SPOMENIKA**

**LEGJENDA / LEGEND / LEGENDA**

|   |                       |
|---|-----------------------|
|   | Kufi komunal          |
|   | Zonat kadastrale      |
| <b>Monumentet e mbrojtura kulturore</b> |                       |
|   | Kala                  |
|   | Kish                  |
|   | Manastiri             |
|   | Mulli                 |
|   | Lokalitet arkeologjik |
|   | Shtëpi                |
|   | Teqe                  |
|   | Varrezë               |
|   | Xhami                 |



Shkalla / Scale / Razmera  
1:150,000

Burimi i të dhënave: Agjencia Kadastrale e Kosovës  
Institucionet e Komunës së Kamenicës  
Fotografitë ajrore të vitit 2009  
Grupi për Shfrytëzimin e Tokës dhe Mjedisit  
Grupi për Demografi dhe Qështje Sociale  
Bashkësia Islame  
Kisha Serbe  
Instituti Arkeologjik i Kosovës

Projected Coordinate System: KosovaRef01  
Projection: Transverse\_Mercator  
Geographic Coordinate System: GCS\_ETRS\_1989  
Datum: D\_ETRS\_1989  
Prime Meridian: Greenwich  
Angular Unit: Degree



Harta.19. Monumentet kulturore në Komunën e Kamenicës.

## 1.1.11.0 FATKEQËSITË NATYRORE DHE TË TJERA


### 1.1.11.1 Fatkeqësitë natyrore - Tërmetet:

#### **Fatkeqësitë natyrore - Tërmetet:**

Vërshimet, rrëshqitjet e borës, bora e madhe, era e fortë, breshëri, akulli, thatësira, paraqitja masive e sëmundjeve ngjitëse te njerëzit, te shtazët dhe te bimët, si dhe fatkeqësi të tjera që i shkakton natyra.

**Fatkeqësitë tjera**- nënkuptohen fatkeqësitë e mëdha në trafikun rrugor, ajror e hekurudhor, zjarret, fatkeqësitë në xeherore, shkatërrimi i digave dhe fatkeqësitë e tjera ekologjike e industriale. Fatkeqësi që i shkakton njeriu me punë dhe me sjellje, gjendja e jashtëzakonshme, emergjente, temperaturat e larta, kolapsi teknik i sistemeve energjike të furnizimit me rrymë, telekomunikacioni dhe teknologjia informative, aktet tërëroriste dhe mënyrat e tjera të rrezikimit masiv. Territori i Komunës së Kamenicës, vazhdimisht është ballafaquar dhe mund të ballafaqohet me fatkeqësi natyrore e të tjera, kështu që Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe për Emergjencë Civile ka përgjegjësi për menaxhimin e këtyre situatave emergjente, siç janë :

- Zjarret
- Vërshimet
- Tërmetet
- Fatkeqësitë e tjera elementare



Njëra ndër fatkeqësitë natyrore më sfiduese është Tërmeti. Dihet se në pikëpamje sizmologjike, Komuna e Kamenicës si edhe pjesa më e madhe e Kosovës paraqet një rajon me aktivitet sizmik të lartë, i cili është goditur në të kaluarën dhe mund të goditet edhe në të ardhmen nga tërmete autoktone shumë të forta. Ato i kanë vatrat e cekëta.

Territori i Kamenicës ka për karakteristikë, zonën e burimeve sizmike ose zona sizmogjene (siç quhen ndryshe), si vijon: zona sizmogjene Gjilan-Kamenicë me magnitudë maksimale  $M=6.1$  shkalla Rihtërë, në krahasim me Kosovën që e karakterizojnë edhe zona sizmogjene Prizren – Pejë, si dhe Zona sizmogjene Kopaonik.

Këto zona të burimeve sizmike kanë gjeneruar në të kaluarën dhe mund të gjenerojnë edhe në të ardhmen tërmete të forta.

Ndër tërmetet më të fuqishme që kanë goditur rajonin, këtu po përmendim: Rajoni Ferizaj – Gjilan duke përfshirë edhe Vitinë është prekur nga dy tërmete shumë të forta, më 1755 dhe 1921. Tërmeti i vitit 1921 ka qenë me intensitetin e njëjtë me atë të vitit 1755, çka do të thotë se është përsëritur këtu pas 166 vjetësh.

Tërmeti i vitit 1921 është shoqëruar nga shumë pasgoditje të forta 7 e 8 ballë-shkalla MCS, të cilat kanë zgjatur për një vjet, nga gushti 1921 deri në shtator 1922.<sup>4</sup>

Karakteristike është se, në rajonin Ferizaj – Gjilan janë regjistruar tërmetet me magnitudë nën 5.0 shkallë të Rihtërëit me intensitet epiqendror rreth 6–7 ballë, me sa vijon:

- Tërmeti i 5 marsit 1936 me magnitudë 4.9 dhe intensitet epiqendror 6-7 ballë;
- Tërmeti i 8 qershorit 1956 me magnitudë 4.6 dhe me intensitet epiqendror 6 ballë.

Nga kjo shihet se pas vitit 1956 nuk është regjistruar ndonjë tërëmet me intensitet epiqendror 6 ose mbi 6 ballë. Vetëm më 24 prill 2002 një tërëmet me intensitet epiqendror prej 7.5 ballë MSK-64 goditi rajonin e Gjilanit.

Nga kjo konkludojmë se, ky tërëmet është përsëritur këtu pas 46 vjetësh nga tërmeti 6 ballësh i vitit 1956 dhe pas 66 vitesh nga tërmeti 6-7 ballësh i vitit 1936.

Nga kjo që u tha më sipër, rrjedh edhe territori i Komunës së Kamenicës si dhe pjesa më e madhe e territorit të Kosovës paraqet një vend aktiv nga pikëpamja sizmike dhe me rrezikshmëri sizmike të lartë, njëlloj si vendet fqinje me të.


Sizmiciteti i lartë dhe tërmeti i 24 prillit 2002, që preku Rajonin Gjilan-Kamenicë, mirëpo vlen të evidentohen edhe tërmetet e kohëpaskohshme të cilat ndodhin në vazhdimësi, sikur edhe ato të datës: 09.10.2010 ku sipas Institutit Sizmik të Kosovës ishin tri tërmete edhe pse me shkallë të vogël të intensitetit prej 3.6, 3.4 dhe 3.7 shkallë të Rihtërëit.



### HARTA E ZONAVE TË RREZIKUARA

### LEGJENDA / LEGEND / LEGENDA

- Kufi komunal
- Zonat kadastrale
- Sipërfaqet e ndërtuara
- Shkalla VII Rihter
- Shkalla VIII Rihter
- vershimet



Shkalla / Scale / Razmera  
1:150,000

3,700 1,850 0 3,700 Meters

Projected Coordinate System: KosovaRef01  
Projection: Transverse\_Mercator  
Geographic Coordinate System: GCS\_ETRS\_1989  
Datum: D\_ETRS\_1989  
Prime Meridian: Greenwich  
Angular Unit: Degree

Burimi i të dhënave: Agjencia Kadastrale e Kosovës  
Institucionet e Komunës së Kamenicës  
Fotografije ajrore të vitit 2009  
Grupi për Shfrytëzimin e Tokës dhe Mjedisit  
Instituti Seizmologjik i Kosovës  
Drejtoria për Shpëtim dhe Mbrojtje



Harta.20. Zonat e rrezikuara në Komunën e Kamenicës

### **1.1.11.2 RRËSHQITJET E BORËS**

Rrëshqitje të borës në komunën e Kamenicës mund të ketë vetëm në zonat e larta malore, të cilat nuk paraqesin ndonjë rrezik për popullatën e Kamenicës dhe ekonominë e saj

### **1.1.11.3 ERËRAT**

Në territorin e Komunës së Kamenicës nuk ka erëra të forta, të cilat do të rrezikonin popullatën e Kamenicës dhe ekonominë e saj. Ndër erërat që njihen në këtë komunë janë:

1. Era jugore (Era e Karadakut) me shpejtësi  $v=3.2$  m/s
2. Era veriore me shpejtësi  $v=3.3$  m/s
3. Era veriperëndimore (Prishtinka) me shpejtësi  $v=2.5$  m/s
4. Era lindore (Vllasinka) me shpejtësi  $v=2.5$  m/s
5. Era jugperëndimore me shpejtësi  $v=2.5$  m/s

### **1.1.11.4 BRESHËRI**

Shpeshherë, breshëri në Komunën e Kamenicës mund të konsiderohet si rrezik për ekonominë e vendit, duke pasur parasysh faktet se në vitet e kaluara ka pasur rrebeshe të breshërit mjaft të forta, siç ishte ai i vitit 2002 i cili kishte shkatërruar të gjitha kulturat bujqësore të fshatrave në jugperëndim të Kamenicës. Është karakteristike se, gati të gjitha të reshurat që vijnë prej anës verilindore, përkatësisht rrymat e erës me re të cilat vijnë prej luginës së Moravës në drejtim të zonave më të larta malore përcillen me breshër.

### **1.1.11.5 AKULLI**

Territori i Kamenicës, sikurse e gjithë bota në të kaluarën ishte e përfshirë nga akulli, pra e ka kaluar periudhën akullnajore. Në kohërat tona territori i Kamenicës përfshihet nga akulli dhe bora, vetëm në zonat e larta malore. Këto dukuri ngjajnë vetëm gjatë stinës dimërore, duke mos paraqitur ndonjë rrezik për ekonominë dhe bujqësinë.

### **1.1.11.6 THATËSIA**

Thatësia mund të konsiderohet si rrezik për kulturat bujqësore gjatë stinës së verës, kryesisht gjatë muajve korrik dhe gusht kur temperaturat janë më të larta dhe të reshurat janë më të rralla.

### **1.1.11.7 VËRSHIMET**

Përmbytjet nuk mund të parandalohen, por dëmet e tyre mund të amortizohen dhe menaxhohen. Uji që grumbullohet nga reshjet ose shkrirja e borës patjetër duhet ta gjejë një rrugë të lëvizjes së tij.

Në këtë rast është e rëndësishme që atij ti krijohen kushte për një shkarkim sa më të lirë pa pengesa.

Komuna e Kamenicës ka një rrjet lumenjsh, por më të rëndësishmit janë : Lumi “Kriva Reka”, lumi i Hogoshtit dhe lumi i Desivojcës . Të gjithë këta lumenj derdhen në Lumin “Morava”. Në këtë komunë ekziston dhe liqeni në fshatin Ruboc. Lumenjtë e Kamenicës rrjedhje më të mëdha kanë gjatë muajit shkurt ,mars dhe maj, kurse rrjedhje më të vogla gjatë muajit gusht dhe shtator.



Komuna e Kamenicës është e pasur me burime ujore. Në bazë të të dhë dhe dhënave të Bazës së Hidroekonomisë së Kosovës, në territorin e Kamenicës janë të rrezikuara rreth 1100 ha.

Në territorin e saj ujërat sipërfaqësore përfshijnë një sipërfaqe prej 1021 ha ose 1.97% e sip. të përgjithshme e komunës.



Foto në Lumin “Kriva Reka”. Bimët e vetërritura në shtratin e lumit.

Rregullimi i shtratit të lumit dhe pastrimin e Lumit “Kriva Reka”, Hajnoc-Domaroc.

Rregullimi i shtratit dhe pastrimin e lumit të Hogoshtit, a Hogosht-Domaroc

Rregullimi i shtratit dhe pastrimin e lumit Karaçevë -Katushnicë.

Rregullimi i shtratit të lumit dhe pastrimin e tij të përroit të Ruboc

Lumi “Kriva Reka” deri në derdhjen e tij në lumin Morava, kryesisht kalon pjesë të banuara dhe pranë tokës bujqësore. Meqenëse, ka gjatësi të madhe gjatë vërshimeve, shpeshherë shkakton dëme të konsiderueshme. Projekti „Rregullimi i shtratit të lumit “ , ka arsyeshmëri të plotë si në aspektin ekonomik po ashtu edhe në aspektin e sigurisë së popullsisë nga vërshimet.

Realizimi i këtij projekti do të parandalonte përmbytjen e tokave bujqësore dhe do të mbronte vendbanimet, si dhe rrugët nga vërshimet. Gjatë të reshurave të mëdha, lumenjtë “Kriva Reka” dhe i Hogoshtit, rregullisht dalin nga shtrati duke shkaktuar dëme të mëdha materiale.

Rregullimi i shtratit të lumit krijon mundësi të mira edhe për shfrytëzimin e tokës, përgjatë tij për nevoja të bujqësisë.

Lumi “Morava”, i cili kalon nëpër territorin e Komunës së Kamenicës ka rrjedhje mesatare rrethë 6.1m<sup>3</sup>/s . Gjatë stinëve me të reshura, shkakton dëme të mëdha duke dalur nga shtrati dhe vërshuar një numër të madh të tokave bujqësore. Dëmtimi i argjinaturave nga faktori natyror dhe antropogjen ndikon në rritjen e shkallës së rrezikshmërisë së vërshimeve, sidomos në fshatrat Petroc, Ranillug, Korminjan i Epërm, Korminjan i Poshtëm, Crep dhe tek Dheu i Bardhë.

Faktorët që ndikojnë në rritjen e shkallës së rrezikshmërisë nga vërshimet janë :

Çrregullimi natyror i shtratit të lumit (nxjerrja ilegale e inerteve);

Ngushtimi i shtratit të lumit nga uzurpimet;

Hedhja e mbeturinave të ngurta në shtretërit e lumenjve;

Mbjellja e bimëve të larta si dhe atyre të vetërritura pranë brigjeve të lumenjve etj.

Shkatërrimi i objekteve hidroteknike dhe moskujdesi i vazhdueshëm (argjinaturat) etj.

### 1.1.11.8 EROZIONI

Erozioni rrezikon natyrën e begatitë e krijuara dhe të planifikuara të njeriut. Ai manifestohet me degradimin e tokës bujqësore dhe pyjore, të bimëve, me bartjen dhe akumulimin e materialit eroziv, i cili ndikon negativisht në tokat bujqësore dhe në vendbanime.

Rreth 6000km<sup>2</sup> ose 56% e territorit të Kosovës, është i rrezikuar nga kjo dukuri natyrore të shkallës së I, II dhe III (I - erozion shumë i fortë, II - erozion i fortë dhe III - erozion i mesëm).

Edhe në territorin e Komunës së Kamenicës është prezent faktori natyror erozioni, që për pasojë ka humbjen e tokës bujqësore dhe dëmet në ekonomitë familjare.

Nga një shkallë e lartë e rrezikshmërisë erozive janë të përfshira 25050 ha ose 48% e sipërfaqes së komunës, që i takojnë shkallës me erozion të fortë dhe shumë të fortë. Shkalla e rrezikshmërisë është në rritje, si pasojë e faktorëve natyror dhe faktorit njeri. Nga shkalla më e lartë e rrezikshmërisë që e ka kategoria e erozionit shumë të fortë, janë të përfshirë 11550 ha tokë.

| Shkalla e erozionit   | Sip.ha | %  |
|-----------------------|--------|----|
| Pa erozion            | 0      | 0  |
| Erozion shumë i dobët | 0      | 0  |
| Erozion i dobët       | 11550  | 22 |
| Erozion i mesëm       | 15900  | 30 |
| Erozion i fortë       | 13500  | 26 |
| Erozion shumë i fortë | 11550  | 22 |

Tab.24. Shkalla e erozionit

Erozioni është njëri prej faktorëve mjaft të rëndësishëm për t'u trajtuar, ngase rrezikon sipërfaqet bujqësore, infrastrukturën, por edhe të mirat e krijuara dhe të planifikuara nga faktori njeri. Kjo dukuri është e pranishme, pothuaj se në tërë territorin e Komunës së Kamenicës në forma dhe madhësi të ndryshme. Përsheptimin e kësaj dukurie në shumë raste e ka luajtur edhe faktori njeri, si rezultat i mosshfrytëzimit racional të tokave bujqësore, prerjes së pa kontrolluar të pyjeve, por edhe gjatë shfrytëzimit të pa kontrolluar të materialeve inerte dhe ndërtimore. Më tepër prezent është mbi formacionet molasike, si rezultat i degradimit të pyjeve, vegjetacionit dhe pjerrtësisë së terrenit, i cili paraqitet në formë të shpëlarjeve sipërfaqësore dhe lugjeve rrëke, por edhe përgjatë brigjeve të shtretërve të lumenjve, përrenjve, përdorimit të pa përshtatshëm të tokës, mosndërtimit të pritave malore etj.

#### **Erozioni në Komunën e Kamenicës**

Faktorët që ndikojnë në shkallën e lartë të erozionit janë :

Kushtet meteorologjike

Pjerrtësia e terrenit

Përbërja gjeologjike

Flora dhe fauna

Shkatërrimi i pyjeve

Shfrytëzimi i inerteve etj.

Shfrytëzimi jo racional i resurseve natyrore

Mënyra e shfrytëzimit të tokave bujqësore

**Rekomandimet për erozion :**

Meliorimi i pyjeve

Ndërtimi i brezave mbrojtës në shpatiet e rrëpishme (tatëpjetat e mëdha);


Parandalimi i prerjes ilegale të pyjeve etj.

Tokat që kanë pjerrtësi të terrenit mbi 15% të mbillen me kullosa ose edhe me pyje.



Masa mbrojtëse anti erozive :Ndërtimi i pritave Hogosht 2007

Erozioni është njëri prej faktorëve mjaft të rëndësishëm për ta trajtuar, nga se rrezikon sipërfaqet bujqësore, infrastrukturën, por edhe të mirat e krijuara dhe të planifikuara nga faktori njeri. Kjo dukuri është prezente, pothuaj se në tërë territorin e Komunës së Kamenicës në forma dhe madhësi të ndryshme. Përshpejtimin e kësaj dukurie në shumë raste e ka luajtur edhe faktori njeri, si rezultat i mosshfrytëzimit racional të tokave bujqësore, prerjes së pa kontrolluar të pyjeve, por edhe gjatë shfrytëzimit të pa kontrolluar të materialeve inerte dhe ndërtimore. Më tepër prezent është mbi formacionet molasike si rezultat i degradimit të pyjeve, vegjetacionit dhe pjerrtësisë së terrenit, i cili paraqitet në formë të shpëlarjeve sipërfaqësore dhe lugjeve rrëqe, por edhe përgjatë brigjeve të shtretërve të lumenjve, e përrenjve, përdorimit të pa përshtatshëm të tokës, mos ndërtimi i pritave malore etj.




Graf.13. Shkalla e erozionit në Komunën e Kamenicës



**VËRSHIMET DHE EROZIONET  
FLOODING AND EROSION  
POPLAVE I EROZIJE**

**LEGJENDA / LEGEND/ LEGENDA**

-  Kufiri Komunal
-  Lumë, rrjedhë, përrua
-  Vërshimet
-  Erozioni sh. i Fortë
-  Erozioni i Fortë
-  Erozioni i Mesëm
-  Erozioni i Dobët



Burimi i të dhënave: Agjencia Kadastrale e Kosovës  
Institucionet e Komunës së Kamenicës  
Grupi për Shfrytëzim të Tokës dhe Mjedis  
Plani Hapësinor i Kosovës

Projected Coordinate System: KosovaRef01  
Projection: Transverse\_Mercator  
Geographic Coordinate System: GCS\_ETRS\_1989  
Datum: D\_ETRS\_1989  
Prime Meridian: Greenwich  
Angular Unit: Degree



Harta.21. Vërshimet dhe Erozionet në Komunën e Kamenicës

## **1.1.12.0 ZHVILLIMI EKONOMIK**

### **1.1.12.1 BUJQËSIA**

KU GJENDEMI ?

#### **Gjendja momentale e zhvillimit të komunës**

Ekonomia në Komunën e Kamenicës është në gjendje mjaft të vështirë. Shumica e ndërmarrjeve janë tregtare, pak prodhuese, të cilat punojnë me kapacitete te vogla. Këto ndërmarrje nuk kanë mundur ti rrisin kapacitetet prodhuese dhe numrin e punëtorëve. Procesi i privatizimit nuk ka dhënë rezultate të pritura. Mungesa e mjeteve financiare, kushtet e pavolitshme të kreditimit, politika fiskale joadekuate, stimulimi jo i mjaftueshëm në bujqësi, janë problem për bujqësi e gjithashtu drejtpërdrejt në ekonomi. Industria është në nivel të ulët, ku të ardhurat nga kjo sferë janë te ulëta.

Punësimi është një prej sfidave për autoritetet vendëse, ku nuk shihet ndonjë përpjekje për hapjen e kapaciteteve, të cilat do të punësonin një numër më të madh të punëtorëve e veçanërisht e të rinjve dhe grave si kategori më të prekura. Migrimi drejt qytetit apo depopullimi i zonave rurale, në mënyrë të drejtpërdrejtë po ndikojnë në zvogëlimin e numrit të fermave. Një ndër problemet që duhet theksuar është se, të rinjtë nuk duan të merren me bujqësi. Të rinjtë më tepër janë të orientuar të migrojnë jashtë vendit, kurse të vjetrit nuk mund të punojnë në bujqësi në mënyrën e duhur. Komuna e Kamenicës ka resurse për zhvillimin e pemëtarisë perimtarisë, blegtorisë, bletarisë, për prodhimin e mishit, shpezëtarisë. Gjithashtu, duhet t'i kemi parasysh resurset pyjore, ku mundësojnë kultivimin e frutave të malit dhe bimëve mjekuese, të cilat mund të luajnë një rol të konsiderueshëm në zhvillimin e bujqësisë. Duke pasur para sysh faktin se një sipërfaqe e konsiderueshme e territorit të komunës është pyjore, na mundëson zhvillimin e florës dhe të faunës. Është me rëndësi të përmendet edhe pozita gjeografike e komunës, e cila jep mundësi të komunikimit të njerëzve, të mallit dhe kapitalit me disa komuna të zonës kufitare si, Medvegja, Bujanoci e tj.

Gjuetia është mjaft e zhvilluar. Prodhimi i mjaltit dhe produkteve të tjera të mjaltit, mund të japë rezultate të mira pasi që kemi njohës të mirë të kësaj veprimtarie, si dhe kushtet klimatike, bashkë me laramaninë bimore krijojnë kushte të mjaftueshme për kultivimin e bletëve.

Mund të mendohen edhe mënyra për kultivimin e peshkut, pasi që lumenjtë e përshkojnë komunën në dy anët e saj.


Qyteti ka pasur një rritje dhe ekspansion viteve të tetëdhjeta, kur kanë funksionuar kapacitetet prodhuese. Ky vrull viteve të fundit ka stagnuar, sepse destinimi i lëvizjes së popullatës është Prishtina dhe Gjilani. Në qytet problem është mosfunksionimi i kapaciteteve prodhuese, dëmtimi i tokës bujqësore, mungesa e deponisë për mbeturina dhe mungesa e nxemjes qendrore. Megjithatë, rreth 60% e popullatës jeton në zona rurale dhe merret me bujqësi. Mekanizmi bujqësor është i vjetruar, parcelat (ngastrat) punuese janë të vogla, mungojnë kooperativat dhe profilimi i bujqve, gjë që tregon për nivelin jo të mirë të bujqësisë.

Raporti përmbledhës i shfrytëzimit të tokës për Komunën e Kamenicës

|    |                       |            |
|----|-----------------------|------------|
| 1  | Fabrika               | 0.3783     |
| 2  | Shtëpi                | 68.6551    |
| 3  | Oborre                | 155.9512   |
| 4  | Rrugë                 | 450.5921   |
| 5  | Rrugë te rendit I     | 0.01       |
| 6  | Rrugë të rendit III   | 0.2129     |
| 7  | Rrugë private         | 39.3058    |
| 8  | Lumë                  | 416.8003   |
| 9  | Përrua                | 74.5763    |
| 10 | Jaz                   | 3.4454     |
| 11 | Kanal                 | 0.3005     |
| 12 | Rrugë III             | 1.7099     |
| 13 | Mbrojtje lumi         | 2.6750     |
| 14 | Vend eksploatues rëre | 4.15963    |
| 15 | Kishë                 | 0.0627     |
| 16 | Fushe sportive        | 0.3138     |
| 17 | Varreza               | 44.2855    |
| 18 | Xhami                 | 0.0517     |
| 19 | Shkollë               | 1050       |
| 20 | Greminë               | 15.2407    |
| 21 | Treg                  | 2.500      |
| 22 | Gurishte              | 23.25717   |
| 23 | Kanal-transhe         | 0.0        |
| 24 | Mulli uji             | 0.0884     |
| 25 | Jo pjellore           | 103.4894   |
| 26 | Kënetë                | 1.4756     |
| 27 | Të tjera              | 20.2946    |
| 28 | Objekt ushtarak       | 0.0        |
| 29 | Ara                   | 12284      |
| 30 | Kopsht                | 20.3372    |
| 31 | Pemishte              | 197        |
| 32 | Vreshtë               | 1.0        |
| 33 | Livadhe               | 2842.3312  |
| 34 | Kullosa               | 7365.3691  |
| 35 | Mal                   | 16510.1305 |
|    |                       |            |

Tab.25.Shfrytëzimi i tokës (ha)

Në Grafik 11 është dhënë shkalla e bonitetit të tokave të komunës së Kamenicës, ku sipas këti rafikoni shifet se pjesa më e madhe e tokës përbëhet nga boniteti i klasës VI 46 %, pastaj klasa V dhe VII me 14%, kurse tokë më pjellore të klasit II ka 5%.



Graf.14. Ndarja e tokave sipas bonitetin në përqindje (%) dhe hektar (ha) në K. E Kamenicës sipas udhëzimeve të FAO (1976, 2007)

Komuna e Kamenicës ka një sipërfaqe prej 417 km<sup>2</sup> tokë, prej së cilës 39199.8308 ha është tokë bujqësore dhe male.


|                        |                     |
|------------------------|---------------------|
| Tokë e punueshme – ara | 12284 ha            |
| Kullosa                | <b>7365.3691ha</b>  |
| Livadhet               | <b>2842.3312ha</b>  |
| Pemë dhe perime        | 197 ha              |
| Vreshta                | 1.0 ha              |
| Male                   | <b>16510.1305ha</b> |
| <b>Totali</b>          | <b>39199.8308ha</b> |

Tab. 26. Sipërfaqja bujqësore dhe ajo malore:



Në mbjelljet vjeshtore toka kryesisht mbillet me grurë, për derisa në mbjelljet pranverore me misër dhe bimë foragjere .

- Me drithëra : 6070 ha:
- Grurë 2650 ha,
- Misër 3400 ha,
- Tërshërë 340 ha,
- Elb 20 ha.
- Duhan 20 ha



Graf.15. Sipërfaqja e mbjellë dhe rendimenti


| KULTURAT        |                   |                 |                   |
|-----------------|-------------------|-----------------|-------------------|
| GRURI           |                   | MISRI           |                   |
| SIPËRFAQJA (HA) | PRODHIMITARIA (T) | SIPËRFAQJA (HA) | PRODHIMITARIA (T) |
| 2650            | 10600             | 3400            | 15300000          |

Tabela. 27. Prodhimtaria e grurit dhe misërit ne Komunën e Kamenicës në 2011

Burimi: Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore 2011

| Lloji i kafshëve | Sasia në krahë |
|------------------|----------------|
| Lopë             | 7601           |
| Dele             | 5455           |
| Dhi              | 901            |
| Derra            | 1752           |
| Kuaj             | 41             |
| Shpezëtari       | 45.900         |
| Bletë            | 4000 koshere   |

Tab. 28. Lloji i kafshëve dhe sasia



Graf. 16. Numri i kafshëve nëpër vendbanime

| Nr: | Lloji i Fermave                        | Numri i tyre |
|-----|--|--------------|
| 1   | Ferma të lopëve qumështore mbi 5 krerë | 360          |
| 2   | Fermat e lopëve 1-5 krerë              | 4100         |
| 2   | Ferma të dhenëve                       | 90           |
| 3   | Ferma të dhive                         | 23           |
| 4   | Fermat e pula vojse                    | 3            |

Tab. 29. Lloji i fermave dhe numri i tyre

|          |      |
|----------|------|
| Kamenica | 4500 |
|----------|------|

Tabela. 30. Numri i ekonomive bujqësore në Komunen e Kamenicës

| Sipërfaqja e ujitur (ha) | % e tokës së ujitur | % e tokës së përgjithshme të ujitur në Kosovë |
|--------------------------|---------------------|---|
| 0                        | 0                   | 3.4   |

**Tabela. 31. Ujitja e tokës së kultivuar në Komunen e Kamenicës (nuk kemi sistem te ujitjes)**

Siç e theksuam edhe më herët, privatizimi nuk ka dhënë rezultate të pritura. Është zhvilluar shumë ngadalë, ndërmarrjet dhe kapacitetet prodhuese janë shitur me çmime mjaft të ulëta, kapacitetet e shitura kanë ndërruar destinacionin, me mijëra punëtorë që më herët kanë punuar, kanë mbetur pa punë, faktorë që rëndojnë situatën ekonomike në Kamenicë.

Komuna për momentin nuk posedon plane zhvillimore sektoriale, gjë që do të nxisnin një zhvillim më të hovshëm

## CILAT JANË SHANSAT (GJASAT) TONA?

### **Faktorët me ndikim, pengesat dhe përparësitë krahasuese për zhvillim.**

Komuna e Kamenicës ka një pozitë të mirë gjeografike, që mundëson zhvillimin e bashkëpunimit ndërkomunal dhe ndërkomunal. Ka resurse të mira natyrore për zhvillimin e disa veprimtarive ekonomike .Sipërfaqet pyjore,,sipërfaqet me ara, me kullosa, me pemë, bimë të ndryshme mjekësore, afërsia me korridoret transportuese, trashëgimia kulturore e arkeologjike, japin mundësi për një zhvillim më të mirë. Pasuritë e tjera tokësore dhe nëntokësore janë benifite për komunën.

### **Mundësitë zhvillimore:**

Krijimi i kushteve për mbështetjen dhe nxitjen e zhvillimit të bujqësisë, si: ndërtimi i pendave me një ndikim shumëdimensional (në bujqësi, turizëm, peshkari, rekreacion e sport, turizëm rural, kampime të ndryshme etj). ndërtimi i kanaleve për ujitje, zgjidhja e problemit të ujit të pijes, mbrojtja e ambientit, subvencionet për fermerë, infrastruktura e përmirësuar për qasje në sipërfaqe të punueshme, themelimin e kooperativave të fermerëve, profilizimi i fermerëve, punktet për grumbullimin dhe ruajtjen e frutave të malit, të pemëve e perimeve, kapacitetet përpunuese për mish ,pemë e perime, bashkëpunimi ndërkomunal dhe nderajonal, ekipi komunal për përgatitjen e projekteve zhvillimore, identifikimi i donatorëve të mundshëm dhe njohja me sferat e tyre të interesit, si dhe me mënyrën e konkurrencës, krijimi i markës lokale për produkte vendëse- të komunës. Gjithashtu, duhet të punohet për mbrojtjen e sipërfaqeve bujqësore, mbrojtjen e tokave nga erozioni, mbrojtjen nga zjarret; pastaj duhet bërë meliorimi e pyllëzimi, mbrojtja e lumenjve dhe shfrytëzimi racional i resurseve natyrore, ku këto janë parakushte për zhvillimin e komunës.

Rritja e bashkëpunimit me organizatat joqeveritare vendëse e lokale dhe përfshirja e fermerëve në vendimarrje, ndikojnë dukshëm në zhvillimin e bujqësisë në veçanti dhe të ekonomisë në përgjithësi.

### **Çka presim në të ardhmen ?**

#### **Vizioni, misioni, qëllimet strategjike dhe vlerat e zhvillimit të komunës**

Komuna e Kamenicës në të ardhmen do të jetë një komunë me ekonomi të zhvilluar ,një ambient për biznese të përmirësuar, me më shumë subvencione për bujqësi, me mjedis të mbrojtur, me trashëgimi kulturore dhe arkeologjike të inventarizuar dhe mbrojtur, me një administrim transparent për qytetarët. Komuna e Kamenicës në mënyrë racionale do të shfrytëzojë resurset e veta natyrore mbitokësore dhe nëntokësore . Atë qytetarët do ta ndejnë si shtëpi të veten.

#### **Zhvillimi ekonomik**

Komuna e Kamenicës do të stimulojë bizneset prodhuese, konkurrenca në tregun vendës dhe cilësor për tregun e jashtëm, do të luftojë ekonominë joformale, do të krijojë logon lokale për identifikimin e produkteve të veta, do të angazhohet për stimulimin, mbrojtjen dhe promovimin e produkteve vendëse.

Me projekte për investime të mundshme, si psh: rritja e sipërfaqeve bujqësore, ndërtimi i kanaleve të ujitjes, ngritja e mundësive për zhvillimin e agroturizmit dhe turizmit në përgjithësi, si dhe rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimarrje, do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik të komunës.

#### **Infrastruktura lokale**

Deponi komunale për mbeturina, vende të përkohshme për mbeturina në nivel lokaliteti apo disa lokalitete, zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit, të kanalizimit, të rrjeteve

elektrike, infrastruktura për rrymë alternative, nxemje me energji alternative, zgjerimi i rrjetit ekzistues të rrugëve dhe ndërtimi i rrugëve të reja, të identifikuara në këtë plan.

### **Administrata komunale**

Kushtet e punës të përmirsuara në objektin e ri komunal, shpenzimet për shërbime të rrymës, ujit dhe mbeturinave të zvoçuara, transparenca e ngritur, staf të trajnuar, përmirsimi dhe rritja e numrit të rregulloreve të komunës, qasja në dokumente zyrtare në nivel më të lartë. Pra, do të krijohen kushte për shërbime më të shpejta dhe më efikase për qytetarët, në përgjithësi komuna do të jetë një organizatë me performancë të lartë.

### **Mbrojtja e tokës**

- Mbëltimin e sipërfaqeve pyjore dhe fushore për mbrojtje nga erozioni;
- Menaxhimi me mbeturina dhe ujëra të zeza;
- Kontrolli i pesticideve në produktet bujqësore dhe zhvillimi i bujqësisë organike;
- Kontrollimi, menaxhimi dhe parandalimi i zjarreve fushore;
- Eliminimi i deponive të egra dhe rikultivimi i tyre;
- Mbëltimin e llojeve të bimëve, përgjatë rrugëve kryesore (që thithin plumbin), në funksion të mbrojtjes së vegjetacionit, si p.sh. plepi i lombardisë, plepi etj.

### **Mbrojtja e ujit**

Me qëllim të parandalimit të ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, qeveria komunale duhet të ndërmarrë këto masa:

- \* Ndërtimi i rrjetit kryesor ( mbledhës) të kanalizimit, në të gjitha vendbanimeve deri te impianti për trajtimin e ujërave të zeza, i cili parashihet të ndërtohet te Dheu i Bardhë;
- \* Lidhja e objekteve industriale në rrjetin e kanalizimit kryesor;
- \* Definimi i zonave mbrojtëse sanitare në vendet rreth puseve-burimeve, të ujit
- \* Kontrollimi i të gjitha puseve që nuk janë në funksion;
- \* Përshtatshmëria e prodhimeve bujqësore me kushtet e mbrojtjes së ujërave nëntokësore;
- \* Plani potencial dhe i qëndrueshëm për përdorimin racional të ujit ;
- \* Parandalimi i derdhjes së ujërave të zeza në ujërat lëvizës (rrjedhës) para trajtimit të tyre.

### **Mbrojtja e ajrit**

Duke e pasur parasysh numrin e madh të makinave (automjeteve) dhe mjeteve tjera, me qëllim të mbrojtjes së ajrit nga ndotja, qeveria komunale duhet të ndërmarrë këto masa:

- \* Të gjenden mënyra të përdorimit të mjeteve alternative për transport;
- \* Të ndërtohen shtigje për biçikleta;
- \* Rregullimi i vegjetacionit të gjelbër rreth rrugëve frekuentuese ;
- \* Parandalimi i djegies së mbeturinave dhe mbetjeve fushore në toka bujqësore;
- \* Menaxhimi adekuat me mbeturina medicinale , kimike dhe mbetje të teknologjisë informative.

### **Riciklimi i mbeturinave**

Të gjitha masat për mbrojtjen e mjedisit bazohen në parandalimin dhe mënjanimin e ndikimeve të dëmshme në natyrë. Parandalimi mund të arrihet me aprovimin e rregulloreve komunale, me ngritjen e vetëdijes për mbrojtjen e

ambientit, me respektimin e ligjit, me informim adekuat, si dhe me shqiptimin e gjobave konform ligjit.

### **Qellimet dhe detyrat për mbrojtjen e bujqësisë**


- Zonimi i tokave bujqësore
- Mbrojtja e tokave bujqësore nga ndërrimi i destinacionit, sidomos në atë ndërtimore;
- Mbrojtja e tokës bujqësore nga ndërtimet e egra;
- Racionalizimi i shfrytëzimit të tokës bujqësore në qytet me ndërtimin e objekteve të banimit kolektiv;
- Rritja e sipërfaqeve bujqësore (hapja e sipërfaqeve të mbuluara me shkurre dhe shpyllëzimi i sipërfaqeve me pyje të ulëta);
- Trajnimi i fermerëve për përdorimin e sistemeve të reja informative;
- Trajnimi i fermerëve për hartimin e projekteve zhvillimore të bujqësisë;
- Zhvillimi i bujqësisë organike;
- Ndërtimi i kapaciteteve përpunuese;
- Përmirësimi i kapaciteteve funksionale të sistemeve meliorative;
- Bujqësia e orientuar në zhvillimin ekonomik;
- Grupimi i tokave përmes komasacionit, mundësisht në disa vende, duke i dhënë formë gjeometrike çdo parcele (ngastre), ku secila të ketë qasje me rrugë, prodhimtari të organizuar, mandej profilizimi i bujqëve, aplikimi i masave bashkëkohore agroteknike për shfrytëzim racional të mekanizmit bujqësorë;
- Ndërtimi i sistemeve për ujitje;
- Përmirësimi i mekanizmit bujqësor;
- Ndërprerja e ndarjes së tokave në ngastra të vogla në bazë të rregulloreve përkatëse;
- Ndërtimi i pendave, përgjatë lumit të cilat mund të përdoren për ujitje;
- Parandalimi i përmbytjeve;
- Organizimi i fermerëve në bazë të veprimtarisë (blegtorë, pemëtarë, perimtarë, bletarë, etj.) në kooperativa bujqësore, shoqata të fermerëve, sindikatën e bujqëve;
- Marketing për produktet bujqësore;
- Krijimi i logos identifikuese për produktet e Komunës së Kamenicës
- Grumbullimi, ruajtja, përpunimi dhe shitja e produkteve bujqësore (tregu i ndermjetëm);
- Ngritja profesionale e fermerëve (kurse, trajnime, demonstrime për lëmi përkatëse të bujqësisë, etj.);
- Shtimi i fondit blegtoral si dhe përmirësimi i racave të kafshëve, me qëllim të përmirësimit të sasisë dhe cilësisë së mishit dhe qumështit;
- Shfrytëzimi i kullosave ekzistuese, pra ato të mos shndërrohen në sipërfaqe me shkurre apo pyje të ulëta;
- Ngritja e fidanishteve dhe pemishteve, si: molla, dardha, kumbulla dhe frutat e imëta, si mjedra, lajthia, dredhëza, manaferra e të ngjashme;

- Zgjerimi i kapacitetit të serrave të perimeve, si dhe kultivimi i serrave për kultivimin e luleve;
- Mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale dhe ripyllëzimi i tyre;
- Gjuetia të shërbejë për rekreacion, por edhe për kultivimin e faunës e në veçanti të llojeve që rrezikojnë zhdukjen;
- Njohja me bimët mjekuese si dhe kultivimi i tyre;
- Rregullimi i infrastrukturës nëpër zona rurale, i kontribuon zhvillimit të bujqësisë, si dhe pengon migrimin e popullatës nga fshatrat në drejtim të qendrave më të mëdha.

Komuna e Kamenicës ka një sipërfaqe prej 417 km<sup>2</sup> tokë, prej së cilës 39199.8308 ha është tokë bujqësore dhe male.  
Sipërfaqja bujqësore dhe ajo malore:

|                               |                     |
|-------------------------------|---------------------|
| <b>Tokë e punueshme – Ara</b> | <b>12284 ha</b>     |
| <b>Kullosa</b>                | <b>7365.3691ha</b>  |
| <b>Livadhet</b>               | <b>2842.3312ha</b>  |
| <b>Pemë dhe perime</b>        | <b>197 ha</b>       |
| <b>Vreshta</b>                | <b>1.0 ha</b>       |
| <b>Male</b>                   | <b>16510.1305ha</b> |
| <b>Totali</b>                 | <b>39199.8308ha</b> |

Tabela. 32.Ndarja e tokës sipas kulturave



Graf.19. Ndarja e tokës sipas kulturave

Sipërfaqet me pyje:


|              |          |
|--------------|----------|
| Pyje private | 9623 ha  |
| Pyje publike | 9118 ha  |
| Shuma        | 18741 ha |



### Zonat e Bujqësisë

### LEGJENDA LEGEND LEGENDA

- Kufi komunal
- Zonë kadastrale
- Blegtoria
- Lavërtaria



Shkalla / Scale / Razmera  
1:150,000

3,700 1,850 0 3,700 Meters

Projected Coordinate System: KosovaRef01  
Projection: Transverse\_Mercator  
Geographic Coordinate System: GCS\_ETRS\_1989  
Datum: D\_ETRS\_1989  
Prime Meridian: Greenwich  
Angular Unit: Degree

Burimi / të dhëna: Agjencia Kadastrale e Kosovës  
Institucionet e Komunës së Kamenicës  
Grupi për Shfrytëzim Tokës dhe Mjedis  
Atlasi Hidroekonomik / AKMM



Harta 22. Tokat bujqësore në Komunën e Kamenicës

### Perimet

Perime mbillen në një sipërfaqe 61.53 ha (patate, domate, spec, lakër, spinaq, karrotë, majdanoz, fasule etj.). Këto kultivohen në fushë të hapur dhe në serra. Në serra kultivohen : speci, domatja, trangulli etj. në një sipërfaqe rreth 12 ha.

### Pemët

Pemët kultivohen në një sipërfaqe rreth 137 ha, (mollë, kumbull, qershi, vishnje, arra, manaferra etj.). Prej kulturave dominante janë molla dhe kumbulla, por vlen të ceket se kemi të mbjella 1.5 ha me manaferra, në 3 fshatra (Kopërnice, Shipashnicë dhe Muçivërc), si kultura demonstruese dhe ku rezultatet janë inkurajuese. Shipashnicë dhe Muçivërc), si kultura demonstruese ku rezultatet janë inkurajuese.

| Lloji    | Viti      | Rendimenti /tona |
|----------|-----------|------------------|
| Patate   | Viti 2010 | 5000             |
| Shalqinj | Viti 2010 | 1500             |
| Specia   | Viti 2010 | 870              |

Tab.33. Lloji i kulturës dhe rendimenti

Bazuar në të dhënat statistikore rreth 60% e buxhetit familjar, e fituar nga të hyrat në bujqësi e që ndahen për shpenzime familjare, e në anën tjetër vetëm 40 % e të hyrave familjare shfrytëzohen për përfitime komerciale.

**Prodhimtaria bujqësore** – Në mbjelljet vjeshtore toka, kryesisht mbillet me grurë, përderisa në mbjelljet pranverore me misër dhe bimë foragjere për blegtori. Kulturat tjera të rëndësishme janë perimet (patatet, shalqiri), etj.

| Prodhimtaria /vit | Grurë / tonë | Miell /tonë | Hime gruri /tonë |
|-------------------|--------------|-------------|------------------|
|                   | 10600        | 6890        | 3710             |

Tab.34. Prodhimtaria e grurit

Shpenzimet e miellit për banorët e komunës në vit janë : 7.800 tona miell/vit. Nga kjo del se komuna në vitin 2010 ka prodhuar miell 6.427,20 tona miell me shumë se kërkesat, kurse me përmirësimet agroteknike për vitin 2009 pritet të kemi rritje të prodhimit të miellit deri 12.616 tona tepriçë mielli për banor.<sup>5</sup>

| Sipërfaqe e mbjellur | Rendimenti i arritur     | Viti 2010   |
|----------------------|--------------------------|-------------|
| 2650ha               | 4000kg/ha                | 10600 tona  |
|                      | Rendimenti i planifikuar | Viti 2011   |
| 2650ha               | 4000/kg.                 | 10600/ tona |

Tab.35. Sipërfaqja e mbjellë dhe rendimenti

Prodhimtaria e drithërave sillet diku prej 3500-4000 kg./ha, kurse e perimeve në varësi preje kulturave:

Patate : 15000-20000 kg.

Shalqiri : 10000 – 20000 kg.



### 1.1.12.2 INDUSTRIA

Në komunë gjatë viteve 1970-90 shënohet një zhvillim i theksuar industrisë dhe tregtisë. Industria në komunë është bazuar në eksploatim dhe përpunim të pasurive ekzistuese minerale. Mbështetur në këto resurse në të kaluarën në komunë janë ngritur kapacitetet prodhuese të tyre, me ç'rast është punësuar edhe një numër i konsideruar i punëtorëve.

Ndërmarrjet industriale në të cilat është mbështetur ky zhvillim, kryesisht të sektorit shoqëror. Investimi në zhvillimin e industrisë përpunuese të mineraleve (jo-metaleve dhe metaleve), të materialit ndërtimor dhe ndërtimtarisë, konsiderohen të jenë mbështetje e mirë për zhvillim ekonomik dhe punësim në komunë.

Nevojat për investime në këtë drejtim, janë të larta dhe për momentin të përaulizueshme. Por në periudhën strategjike në vazhdim, besohet që komuna në partneritet me sektorin privat dhe investitorët eventuale, do të fillojë me investime në këtë drejtim.

**Pasuritë natyrore:** Kaolini, magneziti, andeziti, bentoniti, kuarci, hekuri, tufi, rëra, etj. janë disa nga mineralet me të cilat është e pasur Komuna e Kamenicës. Sipas ekspertëve të kësaj fushe, rezervat ekzistuese të këtyre mineraleve garantojnë eksploatim të gjatë të tyre. Për qëllime të eksploatimit e të njëjtave, në komunë janë të vetëdijshëm se, nevojiten investime kapitale, të cilat komuna për momentin nuk i ka, mirëpo por kjo strategji do të realizohet me sektorin privat. Ky synim mund të arrihet duke krijuar kushte të volitshme për investitorë të huaj dhe të vendit.

| NR. | XEHE      | SASIA                  | NR. | XEHE      | SASIA                  |
|-----|-----------|------------------------|-----|-----------|------------------------|
| 1.  | Magneziti | 1.3mil/t               | 8.  | Tufi      | 665.000t               |
| 2.  | Andeziti  | 635.000 m <sup>3</sup> | 9.  | Deltina   | 30.000 m <sup>3</sup>  |
| 3.  | Kaolina   | 3.5 mil/t              | 10. | Gelqerori | 250.000 m <sup>3</sup> |
| 4.  | Bentoniti | 1.2mil/t               | 11. | Graniti   | 1.800 t.               |
| 5.  | Kuarci    | 2.5mil/t               | 12. | Feldspati | 50.000 t.              |
| 6.  | Rëra      | 200.000 m <sup>3</sup> | 13. | Zhavorri  | 60.000 t.              |
| 7.  | Hekur     | 50.000 t               |     |           |                        |

**Tab. 36. Resurset minerale në Komunën e Kamenicës**

#### **Pasuri natyrore për komunë konsiderohet edhe:**

fondi prej 24,624 ha tokë bujqësore, e përshtatshme për kultivim të pothuajse e të gjitha llojeve të kulturave bujqësore, si dhe për shfrytëzim të tyre si kullosa.

Fondi prej 18.741 ha tokë me pyje, që siguron ambient të këndshëm dhe të shëndosh për komunitetin, si dhe zhvillim të aktiviteteve ekonomike.

shtrirja e katër lumenjve (Kriva Rekë, Desivojcë, Hogosht dhe Morava) në territor të komunës konsiderohet një pasuri tjetër me vlerë, që gëzon Kamenica.

**Ndërmarrjet shoqërore:** Ekonomia lokale si edhe e tërë vendit në të kaluarën është zhvilluar kryesisht në sektorin shoqëror. Nga ndërmarrjet shoqërore, të cilat ishin bartëse të zhvillimit ekonomik në komunë, duhet përmendur ndërmarrjen për prodhimin e pllakave të qeramikës XIQ “Karaçeva”, fabrika për eksploatim dhe përpunim të xehes së magnezitit XIM “Strezoci”, ndërmarrja për prodhimin e materialit ndërtimor, ishte një tjetër ndërmarrje që punonte me sukses dhe që punësonte numër të konsiderueshëm të punëtorëve. Pos këtyre, në Kamenicë qenë edhe 15 ndërmarrje të tjera, të cilat mbanin barrën kryesore të zhvillimit ekonomik të komunës.

### Lista e tyre

1. **XIQ “ Karaçeva”**- Fabrika për prodhimin e pllakave të qeramikës ,
2. **XIM “ Strezoci”** – F. për eksploatimin e sintermagnezitetit,
3. **NN.” Betoni “ ish “Trajko Periq”** me njësinë për prodhimin e tjegullave,
4. **NSH. “ Kaolini “**- Eksploatimi i kaolinit
5. **NSH”Imkos”**-Përpunimi i metaleve
- 6 **NT.” Qëndresa” ish “Morava”** tregtare
6. **NTr. “ Kosovatrans”**- Transport i udhëtarëve,
7. **KB.Agroprodukti ish “Kriva Reka”** Kamenicë -Kooperativë prodhuese bujqësore,
8. **KB. „Bujku”** Rogaçicë– Kooperativë kooperuese
9. **KB. “ Përparimi”** Hogosht-Sh. bujqësore
10. **KB. “ Strezoc”** në Strezoc.- Sh. bujqësore,
11. **KB. “ Zhivko Vasiq”** në Ranillug Sh. Bujqësore ( lokalitet serb)
12. **Ekonomia e pyjeve-** Kamenicë
13. **Hoteli “ Mineral”**- Kamenicë
14. **NSH. “ Pionier”** Crep – konfeksion – tekstil.
15. **NP.”Higjiena “** –Shërbime publike
16. **Stacioni i vetëreinës**-Sh. vetëreinare
- 17 **Elektrokosova-** elektro shërbime.
- 18 **PTK-ja**

Pas vitit 1999 gjendja në ekonominë shoqërore-publike u keqësua shumë. Ajo plotësisht ishte jashtë funksionit dhe e dëmtuar. Që nga viti 2000 me pronën shoqërore të komunës, menaxhon AKM-ja. Sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12 e plotësuar me Rregulloren 2005/18, AKM-ja tash AKP-ja si aktivitet primar ka privatizimin, likuidimin e ndërmarrjeve shoqërore, si dhe ristrukturimin (konsolidimin/korporatizimin) e atyre publike.

#### **Nga ndërmarrjet shoqërore të theksuara më lartë janë privatizuar:**

XIQ “Karaçeva”, NN “Betoni”, Miniera “Kaolini”, NSH “Imkos” , NSH ”Pioner” , NT ”Qëndresa”, KB “Bujku”, NT. “Kosovatrans”. Është privatizuar edhe NSH XIM ”Strezoci”, e vetmja me spinof special, por për shkak të mos plotësimit të kushteve të kontratës nga ana e blerësit, kjo ndërmarrje është ritenderuar. Procesi në fjalë po rrjedh, mjaft ngadalë dhe me shumë pa rregullsi. Kjo situatë në përgjithësi po e ngadalëson zhvillimin ekonomik të komunës. Edhe pas privatizimit asnjë nga ndërmarrjet shoqërore, nuk është aktive dhe shumë prej tyre u është ndërruar destinimi.

#### **1.1.12.3 TREGTIA**

Pas luftës në Kosovë, në përgjithësi u orientua zhvillimi ekonomik duke u bazuar në ekonominë e lirë dhe të tregut. Numri i subjekteve afariste në sektorin privat para vitit 1999 ishte simbolik, andaj edhe ndonjë informacion i saktë për numrin dhe strukturën e tyre nuk ekziston.

Pas vitit 1999 sektori privat ka përjetuar një ekspansion të vërtetë në komunë, por jo në mënyrë të organizuar dhe jo me ndonjë strategji të mirëfilltë zhvillimore. Në Komunën e Kamenicës janë të regjistruara rreth 1850 subjekte afariste të profileve të ndryshme. Nga ky numër i subjekteve të regjistruara, veprojnë afërsisht 1,008 sosh, ndërsa të tjerat janë pasive (për arsye të ndryshme). Në sektorin privat, biznesi kryesisht zhvillohet në dy fusha, në tregti dhe shërbime. Nga numri i përgjithshëm i bizneseve të regjistruara 462 janë tregtare. Shitja me pakicë dhe shumicë, janë forma

përmes të cilave kjo tregti realizohet. Sipas një evidence interne në komunë , numri i të punësuarve në sektorin privat është rreth 2000 punëtorë. Në Komunën e Kamenicës veprojnë dhe tri tregje publike ditore, si: Tregu i Gjelbër në Kamenicë , i menaxhuar nga Nd. Shërbyese “Higjiena”, ndërsa Tregu i Gjelbër në Rogaçicë i menaxhuar nga Nd. Private “ Nd. e Re “Bujku” , si dhe tregu i kafshëve N.Private “Atalanta”. Numri i subjekteve aktive afariste dhe struktura e tyre, është prezentuar në tabelën në vijim:

**Subjektet afariste aktive 1008 e ato janë:**

Subjekte af. 843 dhe  
Autotaxi 165

| Nr              | Nacionaliteti | Numri i Bizneseve | Meshkuj     | Femra     |
|-----------------|---------------|-------------------|-------------|-----------|
| 1.              | Shqiptarë     | 902               |             |           |
| 2.              | Serbë         | 97                |             |           |
| 3.              | Romë          | 7                 |             |           |
| 4.              | Anglez        | 1                 |             |           |
| 5.              | Kinez         | 1                 |             |           |
| <b>Gjithsej</b> |               |                   | <b>913</b>  | <b>95</b> |
| <b>Totali</b>   |               |                   | <b>1008</b> |           |

| Përshkrimi    | Nr. | %     |
|---------------|-----|-------|
| Tregëtare     | 462 | 45.84 |
| Zejtare       | 138 | 13.70 |
| Transportuese | 171 | 16.96 |
| Shërbyese     | 111 | 11.01 |
| Hoteliere     | 80  | 7.94  |
| Ndërtimore    | 26  | 2.58  |
| Prodhuese     | 18  | 1.78  |
| Rekreative    | 2   | 0.19  |

**Tab.37. Struktura e subjekteve afariste**

Shumica e subjekteve afariste i takojnë tregtisë dhe shërbimeve. Këto subjekte kanë dhënë kontributin e tyre në furnizimin e qytetarëve me artikuj themelor dhe kanë punësuar numër të konsideruar të punëtorëve. Megjithatë, mendojmë se qysh tash janë plotësuar dhe tejkaluar nevojat për këto veprimtari.

Në të ardhmen qeveria komunale, duhet të përqendrohet në krijimin e kushteve për hapjen e NMV-e e sidomos atyre prodhuese.

**1.1.11.1 ZEJTARIA**

Vazhdon të mbetet një fushë e rëndësishme për zhvillim ekonomik edhe në komunën e Kamenicës. Ekzistimi i një përvoje të konsiderueshme në veprimtaritë zejtare, qoftë në zejtarinë prodhuese, shërbyese, artistike dhe të artizanateve, që konsiderohet si një përparësi për zhvillimin ekonomik.

| Vendi     | Përshkrimi    | Nr | Vendi            | Përshkrimi        | Nr |
|-----------|---------------|----|------------------|-------------------|----|
| Kamenicë  | Argjendari    | 1  | Koretin          | Auto elektrikist  | 2  |
|           | Autolarje     | 5  |                  | Auto mekanik      | 4  |
|           | Automekanik   | 3  |                  | Axhustator        | 2  |
|           | Elektroservis | 3  |                  | Frizer (ondulues) | 2  |
|           | Bluarje kafe  | 1  |                  | Auto laker        | 2  |
|           | Fotografist   | 3  |                  | Sharrë e druve    | 1  |
|           | Frizer/re     | 19 |                  | Zdrukthtar        | 7  |
| Berivojcë | Këpucar       | 2  | Auto elektrikist | 2                 |    |
|           | Rrobaqepës/se | 3  | Automekanik      | 2                 |    |

|                    |                    |          |            |                     |   |
|--------------------|--------------------|----------|------------|---------------------|---|
|                    | Vulkanizer(gomist) | 1        |            | Vulkanizer (gomist) | 1 |
|                    | Xhamprerës         | 1        |            | Auto larje          | 1 |
|                    | Zdrukthëtar        | 3        | Hodonoc    | Autolarje           | 1 |
|                    | Zdr. PVC           | 3        |            | Automekanik         | 3 |
|                    | Instalues          | 1        |            | Frizer              | 2 |
|                    | Axhustator         | 1        |            | Zdrukthëtar         | 1 |
| <b>Karaçevë</b>    | Automekanik        | 1        | Topanicë   | Automekanik         | 1 |
|                    | Axhustator         | 1        |            | Zdrukthëtar         | 1 |
| <b>Shipashnicë</b> | Automekanik        | 1        |            | Zdr. PVC            | 1 |
|                    | Sharrë             | 1        | Velegllavë | Sharrë              | 1 |
| <b>Hogosht</b>     | Frizer             | 2        | Tërstenë   |                     | 1 |
|                    | Zdrukthtar         | 2        |            |                     |   |
| <b>Rogaçicë</b>    | Argjendari         | 1        | Rogaçicë   | Frizer /re          | 8 |
|                    | Autolarje          | 4        |            | Rrobaqepës          | 1 |
|                    | Automekanik        | 4        |            | Xhamprerës          | 1 |
|                    | Axhustator         | 2        |            | Zdrukthëtar         | 2 |
|                    | Elektro servis     | 1        |            | Zd. PVC             | 1 |
|                    | <b>Fotografist</b> | <b>1</b> |            |                     |   |

Tab. 38. Zejtaria, profili i aktiviteteve dhe shpërndarja:

#### 1.1.12.5 TURIZMI

Në Komunën e Kamenicës, aktualisht nuk ka objekte si dhe infrastrukturë të nevojshme për ta zhvilluar turizmin.

Në sektorin privat pas përfundimit të luftës janë rregulluar gjithsej 2 pishina, të cilat veprojnë gjatë stinës së verës, mirëpo edhe ato në mungesë të eksperiencës e këshillave profesionale, nuk janë në nivelin e duhur dhe nuk i kanë të respektuara normat për zhvillimin e këtyre aktiviteteve në përmasa më të gjera- të turizmit.

Në këtë kontekst paraqitet nevoja e ndërtimit të një kompleksi të gjerë hoteliere-spitalore, duke u bazuar në kapacitete komunale si në Gmicë dhe Kikë me një pozitë gjeografike të mirë, për terrene rehabilituese dhe sportive, që do të ndikojë në ngritjen e nivelit të zhvillimit të turizmit. Këto hapësira ka mundësi të zhfrytëzohen gjatë stinës së verës dhe dimrit për zhvillimin e sporteve në ecje, kampingje malore, si dhe forma të ndryshme të rehabilitimit.

Në Komunën e Kamenicës për aktivitetet dhe investimet për zhvillimin e turizmit gjatë stinës së dimrit, potencial relevante janë edhe fshatrat për rreth majës së Kikës, Gmicës, Kranidellit me rrethina, ku japin mundësi të arsyeshme për investime në objekte hoteliere, për qendër të skijimit dhe turizëm veror. Pra, të gjitha këto që i përmendëm bëjnë pjesë në viset malore, të cilat kanë bukuri të rralla.

Të gjitha këto pjesë malore, mundësojnë zhvillimin dhe kultivimin e kulturës së gjahut me kafshë të egra, të cilat i përshtatën jetës në viset malore. Aktualisht, kemi praninë e tyre të mirë, ndërkaq forma e zhvillimit të aktivitetit të gjahut në komunën tonë, është e egër dhe e pa ligjshme. Këto veprime kanë shkaktuar destabilizim total të këtij sporti në komunën tonë.

Zhvillimin e kulturës së gjuetisë në komunën tonë mund ta zhvillojmë në pjesët kodrinore-malore. Pra, pozita gjeografike, në një shtirje mjaft të gjerë, veçmas në fshatrat a ndërmjet tyre, si Desivojcë, Kolloleq, Kranidell, Tugjec etj. ofrojnë mundësi ideale për zhvillimin e gjuetisë.

Në Komunën tonë mund të zhvillohet edhe kultura e peshkimit rekreativ, pasi që në lumenjtë e komunës sonë ka lloje të mjaftueshme të peshkut. Mirëpo në këtë drejtim, mungojnë aktivitetet në kultivimin e llojeve të ndryshme të peshkut.

Të luftohen dukurit të cilat dëmtojnë ambientin dhe ndotin lumenjtë, ku pa mundësojnë (pengojnë) zhvillimin e peshktarisë dhe kultivimin e peshkut. Ndërtimet në formë të egër, kanalizimet e pa trajtuara, derdhja e ujërave të zeza në lumenj, shfytëzimi jo adekuat i zhavorrit, është veprim alarmant ku duhet të ndërmerren masa të menjëhershme që të ndërpriten këto dukuri negative, me qëllim që ti shpëtojmë lumenjtë natyralë, gjallesat në ujera dhe të ngremë kulturën e turizmit edhe në peshkim. Mundësi për ndërtimin e pishinave për kultivimin e peshkut ka në vendet e rrafshata, sidomos rreth lumenjve si në; Hogosht, Shipashnicë, Kriva Rekë.

Në Komunën e Kamenicës ekziston qendra sportive e mbyllur e pa përfunduar, që në të ardhmen mund të shfrytëzohet gjatë stinës së dimrit, prandaj është më së e domosdoshme që objekti i tillë të kompletohet me gjithë infrastrukturën përcjellëse. Ky objekt kompleks sportiv do ti kishte plotësuar nevojat e qytetarëve të Komunës së Kamenicës për zhvillimin e rekreativitetit sportiv gjatë dimrit. Për shkak të hapësirës që ka duhet të ndërtohen edhe fusha të ndryshme sportive të në terrene të hapura.

#### **1.1.12.6 ENERGJETIKA**

Problem kryesor në gjendjen e tanishme të furnizimit me rrymë elektrike në Kamenicë sikur edhe në tërë Kosovën, është mungesa e sasisë së nevojshme me energji elektrike. Arsye për këtë është mungesa kapaciteteve prodhuese, kapacitetet e vjetëruara (termoelektranat e Kosova-s A dhe Kosova-s B), pastaj rrjeti i amortizuar i shpërndarjes dhe humbjet e mëdha që në një masë të madhe janë pasojë e mospaguarjes së shërbimeve nga ana e konsumatorëve. Problemi i energjisë, ndikon në hezitimin e investitorëve të huaj që të investojnë edhe në komunën e Kamenicës, si njëra nga mundësitë për ringjalljen e ekonomisë.

Prodhimi i energjisë elektrike është më i vogël se kërkesat e konsumatorëve, që do të thotë se është e nevojshme të ndërtohen kapacitete të reja prodhuese me çka do të përmirësohej furnizimi i konsumatorëve. Si rrjedhim i këtyre veprimeve do të krijohej mundësia e këmbimit të energjisë me rajonin.

Kapacitetet e vjetruara janë ndotës të ambientit, prandaj kapacitetet e reja do të duhej të kenë komponentën mjedisore. Ngritja e kapaciteteve të reja do të mundësonte furnizimin e sigurtë me energji elektrike të zonave të zhvillimit ekonomik. Janë në ndërtim e sipër kapacitetet energjetike me erë në Kikë. Gjithashtu, me ngritjen e pendave për furnizim me ujë në komunën tonë, mund të ngriten hidrocentrale për prodhimin e energjisë elektrike.

Tani planifikohet termocentrali i ri "Kosova e re" me 2000 MW. Në të ardhmen planifikohet që të shfrytëzohen edhe energjitë alternative (era, dielli, energjia gjeotermale, mbeturinat etj.).

### 1.1.12.7 ZHVILLIMI I PABARABART EKONOMIK

Komuna e Kamenicës shtrihet në pjesën lindore të Kosovës , ku ka një sipërfaqe prej 417 km<sup>2</sup>. Ajo ka 58 vendbanime, me numër të popullsisë rreth 40224 banorë. Dendësia e banorëve për një kilometër katror është 107.5 banorë/km<sup>2</sup>. Para periudhës së luftës në Komunën e Kamenicës kanë qenë disa ndërmarrje kryesisht industriale që ishin funksionale, si :“Sintermagneziti” Kamenicë – Berivojcë, “Qeramika” – Berivojcë, fabrika e materialit ndërtimor në Crep dhe “Trepça Plast” në Topanicë. Prej tyre vetëm fabrika e materialit ndërtimor punon edhe sot e kësaj dite, si dhe “Trepça Plast”, e cila tani është fabrikë e birrës. Komunën e Kamenicës e përshkruajnë rrugë të nivelit nacional, regjional dhe sigurisht edhe rrugët lokale. Kjo komunë kufizohet me komunat shqiptare të Serbisë Jugore, siç janë Bujanoci dhe Medvegja. Gjithashtu, në këtë komunë ndodhet pika doganore e Konçulit, ku në vitin 2005 janë realizuar rreth 50 milion EURO nga Shërbimi Doganor i Kosovës. Nga 58 vendbanime gjithsej që ka Komuna e Kamenicës, në tetë vendbanime nuk ka asnjë lloj biznesi, 11 prej tyre kanë nga një biznes, 5 kanë nga 2-3 biznese dhe 28 prej tyre kanë mbi 4 biznese të përqendruara në vendbanim. Numri më i madh i bizneseve është i përqendruar në kryeqendrën komunale, Kamenicë(349), Rogaçicë(128) dhe Koretin(69). Përveç bizneseve të vogla e të mesme, të cilat janë pjesa aktive dhe kryesore e jetës në Komunën e Kamenicës, një rol shumë të madh luan edhe diaspora e kësaj ane e cila jeton dhe punon në botën perëndimore. Prania e tyre gjatë stinës së verës, ndikon dukshëm në qarkullimin e biznesit, sidomos në tregti dhe hotelieri. Është me rëndësi të theksohet edhe roli i madh në investime që bëhen nga ajo, sidomos në ndërtimtari dhe objekte afariste. Bazuar në regjionalizimin e Kosovës sipas potencialit të zhvillimit ekonomik, Komuna e Kamenicës është në grupin e komunave me zhvillim mesatar, sikurse komuna e Vitisë, Lipjanit, Klinës, Suharekës, etj. Sipas sektorëve të veprimtarive ekonomike, sektori i terciar është më i zhvilluar, me pjesëmarrje prej 88.62% të gjitha bizneseve, mandej vie sektori kuartar, me 5.03% te bizneseve. Kjo dëshmon se natyra e ekonomisë në këtë komunë është, kryesisht e mbështetur në ekonomi të vogël ose në biznese të vogla e më pak ne biznese të mesme.

| Sektori | Numri dhe % Bizneseve |
|---------|-----------------------|
| I       | 22                    |
| %       | 2,21                  |
| II      | 33                    |
| %       | 3,32                  |
| III     | 880                   |
| %       | 88,6                  |
| IV      | 50                    |
| %       | 5,03                  |

Tabela .39. Bizneset

Kurse numri më i madh i të punësuarve është po ashtu në sektorin terciar, me 78.37% të numrit të përgjithshëm të të punësuarve, mandej vie sektori sekondar, me 12.23% nga totali (tërësia), kjo pjesëmarrje e bizneseve në këtë sektor, tregon se ndërmarrjet e mesme i takojnë kryesisht këtij sektori

| Sektori | Numri dhe % Bizneseve |
|---------|-----------------------|
| I       | 49                    |
| %       | 3,38                  |
| II      | 177                   |
| %       | 12,23                 |
| III     | 1134                  |
| %       | 78,37                 |
| IV      | 53                    |
| %       | 3,66                  |

Tabela .39. Bizneset

Bazuar ne raportin e MEF, buxheti i komunës së Kamenicës për vitin 2006 ka qenë 4,286,442 euro, ndërsa buxheti i vlerësuar për vitin 2007 është 4,358,779 milion euro, që do të thotë se në vitin 2007 komuna e Kamenicës ka 72,337 mijë euro më shumë se në vitin paraprak. Nëse e ndajmë këtë buxhet për kokë banori për një vit 87.73 euro, kurse shpërndarja për kokë banori për një ditë është 0.24 euro. Raporti në mes të hyrave vetanake dhe granteve qeveritare është shumë i madh; 12.35% e të hyrave vetanake, me 87.65% të granteve qeveritare. Ky tregues tregon se sa e pa fuqishme është komuna ekonomikisht, dhe po të mos ishin grandet qeveritare atëherë për përmbushjen e obligimeve të shpenzimeve operative as që mund të flitej. Numri gjithsej i bizneseve është 993, mesatarja që paguan çdo biznes për një vit në komunën e Kamenicës është 536.5euro. Kjo është shuma që komuna siguron nga të hyrat vetanake, duke mos përfshi tatimet e pronës dhe banimit.

| Regjistri I tokave bujqesore neper zona katastrale |                  |        |        |          |         |          |         |        |
|--|------------------|--------|--------|----------|---------|----------|---------|--------|
| NR   | Fshati           | Ara    | Perime | Pemishte | Livadhe | Gjithsej | Kullosa | Male   |
| 1  | Hajnoc           | 242.21 | 7.52   | 0.48     | 67.17   | 317.38   | 87.76   | 868.05 |
| 2  | Berivojcë        | 337.41 | 2.21   | 14.95    | 13.92   | 368.49   | 132.73  | 231.39 |
| 3  | Billatë          | 69.24  |        |          |         | 69.24    | 34      | 8.47   |
| 4  | Huboc            | 165.78 |        | 12.78    | 14.68   | 193.24   | 170.81  | 61.13  |
| 5  | Bratilloc        | 101.78 |        | 1.24     | 63.57   | 166.59   | 158.14  | 93.73  |
| 6  | Busavatë         | 365.87 | 0.44   | 4.6      | 26.62   | 397.53   | 178.16  | 441.15 |
| 7  | Vaganesh         | 77.24  | 0.71   | 2.54     | 12.47   | 92.96    | 43.4    | 246.51 |
| 8  | Vriçec           | 86.84  | 0.35   | 0.1      | 18.66   | 105.95   | 68.71   | 223.79 |
| 9  | Gmicë            | 204.59 | 1.98   |          | 259.98  | 466.55   | 251.81  | 445.8  |
| 10   | Qarakoc          | 239.24 | 1.29   |          | 6.61    | 247.14   | 93.18   | 5.58   |
| 11   | Velegllavë e P.  | 157.82 | 0.88   |          | 115     | 273.7    | 197.73  | 316.94 |
| 12   | Shipashnicë      | 262.24 | 2.37   | 2.16     | 3.67    | 270.44   | 68.77   | 555.68 |
| 13   | Karaçevë e Ep.   | 401.48 |        | 1.31     | 9.4     | 412.19   | 136.67  | 515.03 |
| 14   | Gragjenik        | 137.5  | 1.09   | 3.1      | 68.54   | 210.23   | 51.84   | 311.54 |
| 15   | Grizime          | 164.69 | 0.35   | 1.71     | 13.99   | 180.74   | 122.31  | 88.37  |
| 16   | Dazhnicë         | 125.3  |        |          | 17.92   | 143.22   | 116.88  | 131.35 |
| 17   | Shahiq           | 51.36  |        |          | 22.38   | 73.74    | 41.9    | 156.13 |
| 18   | Dajkoc           | 178.11 | 1.37   | 2.11     |         | 181.59   | 52.72   | 62.26  |
| 19   | Desivojcë        | 348.1  |        | 3.23     | 133.5   | 484.83   | 196.33  | 873.42 |
| 20   | Velegllavë Ep    | 39.28  |        | 0.17     | 31.67   | 71.12    | 26.94   | 178.3  |
| 21   | Shipashnic e Po. | 168.18 | 2.2    | 0.25     |         | 170.63   | 38.1    | 146.13 |
| 22   | Karaçevë e P.    | 171.28 |        | 1.05     | 16.95   | 189.28   | 185.15  | 10.25  |
| 23   | Feriqevë         | 178.35 |        |          | 79.3    | 257.65   | 207.81  | 189.16 |
| 24   | Gjyrishec        | 203.43 |        | 1.52     | 114.63  | 319.58   | 349.1   | 290.16 |
| 25   | Zhujë            | 69.32  |        |          | 40.25   | 109.57   | 62      | 108.12 |

|    |              |         |       |        |         |          |         |         |
|----|--------------|---------|-------|--------|---------|----------|---------|---------|
| 26 | Zajçec       | 116.83  |       | 3      | 183.44  | 303.27   | 128.84  | 388.01  |
| 27 | Kolloleq     | 402     | 1.06  | 3.01   | 12.91   | 418.98   | 102.58  | 238.39  |
| 28 | Kopërnice    | 371.27  | 3.92  |        | 5.02    | 380.21   | 225.7   | 168.87  |
| 29 | Koretin      | 752.25  | 6.25  | 12.93  | 9.18    | 780.61   | 123.17  | 131.5   |
| 30 | Kamenice     | 224.14  | 2.23  | 12.76  | 18.84   | 257.97   | 127.39  | 172.2   |
| 31 | Kostadince   | 109.76  |       |        | 40.8    | 150.56   | 217.9   | 131.7   |
| 32 | Kranidell    | 176.2   |       | 0.5    | 29.02   | 205.72   | 171.21  | 560.2   |
| 33 | Kremenatë I  | 87.91   |       | 0.26   | 77.32   | 165.49   | 60.04   | 432.06  |
| 34 | Kremenatë II | 35.09   |       | 0.64   | 22.64   | 58.37    | 10.51   | 140.75  |
| 35 | Krilevë      | 345.99  |       | 0.67   | 91.58   | 438.24   | 146.29  | 1025.33 |
| 36 | Lisockë      | 233.11  |       |        | 74.27   | 307.38   | 175.55  | 272.01  |
| 38 | Lajçiq       | 182.73  |       | 1.09   | 69.29   | 253.11   | 210.3   | 411.12  |
| 39 | Leshtar      | 172.81  |       | 3.19   | 17.19   | 193.19   | 26.99   | 229.27  |
| 40 | Marocë       | 53.22   |       |        | 13.18   | 66.4     | 47.5    | 103.85  |
| 41 | Meshinë      | 105.52  | 0.03  | 2.1    | 106.99  | 214.64   | 147.86  | 396.61  |
| 42 | Moçarë       | 210.48  | 1.19  | 7.34   | 20.6    | 239.61   | 72.5    | 280.32  |
| 43 | Muçivërc     | 306.11  | 7.95  |        | 11.3    | 325.36   | 79.95   | 248.83  |
| 44 | Novosellë    | 67.22   |       |        | 7.92    | 75.14    | 62.04   | 4.27    |
| 45 | Hogosht      | 583.76  | 5.36  | 4.52   | 18.29   | 611.93   | 164.74  | 675.37  |
| 46 | Hodonoc      | 626.71  | 0.87  | 1.5    | 55.82   | 684.9    | 319     | 377.15  |
| 47 | Rahovicë     | 100.51  | 0.72  | 4.04   | 19.98   | 125.25   | 47.06   | 284.66  |
| 48 | Petroc       | 158.15  | 2.39  |        | 11.95   | 172.49   | 107.12  | 69.67   |
| 49 | Poliçkë      | 228.74  |       | 2.5    | 104.21  | 335.45   | 315.07  | 298.8   |
| 50 | Ruboc        | 124.95  | 1.73  | 3.11   | 8.2     | 137.99   | 50.18   | 156.33  |
| 51 | Rogaçicë     | 494.72  | 0.5   | 2.15   | 15.47   | 512.84   | 197.31  | 357.99  |
| 52 | Svircë       | 180.94  |       | 1.88   | 264.88  | 447.7    | 186.64  | 385.58  |
| 53 | Sedllar      | 98      |       |        | 36.57   | 134.57   | 71.93   | 396.97  |
| 54 | Strezoc      | 172.42  | 1.01  | 2.96   | 15.94   | 192.33   | 107.5   | 409.78  |
| 55 | Stralicë     | 109.46  | 0.06  | 2.35   | 4.4     | 116.27   | 107.47  | 37.63   |
| 56 | Topanicë     | 562.44  | 3.5   | 2.5    | 4.03    | 572.47   | 157.94  | 27.09   |
| 57 | Tërstenë     | 165.72  |       | 2.7    | 116.11  | 284.53   | 157.93  | 534.74  |
| 58 | Tugjec       | 178.5   |       | 6.89   | 216.12  | 401.51   | 233.09  | 686.31  |
|    | Gjithsej     | 12284.3 | 61.53 | 137.89 | 2854.34 | 15338.06 | 7432.25 | 16591.8 |

Tab.40. Tokat pjellore në Kamenicë

| NR | Fshati         | Lopë(Copë) | dele (Copë) | Dhi (Copë) | Derra (Copë) | kuaj(Copë) |
|----|----------------|------------|-------------|------------|--------------|------------|
| 1  | Haqnoc         | 169        | 48          | 73         | 306          | 0          |
| 2  | Berivojcë      | 151        | 0           | 67         | 370          | 0          |
| 3  | Billatë        | 20         | 80          | 0          | 0            | 0          |
| 4  | Huboc          | 15         | 0           | 0          | 0            | 0          |
| 5  | Bratilloç      | 10         | 100         | 1          | 1            | 0          |
| 6  | Busavatë       | 312        | 450         | 56         | 0            | 0          |
| 7  | Vaganesh       | 15         | 0           | 0          | 0            | 0          |
| 8  | Vriçec         | 56         | 185         | 0          | 0            | 0          |
| 9  | Gmicë          | 125        | 56          | 0          | 0            | 0          |
| 10 | Qarakoc        | 0          | 0           | 0          | 0            | 0          |
| 11 | Velegllavë Ep. | 35         | 250         | 0          | 0            | 1          |



|    |                  |      |      |     |      |    |
|----|------------------|------|------|-----|------|----|
| 12 | Shipashnicë      | 104  | 0    | 0   | 0    | 1  |
| 13 | Karaçevë e Ep.   | 322  | 250  | 28  | 0    | 1  |
| 14 | Gragjenik        | 15   | 0    | 0   | 0    | 0  |
| 15 | Grizime          | 67   | 133  | 54  | 138  | 0  |
| 16 | Dazhnicë         | 39   | 50   | 7   | 0    | 0  |
| 17 | Shahiq           | 79   | 70   | 0   | 0    | 1  |
| 18 | Dajkoc           | 106  | 150  | 47  | 0    | 0  |
| 19 | Desivojcë        | 147  | 30   | 0   |      | 2  |
| 20 | Velegllavë Ep.   | 25   | 0    | 0   | 0    | 0  |
| 21 | Shipashnic e Po. | 262  | 0    | 1   | 3    | 1  |
| 22 | Karaçevë e P.    | 211  | 180  | 14  | 0    | 1  |
| 23 | Feriqevë         | 124  | 110  | 0   | 0    | 0  |
| 24 | Gjyrishec        | 99   | 150  | 0   | 0    | 2  |
| 25 | Zhujë            | 84   | 56   | 0   | 0    | 2  |
| 26 | Zajçec           | 42   | 130  | 15  | 0    | 0  |
| 27 | Kolloleq         | 82   | 200  | 11  | 164  | 3  |
| 28 | Kopërnice        | 294  | 145  | 14  | 0    | 0  |
| 29 | Koretin          | 220  | 80   | 36  | 0    | 0  |
| 30 | Kamenicë         | 241  | 0    | 23  | 304  | 0  |
| 31 | Kostadincë       | 56   | 0    | 26  | 19   | 0  |
| 32 | Krenidell        | 23   | 0    | 0   | 0    | 2  |
| 33 | Kremenatë I      | 31   | 0    | 0   | 0    | 0  |
| 34 | Kremenatë II     | 0    | 0    | 0   | 0    | 0  |
| 35 | Krilevë          | 306  | 411  | 48  | 0    | 0  |
| 36 | Lisockë          | 173  | 191  | 26  | 0    | 5  |
| 38 | Lajçiq           | 146  | 40   | 1   | 0    | 3  |
| 39 | Leshtar          | 58   | 32   | 22  | 0    | 0  |
| 40 | Marocë           | 78   | 131  | 37  | 0    | 2  |
| 41 | Meshinë          | 55   | 0    | 0   | 0    | 0  |
| 42 | Moçarë           | 108  | 70   | 55  | 150  | 0  |
| 43 | Muçivërc         | 343  | 0    | 3   | 0    | 0  |
| 44 | Novosellë        | 249  | 181  | 17  | 0    | 0  |
| 45 | Hogosht          | 342  | 150  | 47  | 0    | 0  |
| 46 | Hodonoc          | 311  | 114  | 52  | 81   | 0  |
| 47 | Rahovicë         | 35   | 0    | 0   | 0    | 0  |
| 48 | Petroc           | 159  | 0    | 0   | 0    | 0  |
| 49 | Poliçkë          | 315  | 560  | 25  | 0    | 3  |
| 50 | Ruboc            | 97   | 0    | 18  | 59   | 0  |
| 51 | Rogaçicë         | 376  | 372  | 31  | 0    | 6  |
| 52 | Svircë           | 78   | 0    | 0   | 0    | 3  |
| 53 | Sedllar          | 35   | 50   | 0   | 0    | 2  |
| 54 | Strezoc          | 101  | 0    | 6   | 72   | 0  |
| 55 | Stralicë         | 57   | 0    | 2   | 85   | 0  |
| 56 | Topanicë         | 345  | 250  | 36  | 0    | 0  |
| 57 | Tërstenë         | 65   | 0    | 0   | 0    | 0  |
| 58 | Tugjec           | 188  | 0    | 2   | 0    | 0  |
|    | Gjithsej         | 7601 | 5455 | 901 | 1752 | 41 |


Tab.41. Numri dhe lloji i kafshëve në Komunën e Kamenicës



### SHTRIRJA HAPËSINORE E BIZNESEVE

### LEGJENDA / LEGEND / LEGENDA

- Kufi komunal
- Zonë kadastrale
- Shtrirja hapësinore e bizneseve



2,800 1,400 0 2,800 Meters

Burimi / Në dhënave: Agjencia Kadastrale e Kosovës  
Institucionet e Komunës së Kamenicës  
Grupi për Zhvillim Ekonomik

Shkalla / Scale / Razmera  
1:150,000

Projected Coordinate System: KosovaRel01  
Projection: Transverse\_Mercator  
Geographic Coordinate System: GCS\_ETRS\_1989  
Datum: D\_ETRS\_1989  
Prime Meridian: Greenwich  
Angular Unit: Degree



Harta.23. Shtrirja hapësinore e bizneseve ne Komunën e Kamenicës

### **1.1.13.0 INFRASTRUKTURA TEKNIKE**

#### **1.1.13.1 TRANSPORTI DHE INFRASTRUKTURA E TIJ**

Komuna e Kamenicës në bazë shtrirjes së territorit me territoret tjera, ka këto distanca në vijën tokësore: me Komunën e Gjilanit rreth 30 km, me Novobërdën nëse kalojmë rrugës për Gjilan ka një gjatësi prej afro 50 km, ndërsa nëse kalojmë nëpër rrugën që përshkon shumë fshatra të Komunës së Kamenicës, si fshatrat Busavatë etj. është afro 25 km më shkurt me Komunën e Prishtinës në rrugë gjatësore që kalon përmes Gjilanit është afro 75 km, ndërsa ajo që kalon kah Artana është rreth 50 km, çka do të thotë se në të dy drejtimet rruga shkurtohet për rreth 50 km.

Distanca e qendrës së komunës me qendrat tjera të territorit të Serbisë, pra me Komunën e Bujanocit rreth 25 km. Me Komunën e Medvegjës rreth 35 km por që infrastruktura rrugore është mjaft e dobët.

Distanca e qendrës së komunës me rrugët magjistrale është: kështu komuna jonë ndodhet rreth 10 km larg magjistrals Bujanoc- Gjilan, rreth 30 km larg autoudhës ndërkombëtare E75 Shkup-Bujanoc-Vranjë-Beograd.

Transporti paraqet një aktivitet shumë të rëndësishëm për qytetarët, institucionet dhe bizneset e Kamenicës. Është faktor përmbajtësor për zhvillim ekonomik, social e mjedisor por edhe pasojë e këtyre zhvillimeve, luan rol të rëndësishëm në relacionet hapësinore midis hapësirave dhe destinimeve të tyre. Transporti në Kamenicë, kryesisht realizohet përmes rrugëve automobilistike.

Dukuria e ndërtimeve ilegale në brezin rrugor është alarmuese dhe kërkon intervenim të shpejtë institucioneve kompetente. Sa më vonë që të intervenohet, dëmet do të jenë më të mëdha dhe më vështirë do të jetë të sanohen.

Në mungesë të transportit përmes hekurudhës, sidomos të mallrave me ngarkesë të madhe, rrugët automobilistike ngarkohen së tepërmi dhe kështu vie deri te dëmtimi i tyre.

Infrastruktura në Komunën e Kamenicës, marrë në përgjithësi është e një niveli jo të kënaqshëm. Duke shikuar shtrirjen e terrenit, viset malore dhe shtrirjen e popullatës, atëherë kemi vështirësi të mëdha në transportimin e njerëzve, prodhimeve të ndryshme, etj.

#### **1.1.13.2 TRANSPORTI AUTOMOBILISTIK**

Rrugët lidhëse me fshatrat për rreth janë në gjendje mjaft të vështirë e sidomos me malësinë e komunës, ku për një numër të madh të popullatës udhëtimi i tyre është mjaft i vështirësuar. Pikërisht për shkaqe të infrastrukturës rrugore është bërë edhe zhvendosja e shumë fshatrave në malësinë e komunës.

Komuna e Kamenicës ka një numër të madh të shërbimeve transportuese, në krahasim me gjendjen e infrastrukturës dhe numrit të popullatës.

Kështu komuna jonë ka tetë (8) kompani private transportuese, rreth 150 auto taksi duke mos përfshirë kombibusët. Po ashtu, ka rreth 4500 automjete personale të regjistruara në tërë Komunën.

Komuna e Dardanës ka një rrjet të rrugëve në gjatësi prej rreth 300 km. Edha atë:

- Rrugë magjistrale - 2 km
- Rrugë regjionale - 100 km

- Rrugë lokale - rreth 229 km

Rrugët magjistrale janë të asfaltuara - 85km por në një gjendje jo të mirë, ndërsa të pa asfaltuara janë rreth 15 km.

Rrugë lokale janë të asfaltuara rreth 159 km ndërsa të pa asfaltuara rreth 70 km .

#### **Analiza e sinjalizimit horizontale dhe vertikale**

Shikuar në tërësi sinjalizimi horizontal është shumë i mangët për të mos thënë nuk ekziston fare. Rëndësia e sinjalizimit horizontal është e rëndësisë së veçantë, duke marrë parasysh domethënien e tyre, prandaj vendosja e tyre duhet jetë në masë më të madhe .

Në komunën e Dardanës, në rrugët regjionale ekziston vija ndarëse e mesit ndërsa në qytet gjendja është e mirë .

Prania e këtyre sinjaleve nëpër qendrën e qytetit mund të themi se, është e kënaqshme, ndërsa nëpër fshatra ka mungesë të vogël të shenjave.

Transporti paraqet një aktivitet shumë të rëndësishëm për qytetarët, institucionet dhe bizneset e Kamenicës. Është faktor përmbajtësor për zhvillim ekonomik, social e mjedisor por edhe pasojë e këtyre zhvillimeve, luan rol të rëndësishëm në relacionet hapësinore midis hapësirave dhe destinimeve të tyre. Transporti në Viti, kryesisht realizohet përmes rrugëve automobilistike.

#### **1.1.13.3 TRANSPORTI HEKURUDHOR**

Në territorin e Komunës së Kamenicës nuk ekziston transport hekurudhor.

Stacioni më i afërt hekurudhor është stacioni hekurudhor në Ferizaj, Bujanoc, Fushë Kosovë dhe Shkup.

Vetë fakti se, që në nivel të Kosovës që nga viti 1963 nuk është ndërtuar asnjë vijë e re hekurudhore, flet mjaft për gjendjen në transportin hekurudhor.

Mungesa e stacioneve hekurudhore dhe largësia nga stacionet momentale, këtë komunë e vë në pozitë shumë të pa volitshme transportuese, ku këtu sidomos ka të bëjë me transportin më masiv të mallrave dhe të produkteve.

#### **1.1.13.4 TRANSPORTI AJROR**

Në komunën e Kamenicës nuk ka aeroport. Më i afërti është aeroporti i “Prishtinës” 80 Km dhe Shkupit 160Km .

Në perspektivë, nuk parashihet ndërtimi i aeroportit, prandaj edhe më tutje kjo komunë do të orientohet në aeroportin e “Prishtinës”, por edhe atë të “Shkupit”.

#### **1.1.13.5 TELEKOMUNIKIMI**

**TELEFONIA FIKSE** -Deri në kohën e fundit në komunën tonë ka vepruar telefonia fikse e PTK-së ,e cila telefoni ka vepruar në një pjesë të komunës sonë. Rrjeti i telefonisë fikse i PTK-së është në fazën e modernizimit me aplikim të teknikës digjitale.

Telefonia fikse është e shtrirë në qytet dhe në këto fshatra: Koretin , Topanicë, Rogaçicë, Moçar, Ruboc dhe Stralicë.

Foltore publike ne tërëë komune jane 5 foltore.

Shërbimi i internetit kryhet aty ku ka sherbime telefonike.

Shërbimet postare kryhen ne tërë territorin e komunës dhe janë të ndarë: në shërbim në rrethin e ngushtë dhe shërbim në rrethin e gjerë.




Kjo kompani ofron edhe shërbimin e telefonisë mobile”Vala”, ku është i mbuluar territori i Komunës së Kamenicës.


Operator tjetër i telefonisë fikse në Komunën e Kamenicës është edhe IPKO, e cila është duke e shtrirë rrjetin në tërëë territorin e komunës.



**INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT**  
**TRANSPORT INFRASTRUCTURE**  
**TRANSPORTNA INFRASTRUKTURA**

**LEGJENDA**  
**LEGEND**  
**LEGENDA**

-  Rrugë lokale pa asfalt
-  Rrugë e rendit III
-  Rrugë e Rendit II




Burimi i të dhënave: Agjencia Kadastrale  
e Kosovës  
Institucionet e Kamenicës  
Grupi i Infrastrukturës  
Plani Hapësror i Kosovës

Projected Coordinate System: KosovaRe01  
Projection: Transverse\_Mercator  
Geographic Coordinate System: GCS\_ETRS\_1989  
Datum: D\_ETRS\_1989  
Prime Meridian: Greenwich  
Angular Unit: Degree



Harta 24. Infrastruktura e transportit në Komunën e Kamenicës



Harta 25. Rrjeti rrugor në Komunën e Kamenicës

### 1.1.13.6 Sistemi i Ujësjetës në Komunën e Kamenicës

Procesi i prodhimit, trajtimit dhe distribuimit të ujit të pijshëm në qytetin e Kamenicës, mandej në fshatin Berivojcë si dhe një pjesë e Rubocit, realizohet në dy (2) stacione pompimi në lokacione të ndara mes veti, por të integruara në sistemin e shpërndarjes së ujit të pijshëm.

Sasia më e madhe e ujit në këtë stacion vjen nga sistemi i drenazhimit, i vendosur nën shtratin e Lumit "KRIVA REKA", i cili bën furnizimin e pesë (5) puseve të hapura dhe tri (3) puseve të shpuara, nga të cilët përmes pompave horizontale dhe zhytëse mbushet rezervuari me kapacitet prej 142 m<sup>3</sup>, pastaj me anë të pompave tjera bëhet distribuimi në rrjetin kryesor të ujit. Aktualisht, është në përfundim e sipër projekti për furnizim me ujë të pijshëm në një pjesë të Lagjes "MALËSIA" në Kamenicë. Furnizim do të bëhet nga një rezervuar me kapacitet prej 300 m<sup>3</sup>.

Uji i pijshëm në këtë stacion vjen nga dy puse të shpuara në thellësi prej 54 m, të cilët e mbushin një pus të hapur dhe nga këtu përmes pompave horizontale, bëhet distribuimi i ujit në rrjetin kryesor të qytetit.

Pjesa më e madhe e banorëve të Komunës së Kamenicës që jetojnë në zonat rurale, furnizohet me ujë të pijshëm nga burime të ndryshme individuale (puse të hapura, kroje malore, lumenj etj), i cili nuk trajtohet profesionalisht dhe nuk është i verifikuar nga institucionet zyrtare.

Momentalisht në funksion janë këta ujësjetës: në Topanicë, Karaçevë e Poshtme dhe Reçan, ndërkaq në ndërtim e sipër janë: në Shipashnicë të Epërme, Kopërnice, Kolloleq dhe Koretin.


Komuna e Kamenicës është e pasur me rezerva hidrike falë 3 (tri) Lumenjve: (Lumi "Kriva Reka", Lumi i Hogoshtit dhe Lumi i Desivojcës) si dhe Lumenjve tjerë më të vegjël, dhe përrrenjve të cilët kanë konfiguracion të përshtatshëm, kualitet të mirë, dhe sasi të mjaftueshme për shfrytëzimin e ujit të pijshëm.



**INFRASTRUKTURA E FURNIZIMIT ME UJË  
WATER SUPPLY INFRASTRUCTURE  
INFRASTRUKTURA SNABDEVANJE VODOM**

**LEGJENDA / LEGEND / LEGENDA**

- Rrjeti i Ujësjellsit në Kamenicë
- Kufi komunal
- Zonë kadastrale
- Vendëbanime që nuk kanë sistem furnizimi me ujë
- Vendëbanime që kanë sistem furnizimi me ujë
- Vendëbanime që janë në zbatim të projektit sistem furnizimi me ujë
- Lumë, rrjedhë, përrua



3,750 1,875 0 3,750 Meters

Petrit (Petroci)

Projected Coordinate System: KosovaRef01  
Projection: Transverse\_Mercator  
Geographic Coordinate System: GCS\_ETRS\_1989  
Datum: D\_ETRS\_1989  
Prime Meridian: Greenwich  
Angular Unit: Degree

Burimi i të dhënave: Agjencia Kadastrale e Kosovës  
Institucionet e Komunës së Kamenicës  
Fotografisë ajrore të vitit 2009  
Grupi për Infrastruktura  
Kompania rajonale hidromorava



Harta 26. Infrastruktura e furnizimit me ujë në Komunën e Kamenicës



### **1.1.13.7 Sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza**

Territori i Komunës së Kamenicës ka një rrjet hidrografik, i cili i takon pellgut të Detit të Zi. Në komunë janë tre lumenj, Kriva Reka me degët e tij në lumë burimor, lumi i Hogoshtit dhe lumi i Desivojcës. Lumi “Kriva Reka” buron në malet e Gollakut, i cili deri në hyrje të fshatit Hajnoc i takon lumenjve me ndotje të kategorisë së parë (lum i pastër). Prej fshatit Hajnoc e deri në hyrje të Kamenicës i takon shkallës së dytë (ndotje e lehtë). Pas daljes nga vendbanimi i Kamenicës e deri në bashkimin me Lumin “Morava” i takon shkallës së dytë, ku shndërrohet në lumë me ndotje të kategorisë së dytë (ndotje e lartë). Shkarkimi i ujërave të zeza dhe industriale pa asnjë trajtim paraprak, lëshohen në Lumin “Kriva Reka”, që rritë shkallën e ndotjes së lumit. Lumi i Hogoshtit është i pastër deri në hyrje të vendbanimeve (ujëra burimore) pas shkarkimit të ujërave të zeza dhe hedhjeve të mbeturinave në shtretërit e lumenjve, kalon në shkallën e ndotjes së dytë. Lumi i Desivojcës deri në vendbanimin e Shipashnicës së Epërme, i takon shkallës së parë të pastërtisë, nga aty e deri në Moravë, i takon shkallës më të lartë të ndotjes. Shkarkimi i ujërave të zeza në rrjedhjet lumore pa trajtim paraprak, rritë shkallën e ndotjes së lumenjve.

Çdo banor shkarkon 16.46m<sup>3</sup> ujra të zeza.

Vetëm Kamenica si qytezë me 7363 banorë, shkarkon 6.5 l/s ose 47859,5 m<sup>3</sup>/vit, ujëra të zeza të patrajuara në lumë brenda vitit pa llogaritur këtu objektet shoqërore, industriale etj.

Përveç shkarkimit të ujërave të zeza, lumenjtë ndoten dhe degradohen edhe nga mbeturinat që i hedhë popullata lokale, nxjerrja ilegale e rërës, shkatërrimi i florës pranë brigjeve të lumenjve, shplarja e tokës gjatë reshjeve atmosferike, nga objektet industriale etj.


Rekomandohet për Komunen e Kamenicës, që të përcaktohet për variantën e parë, ndërkaq komuna të ndaj sipërfaqe tokësore për ndërtim impianti në mes fshatit Korminjan dhe Dheut të Bardhë. Arsye është se, përshkak të konfiguracionit të terrenit.



### KANALIZIMI CANALISATION KANALIZACIJE

#### LEGJENDA / LEGEND / LEGENDA

- Kufi komunal
- Zonë kadastrale
- Lumë, rrjedhë, përrua
- Vendbanimet pa kanalizim
- Vendbanimet në ndërtim
- Vendbanimet me kanalizim



Burimi i të dhënave: Agjencia Kadastrale e Kosovës  
Institucionet e Komunës së Kamenicës  
Grupi i Infrastrukturës  
Kompania Publike "Hidromorava"

Projected Coordinate System: KosovaReD01  
Projection: Transverse\_Mercator  
Geographic Coordinate System: GCS\_ETRS\_1989  
Datum: D\_ETRS\_1989  
Prime Meridian: Greenwich  
Angular Unit: Degree



Harta 27. Infrastruktura e kanalizimit në Komunën e Kamenicës

**TELEFONIA MOBILE**-në Komunën e Kamenicës, shërbimet e serviseve të telefonisë mobile i kryen dy kompani edhe atë GSM VALA 900, IPKO dhe ZMobile.

Këto dy kompani e kanë të shtrirë rrjetin në tërë territorin e komunës.

**Shërbimet e internetit** - Në Kamenicë ekzistojnë 2 kompani të mëdha IPKO dhe Kujtesa që ofrojnë shërbime Internetit dhe disa kompani më të vogla lokale që operojnë në këtë lëmë. Nga këto dy kompani është duke u bërë shtrirja e rrjetit pa tela. Resurset humane, me të cilat Kamenica ka përparësi zhvillimore, do të mund të jenë në funksion të zhvillimit bashkëkohor vetëm nëse ngritet arsimimi dhe aftësimi në fushën e teknologjisë informative.

Harta e mbulueshmërisë me valët e telefonisë mobile, sipërfaqet territoriale sipas kapacitetit të mbulueshmërisë me valët e telefonisë mobile: Rrjeti ekzistues PTK-së, Rrjeti ekzistues (lokale), Linjat ekzistuese.

Territori i Kamenicës është i mbuluar mjaft mirë, pothuajse të gjitha vendbanimet e Kamenicës, kanë qasje në shërbimet e telefonisë mobile, të cilat ofrohen nga dy operatorët e licencuar nga ART-ja. Të dy operatorët mobil kanë të shpërndarë antena individuale në lokacione të ndryshme të komunës. Numri i antenave të vendosura nga operatorët mobilë, sipas vendbanimeve dhe operatorëve në tërë territorin e komunës.



**TELEKOMUNIKIMI  
TELECOMMUNICATION  
TELEKOMUNIKACIJA**

**LEGJENDA  
LEGEND  
LEGENDA**

- Kufi komunal
- Zonë kadastrale
- Lumë, rrjedhë, përrua
- Vendëbanime pa telefoni fikse
- Vendëbanime me telefoni fikse



Shkalla / Scale / Razmera  
1:150,000



Burimi i të dhënave: Agjencia Kadastrale e Kosovës  
Institucionet e Komunës së Kamenicës  
Fotografisë ajrore të vitit 2009  
PTK, IPK përfaqësija në Kamenicë

Projected Coordinate System: KosovaRef01  
Projection: Transverse\_Mercator  
Geographic Coordinate System: GCS\_ETRS\_1989  
Datum: D\_ETRS\_1989  
Prime Meridian: Greenwich  
Angular Unit: Degree



Harta.28. Telekomunikimi në Komunën e Kamenicës

### 1.1.13. INFRASTRUKTURA E ENERGJETIKËS

Në Komunën e Kamenicës, elektrifikimi i fshatrave daton që nga viti 1955, ku në këtë vit, elektrifikohen, fshatrat Ropotovë e Madhe dhe Panqellë. Në vitin 1957 janë elektrifikuar fshatrat:

Topanicë, Tomancë, Korminjani i Epërm dhe qyteti i Kamenicës. Në vitin 1958 janë elektrifikuar

fshatrat: Ropotova e Madhe, Berivojca, Domaroci, Korminjani i Poshtëm, Koretini, Ruboci dhe Moçari.

Në vitin 1959 Ranillugu, në vitin 1961 Glligoci. Pjesa më e madhe e fshatrave të Komunës së Kamenicës elektrifikohet nga vitet 1965 deri në vitin 1975 për të përfunduar elektrifikimi në vitin 1984 ku edhe janë elektrifikuar fshatrat e fundit të malësisë së Kamenicës.

Gjatë kësaj kohe, furnizimi me energji elektrike është bërë nga Bujanoci përmes një linje 35kV, deri te T.S 35/10kV në Ropotovë të Madhe. Më pastaj me ndërtimin e T.S 35/10kV në Berivojcë, furnizimi me energji elektrike është bërë nga T.S 110/35kV në Gjilan përmes dy linjave 35kV paralele.

Kjo ka ndodhur kështu deri në vitin 2003 kur në Berivojcë është ngritur T.S 110/10(20)kV i fuqisë 31.5MVA.

Sa i përket gjendjes së SEE në Kamenicë, nga vetë fakti se ende ekzistojnë ato linja dhe ato rrjete të montuara që nga viti 1955 deri në vitin 1984 tregon, se gjendja e rrjetit e veçanërisht e rrjetit të tensionit të ulët (0.4kV) është kritike.

Ndërsa linjat 10kV dhe 110kV janë në gjendje pak më të mirë.

D.m.th në territorin e komunës së Kamenicës ekzistojnë tri nivele të tensionit (linjave) me të cilat bartet energjia elektrike, edhe atë:



1. Rjeti i tensionit të ulët (0.4kV) me një gjatësi prej 322km
2. Linjave 10(20)kV me gjatësi prej afër 209km, dhe
3. Linjës 110kV me gjatësi afër 30km.

Ekziston një T.S 110/10(20)kV me fuqi 31.5MVA

Furnizimi bëhet nga Gjilani përmes linjës 110kV dhe nga Bujanoci (Ristoci), gjithashtu përmes linjës 110kV.


Kostoja e këtij rrjeti, e këtyre linjave (10 dhe 110)kV si dhe e këtij T.S 110/10(20)kV me të gjitha T.S 10(20)/0.4kV vlerësohet të jetë afër 50 milion euro.

# SKEMAT NJËPOSHE TË DISKTRIKTIT TE KAMENICËS




| Plote:                      | Plaqi | Shpytit e Ishtena | Shpytit e Dera | Linja Kabilizues | Linjat Ajrore | TS 630  | TS 400 | TS 250 | TS 100 | TS 100 | TS 60 |
|-----------------------------|-------|-------------------|----------------|------------------|---------------|---------|--------|--------|--------|--------|-------|
| Mjetet themelore të FSK-ut  | 0,21  | 4,26              | 0,21           | 4,98             | 0             | 0       | 2      | 0      | 2      | 0      | 0     |
| Transtransformatore private | 0,21  | 4,26              | 0,21           | 4,98             | 0             | 0       | 0      | 0      | 0      | 0      |       |
| Tëlbashq                    | 0,21  | 4,26              | 0,21           | 4,98             | 0             | 0       | 2      | 0      | 2      | 0      |       |
|                             |       |                   |                |                  |               | 799 kVA |        |        |        |        |       |
|                             |       |                   |                |                  |               | TSH 4   |        |        |        |        |       |

Seksionet tërthore të linjave ajrore 35 kV, 10 kV në rajonin e Kamenicës dalja e Rubocit




| Rrëz:                        | Thaçi | Sh. e betonit | Sh. e Drurit | L. Kablovike | L. Ajrore | TS 630 | TS 400 | TS 250 | TS 160 | TS 100 | TS 50 |
|------------------------------|-------|---------------|--------------|--------------|-----------|--------|--------|--------|--------|--------|-------|
| Mjetet themelore te KEK - ut | 0,0   | 22,81         | 0,0          | 37,71        | 0         | 1      | 1      | 1      | 2      | 0      |       |
| Trafo stacionet private      | 0,0   | 22,81         | 0,0          | 37,71        | 0         | 1      | 1      | 1      | 2      | 0      |       |
| 1010 kVA                     |       |               |              |              |           |        |        |        |        |        |       |
| Blind 3 TSH19                |       |               |              |              |           |        |        |        |        |        |       |

Seksionet tërthore të linjave ajrore 35 kV, 10 kV në rajonin e Kamenicës dalja e Ropotoves




| Rrëz:                        | Thaçi | Shtyllat e betonit | Shtyllat e Drurit | Linja Kablovike | TS 3x100 | TS 3x630 | TS 1000 | TS 160 | TS 100 | TS 50 |
|------------------------------|-------|--------------------|-------------------|-----------------|----------|----------|---------|--------|--------|-------|
| Mjetet themelore te KEK - ut |       |                    |                   | 0,55            |          |          | 2       |        |        |       |
| Trafo stacionet private      |       |                    |                   |                 |          |          | 2       |        |        |       |
| Gjithsej                     |       |                    |                   | 0,55            |          |          | 2       |        |        |       |
| 2000 kVA                     |       |                    |                   |                 |          |          |         |        |        |       |
| Blind .2                     |       |                    |                   |                 |          |          |         |        |        |       |

Seksionet tërthore të linjave ajrore 35 kV, 10 kV në rajonin e Kamenicës dalja e Maliqit Petroll



Seksionet tërthore të linjave ajrore 35 kV, 10 kV në rajonin e Kamenicës dalja e Muçivërcit




|                             | Shtyllat e betonit | Shtyllat e Drurit | Linjat Kablovike | TS 3x100 | TS 3x630 | TS 1000 | TS 160 | TS 100 | TS 50 |
|-----------------------------|--------------------|-------------------|------------------|----------|----------|---------|--------|--------|-------|
| Mjetet themelore te KEK- ut |                    |                   | 0,55             |          |          | 2       |        |        |       |
| Trafostacionet private      |                    |                   |                  |          |          |         |        |        |       |
| Gjithsej                    |                    |                   | 0,55             |          |          | 2       |        |        |       |
| 2000 kuA                    |                    |                   |                  |          |          |         |        |        |       |
| Blind.3                     |                    |                   |                  |          |          |         |        |        |       |


Seksionet tërthore të linjave ajrore 35 kV, 10 kV në rajonin e Kamenicës dalja e Magnoromit




### DALJA E KORETIN



Seksjonet tërthore të linjave ajrore 35 kV, 10 kV në rajonin e Kamenicës dalja e Koretinit



Seksjonet tërthore të linjave ajrore 35 kV, 10 kV në rajonin e Kamenicës dalja e Kamenicës



| Planç                        | Sh. e betimit | Sh. e Drurit | L. Këmbësive | L. Ajros | TS 5x1000 | TS 2x630 | TS 630 | TS 100 | TS 100 | TS 50 |
|------------------------------|---------------|--------------|--------------|----------|-----------|----------|--------|--------|--------|-------|
| Mjetet themelore të KEK - ut | 7,82          | 2,05         | 0,70         | 10,47    | 1         | 2        | 1      | 4      | 1      | 1     |
| Trafostacionet private       |               |              |              |          |           |          |        |        |        |       |
| Gjithsej                     | 7,82          | 2,05         | 0,70         | 10,47    | 1         | 2        | 1      | 4      | 2      | 2     |
| 2729 Postë                   |               |              |              |          |           |          |        |        |        |       |
| Blloku 5 TSB13               |               |              |              |          |           |          |        |        |        |       |

Seksionet tërthore të linjave ajrore 35 kV, 10 kV në rajonin e Kamenicës dalja Industriale



Fig .2. Skema njëpolare 400/220/110 kV në hartën gjeografike të Kosovës .

#### **1.1.13.9 VARREZAT**

Nga informatat të cilat janë marrë nga bashkësitë fetare në Kamenicë, dhe analiza e bërë në këtë fushë, çdo vendbanim në K. Kamenicës ka lokacione të caktuara të varrezave. Në disa vendbanime ka dy e më tepër lokacione të varrezave. Në bazë të analizave në terren, grupi hulumtues i përfaqësuar edhe nga përfaqësuesit e bashkësive fetare, kanë identifikuar lokacionet e varrezave në tërë territorin e Komunës së Kamenicës, me të cilin rast është konstatuar se një pjesë e tyre i plotëson kërkesat edhe për 10 vjetët e ardhshëm. Duhet të ndërmerren masa për plotësim me infrastrukturë, mirëmbajtje dhe menaxhim. Janë planifikuar edhe hapësira të reja për varreza, të cilat janë prezantuar në hartën e infrastrukturës së varrezave.

Gjatë marrjes së informatave, është vërejtur se gati shumica e varrezave nëpër vendbanime janë në gjendje të keqe, ku në të gjitha varrezat shqiptare (myslimane), shqiptare (katolike) dhe serbe (ortodokse), u mungon infrastruktura dhe elementet përcjellëse të varrezave. Në varrezat e qytetit të Kamenicës mungon infrastruktura e nevojshme për varrim dhe qëndrim, organizimi i hapësirës dhe rregullimi i varrezave, gjelbërim dhe aktivitetet tjera të nevojshme. Situata e njëjtë është edhe në të gjitha vendbanimet e tjera të Komunës së Kamenicës.

#### **1.1.13.10 MENAXHIMI I MBETURINAVE**

Me analizat e bëra nga grupet punuese dhe kompania “Univerzal”, si dhe aktorë tjerë është parashikuar: që të ndërtohen deponi tranzite të mbeturinave inerte (ndërtimtarisë) gati në të gjitha fshatrat, janë planifikuar deponi tranzite të mbeturinave komunale në çdo lokalitet.

Parashikohen intervenime të vendi i deponisë së vjetër të qytetit (rehabilitimi i zonës dhe izolimi, ngjashëm është planifikuar që të bëhet edhe rehabilitim i vendit ku janë rialokuar mbeturinat e deponisë së vjetër në fshatin Koretin.

Parashikohet grumbullimi dhe trajtimi i mbeturinave, që janë hudhur në mënyrë të pa kontrolluar me prioritet në brigjet e Lumit “Kriva Reka”, Lumit të Hogoshtit, Lumit të Desivojcës dhe në hapësira të ngjashme.

Parashikohet në vendbanimet ku nuk ka fare menaxhim, të futen në sistem të menaxhimit të mbeturinave, mandej në vendbanimet të cilat janë pjesërisht nën sistem të menaxhimit të mbeturinave që të futen nën menaxhim të plotë, kurse vendbanimet në të cilat bëhet menaxhimi i mbeturinave të fuqizohet sistemi i menaxhimit përmes infrastrukturës dhe elementeve tjera përbërëse.

Aktualisht, qyteti e ka strategjinë për trajtimin e mbeturinave, duke u bazuar në parimet e kontrollit dhe të vendosjes në vend të sigurtë. Hedhja e mbeturinave bëhet nëpër kontejnerë të mëdhenj e të vegjël, nëpër vende të caktuara, ku më pas bëhet bartja e tyre në deponinë qendrore në afërsi të qytetit të GJILANIT. Përveç qytetit dhe lokaliteteve si në Berivojcë, Koretin dhe Rogaçicë, në vendbanimet tjera të komunës nuk bëhet fare menaxhimi i mbeturinave si dhe trajtimi i tyre. Vendi i mëparshëm ku është bërë deponimi i mbeturinave, është mbuluar dhe kthyer në gjendje të rikultivueshme. Problem më vete janë vajrat e ndërruara të automjeteve, gomat e vjetra, thaset e najlonit, shishet e plastikes, liri i gazrave nga automjetet e vjetruara.



## MENAXHIMI I MBETURINAVE WASTE MANAGEMENT UPRAVLANJE OTPADOM

### LEGJENDA / LEGEND / LEGENDA

Kufi komunal

Zonë kadastrale


#### Menaxhimi i Mbeturinave

Vendbanimet nën sistem të grumbullimit

Vendbanimet ku pjesërisht grumbullohen

Vendbanimet ku nuk grumbullohen fare

Pikat e Nxeta të ndotjes



Burimi i të dhënave: Agjencia Kadastrale e Kosovës  
Institucionet e Komunës së Kamenicës  
Grupi i Infrastrukturës  
Kompania Publike "Hygjena"

Projected Coordinate System: KosovaRef01  
Projection: Transverse\_Mercator  
Geographic Coordinate System: GCS\_ETRS\_1989  
Datum: D\_ETRS\_1989  
Prime Meridian: Greenwich  
Angular Unit: Degree

Harta 29. Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Kamenicës

### 1.1.14. SHËNDETËSIA

Duke marrë parasysh se në komunën tonë ekziston vetëm mbrojtja primare shëndetësore, rëndësia e saj është shumë e madhe për ç'arsye para nesh shtrohet detyra e patjetërsueshme për të ngritur nivelin në shkallën më të lartë të mundshme.

Kujdesi primar shëndetësor në komunën tonë është i organizua siç vijon:

- Ofrimi i shërbimeve Shëndetësore parësore përmes konceptit të Mjekësisë Familjare
- Menagjimi i sëmundjeve kronike (hipertensioni, diabeti, astma TBC etj)
- Zvoglimi i mortalitetit dhe morbiditetit të fëmijëve nën moshën 5 vjeqare ,
- Përmirësimi i Shëndetit mendor duke zhvilluar shërbime të shëndetit mendor të bazuar në komunitet e në bashkëpunim me Qendrën e Shëndetit Mendor ,
- Ngritja e shkallës së imunizimit ,
- Reduktimi i sëmundjeve ngjitëse ,
- Menagjimi racional me barëra në nivel lokal dhe paisje mjekësore ,
- Ngritja e vazhdueshme profesionale e punëtorëve shëndetësor dhe e atyre jo shëndetësor.

Mbrojtja shëndetësore në komunë bëhet nëpërmjet një Qendre Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), dy Qendrave të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe 19 Ambulantave të Mjekësisë Familjare (AMF), që shifën në tabelën e më poshtme.

| Nr . | Lloji i institucionit shëndetësor | Emërtimi i lokalitetit |
|------|-----------------------------------|------------------------|
| 1    | QKMF                              | Kamenicë               |
| 2    | QMF                               | Roganë                 |
| 3    | QMF                               | Hogosht                |
| 4    | AMF                               | Karaqevë               |
| 5    | AMF                               | Koretin                |
| 6    | AMF                               | Topanicë               |
| 7    | AMF                               | Muqivërc               |
| 8    | AMF                               | Hodonoc                |
| 9    | AMF                               | Shipashnicëe Ep.       |
| 10   | AMF                               | Desivojcë              |
| 11   | AMF                               | Poliqkë                |
| 12   | AMF                               | Lisocë                 |
| 13   | AMF                               | Kopernicë              |
| 14   | AMF                               | Busavatë               |
| 15   | AMF                               | Krilevë                |
| 16   | AMF                               | Strezoc                |
| 17   | AMF                               | Tuxhevc                |
| 18   | AMF                               | Kamenicë ( te kisha)   |
| 19   | AMF                               | Bosce                  |
| 20   | AMF                               | Kolloleq               |
| 21   | AMF                               | Ajnovc                 |
| 22   | AMF                               | Bushincë               |

Problemet me të cilat përballohet këto qendra të mjekësisë familjare

Ofrimi i shërbimeve Shëndetësore parësore përmes konceptit të Mjekësisë Familjare

- Në të gjitha këto mungojnë objektet përcjellëse si garazhat, depot, furrat për djegien e mbeturinave.
- Kujdesi primar shëndetësor në komunën tonë është i organizua siç vijon.  
Ofrimi i shërbimeve Shëndetësore parësore përmes konceptit të Mjekësisë Familjare
- Menagjimi i sëmundjeve kronike (hipertensioni, diabeti, astma TBC etj)
- Zvoglimi i mortalitetit dhe morbiditetit të fëmijëve nën moshën 5 vjeqare ,
- Përmirësimi i Shëndetit mendor duke zhvilluar shërbime të shëndetit mendor të bazuar në komunitet e në bashkëpunim me Qendrën e Shëndetit Mendor ,
- Ngritja e shkallës së imunizimit ,
- Reduktimi i sëmundjeve ngjitëse ,
- Menagjimi racional me barëra në nivel lokal dhe paisje mjekësore ,
- Ngritja e vazhdueshme profesionale e punëtorëve shëndetësor dhe e atyre joshëndetësorë
- Kanalizimi ka nevojë të rrgullohet në shumicën e AMF nëpër lokalitete.

- Renovimi i objekteve shëndetësore ka nevojë të bëhet në QKMF, QMF Roganë dhe Hogosht si dhe në shumicën e AMF nëpër lokalitete  
Paraqitja sa më reale e nivelit të shërbimeve shëndetësore në komunën e Kamenicës është realizuar përmes analizës së indikatorëve si:

- objekti shëndetësor/nr. banorëve
- gjendja fizike e objekteve
- kuadri shëndetësor/nr. banorëve
- kuadri përkatës – kualifikimi i personelit mjekësor
- largësia e shërbimeve shëndetësore

Shtrirja hapësinore e shërbimeve shëndetësore dhe niveli i tyre

Niveli i ulët i shërbimeve shëndetësore sidomos vërehet në ambulantën e Lisockës, Strezovcit, Krilevës, Hajnovcit, pastaj në ambulantën e Desivojcës, Tugjecit, Busavatës, Bosces, Kololeqit si dhe në ambulantën e Bushincës.

Niveli mesatar i shërbimeve shëndetësore vërehet në ambulantën e Topanicës, Kraqevës si dhe në ambulantën e Shipashnicës së Epërme.

Niveli i lartë i shërbimeve shëndetësore vërehet në QKMF-në e Kamenicës, QMF-në e Rogaçicës, QMF – në e Hogoshtit, QMF- në e në ambulancën e Koretinit, Muçivërcës.

Mungesa e shërbimeve shëndetësore

Objekti shëndetësor në raport me numrin e banorëve plotëson kushtin 1Ambulantë/6000 banorë, 1QMF/10.000 banorë, 1QKMF/100.000 banorë që don të thotë se komuna e Kaçanikut mbulohet sa i përket objekteve shëndetësore.

Gjendja e dobët fizike e objektit vërehet sidomos në ambulantën e Muçivërcës, ambulantën e Lisockës dhe ambulancën e Krilevës, pastaj në ambulantën e Strezovcit, ambulantën e Busavatës, si dhe në QKMF-në e Kamenicës, QMF-në e Hogoshtit . Sistemi shëndetësorë në komunën e Kamenicës ka nevojë për investime të mëtejshme si në objekte, infrastrukturë ashtu edhe në mjete të punës.

Kuadri i mjaftueshëm në raport me numrin e banorëve nuk e plotëson kushtin 1mjek + 2 motra/2000 banorë i përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë. Mungesa e kuadrit vërehet sidomos në ambulantën e Rajanovcit, Bushincës, pastaj në ambulantën e Topanicës, Kraqevës, Shipashnicës, Desivojcës, Kopërnices, Lisockës, Tugjecit, Strezovcit, Krilevës, Busavatës, Hajnovcit, Bosces, dhe ambulantes së Kololeqit. Po ashtu vërehet qartë se kuadri aktual shëndetësor është i pa specializuar. Lidhur me këtë duhet punuar në zhvillimin e kapaciteteve të reja superiore si dhe në aftësimin e atyre ekzistuese.


Popullata e vendbanimeve që graviton sidomos në QKMF-në e Kaçanikut, QMF-në e Rogoçicës, QMF-në e Ranillugës, ambulantën e Hajnovcit si dhe banorët që gravitojnë në ambulantën e Desivojcës, Tugjecit, Strezovcit, Ropotovës, Bosces duhet të rrugëtojnë gjatë deri te këto shërbime shëndetësore. Rekomandohet që në këto vendbanime të lehtësohet mundësia e qasjes në shërbimet shëndetësore duke organizuar transport për popullatën.



## SHËRBIMET SOCIALE SOCIAL SERVICES SOCIJALNE USLUGE

### LEGJENDA / LEGEND / LEGENDA

- Kufi komunal
- Zonat kadastrale
- Sipërfaqet e ndërtuara
- Objektet Fetare**
- Xhamitë
- Kishat Ortodokse
- Shërbime shëndetësore**
- Ambulanca të Mjekësisë Familjare
- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare



Burimi i të dhënave: Agjencia Kadastrale e Kosovës  
Institucionet e Komunës së Kamenicës  
Fotografitë ajrore të vitit 2009  
Grupi për Shtytëzimin e tokës dhe mjedisit  
Grupi për Demografi dhe Qëshje Sociale  
Bashkësia Islame  
Bashkësia Katolike  
Bashkësia Ortodokse

Projected Coordinate System: KosovaRef01  
Projection: Transverse\_Mercator  
Geographic Coordinate System: GCS\_ETRS\_1989  
Datum: D\_ETRS\_1989  
Prime Meridian: Greenwich  
Angular Unit: Degree



Harta 30. Shërbimet sociale në Komunën e Kamenicës

### 1.1.2.0 POZITA, RËNDËSIA DHE ÇËSHTJE SPECIFIKE PËR TERRITORIN E KOMUNËS SË KAMENICËS NË KONTEKST TË PHK (PLANIT HAPËSINOR TË KOSOVËS)

“Plani Hapësinor i Kosovës për vitin 2013 – 2023 + ”

Institucionet e Kosovës kanë një përvojë të mirë në fushën e planifikimit hapësinor, që ishte arritur gjatë hartimit të Planit Hapësinor të Kosovës gjatë viteve 70-80 të shek. XX nga Enti i Urbanizmit dhe Projektimit në Prishtinë si dhe OECD-se nga Parisi, ku në këtë dokument që trajtuar edhe Komuna e Kamenicës.

Por trajtim më i veçantë i është bërë me Draft Planin Hapësinor Regjional të Anamoravës, i punuar nga enti i urbanizmit dhe i projektimit në Prishtinë si edhe ekspertët e OECD-së, duke përfshirë territorin e Kamenicës, Gjilanit, dhe Vitisë.

Vitet e para luftës dhe pas luftës së fundit, ishin vite të degradimit dhe shkatërrimeve të shumta nga ajo që ishte planifikuar për ruajtje dhe zhvillim në Kosovë duke pasur ndikim edhe në Komunën e Kamenicës

Me “Ligjin për Planifikim Hapësinor “- 2003 dhe avancimi i tij më 2008 u krijua një kornizë e re ligjore për planifikim hapësinor. Plani Hapësinor i Kosovës 2013-2023+ është plani i parë hapësinor, i cili mbulon tërë territorin e Kosovës (edhe pse në këtë kohë është duke u përgatitur PZHK-PZHU për Komunën e Kamenicës 2011), Plani Hapësinor i Kosovës është ende si dokument pune.

Në kuadër të procesit të hartimit të Planit Hapësinor të Kosovës, është krijuar **vizioni për të ardhmen e Kosovës**, është normale që në vizion të synohet realizimi në tërë territorin e Kosovës në këtë kontekst edhe Komuna e Kamenicës gjatë hartimit të PZHK-se –PZHU-se është duke u analizuar **pozita, rëndësia dhe çështjet specifike që duhet trajtuar**.

Pjesa qendrore e Draft Planit Hapësinor të Kosovës, është strategjia zhvillimore hapësinore, ku bazohet në tri parime kryesore:

- Zhvillimi i rrjetit të fuqishëm urban për zhvillim ekonomik, shumica e zonave urbane janë përmirësuar dhe është themeluar rrjeti i infrastrukturës ndërmjet vendbanimeve të vogla dhe të mëdha, ndërkaq qytetarëve u është ofruar kujdesi shëndetësor, edukimi, bujqësia, mandej industria e lehtë është përkrahur në zonat rurale, industria e rëndë është rehabilituar, si dhe është përkrahur tregtia e turizmi.

- Zhvillimi dhe ruajtja e burimeve natyrore , mbrojtja e përdorimi i mjedisit , trashëgimisë kulturore dhe natyrore, cilësia e tokës bujqësore, burimet minerale, si dhe kontrollimi i zhvillimit dhe i zgjerimit të vendbanimeve.
- Zhvillimi i lidhjeve strategjike, integrimi në rrjetin rajonal dhe evropian të transportit, përmirësimi i nevojave të transportit në Kosovë, si dhe furnizimi i qëndrueshëm me energji elektrike e ujë për banorët dhe industrinë.

Këto parime do të jenë parime bazë, për hartimin e kornizës së zhvillimit hapësinor të Komunës së Kamenicës për atë sa i takon dhe për sa ka kapacitete Komuna e Kamenicës.



Strategjia dhe objektivat për një zhvillim të dëshirueshëm hapësinor, ekonomik, mjedisor dhe shoqëror, janë të ndara në katër grupe:

1. Porti i Kosovës-zona e kaltërt
2. Thesari i Kosovës-zona e gjelbër
3. Urat e Kosovës-zona e verdhë, ku përfshihen rajonet për rreth Gjilanit, Ferizajit, Komuna e Kamenicës dhe rajoni i Gjakovës, për qëndrimin në shërbime, tregti, industri të lehtë, bujqësi dhe turizëm.
4. Parqet e Kosovës-zona e portokalltë.

Në dokumentin e strategjisë hapësinore të Kosovës, komunat e Gjilanit dhe Ferizajit janë të shënuara si, zonat e verdha e të definuara si “Urat e Kosovës”. Komunat e Kamenicës, Artanës, Vitisë, Kaçanikut, Shtërpcës, gjithashtu janë të përfshira në këtë zonë. Kjo zonë karakterizohet me tokën cilësore bujqësore, me burime të pasura të ujit mineral, me tregtinë dhe me traditën e turizmit. Lidhjet ndërkuftare me Maqedoninë dhe Serbinë, sigurojnë kushte të mira për investime në këtë rajon.

Ky dokument parasheh një rol të rëndësishëm për rajonin si një lidhje ndërmjet Kosovës dhe vendeve fqinje, ku vlen të ceket lidhja me pikën kuftare “Dheu i Bardhë” me Serbinë lidhja Kamenicë-Crep-Bujanoc.


Synimet kryesore për rajonin e Gjilanit-Ferizajit, ku bën pjesë edhe Komuna e Kamenicës janë:

-Zhvillimi i rrejtës së vendbanimeve që siguron qasje të lehtë dhe kushte për jetë e punë atraktive në qytetet: Gjilan, Ferizaj, Kamenicë, si dhe fshatrat e këtyre qyteteve.


-Përkrahja e ekonomisë së qëndrueshme të urbanizmit lokal, konkurrencë në tregjet e brendshme dhe të jashtme.

-Zhvillimi i infrastrukturës (transporti rrugor, hekurudhor, ajror, teknologjia e informimit dhe komunikimit) për të krijuar lidhje të përshtatshme ndërbane me pjesët e tjera të Kosovës dhe jashtë vendit.

PHK-se i vendosë kufijtë e rajonit që kryqëzohen me Serbinë dhe Maqedoninë si një zonë me interes të veçantë për tërë Kosovën, ku kjo zonë karakterizohet me tokën cilësore bujqësore, me burime të pasura të ujit mineral, me tregti dhe me traditën e turizmit, pra vlera që e bëjnë të rëndësishëm rajonin, por edhe çështjet specifike për të trajtuar gjatë hartimit të **Planit Zhvillimor dhe Urban të Komunës së Kamenicës**. Një ndër propozimet për zhvillimin e infrastrukturës, është edhe ndërtimi i lidhjes hekurudhore Ferizaj-Gjilan-Bujanoc përmes Komunës së Kamenicës.



Strategjia për zhvillim hapësinor, dokument pune(shiko versionin e ri)



Strategjia për Zhvillim Hapësinor për Rajonin e Gjirokastrës/Ferizajt, ku bën pjesë edhe Komuna e Kamenicës, “Urat e Kosovës”, dokument pune

### **1.1.3.0 PËRFSHIRJEN E INFORMATAVE THELBËSORE TË RAPORTEVE DHE STRATEGJIVE SEKTORIALE NË DISPOZICION**

Në Komunën e Kamenicës janë punuar raportet dhe strategjitë sektoriale në të gjitha drejtoritë, ku në këtë kapitull janë përfshirë informatat thelbësore të raporteve dhe strategjive sektoriale në dispozicion të drejtorive përkatëse të komunës:

#### **1.1.3.1 EKONOMI DHE FINANCA**

##### **Informatat e Përgjithshme:**

Objektivat e Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit në rend të parë janë, ofrimi i shërbimeve për qytetarët dhe subjektet juridike, si dhe mbështetja e zhvillimit ekonomik lokal në të gjitha fusha e ekonomisë të nivelit komunal dhe brenda kompetencave të komunës.

Drejtoria udhëhiqet nga drejtori, i cili koordinon punën me të gjithë sektorët e drejtorisë dhe personelit në përgjithësi, me qëllim të realizimit të objektivave vjetore. Ai merr pjesë në të gjitha mbledhjet e bordit të drejtorëve, mbledhjet e komisioneve të ndryshme, bashkëpunon me të gjitha drejtoritë komunale, kontakton me përfaqësuesit e organeve qendrore e sidomos me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, si dhe me Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë. Drejtpërdrejtë i përgjigjet kryetarit të komunës.

Në kuadër të kësaj drejtorie veprojnë këta sektorë: : Sektori i Ekonomisë dhe Zhvillimit, i Financave, Tatimi në pronë dhe Buxheti.

##### **Çështjet dhe problemet**

- Eksploatimi i resurseve natyrore
- Caktimi i zonave specifike për zhvillim
- Përmirësimi i infrastrukturës ligjore
- Krijimi i fondeve për huadhënie për NVM-ve , e sidomos atyre prodhuese
- Stimulimi i ndërmarrjeve bujqësore
- Krijimi i kushteve lehtësuese për ndërmarrjet, që punësojnë një nr. të madh të punëtorëve
- Zgjedhja e ndërmarrjeve komunale më të suksesshme
- Pozita e volitshme dhe ndërkufitare e Kamenicës

### **Propozimet dhe Prioritetet e Trajtuarra dhe Strategjitë:**

- Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme
- Krijimi i Inkubatorit të Biznesit.
- Identifikimi i Zonës Industriale.
- Organizimi i panairëve
- Regjistrimi i bizneseve nga niveli qendrorë në nivelin lokal.
- Mirëmbajtja dhe riparimi i rrugëve ekzistuese dhe ndërtimi i rrugëve të reja
- Rritja e sasisë dhe cilësisë së ujit të pijshëm
- Ngritja e një kapaciteti për përpunimin e drurit
- Pika grumbulluese të produkteve bujqësore
- Ngritja e një kapaciteti për përpunimin e pemëve dhe perimeve.

### **Buxheti**

- Ndhmon kryetarin e komunës në përgatitjen e projektbuxhetit, para paraqitjes së tij në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin e Komunës;
- Plani dinamik i realizimit të projekteve dhe alokimit të mjeteve për zërat buxhetorë;
- Planifikimi i pasqyrës së rrjedhjes së parasë së gatshme;
- Ofron këshilla profesionale për organet komunale lidhur me menaxhimin e buxhetit;
- Mbikëqyrja e procedurave dhe shpenzimit të mjeteve buxhetore;
- Pranimit i raporteve mujore për dinamikën e realizimit të projekteve nga drejtoritë dhe nga Zyra e prokurimit;
- Përgatitja e raporteve buxhetore, sipas nevojës.

### **Financa**

- Harton projektregulloret komunale për çështje financiare;
  - Udhëheqja e çështjeve financiare;
  - Është përgjegjës për mbajtjen e llogarive dhe raporteve vjetore financiare;
  - Është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe monitorimin e sistemeve dhe procedurave për ekzekutimin e buxhetit;
  - Përgatitë procedurat dhe raportet e kontabilitetit;
  - Jep këshilla profesionale nga fusha e buxhetit të organeve komunale;
  - Planifikon, përcakton obligimet në bazë të rregulloreve komunale të subjekteve të caktuara në komunë, shkallën e ngarkesës, tarifën e taksave dhe gjobave komunale.
- . Angazhohet për inkasimin e obligimeve të subjekteve afariste, personave fizikë për taksa komunale, tatimit në pronë, shfrytëzimit të hapësirave publike , qirave etj.

### 1.1.3.2 URBANIZËM, KADASTËR DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

**Informatat e Përgjithshme:** Në procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe Urban, bazuar në obligimet ligjore por edhe profesionale, duke pasur parasysh se drejtorja jonë si institucion është bartëse kryesore e këtij procesi. Ekipi i ekspertëve të Drejtorisë së Urbanizimit dhe Planifikimit Hapësinor, ka punuar në hartimin e këtij drafti të raportit dhe strategjisë sektoriale, duke qenë të bindur se do të jetë bazë e mire për PZHK dhe PZHU.

#### **Çështjet dhe problemet e këtij raporti:**

-Komasacioni në certifikata të pronës, regjistrimin e këtyre pronave në librat e tokës në kadastër,

nga se shumica e pronarëve të këtyre tokave nuk posedojnë vendimet e ndarjes në komasacion,

por edhe tabelat e ndarjes së tokave në komasacion.

Sfidë kryesore, mbetet digjitalizimi i të gjitha ndryshimeve të bëra në terren.

Zhvillimi i bujqësisë-lavërtarisë (luginat e lumenjve)

Zhvillimi i blegtorisë, bletarisë 9 viset kodrinoro-malore)

Zhvillimi dhe shfrytëzimi i pylltarisë (rreth 27000ha)

Shfrytëzimi i resurseve natyrore rërë, zhavorr (të kontrolluar)

Shfrytëzimi i pasurive natyrore, të mineraleve për rimëkëmbjen i industrisë

Zhvillimi i turizmit në bazë të rekomandimeve në diskutimet publike për Planin H hapësinor të Kosovës në V-L të komunës në Malin "KIKA"(turizëm rekreativ dhe shëndetësor)

Mundësitë e shfrytëzimit të ujit të lumenjve për pije, ujë industrial dhe ujitje.

Rekomandohet ndërtimi i tri pikave ujëmbledhëse në Kremenatë, në Gjyrishec dhe në Desivojcë, që përfshinë pjesën më të madhe të popullatës dhe tokave bujqësore.

Zgjerimi i infrastrukturës rrugore, Kamenicë-Crep-Bujanoc dhe Crep-Gjilan M25.3

Hapja e rrugëve të reja dhe lidhja me shtetin fqinj Hogoshtë-Poliçkë-Desivojcë-Tërstenë-Lebanë (parandalimi i migrimeve)

Lidhja me unazën e jashtme që është paraparë me Planin Hapësinor të Kosovës me rrugën Kamenicë –Krivë-Podujevë

Rregullimi i rrugëve kodrinoro-malore, Hogoshtë-Lisockë-Gjyrishec-Gmicë-Tugjec

Shfrytëzimi i kapaciteteve të turizmit kulturor(inventarizimi i tyre dhe oferta turistike)

Shfrytëzimi i peizazheve natyrore për turizëm rural .

Mundësitë e zhvillimit të zonës industriale në trekëndëshin ekonomik ,në Crep për

shkak të pozitës gjeografike dhe shtrirjes si regjion në mes të tri qendrave, Kamenicë-Bujanoc-Gjilan (shtrirja hapësinore: zhvillim i kontrolluar në tokat me kualitet të dobët)

Është shumë e rëndësishme që niveli i shërbimeve arsimore dhe shëndetësore të përmirësohet (kuadri arsimor dhe shëndetësor, hapësira, pajisjet, zvogëlimi i distancave nga objektet në shtëpi etj.). Kjo do të ndikonte drejtpërdrejtë në përmirësimin e kualitetit të jetës në përgjithësi, si dhe ngritjen e standardit jetësor.

Në aspektin e edukimit dhe të shëndetësisë, kujdes i veçantë duhet ti kushtohet grupeve të caktuara shoqërore që paraqiten me kërkesa të veçanta dhe mjaft specifike. Përmirësimi i shërbimeve publike në këto hapësira do të ndikojë shumë në uljen e shkallës së varfërisë: rrugët, kanalizimi, ujësjellësi, telekomunikimet etj.

Të planifikohet një perspektivë më e mirë për zhvillimin dhe përkrahjen e industrisë ekzistuese si dhe të bujqësisë të cilat do të ndikojnë në zhvillimin e përgjithshëm të kësaj komune.

Për zvogëlimin e shkallës së depopullimit, rekomandohet që të stimulohet popullsia e këtyre vendbanimeve për veprimin dhe krijimin e kushteve më të mira për jetesë në këto hapësira. Që të arrihet ky rezultat është e nevojshme të hapen mundësi për zgjerimin e aktiviteteve ekonomike dhe investime në mjete teknike, lehtësime në shkollimin e të rinjve, përmirësimin e shërbimeve (rrugët, ujësjellësi, kanalizimi, energjia etj.), mbrojtja dhe menaxhimi më i mirë i resurseve natyrore etj.

Mungesa e hapësirës shkollore është sidomos e shprehur në ShMLP “Andrea Durrsaku” të Kamenicës, pastaj në Gjimnazin “Ismail Qemali” të Kamenicës, ShFMU “Metush Krasniqi” të Rogaçicës. Mu për këtë arsye rekomandohet zgjerimi apo ndërtimi i objekteve të reja shkollore në këto vendbanime.

Gjendja e dobët fizike e objekteve, sidomos vërehet në ShFMU të Busavatës, pastaj në SHFMU të Kamenicës, Rogaçicës, Koretinit, Hogoshtit, Tugjecit, Topanicës, Karaçevës së Poshtme, Krilevës, pastaj në gjimnazin e Kamenicës, ShMLP të Kamenicës, në paralelen e ndarë të SHMLP të Rogaçicës si dhe në atë të gjimnazit në Hogosht. Shkollat kanë nevojë për investime në objekte, kanalizim, ujësjellës në rregullim të oborreve dhe të fushave sportive dhe pajisje me laboratorë, kabinete dhe punëtori me mjete të nevojshme konkretizuese arsimore.

Kuadri i mjaftueshëm, pra raporti nxënës – mësimdhënës plotëson kushtin 21nx./1mësimdhënës i përcaktuar nga MASHT (Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë).

Mungesa e kuadrit përkatës, respektivisht kualifikimit të mësimdhënësve sidomos vërehet në shkollën fillore të Tugjecit dhe të Krilevës, pastaj në shkollën fillore të Desivojcës, Poliçkës, si dhe në dy shkollat e mesme të larta të Kamenicës, në paralelet e ndara të gjimnazit të Rogaçicës dhe të Hogoshtit. Në këtë kuptim duhet ndihmuar më tej zhvillimin profesional të punëtorëve shkencor të rinj dhe të atyre aktual.

Nxënësit e Komunës së Kamenicës kalojnë distanca të gjata deri në shkollë. Sidomos nxënësit e vendbanimeve që gravitojnë në shkollat e mesme të larta të Kamenicës duhet të rrugëtojnë gjatë deri në shkollë. Gjithashtu, edhe nxënësit e vendbanimeve që gravitojnë në ShFMU të Kamenicës, Rogaçicës, Lisockës, si dhe nxënësit e shkollës fillore të Desivojcës, Poliçkës, Strezocit, kalojnë distanca të gjata të rrugës deri në

shkollë. Rekomandohet që në këto vendbanime të lehtësohet mundësia e qasjes në shërbimet arsimore duke organizuar transport për nxënës.

Objekti shëndetësor në raport me numrin e banorëve, plotëson kushtin 1ambulancë/6000 banorë, 1QMF/10.000 banorë, 1QKMF/100.000 banorë që do të thotë se, Komuna e Kamenicës mbulohet sa i përket objekteve shëndetësore. Gjendja e dobët fizike e objektit vërehet sidomos në ambulancën e Muçivërcit, ambulancën e Lisockës dhe ambulancën e Krilevës, pastaj në ambulancën e Strezocit, ambulancën e Busavatës, si dhe në QKMF-në e Kamenicës, QMF- në e Rogaçicës, QMF-në e Hogoshtit . Sistemi shëndetësor në Komunën e Kamenicës, ka nevojë për investime të mëtejshme si në objekte, infrastrukturë ashtu edhe në mjete të punës. Kuadri i mjaftueshëm në raport me numrin e banorëve nuk e plotëson kushtin 1mjek + 2 motra/2000 banorë i përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë. Mungesa e kuadrit vërehet, në ambulancën e Topanicës, Karaçevës, Shipashnicës, Desivojcës, Kopërnicsës, Lisockës, Tugjecit, Strezocit, Krilevës, Busavatës, Hajnovit, Bosces, dhe ambulancës së Kolloleqit. Po ashtu, vërehet qartë se kuadri aktual shëndetësor është i pa specializuar. Lidhur me këtë, duhet punuar në zhvillimin e kapaciteteve të reja superiore si dhe në aftësimin e atyre ekzistuese. Popullata e vendbanimeve që graviton, sidomos në QKMF-në e Kamenicës, QMF-në e Rogaçicës, ambulancën e Hajnovit si dhe banorët që gravitojnë në ambulancën e Desivojcës, Tugjecit, Strezocit, duhet të rrugëtojnë gjatë deri te këto shërbime shëndetësore. Rekomandohet që në këto vendbanime të lehtësohet mundësia e qasjes në shërbimet shëndetësore, duke organizuar transport për popullatën. Që të kemi një harmonizim të plotë lidhur me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, është i domosdoshëm bashkëpunimi i drejtorive komunale për kulturë me Institutet për mbrojtjen e monumenteve kulturore, MKRS-Departamentin e kulturës/ dhe me MMPH- Institutin për planifikim hapësinor. Ky bashkëpunim do të mund të rezultojë me një gjendje reale të pasurive të shumta të monumenteve kulturoro-historike që ka Kosova në tërësi dhe Komunitat në veçanti, i cili do të ketë si rezultat mbrojtjen, ruajtjen, konservimin, zhvillimin dhe promovimin e saj; Respektimin e legjislacionit (Ligjit për Planifikim Hapësinor, Ligjit për Trashëgimi Kulturore), të cilët do të mundësojnë zhvillim të qëndrueshëm të komunave në sferën e trashëgimisë kulturore dhe historike; Niveli komunal duhet të ngrehë vetëdijen e popullatës vendëse për rëndësinë e trashëgimisë kulturore; Të bëhet shenjëzimi i monumenteve që kanë status të mbrojtjes dhe monumenteve tjera të rëndësishme për komunën (të vihen shenjat e identifikimit të monumentit, në afërsi të tyre), do të jetë ndihmes për turistët që e vizitojnë këtë rajon; Katalogu i komunës është shumë i rëndësishëm, sepse përmes tij me pak fjalë dhe fotografi do të promovohen pasuritë dhe potencialet e Komunës së Kamenicës, i cili do të ndikojë në zhvillimin e të gjitha sferave, pra një zhvillim të gjithëmbarshtëm të saj. Drejtoria për Kulturë e K.K.Kamenicë duhet, që sa më parë të hartojë listën e monumenteve kulturo-historike që do të duhej të kenë status të mbrojtjes; zhvillimin e turizmit në këtë komunë. Të respektohen parimet udhëzuese të politikës për mbrojtjen e mjedisit; Të bëhet inventarizimi i monumenteve natyrore dhe të propozohen zonat për mbrojtje.

Respektimi i legjislacionit si, i Ligjit për Planifikim Hapësinor, Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, do të mundësonte mbrojtjen e mjedisit konform zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë;

Bashkëpunimi i pushtetit qendror (MMPH, MKRS dhe MTI), instituteve për mbrojtjen e mjedisit dhe pushtetit lokal (drejtoritë për mjedis), është i domosdoshëm me qëllim të harmonizimit të aktiviteteve në mbrojtjen e trashëgimisë natyrore si potencial i zhvillimit të gjithëmbarshtëm të Kosovës;

Të stimulohet zhvillimi i turizmit me investime në infrastrukturën teknike dhe në objektet turistike, përmes promovimit të vlerave të trashëgimisë natyrore që i ka kjo anë. Kjo do të ndikonte edhe në rritjen e zhvillimit të gjithëmbarshtëm të komunës në veçanti dhe të Kosovës në përgjithësi.

Zhvillimi i politikave për parandalimin e humbjes së tokës bujqësore, si resurs shumë i rëndësishëm në këtë rast, për qytetin e Kamenicës dhe komunën në përgjithësi;

Zonimi i territorit të komunës (përcaktimi i zonave të cilat do të përdoren vetëm për kultivimin e kulturave bujqësore dhe jo për qëllime tjera);

Me rastin e zgjerimit të qyteteve dhe vendbanimeve (me planet urbanistike), të mbrohet toka bujqësore, sidomos ajo e kategorive I, II, III dhe IV dhe të krijohet tampon zona me rreth 150 m, në harmoni me Ligjin për Tokat Bujqësore si dhe kategoritë tjera të tokës, të cilat kanë mundësinë e sistemit të ujitjes.

Që të arrihet një zhvillim i mirëfilltë i bujqësisë në komunë, kërkohet mbrojtje dhe shfrytëzim racional i tokës bujqësore, organizim i mirë shoqëroro-ekonomik, investime në mjete dhe teknologji të punës, teknologji bashkëkohore për një bujqësi intenzive, hapja e mini fabrikave për përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale.

Kategoria V-VIII e tokës brenda sipërfaqes kodrinore të shfrytëzohet për ndërtim industrial, kullosë ose pyje.

Tokat që kanë pjerrtësi > 15% propozohen për kullosa dhe pyje me qëllim të parandalimit të erozionit dhe shkatërrimit të pjesës pedologjike dhe trollit.

Shfrytëzimi tokës në fusha lumore të lumenjve kryesor, duhet të kufizohet me kullosa të përhershme ose me pyje me qëllim të mbrojtjes së tokave të lëvrueshme nga **Erozioni**, **shpërlarja por edhe nga vërshimi**.

Erozioni duhet të kufizohet me brigjet e lumenjve kryesore me mbëltime të druve që do ta mbulonin sipërfaqen prej 10 m nga largësia e lumit;

Rregullimi i shtratit të lumit dhe pastrimin e tij, përkatësisht të Lumit „Kriva Reka“ në linjën Hajnoc-Domaroc;

Rregullimi i shtratit të lumit dhe pastrimin e tij, përkatësisht të lumit Hogoshtit, nga Hogoshti deri në Domaroc;

Rregullimi i shtratit të lumit dhe pastrimin e tij, përkatësisht të Lumit „Katushnica“, nga Karaçeva deri në Katushnicë;

Rregullimi i shtratit të lumit dhe pastrimin Lumit të Rubocit;

Ç'rregullimi natyror i shtratit të lumit (nxjerrja ilegale e inerteve);

Ngushtimi i shtratit të lumit nga uzurpimet;

Hedhja e mbeturinave të ngurta në shtretërit e lumenjve;

Mbjellja e bimëve të larta si dhe të atyre të vetritura pranë brigjeve të lumenjve etj.

Shkatërrimi i objekteve hidroteknike dhe moskujdesi i vazhdueshëm (argjinaturat) etj.

Rregullimi i shtretërve të lumenjve në baza natyrore;

Pastrimi i shtratit të lumit nga mbeturinat e ngurta;



Mirëmbajtja dhe ndërtimi i argjinaturave (sipas nevojës);  
 Përcaktimi i kritereve profesionale për shfrytëzimin e inerteve si dhe ndalimi i shfrytëzuesve ilegalë;  
 Eliminimi i pengesave natyrore, përgjatë shtratit të lumit etj.(urgjent në Lumin “Kriva Reka”);  
 Krijimi i zonave të gjelbra (mbjellje e drunjve )10m nga lumi;  
 Meliorimi i pyjeve;  
 Ndërtimi i brezave mbrojtës në shpatiet e rrëpishme;  
 Parandalimi i prerjes ilegale të pyjeve etj.  
 Tokat që kanë pjerrtësi të terrenit mbi 15% të mbillen me kullosa ose edhe me pyje;  
 Përcaktimi i lokacionit për impiant nga komuna, varësisht se cili variant i përshtatet;  
 Preferohet ndërtimi i impiantit të decentralizuar me lokacionin e propozuar afër Urës së Mbretit në mes të lokacionit Crep – Dheu i Bardhë;  
 Ndalimi i shkarkimit të ujërave industrial në rrjedhjet ujore;  
 Obligimi me ligj që çdo objekt industrial ti ketë edhe stabilimentet për pastrimin e ujërave industriale;  
 Rregullimi i shtretërve të lumenjve;  
 Ndalimi i nxjerrjes ilegale të inerteve nga lumenjtë dhe ndalimi i seperimit të rërës në ujërat e lumenjve;  
 Ndalimi i qarkullimit të mjeteve motorike në ujërat e lumenjëve;  
 Mënjanimi i mbeturinave në të gjitha vendbanimet, ku janë të grumbulluara;  
 Riciklimi i mbeturinave;  
 Shfrytëzimi racional i resurseve pyjore;  
 Ripyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura nëpër pyje;  
 Mënjanimi i deltës dhe inerteve të grumbulluara;  
 Rehabilitimi i tokës më parë të mbuluar me inerte;  
 Asfaltimi i rrugëve qe qojnë drejt fshatrave te malësisë;  
 Zhvillimi i programeve që kanë për qëllim kthimin e banorit në viset e malësisë;  
 Zhvillimin e programeve me qëllim të komunikimit dhe bashkëpunimit ndërkufitar;  
 Zhvillimi i programeve te zhvillimit rural, me theks të veçantë në fshatrat që ndodhen në nivelin e ulët të zhvillimit ekonomik;  
 Përforcimi i kushteve në vazhdimin e progresit në vendbanimet me zhvillim të lartë;  
 Koncentrimi i bizneseve në trekëndëshin potencial të zhvillimit ekonomik(Kryqëzimi i rrugëve Kamenicë-Gjilan-Bujanoc ) Crep;  
 -Kamenicë - Kopërrnicë (ku pëfshinë fshatrat Grizimë, Stralicë, Bosce)  
 -Kamenicë - Ranillug (Korminjan, Gllogoc, Ropotovë);  
 Kamenica ka lidhje edhe me të gjitha fshatrat tjera, që nuk u përmendën por përmes rrugëve dytësore dhe të pa asfaltuara;  
 Kryesisht, vendbanimet në zonat e thella malore të Komunës së Kamenicës nuk kanë rrugë të asfaltuara . Ky fakt sjell, si pasojë ngecjen në zhvillimin e gjithëmbarshtëm të atyre vendbanimeve, ku kjo pastaj ka si pasojë migrimin e popullsisë nga ato vendbanime.  
 Lidhja me rrugë të asfaltuara midis vendbanimeve dhe po ashtu me qendrën komunale, mundëson lëvizje më të lehtë dhe komunikim më të mirë midis tyre, që si pasojë ka edhe shkëmbimin më të lehtë dhe të avancuar të të mirave e rrjedhimisht edhe ngritjen e mirëqenies. Kur në mungesë të rrugëve, lëvizja prej zonave më pak të zhvilluara, në

ato më shumë të zhvilluara është e vështirë, banorët nga ato zona ose shpërngulen ose mbesin të izoluar dhe ngecin në zhvillim si në aspektin social ashtu edhe në atë ekonomik. Në zonat ku rrjeti rrugor është pak i zhvilluar edhe zhvillimi ekonomik, si industria, bujqësia dhe tregtia, është nën nivelin mesatar të zhvillimit e kjo vlen edhe për zhvillimin social siç janë shërbimet shëndetësore dhe arsimore. Ndërtimi i rrugëve dhe lidhjeve të reja mundëson dhe krijon kushte që shërbimet të ngriten në nivel më të lartë duke ndikuar në këtë mënyrë në ndalimin e shpërnguljes së popullatës në kërkim të kushteve më të mira.

Zgjerimi i rrugëve të asfaltuara, duhet të planifikohet, të bëhet në ato drejtime të cilat mundësojnë një zhvillim më të madh të komunës, në relacionet e rrugëve më të frekuentuara, si ajo në drejtimin Kamenicë – Crep – Dheu i Bardhë – Terminali Doganor dhe Crep - Gjilan. Duhet të bëhet asfaltimi i rrugëve lokale, të cilat janë kryesisht të pa asfaltuara e sidomos në viset malore dhe brezin kufitar, në mënyrë që të ndalet shpërngulja e popullatës së këtyre viseve. Si prioritet duhet të jetë asfaltimi i rrugës Hogosht – Poliçkë – Desivojcë – Tërstenë.

Nga niveli i dëmtimit të rrugëve, shihet se rrugët më të dëmtuara janë relacionet Dheu i Bardhë – Hogosht dhe Karaçevë e Poshtme – Karaçevë e Epërme, prandaj një ndër prioritet duhet të jetë asfaltimi i këtyre rrugëve.

Në mënyrë që të mundësohet një lidhje më e favorshme me qendrat e tjera komunale, në Planin Hapësinor të Kosovës është propozuar ndërtimi i rrugës që lidhë drejtpërdrejt Kamenicën me Podujevën ( që kalon në relacionin Kamenicë – Strezoc – Krilevë – Podujevë), që mbyll rrugën unazore të qendrave të Kosovës.

Nga analiza e shtrirjes hapësinore të transportit publik (me autobus, përkatësisht me kombibus), shihet se ai zhvillohet edhe nëpër vendbanime, të cilat nuk i kanë rrugët e asfaltuara, çka do të thotë se këto rrugë, duhet të jenë në prioritetet e komunës për asfaltimin dhe ngritjen e kategorisë së tyre, në mënyrë që transporti publik të jetë sa më kualitativ.

Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit publik dhe qasja më e madhe e popullatës në të, e sidomos në pjesët e komunës që kanë potenciale të zhvillimit (ekonomik, bujqësor, turistik, social, kulturor, shëndetësor e arsimor), e të cilat do të ndihmoheshin për zhvillim të mëtutjeshëm me qëllim të përmirësimit të kushteve dhe kualitetit të jetës.

Ndërtimi i akumulacioneve ujore në Kremenatë, Desivojcë dhe Gjyrishec,

Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza dhe qasja më e madhe e popullatës në të; gjithashtu ndërtimi i impiantit për përpunimin e ujërave të zeza,

Duke u bazuar në të dhënat që thonë se, në Kosovë prodhohet rreth 1.2 kg mbeturina në ditë për kokë banori, dhe në anën tjetër duke e marrë parasysh shkallën e shtrirjes së këtij shërbimi në komunën e Kamenicës dhe numrin e popullatës të përfshirë nga ky shërbim, mbetet nevojë që shërbimi i largimit të mbeturinave të zgjerohet dhe nga ai të përfshihet e tërë popullata.

furnizimi i baraspeshuar me energji elektrike i të gjitha zonave të komunës, si dhe përmirësimi i rrjetit të shpërndarjes në mënyrë që mos të mbeten vendbanime me tension të dobët të rrymës elektrike;

Shtrirja e rrjetit të telefonisë fikse dhe mobile edhe në vendbanimet tjera të komunës.

### 1.1.3.3 ARSIMI

#### **Informatat e Përgjithshme:**

Komuna e Kamenicës, është shumë vaçantë dhe që veçohet prej shumë komunave tjera të Kosovës. Është e tillë për shkak të relievit, strukturës etnike (92% shqiptarë, të tjerë serbë dhe rreth 300 romë), prandaj planprogrami i punës së DKA-së është mbështetur në këta faktorë, pastaj në kompetencat dhe përgjegjësit e mbështetura në ligj dhe në statutin e komunës. Zhvillimin e institucioneve arsimore komunale, e bazon edhe në Strategjinë e Zhvillimit të Arsimit i hartuar nga MASHT-i. Planprogrami i DKA-së, nuk do të jetë i ngurtë por gjithnjë do të përshtatet me proceset e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe Urban të Komunës së Kamenicës.

#### **HISTORIK I SHKURTËR I ARSIMIT NË KAMENICË**

Procesi mësimor dhe edukativ në Komunën e Kamenicës zhvillohet në këto nivele: parashkollor (qerdhe), parafillor, fillor, i mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë. Mësimi zhvillohet në dy gjuhë, shqipe dhe serbe. Nxënësit romë mësimet i ndjekin në shkollat serbe.

#### **Institucionet arsimore**

- 4 20 paralele parafillore 319 fëmijë, 302 shqiptarë, 14 serbë dhe 3 romë;
- 5 SHFMU: 17 (gjuhë shqipe), 3 (gj. serbe), me 5451 nxënës;
- 6 ShML: 2 (gjuhë shqipe), 2 gjuhë serbe me 2265 nxënës.

Në qytet është qerdhja e fëmijëve, ku janë vendosur 34 fëmijë, 7 edukatore dhe 8 punëtorë teknik dhe administrativ. Objekti është shumë i përshtatshëm dhe ka një ambient të bukur.

#### **Çështjet dhe problemet e këtij raporti:**

Përshkrimi i mësipërm i sfidave për hartimin e PZHK dhe PZHU, janë treguesë të mjaftueshëm se me çfarë problemesh ballafaqohet DKA-ja në Kamenicë:

- shkollat tona prej vitit 2007 përpos në fshatrat kodrinore-malore, edhe në ato luginore-rrafshinore janë duke u ballafaquar me rënien e dukshme të numrit të nxënësve;
- zhvillimi i mësimet në tri turne dhe me orë mësimore të reduktuar;
- menaxhimi i buxhetit me procedura, tejet të centralizuara;
- procedurat e koklavitura të prokurimit;
- mungesa e mjeteve financiare;
- udhëtimet e gjata të nxënësve prej një fshati deri në shkollën amë;
- mungesa e mjeteve të konkretizimit, pajisjeve përkatëse e kabineteve dhe e laboratorëve të shkollave;
- pamundësia e organizimit të orëve praktike adekuate për nxënësit e shkollave profesionale;
- pamundësia e organizimit të mësimet joformal për arsimin fillor dhe të mesëm të ulët;

- mungesa e ngrohjes qendrore në konvikt dhe në disa shkolla tjera;
- mungesa e kontrollimit shëndetësor të nxënësve;
- mungesa e sallave të edukatës fizike në shkollat e mëdha;
- funksionimi paralel i shkollave me mësim në gjuhën serbe;
- pengesat ligjore për monitorimin e drejtpërdrejtë të procesit mësimor nga ana e DKA-së.

### **Propozimet dhe Prioritetet e Trajtuarra dhe Strategjitë:**

Për periudhën e ardhshme pesëvjeçare DKA-ja e mbështetur në parime profesionale, për arsimin para universitar në komunë synon që:

1. të sigurojë hapësirë të mjaftueshme shkollore,
2. të sigurojë shkollimin për të gjithë, pra të gjitha llojet dhe mundësitë e arsimit para universitar;
3. të punojmë me të gjitha mundësitë për integrimin e shkollave me mësim në gjuhën serbe në sistemin e përbashkët të Republikës së Kosovës;
4. t'i ofrohen kushte të barabarta, edhe organizimit të arsimit privat;
5. jetësimi i reformës sipas strategjisë së MASHT-it për të gjitha nivelet e arsimit para universitar, me qëllim të respektimit dhe të pranimit a njohjes së plotë nga vendet më të përparuara të botës.

#### **1.1.3.4 SHËNDETËSIA DHE MIRËQENIA SOCIALE**

##### **Informatat e Përgjithshme:**

Duke marrë parasysh se, në komunën tonë ekziston vetëm mbrojtja primare shëndetësore, rëndësia e saj është shumë e madhe për ç'arsye para nesh shtrohet detyra e patjetërsueshme, për të ngritur nivelin në shkallen më të lartë të mundshme.

Kujdesi primar shëndetësor në komunën tonë është i organizuar siç vijon:

- Ofrimi i shërbimeve shëndetësore parësore përmes konceptit të mjekësisë familjare
- Menaxhimi i sëmundjeve kronike (hipertensioni, diabeti, astma TBC etj.);
- Zvogëlimi i mortalitetit dhe morbiditetit të fëmijëve nën moshën 5 vjeçare;
- Përmirësimi i shëndetit mendor, duke zhvilluar shërbime të shëndetit mendor të bazuar në komunitet e në bashkëpunim me Qendrën e Shëndetit Mendor;
- Ngritja e shkallës së imunizimit;
- Reduktimi i sëmundjeve ngjitëse;
- Menaxhimi racional me barëra në nivel lokal dhe pajisje mjekësore ;
- Ngritja e vazhdueshme profesionale e punëtorëve shëndetësor dhe e atyre jo shëndetësor.

## **Çështjet dhe problemet e këtij raporti:**

### **Problemet me të cilat përballlet qendra e mjekësisë familjare**

- Ofrimi i shërbimeve shëndetësore parësore përmes konceptit të mjekësisë familjare;
- Në të gjitha këto mungojnë objektet përcjellëse si garazhat, depot, furrat për djegien e mbeturinave;
- Kujdesi primar shëndetësor në komunën tonë është i organizuar siç vijon: ofrimi i shërbimeve shëndetësore parësore përmes konceptit të mjekësisë familjare;
- Menaxhimi i sëmundjeve kronike (hipertensioni, diabeti, astma TBC etj);
- Zvogëlimi i mortalitetit dhe morbiditetit të fëmijëve nën moshën 5 vjeçare;
- Përmirësimi i shëndetit mendor duke zhvilluar shërbime të shëndetit mendor të bazuar në komunitet e në bashkëpunim me Qendrën e Shëndetit Mendor;
- Ngritja e shkallës së imunizimit;
- Reduktimi i sëmundjeve ngjitëse;
- Menaxhimi racional me barëra në nivel lokal dhe pajisje mjekësore ;
- Ngritja e vazhdueshme profesionale e punëtorëve shëndetësor dhe e atyre joshëndetësor ;
- Kanalizimi ka nevojë të rregullohet në shumicën e AMF nëpër lokalitete;
- Renovimi i objekteve shëndetësore ka nevojë të bëhet në QKMF, QMF Rogaçicë dhe Hogosht, si dhe në shumicën e AMF nëpër lokalitete.

### **Propozimet, Prioritetet e Trajtuara dhe Strategjitë:**

- Ndarja e repartit të emërgjencës nga pjesa tjetër e QKMF, në të ardhmen mendohet të jetë njësi më vete;
- ajo duhet të funksionojë 24 orë, ku mendohet që emergjenca të ketë objekt më vete me të gjitha pajisjet e nevojshme për emërgjencë;
- dhënia e ndihmës së parë shumë më shpejtë dhe pa u penguar nga pacientët e tjerë;
- t' i iket ballafaqimit të pacientëve të rëndomtë nga rastet e rënda emergjente;
- në Kamenicë duhet të bëhet një qendër spitalore - të rregullohet objekt i ri.

#### **1.1.3.5 BUJQËSIA, PYLLTARIA DHE ZHVILLIMI RURAL**

##### **Informatat e Përgjithshme:**

Territori i Komunës së Kamenicës shtrihet në një sipërfaqe prej 417 km<sup>2</sup>, me rreth 36204 banorë të grupuar në 58 fshatra. Numri i ekonomive familjare-bujqësore sillet rreth 4500 sish. Nga e gjithë sipërfaqja e përmendur më lartë, sipërfaqe bujqësore janë 22.770 ha. (ara 15.338ha, kullosa 7.432 ha). 58 % dhe pyje 16.591.8 ha ose 42% .

-Tokë e punushme 13.950 ha këtu bëjnë pjesë:

- Ara 12.284 ha
- Perime 61 ha
- Pemë 137 ha
- Livadhet 2.897 ha
- Kullosa 7.432 ha
- Male 16.591 ha .

Madhësia mesatare e fermës është 2.2 - 2.4 ha për familje, të ndara në 6-8 ngastra, fermat janë kryesisht të vogla dhe gjysmë komerciale. **IA** madhësia e fermës në Komunën e Kamenicës, por edhe në Kosovë është për disa herë më e vogël se ajo që është në nivelin e Bashkësisë Evropiane. Prona mesatare në BE në vitin 1997 ishte 18.4 ha me variacione në mes 4.3 ha në Greqi dhe 69.3 ha në Britaninë e Madhe

Me tepër se 60 % të popullatës jetojnë në zonat rurale, ku në komunën e Kamenicës mendohet se janë rreth 4500 ekonomi familjare që merren me bujqësi.

#### **Çështjet dhe problemet e këtij raporti:**

- Mbrojtja e tokës bujqësore
- Parcializimi i tokave bujqësore
- Rregullimi i sipërfaqeve punuese të tokës, përmes formës së komasacionit
- Prodhimtaria e ulët,
- Mungesa e sistemit të ujitjes për sipërfaqet bujqësore
- Ndërmarrja e masave meliorative
- Menaxhimi dhe shfrytëzimi i kullotave natyrale
- Mungesa e objekteve për ruajtjen e prodhimeve bujqësore
- Mungesa e mekanizmit adekuat bujqësor
- Mungesa e kapaciteteve përpunuese
- Fermat e vogla
- Mungesa e bashkëpunimit në mes të fermerëve
- Mosorganizimi dhe mosfunksionimi i shoqatave-kooperativave të fermerëve në nivelin e duhur
- Mbrojtja e pyjeve
- Privatizimi.

#### **Propozimet dhe Prioritetet e Trajtura dhe Strategjitë:**

1. Sigurimi i ushqimit: Ruajtja e mundësive ekonomike të Komunës së Kamenicës që të shfrytëzojë në mënyrë efikase resurset e veta rurale, për ta zvogëluar nevojën e importit të ushqimit, si dhe ushqimit të kafshëve;
2. Krijimi i kushteve të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve blegtorale sipas kriterëve të ekonomisë së tregut;
3. Krijimi i mekanizmave të nevojshëm për zbatimin e ligjit dhe mbështetjen e fermerëve;
4. Privatizimi i aseteve të ndërmarrjeve shoqërore;
5. Mbështetja e fermerëve komercialë përmes kredive preferenciale;
6. Zhvillimin e agropërpunimit;
7. Krijimi i mundësive për punësim të popullatës rurale me qëllim të krijimit të të ardhurave dhe parandalimin e migrimit.

Të gjitha këto veprime kanë për qëllim krijimin e një sistemi komercial të fermave të mëdha të orientuara në treg me një fond dhe strukturë racore të qëndrueshme e produktive, si dhe një industri përpunuese që do të përgjigjet kapaciteteve prodhuese e të sigurojë cilësi sipas ( HASAP dhe ISO)kërkesave të konsumatorëve etj.

#### **1.1.4.0 ÇËSHTJE KYÇE TË KONTEKSTIT MË TË GJERË HAPËSINOR, TË CILAT INKORPOROJNË UDHËZIME, PLANIFIKIME DHE OBLIGIME, TË CILAT RRJEDHIN NGA DOKUMENTET DHE PLANET (HAPËSINORE) PËR RAJONE MË TË GJERA, E QË AFEKTOJNË KOMUNËN E KAMENICËS**

Udhëzimet e përmbledhura në këtë kaptinë, qartësojnë një sërë të çështjeve që dalin nga Plani Hapësinor i Kosovës, lidhur me atë se çka çdo komunë e në këtë rast komuna e Kamenicës, ku duhet pasur parasysh gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal e Urban, njëkohësisht si material do ta lehtësojë komunikimin mes dy niveleve të planifikimit.

##### **1.1.4.1 BANIMI - Autoritetet lokale të planifikimit duhet të:**

- Planifikojnë kërkesat për banim për të gjithë, prej shtresave më të ulëta, ata me nevoja për banim të volitshëm dhe nevoja speciale;
- Ofrojnë mundësi dhe zgjedhje më të mëdha banimi, me kombinim të mirë në madhësi, lloje dhe lokacione të banimit dhe të kërkojnë të krijojnë komunitete të përziera;
- Ofrojnë tokë të mjaftueshme banimi, me prioritet rishfrytëzimit të tokës brenda zonave urbane, duke i shfrytëzuar edhe shtëpitë e zbrazëta dhe duke transformuar ndërtesat ekzistuese;
- Krijojnë modele më të qëndrueshme të zhvillimit, duke ndërtuar dhe siguruar transportin publik, për në punë, arsim dhe ente shëndetësore, tregti, argëtim dhe shërbime lokale;
- Shfrytëzojnë në mënyrë më efikase tokën, përmes politikave dhe standardeve të planifikimit;
- Vlerësojnë nevojat e njerëzve për transport urban, kërkesa këto për lëvizje brenda vendbanimeve, zonës urbane dhe lidhjeve me qendrat e tjera;
- Zvogëlojnë varësinë ndaj veturave, duke mundësuar më shumë trafikun e këmbësorëve dhe të çiklistëve, duke përmirësuar lidhjet e transportit publik me banimin, punën, shërbimet lokale e mundësitë lokale dhe duke planifikuar destinim të përzier; si dhe
- I japin shtytje dizajnit të mirë në zhvillimet e reja të banimit, për të krijuar ambiente atraktive, me cilësi të lartë në të cilat njerëzit do të gjedhin të jetojnë.

##### **Vendbanimet joformale**

- Gjatë hartimit të planeve komunale dhe urbane, kërkohet të identifikohen të gjitha VJF bazuar në kriteret e përgjithshme. Planet lokale, po ashtu duhet ti trajtojnë këto vendbanime me qëllim të përmirësimit të gjendjes socio-ekonomike, mjedisore dhe të infrastrukturës.

## 1.1.4.2 LOKACIONET STRATEGJIKE DHE PORTET E ZHVILLIMIT EKONOMIK

### Çështjet dhe arsytet për udhëzime

Duke u bazuar në faktin se Kosova nuk ka zhvillim të barabartë në hapësirat e saja. Në mungesë të planifikimit për një shfrytëzim racional të hapësirës, vendbanimet- qytetet e mëdha vazhdojnë trendin e rritjes së tyre, me rritje të zhvillimeve joformale, kosto të lartë të investimeve në infrastrukturë fizike dhe shërbime, si dhe në pamundësi për veprim sinergjik. Trendi i migrimit drejt qendrave të mëdha vazhdon, ndërsa mungesa e hapësirave për banim me qasje dhe kushte të volitshme është prezent. Qytetet vazhdojnë zhvillimin e tyre në kushte të ekonomisë së tregut, me kritere të mbijetesës e jo të promovimit të zhvillimit komplementar. Për shkak të funksionit si qendër administrative dhe universitare, Prishtina grumbullon veprimtaritë kryesore ekonomike dhe sociale, të cilat i ofrojnë pozitë të favorshme në tregun rajonal, por në kontekstin kosovar implikon zhvillim të pabarabartë socio ekonomik e hapësinor të pjesëve tjera të Kosovës, me shpopullim të zonave rurale dhe qendrave më të vogla urbane, tensione sociale dhe ndarje të Kosovës në ato të zhvilluara dhe të pazhvilluara. Për shkak të mungesës së strategjisë zhvillimore dhe zbatimit të ligjeve në fuqi kemi humbje të pakthyeshme të resurseve natyrore, ndërsa vlerat e krijuara të karakterit të trashëgimisë degradohen dhe sillen në kufijtë kritik të funksionimit dhe shfrytëzimit të tyre.

Vazhdimi i trendit të zhvillimeve të pakontrolluara, e rritë koston e transportit civil dhe mallrave, dhe ka për pasojë qasje të vështirësuar në infrastrukturë dhe me implikime negative në zhvillimin ekonomik të vendit. Ngushtimi i arterieve kryesore rrugore, pengon lëvizjen normale brenda dhe jashtë Kosovës, ndërsa ngadalësimi i shërbimeve në vendbanime nxitë në mënyrë të tërthortë migrimet, situatë kjo e disfavorshme për investime të mundshme. Strategjia e preferuar e zhvillimit hapësinor të Kosovës, bazohet (mbështetet) në zhvillimin e rrjetit të fuqishëm të qyteteve me zhvillim ekonomik, përmes resurseve njerëzore - ngritjes së bazës së njohurive, shfrytëzimit racional e të planifikuar të resurseve natyrore e kulturore, qasjes së lehtë në infrastrukturë fizike (rrugore, hekurudhore, ajrore, TI-ve), për sigurimin dhe ngritjen e cilësisë së jetës (banimit e shërbimeve), barazisë sociale, duke tentuar si qytete konkurrencën në rajon, këto të tëra të mbështetura nga kapacitetet organizative (udhëheqje, qeverisje të mirë, mbështetje politike, mbështetje shoqërore, rrjete strategjike).

**Udhëzimet për nivelin komunal**-Ky udhëzues për komuna duhet të ndihmojë komunat në kryerjen e detyrave të planifikimit hapësinor e posaçërisht në:

- Përpilimin e planeve zhvillimore komunale dhe atyre urbane,
- Përpilimin e planeve zhvillimore strategjike rajonale - planifikimi zhvillimor i përbashkët për disa komuna; planifikimit (dhe/ose qeverisjes) të rajonit metropolitan urban (Prishtina me komunat përreth saj),



### **Planet zhvillimore komunale me strategjitë e tyre duhet të;**

- Inspirojnë - ngritin vetëdijen dhe mobilizojnë banorët, grupet e interesit, politikanët në krijimin e planifikimit të ardhshëm të komunave.
- Jenë të formuluar për një zhvillim, të caktuar kohor, dhe të bazuar në çështjet prioritare dhe gjendjen ekzistuese të komunave.
- Përmbajnë vizionet për zhvillim të tyre në harmoni me strategjinë për zhvillim hapësinor, të formuluar qartë dhe në mënyrë specifike, të referojnë karakteristikat lokale, problemet dhe mundësitë për zhvillim.
- Objektivat duhet të jenë zgjidhje të problemeve apo nevojave të banorëve, me përcaktim të vendndodhjeve në hapësirë. Në rast se objektivat janë të ndërlidhura (p.sh. zbutja e papunësisë dhe investimet ekonomike), duhet të përcaktohen prioritetet dhe objektivat para se të caktohet strategjia.
- Planet zhvillimore komunale duhet të bëjnë promovimin e zhvillimit ekonomik e social, sipas kornizës kushtetuese për qeverisje të decentralizuar lokale, pra duke:
- Siguruar që strategjitë të jenë të planifikuara, për zhvillim ekonomik lokal;
- Indikuar rolin që do të duhej të luanin qeveritë lokale në promovim të ZHEL, për të adresuar çështjet e rritjes ekonomike, zhvillimit të bazuar në resurse lokale, papunësisë, krijimit të vendeve të reja të punës, redistribuimit të resurseve dhe mundësive ekonomike në të mirë të qytetarëve (zbutjes së varfërisë), koordinimit mes kërkesave të tregut dhe arsimit të specializuar, shkollimit të lartë e ngritjeve profesionale;
- Indikuar qëllimet për rritje ekonomike si dhe konkurrencë. Planet zhvillimore shërbejnë si mjet për mbështetje ZHEL, duke siguruar që çështjet e rëndësishme prioritare të adresohen nëpërmes iniciativave për ZHEL;
- Udhëzuar me strategji për ZHEL, sektorët ekonomik për t'u promovuar (p.sh. turizmi, industritë agroindustriale, industritë përpunuese, shërbyese etj),
- Siguruar veprimet për arritjen e objektivave për ZHEL;
- Caktuar zona në kuadër të territorit të komunës apo zona të përbashkëta mes komunave, duke indikuar planifikim të integruar.

#### **1.1.4.3 Koncepti i Qyteteve- Gjeneratorë të Zhvillimit Ekonomik**

Autoritetet lokale komunale për planifikim duhet të kenë parasysh, qëllimet dhe synimet e PHK për qytetet si nyje të zhvillimit ekonomik lokal (ZHEL), si koncept i cili siguron zhvillimin ekonomik të Kosovës.

## **Qytetet duhet të jenë zbatuese të qëllimeve të përcaktuara përmes shfrytëzimit të:**

1) Qendrave të qyteteve për aktivitete shërbyese, shërbyese-tregtare, kulturë, argëtim e rekreacion, të cilat do të duhej të ishin zona të gjalla me shprehje identiteti të qytetit, ku së bashku me parimin e zhvillimeve të kombinuara do të ketë përmbajtje të kombinuara e përmbajtje tjera përcjellëse të banimit; ekonomive të natës në qytete me aktiviteteve kulturore, zbavitëse e argëtuese;

2) Zonave ekonomike të qyteteve, zonave me përqendrim të veprimtarive ekonomike në afërsi të qyteteve, si grupime aktiviteteve të veprimtarive industriale, shërbyese, shërbyese tregtare, institucionesh hulumtuese zhvillimore, grupime këto që promovojnë konkurrencën dhe kooperimin në të njëjtën kohë (TZHEK dhe grupimet tjera në komuna);

3) Ekonomive rurale ;

4) Zonave me veprimtari të industrisë së rëndë përpunuese metalurgjike;

5) Zonave me potenciale turistike;

6) Ekonomi transporti;

7) Ekonomia e turizmit.

Në bazë të gjendjes së tanishme të ekonomisë turistike në Kosovë mund të nxirren këto konkludime, të cilat duhet në afat sa më të shkurtër të ofrojnë zgjidhje në çështjet si në vijim:

- Mungesa e definimit të vizionit, objektivave, strategjisë udhëheqëse dhe detyrave në turizëm;
- Mungesa e avancimit të ofertës turistike ekzistuese;
- Mungesa e propagandës turistike;
- Mungesa e pozicionimit të qartë në tregun turistik si destinacion i ri turistik me imazh të ri, në pajtim me zhvillimin aktual dhe të ardhshëm të tregut turistik;
- Mungesa e realizimit të investimeve të rëndësishme në sektorin privat dhe atë publik të turizmit;
- Mungesa e formulimit të sistemit të ri të administrimit në turizëm si, garanci për zhvillim afatgjatë dhe të qëndrueshëm të turizmit;
- Problemet me energjinë, ujin, kanalizimin e ujërave të zeza dhe hedhurinat, degradimit të natyrës dhe të qendrave urbane nga ndërtimet e egra;
- Interesimi i dobët i investitorëve për shkak të zgjatjes së çështjes së pronësisë për tokën;

### **Udhëzimet për nivelin lokal**

Planet zhvillimore komunale duhet:

- Ta konsiderojnë turizmin si sektor ekonomik thelbësor për ZHEL, duke promovuar vlerat dhe identitetin e qytetit për qëllime marketingu, me qëllim të krijimit të të ardhurave nga industria e tillë shërbyese, e cila njëkohësisht kontribuon në krijimin e vendeve të reja të punës;
- Zhvillimi i turizmit duhet të jetë në pajtim me parimet për zhvillim të qëndrueshëm;
- Parashohin hapat e veprimeve për stimulimin e sektorit të turizmit, në aspekt

(pikëpamje) të investimeve kapitale në infrastrukturë fizike dhe marketingun e qytetit përmes vlerave natyrore dhe kulturore;

- Të kenë qasje të integruar në planifikimin, menaxhimin e investime të përbashkëta mes komunave që ndajnë mes veti resurset e trashëgimisë natyrore e kulturore;
- Të promovojë dhe të krijohet partneriteti mes aktorëve të turizmit publik dhe privat, me qëllim të sigurimit të zhvillimit të qëndrueshëm të infrastrukturës së turizmit, i cili respekton kulturat dhe ekonominë lokale;
- Ti japin përparësi rikonstruksionit të hoteleve ekzistuese të sektorit shoqëror deri në nivele ndërkombëtare;
- Të sigurohet se, qëndrueshmëria e trashëgimisë dhe funksionet e reja të saj janë adresuar në mënyrë të drejtë, duke iu shmangur transformimit të këtyre objekteve në vende të cilat nga vizitat kanë ndikim të limituar ekonomik në rrethinën e tyre;
- Fillojë hartimi i studimeve për llojet selektive të turizmit (gjuetisë, rural, ekoturizmit, turizmit kulturor, turizmit të kongreseve, turizmit rekreativ, etj.);

#### **1.1.4.4 Zonat me vlera të larta bujqësore**

##### **Çështjet dhe arsyet për udhëzim**

- Humbja e tokës kualitative bujqësore - mbrojtja e saj si resurs natyror dhe njëherazi potencial për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm;
- Zhvillimi i bujqësisë - sigurimi i ushqimit për popullatën e vendit, zvogëlimi i shpenzimeve nga importi i të mirave ushqimore dhe mundësi për eksport të prodhimeve bujqësore;
- Zhvillimi i zonave rurale - si proces në të cilin popullata rurale bashkon resurset e tyre dhe përmirëson kushtet për jetë e punë, zhvillon aftësitë e veta, siguron vende të reja pune, përmirëson edukimin dhe shëndetin, infrastrukturën dhe shërbimet;
- Zgjidhja e konflikteve: toka bujqësore –me ndërtimet e pakontrolluara e të paplanifikuara, mihjet sipërfaqësore, degradimi i mjedisit etj.
- Bashkëveprime sinergjike me mjedisin e pastër, trashëgiminë natyrore e kulturore dhe turistike.

##### **Udhëzimet**

Me plane hapësinore, zhvillimore dhe urbane të sigurohet mbrojtja e tokave kualitative bujqësore (I - IV) dhe atyre nën skemën e ujitjes së menaxhuar;

- Për zhvillim të ardhshëm të shfrytëzohen djerrinat, klasat më të ulëta (V-VIII) të tokës bujqësore dhe vetëm në raste kërkesave të veçanta e specifike të shfrytëzohet edhe toka kualitative bujqësore;
- Themelimi i një grupi në nivelin qendror dhe lokal për administrimin e tokave bujqësore nga institucione relevante;
- Parandalimi i ndërtimit mbi tokat bujqësore dhe nën skemën e ujitjes;
- Monitorimi i gjendjes në terren dhe të zbatohet ligji nga ana e inspektorateve të bujqësisë, ndërtimit, komunikacionit dhe mjedisit e të dyja niveleve;

- Rivitalizimi i sipërfaqeve ekzistuese dhe të planifikuara për mihje sipërfaqësore, që pas nxjerrjes së linjtit, të kthehen në toka bujqësore;
  - Rehabilitimi i sipërfaqeve në tokë bujqësore, të cilat më parë shërbenin si deponi qofshin ato ilegale, komunale dhe deponi të hirit industrial;
  - Rehabilitimi i sipërfaqeve në tokë bujqësore, të cilat kanë pësuar degradim nga vërshimi, gërryerjet, kullimi dhe rrëshqitja e dherave;
  - Përcaktimi i zonave dhe peizazheve bujqësore nën mbrojtje;
  - Me privatizim dhe riadaptim (ripërshtatje), të shfrytëzohen objektet, komplekset industriale ekzistuese dhe me infrastrukturë përcjellëse, në mënyrë që të mos humben sipërfaqe të reja të tokës bujqësore për ndërtimin e objekteve të reja prej nga edhe investimet do të jenë më të ulëta;
  - Rehabilitimi i sistemeve ekzistuese të ujitjes dhe projekte për ndërtimin e kapaciteteve të reja të ujitjes së menaxhuar;
  - Kryerja e konsolidimit të tokave bujqësore dhe krijimi i kadastrit të ri të tokës bujqësore;
  - Identifikimi i zonave me toka të përshtatshme për veprimtari profitabile të bujqësisë në të mirë të zhvillimit rural;
  - Hartimi dhe prezantimi i planeve për lokalitete me rëndësi të veçantë në sektorin e bujqësisë për komunën;
  - Zonimi dhe përkufizimi strikt i tokës bujqësore për nga veprimtaria profitabile për dy rajonet kryesore, Dukagjin dhe Rrafsh të Kosovës: Rrafsh i Dukagjinit (Pejë, Istog, Klinë, Deçan, Gjakovë, Rahovec, Malishevë, Prizren, Suharekë dhe Dragash); Rrafshi i Kosovës / Mitrovicë, Lepsaviq, Zveçan, Zubin Potok, Skënderaj, Vushtrri, Podujevë, Prishtinë, Obiliq, Fushë Kosovë, Drenas, Lipjan, Shtime, Novobërdë, Kamenicë, Gjilan, Viti, Kaçanik, Shtërpçë dhe Ferizaj.
- Planet zhvillimore komunale dhe strategjitë tjera të sigurojnë, që zonat rurale të kenë qasje në punësim, banim të mjaftueshëm, edukim, shëndetësi, shërbime dhe transport.

#### **1.1.4.5 Konservimi dhe zhvillimi i trashëgimisë– mbrojtja e vlerave ekzistuese Gjendja, çështjet dhe arsyet për udhëzim**

Në Kosovë, trashëgimia kulturore është një ndër elementet më të rëndësishme dhe pjesë përbërëse e mjedisit jetësor. Ajo shfaqë vërtetësinë e identitetit të shoqërisë dhe vendit. Konsiderohet potencial për zhvillime dhe integritet të qëndrueshme shoqërore e ekonomike, në vend rajon dhe më gjerë. Sikur çdo shoqëri edhe Kosova, ka nevojë për një baraspeshë ndërmjet të resë dhe të vjetrës. Humbja e saj është vlerë e pakthyeshme në dëm të identitetit të vendit dhe njerëzimit. Në të përfshihet krijimtaria që nga kohërat e lashta gjer në ditët e sotme. Kjo pasuri e trashëguar me vlera artistike, estetike, historike dhe kaakteristika tradicionale, ilustruhet me llojlojshmërinë e pasur të trashëgimisë: **arkitekturore, arkeologjike, të luajtshme, arkivore dhe shpirtërore.**

Në Kosovë sistemi i përkujdesjes ndaj trashëgimisë kulturore, nuk është në harmoni me kërkesat bashkëkohore. Kjo situatë, është pasojë e politikës moniste të pushtetit në periudhën e kaluar dhe e praktikuar mbi pesëdhjetë vjet. Vlerësimi i trashëgimisë kulturore, nuk është bërë sipas kriterëve objektive të cilat mundësojnë ruajtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm. Gjatë luftës 1998/99 pasojnë dëmet e rënda të monumenteve me vlera kulturore historike. Në nivele vendëse dhe ndërkombëtare

janë zhvilluar aktivitete në përmirësimin e gjendjes, mirëpo situata nuk është konsoliduar në nivel të duhur, ku kemi të trashëguara çështjet (problemet) në vijim :

- Mijëra tërësi-monumente me vlera kulturore-historike janë të rrezikuara, të dëmtuara dhe të shkatërruara në shkallë të lartë;
- Mijëra koleksione të muzeut dhe tërë arkivi i monumenteve kulturore historike të Kosovës të grabitura nga pushteti serb;
- Sistem, mekanizma, procedura dhe kapacitete të limituara përfshirë aspektet: ligjore, administrative, menaxhuese, inventarizuese, dokumentime, studime, specializime, planifikime, buxhetore etj. konform kërkesave bashkëkohore;
- Institucione me kompetenca, infrastrukturë, përvojë, metodologji dhe potenciale specialistike e buxhetore të limituar;
- Mungesa e informimit të duhur dhe integrimi në plane të: edukimit, arsimit, botimit, ekspozita, mediave, turizmi etj.
- Mungesa e planeve të edukimit në të gjitha nivelet shkollore, universitare dhe pasuniversitare;
- Mungesa e planeve dhe fondeve sistematike në mirëmbajtje të tërësive kulturore historike dhe mospërfshirja e saj në programe të rivitalizimit urban dhe rural.

#### **Udhëzimet**

Autoritetet lokale të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit hapësinor, kulturor dhe historik duhet të:

- Promovojnë menaxhimin pozitiv të mjedisit natyror, të ndërtuar dhe historik, ta mbrojnë atë prej zhvillimit që mund të shkaktojë dëme;
- Adaptimi në një qasje të integruar e cila mbron zonat e destinuara, duke plotësuar nevojat sociale dhe ekonomike të komuniteteve lokale;
- Mbrojnë të gjitha aspektet e rëndësishme të peizazhit, duke përfshirë pamjet dhe lokacionet e veçanta;
- Ruajnë dhe avancojnë, ku është e mundur, veçantitë dhe llojshmëritë, duke përfshirë peizazhet dhe duke rivlerësuar destinimet peizazhore lokale;
- Integrojnë një qasje të bazuar në lokacion për planifikim zhvillimor, me një kujdes më të gjerë mbi biodiversitetin dhe çështjet tjera mjedisore;
- Kërkojnë të rikthehen vlerat dhe pamjet e dëmtuara e të humbura ku është e mundur;
- Planet zhvillimore duhet ti japin përparësi mbrojtjes dhe zhvillimit të lokacioneve të trashëgimisë kulturore të nivelit ndërkombëtar apo kombëtar. Zhvillimi, i cili ka mundësi të ndikojë në lokacione të tilla, mund të lejohet vetëm nëse nuk ka zgjidhje të tjera alternative. Disa peizazhe që mund të kontribuojnë në bukurinë, llojllojshmërinë dhe veçantinë e rajonit, duhet të konsiderohen të interesit kombëtar, ndërsa edhe përparimi dhe mbrojtja e peizazheve të karakterit lokal duhet të konsiderohen të rëndësishme.

#### **1.1.4.6 ZONAT ENERGJETIKE DHE MINIERAT**

##### **Çështjet dhe arsyet për udhëzim**

Autoritetet lokale për planifikim duhet të udhëzohen lidhur me zonat energjetike dhe minierat meqë ekziston nevoja për:

- Zonimin e saktë të këtyre hapësirave
- Vlerësimin kapaciteteve ekzistuese

- Racionalizimi i shfrytëzimit të tyre dhe respektimi i kritereve mjedisore
- Planifikim të koordinuar me sektor tjerë
- Ti minimizuar konfliktet sektoriale dhe për të gjetur zgjidhje në to,

#### **Udhëzimet**

Përcaktimi i zonave për eksploatim të minierave duhet të bazohen në udhëzimet politike nga (MMPH, MEM dhe KPMM). Nëse përcaktimi i zonës për eksploatim të minierës është në konflikt me ndonjë sektor tjetër, të drejtën për t'u realizuar do ta fitojë ai prioritet për të cilin studimi tregon se është ekonomikisht më i arsyeshëm.

Në koordinim me autoritetet qendrore, autoritetet lokale duhet të :

- Bëjnë përcaktimin me plan të masave të kontrollit për minierat në eksploatim dhe iniciojnë hulumtimet për çështje prioritare,
- Bëjnë përpilimin e planeve për vendbanime të reja në rast të dislokimit të vendbanimeve nga minierat apo nga afërsia e zonave të parapara energjetike,
- Bazohen në planin e: veprimit për eksploatim në faza dhe masave përcjellëse,
- Marrin parasysh planin e veprimit nga raportet sektoriale për kohën e eksploatimit,
- Marrin parasysh përfshirjen e planeve të rikultivimit të territorit të minierës së eksploatuar,
- Bazohen në planet për përmirësim të kushteve mjedisore.

#### **1.1.4.7 ZONAT ENERGJETIKE DHE MINIERAT**

##### **Çështjet dhe arsyet për udhëzim**

Autoritetet lokale për planifikim duhet të udhëzohen lidhur me zonat energjetike dhe minierat, meqë ekziston nevoja për:

- Zonimin e saktë të këtyre hapësirave
- Vlerësimin kapaciteteve ekzistuese
- Racionalizimi i shfrytëzimit të tyre dhe respektimi i kritereve mjedisore
- Planifikim të koordinuar me sektorë tjerë
- Për t'i minimizuar konfliktet sektoriale dhe për të gjetur zgjidhje në to.

#### **Udhëzimet**

Përcaktimi i zonave për eksploatim të minierave duhet të bazohen në udhëzimet politike nga (MMPH, MEM dhe KPMM). Nëse përcaktimi i zonës për eksploatim të minierës është në konflikt me ndonjë sektor tjetër, të drejtën për t'u realizuar do ta fitojë ai prioritet për të cilin studimi tregon se, është ekonomikisht më i arsyeshëm.

Në koordinim me autoritetet qendrore, autoritetet lokale duhet të :

- Bëjnë përcaktimin me plan të masave të kontrollit për minierat në eksploatim dhe iniciojnë hulumtimet për çështje prioritare;
- Bëjnë përpilimin e planeve për vendbanime të reja, në rast të dislokimit të vendbanimeve nga minierat apo nga afërsia e zonave të parapara energjetike;
- Bazohen në planin e veprimit për eksploatim në faza dhe masave përcjellëse;
- Marrin parasysh planin e veprimit nga raportet sektoriale për kohën e eksploatimit;
- Marrin parasysh përfshirjen e planeve të rikultivimit të territorit të minierës së eksploatuar;
- Bazohen në planet për përmirësim të kushteve mjedisore.

#### **1.1.4.8 GJENDJA MOMENTALE E DEPONITË DHE TRAJTIMI I MBETURINAVE - ZONAT E MBETJEVE INDUSTRIALE**

##### **Çështjet dhe arsyet për udhëzime**

- Nevoja për planifikim të koordinuar që të sigurohen shërbime efikase,
- ekzistenca e deponive ilegale dhe mosekzistenca e deponive të veçanta për mbeturinat e rrezikshme;
- sigurimi i kornizës së qartë për investime.

##### **Udhëzimet**

- Planifikimi përreth deponive, kushtëzohet me mundësinë e zgjerimit të tyre;
- komunat duhet ti propozojnë lokacionet për ndërtimin eventual të deponive të veçanta për mbeturinat e rrezikshme;
- lokacioni i propozuar për ndërtimin e deponisë, duhet të jetë në vend të sigurtë që nuk rrezikon shëndetin e banorëve më të afërm;
- nuk duhet të propozohet që lokacioni, të jetë në zonën ku ka pasuri nëntokësore, në tokën bujqësore të kategorive I – IV, shumë afër lumit apo liqenit dhe afër brezave rrugor;
- deponitë ilegale duhet të mbyllen;
- përpilimi i planeve për vendbanime të reja, në rast të dislokimit eventual të vendbanimeve për arsye të ndërtimit të ndonjë deponie.

#### **1.2. 0 VLERËSIMIN E GJENDJES NË KOMUNA, E CILA PËRFSHINË:**

Vlerësimi i gjendjes në komunë, është njëri ndër hapat më të rëndësishëm i cili na ka mundësuar kuptimin e saktë të përparësive (përshkrimi i avantazheve të komunës), dobësive (pengesat të cilat stopojnë apo kufizojnë zhvillimin komunal), mundësive (përshkrimin e faktorëve të jashtëm të cilët mund të shfrytëzohen) dhe kërcënimeve (përshkrimin e faktorëve të jashtëm të cilët mund të ndikojnë në rrezikimin në zhvillimin në komunë dhe banorëve) me të cilat mund të ballafaqohet Komuna e Kamenicës. Kjo do të pasqyrojë dhe ofrojë të gjitha faktet dhe analizat profesionale për ilustrimin si dhe trajtimin e çështjeve kyçe zhvillimore në komunë.

Analiza në vazhdim është bërë mbi të dhënat, hulumtime e tregues të mbledhur dhe strukturuar në profilin e zhvillimit komunal sipas fushave tematike të identifikuar dhe të shfrytëzuara edhe gjatë hartimit të Planit Hapësinor të Kosovës.

Këto janë: Demografia dhe zhvillimi social, Mjedisi dhe shfrytëzimi i tokës, zhvillimi ekonomik, Infrastruktura, sinergjia dhe çështjet ndërlihdhëse.

Analizat janë bërë sipas fushave tematike, çështjeve, temave dhe nëntemave dhe në Planin Zhvillimor Komunal është prezantuar vetëm raporti i përbërë nga analizat në nivel të fushës tematike dhe konkluzioneve.

Konkluzionet e vlerësimit të gjendjes në komunë janë shfrytëzuar si njëra ndër bazat e rëndësishme në të gjitha hapat në vijim duke filluar nga vizioni ,prioritetet, korniza e zhvillimit hapësinorë deri te kapitulli i fundit në këtë dokument

**FUSHAT TEMATIKE: DEMOGRAFIA DHE ÇËSHTJET SOCIALE**

**FUSHAT TEMATIKE: ZHVILLIMI EKONOMIK**

**FUSHAT TEMATIKE: INFRASTRUKTURA**

**FUSHAT TEMATIKE: SHFRYTËZIMI I TOKËS DHE MJEDISI**

| <b>FUSHAT TEMATIKE: DEMOGRAFIA DHE ÇËSHTJET SOCIALE</b>                |  |
|--|--|
| <b>PËRPARËSITË</b>   | <b>DOBËSITË</b>  |
| Dominimi i strukturës së re të popullsisë                              | Shkalla e lartë e varfërisë, shkalla e lartë e papunësisë  |
| Jetëgjatësia e rritur në krahasim me dekadat e mëparshme               | Shkallë e ulët e zhvillimit ekonomik   |
| Struktura gjinore e balancuar  | Mesatarja e anëtarëve të familjes ende e lartë, sidomos te familjet fshatare                             |
| Niveli ende i ulët i sëmundjeve moderne                                | Standard i ulët i jetesës  |
| Sektori privat është i fuqishëm dhe duke u fuqizuar vazhdimisht        | Hapësirë e pamjaftueshme për veprimtari rinore, por edhe për të moshuar e kategori tjera deri te fëmijët |
| Nisma e planifikimit të familjes                                       | Mungesa e hapësirave dhe kujdesit adekuat shëndetësor, shkollor, social dhe mjedisor                     |
| Popullsia tolerante ( nga aspekti fetar dhe etnik)                     | Mosshfrytëzimi adekuat i multietnicitetit në funks. të donacioneve etj.                                  |
| Kushte të përshtatshme mjedisore (ndotja industriale në nivel të ultë) | Nuk ka sistem adekuat të vlerave   |
| Potencial i mjaftueshëm natyror dhe i krijuar                          | Shfrytëzimi i pa planifikuar, joracional dhe jo i qëndrueshëm i hapësirës                                |
| Interesimi i madh i rinisë për arsim, sport dhe kulturë                | Shpërndarja joadekuate hapësinore e infrastrukturës  |
| Fuqi punëtore e kualifikuar në disa profile                            | Mos krijimi i kushteve, mospërkrahja dhe stimulimi adekuat i sektorit privat në të gjitha fushat         |
| Krijimi i institucioneve private në shëndetësi                         | Mosvendosja adekuate hapësinore e objekteve shkollore, shëndetësore, kulturore në disa vendbanime        |
|  | Mungesa e sigurimit social dhe shëndetësor   |
|  |  |
|  |  |
|  | Investimet e pakëta në teknologjinë e re   |
|  | Aftësimi i fuqisë punëtore, konform kërkesave të tregut vendor dhe ndërkombëtar                          |
|  | Migrimi i popullatës drejtë qytetit, por edhe nga komuna e Kamenicës në qytetet dhe shtetet tjera        |



| MUNDËSITË   | KËRCËNIMET   |
|---|--|
| Shtrirja e vendbanimeve në mënyrë të planifikuar dhe me të gjitha përmbajtjet   | Shkurtimi i jetëgjatësisë së popullatës  |
| Krijimi i hapësirave për shëndet të qëndrueshëm, punë, shërbime dhe pushim  | Rritja e numrit të vdekjeve si pasojë e mjedisit të krijuar në çdo fushë                       |
| Krijimi i hapësirave për sport dhe rekreacion   | Shtimi i dukuritë devijante ,me theks te popullata e re, sidomos ne zonën urbane               |
| Krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm social, ekonomik dhe mjedisor në Kamenice  | Dalja jashtë kontrollit e rasteve në gjendje sociale dhe varfëri të skajshme                   |
| Implementimi i mirëqenies sociale nga niveli lokal (transferimi i kompetencave nga mpms)  | Thellimi i mëtejme i krizës ekonomike  |
| Shfrytëzimi i trashëgimisë për turizëm  | Kërcënimi i vlerave të krijuara dhe trashëguara  |
| Privatizimi dhe Thithja e investimeve , donacioneve vendëse dhe ndërkombëtare me qëllim të hapjes së vendeve të reja të punës   | Protesta dhe trazira   |
| Mbështetja e punësimit përmes projekteve  | Ndërrimi i strukturës së popullsisë, për shkak të emigrimit të popullatës së re jashtë vendit. |
| Mbështetja e punësimit për persona me aftësi të kufizuara   | Depresioni   |
|   |  |
| Krijimi i një infrastrukture të qëndrueshme në të gjitha fushat, duke shfrytëzuar partneritetet publiko private, investimet dhe donacionet nga brenda dhe jashtë vendit | Rritja e fertilitetit  |
| Krijimi i hapësirave për banim adekuat dhe ulje të çmimit për m2  |  |
| Vetëdijësimi i popullsisë për ruajtjen e shëndetit dhe arsimim më të mirë përmes kampanjave (fushatave) të ndryshme   |  |

**FUSHAT TEMATIKE: ZHVILLIMI EKONOMIK**

| PËRPARËSITË  | DOBËSITË   |
|--|--|
| Ekzistimi i resurseve natyrore (bentoniti, deltina, argjila, tufi, kuarci, leuciti, thëngjilli silikoni, antimoni, çeliku, hekuri etj)   | Infrastruktura e kufizuar energjetike, kanalizimit, ujit industrial, atmosferik, telekomunikimi etj (zona aktuale industriale) |
| Ekzistimi i zonave të veçanta industriale-prodhuese dhe planifikimi i disa zonave të tilla, (Zona industriale Berivojcë, Topanicë dhe disa vendbanime e hapësira me mundësi industriale) | Transporti, telekomunikimi, bartja dhe mobiliteti i shtrenjtë, i ngadalshëm joefikas   |
| Tradita industriale (industria e përpunimit të lëngjeve, qeramikës, materialeve ndërtimore, drurit etj)  | Humbja e tregut (1990-1999) si dhe tregu jo stabil   |
| Resurset njerëzore   | Teknologjia e vjetruar në kapacitete ekzistuese  |
| Interesi i sektorit privat dhe mundësitë e investimeve nga jashtë  | Kuadri i pamjaftueshëm profesional në kushtet e zhvillimeve globale  |
| Ekzistimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme prodhuese   | Politika fiskale dhe kreditore jo e volitshme,   |
| Ekzistimi i një infrastrukture (rruga, rryma etj...)   | Hapësira të pa planifikuara për industri dhe shpërndarje jo adekuate hapësinore deri më tani                                   |
| Procesi i privatizimit (disa ndërmarrje si, XIQ-i, Xim Strezoci, Niteksi, janë privatizuar)  | Zhvillime të ngadalshme si dhe shfrytëzimi i vogël i kapaciteteve industriale,   |
| Ekzistimi i kushteve për zhvillimin dhe kultivimin e kulturave bujqësore në prodhimin e drithërave   | Mos shfrytëzimi adekuat i kushteve për prodhimin e drithërave, pemëtarisë, perimtarisë, blegtorisë, shpezëve etj               |
| Ekzistimi i tokave dhe masave pyjore si resurs për zhvillim ekonomik   | Mospërkushtimi i duhur as nga sektori publik as privat, ndaj kësaj fushe shumë të rëndësishme për zhvillim ekonomik            |
| Dega prioritare e zhvillimit ekonomik të komunës (Sipas llojit dhe aktiviteteve kemi biznese tregtare 85 % nga numri i përgjithshëm i bizneseve në komunë)                               | Pozicioni i Kamenicës jo i favorshëm në raport me Kosovën për këtë fushë nëse krahasohet me mundësi të ofron fusha             |
| Trashëgimia e pasur natyrore (peizazhe, monumente të natyrës, trungje të vjetra, monumente gjeomorfologjike etj)   | Dëmtimi i resurseve natyrore në mënyrë të vazhdueshme  |

| MUNDËSITË  | KËRCËNIMET   |
|--|--|
| Krijimi i ambientit fizik dhe ambient biznesi në të cilin që të dyja edhe bizneset ekzistuese dhe ato mikro, të vogla dhe të mesme mund të zhvillohen dhe të prosperojnë . | Mos zhvillim ekonomik  |
| Tërheqja e investime të reja (vendëse dhe të huaja)  | Rritje e papunësisë  |
| Përgatitja e planit rregullues të zonës ekzistuese industriale   | Rritje e varfërisë   |
| Përmirësimi dhe zhvillimi i transportit, telekomunikimit, bartjes dhe mobilitetit  | Trazira dhe jo qëndrueshmëri ekonomike                                   |
| Ndërtimi i kapaciteteve nxjerrëse dhe përpunuese në zonat e reja, ku kemi pasuri natyrore (bentonit, deltinë, argjil, tuf, kuarcit, leucit, etj.                           |  |
| Rishikimi dhe përmirësimi i politikave fiskale dhe kreditore   |  |
| Aftësimi i resurseve njerëzore-profesionale  |  |
| Shfrytëzimi i rrjetit ekzistues aktual alternativ energjetik në zonën aktuale  |  |
| Krijimi i partneriteteve.  |  |
| Shfrytëzimi i huave dhe kredive nga komuna për përkrahjen e zhvillimit industrial  |  |
| Dhënia me koncesion e hapësirave dhe pasurive  |  |
| Ruajtja e tokës bujqësore dhe reduktimi i shndërrimit të saj për destinime tjera e sidomos për ndërtim.  | Dëmtimi dhe shkatërrimi i tokës bujqësore                                |
| Përdorimi i drurit për industri përpunuese   | Shkatërrimi i ekonomisë së komunës së Kamenicës në këtë fushë (pylltari) |
| Krijimi i partneriteteve publiko- private dhe dhënia me koncesion e hapësirave dhe masave të ndryshme pyjore   | Shkatërrimi i tregut   |
| Fuqizimi i rolit të tregtisë në komunë me hekurudhë dhe autoudhë   | Degradim dhe dëmtim të tregtisë  |
| Hartimi i projekteve kryesore së bashku me ekspertët e nivelit qendrorë për zhvillim turizmi në komunën e Kamenicës  | Shkatërrim i resurseve turistike   |

| <b>FUSHAT TEMATIKE: INFRASTRUKTURA</b>  |  |
|---|--|
| <b>PËRPARËSITË</b>  | <b>DOBËSITË</b>  |
| Kushtet për zhvillim të infrastrukturës duke përfshirë edhe terrenin                            | Kualiteti i dobët i infrastrukturës rrugore  |
| Rritja e interesimit dhe kërkesave për zhvillim dhe modernizim të infrastrukturës               | Mos ekzistimi i infrastrukturës hekurudhore që kalon nëpër territor të Komunës së Kamenicës          |
| Afërsia me rrugët rajonale  | Shpejtësia e qarkullimit të mallrave   |
| Potencialët për zhvillim ekonomik   | Mungesa e infrastrukturës hidro -ekonomike e nivelit të dëshiruar                                    |
| Infrastruktura e telekomunikimit që ka Kamenica   | Mos mbulimi i gjithë territorit të Komunës së Kamenicës  |
| Shtrirja në disa vendbanime e rrjetit të ujësjellësit   | Mos funksionimi adekuat i infrastrukturës së furnizimit me ujë për disa segmente por edhe vendbanime |
| Shtrirja në disa vendbanime e rrjetit të kanalizimit  | Mos mbulimi dhe mosfunksionimi nga sistemi i furnizimit me ujë i të gjitha vendbanimeve              |
| Mbulimi i tërë territorit me rrjet energjetik 10 KV   | Infrastruktura energjetike e vjetruar  |
| Kalimi nëpër territor të Kamenicës i largpërçuesit 400KV  | Disa segmente jashtëzakonisht të dëmtuara dhe me rrezik për sigurinë                                 |
| Kalimi nëpër territor të Kamenicës i largpërçuesit 110 KV                                       | Menaxhimi i dobët me këtë infrastrukturë   |
| Kalimi i fibrës optike nëpër territor të komunës  | Rrjeti jo i kompletuar në tërë territorin e komunës me internet                                      |
| Ofrimi i shërbimeve nga disa operator   | Rrjeti ngarkuar ,me shpejtësi të kufizuar telekomunikuese dhe me shërbime jo cilësore internetit     |
| Trajtimi për çdo ditë e më shumë si prioritet nga të gjithë aktorët për trajtimin e mbeturinave | Shfrytëzimi i shtretërve të lumenjve dhe hapësirave tjera për deponim ilegal                         |
| Ekzistimi i ndërmarrjes publike   | Menaxhimi jo adekuat me mbeturina  |


| <b>MUNDËSITË</b>  | <b>KËRCËNIMET</b>  |
|---|--|
| Lidhja me rrugë e Kamenicës në drejtim të Gjilanit me rrugët e Prishtinës   | Trazirat e mundshme  |
| Ndërtimi i hekurudhës Bujanoc, Gjilan, Viti, Ferizaj dhe në drejtim të korridoreve <b>VIII</b> dhe <b>X</b>             | Rritje të kimit  |
| Planifikimi i furnizimit me ujë nëpërmes infrastrukturës efikase për tërë komunën                                       | Çrregullime sociale  |
| Modernizimi i rrjetit të bartjes dhe të shpërndarjes duke siguruar integrimin e tyre me rrjetin rajonal                 | Çrregullim social  |
| Ndërtimi i rrjetit nëntokësor elektroenergjetik Kamenicë-Prishtinë  | Avari dhe shkatërrime ekonomike  |
| Mbulimi i tërë territorit të Komunës së Kamenicës me rrjet të internetit  | Trazira dhe pakënaqësi e përgjithshme për shkak të cilësisë së dobët telekomunikuese |
| Fuqizimi i rrjetit në nivel të standardeve evropiane  | Kërcënim nga hakerët në llogarit elektronike   |
| Planifikimi i deponive të përkohshme në nivel vendbanimi me hapësira të ndara për mbeturina ndërtimore ,industriale etj | Paraqitja dhe përhapja e ndonjë sëmundje të rrezikshme                               |
| Hartimi i projekteve dhe sigurimi i fondeve për zbatim urgjent  | Degradimi dhe shkatërrimi i ndonjë zone mjedisore                                    |
| Planifikimi i një deponie të përkohshme në nivelin komunal  | Ndotja e ujërave nëntokësore   |

| <b>FUSHAT TEMATIKE: SHFRYTËZIMI I TOKËS DHE MJEDISI</b>  |  |
|--|--|
| <b>PËRPARËSITË</b>   | <b>DOBËSITË</b>  |
| Mungesa e një industrie të zhvilluar që ka efekte në fushën e mjedisit   | Mungesa e infrastrukturës rrugore bën që të krijohen kolona dhe zbrazje të gazrave të serrës në mjedis.  |
| Mungesa e komunikacionit ajror dhe atij rrugorë me intensitet të lartë bën që në këtë vend të mos ketë emisione të mëdha të gazrave të serrës. | Automjetet dhe mjetet e tjera motorike nuk janë obliguar ligjërisht në standardin e ndotjes(filtër etj)  |
| Sasi të konsiderueshme të burimeve të ujit nëntokësor dhe sipërfaqësorë  | Dëmtimi dhe shkatërrimi fizik i disa burimeve të ujërave   |
| Në Komunën e Kamenicës ka sipërfaqe të mëdha tokës me bonitet <b>I - IV</b>  | Zvogëlimi i tokave pyjore: nga prerja e pakontrolluar e drunjve, zjarri (kjo po ndikon edhe në rritjen e erozionit)  |
| Në kuptimin e shfrytëzimit të tokës, mund konsiderohet përparësi ekzistimi i tokave pyjore   | Degradimi dhe shkatërrimi i sipërfaqeve të mëdha të tokave pyjore  |
| Në kuptimin e shfrytëzimit të tokës, mund konsiderohet përparësi edhe ekzistimi i tokave me destinim për kullosa                               | Mosmenaxhimi adekuat dhe mirëmbajtja e pyjeve  |
| Komuna e Kamenicës ka florë dhe faunë të përshtatshme, disponon me pasuri të rëndësishme mbi dhe nëntokësore                                   | Resurset natyrore nuk janë mirë të hulumtuara dhe gjurmua  |
| Vetëm disa zona të kufizuara kanë erozion të fortë   | Sasia e madhe e mbeturinave për kokë të banorit (2kg/kokë të banorit /ditë dhe deponi të egra gati në secilin vendbanim e posaçërisht rethë shtatit të lumit |
| Hapësira të mjaftueshme brenda zonave të ndërtimit   | Dendësi e ultë e banimit   |

| MUNDËSITË  | KËRCËNIMET  |
|--|---|
| Planifikimi dhe përgatitja e projekteve për gjelbërim dhe pyllëzim në hapësira të ndryshme të Komunës së Kamenicës   | Krijimi i shirave acidike   |
|  | Dëmtimi deri te shkatërrimi i resurseve ujore   |
| Krijimi i mekanizmave në nivel qendror dhe komunal për mbrojtjen e tokës në përgjithsi me theks në tokën bujqësore në funksion të zënies minimale të tokës për vendbanime(urbanizim)   | Degradim dhe shkatërrim i pakthyeshem i tokës   |
|  | Degradimi deri te shkatërrimi i resursit të tokës pyjore  |
| Planifikimi dhe përgatitja e projekteve të konservimit të tokave pyjore në funksion të shndërrimit gradual(natyrar,artificial) të pyjeve të ulëta në pyje të larta   | Degradimi deri te shkatërrimi i resursit të tokës së destinuar për kullosë  |
| Planifikimi dhe zhvillimi i projekteve që sigurojnë ekosisteme të plota pa ndërprerë rrjedhat dhe ciklet e mbyllura  |   |
| Hartimi i planeve dhe projekteve për futje në zona të mbrojtura të zonave të pasura me florë dhe faunë duke specifikuar edhe peizazhet dhe monumentet e natyrës  | Degradim dhe shkatërrim të zonave me peizazhe dhe monumente të natyrës  |
| Planifikimi dhe zhvillimi i projekteve për deponim të ndarë të mbeturinave, në nivel të një vendbanimi ose disa vendbanime një deponi , një deponi duhet planifikuar në nivel komunal të gjitha të deponitë të jenë të karakterit të përkohshme deri sa të funksionoj deponia regjionale | Nga <b>fatkeqësitë natyrore</b> si Tërmeti i shkallës së lartë mund ta kërcënojë Komunën e Kamenicës pasi gjendet në një zonë sizmike |
| Zhvillimi i konceptit kompakt në nivel vendbanimi  | Shfrytëzim jo i qëndrueshem dhe jo racional i tokës ndërtimore  |
|  |   |

**Konkluzion: Skenari i zhvillimit linear të vendbanimeve,** është analizuar nga grupet punuese , bazuar në faktin se shumica e vendbanimeve kanë shtrirje lineare, të detyron shumë seriozisht të merresh me këtë skenar, por duke marrë për bazë kostot e larta ,pasigurinë,aspektin social e mjedisor, pajisjen e vendbanimit me infrastrukturë të nevojshme, qasje të mirë në shërbime sociale dhe krijimin e kushteve të favorshme për punë dhe rekreacion,shtrirjen hapësinore dhe shfrytëzim të qëndrueshem të resurseve , nga vlerësimi i përparësive, dobësive ,mundësive dhe kërcënimeve del se nuk është i favorshëm për zhvillim të mëtejshëm.

### Zgjerimi nipesinor i qytetit te Kamenices (1980 - 2000)



Harta. 31. Zgjerimi hapësinor i qytetit të Kamenicës



## 1.2.1 Analizën e cila tregon përparësitë, mangësitë, mundësitë dhe kërcënimet;

| DEMOGRAFIA DHE ÇËSHTJA SOCIALE   |  |
|--|--|
| PËRPARËSITË  | DOBËSITË   |
| Dominimi i strukturës së re të popullsisë  | Shkalla e lartë e varfërisë, shkalla e lartë e papunësisë  |
| Jetëgjatësia e rritur në krahasim me dekadat e mëparshme   | Shkallë e ulët e zhvillimit ekonomik   |
| Struktura gjinore e balancuar  | Mesatarja e anëtarëve të familjes ende e lartë e sidomos te familjet fshatare                            |
| Niveli ende i ulët i sëmundjeve moderne  | Standard i ulët i jetesës  |
| Sektori privat është i fuqishëm dhe duke u fuqizuar vazhdimisht  | Hapësirë e pamjaftueshme për veprimtari rinore, por edhe për të moshuar e kategori tjera deri te fëmijët |
| Nisma e planifikimit të familjes   | Mungesa e hapësirave dhe kujdesit adekuat shëndetësor,shkollor,social dhe mjedisor                       |
| Popullsia tolerante ( nga aspekti fetar dhe etnik)   | Mosshfrytëzimi adekuat i multietnicitetit në funks.te donacioneve etj.                                   |
| Kushte të përshtatshme mjedisore(ndotja industriale në nivel të ultë)  | Nuk ka sistem adekuat të vlerave   |
| Potencial i mjaftueshëm natyror dhe i krijuar  | Shfrytëzimi i pa planifikuar,joracional dhe jo i qëndrueshëm i hapësirës                                 |
| Interesimi i madh i rinisë për arsim, sport dhe kulturë  | Shpërndarja joadekuat hapësinore e infrastrukturës   |
| Fuqia punëtore e kualifikuar në disa profile   | Moskrijimi i kushteve,mospërkrahja dhe stimulimi adekuat i sektorit privat në të gjitha fushat           |
| Krijimi i institucioneve private në shëndetësi   | Mos vendosja adekuat hapësinore e objekteve shkollore, shëndetësore,kulturore në disa vendbanime         |
| KONKLuzionET   |  |
| Duke e shfrytëzuar strukturën e re te popullatës të Komunës së Kamenicës, jetëgjatësinë, strukturën gjinore, sektorin privat, planifikimin familjar, tolerancën në mes popullsisë, kushtet e përshtatshme mjedisore, fuqinë punëtore të kualifikuar dhe duke i eliminuar dukuritë negative: shkallën e lartë të varfërisë, standardin e ulët jetësor etj. do të krijohen kushte për jetë të mirë, zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, orientim dhe punësim të rinisë në profile adekuat. |  |

| DEMOGRAFIA DHE ÇËSHTJA SOCIALE   |  |
|--|--|
| MUNDËSITË  | KËRCËNIMET   |
| Shtrirja e vendbanimeve në mënyrë të planifikuar dhe me të gjitha përmbajtjet  | Shkurtimi i jetëgjatësisë së popullatës  |
| Krijimi i hapësirave për shëndet të qëndrueshëm, punë, shërbime dhe pushim   | Rritja e numrit të vdekjeve si pasojë e mjedisit të krijuar në çdo fushë                       |
| Krijimi i hapësirave për sport dhe rekreacion  | Shtimi i dukurive devijante ,me theks te popullata e re, sidomos ne zonën urbane               |
| Krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm social,ekonomik dhe mjedisor në Kamenice  | Dalja jashtë kontrole e rasteve në gjendje sociale dhe varfëri të skajshme                     |
| Implementimi i mirëqenies sociale nga niveli lokal (transferimi i kompetencave nga mpms)   | Thellimi i mëtejme i krizës ekonomike  |
| Shfrytëzimi i trashëgimisë për turizëm   | Kërcënimi i vlerave të krijuara dhe trashëguara  |
| Privatizimi dhe thithja e investimeve , donacioneve vendore dhe ndërkombëtare me qëllim të hapjes së vendeve të reja të punës  | Protesta dhe trazira   |
| Mbështetja e punësimit përmes projekteve   | Ndërrimi i strukturës së popullsisë, për shkak të emigrimit të popullatës së re jashtë vendit. |
| Mbështetja e punësimit për persona me aftësi të kufizuara  | Depresioni   |
| Krijimi i një infrastrukture të qëndrueshme në të gjitha fushat duke shfrytëzuar partneritetet publiko private,investimet dhe donacionet nga brenda dhe jashtë vendit  | Largimi i te rinjve dhe ngecja e zhvillimit ekonomik   |
| Krijimi i hapësirave për banim adekuat dhe ulje të çmimit për m2   | Mosinteresim i qytetareve dhe shperngulja  |
| Vetëdijesimi i popullsisë për ruajtjen e shëndetit dhe arsimim më të mirë përmes kampanjave të ndryshme  | Rritja e numrit te sëmundjeve dhe analfabetizmi  |
| <b>KONKLUZIONET</b>  |  |
| <p>Planifikim i vendbanimeve urbane, shfrytëzimi i mirë i hapësirave për rekreacion, caktimi i zonave të mbrojtura të trashëgimisë dhe resurseve etj.<br/> , krijojmë kushte për eleminimin e dukurive negative: varfërinë, trazirat, depresionin, parandalimin e sëmundjeve të ndryshme, arrihet ruajtje e shëndetit, arsimim dhe punësim në nivel të kënaqshëm të popullsisë</p> |  |

| <b>SHFRYTËZIMI I TOKËS DHE MJEDISI</b>  |  |
|---|--|
| <b>PËRPARËSITË</b>  | <b>DOBËSITË</b>  |
| <p>Sasi e konsiderueshme e resurseve të ndryshme natyrore</p> <p>Siperfaqja e madhe me pyje industriale, toka shumë cilësore dhe pjellore, sipërfaqe të mëdha të tokës me bonitet I - IV tokë kushte të mjaftueshme për zhvillimin e bujqësisë blegtorisë, pemtarisë etj., zhvillimi i turizmit malor dhe kushte të favorshme klimatike, sasia e mjaftueshme e ujërave.</p> <p>Kultivimi i bioprodukteve ushqimore</p>  | <p>Djegiet e biomasës (kashta, talla, ashklat e drurit dhe djegiet e qëllimshme dhe të pa qëllimshme të pyjeve) dhe mbeturinave komunale në mënyrë të pakontrolluar dhe të jashtëligjshme Shkatërrimi i pyjeve mungesa e ngrohtores qendrore në qytetin e Kamenicës, mungesa e gjelbërimit në vendet urbanistike</p> <p>Dëmtimi dhe shkatërrimi fizik i disa burimeve të ujërave, ndotja e lumenjve nga: shkarkimi i ujërave të zeza dhe industriale, hedhja e mbeturinave në to, shfrytëzimi i pakontrolluar i ujit në amvisëri, shfrytëzimi i ujit të pijes nga sektorët ekonomik (ujitja e kulturave bujqësore, industriale)</p> <p>Menaxhimi i tokave bujqësore dhe pyjeve nuk është i nivelit të duhur në kuptimin e mbrojtjes dhe zhvillimit të cilësisë së tokës Degradimi i tokës në disa zona (separacionet etj), ndotja e pjesshme e tokës me pesticide dhe përmbajtje tjera, mungesa e sistemit të ujitjes, vetëdijesimi i popullatës për ruajtjen e tokës bujqësore në nivel të ulët</p> |
| <b>KONKLUZIONET</b>   |  |
| <p>Duke shfrytëzuar pozitën gjeografike shumë të mirë që ka komuna e Kamenicës, resurseve natyrore, tokën bujqësore cilësorë, kullosat e mjaftueshme për zhvillimin e blegtorisë dhe duke i eliminuar dukuritë negative: dëmtimin dhe shkatërrimin fizik të ujërave, dëmtimin e pyjeve, degradimin e tokës në zonat e separuesve të rërës dhe zhavorrit, djegiet e qëllimshme të pyjeve dhe të biomasës, do të krijojmë bazë të mirë për investime të cilat ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe zvogëlimin e papunësisë, si dhe në krijimin e një mjedisi të pastër, pra kultivimi i bioprodukteve ushqimore.</p> |  |

| <b>SHFRYTËZIMI I TOKËS DHE MJEDISI</b>   |  |
|--|--|
| <b>MUNDËSITË</b>   | <b>KËRCËNIMET</b>  |
| <p>- Planifikimi dhe përgatitja e projekteve për gjelbërim dhe pyllëzim në hapësira të ndryshme të Komunës së Kamenicës, Zhvillimi i projekteve për hulumtim të cilësisë, ndotësve dhe aftësim të ujit për pije, industri, ujitje, rekreacion etj. Vetëdijesimi dhe edukimi i popullsisë për shfrytëzim racional të resurseve, si ujërave, ndërtimi i akumulimeve të ujit, përpunimi i drurit teknik, përpunimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale<br/>Hartimi i politikave dhe planeve për ruajtjen e tokës bujqësore dhe pyjore, edukimi për menaxhimin e drejtë të tokës dhe mbrojtja nga erozioni dhe faktorëve tjerë ekologjik, marrja e masave melorative</p> | <p>- Planifikimi dhe përgatitja e projekteve për gjelbërim dhe pyllëzim në hapësira të ndryshme të komunës së Kamenicës, Zhvillimi i projekteve për hulumtim të cilësisë, ndotësve dhe aftësim të ujit për pije, industri, ujitje, rekreacion etj. Vetëdijesimi dhe edukimi i popullsisë për shfrytëzim racional të resurseve, si ujërave, ndërtimi i akumulimeve të ujit, përpunimi i drurit teknik, përpunimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale<br/>Hartimi i politikave dhe planeve për ruajtjen e tokës bujqësore dhe pyjore, edukimi për menaxhimin e drejtë të tokës dhe mbrojtja nga erozioni dhe faktorëve tjerë ekologjik, marrja e masave melorative</p> |
| <b>KONKLuzionET</b>  |  |
| <p>Përgatitja e projekteve për pyllëzimin dhe gjelbërimin e disa hapësirave në komunë, hulumtimin e ndotësve të ujit, hartimin e politikave për ruajtjen e tokës bujqësore, ruajtjen e pyjeve, mbrojtjen nga erozioni dhe duke marrë masat, të cilat rrezikojnë mjedisin do ta ruajnë ambientin, komosacionin e tokave bujqësore.</p>  |  |

| ZHVILLIMI EKONOMIK  |  |
|---|--|
| PËRPARËSITË   | DOBËSITË   |
| Ekzistimi i resurseve natyrore (bentoniti, deltina, argjila, tufi , kuarci, leuciti, thëngjilli silikoni, antimoni, çeliku hekuri etj)  | Infrastruktura e kufizuar energjetike, kanalizimit, ujit industrial, atmosferik, telekomunikimi etj (zona aktuale industriale, inkubator biznesi ) |
| Ekzistimi i zonave të veçanta industriale-prodhuese dhe planifikimi i disa zonave të tilla, (Zona industriale Berivojcë, Topanicë dhe disa vendbanime e hapësira me mundësi industriale)  | Transporti, telekomunikimi, bartja dhe mobiliteti i shtrenjtë, i ngadalshëm joefikas   |
| Tradita industriale (industria e përpunimit të lëngjeve, qeramikës, materialeve ndërtimore, drurit etj)   | Humbja e tregut (1990-1999) si dhe tregu jo stabil   |
| Resurset njerëzore  | Teknologjia e vjetruar në kapacitete ekzistuese  |
| Interesi i sektorit privat dhe mundësitë e investimeve nga jashtë   | Kuadri i pamjaftueshëm profesional në kushtet e zhvillimeve globale mungesa e marketingut të resurseve   |
| Ekzistimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme prodhuese  | Politika fiskale dhe kreditore jo e volitshme,   |
| Ekzistimi i një infrastrukture (rruga, rryma etj...)  | Hapësira të pa planifikuara për industri dhe shpërndarje jo adekuate hapësinore deri më tani   |
| Procesi i privatizimit (disa ndërmarrje si, XIQ “Karaçeva”, XIM Strezoci, Niteksi janë privatizuar)   | Zhvillime të ngadalshme si dhe shfrytëzim i vogël i kapaciteteve industriale   |
| Ekzistimi i kushteve për zhvillimin dhe kultivimin e kulturave bujqësore në prodhimin e drithërave  | Mos shfrytëzimi adekuat i kushteve për prodhimin e drithërave, pemëtarisë, perimtarisë, blegtorisë, shpezëve etj                                   |
| Ekzistimi i tokave dhe masave pyjore si resurs për zhvillim ekonomik  | Mos përkushtimi i duhur as nga sektori publik as privat ndaj kësaj fushe shumë të rëndësishme për zhvillim ekonomik                                |
| Dega prioritare e zhvillimit ekonomik të komunës (sipas llojit dhe aktiviteteve kemi biznese tregtare 85 % nga numri i përgjithshëm i bizneseve në komunë)  | Pozicioni i Kamenicës jo i favorshëm në raport me Kosovën për këtë fushë nëse krahasohet me mundësitë që ofron fusha                               |
| Trashëgimia e pasur natyrore (peizazhe, monumente të natyrës, trungje të vjetra, monumente gjeomorfologjike etj)  | Dëmtimi i resurseve natyrore në mënyrë të vazhdueshme, mosidentifikim i tyre   |
| KONKLuzionET  |  |
| Duke i shfrytëzuar resurset e mëdha natyrore, njerëzore, infrastrukturore, traditën industriale, partneritetin publiko-privat, do t'i sfidojmë dukuritë evidente negative: Humbjen e tregut, teknologjinë e stërvjetruar, kuadrin joprofesional, shkatërrimin e resurseve për qëllime sa më të qëndrueshme ekonomike. |  |

| <b>ZHVILLIMI EKONOMIK</b>   |  |
|---|--|
| <b>MUNDËSITË</b>  | <b>KËRCËNIMET</b>  |
| Krijimi i ambientit fizik dhe ambient biznesi në të cilin që të dyja edhe bizneset ekzistuese dhe ato mikro, të vogla dhe të mesme mund të zhvillohen dhe të prosperojnë .  | Moszhvillim ekonomik rënje e standardit të popullatës                    |
| Tërheqja e investime të reja (vendëse dhe të huaja)<br>Përgatitja e planit rregullues të zonës ekzistuese industriale   | Rritje e papunësisë<br>Rritje e varfërisë                                |
| Përmirësimi dhe zhvillimi i transportit, telekomunikimit, bartjes dhe mobilitetit   | Trazira dhe jo qëndrueshmëri ekonomike                                   |
| Ndërtimi i kapaciteteve nxjerrëse dhe përpunuese në zonat e reja ku kemi pasuri natyrore (bentonit, deltinë, argjil, tuf, kuarcit, leucit, etj.<br>Rishikimi dhe përmirësimi i politikave fiskale dhe kreditore<br>Aftësimi i resurseve njerëzore-profesionale  | Migrimi i popullsisë<br>Shuarja e bizneseve<br>Humbja e tregut të punës  |
| Shfrytëzimi i rrjetit ekzistues aktual alternative energjetik në zonën aktuale  | Largim i investitorëve   |
| Krijimi i partneriteteve.   | Rritje e papunësisë  |
| Shfrytëzimi i huave dhe kredive nga komuna për përkrahjen e zhvillimit industrial   | Zhvillim i dobët ekonomik industrial                                     |
| Ruajtja e tokës bujqësore dhe reduktimi i shendrrimit të saj për destinime tjera e sidomos për ndërtim.   | Dëmtimi dhe shkatërrimi i tokës bujqësore                                |
| Përdorimi i drurit për industri përpunuese  | Shkatërrimi i ekonomisë së Komunës së Kamenicës në këtë fushë (pylltari) |
| Hartimi i projekteve kryesore së bashku me ekspertët e nivelit qendror për zhvillim turizmi në Komunën e Kamenicës  | Shkatërrim i resurseve turistike   |
| <b>KONKLuzionET</b>   |  |
| Pasi që kemi mundësi të mëdha të shfrytëzimit të ambientit, resurseve natyrore si: eksploatimin dhe shfrytëzimin e mineraleve, pyjeve, krijimin e kushteve për partneritet rajonal dhe ndërkombëtar evitojmë: papunësinë në rritje, zbutjen e varfërisë, migrimin, parandalimin e protestave, shkatërrimin e ekonomisë, tokës bujqësore, resurseve turistike, do të krijojmë mundësi për jetë të mirë dhe me trende bashkëkohore. |  |

## INFRASTRUKTURA

| PËRPARËSITË  | DOBËSITË   |
|--|--|
| <p>- Ekzistimi i transportit rrugor, ekzistimi i linjave të lartëpërçuesve energjetik, afërsia me rrugët rajonale, me aeroportin (Prishtina) Kushtet për zhvillim të infrastrukturës, duke përfshirë edhe terrenin.</p> <p>Shtrirja në disa vendbanime e rrjetit të ujësjellësit , e rrjetit të kanalizimit, avancimi i rrjetit të ujësjellësit në disa pjesë të qytetit, ekzistimi i mekanizmave të përpunimit të ujit në qytetin Kamenicës, ekzistimi i resurseve ujore sipërfaqësore (lumenjve, përroskave etj)</p> <p>Mbulimi i tërë territorit me rrjet energjetik 10 KV, mbulimi i shumicës së komunës me trafo, kalimi nëpër territor të Kamenicës i largpërçuesit 400KV , 110 KV, 35 KV , ekzistimi i rrjetit nderkombëtar, ekzistimi i disa segmenteve nëntokësore të kabllove energjetike.</p> <p>Ofrimi i shërbimeve nga disa operatorë, digjitalizimi i centraleve, telefonia fikse në disa vendbanime</p> <p>Vetëdijësimi i trajtimit të mbeturinave në hap me kohën nga të gjithë aktorët, ekzistimi i ndërmarrjes publike, ekzistimi i deponisë regjionale.</p> | <p>Kualiteti i dobët i transportit rrugor, mosekzistimi i transportit hekurudhor, i cili do të kalojë nëpër territor të Komunës së Kamenicës ,Ranillugut,Gjilanit dhe Vitisë. Shpejtësia e qarkullimit të mallrave, mosmbulimi i gjithë territorit të komunës</p> <p>Mosfeksionimi adekuat i infrastrukturës së furnizimit me ujë për disa segmente, por edhe vendbanime, mungon trajtimi i ujërave të zeza, mosekzistimi i kadastrit nëntokësor, mosanga zhimi për rregullimin e pendave akumuluese Të ujërave sipërfaqësore</p> <p>Infrastruktura energjetike e vjetruar, mirëmbajtja jo adekuate e infrastrukturës energjetike të lartëpërçuesve dhe traseve të tyre. Kadastru nëntokësor energjetik nuk ekziston(rrjeti energjetik nëntokësor), gjendja e një numri të trafave jo e mirë, mosshfrytëzimi i energjisë alternative.</p> <p>Mosmbulimi i territorit me rrjet të telefonisë fikse dhe pjesë të caktuara edhe valore, rrjeti kabllor i vjetruar(pas viteve të 90), mungesa e rrjetit optik në tërë territorin e Kamenicës</p> <p>Shfrytëzimi i shtretërve të lumenjve, përrojeve, përroskave, gropave të ndryshme, si dhe të hapësirave tjera për deponim ilegal, menaxhimi jo adekuat me mbeturina (mungesa e deponisë në komunë), mos selektimi i mbeturinave.</p> <p>.</p> |

### KONKLuzionET

**Duke i shfrytëzuar përparësitë:** transportin rrugor, linjat e largpërçuesve elektrik, rregullimin e ujësjellësit dhe kanalizimit mbulimin e territorit me rrjet energjetik 10 KV dhe me trafo, shërbimet nga operatorët e ndryshëm me fibra optik, trajtimin e mbeturinave etj. dhe duke i eliminuar dobësitë siç janë: kualitetin e dobët të transportit rrugor, mungesën e ujësjellësit dhe kanalizimit në shumicën e territorit të komunës, rrjetin energjetik të vjetruar, mosekzistimin e kadastrit nëntokësor, hapësirat për deponitë ilegale etj.do të krijojmë kushte të favorshme për zhvillimin e infrastrukturës me standarde, që do ti plotësojnë nevojat e popullatës së komunës dhe më gjerë.

## INFRASTRUKTURA

| MUNDËSITË  | KËRCËNIMET   |
|--|--|
| <p>Shfrytëzimi i korridorit të shtatë (Bujanoc- Gjilan), lidhja me Prishtinën, Leskocin, Medvegjën dhe Vrajën; ndërtimi i Hekurudhës Bujanoc- Gjilan- Ferizaj, ngritja e sigurisë në trafik, modernizimi dhe kompletimi i infrastrukturës</p> <p>Planifikimi i furnizimit me ujë përmes infrastrukturës efikase për tërë komunën, rregullimi i pendave në lumenjtë, si të Kremenatës, Hogoshtit dhe të Desivojcës, hulumtimet për ndërtimin e pendës dhe infrastrukturës për furnizim me ujë të pijes për ujitje dhe industri nga pendat e lartpërmendura, trajtimi i përkohshëm me gropa septike i ujërave të zeza, ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza.</p> <p>Modernizimi i rrjetit të bartjes dhe të shpërndarjes, duke siguruar integritetin e tyre me rrjetin rajonal, eliminimin gradual të TS 35/10kV dhe kalimin në TS 110/20kV (Rrjetet e tensionit të ulët duhet të planifikohen, gjithashtu me shtylla betoni dhe me kablllo vetëmbajtëse, aplikimi i kablllove nëntokësore në zonat e urbanizuara),</p> <p>Fuqizimi i rrjetit në nivel të standardeve Evropiane, mbulimi i tërë territorit me rrjet të telefonisë fikse dhe mobile, përmirësimi i rrjetit kabllor dhe ofrimi i programeve televizive HD</p> <p>Planifikimi i deponive të përkohshme në nivel vendbanimi me hapësira të ndara për mbeturina ndërtimore ,industriale etj. partneritete publiko-private për grumbullim dhe menaxhim të efektshëm me mbeturina, trajtim në një hapësirë të caktuar të mbeturinave inteligjente me mundësi deponimi dhe servisimi</p> | <p>Moszhvillimi ekonomik, papunësia e madhe dhe në rritje, migrimi i të rinjve, shkaktimi i aksidenteve.</p> <p>Ndotje të ujit të pijshëm, infektive dhe sëmundje të rrezikshme, degradimi i ambientit (florës dhe faunës)</p> <p>Dëmet në pajisjet dhe makinerinë shtëpiake, fatkeqësi dhe humbje të jetëve të njerëzve dhe familjeve, ngecja e zhvillimit ekonomik,</p> <p>Keqpërdorim nga konsumatorët ,çmime të pa përballueshme për qytetarin, aktivitete të ndryshme ilegale.</p> <p>Degradimi dhe shkatërrimi i zonave mjedisore, ndotja e ujërave nëntokësore krijimi i deponive ilegale</p> |

### KONKLUZIONET

Shfrytëzimi i korridorit të shtatë (Bujanoc- Gjilan), lidhja me Prishtinën, Leskocin, Medvegjën dhe Vranjën, rregullimi i pendave në lumenjtë, e Kremenatës, Hogoshtit dhe Desivojcës; eliminimin gradual të TS 35/10kV dhe kalimin në TS 110/20kV ndërtimin dhe zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, trajtimin e ujërave të zeza, planifikimin e deponive të përkohshme dhe riciklimin e tyre, ndërsa duke marrë masa preventive ndaj kërcënimeve të paraqitura, siç janë ndotja e ujit, sëmundjet e rrezikshme, degradimi i ambientit (florës dhe faunës), deponitë ilegale do të ndikojnë në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe në rritjen e standardit jetësor.



| SINERGJIA DHE ÇËSHTJET NDËRLIDHËSE<br>BASHKËPUNIMI DHE BASHKËVEPRIMI   |  |
|--|--|
| PËRPARËSITË  | DOBËSITË   |
| <p>Ekzistimi i drejtorive të ndryshme në nivelin komunal</p> <p>Ekzistimi i kompanive publike</p> <p>Ekzistimi i shoqërisë civile</p> <p>Ekzistimi i gjykatave</p> <p>Ekzistimi i Policisë së Kosovës</p> <p>Ekzistimi i agjencive në nivel qendror</p> <p>Ekzistimi i ministrive të ndryshme</p> <p>Ekzistimi i donatorëve</p> <p>Ekzistimi i OJQ-ve ndërkombëtare dhe Vendëse</p> <p>Ekzistimi i sektorit privat</p> | <p>Mosfunksionimi adekuat i bashkëpunimit horizontal dhe vertikal(drejtoritë në mes vete, si dhe niveli lokal me ate qendror)</p> <p>Mosfunksionimi i bashkëpunimit donator – agjenci ose OJQ zbatuese e projekteve agjencie dhe komunës</p> <p>Mosfunksionimi adekuat i bashkëpunimit në mes të sektorit publik dhe privat</p> <p>Mosfunksionimi adekuat, shoqëri civile- autoritete</p> <p>Mosfunksionimi adekuat i bashkëpunimit horizontal komunë – gjykatë-polici</p> |
| KONKLuzionET   |  |
| <p>Me ekzistimin e institucioneve të ndryshme në nivelin komunal, kompanive publike, shoqërisë civile, gjykatave, policisë së Kosovës, agjencive të ndryshme, sektorit privat etj. do të rritet bashkëpunimi , do të evitohen dhe menaxhohen situatat, të cilat do të krijojnë kushte të volitshme sinergjetike.</p>   |  |

| SINERGJIA DHE ÇËSHTJET NDËRLIDHËSE<br>BASHKËPUNIMI DHE BASHKËVEPRIMI   |  |
|--|--|
| MUNDËSITË  | KËRCËNIMET   |
| <p>Krijimi i sistemit të informimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit në nivel drejtorishë</p> <p>Krijimi i sistemit të informimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit adekuat në nivelet qendror - lokal</p> <p>Ngritje kapacitetesh në mënyrë të ndërsjellë</p> <p>Identifikim i projekteve prioritare</p> <p>Sigurim fondesh për implementim</p> <p>Krijim partneritetesh publiko- private</p> <p>Shfrytëzim i zonave me mirëkuptim për destinime të caktuara</p> <p>Krijimi i sistemit të informimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit adekuat në komunë-gjykatë-Polici</p> <p>Rritje bashkëpunimi institucion-qytetar</p> | <p>Kriza institucionale</p> <p>Humbje investimesh</p> <p>Pakënaqësi dhe trazira</p> <p>Mos zbatim planesh</p> <p>Mosefikasitet dhe krizë sociale</p> <p>Rritje e krimit dhe korrupsionit</p> |
| KONKLuzionET   |  |
| <p>Krijimi i sistemit të informimit dhe bashkëpunimi në nivel institucionesh, krijimi i partneritetit publiko – privat, rrit efikasitetin dhe cilësin e shërbimeve ndaj qytetarëve.</p>  |  |

## 1.2.2 ANALIZËN E NDËRLIDHJEVE NË MES TË ÇËSHTJEVE, POLITIKAVE DHE PROGRAMEVE;

Trajtimi profesional i integruar i hapësirës së Komunës së Kamenicës, është njëri nga faktorët shumë të rëndësishëm që do të shërbejë si bazë e mirë edhe për analizën e ndërlidhjeve me çështjet e zhvillimit ekonomik, social si dhe me çështjen e mbrojtjes së mjedisit, por edhe trajtimit të ndërlidhjes në mes politikave të krijuara në nivel qendror, lokal ose atyre konform marrëveshjeve dhe obligimeve ndërkombëtare, siç janë politikat e banimit, bujqësisë, zhvillimit ekonomik, politikave sociale ,mjedisore, të trafikut dhe të gjitha politikave dhe programeve që i përkasin këtyre fushave .

Sipas ligjit dhe akteve nënligjore gjatë hartimit të **Planit Zhvillimor Komunal** dhe atij **Urban**, jemi të obliguar të marrim në konsideratë të gjitha çështjet e rëndësishme, të bëjmë një analizë të ndërlidhjeve në mes tyre, në mes politikave dhe programeve dhe natyrisht në koordinim me grupet punuese, si dhe me faktorët tjerë relevantë. Të identifikohen çështjet më problematike dhe ato që ndërlidhen dhe shkaktojnë probleme në shumë fusha tjera, ku paraqesin kërcënim te një numër i madh njerëzish, në kuptimin socio-ekonomik , në kuptimin mjedisor, në kuptimin e baraspeshimit dhe shfrytëzimit të atyre politikave, që prodhojnë qëndrueshmëri dhe përkrahin programet të cilat janë reale, të domosdoshme dhe të zbatueshme për rrethanat tona.

**Analiza e të drejtave njerëzore dhe të planifikimit**-në veçanti e drejta për jetë, informim, shëndet, punë, rekreacion etj.

**E drejta për shëndet** -është përmbledhje shumë e gjerë dhe komplekse e çështjeve të ndërlidhura mes vete, pasi që shëndeti dhe mirëqenia janë ngushtë të lidhura në të gjitha fazat dhe aspektet e jetës. Të drejtat specifike për shëndetin, mund të gjenden nëpër dokumente ndërkombëtare të pranuar edhe nga Kosova, siç është **dokumenti për të drejtat e njeriut**. Në esencë, të gjitha të drejtat e njeriut janë të ndërlidhura dhe të ndërvarura mes vete, duke bërë realizimin, neglizhimin, si dhe shkeljen e të drejtave të njeriut, për një numër më të madh e të drejtave, e jo vetëm ndaj një të drejte të vetme dhe të izoluar nga të tjerat. Kjo ndërlidhje bëhet më e qartë kur merret parasysh se një e drejtë njerëzore (p.sh. shëndeti), kërkon plotësimin e të gjitha nevojave njerëzore, qoftë fizike, ( nevoja për ajër, ujë, ushqim, etj.) qoftë të atyre sociale dhe psikologjike, (siç janë, nevoja për dashuri, familje dhe shoqëri).

Nisur nga Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut , 1948, ku në nenin 25 thuhet: “Çdokush ka të drejtë për një nivel jetese që siguron shëndetin dhe mirëqenien e tij dhe të familjes së tij, duke përfshirë këtu ushqimin, veshmbathjen, strehimin, kujdesin mjekësor dhe shërbimet e nevojshme sociale.

Të drejtat e njeriut kanë të bëjnë me obligimet që i kanë shtetet(Kosova),në këtë rast edhe Komuna e Kamenicës, si një njësi e shtetit për ti kontribuar përmbushjes së

këtyre nevojave dhe për t'ua mundsuar grupeve dhe individëve një jetë sipas standardeve evropiane.

Pasi që **Plani Zhvillimor Komunal dhe Urban i Kamenicës** është multisektorial dhe përfshinë të gjitha fushat dhe ka për qëllim plotësimin, krijimin dhe shfrytëzimin racional dhe të qëndrueshëm të hapësirave dhe kushteve, për të siguruar për këtë gjeneratë, pa kërcënuar të ardhshmet, shëndet sa ma të plotë e cila nënkupton: "gjendje të plotë fizike, mendore dhe mirëqenie sociale dhe jo vetëm mungesë e sëmundjeve ose gjendjes së dobët shëndetësore" nënkuptohet rëndësia e ndërlidhjes në mes të këtyre çështjeve, aspekteve, politikave e programeve dhe planifikimit si proces dhe planit si dokument, i cili synon të ruajë dhe zhvillojë hapësira e projekte për të arritur këto cilësi konform deklaratës për të drejtat e njeriut lidhur me hapësirën. Analiza të njëjta, sikur për shëndetin janë bërë edhe për të drejtat tjera të njeriut gjatë hartimit të dokumentit.

Është e qartë se Komuna e Kamenicës si edhe pjesa ma e madhe e Kosovës ballafaqohet me **burime të reduktuara për financimin** e zhvillimeve dhe projekteve kapitale, që ndërlidhet fuqishëm me çështjen e zhvillimit ekonomik me politikat e ekonomike, papunësinë (norma e vlerësuar e papunësisë 55-65%) dhe varfërisë në aspektin social dhe lidhet me sektorin publik në përmirësimin e infrastrukturës publike. Gjendja aktuale në sektorin e energjetikës, telekomunikimeve dhe transportit rrugor mund të konsiderohet, si një çështje që prezanton një faktorë limitues në zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor. Aktiviteti investues i bizneseve private në periudhën e pasluftës ka shënuar rritje të vogël ekonomike dhe të punësimit, por që tani vërehen shenja të recesionit në kuptim të rënies së vëllimit të qarkullimit mesatar për një ndërmarrje dhe rritjes së punësimit. Aktiviteti investues i bizneseve private lidhet edhe me shfrytëzimin joracional të hapësirës, me planifikimin e hapësirave dhe zonave (zona industriale dhe inkubatorët e biznesit) për thithje të këtyre investimeve dhe aspektet tjera.

Në këto kushte, krijuesit e politikave ekonomike sfidohen me nevojën e nxitjes së investimeve të reja. Prandaj krijimi një ambienti miqësor afarist dhe ambientit adekuat institucional, për tërheqjen e investimeve të jashtme të drejtpërdrejta imponohet si një nga prioritetet më të rëndësishme të politikave ekonomike dhe reformës ekonomike. Është e kuptueshme se vetëm (IJD) investimeve të jashtme direkte nuk mund ti shpejtojnë aktivitetet më se të domosdoshme investuese. Synimi duhet të jetë që ato të bëhen një burim i rëndësishëm dhe komplementar me burimet e tjera të financimit. - planet zhvillimore komunale dhe urbane duhet planifikojnë zonat industriale, të cilat do të ndërlidhen me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe me politikat e punësimit, infrastrukturës dhe thithjen e investimeve nga bizneset e komunës, bizneset tjera në Kosovë dhe jashtë Kosovës.

**Politikat e zhvillimit rural**-ndërlidhen me zvogëlim e migrimeve të jashtme dhe si çështje që duhet të trajtohet është të krijohen kushte të domosdoshme për mënjanimin e problemeve të rënda njerëzore dhe sociale, të cilat rezultojnë me migrimet e popullatës nga zonat rurale. Zhvillimi rural është një çështje e cila në vetvete përfshinë: zhvillimin e bujqësisë, shfrytëzimin racional të resurseve natyrore, zhvillimin e transportit rural, ujin dhe higjienën, zhvillimin e telekomunikimeve, zhvillimin e shkollimit, shëndetësinë dhe shërbimet sociale. Në këtë aspekt, gjatë këtij punimi do të mundohemi të paraqesim rëndësinë e të gjithë faktorëve kryesore të zhvillimit rural dhe ndërlidhjen shumë të fortë në mes tyre. Aktualisht, në të gjithë komunën, varfëria është prezentë kryesisht në vendet rurale e sidomos në ato kodrinore malore. Si rezultat i kësaj shtate, zhvillimi rural ndërlidhet me zbutjen e varfërisë

Nga kjo analize e ndërlidhjes së politikave, programeve dhe çështjeve mund të konkludojmë se, për një zhvillim rural të qëndrueshëm në Komunën e Kamenicës, duhet të kemi investime më të mëdha si publike ashtu edhe private në zonat rurale. Orientimi vetëm në zhvillimin e bujqësisë në zonat rurale nuk është i mjaftueshëm për rritjen e standardit jetësor të familjeve rurale. Investimet duhet të orientohen kryesisht në zhvillim të infrastrukturës, përmirësim të mjedisit afarist në zonat rurale, zhvillim të shkollimit dhe shëndetësisë, si dhe ofrim të shërbimeve publike, zhvillimin e zonave rekreative turistike etj. Për një zhvillim rural të qëndrueshëm në komunë, duhet të ketë me shume investime të orientuara kah bizneset jo-bujqësorë, siç mund të jetë industria e përpunimit të drurit, industria e përpunimit ushqimor dhe industria e bimëve mjekuese. Si çështje gjithashtu ndërlidhet edhe me lehtësirat e mëdha fiskale për prodhimtarinë bujqësorë, në mënyrë që produktet e prodhuara në komunën e Kamenicës si edhe në pjesët tjera të Kosovës të jenë kompetitive me ato të prodhuara në vendet e rajonit. Çështjet ndërlidhen edhe me Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), të pajisjeve teknologjike, sepse mënyra aktuale e zbatimit të TVSH-së po i shkakton kufizime të mëdha investimeve private në zonat rurale dhe po i largon investitorët potencial të huaj.

**Çështja e sigurimit të ajrit të pastër**-është e lidhur në mënyrë përmbajtjesore me shëndetin e njeriut, me zhvillimin industrial ,djegia e karburanteve, fosileve si dhe rritja drastike e trafikut kanë shtuar edhe më shumë ndotjen e ajrit në qytetin e Kamenicës dhe vendbanimet tjera, çka si rrjedhojë mund të shkaktojë probleme shëndetësore serioze. Paralelisht me problemet shëndetësore si rezultat i ngrohjes globale paraqesin brenga të mëdha sociale.

**Çështja e Ujit**-ndërlidhet si faktorë esenciale me jetën, prodhimin bujqësor e industrial etj. por njëkohësisht çështja e ujit ndërlidhet edhe me mundësin që në raste të jashtëzakonshme të prezantoj kërcënim të madh për jetën dhe hapësirën jetësore. Bujqësinë dhe zhvillimin ekonomik, ujërat nuk njohin kufij dhe përmes qarkullimit të vet natyror janë në dispozicion tonin të vazhdueshëm. Mirëpo ujërat nuk janë një resurs pakufi dhe për këtë kërkon mbrojtje të veçantë . Pra, mund të thuhet lirisht se uji ka ndërlidhje edhe me koston e saj nga aspekti ekonomik, humbjen e ekosistemeve

natyrore(llojeve bimore dhe shtazore) me rëndësi farmaceutike dhe në industri të ushqimit.

Cilësia e ujit në komunën e Kamenicës është një çështje që është shumë e ndërlidhur me shëndetësinë e popullatës dhe deri tani ndikim të madh ka pasur në shkaktimin e sëmundjes së veshkave(nefropathia endemike).

**Bujqësia**-tradicionalisht ka qenë një ndër sektorët më të rëndësishëm në Komunën e Kamenicës. Sot, bujqësia është lënë pas dore dhe si çështje lidhet edhe me politikën e zhvillimit edhe programet për bujqësi(një paketë e projekteve për stimulim, mbrojtje nga vërshimet, masa meliorative deri te grumbullimi i parcelave) si zhvillim ndërlidhet edhe me çështjen e tregtisë pasi që importohen shumica e produkteve bujqësore nga jashtë, lidhet me çështjen e tregut në përgjithësi, me aspektin social, papunësinë dhe varfërinë. Edhe pse ka edhe shumë çështje të hapura, me të cilat ndërlidhen si te fusha e planifikimit që tani është duke u shkatërruar toka bujqësore, deri te kushtet për zhvillimin e bujqësisë, bazuar në parimet organike që janë të favorshme si dhe industrisë ushqimore etj. Edhe pse në disa raste nga përdorimi i plehrave artificiale kemi ndërlidhje me ndotjen e ujërave në Territorin e Kamenicës.

**Zhvillimi i qëndrueshëm**-ndërlidhet me përmirësimin e cilësisë së jetës që prezanton një dimension social, si dhe me shfrytëzimin racional të resurseve natyrore dhe zvogëlimin e presioneve në mjedis prezanton dimensionin mjedisor. Cilësia e jetës, ndërlidhet shumë me shfrytëzimin e energjisë dhe shërbimet që ofron ajo. Burimi kryesor për prodhimin e energjisë elektrike, që e shfrytëzon e tërë Kosova është linjiti. Çështja qëndron në atë se, si mund ti përdorim resurset ekzistuese të energjisë në mënyrë të qëndrueshme dhe si ti zëvendësojmë ato me burime të ripërtritshme ujin, Diellin, erën, biomasën, mbeturinat që ndërlidhen ndër vete shumë çështje e projekte dhe si energji ndërlidhet edhe me standardet e ndërtimit e izolimit, pasi që ndikojnë në vëllimin e energjisë që do të përdoret.

Energjia që përdoret për ngrohje në Komunën e Kamenicës, në masë të madhe vjen si energji e liruar nga djegia e druve që ndërlidhet në aspektin social me cilësinë e jetës dhe ngrohjes së 40000 banorëve, ose diku afro 6500 familjeve ku nëse për një sezon një familje harxhon 10 m<sup>3</sup> dru, bëjnë 65000 m<sup>3</sup> dru. Pra, në çështjen mjedisore, nëse e trajtojmë mund ta merrni me mend se sa sipërfaqe pyjore prehet, me kontestin e planifikimit të ripyllëzimit e menaxhimit me pyje, me shfrytëzimin e energjive alternative dhe politikave për energji të ripërtritshme, si dhe në aspektin e ndotjes në kuptimin e vëllimit të ndotjes që lirohet, por edhe zhvillimit ekonomik në kuptimin e kostove për ngrohje dhe zhvillimit të industrisë së përpunimit të drurit deri te aspekti legal.

**Gjenerimi i mbeturinave**-paraqet një ndër çështjet dhe shqetësimet më të mëdha që ndërlidhet me mjedisin dhe është një barrë e madhe ekonomike për shoqërinë. Pas gjenerimit mbeturinat duhet të mblidhen, trajtohen dhe mënjanoen. Ky proces, sërish ndërlidhet me përdorim të resurseve dhe paraqet një rrezik potencial për ndotje. Për këtë arsye puna me mbeturina ngërthen një mori çështjesh mjedisore, duke

përfshirë këtu shfrytëzimin e resurseve natyrore, konsumimin e energjisë, gjenerimin e gazrave që ndikojnë në klimë si dhe kontaminimin e ujërave, tokës dhe ajrit. Për këtë arsye, Komuna e Kamenicës menaxhimin e mbeturinave duhet ta vendosë ndër prioritetet e saj, duke e ndërlidhur edhe në aspektin financiar dhe resurseve humane e teknologjike.

**Mbrojtja, konservimi dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i trashëgimisë,** i natyrës dhe llojeve të ndryshme të gjallesave, gjatë këtyre viteve të fundit, është bërë bazë e disa politikave dhe ndërlidhet me shumë politika si ,zhvillimore,kulturore etj. Pra, ndërlidhet me çështjen e identitetit që prezanton trashëgimia, në aspektin e mjedisit, prishje të ekosistemeve, baraspeshave mjedisore deri te shkatërrimet e degradimet në fusha të veçanta. Në aspektin e zhvillimit ekonomik, paraqitet si sfidë për resurse shumë të veçanta në kuptimin e mundësisë së zhvillimit të turizmit dhe përfitimeve tjera nga këto vlera, edhe pse në aspektin social gati të gjithë kanë një kënaqësi për këto vlera dhe pothuajse, të gjithë e pranojnë që mbrojtja e trashëgimisë, natyrës dhe llojeve të ndryshme të gjallesave është një kategori zhvillimore esenciale për Komunën e Kamenicës.

**Planifikimi, zhvillimi dhe modernizimi i infrastrukturës-** është njëra ndër çështjet më përmbajtjesore, kështu që rrjeti dhe cilësia e infrastrukturës paraqet bazën e integritetit hapësinor, ku ndërlidhet me çështjet komplekse të zhvillimit ekonomik si dhe parakushtin e parë të arritjes së zhvillimit harmonik (shfrytëzimi i resurseve, krijimi i zonave të zhvillimit ekonomik duke filluar nga zonat industriale, zonat rekreative, infrastrukturës sociale-kulturore etj). Shpërndarja adekuate e infrastrukturës ndërlidhet edhe me realizimin e drejtpeshimit hapësinor në kuptimin e përqendrimit të popullsisë, në aspektin social (krijimi i një cilësie të jetës, mundësia e punësimit, reduktim i varfërisë etj.), por edhe aspektin mjedisor ndërlidhet me efektet potenciale ndotëse të mjedisit. Duhet të ndërmerren masat mbrojtëse dhe kostot e përafërta si gjatë fazës së ndërtimit ashtu edhe gjatë fazës së operimit të infrastrukturës së planifikuar, e cila do të zhvillohet dhe modernizohet, ashtu edhe në nivelin komunal.

**Edukimi, arsimimi dhe ndërgjegjësimi** për zhvillimin socio-ekonomik dhe mjedisin është një proces mjaft kompleks, ngritja edukativo- arsimore dhe e ndërgjegjes për zhvillimin socio-ekonomik dhe mbrojtjen, ruajtjen dhe qëndrimin miqësor ndaj çështjeve dhe problemeve mjedisore, Gjithashtu, është e lidhur ngushtë me krijimin e hapësirave dhe infrastrukturës adekuate, futjes së planprogrameve dhe teknologjive bashkëkohore të ligjërimit dhe aftësimit. Ky proces nënkupton krijimin e qëndrimit pozitiv dhe të menduarit kritik ndaj të gjitha kërkesave dhe ofertave në tregun komunal të punës, tregut kosovar dhe atij ndërkombëtar. Ky proces, gjithashtu, nënkupton edhe marrjen e qëndrimit ndaj asaj se, çka duam dhe si mundemi ta përgatisim rininë tonë që të jetë konkurruese në tregun e vlerave. Në çfarë profilesh duhet të përgatitet që ti kontribuojë aspektit ekonomik, krijimit të vendeve të reja të punës dhe stimulimit të zhvillimit ekonomik, aspektit social dhe krijimit të një cilësie të jetës, reduktim të varfërisë si dhe qëndrimin pozitiv dhe kritik ndaj atyre që shkaktojnë dukuri negative në aspektin social, ekonomik si dhe për mjedisin ose për pjesë të tij.

Gjithashtu, ky proces ka të bëjë edhe me ngritjen e çështjes së ndjeshmërisë së qytetarëve për të marrë pjesë në të gjitha proceset e vendimmarrjes, lidhur me të ardhmen e zhvillimit socio-ekonomik të mjedisit si dhe gjendjen e tij momentale në marrjen e përgjegjësisë.

## KONKLUZION.

Kjo analizë ka nxjerrë në sipërfaqe një numër çështjesh që duhet trajtuar si, ajo e të drejtave të njeriut, ujit të pijes, ngrohjes, papunësisë, të profileve të caktuara arsimore, bujqësisë, trajtimit të mbeturinave etj. për shkak të ndikimeve të mëdha që kanë në fushat e zhvillimit ekonomik dhe çështjet tjera.

### 1.3.0 VLERËSIMIN E KAPACITETEVE INVESTIVE KOMUNALE, I CILI DO TË PËRMBAJË INFORMATA MBI KAPACITETET DHE RESURSET INVESTIVE;


#### 1.3.1 KAPACITETET INVESTIVE TË KOMUNËS SË KAMENICËS

Raporti më poshtë skicon performancën (pasqyrën e suksesit) e komunës në të kaluarën në gjenerimin e të hyrave vetanake dhe interpreton disa nga studimet për kategoritë e të hyrave vetanake të ndryshme gjatë periudhës 2007-2009. Pastaj, raporti skicon supozimet e bëra në modelin parashikues, për të bërë parashikimet për gjenerimin e të hyrave vetanake për periudhën 2012-2017. Duke u siguruar se këto parashikime janë arritur, raporti analizon trendet e parashikuara dhe përpiket që të interpretojë shkaqet e performancës së tillë të parashikuar. Më në fund, raporti jep disa sugjerime treguese në fushat, në të cilat komunat do të mund të ndihmoheshin nga projekti për të arritur objektivin e rritjes së të hyrave vetanake të gjeneruara nga komuna.

#### 1.3.2 Të hyrat vetanake të parashikuara –Komuna e Kamenicës

| LLOJI I TË HYRAVE VETANAKE                                       | 2007              | 2008                | 2009                | F 2010            | F 2011              | F 2012            | F 2013            | F 2014            | F 2015              |
|--|-------------------|---------------------|---------------------|-------------------|---------------------|-------------------|-------------------|-------------------|---------------------|
| <b>1 TATIMI NË PRONË</b>   | 125,882.46        | 182,500.68          | 160,119.44          | 164,602.78        | 169,211.66          | 174,118.80        | 179,342.36        | 184,901.98        | 187,860.41          |
| <b>2 TALENTAT E QYTETARËVE NË TATIMET</b>                        | 99,386.65         | 120,981.92          | 101,822.85          | 128,652.11        | 139,455.35          | 152,483.61        | 166,733.69        | 148,794.28        | 161,132.38          |
| <b>3 TË HYRAT NGA TRAFIKU NË I PRONË PËRVEKALLE</b>              | 7,265.60          | 18,165.00           | 12,126.90           | 18,190.80         | 18,815.84           | 19,666.55         | 21,214.69         | 23,585.23         | 29,164.01           |
| <b>4 TË HYRAT NGA QYTI I SHËRIMEVE</b>                           | 73,752.56         | 92,830.63           | 69,420.69           | 79,409.84         | 83,045.77           | 86,731.34         | 90,298.23         | 93,544.90         | 96,439.48           |
| <b>5 TË HYRAT NGA QYTI I SHËRIMEVE, TË QYTETARËVE DHE POLICË</b> | 96,615.37         | 113,065.76          | 128,740.92          | 132,519.05        | 135,439.91          | 139,734.65        | 145,509.84        | 152,984.14        | 162,306.34          |
| <b>6 TË HYRAT TË JERA</b>  | 0.00              | 0.00                | 0.00                | 0.00              | 0.00                | 0.00              | 0.00              | 0.00              | 0.00                |
| <b>7 TË HYRAT NGA TALENT ADMINISTRATIVE DHE TATIMET</b>          | 30,373.64         | 93,902.60           | 133,237.06          | 142,619.93        | 150,943.39          | 158,662.28        | 165,715.10        | 172,584.90        | 179,799.83          |
| <b>8 PËRSHKARJA E QYTETARËVE NË SHËRIMET DHE ARSIM</b>           | 54,644.60         | 75,984.35           | 68,357.91           | 71,775.81         | 75,364.60           | 79,132.83         | 82,298.14         | 84,767.08         | 86,462.42           |
| <b>9 QYTI DHE SHËRIMET</b>                                       | 242,460.00        | 250,933.91          | 44,000.00           | 0.00              | 100,000.00          | 10,400.00         | 10,500.00         | 10,600.00         | 10,700.00           |
| <b>TOTAL :</b>   | <b>730,380.88</b> | <b>948,364.85</b>   | <b>717,825.77</b>   | <b>737,770.32</b> | <b>872,276.52</b>   | <b>820,930.06</b> | <b>861,612.05</b> | <b>871,762.52</b> | <b>913,864.87</b>   |
| <b>Indeksi i ndryshimit të hyrave vetanake në të kaluarën</b>    |                   | 0.298452459         | 0.243091127         | 0.0277847         | 0.182314463         | 0.058865          | 0.049556          | 0.01178079        | 0.048295668         |
| Të hyrat e barta   | 240,000.00        | 252,000.00          | 312,000.00          | 184,442.58        | 191,900.83          | 139,558.11        | 129,241.81        | 104,611.50        | 91,386.49           |
| <b>TOTALI I PËRMBAJËSISË DHE SPONJORITËT KOMUNAL</b>             | <b>970,380.88</b> | <b>1,200,364.85</b> | <b>1,029,825.77</b> | <b>922,212.92</b> | <b>1,064,177.53</b> | <b>960,488.11</b> | <b>990,853.91</b> | <b>976,374.03</b> | <b>1,005,251.41</b> |

Siç mund të shihet nga tabela e parashikimit të të hyrave vetanake , THV për Komunën e Kamenicës, rriten deri në 913,846.87 € në fund të vitit 2015. Kur t'i shikojmë të hyrat e përgjithshme vetanake, duket qartazi ekziston një trend pozitiv . Krahasuar me vitin e mëparshëm, THV rriten për çdo vit, përveç për vitin 2011 siç paraqitet në tabelën më poshtë:




### **THV në të kaluarën dhe të parashikuara nga viti në vit me ndryshimin e përqindjes.**


Edhe pse viti 2008 ishte një pikë ngritëse, lëvizësit kryesore aty ishin grandet dhe donacionet, që nëse do të përfshiheshin në atë nivel në vitet e parashikuara do të ofronin një nivel shumë më të lartë e të hyrave vetanake të përgjithshme. Sidoqoftë, kur të jetë shumë e kujdesshme me grande dhe donacione, komuna në bazë të parashikimeve mund të arrijë të gjenerojë deri në 34% më shumë në vit, krahasuar me të hyrat vetanake të gjeneruara në vitin 2009. Kjo mund të arrihet, nëpërmjet menaxhimit më të mirë dhe shfrytëzimit të burimeve dhe shërbimeve komunale, si dhe nëpërmjet mbikëqyrjes më efikase, inspektimeve dhe zbatimeve.

Grafiku i mëposhtëm tregon THV në të kaluarën dhe të projektuarat deri më 2015:






**Të hyrat vetanake në të kaluarën dhe të parashikuarat**



**Pjesëmarrja e secilës kategori të të hyrave vetanake në të hyrat vetanake të përgjithshme të parashikuara për Komunën e Kamenicës:**


Siç mund të shihet nga grafiku më lartë, lëvizësit kryesorë të THV gjatë periudhës në vijim mbeten të jenë, tatimi në pronë, taksat në biznes dhe tatimet, shërbimet komunale , taksat administrative , tarifat dhe gjobat e lëshuara nga gjykatat , policia e trafikut dhe komuna. Këto janë fushat, ku komuna duhet të përpiqet të arrijë

ngritje sa i përket e të hyrave vetanake, nëpërmjet efikasitetit të shtuar në menaxhimin e tyre financiar dhe zbatimin.



Rritja e secilës kategori të të hyrave vetanake të parashikuara

Të hyrat nga tatimi në pronë vazhdojnë të rriten për shkak të regjistrimit të përmirësuar, menaxhimit të bazës së të dhënave , faturimit të përmirësuar dhe zbatimit më të mirë. Të hyrat nga ky tatim, gjithashtu do të ngriten për shkak të rritjes së natyrshme të komunës si dhe rritjes së ekonomisë. Më në fund, gjithashtu mund të llogaritet në mbledhjen e të hyrave të detyrimeve tatimore nga vitet e kaluara, e cila duhet të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me departamentin e tatimit në pronë në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.



Paraqitja e të hyrave nga taksat e biznesit

Tatimet në biznes kanë një rritje të madhe potenciale, për shkak të rritjes ekonomike , regjistrimit më të mirë, shërbimit të bizneseve dhe zbatimit të përmirësuar. Grumbullimi i shtuar i tatimit të biznesit, gjithashtu mund të arrihet nëpërmjet një bashkëpunimi më të mirë me komunat dhe Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë (njësia e regjistrimit të biznesit).Më në fund, prania e përmirësuar e zyrtarëve komunalë brenda komunitetit të biznesit dhe zbatimi më i mirë i rregulloreve komunale, mund të ndihmojë në përmirësimin e të hyrave nga bizneset. Rritja e parashikuar krahasuar me vitin 2009 është 58.24% deri me 2015.




Të hyrat Komunale nga shfrytëzimi i pronës

Të hyrat nga shfrytëzimi i pronës komunale, nuk përbëjnë një përqindje të madhe e të hyrave vetanake të përgjithshme , sidoqoftë, me menaxhimin e përmirësuar të aseteve komunale, rritja e të hyrave nga kjo kategori mund të jetë 3 herë krahasuar me vitin 2009, dhe deri atëherë të përbëjnë rreth 3.19% të të hyrave vetanake të përgjithshme.




Të hyrat nga shërbimet Komunale

Të hyrat nga ofrimi i shërbimeve komunale, janë një kontribuues i rëndësishëm për të hyrat vetanake në komunë, duke përbërë një mesatare prej 10.44% e të hyrave të parashikuara. Parashikimet janë, nëse ka një efikasitet të shtuar dhe përgatitje më të mirë të shërbimeve komunale, Komuna e Kamenicës mund të arrijë një rritje prej 38.92% në gjenerimin e të hyrave nga ofrimi i shërbimeve komunale.




Të hyrat Komunale nga Policia dhe Gjykata

Të hyrat nga gjobat e lëshuara nga gjykatat, policia dhe komuna janë dhe vazhdojnë të jenë kontribuuesë të mëdhenj e të hyrave vetanake komunale, ku mesatarisht duke kontribuar me 17.44% në hyrjet e gjeneruara nga komuna në vitet deri më 2015. Komuna duhet të përpiqet të rrisë pjesëmarrjen në këto tarifa, duke rritur kontributin në këtë kategori që vijnë nga gjobat komunale nëpërmjet përmirësimit të efikasitetit të shërbimeve komunale të inspektimit.



Të hyrat komunale nga taksat administrative

Taksat administrative, tarifat dhe tatimet pritet që të kontribuojnë me një mesatare prej 19.11% në të hyra vetanake të gjeneruara nga komuna. Rritja e të hyrave të gjeneruara nga kjo kategori, do të rezultojë në një rritje prej 34.94% në të hyrat e gjeneruara krahasuar me vitin 2009.



Të hyrat komunale nga arsimi dhe shëndetësia

Të hyrat e parashikuara që vijnë nga pjesëmarrja e qytetarëve në pagesat e shëndetësisë dhe arsimit, kontribuojnë me një mesatare prej 9.46% të të hyrave vetanake të gjeneruara gjatë periudhës 2010 – 2015. Kjo do të rezultojë në një rritje prej 26.48% të të hyrave të gjeneruara nga kjo kategori krahasuar me ato të gjeneruara në vitin 2009.

### 1.3.3 FUSHAT POTENCIALE PËR INTERVENIM DHE PËRKRAHJE

Fushat potenciale për përkrahje nga projekti LOGOS për Komunën e Kamenicës në rritjen e nivelit të të hyrave vetanake të gjeneruara duhet, të fokusohen në kategoritë e THV që mund të ndikohen nga veprimet e autoriteteve komunale dhe ku mund të ketë përfitime të qarta në përmirësimin e performancës komunale.

Tatimi në pronë, duke qenë njëri nga kontribuuesit më të mëdhenj, është një fushë që duhet të përkrahet. Aktualisht, komuna nuk e freskon bazën e të dhënave të pronave siç kërkohet nga ligji (1/3 e bazës së të dhënave e freskuar në vit), dhe faturimi bëhet bazuar në bazën ekzistuese së të dhënave nga Departamenti Qendror i tatimit në pronë në Ministrinë e Financave, pa asnjë komunikim të drejtpërdrejtë me mes të komunës dhe nivelit qendror. Janë disa raporte se një projekt i financuar suedez, do të përkrahë komunat në freskimin e bazës së të dhënave të pronave gjatë vitit 2011. Kjo do të mundësojë komunave, që të kenë një pasqyrë më të qartë të bazës së tatimit të tatuashëm dhe përmirësimit të politikave të tatimit që ata aplikojnë, si dhe përmirësimin e efikasitetit në zbatim dhe reagimin e komunës në dërgimin e projekteve të investimeve kapitale në zona kadastrale përkatëse që paguajnë. Një fushë për përkrahje nga projekti i LOGOS mund të jetë, në përgatitjen e publikimeve komunale dhe ngjarjeve në terren në mënyrë që të prezantohen rezultatet e arritura në grumbullimin e tatimit në pronë dhe të promovojë efektin e grumbullimit të përmirësuar në jetën e përditshme të qytetarëve të zonave përkatëse.

Komuna, gjithashtu mund të përkrahët në gjenerimin e të hyrave nga bizneset. Kjo mund të bëhet në dy drejtime: Njëri është që ti ndihmojë ata në përmirësimin e regjistrimit të bizneseve dhe klasifikimin, si dhe si rezultat të prodhojë politika më të mira tatueshme për bizneset. Gjithashtu, projekti mund të përpiqet që të përmirësojë lidhjet në mes të komunave dhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në shkëmbimin e informatave për bizneset e regjistruara dhe funksionimin e tyre aktual. Një bazë e të dhënave të tatimeve të pa grumbulluara mund të krijohet në komunë dhe të freskohet në baza vjetore, kështu që mund të eliminohen bizneset që janë mbyllur, bankrotuar apo që nuk janë aktive, gjersa në të njëjtën kohë mundëson shënjestrim më të mirë të bizneseve ekzistuese, funksionale dhe të suksesshme. Duhet të përdoren politika për kushtëzimin e shërbimeve komunale për bizneset që kanë taksa dhe tatime të pakryera.

Më tutje, Komuna e Kamenicës, aktualisht nuk grumbullon asnjë të hyrë nga licencat për shfrytëzimin e hapësirës për reklamim. Një rekomandim, është që komuna të fillojë të vendosë tarifa në rregulloren komunale dhe ti zbatojë ato në baza të barabarta për të gjitha bizneset dhe ofruesit e hapësirave për reklamim. Grumbullimi i tarifave për shfrytëzimin e pyjeve dhe zbatimi i përmirësuar i këtyre tarifave, i përkrahur nga nivelet më të larta politike për lobim, në mënyrë që komuna të menaxhojë tarifën dhe tatimet që vijnë nga shfrytëzimi i pyjeve, mund të rezultojë në një burim të mirë e të hyrave për komunën.

Dhënia me qira e tokës komunale, ndërtesave dhe hapësirave është një burim tjetër i mirë i të hyrave, nëse menaxhohet si duhet. Komuna aktualisht ka të hyra të paqëndrueshme nga kjo kategori kryesisht për shkak të menaxhimit joadekuat. Shfrytëzimi i aseteve komunale mund të bëhet më atraktiv nëpërmjet investimeve strategjike, vendimeve dhe politikave stimuluese.

Kompletimi i dokumentacionit të planifikimit hapësinor, duke përfshirë planin urban dhe rregullativ të detajuar, do të lejojë komunës që të inkurajojë zhvillimin, posaçërisht në sektorin e ndërtimit. Kjo do të ndihmonte komunën të rriste të hyrat nga lejet për ndërtim, si dhe shërbimet tjera, duke stimuluar aktivitetin e ndërtimit të ri dhe legalizimin e pronave të paregjistruara dhe pa leje.

Projekti, gjithashtu mund të përkrahë komunën në identifikimin e donatorëve potencial dhe të fushave që mund të përfitojnë nga grantet dhe format e tjera të përkrahjes nga donatorët. Kjo përkrahje më tutje, mund të përfshijë asistencë dhe aftësim në planifikimin e projekteve, shkrimin e propozimeve, ngritjen e fondeve dhe teknikat për monitorim dhe vlerësim. Kjo do të mundësonte komunës të trokiste në grande potenciale dhe në dispozicion. Kështu do të ndihmohej në rritjen e të hyrave vetanake në dispozicion.

Këto fusha të propozuara të përkrahjes së projektit LOGOS, duhet të diskutohen me zyrtarë komunalë dhe fushat në të cilat përkrahja do të ishte më optimale duhet të zgjedhen në bashkëpunim me komunën.

Ky raport është përgatitur me informatat që mbulojnë performancën financiare deri në vitin financiar 2009. Këshilluesi sugjeron që kjo analizë të freskohet në baza të rregullta vjetore gjatë jetë gjatësisë së projektit LOGOS dhe modeli dhe konstatimet e tij të akordohen kur informatat e reja dhe më të detajuara të jenë në dispozicion.

#### 1.3.4 Investimet kapitale

Në investimet kapitale, duhet të përfshin kontributet financiare nga kapacitetet ekzistuese dhe atyre të mundshme.

Kapacitetet ekzistuese përfshinë :

- Buxhetin komunal, sektorin privat, sektorin publik, burimet natyrore, kapacitetet e infrastrukturës publike (ndërtesat) dhe potencialin njerëzor (rinia)

Kapacitetet e mundshme përfshinë :

- Investimet nga jashtë, fondet ndërkombëtare donacionet etj. kreditë dhe grantet si dhe investimet prej qeverisë.

-Edhe pse pagesa e stafit së bashku me shpenzimet për mallra dhe shërbime mbulohet nga fondi i qeverisë, mjetet e grumbulluara as për së afërmi nuk i plotësojnë nevojat lokale të infrastrukturës (rrugë, ujësjellës, kanalizim) si dhe ngritjen e kapaciteteve ekonomike, që do të bënte të mundur rritjen e vendeve të reja të punës, sfidë kjo me të cilën do të ballafaqohemi edhe në vitet në vijim.

-Komuniteti i biznesit, kryesisht përbëhet nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, ekonomit familjare, kryesisht në lëmin e tregtisë, hotelierisë, zejtarisë, bujqësisë dhe më pak të ndërtimtarisë.

-Ndërmarrjet shoqërore, të cilat tanimë janë privatizuar e që në të kaluarën kanë qenë gjigante, nuk kanë ofruar rezultate të pritura.

-Burimet natyrore do të shfrytëzohen në mënyrë sa më racionale, duke e mbrojtur ambientin jetësorë.

-Te grantet e rregullta të Qeverisë së Kosovës dhe investimeve nga ajo, duhet të mundësojnë zhvillim harmonik të Kosovës duke i mënjanuar dallimet mes regjioneve.

-Një rëndësi e veçantë, duhet ti jepet partneritetit publiko-privat e që është një mundësi reale e rritjes së kapaciteteve investuese komunale.

-Të rritet bashkëpunimi me qytetarët jashtë vendit dhe në bashkëpunim me ta investimet e tyre në Kosovë të mos shkojnë vetëm në konsum, por të orientohen në investime, me qëllim të hapjes së vendeve të reja të punës dhe gjenerimin e mjeteve financiare .

-Komuna mund të aplikojë taksa të veçanta për investime të veçanta.

-Zvogëlimi i shpenzimeve për mallra dhe shërbimeve, shpenzimeve komunale, mund të rrisin investimet kapitale.

-Mekanizmi më mirë për marrjen e donacioneve nga jashtë është formula komuniteti, komuna dhe donatorët.

### **1.3.5 Rekomandimet për rritjen e kapaciteteve investuese të komunës**

#### **Rekomandimet për rritjen e kapaciteteve investuese të komunës janë :**

- Rritja e kapaciteteve për tërheqjen e investimeve nga jashtë,
- Krijimi i ambientit të favorshëm për afarizëm,
- Definimi i rregullave unike të thjeshta, të shpejta për themelimin e bizneseve të reja,
- Promovimi i potencialeve lokale,
- Përgatitja e materialit promovues-informativ për kapacitetet komunale,
- Krijimi i kontakteve të rregullta me investitorë potencial (të brendshëm dhe të jashtëm),
- Krijimi i kontakteve dhe mbështetjes së komunitetit,
- Përmirësimi i raporteve dhe komunikimi në baza të rregullta me institucione qendrore-përgjegjëse për zhvillim ekonomik.

### **1.4.0 SFIDAT KRYESORE ZHVILLIMORE, TË CILAT DO TË MARRIN PARASYSH PRIORITETET E QEVERISË, PARIMET NDËRKOMBËTARE, STANDARDET ,SI DHE TË REFLEKTOJNË NEVOJAT E POPULLATËS KOMUNALE, TË NGRITURA PËRMES PJESËMARRJES PUBLIKE**

Sfidat kryesore zhvillimore, të cilat do të marrin parasysh prioritetet e qeverisë, parimet ndërkombëtare, standardet, si dhe të reflektojnë nevojat e popullatës komunale, të ngritura përmes pjesëmarrjes publike janë:

Sfidat kryesore zhvillimore të komunës së Kamenicës të cilat janë punuar nga grupet punuese dhe kanë marrë parasysh prioritetet e qeverisë,parimet dhe standardet ndërkombëtare si dhe të reflektojnë nevojat e popullatës së Komunës së Kamenicës, të ngritura edhe përmes pjesëmarrjes publike janë:

#### **1.4.1 ZHVILLIMI EKONOMIK DHE SHKALLA E LARTË E PAPUNËSISË**

Caqet themelore të shoqërisë sonë janë të përkufizuara me orientimin tonë drejtë: zhvillimit të qëndrueshëm, integritimeve, arritjeve të qëllimeve të mileniumit, si dhe respektimin e ligjeve dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Për nivelin e Kosovës këto qëllime themelore janë trajtuar në Draft Planin Hapësinor të Kosovës, si dhe në shumë dokumente tjera(strategji, politika dhe plane të nivelit shtetëror), prandaj duhet të merren si pjesë përbërëse e dokumentacionit bazë të këtij plani.



Për nga rëndësia e tyre, qëllimet mund të ndahen në ato: themelore ose globale dhe në qëllime të nivelit komunal.

Qëllimet themelore sipas vështrimit më të gjerë e që kane të bëjnë edhe me këtë plan, mund të definojnë si:

- Zhvillimi i mëtejshëm i një sistemi të vlerave ku të gjithë aktorët të ushtrojnë të drejtat e tyre për të ditur, për të dëgjuar dhe për ndikim në vendimet që të kenë ndikim në jetën dhe zhvillimet e tij, ku njëri ndër qëllimet globale është që gjatë hartimit dhe zbatimit të këtij dokumenti të kemi pjesëmarrje cilësore;
- Zhvillimi i qëndrueshëm, i shpejtë e më intensiv dhe ndërrimet e strukturës socio-ekonomike, duke përfshirë këtu edhe zhvillimin më të barabartë brenda përbrenda komunës;
- Krijimi i kushteve për një rritje të vazhdueshme të inkuadrimit, zhdukja e varfërisë, luftimin e sëmundjeve, përmirësimin e shëndetit si dhe zvogëlimin e vdekshmërisë të fëmijët sipas normës që do të sigurojë qëllimet themelore të ndërrimit të strukturës socio-ekonomike, të zhvillimit dinamik të ekonomisë dhe të nivelit të jetesës dhe forcimi i rolit të sektorit privat për zhvillimin socio-ekonomik;
- Shtimi i vazhdueshëm i sigurisë në të gjitha dimensionet e saj (krijimi i sigurisë për arsim primar, social, mjedisor, fizik etj.);
- Ndërtimi i një partneriteti global për zhvillim.

#### **1.4.2 SHFRYTËZIMI I HAPËSIRËS**

- Destinimi themelor dhe bilanci i sipërfaqeve (bujqësi, pylltari, industri, turizëm, banim etj.)
- Planifikimi hapësinor dhe organizimi i banimit në vendbanimet dhe qytet në përputhje me dendësinë e popullsisë dhe infrastrukturës;
- Shumica e ndërtimeve janë bërë në tokë bujqësore (humbje e pakthyeshme e tokës bujqësore) dhe përgjatë korridorit të rrugëve (pamundësi e zgjerimit të rrugëve ekzistuese);
- Planifikimi i hapësirës për zhvillim ekonomik (zona industriale dhe inkubatorët e biznesit) që do të mundësojnë qëndrueshmërinë e qëllimeve ekonomike, për ruajtjen e vlerave të shquara hapësinore dhe të vendbanimeve;
- Planifikimi i hapësirës për qëllime publike, që do të krijojë ambient urban e bashkëkohor në qytet, duke krijuar një hapësirë publike të mjaftueshme dhe të planifikuar në zonën urbane dhe në fshatra;
- Planifikimi i hapësirave për zhvillimin e sportit dhe rekreacionit - jo vetëm për banorët e Kamenicës, por edhe për banorët e fshatrave në tërë komunën;

- Parandalimi i krijimit të zonave të reja me ndërtime ilegale, si dhe trajtimi (legalizimi) i atyre ekzistuese;
- Identifikimi, përkufizimi si dhe propozimet për mbrojtje dhe zhvillim në zonat me vlera të trashëgimisë ndërtimore, kulturore, natyrore, historike, si dhe pasuritë nëntokësore dhe ato sipërfaqësore.

#### **1.4.3 MJEDISI**

- Sfidë e madhe në fushën e mjedisit është, të planifikohet dhe zhvillohet një Mjedis i shëndosh, i sigurt, tërheqës, atraktiv, shëruese-rehabilituese, ku njerëzit duan të jetojnë dhe të rrinë, t'u qasen lehtë dhe lirshëm të gjitha shërbimeve;
- Mbrojtja dhe avancimi i sistemeve të pandërprera të rrjedhave sipërfaqësore dhe nëntokësore të ujit, avancimi i cilësisë së mirë të ujit dhe mirëmbajtjes së sasive ujore, filtrimi natyror deri ku është e mundur, si dhe trajtimi i ujërave sipërfaqësore si elemente atraktive e peizazhe në qytetin e Kamenicës dhe fshatra, është sfidë tjetër në fushën e mjedisit;
- Gjithashtu, sfidë është sigurimi i ajrit të pastër si dhe nivel të tolerueshëm të zhurmës sidomos në zonat e ndjeshme (banimit, shkollat dhe vendet tjera);
- Kujdesi dhe mbrojtja e tokës së pastër, kontaminim minimal, mostrazim i kaarakteristikave gjeomorfologjike dhe ruajtja e tokës bujqësore nga ndërtimet;
- Planifikimi i vendeve për deponi të përkohshme e të përhershme për mbeturina ndërtimore, industriale dhe farmaceutike, menaxhimi me mbeturina komunale, vëllimi minimal i mbeturinave dhe riciklimi i tyre, është njëra ndër sfidat më të mëdha mjedisore;
- Sigurimi i një transporti kreativ, racional, efikas dhe miqësor ndaj mjedisit si sfidë e radhës.

#### **1.4.4 INFRASTRUKTURA**

- Pajisja me infrastrukturë për trajtimin e ujërave të përdorura, atë hidroekonomike, për grumbullim dhe trajtim të mbeturinave, janë sfida të mëdha për Komunën e Kamenicës në fushën e infrastrukturës;
- Infrastruktura e komunikacionit, telekomunikimi, rrjeti energjetik, furnizimit me ujë, infrastruktura e kanalizimit, e trajtimit të ujërave, mbrojtje të ujërave nga ndotja, edhe këto janë ndër sfidat e radhës;
- Mbrojtja e korridoreve për zhvillimet e planifikuara dhe planifikimi i korridoreve të reja në harmoni me nevojat për zhvillimin e ardhshëm (kolektori kryesor i kanalizimit, ai hekurudhor, lartëpërçuesi 110 kw Prishtinë, Kamenicë etj.) paraqet sfidën tjetër;
- Kompletimi i infrastrukturës sociale (arsimore, kulturore, sportive, shëndetësore, etj.).

#### **1.4.5 TRASHËGIMIA**

- Identifikimi, incizimi, përkufizimi, mbrojtja dhe zhvillimi i lokaliteteve arkeologjike, vazhdon të mbetet sfidë e madhe e trashëgimisë;
- Mbrojtja, konservimi, rivitalizimi dhe rikonstruktimi i strukturave dhe hapësirave kulturo-historike (kështjellat, kalatë që ndodhen në Komunën e Kamenicës, kishat ilire-dardane) dhe objekte tjera të kultit;
- Mbrojtja nga shkatërrimi i vlerave të trashëgimisë etnografike;

- Krijimi i një identiteti të Komunës së Kamenicës;
- Pajisja me infrastrukturë në hapësirat arkeologjike, kulturo - historike duke marrë parasysh shfrytëzimin e këtyre vlerave dhe mbrojtjen e tyre për brezat e ardhshëm, është prapë një sfidë;
- Rritja e vetëdijes për vlerat që ka Komuna e Kamenicës dhe futja nën mbrojtje e vlerave trashëgimore në nivel komunal dhe qendror;
- Gjenerimi i mjeteve nga vlerat e trashëgimisë është sfidë, e cila duhet të trajtohet dhe planifikohet në detaje në të ardhmen.

#### **1.4.6 NIVELI I SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE DHE SOCIALE, KULTURORE, SPORTIVE, ARSIMORE**

- Ofrimi i shërbimeve cilësore, paraqet sfidë në këtë fushë;
- Sigurimi i qasjes në objekte dhe shërbimet e të gjithë popullatës, duke e reformuar atë sipas modelit të bazuar në nevojat e ndryshme të grupeve të ndryshme të popullatës;
- Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe sociale, në përgjithësi në standarde të kërkuara si në zonën urbane, ashtu edhe në atë rurale do trajtohet si sfidë e veçantë;
- Ofrimi i mundësisë si dhe zgjidhja e drejtë e statusit të funksionimit të sektorit privat dhe partneritetit publiko-privat, do të krijonte një alternativë të shëndoshë të shkollimit, shëndetësisë dhe funksioneve tjera.

#### **1.4.7 VARFËRIA**

- Shkalla e varfërisë, varfërisë së skajshme (mjerimit), është sfidë e madhe për Komunën e Kamenicës;
- Rritja e shkallës së varfërisë për shkak të tranzicionit, kufizimeve dhe politikave fiskale, krizës globale etj.
- Mosfunksionimi adekuat i mekanizmave për përkrahje sociale në nivel të shtetit, por edhe të komunës, si dhe reduktimi i ndihmave nga organizatat joqeveritare;
- Shtrirja e varfërisë edhe në qytetin e Kamenicës (familjet nga zonat rurale të cilat kanë migruar drejt qytetit dhe ballafaqohen me mungesë të burimeve për jetesë) është edhe një sfidë.

#### **1.4.8 STANDARDET, NORMAT DHE PARIMET**

Pasi që synojmë integritet në strukturat Euro Atlantike si Kosovë, kemi obligim të plotësojmë disa standarde norma si dhe punojmë në bazë të disa parimeve ndërkombëtarisht të pranuar e ato na paraqiten si sfida në të gjitha fushat

- Të gjitha zhvillimet që bëhen në **fushën e ekonomisë**, duhet plotësojnë standarde, norma dhe parime të aplikueshme, të cilat janë obliguese edhe për ne dhe paraqesin një sfidë.
- Të gjitha zhvillimet që bëhen në **fushën e trashëgimisë** duhet plotësojnë standarde, norma dhe parime të aplikueshme.
- Të gjitha zhvillimet që bëhen në **fushën e infrastrukturës** duhet plotësojnë standarde, norma dhe parime të aplikueshme, vlen të ceket p.sh. se një pjesë e gypave për furnizim me ujë janë azbest i çimentos.

- Të gjitha zhvillimet që bëhen në **fushën e mjedisit** duhet plotësojnë standarde, norma dhe parime të aplikueshme, të cilat janë obliguese edhe për ne dhe paraqesin edhe një sfidë.
- Të gjitha zhvillimet që bëhen në **fushën e punësimit, varfërisë** duhet plotësojnë standarde, norma dhe parime të aplikueshme,
- Të gjitha zhvillimet që bëhen në **fushën e shfrytëzimit** të tokës duhet plotësojnë standarde, norma dhe parime të aplikueshme, të cilat janë obliguese edhe për ne dhe paraqesin një sfidë.
- Si ti qeverisim dhe si ti planifikojmë zhvillimet për të ardhmen në mënyr që ti plotësojm standartet ndërkombëtare , transparenca si dhe qasja në vendimmarrje janë sfida të veçanta për tu trajtuar.

## **2.0 VIZIONI, PARIMET DHE CAQET**

### **2.1 VIZIONI PËR TË ARDHMEN E KOMUNËS**

Ky kapitull prezanton në njërin ndër kapitujt kryesor, ku përshkruhet e ardhmja e dëshirueshme e grupeve punuese, institucioneve, sektorëve dhe të gjithë qytetarëve të Kamenicës.

Duke vlerësuar shumë lartë hartimin e Planit Zhvillimor Komunal si, dokument që përcakton rregullimin dhe shfrytëzimin e territorit të komunës për periudhën **10 +** (dhjetë e më shumë vite), është bërë një mobilizim i të gjitha resurseve njerëzore e intelektuale nga dhe jashtë komunës për të hartuar këtë pjesë të dokumentit. Pëkitazi për këtë si rezultat i aktiviteteve të pandërprera të grupeve punuese ,institucioneve, sektorëve dhe të gjithë qytetarëve të Kamenicës, të cilët hulumtuan, analizuan dhe trajtuan çështje të ndryshme, pas organizimit edhe të punëtorisë së vizionimit u përcaktua e ardhmja e dëshirueshme e qytetarëve të Komunës së Kamenicës .

Bazuar edhe në vizionin nga Plani Hapësinor i Kosovës, i cili rajonin në të ardhmen e sheh si: **Urat e Kosovës (Hapësira e verdhë)**, urë e zhvillimit të lidhjes së Kosovës me rajonin, rrjet funksional i fuqishëm i qyteteve dhe fshatrave, atraktive për të jetuar dhe punuar në to, me aktivitete ekonomike tregtare, industriale dhe turizëm, atraktive për investime dhe ndërmarrësi në industrinë përpunuese, agrobiznes, turizëm shërues e rekreativ me plotësimin e kriterëve për mbrojtje të mjedisit.

Të inspiruar për të ardhmen e komunës, në një proces cilësor të shkëmbimit të informatave, ideve, propozimeve, përvojave dhe mobilizimit të gjithë banorëve, komuniteteve, institucioneve, palëve, politikanëve dhe zyrtarëve drejtë krijimit të së ardhmes së dëshiruar për sipërfaqen (komunale), zhvillimet dhe qytetarët u konstatua se:

Është momenti i fundit (2010/2011) për t'u marrë shumë seriozisht me statusin hapësinor të komunës së Kamenicës. **“Më seriozisht”** do të thotë se duhet të ndërpriten trendet e zhvillimit të paqëndrueshëm të dekadave të kaluara sidomos të viteve pas luftës.

Komunës së Kamenicës i nevojitet rritje dhe zhvillim, por është: dëshira, vullneti dhe obligimi i ynë që në të ardhmen ky zhvillim të jetë **zhvillim i qëndrueshëm**.

Me këtë plan duhet të bëhet e mundur që Kamenica të rritet në mënyrë të qëndrueshme, zonat e banimit, industriale, rekreative turistike dhe të gjitha zhvillimet të planifikohen dhe ndërtohen në mënyrë që të jetë pozitive për mjedisin, ekonominë dhe popullsinë, sot dhe në të ardhmen.

Duhet të sigurohemi se zhvillimet nuk janë në konflikt (kanë efekte negative) me interesat tjera sociale, siç janë: mjedisi, shëndeti dhe siguria e popullatës.

Kur planifikohen zhvillime të reja duhet pasur kujdes për zhvillimet e vjetra

Pati edhe disa konstatime të cilat u përmbledhën në këtë deklaratë të vizionit të Komunës së Kamenicës:

**Kamenica** : Vend i resurseve natyrore me traditë industriale

- Komuna e kamenicës do të jetë vend i ofertave të mëdha për investitor të mbrendshëm dhe të jashtëm.
- Vend i përshtatshëm për zhvillim të bujqësisë moderne dhe të organizuar.
- Komunë policentrike me lidhje funksionale, komunale dhe rajonale si dhe me vlera të trashëgimisë kulturore.
- Vend ku përkrahet dija, puna, mirëqenja, në funksion të cilësisë së jetës dhe të mjedisit.

## **2.2 PARIMET E PËRGJITHSHME PËR ZHVILLIM E MBROJTJE**

Parimet e përgjithshme për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Kamenicës, bazohen (mbështeten) në ligjet e Kosovës, konventa, deklarata e agjenda ndërkombëtare, si dhe në dokumente të rëndësishme referente për planifikimin hapësinor.

Bazuar në specifikat veçantitë e Komunës së Kamenicës me qëllim të rregullimit, shfrytëzimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të territorit, përgatitja, zbatimi, rishikimi dhe monitorimi i planit do të përfillin edhe këto parime bazë:

- ✓ **Qasje të integruar** (ky plan duhet të përfshijë elementet hapësinore të transportit, zhvillimit ekonomik, social, mjedisor dhe politikat tjera strategjike për Komunën e Kamenicës);
- ✓ **Strategjia** (ti prijë zhvillimit strategjik të Komunës së Kamenicës dhe ti trajtojë çështjet e rëndësisë strategjike për fushat përkatëse);
- ✓ **Subsidiariteti** (plani duhet të ketë parasysh kontekstin e gjerë hapësinor, pra sipas parimit të subsidiaritetit, plani duhet të fokusohet në çështje lokale, mirëpo të mos jetë kontradiktor me çështjet e nivelit më të lartë);
- ✓ **Monitorimin dhe Rishikimin** (plani duhet të jetë i shprehur në formën, e cila lehtëson monitorimin dhe rishikimin);
- ✓ **Barazia** (plani duhet të marrë parasysh aspektet e barazisë: minoritetet, femrat, fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, adresimi i nevojave të grupeve të tilla përmes pjesëmarrjes publike), të ketë në konsideratë aspektet e ndjeshmërisë gjinore;
- ✓ **Interesat të përbashkëta** (plani duhet të bëjë promovimin e interesave të përbashkëta të komunës, duke mbrojtur dhe zhvilluar resurset natyrore dhe duke mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm);
- ✓ **Procesi demokratik** (bartësit e procesit dhe hartuesit e planit, duhet të bëjnë promovimin e procesit demokratik të pjesëmarrjes dhe përfshirjes cilësore në çdo fazë të hartimit dhe zbatimit të dokumentit);
- ✓ **Transparenca** (bartësit e procesit dhe hartuesit e planit duhet të bëjnë promovimin e transparencës së plotë në planifikim dhe procesin e marrjes së vendimeve, duke u lejuar pjesëmarrësve qasjen në të dhëna dhe hartat e nevojshme);
- ✓ **Zhvillimi i baraspeshuar** (ky plan do të përgatitet duke promovuar zhvillim të baraspeshuar ekonomik, të infrastrukturës, mjedisor, social për atë që është e mundur në tërë territorin e Komunës së Kamenicës);
- ✓ **Kualiteti i jetës** (promovimin e kualitetit të përmirësuar të jetës);
- ✓ **Kohezioni territorial** (promovimi i kohezionit territorial, përmes zhvillimit socio-ekonomik më të balancuar të rajonit dhe përmirësimit të konkurrencës);
- ✓ **Kufizimi i ndikimeve negative** (zvogëlimi i dëmeve mjedisore si dhe kufizimi i ndikimeve nga fatkeqësitë natyrore);
- ✓ **Mbrojtja dhe zhvillimi** (përparimi dhe mbrojtja e resurseve nëntokësore dhe mbitokësore, trashëgimisë natyrore, kulturo-historike, arkitektonike, arkeologjike etj.);
- ✓ **Energjia alternative** (shfrytëzimi sa më i gjerë i energjive të përsëritshme në të gjitha fushat);
- ✓ **Siguria** (promovimi i zhvillimeve dhe hapësirave të sigurta për jetë dhe punë);

- ✓ **Përgjegjshmëria** (për të gjitha zhvillimet, të cilat ndodhin në hapësirë duhet të promovohet ndjenja e përgjegjshmërisë, duke përfshirë sektorin publik e privat deri te qytetari më i thjeshtë);
- ✓ **Zhvillimi duke u bazuar në nevoja** (zhvillimin e objekteve dhe pajisjeve për një infrastrukturë adekuate sociale dhe teknike, e cila i merr parasysh nevojat e banorëve);
- ✓ **Banim të shëndetshëm** (ngritjen e kushteve për banim të shëndetshëm dhe atraktiv në zonat urbane dhe në zonat rurale);
- ✓ **Rekreacioni dhe turizmi** (promovimin e infrastrukturës për rekreacion dhe turizëm);
- ✓ **Sistemi i trafikut** (zhvillimin e sistemit të përshtatshëm të trafikut, lëvizshmërisë, duke siguruar qasje të mirë rurale dhe urbane);
- ✓ **Zhvillim i planifikuar hapësinor** (çdo zhvillim i ardhshëm duhet të jetë i planifikuar dhe i mbështetur me vendime përkatëse);
- ✓ **Zhvillimi kompakt** (në të mirë të shfrytëzimit sa më racional të hapësirës dhe mbrojtjes së resurseve, duhet synuar zhvillim sa më kompakt në hapësirë, më të fokusuar dhe dendësi më të madhe të zënies së hapësirës);
- ✓ **Zhvillimi i qëndrueshëm**(synon shkallën sa më të lartë të bilancit në mes të zhvillimit social, ekonomik e mjedisor, brenda për brenda tyre);
- ✓ **Stimulimi i sinergjive dhe shmangia nga konfliktet potenciale**, parim për të shfrytëzuar në mënyrën më të mirë tendencat zhvillimore të sektorëve të ndryshëm dhe autoriteteve ( komunat fqinje, niveli qendror etj.);
- ✓ **Integrimi në Evropë** (çdo zhvillim i udhëzuar me plan, duhet për aq sa është e mundur të kontribuojë në procesin e integritit të kësaj pjese të Kosovës në BE;
- ✓ **Zhvillimi komplementar** (funksioni themelor i një vendbanimi i plotëson funksionet e vendbanimit tjetër).

### 2.3 CAQET ZHVILLIMORE AFATGJATE

Caqet themelore të shoqërisë sonë janë të përkufizuara me orientimin tonë drejtë: zhvillimit të qëndrueshëm, integritimeve, arritjeve të qëllimeve të mileniumit si dhe respektimin ligjeve dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Për nivelin e Kosovës këto qëllime themelore janë trajtuar në Draft Planin Hapësinor të Kosovës, si dhe në shumë dokumente tjera (strategji, politika dhe plane të nivelit shtetëror), prandaj duhet të merren si pjesë përbërëse e dokumentacionit bazë të këtij plani.

Për nga rëndësia e tyre, qëllimet mund të ndahen në atë: themelore ose globale dhe në qëllime të nivelit komunal

Qëllimet themelore sipas vështrimit më të gjerë e që kanë të bëjnë edhe me këtë plan, mund të definojnë si.

1/ Zhvillimi i mëtejshëm i një sistemi të vlerave ku të gjithë aktorët të ushtrojnë të drejtat e tyre për të ditur, për të dëgjuar dhe për ndikim në

vendimet që të kenë ndikim në jetën dhe zhvillimet e tij, njëri ndër qëllimet globale është që gjatë hartimit dhe zbatimit të këtij dokumenti të kemi pjesëmarrje cilësore;

2/ Zhvillimi i qëndrueshëm, i shpejtë e më intensiv dhe ndërrimet e strukturës socio-ekonomike, duke përfshirë këtu edhe zhvillimin më të barabartë brenda përbrenda komunës;

3/ Krijimi i kushteve për një rritje të vazhdueshme të inkuadrimit ,zhdukja e varfërisë,luftimin e sëmundjeve,përmirësimin e shëndetit si dhe zvogëlimin e vdekshmërisë të fëmijët sipas normës që do të sigurojë qëllimet themelore të ndërrimit të strukturës socio-ekonomike, të zhvillimit dinamik të ekonomisë dhe të nivelit të jetesës dhe forcimi i rolit të sektorit privat për zhvillimin socio-ekonomik;

4/ Shtimi i vazhdueshëm i sigurisë në të gjitha dimensionet e saj (krijimi i sigurisë për arsim primar,social,mjedisor,fizik etj);

5/ Ndërtimi i një partneriteti global për zhvillim.

Detyrat e përgjithshme janë:

Shfrytëzimi i arsyeshëm dhe racional i hapësirës, që nënkupton edhe orientimin me plan të zhvillimit të vendbanimeve dhe të hapësirës në tërësi, shtrohet si detyrë e drejtpërdrejtë e këtij plani për sendërtimin e qëllimeve të shtruara.

Proceset bashkëkohëse të zhvillimit ekonomik gjithnjë e më shumë shtrojnë kërkesën që shpërndarja e kapaciteteve prodhuese si dhe organizimi i jetës dhe i punës në hapësirë të trajtohet në mënyre komplekse edhe në suaza më të gjëra e jo vetëm brenda përbrenda vendbanimeve të caktuara.

Nga kjo arsye, objekt i planifikimit në Planin Zhvillimor Komunal të Kamenicës nuk është vetëm hapësira dhe ambienti fizik, por në radhë të parë njeriu dhe organizimi i jetës dhe i punës së tij në një hapësirë të caktuar. Prandaj organizimi dhe rregullimi i hapësirës, janë parakusht për intensifikimin e zhvillimit dhe të përmirësimit të kushteve të jetesës së popullsisë dhe të punonjësve.

Për ti përcaktuar qëllimet themelore të zhvillimit hapësinor të Komunës së Kamenicës, territorin e saj e kemi trajtuar si pjesë e sistemit të përgjithshëm hapësinor të Kosovës, pjesë përbërëse e të cilit është.

Jemi bazuar edhe në faktin se jemi komunë ndërkufitare.

Plani Zhvillimor Komunal i Kamenicës ofron organizim racional të hapësirës, me qëllim që organizimi i hapësirës t'u përgjigjet sa më mirë interesave të popullsisë që jeton dhe punon në Komunën e Kamenicës, duke mos i lënë anash me këtë rast interesat edhe më të gjëra, si dhe ndërvarësinë dhe lidhshmërinë me viset ndërkufitare dhe komunat tjera.

Përveç qëllimeve dhe detyrave që dalin nga dokumentet e nivelit qendror si dhe agjendat e konventat ndërkombëtare, për Komunën e Kamenicës, më konkretisht mund të përkufizohen edhe këto qëllime dhe detyra.



## **Demografia dhe Çështjet Sociale**

**QËLLIMI 1** Zhvillimi dhe mbrojtja e hapësirave dhe ofrim i shërbimeve cilësore për mirëqenie socio-kulturore.

**QËLLIMI 2** Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë.

**QËLLIMI 3** Zhdukje e varfërisë.

## **Zhvillimi Ekonomik**

**QËLLIMI 4** Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik.

**QËLLIMI 5** Ndërtimi i partneriteteve për zhvillim.

## **Mjedisi dhe Shfrytëzimi i Tokës (planifikimi dhe menaxhimi i vendbanimeve)**

**QËLLIMI 6** Zhvillim dhe menaxhim të qëndrueshëm mjedisor.

**QËLLIMI 7** Zhvillim i qëndrueshëm hapësinor.

## **Infrastruktura**

**QËLLIMI 8** Zhvillimi i një infrastrukture të integruar funksionale dhe moderne.

**QËLLIMI 9** Zhvillim i lëvizshmërisë së lirë të qytetarëve dhe mallrave , të sigurtë, tërheqëse dhe të shumëllojshme për të gjithë aktorët që operojnë në Komunën e Kamenicës.

Për të arritur Vizionin dhe qëllimet e planit për nivelin komunal, dalin edhe këto detyra konkrete:

-Ripërcaktimi i vendit dhe i rolit të Komunës së Kamenicës në kuadër të shtetit të Kosovës.

-Paraqitja e pasurive natyrore dhe e resurseve tjera si faktorë zhvillimi, si dhe shfrytëzimi maksimal dhe racional i faktorëve natyror dhe i atyre të krijuar të zhvillimit me qëllim të realizimit të qëllimeve të lartpërmendura dhe të zhvillimit në harmoni me hapësirën;

-Koncepti global afatgjatë i zhvillimit socio-ekonomik të komunës me orientim të zhvillimit edhe të tërësive më të vogla.

-Krijimi i kushteve për shpërndarje sa më të favorshme të aktiviteteve ekonomike, varësisht nga shpërndarja e popullsisë, infrastrukturës dhe e inkuadrimit;

-Shpërndarja hapësinore e infrastrukturës (rrugëve, sistemit furnizimit me ujë, kanalizimit, rrjetit energjetik , rrjetit telefonik, internetit, objekteve të hidroekonomisë etj.);

-Krijimi i kushteve për organizimin dhe shpërndarjen hapësinore të veprimtarive shërbyese;

-Shpërndarja hapësinore dhe organizimi i banimit në vendbanimet dhe qytet në përputhje me shpërndarjen e popullsisë dhe të infrastrukturës;  
-Norma e rritjes së zhvillimit duhet jetë në pajtim me parimet e përcaktuara.

Ndërrimet që do të pasojnë në zhvillimin socio-ekonomik të komunës, shtrojnë nevojën që planifikimi të bëhet proces i pandashëm. Vetëm duke e kultivuar planifikimin strategjik e të pandashëm hapësinor, mund të ruhet drejtpeshimi në mes të zhvillimit social ekonomik dhe mjedisor në hapësirë.

## **Demografia dhe Çështjet Sociale**

### Prioritetet strategjike

- Krijimi i kushteve për edukim të ultë dhe të mesëm në varësi me konceptin e nën-qendrave dhe standardeve evropiane;
- Ndërtimi i ShMLP në Kamenicë (Lagja ‘Malësia’), me qëndrim ditor ;
- Ndërtimi i shkollës fillore në Berivojcë dhe Novosellë;
- Krijimi i kushteve për arsimim të lartë dhe superior;
- Krijimi i kushteve për aktivitete kulturore dhe sportive e posaçërisht hulumtimit të vlerave kulturore, arkitektonike e arkeologjike (restaurimi i kështjellave: KULINA në Kamenicë dhe në Kopërnice);
- Përmirësimi i koncepteve për mjekësinë familjare;
- Ndërtimi i qendrave rehabilituese dhe rekreative në: Kikë, Kranidell, Gmicë, Velegllavë etj.
- Ndërtimi i qendrës spitalore ne Kamenicë;
- Ndërtimi i objektit për persona me aftësi të kufizuara.

## **Zhvillimi Ekonomik**

### Prioritetet strategjike

- Planifikimi i zonës Industriale dhe i zonave për zhvillim të industrisë;
- Planifikimi i hapësirave aktive rurale dhe zonave zhvillimore bujqësore;
- Planifikimi i zonave turistike dhe rekreative në Kikë, Tugjec, Velegllavë, Kranidell, Kremenatë, etj.
- Hapja e pikës doganore në Svirçë (Kapi - Medvegjë), Kikë (Marocë – Leskoc), Tërstenë – Vllasë, Karaçevë e Poshtme – Muhoc;
- Mbrojtja dhe shfrytëzimi i resurseve natyrore (bentoniti, argjila, tufi, kaolini, antimoni, silici, graniti, mermeri, andeziti, hekuri, çeliku, magneziti, thëngjilli, etj.);
- Planifikimi i korridoreve të reja për transport dhe plotësimi e fuqizimi i korridoreve ekzistuese;

- Krijimi i kushteve për tërheqjen e investitorëve të brendshëm dhe të jashtëm për investime;
- Ngritja e kapaciteteve prodhuese për shfrytëzimin e resurseve dhe finalizimin e tyre, nëpërmjet partneritetit publiko-privat;
- Bashkëpunimi ndërkomunal dhe rajonal;
- Inkubatorët e biznesit.

## **Mjedisi dhe Shfrytëzimi i Tokës (planifikimi dhe menaxhimi i vendbanimeve)**

### Prioritetet strategjike

- **Hartimi i planeve rregulluese të qytetit dhe nënqendrave: Koretin, Topanicë, Hodonoc, Rogaçicë, Muçivërc, Hogosht, Karaçevë, Petroc.**  
**Qëllimi:** Zhvillim dhe menaxhim të qëndrueshëm mjedisor në të gjitha këto vendbanime të cekura. Zhvillim të qëndrueshëm hapësinor dhe një jetë më të mirë njerëzore.
- **Trajtimi i vendbanimeve joformale**  
Në komunën tonë kemi identifikuar së paku dy zona të vendbanimeve jo formale: një në zonë urbane dhe tjetra në Berivojcë, për të cilat mendojmë se janë më të dalluara. Si zgjidhje për këto vendbanime, kemi vendosur që të bëjmë zgjerimin e planit rregullativ dhe në mënyrë të veçantë, të kujdesemi për këto zona, si dhe të përmirësojmë jetën dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të tokës dhe hapësirës.
- **Rregullimi i shtretërve të lumenjve**  
Me këtë kemi menduar, që të rregullohen shtretërit e lumenjve si: Lumit “Kriva Reka”, Lumit të Hogoshtit, Lumit të Desivojcës dhe Përroi i Rubocit.
- **Mbrojtja e tokës bujqësore, e cila do të përkufizohet me këtë plan**  
Me këtë kemi menduar se, me hartimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Urban për Komunën e Kamenicës, do të arrihet të përcaktimi i zonave me destinime të caktuara. Gjatë hartimit të këtyre planeve, do të kujdesemi që në tokat bujqësore nga kategoria **I - IV** të ndalohen ndërtimet.
- **Mbrojtja dhe shfrytëzimi i resurseve natyrore**  
Dihet se Komuna e Kamenicës ka shumë lloje të resurseve natyrore. Atëherë, kërkohen investitorë dhe ekspertë të këtyre lloje resursesh, sepse sipas shënimeve të mëhershme ka sasi të mjaftueshme të rezervave. Kurse sa i përket mbrojtjes së resurseve natyrore me sasi të vogël, në këtë rast do të veprohet konform ligjeve në fuqi dhe do të kërkohet që në këtë drejtim mos të ketë tolerancë.

## Infrastruktura

### PRIORITETET STRATEGJIKE

- Ndërtimi i infrastrukturës për akumulim (ndërtim i pendave, digave dhe kaptazheve tjera) dhe prurje të ujit për pije;
- Infrastruktura për trajtim të përkohshëm dhe të përhershëm të ujërave të zeza, duke konsideruar ndërtimin e impiantit ndërkomunal (në Korrminjan);
- Ndërtimi i pendës (digës) në Kremenatë, Shipashnicë të Epërme dhe në Gjyrishec –Hogosht;
- Ndërtimi i infrastrukturës për energji alternative në Kikë-Velegllavë, Kranidell(Pllanik);
- Ndërtimi i infrastrukturës për deponi të përkohshme dhe të përherëshme, në Kopërrnicë (te Qafa), Hogosht (te Batalhtë), Berivojcë (te Rovina), Bllatë;
- Ndërtimi i rrjetit të ri rrugor (1. Kamenicë – Kapi – Medvegjë, 2. Kamenicë – Krilëvë – Podujevë – unazat e Kosovës, 3. Kamenicë – Hogosht – Desivojcë – Guri i Zi – Vllasë, 4. Kamenicë – Berivojcë – Koretin – Dajkoc – Muçivërc – Rogaçicë – Karaçevë e Poshtme – Muhoc, 5. Kamenicë – Bullaj – Zllatar – Prishtinë, 6. Hogosht – Lisockë – Zhujë – Shahiq – Gjyrishec – Svirçë – Baja e Sijarines, 7. Unaza e qytetit të Kamenicës) si dhe përmirësimi i rrjetit rrugor ekzistues me infrastrukturë përcjellëse në drejtim të Serbisë;
- Ndërtimi i vijës hekurudhore (1. Podujevë - Kamenicë – Dheu i Bardhë – Bujanoc) me korridoret VIII-të dhe X-të;
- Mbështetja me infrastrukturë teknike të zhvillimit policentrik dhe lehtësim të qasjes së nënqendrave;
- Ndërtimi i infrastrukturës që do të ofrojë siguri dhe rregullim të komunikacionit urban dhe ndër-urban;
- Krijimi dhe përmirësimi i kualitetit të hapësirave publike në pjesën urbane dhe rurale të Kamenicës (varrezat, stacioni i autobusëve, vendparkimet, hapësirat e gjelbëruara, rehabilitimi i hapësirave tregtare urbane dhe rurale);
- Përmirësim të rrjetit energjetik 110 dhe 400 kV me infrastrukturë përcjellëse, Prishtinë-Kamenicë, Kamenicë – Bujanoc, si dhe përmirësimi e avancimi i infrastrukturës ekzistuese;
- Lidhje të re të rrjetit optik me infrastrukturë përcjellëse në territorin e Komunës së Kamenicës;
- Lidhje të re të rrjetit të autoudhës me infrastrukturë përcjellëse, Ferizaj-Gjilan – Ranillug - Kamenicë – Bujanoc, me korridoret VIII-të dhe X-të;
- Ndërtimi i aeroportit emergjent dhe bujqësor (në Marocë dhe në Kremenatë);
- Ndërtimi i infrastrukturës së ujësjellësit në tërë territorin e komunës.

## 3.0 KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR KOMUNAL

Korniza e zhvillimit hapësinor, shpreh parashikimin e dëshiruar hapësinor për territorin e komunës. Ajo përcakton kontekstin hapësinor të strategjive për implementim, planeve të veprimit dhe të vendimmarrjes. Korniza e zhvillimit hapësinor, duhet së paku të përmbajë:

### 3.1 Konceptet kryesore të zhvillimit hapësinor

#### Në nivelin komunal

Ekipi komunal i planifikimit dhe ekipet tjera të angazhuara në hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, kanë analizuar nga aspekti ekonomik, social dhe mjedisor disa koncepte dhe skenarë të mundshëm të zhvillimit hapësinor të vendbanimeve. Pas analizës serioze në rrafshin profesional, analizës politike por edhe me shoqërinë civile, duke marrë parasysh gjendjen faktike në komunë dhe zhvillimet që kanë ndodhur në hapësirën e Komunës së Kamenicës, por edhe të gjitha implikimet që reflekton kjo gjendje në aspektin ekonomik, social dhe mjedisor, është konstatuar se për të arritur:

- Zhvillim dhe mbrojtje të tokës bujqësore
- Rritje e komunës në mënyrë të qëndrueshme
- Zhvillim ekonomik, social dhe mjedisor të qëndrueshëm dhe të baraspeshuar
- Ofrim të shërbimeve dhe mundësive sa ma afër, shpejtë dhe lirë për qytetarët.

Duhet bërë zhvillimi i vendbanimeve me konceptin e zhvillimit hapësinor **policentrik me tri segmente lineare**, segmenti i parë Kamenicë –Rogaçicë , segmenti i dytë Kamenicë – Hogosht, si dhe segmenti i tretë Kamenicë – Strezoc që ndryshe do ta quajmë edhe “**Koncepti i Diellit**”.

Për plotësimin e rrjetit urban të vendbanimeve me funksione e përmbajtje dhe për një zhvillim më të baraspeshuar hapësinor të territorit të Komunës së Kamenicës, vlerësohet prioritare **zhvillimi i shpejt i qytetit të Kamenicës, Rogaçicë, Hogosht, Strezoc** dhe disa nën – qendrave, siç janë **Koretini, Hodonoci, Muçivërci**, si në funksion të lidhjeve, shërbimeve, dendësimit dhe ushtrimit të funksioneve tjera plotësuese sociale , ekonomike e mjedisore .

Ky koncept i konsideruar si, racional dhe efikas nga grupet punuese për zhvillim të planifikuar Komunal, si bosht të vetin orientues për arritjen e vizionit të Komunës së Kamenicës, konsideron nevojën e zhvillimit (ekonomik, social-demografik e mjedisor) të sinkronizuar, në kohë e hapësirë të qendrës komunale edhe të nënqendrave, të cilat do të jenë në pozitën e vendbanimit komplementar, në kuptimin se funksionet themelore të këtyre vendbanimeve plotësojnë funksionet e vendbanimeve tjera brenda ndarjes hapësinore policentrike, ashtu që këto të sigurojnë edhe lidhjen funksionale të rregullt dhe të mirë të mbarë hapësirës brenda kësaj komune dhe rajonit.

Specifikat e zhvillimit të vendbanimeve në Komunën e Kamenicës, kërkojnë që në të ardhmen konceptin të urbanizimit të hyhet në mënyrë tepër elastike, përveç urbanizimit për qendrat kryesore e nënqendrat, lansohet koncepti edhe për urbanizimin kompakt të fshatrave tjera.

Qendra komunale (Kamenica), duhet të orientohet e ndërtohet me të gjitha elementet e strukturës urbane complete. Ajo do të sigurojë mënyrën urbane të jetesës, me të gjitha funksionet dhe përmbajtjet që i përgjigjen urbanizimit të qëndrueshëm, zhvillime të rëndësishme në disa pajisje dhe përmbajtje urbane, duhet pritur edhe në **Rogaçicë, Hogosht, Strezoc**, të cilat do të përgjigjen funksionit të Kamenicës në hapësirë, komunë, regjion dhe nivel të Kosovës por edhe në **Rogaçicë, Hogosht dhe Strezoc** brenda këtyre zhvillimeve

Shkalla e urbanizimit duhet të rritet në harmoni me trendet globale, tani më tepër se gjysma e popullsisë botërore jeton në vendbanime urbane. Shtimi i shpejtë i popullsisë urbane dhe i vendbanimeve gjysmurbane dhe popullsisë gjysmurbane, mund të pritet në vitin në vijim, si rezultat i investimeve për plotësim të standardeve për paraqasje të Kosovës në strukturat evropiane, zhvillimit ekonomik dhe i ndërtimit të kapaciteteve industriale dhe gjatë kësaj periudhe gjer në vitin 2021.


Numri i vendbanimeve urbane e gjysmurbane të propozuara me këtë plan, në të ardhmen do të kompletojnë strukturën urbane . Rolin më të rëndësishëm në këtë drejtim do të vazhdojë ta ketë Kamenica, si qendër administrative e komunale dhe vendbanimi me i madh Komunal.

Duhet bërë zhvillimi i vendbanimeve me konceptin e zhvillimit hapësinor **policentrik me tri segmente lineare** segmenti i parë Kamenicë –Rogaçicë , segmenti i dytë Kamenicë – Hogosht si dhe segmenti i tretë Kamenicë – Strezoc, që ndryshe do ta quajmë edhe **“Koncepti i Diellit”**.


Harta. Ndarja hapësinore e Kamenicës-Koncepti i Diellit Fq.148)

Ky koncept përmbajtësish është **policentrik** i kombinuar me elemente lineare, me **tri segmente** , segmenti i parë Kamenicë –Rogaçicë , segmenti i dytë Kamenicë – Hogosht si dhe segmenti i tretë Kamenicë – Strezoc, që ndryshe do ta quajmë edhe **“Koncepti i Diellit”**. Elementet lineare janë ekzistuese, ku në të ardhmen nuk do të favorizohen segmente tjera, ky koncept i zhvillimit synon fuqizimin e nënqendrave, si dhe monitorimin, funksionalizmin e rehabilitohen për aq sa është e mundur të tri segmenteve me hartimin e planeve rregulluese.

Tendencat e shprehura në shtimin dhe përqendrimin e popullsisë dhe rrethanat tjera, të cilat do të kenë ndikim në proceset e urbanizimit - kushtet natyrore, zhvillimi dhe kompozicioni i infrastrukturës dhe elementet tjera të ekonomisë eksterne në hapësirë, do të ndikojnë që këto procese të jenë më të theksuara në zonën rreth rrugës Hogosht - Dheu i Bardhë dhe Krilevë-Kamenicë. Njëkohësisht, ky do të jetë edhe boshti kryesor territorial i zhvillimit, në të cilin do të formohet edhe njëra ndër degët e sistemi kryesor urban, por edhe segmenti Krilevë-Kamenicë-Rogaçicë-Hogosht, do jetë bosht i rëndësishëm i zhvillimit, ku këtu do synohet një lëvizje dhe fuqizim i aksit Kamenicë –Muçivërc –Rogaçicë-Vranjë, Kamenicë-Hogosht-Tërstenë-Leskoc, Kamenicë-Tugjec-Bajë e Siarinës, Kamenicë – Krilevë-Prishtinë, Kamenicë-Busavatë-Novobërd, Kamenicë- Petroc-Gjilan , Kamenicë-Dheu i Bardhë- Bujanoc; për plotë arsye dhe me këtë do kompletohet edhe boshti tjetër kryesor urban, këto boshte zhvillimi dhe nënqendrat në to, duhet të kenë prioritet në planifikimin hapësinor dhe urban dhe zhvillimet në përgjithësi.



Harta. 32. Ndarja hapësinore e Komunës së Kamenicës-“Koncepti i Diellit”



Harta. 33. Organizimi hapësinore i Komunës së Kamenicës



### 3.1.1 NE NIVEL VENDBANIMI

## POPULLSIA, VENDBANIMET, VENDBANIMET JOFORMALE

### 3.1.2 POPULLSIA

Gjatë analizës së zhvillimit të popullsisë në komunën e Kamenicës, përpos shtimit natyror, migrimit dhe emigrimeve kishte edhe faktor tjerë që ndikuan në dinamikën e rritjes, deri me decentralizimin e komunës në vitin 2010 ku një pjesë e territorit u nda në dy komuna si Ranillugu dhe një pjesë Novobërdës. Sipas analizave komuna e Kamenicës deri vitet 90' shënoi rritje të popullsisë. Me fillimin e krizës ekonomike sidomos pas shkatërrimit të fabrikave të Sintermagnezitet, Niteksiit dhe fabrikës së Qeramikës, ku mbeten një numër i madh i punëtorëve pa punë kjo ndikoi dukshëm në migrimin e popullsisë në qendrat tjera të Kosovës po ashtu në shtetet perëndimore. Këta faktorë ndikuan dukshëm në rënien e numrit të popullsisë.

Po paraqesim në figurën e më poshtme të dhënat statistikore sipas viteve të shtimit të popullsisë

| Viti regjistrimit | 1948  | 1953  | 1961  | 1971  | 1981  | 1991  | 2009(Vler) |
|-------------------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|------------|
| Nr. i banorëve    | 36676 | 39977 | 43058 | 46506 | 48320 | 52152 | 54000      |


Tab. 42. Regjistrimi i popullsisë sipas viteve(tërë territori pa decentralizim)



Graf.20. Dinamika e rritjes së popullsisë

|                   |       |       |       |       |       |       |       |
|-------------------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|
| Viti regjistrimit | 1948  | 1953  | 1961  | 1971  | 1981  | 1991  | 2011  |
| Nr. i banorëve    | 29937 | 32305 | 34064 | 37474 | 38934 | 40884 | 40224 |

Tab.43. Regjistrimi i popullsisë sipas viteve(tërë territori me decentralizim 2011)



Graf.21. Numri i banorëve me decentralizim.

| Mosha         | Nr. i popullsisë | %           |
|---------------|------------------|-------------|
| Prej 0 – 6    | 6821             | 16.95%      |
| Prej 7 – 15   | 6092             | 15.15%      |
| Prej 16 – 19  | 2483             | 6.19%       |
| Prej 20 – 40  | 10756            | 26.74%      |
| Prej 41 – 65  | 12256            | 30.46%      |
| Mbi 65        | 1816             | 4.51%       |
| <b>Totali</b> | <b>40224</b>     | <b>100%</b> |

Tab.44. Struktura e popullsisë sipas moshës

Në fazën e analizës së situatës është analizuar edhe **Zhvillimi i mundshëm demografik për Komunën e Kamenicës**

Zhvillimi demografik i komunës së Kamenicës, është shtjelluar sipas parametrave demografik kryesore siç janë:

**Natalitetit në Komunën e Kamenicës** - që paraqet raportin në mes numrit të lindjeve të gjalla dhe numrit të popullsisë të të njëjtit vitë në njëmijë banorë.

**Mortalitetit në Komunën e Kamenicës** - që paraqet raportin në mes numrit të vdekjeve dhe numrit të popullsisë të të njëjtit vitë në njëmijë banorë.

**Shtimit natyral në Komunën e Kamenicës** -që paraqet ndryshimin në mes numrit të lindjeve të gjalla dhe numrit të vdekjeve, në raport me numrin e popullsisë të njëjtit vit në njëmijë banorë.

Duke kalkuluar dy mundësi migrimi parashikimet janë se për 15 vitet e ardhshme Kamenica do të ketë shtim të qëndrueshëm dhe numri i banorëve mund të sillet **(51038 – 51797)** banorë

### 3.1.3 Zhvillimi demografik në Komunën e Kamenicës

Ekipi që kemi punuar në analiza dhe parashikimet demografike kemi qenë plotësisht të përkushtuar të shfrytëzojmë si burim të parë të informatave, burimet zyrtare dhe të dhënat e plotësisht të dokumentuara ,në mungesë të tyre kemi shfrytëzuar burime sekondare për parametra të caktuar që na i kemi konsideruar si vlerësime ose të dhëna të vlefshme, të grumbulluara dhe strukturuar duke shfrytëzuar mekanizma të caktuar të tilla burime janë konsideruar Organizata Ndërkombëtare për Migrim / IOM ,UNDP, OSBE, UNHCR etj, dhe burimi i tretë i shfrytëzuar janë parashikimet dhe projeksionet profesionale.


Në këtë drejtim regjistrimi si operacion statistikor që ofron gjendjen reale të popullsisë në një moment të caktuar dhe shërben si bazë për të bërë vlerësimet e mëvonshme demografike, duke përdorur informacionin mbi shtimin natyral dhe saldot migruese është burimi i parë që kemi konsultuar dhe shfrytëzuar.

Një pjesë të të dhënave të tilla nga regjistrimet e përgjithshme të popullsisë në Kosovë që datojnë që nga viti 1921, e sidomos regjistrimet e realizuara në vitin 1948,1958,1971,1981 janë në dispozicion për Komunën e Kamenicës nga Enti i Statistikave të Kosovës.

Komuna e Kamenicës në vitin 1981 kishte 48320 banorë, ndërsa në vitin 1991 kishte 52152 banorë kurse në vlerësimin e bërë me 2009 kishte 54000 banorë dhe në vlerësimin e fundit 2011 Kamenica vlerësohet të ketë mbi 40224 banorë.

| Viti regjistrimit | 1948  | 1953  | 1961  | 1971  | 1981  | 1991  | 2009(VI<br>er) | 2011  |
|-------------------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|----------------|-------|
| Nr. i banorëve    | 36676 | 39977 | 43058 | 46506 | 48320 | 52152 | 54000          | 40224 |

Tab. 45.Nr.banorëve sipas viteve



**Graf.22. Numri i banorëve me decentralizim.**

Megjithëse këto të dhëna nuk mund të merren si baza me një besueshmëri të lartë (sidomos vlerësimet 2009, dhe regjistrimit 2011) për shfrytëzime në disa fusha të veçanta, por gjithsesi që për fushën e planifikimit zhvillimor komunal paraqesin një bazë të solide për ta vlerësuar shtimin e popullsisë .

Një regjistrim i ri i përgjithshëm është i nevojshëm dhe mund të pritët që të organizohet nga niveli qendrorë gjatë viteve të ardhshme që do të ishte një bazë për të azhurnuar edhe këtë bazë të informatave.

Rekomandohet që në vitet në vijim të rishqyrtohet parashikimi demografik, duke përcjellë rritjen e numrit të banorëve (duke u bazuar në të dhëna të sakta statistikore) për të përmirësuar gabimet e mundshme të kalkulimeve të rritjes së popullsisë, në mënyrë që parashikimi të jetë sa më i qëndrueshëm.

Megjithatë ekipi ynë duke pasur parasysh rendësin e këtij parashikim është munduar të ketë sa ma shumë informata të sakta dhe të besueshme që është e mundur dhe në këtë dokument janë shfrytëzuar të dhënat për lindjet, vdekjet dhe shtimin natyral nga burimet zyrtare për vitet e fundit, ndërsa përlllogaritjet e disa parametrave demografik, interpretimi i tyre dhe grafikonet janë bërë nga ekspertët e fushës përkatëse.

#### **Metodologjia e grumbullimit të të dhënave**

Të dhënat për lindjet dhe vdekjet janë marrë nga ESK e ata i kanë marrë nga ofiqarit. Sipas ligjit mbi librat amzë çdo ngjarje vitale, lindje apo vdekje, regjistrohet në selinë e ofiqarisë të vendngjarjes, pa marrë parasysh se personat në fjalë, vendbanimin e përhershëm e kanë në vendin ku ka ndodhur ngjarja, apo në ndonjë vend tjetër.

Zhvillimi demografik i Komunës së Kamenicës, është shtjelluar sipas parametrave demografik kryesore siç janë:

**Natalitetit në Komunën e Kamenicës** -që paraqet raportin në mes të numrit të lindjeve të gjalla dhe numrit të popullsisë e vitit të njëjtë në njëmijë banorë.

**Mortalitetit në komunën e Kamenicës** –që paraqet raportin në mes numrit të vdekjeve dhe numrit të popullsisë të të njëjtit vit në njëmijë banorë.

**Shtimit natyral në komunën e Kamenicës** –që paraqet ndryshimin në mes numrit të lindjeve të gjalla dhe numrit të vdekjeve, në raport me numrin e popullsisë e vitit të njëjtë në njëmijë banorë.

### **Migrimi**

Duke e marrë parasysh perspektivën ekonomike sociale dhe mjedisore ,Sipas shifrave dhe informatave që kemi në dispozicion për migrimin, në komunën e Kamenicës nuk mund të thuhet se ka migrim të cilin duhet ta theksojmë, shumë numër i vogël nga komunat tjera edhe nga jashtë Kosovës në mënyrë të veçantë nga Republika e Serbisë kanë lëvizur në Komunën e Kamenicës, në kohë të njëjtë kemi emigrime jashtë Kosovës por edhe në disa qendra nëpër Kosovë, vlerësimi përfundimtarë është se në komunë ka trendë negative të migrimit duke marrë për bazë të gjitha lëvizjet brenda në komunë por edhe lëvizjet nga komuna jashtë është konstatuar se koeficienti i migrimit i përgjithshëm është :



$S_m =$  shtimi vjetor nga migrimi -0.5 deri 0

Parashikohet që Kamenica si komunë do të jetë atraktive për banorët e Kamenicës por edhe për të tjerët, kështu që siç shihet në të ardhmen duhet pritur lëvizje drejt një balancimi në mes migrimeve dhe emigrimeve dhe prej koeficientit  $S_m = -0.5$  të lëvizmi ka zeroja.

Në kapitujt paraprak prezantuam karakteristikat e përgjithshme të familjeve në Kosovë me fokus të veçantë tek dallimet ndërmjet familjeve që pranojnë remitenca dhe atyre që nuk pranojnë ato. Në këtë seksion paraqiten karakteristikat e emigrantëve – pra atyre që sigurojnë mbështetjen financiare për këto familje kosovare. Ky seksion po ashtu, paraqet një përmbledhje të planeve për migrim tek familjet kosovare në përpjekje për të kuptuar dinamikën e ardhshme të lëvizjeve të popullsisë jashtë vendit dhe rrjedhave të remitencave në Kosovë


### **Emigranti**

Sipas këtij studimi, emigranti në shumicën e rasteve është në një lidhje të ngushtë gjaku me kryefamiljarin. Tek 42 përqind e rasteve të familjeve që pranojnë remitenca dërguesi ishte vëlla i kryefamiljarit krahasuar me 40 përqind të rasteve kur dërguesi ishte fëmija apo prindi i kryefamiljarit. Rreth 20 përqind nga numri i përgjithshëm i dërguesve ishin femra. Në anën tjetër, arsyet kryesore që kishin motivuar emigrimin tek shumica e rasteve ishin të natyrës politike ose ekonomike ( Figura 7). Shumica syresh vazhdojnë të jetojnë në vendet e Evropës Perëndimore – pra aty ku kishin emigruar më herët. Nga të dhënat e hulumtimit del që lëvizjet kryesore drejt këtyre vendeve kanë ndodhur ndërmjet viteve 1990-1999 (Figura 8).



Statusi juridik dhe statusi i punësimit të emigrantëve ishin, gjithashtu me interes për këtë studim. Mbi 95 përqind e emigrantëve që dërgojnë remitenca kanë një status të rregulluar ligjor në vendin në të cilin ata banojnë. Nga ky numër, 47 përqind e tyre kanë shtetësinë e vendit të banimit, 27.7 përqind kanë statusin e banorit të përhershëm dhe pjesa tjetër prej 21.6 përqind banojnë me leje qëndrimi. Shumica e emigrantëve raportuan se statusi i tyre i punësimit është një nga : janë të punësuar të përhershëm, të punësuar në sektorin publik, të ketë gjetur mundësi vetë-punësimi ose të jenë vetë

punëdhënës (në rreth 89 përqind). Pjesa tjetër kanë gjetur mundësi punësimi me gjysëm normë apo kanë mbetur jashtë tregut të punës (Figura 9).



Planifikim zhvillimor komunal në qendër të fokusit e ka qytetarin, planifikim behet për njerëzit që jetojnë e punojnë sot në vendbanimet e ndryshme të Komunës duke përfshirë edhe qytetin e Kamenicës duke i kushtuar rëndësi për të iu ofruar të njëjtat mundësi edhe për gjeneratat që do të vinë.

Ky parashikim fiton në peshë kur dihet, infrastrukturë e hapësira ekonomike, sociale e mjedisore duke u bazuar në këtë parashikim.

Gjatë vlerësimit të popullsisë për Komunën e Kamenicës deri në vitin 2026 janë marr parasysh parametrat kryesor si vlerësimi i popullsisë me 2011, shkalla vjetore e shtimit, si dhe migrimi, parametra këto themelor që ndikojnë drejtpërdrejtë në rritjen demografike .

Në vazhdim do të paraqitet ky parashikim sipas formulës:

$$P_k = P_o \times (1 + P/100)^n$$

### Shpjegimet e simboleve:

$P_k$  - parashikimi i popullsisë për vitin 2026

$P_o$  - Numri i popullsisë për vitin 2011(40224)

P1 - shkalla vjetore e shtimit të ulët (1.6)

P2 - shkalla vjetore e shtimit të lartë (1.7)

n – numri i viteve të parashikuara (15)

Parashikimi i numrit të popullsisë për qytetin e Kamenicës për një vit:

$$P_k = P_o \times (1 + P1/100)^n = 40224 * (1 + 1.6/100)^1 = 40868$$

$$P_k = P_o \times (1 + P2/100)^n = 40224 * (1 + 1.7/100)^1 = 40908$$

Parashikimi i numrit të popullsisë për qytetin e Kamenicës për vitin 2026:

$$P_k = P_o \times (1 + P1/100)^n = 40224 * (1 + 1.6/100)^{15} = 51038$$

$$P_k = P_o \times (1 + P2/100)^n = 40224 * (1 + 1.7/100)^{15} = 51797$$

### 3.1.4 Definimi dhe matja e zhvillimit të popullsisë

Edhe se zhvillimi mund të vlerësohet si një proces i vazhdueshëm i rritjes dhe i përparimit. I cili nuk nënkupton ndryshime revolucionare por nënkupton ekzistencën e një procesi të vendosur, që ka për qëllim përmirësimin e jetës së qytetarit dhe shoqërisë në Komunën e Kamenicës.

Gjatë hartimit të këtij dokumenti me konceptin e zhvillimit të popullatës synojmë ti vendosim njerëzit dhe nevojat e tyre në qendër të procesit.

Zhvillimi i popullatës është planifikuar duke hulumtuar zgjerimin e mundësive të përzgjedhjes së qytetarit. Me zgjerimin e mundësive qytetarit duhet ti sigurohet një jetë e gjatë dhe e shëndetshme, shkollim, punësim, standard të mirë të jetës dhe pjesëmarrje aktive në jetën e komunitetit.

Procesi do të tenton të krijojë kushte dhe mundësi të njëjta për të gjithë, në veçanti për ata jeta e të cilëve është e cënuar. Kjo do të bëhet në mënyrë që të zmadhohet potenciali i secilit person.

Matja e zhvillimit të popullatës tejkalon mënyrat tradicionale të matjes të të ardhurave, që në kohë të caktuara ka shtrembëruar faktin që caku themelor i zhvillimit është pikërisht mirëqenia për njerëzit. Edhe pse matjet tradicionale ishin shumë të dobishme, ato kanë dështuar të zbulojnë përmbajtjen e të ardhurave, apo të përfituesve të vërtetë të rritjes ekonomike. Në disa raste popullsia mund të çmojnë më shumë kualitetin më të mirë të ushqimit dhe shërbimet e mira shëndetësore, qasjen më të mirë në shkollim, qasjen më të madhe në përgjegjësi dhe vendim marrje, jetën më të sigurt apo kushtet më të mira të jetës se sa të ardhurat absolute.

Politikat nacionale të zhvillimit nuk mund të mbështeten vetëm në gjenerimin e të ardhurave. Në diskursin zhvillimor, rritja duhet të jetë "mjet" dhe "cak" e jo vetëm cak në



vetvete. Qasja e zhvillimit të popullatës duhet të tërheqë vërejtjen në ndikimin që kanë politikat zhvillimore dhe si përkthehen ato në jetë më të mirë dhe përmirësim të mirëqenies. Tutje, gjatë viteve të fundit, kjo qasje ka rritur theksin në liritë themelore politike të njeriut, në mënyrë që të balancohet theksi i zhvillimit popullatës në zhvillim të drejtë social dhe ekonomik.

Kështu që matja e zhvillimit të popullatës edhe në hartimin e Planit Zhvillimor Komunal të Kamenicës ka marr parasysh: Indeksën e Zhvillimit Njerëzor (IZHNJ). Ky indeks është krijuar për të matur zhvillimin edhe me mjete të tjera përveç indekseve rritjes ekonomike siç janë Bruto Prodhimi Vjetor (GDP) por në të llogaritet edhe jetëgjatësia dhe arsimimi. Mjetet tjera statistikore për të matur zhvillimin që janë përdorur janë edhe Indeksi i Varfërisë Njerëzore dhe Indeksi i Zhvillimit Gjinerë por edhe ajë etnik.

Me Ligjin e Banimit do të krijohen dhe garantohen kushtet që subjektet që merren me administrimin e banesave, pronarët e banesave, qiramarrësit e banesave dhe shfrytëzuesit në përgjithësi të hyjnë në procedurë për realizimin e të drejtave dhe detyrimeve të tyre. Gjithashtu, ky ligj ka për qëllim nxitjen e një zhvillimi ekonomik, zgjidhjen e problemit të të pa strehëve, dhe përmirësimit të standardit dhe kushteve të banimit, për dallim nga ligji i aplikueshëm që është pengesë e drejtpërdrejtë e realizimit të koncepteve të reja për ekonominë e tregut , proceseve demokratike, dhe aplikimit të ndryshimeve rrënjësore që kanë ndodhur dhe po ndodhin në sistemin juridik dhe janë ndërtuar mbi bazën e Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Institucioneve të Përkohshme të Kosovës.

Kjo gjithashtu, nënkupton se e gjithë rregullativa për këtë veprimtari, është në përputhje dhe promovon legjislacionin e Unionit Evropian nga sfera e banimit.

Çështjet që trajton dhe rregullon ky ligj janë:

Themelimi i institucioneve përgjegjëse për banim

Raporti për banim (Raporti Qendror dhe Strategjia e Banimit)

Krijimi i fondit financiar për banim

Raportet pronësor-juridike në ndërtesat shumëkatëshe për banim

Administrimi i ndërtesave shumëkatëshe për banim

Raportet në mes të pronarëve dhe personave të tretë

Bashkësitë e pronarëve

Shfrytëzimi i banesave

Raportet e banesave qiramarrëse

Banesat joprofitabile me qira

Shpengimi (privatizimi i banesave)

Nxitja e ndërtimeve të reja

### **Orientimet (Politikat e Banimit)**

Zhvillimi i politikave të banimit duhet të jetë proces i vazhdueshëm dhe duhet të fokusohet në promovimin e banimit si tërësi e elementeve sociale, financiare dhe institucionale në procesin e sigurimit të banesës dhe nënkupton çështjen vendimtare për stabilitet social, shëndet dhe kualitet të jetesës.

Politikat e banimit janë të përqendruara në:

**Zhvillimin e Politikave Sociale**-nënkupton zhvillimin e një programi të qëndrueshëm për banim social, si dhe promovimin e banimit me qira joprofitabile

**Zhvillimin e Politikave mbi Financimin e Banimit**- nënkupton ngritjen e një sistemi financiar për banim që të mund të mbështesë politikat e banimit

**Zhvillimin e Politikave për Menaxhim dhe Mirëmbajtje** nënkupton ndërmarrjen e veprimeve për të krijuar një sistem të qëndrueshëm të mirëmbajtjes së banesave të privatizuara

**Zhvillimi i Politikave të Qirasë**-nënkupton nxitjen, promovimin dhe sigurimin e banimit me qira joprofitabile, në mënyrë institucionale Qëllimi kryesor i politikave të banimit është lëvizja drejt një strategjie të qëndrueshme të banimit në Kosovë.

## MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

### Udhëzimet Politike

Meqë banimi ka ndikim direkt në të gjitha aspektet themelore për zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të një vendi, patjetër se duhet të konsiderohet si prioritet i politikave të Qeverisë së Kosovës. Mirëpo, për një zhvillim më të drejtë, më efikas dhe të balancuar të banimit, patjetër se është më se i nevojshëm orientimi drejt zhvillimit të politikave të banimit nëpërmes :

Koordinimit dhe bashkëpunimit me të gjitha institucionet për hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe programeve për banim

Implementimit të obligimeve ligjore

Hartimit të politikave, strategjive dhe programeve për banim që synojnë përmirësimin e kushteve të banimit të zonave rurale-urbane si dhe integrimin shoqëror të shtresave të varfra.

### PRIORITETET STRATEGJIKE DHE ZONAT E VEPRIMIT

Në bazë të asaj çka u cek më lartë, si prioritete strategjike janë në:

#### Aspektin social:

Ulja e numrit të të pastrehëve

Ndërtimi i objekteve për banim social

Orientimin e ndihmës së qeverisë për familjet e pastreha

#### Aspektin Ligjor:

Implementimi i Ligjit për Banim dhe hartimi i akteve nënligjore

Hartimi i ligjeve dhe akteve nënligjore që kanë të bëjnë me fushën e banimit, duke u bazuar në legjislacionin evropian

#### Aspektin Institucional:

Hartimi i Raportit Qendror të Banimit

Hartimi i Raportit Lokal të Banimit

Krijimi i rrjetit-sektorëve funksional në mes të nivelit qendror dhe lokal,

Hartimi i Strategjive dhe Programeve Komunale për Banim, dhe harmonizimi i tyre me Strategjinë dhe Programet Qendrore

Trajnimet dhe ngritja profesionale e kuadrove, në nivelin qendror dhe lokal, për zhvillimin e projekteve në fushën e banimit.

### 3.1.5 Komponentat e IZHNNJ-së komunale


Indeksi komunal i zhvillimit njerëzor (IKZHNNJ) është përbërje e tri matjeve të ndryshme:

- Mirëqenia ekonomike, e matur nga të ardhurat për kokë banori;
- Statusi shëndetësor, i matur sipas jetëgjatësisë; dhe
- Arsimimi, matur sipas shkallës së regjistrimit në arsimim primar dhe sekondar, si dhe shkalla e shkrim-leximit e të rriturve (mbi 15 vjeç);

Bazuar në analizën e IKZHNNJ sipas komponentave Komuna e Kamenicës në mirëqenien ekonomike, e matur nga të ardhurat për kokë banori, renditet në mesin komunave me të ardhura mesatare për kokë banori në nivel të Kosovës.<sup>6</sup>

---

<sup>6</sup> Burimi i informative Raporti i Zhvillimit Njerëzor - Kosova 2004



Graf.23. Të ardhurat në (€) për kokë banori në vit (për disa komuna të Kosovës)

Në treguesin e parë parashikohet që të krijohen kushte me këtë plan është që mirëqenia ekonomike, e matur nga të ardhurat për kokë banori të rritet. Statusi shëndetësor, i matur sipas jetëgjatësisë në Komunën e Kamenicës është në mesataren e Kosovës dhe nën mesataren e disa shteteve të rajonit, ku në këtë drejtim parashikohen të bëhen përpjekje që ky tregues kompleks të shkojë drejt rritjes së jetëgjatësisë. Gjithashtu - Arsimimi, matur sipas shkallës së regjistrimi në arsimim primar të përmirësimit, sepse gjendemi në mesataren e Kosovës dhe më ulët se shtetet e rajonit.<sup>7</sup> Edhe në tre treguesit tjerë Indeksi i Varfërisë Njerëzore, Indeksi i Zhvillimit Gjinnor edhe ai etnik duhet planifikuar zhvillime dhe krijuar kushte për të ulur varfërinë e popullatës, ngritur punësimin, ofruar kushte për barazi gjinore dhe etnike në të gjithë treguesit e zhvillimit të popullsisë së komunës.

### Në nivelin vendbanimi

Ekipi komunal i planifikimit dhe ekipet tjera të angazhuara në hartimin e Planit Zhvillimor Komunal kanë analizuar edhe zhvillimet hapësinore të çdo vendbanimi duke marrë për bazë elementet në vijim:

- Dendësia e popullsisë
- Parashikimet dhe proceset demografike
- Sipërfaqet e ndërtuara ekzistuese
- Kategoria e tokave

<sup>7</sup> Burimi i informative Raporti i Zhvillimit Njerëzor - Kosova 2004  
Hulumtimet e Ekipit komunal të planifikimit

Dhe duke marrë parasysh gjendjen faktike në vendbanimet dhe implikimet që reflekton kjo gjendje është konstatuar se vendbanimeve në Komunën e Kamenicës duhet ofruar **Koncepti i urbanizimit kompakt**.

Synimi i këtij koncepti është që edhe nëpër fshatra zhvillimet të jenë të tilla që tentojnë shfrytëzim sa më racional të hapësirës përmes të dendësimit të ndërtimit dhe zhvillimeve brenda një hapësire të kufizuar e prezantuar përmes kufijve ndërtimor edhe të fshatrave.

Në të ardhmen e shpejt, procesi i transformimit dhe të pajisjes urbane të fshatrave dhe popullsisë fshatare do të vazhdojë edhe me intensitet të shtuar, Strukturat e territorit fshatar do të jenë gjithnjë e më të kompletuara. Ato do të jene veçanërisht të kompletuara afër qytetit të Kamenicës dhe në zonat e boshteve të zhvillimit të **shpejtë të Kamenicës, Rogaçicë, Hogosht, Strezoc** dhe disa nënqendra, siç janë **Koretini, Hodonoci, Muçivërci**, si në funksion të lidhjeve, shërbimeve, dendësimit dhe ushtrimit të funksioneve tjera plotësuese sociale , ekonomike e mjedisore .

Në fshatra synohet që të shtohet vazhdimisht popullsia e cila është e ndarë prej aktiviteteve që lidhen me punimin vetëm të tokës, në ato hapësira do të jetojë një numër i madh punëtorësh të cilët do të inkuadrohen në punë aty edhe në vende tjera. Koncepti i ardhshëm i urbanizimit në fshatra edhe më gjerë favorizon këto procese, Kjo kërkon drejtimin e aksioneve të planifikuara në përmirësimin e kushteve të jetesës në fshatra dhe në lidhjen e tyre më të volitshme në komunikacion dhe përfshirjen në të gjitha proceset e lëvizjeve socio-ekonomike.

Për zhvillimin modern të fshatit planifikohet që organizimin e brendshëm, madhësitë dhe strukturat hapësinore të fshatit, të cilat do t'iu përgjigjen kushteve të ekonomisë së tregut, prodhuese, mjedisore e sociale të jetesë. Sa i përket aspektit legal në gjendjen kur po hartojmë këtë dokument, fshati në komunë por edhe në nivel të Kosovës si njësi mbetet vetëm si element i sistemit por pa asnjë funksion qeverisës.

Rrjetën e fshatrave në territorin e Komunës së Kamenicës ekipet profesionale edhe palët tjera të interesit i kanë kategorizuar në këto grupe vendbanimesh. Grupin e parë e përbëjnë fshatrat rurale më elementare , grupin e dytë e përbëjnë vendbanimet si zona të interesit të veçantë për komunën, ku hynë vendbanimi i **Tugjec - Kapi dhe i Kikës** dhe të tretin e përbëjnë nën-qendrat ose qendrat sekondare brenda komunës si **Topanica, Hodonoci, Muçivërci, Karaçeva, Petroci, kurse Koretini, Rogaçica dhe Hogoshti** do trajtohen si vendbanime në grup të veçantë.

Procesi i urbanizimit do të përfshijë, më tepër se gjer më tani territoret fshatare e për këtë shkak, orientimi i këtij procesi në fshatra është detyrë tepër me rëndësi e planeve në tërësi . Shkalla e urbanizimit në pajtim me konceptin e urbanizimit kompakt në zhvillimin e mëtejshëm të këtij territori, duhet të rritet, në mënyrë të konsiderueshme. Niveli i urbanizimit i shprehur me pjesëmarrjen e popullsisë në vendbanimet urbane dhe gjysmë - urbane në popullsinë e përgjithshme të Kamenicës duhet të shumëfishohet gjer në vitin 2022.

Për organizimin hapësinor të fshatrave dhe të territorit rural në Komunën e Kamenicës, pos pozitës gjeografike, ka shumë rëndësi tipi i vendbanimit dhe dispersioni i vendbanimeve. Çdo tip vendbanimi kërkon trajtim të ndryshëm në organizimin e hapësirës. Kushtet e aktiviteteve ekonomike, organizimi i aktiviteteve ekonomike, futja e elementeve urbane dhe mënyrës së jetesës, duhet përshtatur pozitës, madhësisë dhe tipit të vendbanimit.

Rregullimi i fshatrave dhe i territoreve të gjera rurale është bazuar në:

- a) Kufijtë e planifikuar ndërtimor të çdo vendbanimi
- b) Zhvillimin e organizimin e prodhimit bujqësor brenda zonës kadastrale të vendbanimit por edhe zonës ndërtimore në zonat e ashtuquajtura zemra e gjelbër (agroekosistemi)
- c) zgjerimin e përmbajtjeve të industrisë në ato vendbanime të cilat kanë levërdi për këtë;
- d) zhvillimin, ndërtimin dhe renditjen si duhet të veprimtarive shërbyese;
- e) orientimin hapësinor të zgjerimit territorial me specifikim edhe të disa zonave të mundshme për zgjerim dhe në ndërtimin modern të objekteve të banimit dhe objekteve tjera.
- f) Me këtë koncept me rastin e ndërtimit të shtëpive e lokaliteteve, do të merren pëlqime, leje dhe do të respektohen më tepër norma e specifika urbane,


Organizimi hapësinor racional dhe pajisja e hapësirës kërkojnë hartimin e planeve përkatëse (bazës) për të gjitha vendbanimet prioritare dhe territoret me një zhvillim më intensiv. Planet rregulluese do të përgatiten për vendbanimet si zona të interesit të veçantë për komunën ku hynë vendbanimi i

**Tugjecit dhe Kika** për nën - qendrat ose qendrat sekondare brenda komunës si **Topanica, Hodonoci, Muçivërci, Karaçeva, Petroci, pra edhe Koretini, Rogaçica e Hogoshti** në kuadër të së cilës mund edhe të avancohen nevojat e çdo vendbanimi gravitues si tërësi në atë nën – qendër në krahasim me këto të parapara me këtë plan . Shpërndarja hapësinore dhe organizimi i banimit në vendbanimet dhe qytet në të ardhmen do të bëhet konform këtyre koncepteve dhe në përputhje me shpërndarjen e popullsisë dhe infrastrukturës mbështetur në parimin bazë për **banim të shëndetshëm** (ngritjen e kushteve për banim të shëndetshëm dhe atraktiv në zonat urbane dhe në zonat fshatare), **për të gjitha shtresat , me mundësi dhe zgjedhje më të mëdha banimi, zvogëlojnë varësinë nga veturat dhe krijojnë modele të qëndrueshme banimi .**

Këto koncepte na mundësojnë shfrytëzim racional të tokës, rritje të dendësisë së banimit , e cila do të arrihet edhe me shfrytëzimin racional të zbrazëtirave brenda zonave të ndërtuara, kjo do të ndikonte në zhvillimin të infrastrukturës, uljen e kostos për investime në infrastrukturë, si dhe qasjen më të lehtë të banorëve në këtë sistem, ndërsa në anën tjetër do të zvogëlon rrezën e shërbimeve tjera si: shkolla, institucione shëndetësore, administratë etj. vetëm zhvillimi kompaktë i paraparë për vendbanime do të kursejë tokën nga ndërtimet e pa kontrolluara, ndërsa në këtë kontekst vendbanimet shndërrohen në zona funksionale, ku duhet vepruar në konsolidimin e infrastrukturës ekzistuese dhe ndërtimin e asaj që mungon

Sipas parashikimeve demografike, nuk ka nevojë për zgjerimin e sipërfaqes së planifikuar për ndërtim në vendbanime për një kohë të gjatë pasi që në shumicën e vendbanimeve duke filluar nga qyteti i Kamenicës mund të shfrytëzohen sipërfaqet e zbrazëta brenda zonës së planifikuar për ndërtim e cila do plotësohet me përmbajtje në funksion edhe në kompletimi të cilësisë së banimit (infrastrukturë, hapësira publike, parqe, hapësira për sport, rekreacion etj.). Në disa fshatra me strukturë të shpërndarë (kryesisht fshatrat kodrinore malore), është vështirë të arrihet ndonjë dendësim edhe se në këto fshatra siç janë **Kranidelli, Poliçka, Desivojca, Lisocka, Shahiqi, Zhuja, Gjyrisheci, Gmica, Tugjeci, Svirca**, edhe disa tjera pasi që në këto vendbanime ka një shkallë të konsideruar të migrimeve, duhet planifikuar projekte zhvillimore në fushat e bujqësisë, turizmit etj. dhe fillimisht të rikthehet gjallëria e viteve të mëparshme dhe të fuqizohet për sa është e mundur në këto vendbanime dhe ma vonë edhe të kemi zhvillim sa ma kompakt dhe cilësi banimi.

## VENDBANIMET NË KOMUNËN E KAMENICËS



Harta. 34. Vendbanimet në Komunën e Kamenicës

## Fshati Berivojcë

### Profili i vendbanimit

Shtrihet 1 km në jug të Kamenicës, është vendbanim fushor i grumbulluar. Ka sipërfaqe 811.5 ha. Në të ka gjurmë të vendbanimit të vjetër Kisha e Shën Gjonit, shek. XIV-XVI, nr. V.E.K.02-338/63 Berivojcë(I – 244). Duhet të jetë një kishë e vjetër shqiptare e besimit të krishterë, në të cilën më vonë e kanë përvetësuar serbët.

Numri i banorëve (jo shënime zyrtare por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Berivojca ka pasur **1444 gjithsej**.

### Regjistrimi i popullsisë, i ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011

ka dhënë këto shifra: 355 ndërtesa, 367 banesa, 92 banesa të pa banuara, 301 ekonomi familjare: ndërkaq përbërja e banorëve është: 798 janë të gjinisë mashkullore, 757 të asj femërore dhe gjithsej 1555 banorë.

### Tipologjia

Shtrirja e fshatit Berivojcë është e tipit shpërndarës, dhe në mes të fshatit kalon Lumi “Kriva Reka”. Fshati ka një rrjet hidrografik, i cili i takon pellgut të Detit të Zi. Kohëve të fundit ka tentime të shtrirjes lineare, përgjatë rrugëve, shërbimet janë në qendër të fshatit (shkolla, ambulanca). Berivojca është vendbanim i tipit individual, e cila ka funksion agrar dhe tregtar shumë funksional. Ky vendbanimi shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve, banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, arsimimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. Të gjithë banorët e fshatit për ngrohje e shfrytëzojnë drurin. Uji i pijes shfrytëzohet nga sistemi i ujësjellësit, ku gjithashtu ekziston edhe sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza i pa trajtuar në aspektin ekologjik. Ujërat e zeza derdhen në Lumin “Kriva Reka” pa u trajtuar.

70% e shtëpive në fshatin Berivojcë janë të ndërtuara me material të fortë. Në këtë fshat nuk ka objekte me rëndësi arkitektonike apo me ndonjë rëndësi të veçantë.

**Pasuritë natyrore** të këtij fshati janë: toka pyjore, kullosat, zhavorri.

Në të zhvillohen këto veprimtari: bujqësia, zejtaria dhe tregtia.

### Problemet momentale

Si probleme kryesore e më të theksuara, janë mostrajtimi i ujërave të zeza, mungesa e grumbullimit të mbeturinave në disa lagje (deponitë e egra), rrugët e pa asfaltuara në disa lagje.

### Kufiri momental ndërtimor

Fshati Berivojcë është vendbanim i tipit shpërndarës, zhvillimet janë krejtësisht lineare përgjatë rrugës kryesore të fshatit. Shërbimet janë në periferi të fshatit.




Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Berivojcës

### Kufiri ndërtimor i propozuar

Për shkak të ruajtjes së tokës bujqësore me bonitet mesatarisht të mirë, kullosave dhe kompaktësimit të fshatit jemi të detyruar që të vejmë kufijtë e ndërtimeve, ndërkaq në disa pjesë jemi detyruar që t'i ndalojmë ndërtimet.




Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Berivojcë.

### Zhvillimet kryesore

Si zhvillime kryesor në këtë fshat janë: hapja dhe shtruarja e rrugës Berivojcë – Dajakoc, rrugët anësore me qytetin e Kamenicës, zgjerimi i rrugëve të fshatit, rregullimi i ndriçimit publik, shtruarja e trotuareve të rrugëve, asfaltimi i rrugëve brenda fshatit, ndërtimi fushave sportive, hapësirave për rekreacion, trajtimi i ujërave të zeza, grumbullimi i mbeturinave, rregullimin i shtratit të Lumit “Krija Reka”, si dhe përroit që kalon nëpër fshat, shtrimi i rrugëve bujqësore dhe pyjore, pyllëzimi i disa sipërfaqeve, turizmi i gjuetisë, zhvillimi i blegtorisë dhe projekteve të veçanta për eksplorimin e zonave arkeologjike.



## Fshati Bllatë

### Profili i vendbanimit

Ndodhet rreth 7 km në juglindje të Kamenicës, ka sipërfaqe 118.5 ha.

Numri i banorëve ( jo shënime zyrtare por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Bllata ka pasur gjithsej **37 banorë**.

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 na jep këto shifra: 11 ndërtesa, 11 banesa, 5 banesa të pa babuara, 6 ekonomi familjare; ndërsa popullata ka këtë përbërje: 22 banorë të gjinisë mashkullore, 13 të asaj femërore dhe gjithsej **35 banorë**.

### Tipologjia

Shtrirja e fshatit Bllatë është e tipit të shpërndarë, në disa raste ndërtimet janë të përqendruara përgjatë rrugës Topanicë-Dajkoc, kurse shërbimet i mungojnë këtij vendbanimi. Fshati Bllatë, është vendbanim i tipit individual.

Bllata ka funksion agrar njëfunksional, ku ky vendbanim shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, arsimimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. I gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes 100% shfrytëzohet nga pusët. Në këtë fshat nuk ekziston sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza.

Shtëpitë në fshatin Bllatë janë të ndërtuara me materiale klasike. Popullsia në këtë fshat është shpërngulur në mënyrë masive, ku për një periudhë kohore 24 vjeçare është zvogëluar aq shumë sa që kanë mbetur shumë pakë njerëz. Drejtimet e migrimit të popullsisë janë të brendshme dhe të jashtme. Një numër i kësaj popullate ka imigruar në qendrën lokale të kësaj komune (Kamenicë), kurse një numër i konsiderueshëm është shpërngulur në qytetet tjera të Kosovës, sidomos në Gjilan dhe Prishtinë. Në këtë fshat nuk ka objekte me rëndësi arkitektonike apo me ndonjë rëndësi të veçantë.

**Pasuritë natyrore** të këtij fshati- ndërrimi i mergeleve dhe ranorëve si dhe zhdukja graduale e këtyre të fundit, tregon kalimin nga pjesa e mesme në të sipërmen të serisë terciare, që më së miri shihet mes Topanicës dhe Bllatës së vjetër. Shtrirja gjenerale e serisë mergelore është kah V.P. në disa zona me drejtim të shtrirjes kah JP, JL dhe VL. Mergelet ndërtojnë zonën në drejtim VL dhe JP me gjerësi mesatare prej 3-3,5 km. Kjo është në të vërtetë zona në mes të Karaçevës së Epërme dhe Breznicës në VL, si dhe Topanicës e Domarocit në JP. Në mes të Karaçevës së Poshtme – Epërme dhe Rogaçicës, mergelet shtrihen mbi pjesën bazale të serisë terciare me të cilën ndërtohet sinklinalja. M.Pavloviqi në mergele ka gjetur faunën “OSTRAKODA”, në mes të Topanicës dhe Bllatës.

Bllata ka një peizazh mjaft atraktiv dhe është po aq i përshtatshëm për ndërtime, sepse këtë ia mundëson kontura e terrenit.

Në Bllatë zhvillohen këto veprimtari: bujqësia dhe blegëtoria

### Problemet momentale

Si probleme kryesore e më të theksuara në të janë: shkollimi, mjekësia familjare, trajtimi i ujërave të zeza, sistemi i ujësjellësit mungesa e grumbullimit të mbeturinave – deponitë e egra, rrugët e pa asfaltuara që e lidhin Bllatën me Topanicën dhe me fshatin Dajkoc, ngrohja qendrore etj.

## Kufiri momental ndërtimor

Fshati Bllatë është vendbanim i tipit shpërndarës.



**Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Bllatës**

## Kufiri ndërtimor i propozuar

Për shkak të ruajtjes së tokës bujqësore dhe kompaktësimit të fshatit, jemi të detyruar që t'i vejmë kufijtë e ndërtimeve për shkak të ruajtjes së tokës bujqësore për zhvillimin e kulturave intenzive bujqësore dhe si burim ekonomik për qytetarët në të ardhmen.



**Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Bllatë**

## Zhvillimet kryesore

Si zhvillime kryesore që i ndihmon ekonomisë dhe qarkullimit të mallrave në këtë fshat është: hapja dhe shtruarja e rrugës Bllatë-Topanicë, Bllatë-Dajkoc. Kjo rrugë bën lidhjen e këtyre fshatrave dhe mundëson zhvillimin e aktiviteteve ekonomike, kulturore, futja e ujërave të zeza në sistem të trajtimit, sigurimi i ujit të pijes përmes shpuarjeve dhe shfrytëzimit të burimeve ekzistuese, qendra e mjekësisë familjare, ndërtimi i fushave sportive (të futbollit), ndërtimi i shkollës në fshatin Bllatë, projekte të veçanta për eksplorimin e zonave arkeologjike.

## Fshati Huboc

### Profili i vendbanimit

Shtrihet 2-3 km në verilindje të Kamenicës ka sipërfaqe prej 442 hektarë. Emërtimi i variantit sllav Bosce, ka mbetur si pasojë e moskujdesit të komisionit përkatës nga kuvendi komunal, megjithëse të gjithë shqipfolësit i thonë Huboc.

Numri i banorëve (jo shënime zyrtare por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Huboci ka pasur gjithsej **243** banorë.

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 janë: 67 ndërtesa, 71 banesa, 42 banesa të pa banuara, 29 ekonomi familjare, 44 të gjinisë mashkullore, 42 është numri i gjinisë femërore, ndërkaq janë **86** banorë.

### Tipologjia

Shtrirja e fshatit Huboc, është e tipit me shtrirje të shpërndarë. Është vendbanim i tipit individual. Huboci ka funksion agrar njëfunksional. Ky vendbanim shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, arsimimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. I gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes shfrytëzohet nga pusët. Sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza dhe atyre atmosferike mungon në tërësi, ujërat e zeza derdhen në lumin e Hubocit.

Shtëpitë në fshatin Huboc janë të ndërtuara me materiale klasike. Në këtë fshat nuk ka objekte me rëndësi arkitektonike apo me ndonjë rëndësi të veçantë.

**Pasuritë natyrore** të këtij fshati janë: shkëmbinj gëlqeror, Lumi "Huboc", i cili ka burimin dhe kalon përmes këtij fshati. Huboci ka një peizazh mjaft atraktiv, i cili është mjaft i përshtatshëm për ndërtime sepse këtë ia mundëson relievi i terrenit.

Në Huboc zhvillohet kjo veprimtari: bujqësia.

### Problemet momentale

Si probleme kryesore e më të theksuara në fshatin Huboc janë: mungesa e kanalizimit (trajtimi i ujërave të zeza), mungesa e grumbullimit të mbeturinave, deponitë e egra, rrugët e pa asfaltuara në disa lagje, ngrohëtorja qendrore, etj

### Kufiri momental ndërtimor

Fshati Huboc është vendbanim i tipit shpërndarës dhe ka zhvillim linear të pa kontrolluar.



Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Hubocit

### Kufiri ndërtimor i propozuar

Për shkak të ruajtjes së tokës bujqësore jemi të detyruar që t'i vejmë kufijtë e ndërtimeve, si dhe janë dhënë mundësitë e zgjerimit të kufijve ndërtimor.



Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Huboc

### Zhvillimet kryesore

Si zhvillime kryesore që i ndihmojnë zhvillimit ekonomik të këtij fshati janë: rregullimi i shtratit të Lumit “Huboc”, futja e ujërave të zeza në sistem të kanalizimit, qendra e mjekësisë familiare, ndërtimi i fushave sportive (futbollit), asfaltimi i rrugeve nëpër fshat.

## Fshati Bratilloç

### Profili i vendbanimit

Shtrihet rreth 17 km në verilindje të Kamenicës, është fshat i tipit me shtrirje të shpërndarë, ka sipërfaqe 435 ha, numri i banorëve ( jo shënime zyrtare por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Bratilloçi ka pasur gjithsej **14** banorë.

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 jep këto të dhëna statistikore: 22 ndërtesa, 22 banesa, 12 banesa të pa banuara, 6 ekonomi familjare: ndërsa sipas gjinisë i ka 17 banorë të gjinisë mashkullore, 14 të asaj femërore dhe gjithsej **31 banorë**.

### Tipologjia

Shtrirja e fshatit Bratilloç është e tipit të shpërndarë. Është vendbanim i tipit individual.

Bratilloçi ka funksion agrar shumë funksional, i cili shtrihet rrëzë maleve. Ky vendbanimi shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve, si: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. I gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes shfrytëzohet nga puset, sistemi i ujësjellësit nuk ekziston, po ashtu nuk ekziston edhe sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza.

Shtëpitë në fshatin Bratilloç janë të ndërtuara me material klasik. Në këtë fshat nuk ka objekte me rëndësi arkitektonike apo me ndonjë rëndësi të veçantë.

**Pasuri natyrore** të këtij fshati janë: shkëmbinjtë gëlqeror.

Në të zhvillohen këto veprimtari: bujqësia dhe blegtoria.

### Problemet momentale

Si probleme kryesore e më të theksuara në fshatin Bratilloç janë: arsimimi, qendra e mjekësisë familjare, sistemi i ujësjellësit, mungesa e grumbullimit të mbeturinave , deponitë e egra, rrugët e pa asfaltuara.

### Kufiri momental ndërtimor

Fshati Bratilloç është vendbanim i tipit shpërndarës.



Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Bratilloçit

### Kufiri ndërtimor i propozuar

Për shkak të ruajtjes së tokës bujqësore të fshatit jemi të detyruar, që t'i vejmë kufijtë ndërtimor.



Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Bratilloç

### Zhvillimet kryesore

Si zhvillime kryesore që i ndihmojnë ekonomisë dhe qarkullimit të mallrave në këtë fshat është: zgjerimi i rrugëve, asfaltimi i rrugës, ndërtimi i ujësjellësit, shtrimi i rrugëve bujqësore, ndërtimi i objektit shkollor, fushave sportive (futbollit, volejboll, hendboll etj.).

## Fshati Busavatë

### Profili i vendbanimit

Ndodhet rreth 5 km., në jugperendim të Kamenicës. Ka sipërfaqe 1065 ha. Në këtë fshat gjendet një shpellë, kisha e vjetër, manastiri e që në të ka mbishkrime ilire te guri, aty ku ndodhen varrezat e vjetra ilire.

Në këtë fshat ka kaluar rruga e vjetër që ka lidhur Novo Bërdën, Kamenicën, Bujanocin e Vranjën. Ka kaluar rruga Kamenicë, Busavatë, Përlepticë, Gjilan. Në bazë të disa materialeve arkeologjike të gjetura në një shpellë, dëshmohet se ky fshat daton që nga koha e paleolitit. Ekziston kalaja e cila daton që nga shekulli II, themelet e një kishe, një shpellë, varre etj.

Numri i banorëve (jo shënime zyrtare por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Busavata ka pasur gjithsej **1145** banorë.

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 jep këto shifra a numra: 148 ndërtesa, 148 banesa, 27 banesa të pa banuara, 121 ekonomi familjare; 448 banorë të gjinisë mashkullore, 370 banorë të gjinisë femërore dhe gjithsej **818 banorë**.

### Tipologjia

Shtrirja e fshatit Busavatë është e tipit shpërndarës. Shërbimet janë në periferi të fshatit (shkolla, xhamia, etj). Është vendbanim i tipit individual.

Busavata ka funksion agrar një funksional. Ky vendbanim shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, arsimimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. I gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes shfrytëzohet nga pusët. Sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza dhe atyre atmosferike mungon në tërësi.

**Pasuritë natyrore** të këtij fshati janë: linjiti, shkëmbinjtë e mermertë, andeziti, nikeli, plumbi, argjendi.

**Flora dhe Fauna** –Ekziston një florë dhe faunë shumë e begatshme, si p.sh. flora karakterizohet me numër të madh të bimëve si, të atyre të larta drusore gjethërenëse siç janë: ahu, bungu, qarri, blini, akacia, shkoza, frashëri etj. Po ashtu, pothuajse të gjitha pemët frutore të grupit faror, grupit bërthamor, arror si dhe të atyre manore - dredhëza, manaferra, mjedra etj. Gjithashtu, është mjaft e pasur me bimë barishtore të lloj-llojshme, të gjitha llojet e drithërave (gruri, tërshëra, elbi, misri etj.); Nga shtazët e egra takojmë: derrin, dhelpren, ujkun, lepurin etj. prej shpezëve të egra: pula e egër, thëllëza, skiftëri, huti etj. Po ashtu, ka edhe zvarranikë si gjarpërinj, bolla etj. Bimë foragjere (jonxhe, tërfili i kuq, telishi etj.) Sa i përket faunës, po ashtu është e pasur si me kafshë të egra ashtu edhe me kafshë të tjera, pra është një potencial i mirë për gjueti.

45% e Shtëpive në fshatin Busavatë janë të ndërtuara me material të fortë. Në këtë fshat nuk ka objekte me rëndësi arkitektonike, apo me ndonjë rëndësi të veçantë. Busavata ka një peizazh mjaft atraktiv dhe është mjaft i përshtatshëm për ndërtime, sepse këtë ia mundëson kontura e terrenit.

Në Busavatë zhvillohen këto veprimtari: bujqësia dhe tregëtia.

### Problemet momentale

Si probleme kryesore dhe më të theksuara në fshatin Busavatë janë: mungesa e kanalizimit (trajtimi i ujërave të zeza), mungesa e ujësjellësit, mungesa e grumbullimit të mbeturinave, deponitë e egra, rrugët e pa asfaltuara në disa lagje, ngrohtorja qendrore, etj.

### Kufiri momental ndërtimor

Fshati Busavatë është vendbanim i tipit shpërndarës me elemente të zhvillimit linear, ndërtime të pa kontrolluara.




Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Busavatës

### Kufiri ndërtimor i propozuar

Për shkak të ruajtjes së kompaktësisë së vendbanimit dhe ruajtjes së tokës bujqësore jemi të detyruar, që t'i vejmë kufijtë ndërtimor.




Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Busavatë

### Zhvillimet kryesore

Si zhvillime kryesore që i ndihmojnë zhvillimit ekonomik të këtij fshati janë: rregullimi i shtratit të përroskës së fshatit, futja e ujërave të zeza në sistem të kanalizimit nëpër të gjitha lagjet, ndërtimi i fushave sportive, ofrim i infrastrukturës për zhvillim të turizmit malor, projekte të veçanta për eksplorimin e zonave arkeologjike.



## Fshati Dajkoc

### Profili i vendbanimit

Shtrihet rreth 17 km në Juglindje të Kamenicës, është fshat i tipit me shtrirje të shpërndarë, ka sipërfaqe 313 ha. Numri i banorëve ( jo shënime zyrtare por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Dajkoci ka pasur, gjithsej **499 (banorë)**.

Regjistrimi i popullsisë ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 KA dhënë këta numra a shifra: 84 ndërtesa, 86 banesa, 16 banesa të pa banuara, 70 ekonomi familjare, 188 banorë të gjinisë mashkullore, 190 banore të gjinisë femërore, si dhe gjithsej **378 banorë**.

### Tipologjia

Shtrirja e fshatit Dajkoc është e tipit shpërndarës. Shërbimet janë në periferi të fshatit (shkolla, xhamia, etj). Dajkoci është vendbanim i tipit individual. Popullsia në këtë fshatë është shpërngulur në mënyrë masive, ku për një periudhë kohore 24 vjeçare është zvogëluar aq shumë sa që, kanë mbetur shumë pak. Drejtimet e migrimit të popullsisë janë të brendshme dhe të jashtme. Një numër i kësaj popullate ka imigruar në qendrën lokale të kësaj komune (Kamenicë), por një numër i konsiderueshëm ka migruar në qytetet tjera të Kosovës, sidomos në Gjilan dhe Prishtinë.

Dajkoci ka funksion agrar një funksional. Ky vendbanim shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, arsimimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. I gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes shfrytëzohet nga pusët. Sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza dhe atyre atmosferike mungon në tërësi, ujërat e zeza derdhen pa kurrfarë trajtimi në rrjedhën e lumit të Hogoshtit.

Shtëpitë në fshatin Dajkoc, janë të ndërtuara me material të fortë. Në këtë fshat nuk ka objekte me rëndësi arkitektonike apo me ndonjë rëndësi të veçantë.

**Pasuritë natyrore të këtij fshati janë:** tufi, zhavorri.

Dajkoci ka një peizazh mjaft atraktiv dhe është mjaft i përshtatshëm për ndërtime, pasi që këtë ia mundëson relievi i terrenit.

Në të zhvillohen këto veprimtari: bujqësia, blegtoria, pemëtaria.

### Problemet momentale

Si probleme kryesore në fshatin Dajkoc dhe më të theksuara janë: mungesa e kanalizimit pjesërisht (trajtimi i ujërave të zeza), mungesa e ujësjellësit, mungesa e grumbullimit të mbeturinave, deponitë e egra, rrugët e pa asfaltuara në disa lagje, ngrohtorja qendrore, etj.

### Kufiri momental ndërtimor

Fshati Dajkoc është vendbanim i tipit të shpërndarë me elemente të zhvillimit linear, ndërtime të pa kontrolluara.



Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Dajkocit

### Kufiri ndërtimor i propozuar

Për shkak të ruajtjes së kompaktësisë së vendbanimit dhe ruajtjes së tokës bujqësore jemi të detyruar që t'i vejmë kufijtë e ndërtimeve të pa kontrolluara.



Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Dajkoc

### Zhvillimet kryesore

Si zhvillime kryesore që i ndihmojnë zhvillimit ekonomik të këtij fshati është: rregullimi i infrastrukturës rrugore, mjedisore, futja e ujërave të zeza në sistem të kanalizimit nëpër të gjitha lagjet, qendra e mjekësisë familjare, projekte të veçanta për eksplorimin e zonave arkeologjike.

## Fshati Dazhnicë

### Profili i vendbanimit

Shtrihet rreth 13 km në verilindje të Kamenicës, është fshat i tipit kodrinoro malor me shtrirje të shpërndarë , ka sipërfaqe 414 ha, numri i banorëve ( jo shënime zyrtare por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Dazhnica ka pasur gjithsej **103 (banorë)**.

Regjistrimi i popullsisë ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 ka dhënë këta numra a shifra: 41 ndërtesa, 41 banesa, 30 banesa të pa banuara, 11 ekonomi familjare, 32 banorë të gjinisë mashkullore, 29 të asaj femërore, si dhe gjithsej **61 banorë**.

### Tipologjia

Shtrirja e fshatit Dazhnicë është e tipit të shpërndarë, shërbimet janë në qendër të fshatit (shkolla, tyrbja). Dazhnica është vendbanim i tipit individual. Popullsia në këtë fshat, është shpërngulur në mënyrë masive, ku për një periudhë kohore 24 vjeçare është zvogëluar aq shumë, sa që kanë mbetur shumë pak. Drejtimet e migrimit të popullsisë janë të brendshme dhe të jashtme. Një numër i kësaj popullate ka migruar në qendrën lokale të kësaj komune (Kamenicë), por një numër i konsiderueshëm ka migruar në qytetet tjera të Kosovës, sidomos në Gjilan dhe Prishtinë.

Ky vendbanim shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve, si: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, arsimimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. I gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes shfrytëzohet nga burimet natyrore (krojet), sistemi i ujësjellësit nuk ekziston, po ashtu nuk ekziston edhe sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza.

**Pasuritë natyrore të këtij fshati janë:** klori, shkëmbinj graniti.

Shtëpitë në fshatin Dazhnicë janë të ndërtuara me material klasik. Në këtë fshat ka objekte me rëndësi arkitektonike (Tyrbja e Dazhnicës).

**Flora dhe Fauna** –Ekziston një florë dhe faunë shumë e begatshme , si p.sh. flora karakterizohet me numër të madh të bimëve si të atyre të larta drusore gjethërenëse, si: ahu, bungu , qarri, blini, akacia, shkoza, frashëri etj. Po ashtu, pothuajse të gjitha pemët frutore të grupit faror, grupit bërthamor, arror si dhe të atyre manore - dredhëza, manaferra,mjedra etj. Gjithashtu, është mjaft e pasur me bimë barishtore të lloj-llojshme, të gjitha llojet e drithërave ( gruri, tërshëra, elbi, misri etj.); Nga shtazët e egra takojmë : derri,dhelpra,ujku, lepuri etj. Prej shpezëve të egra : pula e egër , thëllëza, skiftëri, huti etj. Po ashtu, ka edhe zvarranikë si gjarpërinj, bolla etj. Në të ka edhe bimë foragjere ( jonxhe , tërfili i kuq, telishi etj.) Sa i përket faunës, po ashtu është e pasur si me kafshë të egra dhe me kafshë të tjera, pra është një potencial i mirë për gjueti.

### Problemet momentale

Si probleme kryesore në fshatin Dazhnicë dhe më të theksuara janë: trajtimi i ujërave të zeza, mungesa e ujësjellësit, mungesa e grumbullimit të mbeturinave , deponitë e egra, rrugët e pa asfaltuara.

## Kufiri momental ndërtimor

Fshati Dazhnicë është vendbanim i tipit të shpërndarë.




Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Dazhnicës

## Kufiri ndërtimor i propozuar

Për shkak të ruajtjes së tokës bujqësore, kullosave dhe kompaktësimit të fshatit jemi të detyruar që t'i vejmë kufijtë e ndërtimeve.



Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Dazhnicë

## Zhvillimet kryesore

Si zhvillime kryesore që i ndihmojnë ekonomisë dhe çarkullimit të mallrave në këtë fshat janë: zgjerimi i rrugëve të fshatit, rregullimi i ndriçimit publik, shtruarja e trotuareve të rrugës, asfaltimi i rrugëve brenda fshatit, ndërtimi i ujësjellësit, kanalizimi, shtrimi i rrugëve bujqësore, rruga Hogosht – Dazhnicë, Dazhnicë – Magurë – Kostadincë – Feriqevë ndërtimi i fushave sportive, projekte të veçanta për eksplorimin e zonave arkeologjike.

## Fshati Desivojcë

### Profili i vendbanimit

Shtrihet rreth 35 km në verilindje të Kamenicës, është fshat i tipit kodrinoro malor me shtrirje të shpërndarë, ka sipërfaqe 1614 ha. Numri i banorëve (jo shënime zyrtare, por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Desivojca ka pasur gjithsej **625 (banorë)**.

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 ka dhënë këta numra a shifra: 58 ndërtesa, 61 banesa, 29 banesa të pa banuara, 32 ekonomi familjare, 88 banorë të gjinisë mashkullore, 89 të asaj femërore, si dhe gjithesej **177 banorë**.

### Tipologjia

Shtrirja e fshatit Desivojcë është e tipit të shpërndarë, shërbimet janë në qendër të fshatit (shkolla, qendra e mjekësisë familjare, xhamia). Desivojca është vendbanim i tipit individual. Popullsia në këtë fshat është shpërngulur në mënyrë masive, ku për një periudhë kohore 24 vjeçare është zvogëluar aq shumë, sa që kanë mbetur shumë pak. Drejtimet e migrimit të popullsisë janë të brendshme dhe të jashtme. Një numër i kësaj popullate ka imigruar në qendrën lokale të kësaj komune (Kamenicë), por një numër i konsiderueshëm ka migruar në qytetet tjera të Kosovës, sidomos në Gjilan dhe Prishtinë.

Ky vendbanim shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, arsimimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. I gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes shfrytëzohet nga burimet natyrore (krojet), sistemi i ujësjellësit nuk ekziston, po ashtu nuk ekziston edhe sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza.

**Pasuritë natyrore të këtij fshati janë:** shkëmbinj graniti, shkëmbinj gnais.

Shtëpitë në fshatin Desivojcë janë të ndërtuara me material klasik.

**Flora dhe Fauna** –Ekziston një florë dhe faunë shumë e begatshme , kështu flora karakterizohet me numër të madh të bimëve të llojllojshme, të atyre të larta drusore gjethërenëse, si.: ahu, bungu , qarri, blini, akacia, shkoza, frashëri etj. Po ashtu pothuajse, të gjitha pemët frutore të grupit faror, grupit bërthamor, arror si dhe të atyre manore - dredhëza, manaferra, mjedra etj. Gjithashtu, është mjaft e pasur me bimë barishtore të lloj-llojshme, të gjitha llojet e drithërave ( gruri, tërshëra, elbi, misri etj.); Nga shtazët e egra takojmë : derrin,dhëlpren,ujkun, lepurin etj. Prej shpezëve të egra : pula e egër , thëllëza, skiftërëi, huti etj. Po ashtu, ka edhe zvarranikë si gjarpërinj, bolla etj. Bimë foragjere ( jongja ,tërfili i kuq, telishi etj.) Sa i përket faunës , po ashtu është e pasur si me kafshë të egra si dhe kafshë të tjera, pra kemi një potencial të mirë për gjueti.

### Problemet momentale

Si probleme kryesore në fshatin Desivojcë dhe më të theksuara janë: trajtimi i ujërave të zeza, mungesa e ujësjellësit, mungesa e grumbullimit të mbeturinave , deponitë e egra, rrugët e pa asfaltuara.

## Kufiri momental ndërtimor

Fshati Desivojcë është vendbanim i tipit të shpërndarë.



**Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Desivojcës**

## Kufiri ndërtimor i propozuar

Për shkak të ruajtjes së tokës bujqësore, kullosave dhe kompaktësimit të fshatit jemi të detyruar që t'i vejmë kufijtë e ndërtimeve.



**Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Desivojcë**

## Zhvillimet kryesore

Si zhvillime kryesore që i ndihmojnë ekonomisë dhe qarkullimit të mallrave në këtë fshat janë: zgjerimi i rrugëve të fshatit, rregullimi i ndriçimit publik, shtruarja e trotuareve të rrugës, asfaltimi i rrugëve brenda fshatit, ndërtimi i ujësjellësit, kanalizimi, shtrimi i rrugëve bujqësore, rruga Desivojcë – Poličkë- Hogosht – Kamenicë, ndërtimi i fushave sportive, projekte të veçanta për përpunimin e drurit.

## Fshati Feriqevë

### Profili i vendbanimit

Shtrihet rreth 7 km. në veri të Kamenicës. Shtrirja e fshatit është e tipit të shpërndarë, vendbanim kodrinoro-malor dhe që ka sipërfaqja 636 ha. Është vendbanim i vjetër ilir, ku dëshmohet me një kishë të vjetër e quajtur “Kisha Thyme” e periudhës së sundimit Romak (kishë ilire).

Numri i banorëve (jo shënime zyrtare, por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Feriqeva ka pasur gjithsej **213 (banorë)**.

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 na jep këta numra a shifra: 41 ndërtesa, 41 banesa, 30 banesa të pa banuara, 16 ekonomi familjare, ndërkaq sipas gjinisë 32 meshkuj, 29 femra, si dhe gjithsej **61 banorë**.

### Tipologjia

Shtrirja e fshatit Feriqevë është e tipit shpërndarës. Shërbimet janë në periferi të fshatit (shkolla). Feriqeva është vendbanim i tipit individual.

Popullsia në këtë fshat, është shpërngulur në mënyrë masive, ku për një periudhë kohore 24 vjeçare është zvogëluar aq shumë, sa që kanë mbetur shumë pak, pra është afër depopullimit të plotë. Drejtimet e migrimit të popullsisë janë të brendshme dhe të jashtme. Një numër i kësaj popullate ka imigruar në qendrën lokale të kësaj komune (Kamenicë), por një numër i konsiderueshëm ka migruar në qytetet tjera të Kosovës, sidomos në Gjilan dhe Prishtinë.

Feriqeva ka funksion agrar shumë funksional. Ky vendbanim shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, arsimimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. I gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes shfrytëzohet nga burime individuale dhe puse. Sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza në këtë fshat mungon tërësisht, ujërat e zeza nuk trajtohen fare.

**Pasuritë natyrore e këtij fshati është:** shkëmbi gnais.

Shtëpitë në fshatin Feriqevë janë të ndërtuara me material klasik. Në këtë fshat nuk ka objekte me rëndësi arkitektonike apo me ndonjë rëndësi të veçantë.

**Flora dhe Fauna** –Ekziston një florë dhe faunë shumë e begatshme , si p.sh. të gjitha pemët frutore të grupit faror, grupit bërthamor, arror si dhe të atyre manore - dredhëza, manaferra,mjedra etj. Gjithashtu, është mjaft e pasur me bimë barishtore të lloj-llojshme, të gjitha llojet e drithërave ( gruri, tërshëra, elbi, misri etj.); Nga shtazët e egra takojmë : derrin,dhelprën, ujkun, lepurin etj. Prej shpezëve të egra : pula e egër , thëllëza, skiftëri, huti etj. Po ashtu, ka edhe zvarranikë si gjarpërinj, bolla etj. Bimë foragjere ( jonxhe etj.) Sa i përket faunës , po ashtu është e pasur si me kafshë të egra, ashtu edhe me kafshë të tjera, pra është një potencial i mirë për gjueti.

### Problemet momentale

Si probleme kryesore në fshatin Feriqevë dhe më të theksuara janë: mungesa e ujësjellësit, mungesa e grumbullimit të mbeturinave, deponitë e egra, rrugët e pa asfaltuara , hapësirat për rekreacion, pushim, etj.

### Kufiri momental ndërtimor

Fshati Feriqevë është vendbanim i tipit shpërndarës.




Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Feriqevës

### Kufiri ndërtimor i propozuar

Për shkak të ruajtjes së tokës bujqësore jemi të detyruar që t'i vejmë kufijtë e ndërtimeve të pa kontrolluara.




Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Feriqevë

### Zhvillimet kryesore

Si zhvillime kryesore që i ndihmojnë zhvillimit ekonomik të këtij fshati janë: rregullimi i infrastrukturës rrugore, asfaltimi i rrugës, infrastruktura mjedisore, futja në sistem të ujësjellësit nëpër të gjitha lagjet. Ofrimi i infrastrukturës për zhvillim të turizmit malor, projekte të veçanta për eksplorimin e zonave arkeologjike.



## Fshati Gmicë

### Profili i vendbanimit

Shtrihet rreth 25 km në veri të Kamenicës, është fshat i tipit kodrinoro malor me shtrirje të shpërndarë , ka sipërfaqe 1213 ha.

Numri i banorëve ( jo shënime zyrtare, por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Gmica ka pasur gjithsej 420 (banorë).

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 na jep këta numra a shifra: 44 ndërtesa, 44 banesa, 30 banesa të pa banuara, 16 ekonomi familjare, 42 banorë të gjinisë mashkullore, 43 të asaj femërore, ndërkaq gjithsej 85 banorë.

### Tipologjia

Shtrirja e fshatit Gmicë është e tipit të shpërndarë, shërbimet janë larg nga fshati (shkolla). Gmica është vendbanim i tipit individual. Popullsia në këtë fshat është shpërngulur në mënyrë masive, ku për një periudhë kohore 24 vjeçare është zvogëluar aq shumë, sa që kanë mbetur shumë pak, pra është afër depopullimit të plotë. Drejtimet e migrimit të popullsisë janë të brendshme dhe të jashtme. Një numër i kësaj popullate ka migruar në qendrën lokale të kësaj komune (Kamenicë), por një numër i konsiderueshëm ka migruar në qytetet tjera të Kosovës, sidomos në Gjilan dhe Prishtinë.

Ky vendbanim shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, arsimimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. I gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes shfrytëzohet nga burimet natyrore (krojet), sistemi i ujësjellësit nuk ekziston, po ashtu nuk ekziston edhe sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza.

**Pasuri natyrore të këtij fshati është:** shkëmbi gnais.

Shtëpitë në fshatin Gmicë janë të ndërtuara me material klasik.

**Flora dhe Fauna** –Ekziston një florë dhe faunë shumë e begatshme , si p.sh. flora karakterizohet me numër të madh të bimëve si të atyre të larta drusore gjethërenëse si: ahu, bingu , qarri, blini, akacia, shkoza, frashëri etj. Po ashtu, pothuajse të gjitha pemët frutore të grupit faror, grupit bërthamor, arror si dhe të atyre manore - dredhëza, manaferra, mjedra etj. Gjithashtu, është mjaft e pasur me bimë barishtore të lloj-llojshme, të gjitha llojet e drithërave ( gruri, tërshëra, elbi, misri etj.). Nga shtazët e egra takojmë : derrin, dhelpren, ujkun, lepurin etj. Prej shpezëve të egra : pula e egër , thëllëza, skiftëri, huti etj. Po ashtu, ka edhe zvarranikë si gjarpërinj, bolla etj. Në të janë kultivuar bimët foragjere ( jongja ,tërfili i kuq, telishi etj.). Sa i përket faunës , po ashtu është e pasur si me kafshë të egra, ashtu edhe me kafshë të tjera, pra është një potencial i mirë për gjueti.

### Problemet momentale

Si probleme kryesore në fshatin Gmicë dhe më të theksuara janë: shkolla, trajtimi i ujërave të zeza, mungesa e ujësjellësit, mungesa e grumbullimit të mbeturinave , deponitë e egra, rrugët e pa asfaltuara.

## Kufiri momental ndërtimor

Fshati Gmicë është vendbanim i tipit të shpërndarë.




Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Gmicës

## Kufiri ndërtimor i propozuar

Për shkak të ruajtjes së tokës bujqësore, kullosave dhe kompaktësimit të fshatit jemi të detyruar që t'i vejmë kufijtë e ndërtimeve,



Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Gmicë.

## Zhvillimet kryesore

Si zhvillime kryesore që i ndihmojnë ekonomisë dhe qarkullimit të mallrave në këtë fshat janë: zgjerimi i rrugëve të fshatit, rregullimi i ndriçimit publik, asfaltimi i rrugëve, ndërtimi i ujësjellësit, kanalizimi, shtrimi i rrugëve bujqësore, rruga Gmicë – Gjyrishec - Lisockë- Desivojcë, projekte të veçanta për përpunimin e drurit.

## Fshati Gogolloc

### Profili i vendbanimit

Shtrihet rreth 5 km në veriperëndim të Kamenicës, është fshat i tipit kodrinoro malor me shtrirje të shpërndarë dhe ka sipërfaqe 235 ha. Numri i banorëve ( jo shënime zyrtare, por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Gogolloci ka pasur gjithsej 86 (banorë).

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 jep këta numra a shifra: 25 ndërtesa, 25 banesa, 21 banesa të pa banuara, 4 ekonomi familjare, struktura e popullsisë sipas gjinisë 4 të gjinisë mashkullore, 6 asaj femërore, si dhe gjithsej 10 banorë.

### Tipologjia

Shtrirja e fshatit Gogolloc është e tipit të shpërndarë, shërbimet janë larg nga fshati (shkolla, qendra e mjekësisë familjare, ) kryhen në qytetin e Kamenicës. Gogolloci është vendbanim i tipit individual. Popullsia në këtë fshat është shpërngulur në mënyrë masive, ku për një periudhë kohore 24 vjeçare është zvogëluar aq shumë, sa që kanë mbetur shumë pak, pra është afër depopullimit të plotë. Drejtimet e migrimit të popullsisë janë të brendshme dhe të jashtme. Një numër i kësaj popullate ka migruar në qendrën lokale të kësaj komune (Kamenicë), por një numër i konsiderueshëm ka migruar në qytetet tjera të Kosovës.

Ky vendbanim shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, arsimimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. I gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes shfrytëzohet nga burimet natyrore (krojet), sistemi i ujësjellësit nuk ekziston, po ashtu nuk ekziston edhe sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza.

**Pasuritë natyrore të këtij fshati janë:** nikeli, plumbi, zinku, argjenti, shkëmbi gnais.

Shtëpitë në fshatin Gogolloc janë të ndërtuara me material klasik.

**Flora dhe Fauna** –Ekziston një florë dhe faunë shumë e begatshme , si p.sh. flora karakterizohet me numër të madh të bimëve të atyre të larta drusore gjethërenëse si: ah, bingu , qarri, blini, akacia, shkoza, frashëri etj. Po ashtu pothuajse, të gjitha pemët frutore të grupit faror, grupit bërthamor, arror si dhe të atyre manore - dredhëza, manaferra,mjedra etj. Gjithashtu, është mjaft e pasur me bimë barishtore të lloj-llojshme, të gjitha llojet e drithërave ( gruri, tërshëra, elbi, misri etj.); Nga shtazët e egra takojmë : derrin, dhelprën, ujku, lepurin etj. Prej shpezëve të egra : pula e egër , thëllëza, skiftëri, huti etj. Po ashtu, ka edhe zvarranikë si gjarpërinj, bolla etj. Bimë foragjere ( jonxhe , tërfili i kuq, telishi etj.) Sa i përket faunës , po ashtu është e pasur si me kafshë të egra, asht edhe me kafshë të tjera, pra është një potencial i mirë për gjueti.

### Problemet momentale

Si probleme kryesore në fshatin Gogolloc më të theksuara janë: shkolla, qendra e mjekësisë familjare, trajtimi i ujërave të zeza, mungesa e ujësjellësit, mungesa e grumbullimit të mbeturinave , deponitë e egra, rrugët e pa asfaltuara.

### **Kufiri momental ndërtimor**

Fshati Gogolloc është vendbanim i tipit të shpërndarë.



**Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Gogolloc**

### **Kufiri ndërtimor i propozuar**

Për shkak të ruajtjes së tokës jemi të detyruar që t'i vejmë kufijtë e ndërtimeve.



**Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Gogolloc**

### **Zhvillimet kryesore**

Si zhvillim kryesor që i ndihmojnë ekonomisë dhe qarkullimit të mallrave në këtë fshat janë: zgjerimi i rrugëve, asfaltimi i rrugës, ndërtimi i ujësjellësit, trajtimi i mbeturinave, rregullimi i kanalizimit

## Fshati Gragjenik

### Profili i vendbanimit

Shtrihet rreth 15 km në veriperëndim të Kamenicës, është fshat i tipit kodrinoro malor me shtrirje të shpërndarë dhe ka sipërfaqe 603 ha. Numri i banorëve (jo shënime zyrtare, por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Gragjeniku i ka pasur gjithsej 126 (banorë).

Regjistrimi i popullsisë ,ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 jep këta numra a shifra: 23 ndërtesa, 23 banesa, 22 banesa të pababnuara, 1 ekonomi familjare, 1 mashkull dhe 1 femër, si dhe gjithsej **2 banorë**.

### Tipologjia

Shtrirja e fshatit Gragjenik është e tipit të shpërndarë, shërbimet janë larg nga fshati (shkolla, qendra e mjekësisë familjare, ) kryhen në fshatin Strezoc. Gragjeniku është vendbanim i tipit individual. Popullsia në këtë fshatë është shpërngulur në mënyrë masive, ku për një periudhë kohore 20 vjeçare është zvogëluar aq shumë sa që kanë mbetur shumë pak, ku është afër depopullimit të plotë. Drejtimet e migrimit të popullsisë janë të brendshme dhe të jashtme. Një numër i kësaj popullate ka migruar në qendrën lokale të kësaj komune (Kamenicë), por një numër i konsiderueshëm ka migruar në qytetet tjera të Kosovës si dhe jashtë Kosovës.

Ky vendbanim shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. I gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes shfrytëzohet nga burimet natyrore (krojet), sistemi i ujësjellësit nuk ekziston, po ashtu nuk ekziston edhe sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza.

**Pasuri natyrore e këtij fshati është:** shkëmbi Dollomit.

Shtëpitë në fshatin Gragjenik janë të ndërtuara me material klasik.

**Flora dhe Fauna** –Ekziston një florë dhe faunë shumë e begatshme , si p.sh. flora (bota bimore) karakterizohet me numër të madh të bimëve si të atyre të larta drusore gjethërenëse, si psh: ahu, bungu , qarri, blini, akacia, shkoza, frashëri etj. Po ashtu, pothuajse të gjitha pemët frutore të grupit faror, grupit bërthamor, arror si dhe të atyre manore - dredhëza, manaferra, mjedra etj. Gjithashtu, është mjaft e pasur me bimë barishtore të lloj-llojshme, të gjitha llojet e drithërave ( gruri, tërshëra, elbi, misri etj.). Nga shtazët e egra takojmë : derrin, dhelprën, ujkun, lepurin etj. Prej shpezëve të egra : pula e egër , thëllëza, skiftëri, huti etj. Po ashtu ka edhe zvarranikë si gjarpërinj, bolla etj. Ka edhe bimë foragjere ( jonxhe, tërfili i kuq, telishi etj.) Sa i përket faunës , po ashtu është e pasur si me kafshë të egra si dhe kafshë të tjera, pra është një potencial i mirë për gjueti.

### Problemet momentale

Si probleme kryesore në fshatin Gragjenik e më të theksuara janë: depopullimi, mungesa e rrugës, trajtimi i ujërave të zeza, mungesa e ujësjellësit, mungesa e grumbullimit të mbeturinave , deponitë e egra, rrugët e pa asfaltuara.\

## Kufiri momental ndërtimor

Fshati Gragjenik është vendbanim i tipit të shpërndarë.



**Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Gragjenikut**

## Kufiri ndërtimor i propozuar

Për shkak të ruajtjes së kompaktësisë së vendbanimit ekzistues jemi të detyruar t'i vejmë kufijtë e ndertimeve të pakontrolluara.



**Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Gragjenik**

## Zhvillimet kryesore

Si projekte kryesore që i ndihmojnë zhvillimit të këtij fshati janë: projekti për kthim të banorëve të cilët e kanë braktisur fshatin, rregullimi i infrastrukturës rrugore, turizmi i gjuetisë, ofrim i infrastrukturës për zhvillim të turizmit malor.

## Fshati Grizime

### Profili i vendbanimit

Ndodhet në një luginë pranë rrugës që lidhë qytetin e Kamenicës rreth 3 km në veri të Kamenicës. Ka sipërfaqe 409 hektar. Është vendbanim i tipit të shpërndarë - linear. Mbi fshat në pjesën veriore ngriten kodrat me male, ku e ndanë me Bratillocin.

Numri i banorëve ( jo shënime zyrtare, por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Grizimja ka pasur gjithsej 144 (banorë).

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 ka dhënë këta numra a shifra: 157 ndërtesa, 157 banesa, 73 banesa të pabanuara, 84 ekonomi familjare, struktura gjinore e popullsisë ka 235 meshkuj, 222 femra, si dhe gjithsej **457 banorë**.

### Tipologjia

Shtrirja e fshatit Grizime është e tipit shpërndarës -linear, kohëve të fundit ka tentime të rritjes së numrit të banorëve për shkak të ndërtimeve në drejtim të qytetit të Kamenicës. Rreth fshatit kalon rruga që lidh shumë fshtarta të komunës, shërbimet janë në qendër të fshatit (shitore ushqimore). Grizimja është vendbanim i tipit individual.

Grizima ka funksion agrar, dhe blektoral një funksional. Ky vendbanim shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, arsimimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. I gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes 100% shfrytëzohet nga puset, sistemi i ujësjellësit nuk ekziston, po ashtu nuk ekziston edhe sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza.

Shtëpitë në fshatin Grizime, janë të ndërtuara me material mesatarisht të fortë. Në këtë fshat nuk ka objekte me rëndësi arkitektonike apo me ndonjë rëndësi të veçantë. Pasuritë natyrore të këtij fshati janë: shkëmbinj gnais, toka bujqësore është mjaft pjellore (klasa e III-V).

Në Grizimë zhvillohen këto veprimtari: bujqësia e blegtoria .

### Problemet momentale

Si probleme kryesore në fshatin Grizimë e më të theksuara janë: trajtimi i ujërave të zeza, mungesa e ujësjellësit, mungesa e grumbullimit të mbeturinave , deponitë e egra, rrugët e pa asfaltuara në disa lagje.

### **Kufiri momental ndërtimor**

Kufijtë ndërtimor të fshatit Grizime janë të tipit të shpërndarë. Në mes të fshatit ndodhet pjesa më e madhe e tokës bujqësore.



**Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Grizimës**

### **Kufiri ndërtimor i propozuar**

Për shkak të ruajtjes së tokës bujqësore jemi të detyruar që t'i vejmë kufijtë ndërtimorë dhe kufizimin e ndërtimor brenda fshatit në zemrën e gjelbër, ku përkohësisht do të shrytëzohet si tokë bujqësore e cila shërben për zhvillimin e kulturave bujqësore dhe si burim ekonomik për qytetarët në të ardhmen, si dhe janë dhënë kufijtë për mundësi të zgjerimit të zonës ndërtimore.



**Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Grizimë**

### **Zhvillimet kryesore**

Si zhvillim kryesor që i ndihmojnë ekonomisë dhe qarkullimit të mallrave në këtë fshat janë: ndërtimi i rrugës sipas standarteve Kamenicë- Kopërnice - Hogosht, me trotuar dhe ndriçim publik, kjo rrugë bënë lidhjen e këtyre fshatrave me qytetin dhe mundëson zhvillimin e aktiviteteve ekonomike, rregullimi rrugës periferike , futja e ujërave të zeza në sistem të kanalizimit nëpër të gjitha lagjet, sigurimi i ujit të pijes përmes shpuarjeve dhe shfrytëzimit të burimeve ekzistuese, qendra e mjekësisë familjare. Ndërtimi i fushave sportive, ofrim i infrastrukturës për zhvillim .



## Fshati Gjyrishec

### Profili i vendbanimit

Shtrihet rreth 23 km në veri të Kamenicës, është fshat i tipit kodrinoro malor me shtrirje të shpërndarë , ka sipërfaqe 891 ha. Numri i banorëve ( jo shënime zyrtare, por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Gjyrisheci ka pasur gjithsej 214 (banorë).

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 ka dhënë këta numra a shifra: 17 ndërtesa, 17 banesa, 6 banesa të pa banuara, 8 ekonomi familjare, ndërsaq struktura gjinore e popullsisë ka 31 meshkuj dhe 27 femra, ku numri i plotë na del gjithsej 58 banorë.

### Tipologjia

Shtrirja e fshatit Gjyrishec është e tipit të shpërndarë, shërbimet mungojnë në fshat. Gjyrisheci është vendbanim i tipit individual. Popullsia në këtë fshat është shpërngulur në mënyrë masive, ku për një periudhë kohore 30 vjeçare është zvogëluar aq shumë sa që kanë mbetur shumë pak, pra është afër depopullimit të plotë. Drejtimit e migrimit të popullsisë janë të brendshme dhe të jashtme. Një numër i kësaj popullate ka migruar në qendrën lokale të kësaj komune (Kamenicë), por një numër i konsiderueshëm ka migruar në qytetet tjera të Kosovës.

Si pasuri nëntokësore është e njohur me mineralin, shkëmb gëlqeror.

Ky vendbanim shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, pushimin, komunikimin etj. I gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes shfrytëzohet nga burimet natyrore (krojet), sistemi i ujësjellësit nuk ekziston, po ashtu nuk ekziston edhe sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza.

**Pasuritë natyrore të këtij fshati është:** shkëmbinj të gnais.

Shtëpitë në fshatin Gjyrishec janë të ndërtuara me material klasik.

**Flora dhe Fauna** –Ekziston një florë dhe faunë shumë e begatshme , si p.sh. flora karakterizohet me numër të madh të bimëve, sidomos të atyre të larta drusore gjethërenëse, si: ahui, bungu , qarri, blini, akacia, shkoza, frashëri etj. Po ashtu, pothuajse të gjitha pemët frutore të grupit faror, grupit bërthamor, arror si dhe të atyre manore - dredhëza, manaferra, mjedra etj. Gjithashtu, është mjaft e pasur me bimë barishtore të lloj-llojshme, të gjitha llojet e drithërave ( gruri, tërshëra, elbi, misri etj.). Nga shtazët e egra takojmë : derrin, dhelprën, ujkun, lepurin etj. Prej shpezëve të egra : pula e egër , thëllëza, skiftëri, huti etj. Po ashtu ka edhe zvarranikë, si gjarpërinj, bolla etj. Bimë foragjere ( jonxhe , tërfili i kuq, telishi etj.).

### Problemet momentale

Si probleme kryesore në fshatin Gjyrishec e më të theksuara janë: shkolla, qendra e mjekësisë familjare, mungesa e rrugës, trajtimi i ujërave të zeza, mungesa e ujësjellësit, mungesa e grumbullimit të mbeturinave , deponitë e egra, rrugët e pa asfaltuara.

## Kufiri momental ndërtimor

Fshati Gjyrishec është vendbanim i tipit të shpërndarë.



**Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Gjyrishecit**

## Kufiri ndërtimor i propozuar

Për shkak të ruajtjes së ambientit jemi të detyruar që t'i vejmë kufijtë e ndërtimeve, si dhe janë dhënë kufijtë për mundësi të zgjerimit të kufijve ndërtimor në zonën rrëzë pyjeve.



**Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Gjyrishec.**

## Zhvillimet kryesore

Si zhvillim kryesor që i ndihmojnë ekonomisë dhe qarkullimit të mallrave në këtë fshat janë: ndërtimi i rrugës Gjyrishec, kjo rrugë bën lidhjen e këtyre fshatrave dhe mundëson zhvillimin e aktiviteteve ekonomike, futja e ujërave të zeza në sistem të kanalizimit nëpër të gjitha lagjet, qendra e mjeksisë familiare, ndërtimi i fushave sportive, ofrim i infrastrukturës për zhvillim të turizmit malor në pjesën jugore të fshati, projekte të veçanta për eksplorimin e zonave arkeologjike.

## Fshati Hajnoc

### Profili i vendbanimit

Shtrihet rreth 3 km në veriperëndim të Kamenicës, është fshat i tipit shpërndarës me sipërfaqe 1373 ha, që shtrihet në luginën veriperëndimore të qytetit e njohur për xehe. Përmes të fshatit kalon Lumi "Kriva Reka" dhe në të dy anët e fshatit shtrihen kodrat e larta me pyje . Toka është pjellore e klasit I –II e përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë.

Numri i banorëve ( jo shënime zyrtare, por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Hajnoci ka pasur gjithsej 357 banorë.

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 ka dhënë këta numra a shifra: 177 ndërtesa, 177 banesa, 84 banesa të pabanuara, 93 ekonomi familjare; ndërkaq 187 banorë të gjinisë mashkullore, 166 të asaj femërore, me gjithsej 353 banorë.

**Tipologjia** Shtrirja e fshatit Hajnoc është e tipit të shpërndarë, zhvillimet janë të koncentruara përgjatë rrugës së asfaltuar në drejtim të Strezocit, shërbimet janë në periferi të fshatit (shkolla, kisha, etj). Hajnoci është vendbanim i tipit individual.

Hajnoci ka funksion agrar një funksional dhe blektorial. Ky vendbanim shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, arsimimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. I gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes 95% shfrytëzohet nga pusët. Sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza dhe atyre atmosferike, aktualisht nuk ekziston.

**Pasuritë natyrore të këtij fshati janë:** shkëmbinj gnais, zhavorri, antimon.


Shtëpitë në fshatin Hajnoc janë të ndërtuara me material të fortë. Si resurs natyror të këtij fshati, është toka bujqësore një pjesë përgjatë lumit të fshatit është mjaft pjellore (klasa I dhe II deri IV e bonitetit, etj).

Hajnoci është vendbanim mjaft i lashtë ka disa mbeturina arkeologjike që tregojnë lashtësinë e tij. Hajnoci është mjaft vend atraktiv për zhvillim të blegtorisë dhe bujqësisë, i pasur me male pasi që këtë ia mundëson rruga Kamenicë - Strezoc.

### Problemet momentale

Si probleme kryesore në fshatin Hajnoc e më të theksuara janë: mungesa e kanalizimit (trajtimi i ujërave të zeza), mungesa e ujit të pijes, mungesa e grumbullimit të mbeturinave , deponitë e egra, etj.

## Kufiri momental ndërtimor



**Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Hajnocit**

## Kufiri ndërtimor i propozuar

Për shkak të ruajtjes së tokës bujqësore me bonitet të lartë (kategoria e I) dhe kompaktësimit të fshatit jemi të detyruar, që t'i vejmë kufijtë e ndërtimeve,.



**Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Hajnoc**

## Zhvillimet kryesore

Si zhvillime kryesore që i ndihmojnë ekonomisë dhe qarkullimit të mallrave në këtë fshat janë: zgjerimi i rrugëve të fshatit, rregullimi i ndriçimit publik dhe shtruarja e trotuareve të rrugës, ndërtimi dhe asfaltimi i fushës sportive, ndërtimi i kanalizimit, shtrimi i rrugëve bujqësore, projekte të veçanta për eksplorimin e zonave arkeologjike.

## Fshati Hodonoc

### Profili i vendbanimit

Shtrihet rreth 18 km në juglindje të Kamenicës, ka sipërfaqe 1481 ha.

Numri i banorëve (jo shënime zyrtare, por të dhëna nga kshillat lokale) në vitin 1998 Hodonoci ka pasur gjithsej **2354 banorë**.

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 ka reflektuar me këta numra a shifra: 414 ndërtesa, 414 banesa, 42 banesa të pa banuara, 384 ekonomi familjare; ndërkaq janë 1249 banorë të gjinisë mashkullore, 1194 të asaj femërore, si dhe gjithsej **2443 banorë**.

### Tipologjia

Shtirja e fshatit Hodonoc është e tipit shpërndarës, në anën perëndimore të fshatit kalon lumi i Hogoshtit, i Desivojcës dhe Lumi “Katushnica” ka një rrjet hidrografik, i cili i takon pellgut të Detit të Zi.). Kohëve të fundit ka tentime të shtrirjes lineare, përgjatë rrugës kryesore të fshatit, shërbimet janë në qendër të fshatit (shkolla, xhamia, ambulanca). Fshati është vendbanim i tipit individual.

Hodonoci ka funksion agrar një funksional. Ky vendbanim shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve, siç janë: banimi, jeta në bashkësi, funksioni i punës, furnizimi, arsimimi, argëtimi, pushimi, komunikimi etj. I gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes 95% shfrytëzohet nga puset, po ashtu në këtë fshat ekziston edhe sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza i pa trajtuar, pra në aspektin ekologjik mungon trajtimi i tyre (gropa septike) ujërat e zeza derdhen në lumin e Hogoshtit dhe te Desivojcës pa u trajtuar.

Shtëpitë në fshatin Hodonoc janë të ndërtuara me material të fortë. Në këtë fshat nuk ka objekte me rëndësi arkitektonike apo me ndonjë rëndësi të veçantë.

**Flora dhe Fauna** –Ekziston një florë dhe faunë shumë e begatë. Flora karakterizohet me numër. të madh të bimëve, sidomos të atyre të larta drusore gjethërenëse si: bungu , qarri, blini, akacia, shkoza, frashëri etj. Po ashtu, pothuajse të gjitha pemët frutore të grupit faror, grupit bërthamor, arror si dhe të atyre manore - dredhëza, manaferra, mjedra etj. Gjithashtu, është mjaft e pasur me bimë barishtore të lloj-llojshme, të gjitha llojet e drithërave ( gruri, tërshëra, elbi, misri etj.); Nga shtazët e egra takojmë : derrin, dhelpren, ujkun, kaprrollin, dhinë e egër, lepurin etj. Prej shpezëve të egra : pula e egër , thëllëza, skiftëri, huti etj. Sa i përket faunës së ujit , lumi nuk është i pastër dhe për atë janë në zhdukje peshqit siç janë: krapë, ngjala, barbeli, etj.

Në Hodonoc zhvillohen këto veprimtari: bujqësia, zeytaria dhe tregtia.

### Problemet momentale

Faktorët kryesor që kanë ndikuar në shkallën e lartë të depopullimit në këto vendbanime janë: shkalla e lartë e papunësisë, varfëria, mungesa e shërbimeve, zhvillimi i pabarabartë ekonomik, niveli më i ulët i shërbimeve arsimore dhe shëndetësore etj.

Si probleme kryesore dhe më të theksuara në fshatin Hodonoc janë: mungesa e grumbullimit të mbeturinave në disa lagje, deponitë e egra, rrugët e pa asfaltuara në disa lagje, ndriçimi publik, ndërtimi i trotuareve përgjatë rrugëve, ndërtimi i ujësjellësit dhe trajtimi i ujërave të zeza si dhe ujërave atmosferike, rregullimi shtratit të përroit, mungesa e hapësirave të lira për rekreacion etj .

### **Kufiri momental ndërtimor**


Fshati Hodonoc është vendbanim i tipit shpërndarës. Shërbimet (shkolla, xhamia, ambulanca) janë në qendër të fshatit.



**Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Hodonocit**

### **Kufiri ndërtimor i propozuar**

Për shkak të ruajtjes së tokës bujqësore me bonitet mesatarisht të lartë (klasa e I-III e bonitetit, si dhe të klasa e II-IV pjesa tjetër) dhe kompaktësisht të fshatit jemi të detyruar që t'i vejmë kufijtë e ndërtimeve, si dhe janë dhënë mundësitë për zgjerim të kufirit ndërtimor në të ardhmën, në disa pjesë jemi detyruar që t'i ndërprejmë ndërtimet.



**Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Hodonoc**

### **Zhvillimet kryesore**

Për zvogëlimin e shkallës së depopullimit rekomandohet që të stimulohet popullsia e këtijë vendbanimi për veprimin dhe krijimin e kushteve më të mira për jetesë në këto hapësira. Që të arrihet ky rezultat, është e nevojshme të hapen mundësi për zgjerimin e aktiviteteve ekonomike dhe investime në këtë fshat, si: asfaltimi dhe zgjerimi i rrugëve të fshatit, asfaltimi i rrugëve brenda fshatit, ndriçimi publik, ndërtimi i trotuareve përgjatë rrugëve, ndërtimi i ujësjellësit dhe trajtimi i ujërave të zeza si dhe ujërave atmosferike; pastaj rregullimi shtratit të përroit, ndërtimi i shkollës profesionale, shtrimi i rrugëve bujqësore, ndërtimi i fushave sportive, turizmi rekreativ dhe projekte të veçanta për eksplorimin e zonave arkeologjike.

## Fshati Hogosht

### Profili i vendbanimit

Shtrihet rreth 10 km në verilindje të Kamenicës, ka sipërfaqe 1547 ha.

Numri i banorëve (jo shënime zyrtare, por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Hogoshti ka pasur gjithsej **2260 banorë**.

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 ka reflektuar me këta numra a shifra: 370 ndërtesa, 377 banesa, 84 banesa të pa banuara, 297 ekonomi familjare: ndërkaq struktura gjinore e popullsisë është, 887 meshkuj, 882 femra, si dhe gjithsej **1769 banorë**.

### Tipologjia

Shtrirja e fshatit Hogosht është e tipit kompakt, kohëve të fundit ka tentime të shtrirjes lineare, përgjatë rrugës Hogosht-Kolloleq, në mes të fshatit kalon lumi i Hogoshtit, ka një rrjet hidrografik, i cili i takon pellgut të Detit të Zi.). Shërbimet janë në fshat (shkollat, xhamia, qendra e mjekësisë familjare, ofiqaria, stadiumi, stacioni i policisë, objektet publike, posta etj.). Hogoshti është vendbanim i tipit individual.

Hogoshti ka funksion agrar një funksional. Ky vendbanimi shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, arsimimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. I gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes 95% shfrytëzohet nga pusët dhe krojet, po ashtu në këtë fshat ekziston edhe sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza i pa trajtuar, pra në aspektin ekologjik mungon trajtimi i tyre (gropa septike) ujërat e zeza derdhen në lumin e Hogoshtit pa u trajtuar.

Shtëpitë në fshatin Hogosht janë të ndërtuara me material të fortë. Në këtë fshat ka objekte me rëndësi arkitektonike (Mullini Binjak) etj. ....

Pasuritë natyrore të këtij fshati janë: shkëmb gnais, shkëmb granit, kallaj, litium.

**-Bentonitet –** . Kanë përdorim të gjerë në industrinë ushqimore, si dhe për prodhimin e tullave, tjegullave, bllokave etj. materiali vullkanik piroklastik, toka bujqësore është mjaft pjellore (klasa e I-III e bonitetit, si dhe te klasa e II-IV pjesa tjetër). Mergalet shtrihen mbi pjesën bazale të serisë terciare, me të cilën ndërtohet sinklinalja.

**Flora dhe Fauna** –Ekziston një florë dhe faunë shumë e begatë. Flora karakterizohet me numër të madh të bimëve, sidomos të atyre të larta drusore gjethërnëse, si: bingu , qarri, blini, akacia, plepi, shkoza, frashëri etj. Po ashtu pothuajse, të gjitha pemët frutore të grupit faror, grupit bërthamor, arror si dhe të atyre manore - dredhëza, manaferra, mjedra etj. Gjithashtu, është mjaft e pasur me bimë barishtore të lloj-llojshme, të gjitha llojet e drithërave ( gruri, tërshëra, elbi, misri etj.); nga shtazët e egra takojmë : derra, dhelpra, ujq, kaproj, dhi të egra, lepuj etj. Prej shpezëve të egra, ka : pula të egra , thëllëza, skiftërëë, huta, shqiponja etj. Sa i përket faunës së ujit , lumi nuk është i pastër dhe për atë janë në zhdukje peshqit siç janë, krapit , ngjala, barbeli, babushka etj. Po ashtu ka edhe zvarranikë si gjarpërinj, bolla etj. Bimë foragjere ( jonxhe, tërfili i kuq, telishi etj.) Sa i përket faunës , po ashtu është e pasur si me kafshë të egra, ashtu dhe me kafshë të tjera, pra është një potencial i mirë për gjueti.

Në Hogosht zhvillohen këto veprimtari: bujqësia, zëjtaria (ndërtimtaria, makineria, elektrik-elektroteknik, hidraulik, dhe teknologji informative) dhe tregëtia.


### Problemet momentale

Faktorët kryesor që kanë ndikuar në shkallën e lartë të depopullimit në këto vendbanime janë: shkalla e lartë e papunësisë, varfëria, mungesa e shërbimeve, zhvillimi i pabarabartë ekonomik, niveli më i ulët i shërbimeve arsimore dhe shëndetësore etj.

Si probleme kryesore në fshatin Hogosht dhe më të theksuara janë: mungesa e grumbullimit të mbeturinave në disa lagje,deponitë e egra, rrugët e pa asfaltuara në disa lagje, ndriçimi publik, ndërtimi i trotuareve përgjatë rrugëve, ndërtimi i ujësjellësit dhe trajtimi i ujërave të zeza si dhe ujërave atmosferike, rregullimi shtratit të përroit, mungesa e hapësirave të lira për rekreacion etj

### **Kufiri momental ndërtimor**

Fshati Hogosht është i tipit kompakt, kohëve të fundit ka tentime të shtrirjes lineare, përgjatë rrugës Hogosht-Kolloleq. Shërbimet (shkolla, xhamia, ambulanca, shtëpia e kulturës etj). janë në fshat.



**Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Hogoshtit**

### **Kufiri ndërtimor i propozuar**

Për shkak të ruajtjes së tokës bujqësore me bonitet mesatarisht të lartë (klasa e I-III e bonitetit, si dhe te klasa e II-IV pjesa tjetër) dhe kompaktësisimit të fshatit jemi të detyruar që t'i vejmë kufijtë e ndërtimeve, si dhe janë dhënë mundësitë për zgjerim të kufirit ndërtimor në të ardhmën, në disa pjesë jemi detyruar që t'i ndërprejmë ndërtimet.



**Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Hogosht**

### **Zhvillimet kryesore**

Për zvogëlimin e shkallës së depopullimit, rekomandohet që të stimulohet popullsia e këtij vendbanimi për veprimin dhe krijimin e kushteve më të mira për jetesë në këto hapësira. Që të arrihet ky rezultat është e nevojshme të hapen mundësi për zgjerimin e aktiviteteve ekonomike dhe investime në këtë fshat si: asfaltimi dhe zgjerimi i rrugëve të fshatit, asfaltimi i rrugëve brenda fshatit, ndriçimi publik, ndërtimi i trotuareve përgjatë rrugëve, ndërtimi i ujësjellësit dhe trajtimi i ujërave të zeza si dhe ujërave atmosferikë, rregullimi shtratit të përroit, ndërtimi i shkollës profesionale, shtrimi i rrugëve bujqësore, ndërtimi i fushave sportive, turizmi rekreativ dhe projekte të veçanta për eksplorimin e zonave arkeologjike.



## Fshati Karaçevë e Epërme

### Profili i vendbanimit

Shtrihet rreth 25 km në lindje të Kamenicës, ka sipërfaqe 1127 ha. Numri i banorëve (jo shënime zyrtare, por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Karaçeva e Epërme ka pasur gjithsej **1550 (banorë)**.

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 jep këta numra a shifra: 293 ndërtesa, 297 banesa, 63 banesa të pabanuara, 235 ekonomi familjare; ndërkaq sipas strukturës gjinore 717 banorë i përkasin gjinisë mashkullore, 695 asaj femërore, si dhe gjithsej ka **1412 banorë**.

### Tipologjia

Shtrirja e fshatit Karaçevë e Epërme është e tipit shpërndarës, kohëve të fundit ka tentime të shtrirjes lineare, përgjatë rrugës Karaçevë e Epërme – Karaçevë e Poshtme, në mes të fshatit kalon Përroi i Karaçevës, ka një rrjet hidrografik, i cili i takon pellgut të Detit të Zi, shërbimet janë në periferi të fshatit (shkolla, xhamia, ambulanca).

Karaçeva e Epërme ka funksion agrar një funksional. Ky vendbanim shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, arsimimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. I gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes 95% shfrytëzohet nga burimet natyrore (puset dhe krojet), po ashtu në këtë fshat ekziston edhe sistemi i kanalizimit të hapur të ujërave të zeza i pa trajtuar në aspektin ekologjik. Pra, mungon trajtimi i tyre (gropa septike) ujërat e zeza derdhen në lumë pa u trajtuar.

Shtëpitë në fshatin Karaçevë e Epërme janë të ndërtuara me material të fortë. Pasuritë natyrore të këtij fshati janë: shkëmbinj magmatik, **granitet e kaolinizuara (kaolini)** – i vetmi vendburim i xehes së granitit të kaolinizuar në Kosovë ndodhet në fshatin Karaçevë e Epërme. Rezervat e kësaj xehe janë rreth 3.5 milion tonelata. Përdorimi i kaolinit, është treguar shumë i përshtatshëm për prodhimin e pllakave të qeramikës dhe për enë porcelani.

**-Bentonitet –** Kanë përdorim të gjerë në industrinë ushqimore, për prodhimin e tullave, tjegullave, bllokave etj. Mandej materiali vullkanik piroklastik, toka bujqësore është mjaft pjellore (klasa e III e bonitetit, si dhe te klasa e III-VI pjesa tjetër). Në të shtrihen mergelet mbi pjesën bazale të serisë terciare, me të cilën ndërtohet sinklinalja.

**Flora dhe Fauna** –Ekziston një florë dhe faunë shumë e begatë, si p.sh.: flora karakterizohet me numër të madh të bimëve, sidomos të atyre të larta drusore gjethrënëse si: ahu, bungu, qarri, blini, akacia, shkoza, frashri, thana, lajthia etj. Po ashtu pothuajse, të gjitha pemët frutore të grupit faror, grupit bërthamor, arror si dhe të atyre manore - dredhëza, manaferra, mjedra etj. Gjithashtu, është mjaft e pasur me bimë barishtore të llojllojshme, të gjitha llojet e drithërave (gruri, tërshëra, elbi, thekra, misri etj.); Nga shtazët e egra takojmë: derrin, dhelprën, ujkun, lepurin, dhinë e egër, kaprrollin, macen e egër etj. Prej shpezëve të egra: pula e egër, thëllëza, skftëri, shqiponja, huti etj. Po ashtu, ka edhe zvarranikë, si: gjarpërinj, bolla etj. Bimë foragjere (jonxhe, tërfili i kuq, telishi etj.). Sa i përket faunës, po ashtu është e pasur si me kafshë të egra, ashtu edhe me kafshë të tjera, prandaj është një potencial i mirë për gjueti.

Në Karaçevë të Epërme zhvillohen këto veprimtari: bujqësia, zeytaria (ndërtimtari, makineri, elektrik-elektroteknik) dhe tregtia.

### Problemet momentale

Si probleme kryesore në fshatin Karaçevë të Epërme dhe më të theksuara janë: mungesa e grumbullimit të mbeturinave, deponitë e egra, ndriçimi publik, ndërtimi i trotuareve përgjatë rrugëve, trajtimi i ujërave të zeza si dhe ujërave atmosferike, rregullimi shtratit të përrrenjve, mungesa e hapësirave të lira për rekreacion etj.

### **Kufiri momental ndërtimor**

Fshati Karaçevë e Epërme, është vendbanim i tipit te shpërndarë. Shërbimet (shkolla, xhamia, ambulanca, stadiumi etj.) janë në periferi të fshatit.



**Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Karaçevës së Epërme**

### **Kufiri ndërtimor i propozuar**

Për shkak të ruajtjes së tokës bujqësore me bonitet, mesatarisht të lartë (te klasa e III-V pjesa tjetër) dhe kompaktësisimit të fshatit, jemi të detyruar që t'i vejmë kufijtë e ndërtimeve, si dhe janë dhënë mundësitë për zgjerim të kufirit ndërtimor në të ardhmen, në disa pjesë jemi detyruar që t'i ndërpresim ndërtimet.



**Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Karaçevë e Epërme**

### **Zhvillimet kryesore**

Si zhvillim kryesor në këtë fshat janë: asfaltimi dhe zgjerimi i rrugëve të fshatit, ndriçimi publik, ndërtimi i trotuareve përgjatë rrugëve, ndërtimi i ujësjellësit dhe trajtimi i ujërave të zeza dhe ujërave atmosferike, rregullimi shtratit të lumit, shtrimi i rrugëve bujqësore, ndërtimi i fushave sportive, turizmi rekreativ dhe projekte të veçanta për eksplorimin e zonave arkeologjike.

## Fshati Karaçevë e Poshtme

### Profili i vendbanimit

Shtrihet rreth 22 km në lindje të Kamenicës, ka sipërfaqe 432 ha. Numri i banorëve (jo shënime zyrtare, por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Karaçeva e Poshtme ka pasur gjithsej **970 (banorë)**.

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 jep këta numra a shifra: 219 ndërtesa, 221 banesa, 59 banesa të pa banuara, 160 ekonomi familjare; ndërkaq sipas gjinisë 488 banorë janë të gjinisë mashkullore, 455 të asaj femërore, si dhe gjithsej **943 banorë**.

### Tipologjia

Shtrirja e fshatit Karaçevë e Poshtme, është e tipit shpërndarës, ku kohëve të fundit ka tentime të shtrirjes lineare, përgjatë rrugës Karaçevë e Epërme – Karaçevë e Poshtme – Rogaçicë, në mes të fshatit kalon Lumi “Katushnica”. Ka një rrjet hidrografik, i cili i takon pellgut të Detit të Zi, ndërsa shërbimet janë në pjesën epërme të fshatit (shkolla, xhamia, ambulanca).

Fshati ka funksion agrar një funksional. Gjithashtu, vendbanimi shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, arsimimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. I gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes 95% shfrytëzohet nga ujësjellësi, po ashtu në këtë fshat ekziston edhe sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza i pa trajtuar në aspektin ekologjik, pra mungon trajtimi i tyre (gropa septike) ujërat e zeza derdhen në lumë dhe pa u trajtuar.

Shtëpitë në fshatin Karaçevë e Poshtme janë të ndërtuara me material të fortë. Pasuritë natyrore të këtij fshati, janë: shkëmbinj magmatik, **granitet e kaolinizuara (kaolini)** – i vetmi vendburim i xehes së granitit të kaolinizuar në Kosovë ndodhet në fshatin Karaçevë e Poshtme. Rezervat e kësaj xehe janë rreth 3.5 milion tonelata. Përdorimi i kaolinit, është treguar shumë i përshtatshëm për prodhimin e pllakave të qeramikës dhe për enë porcelani si dhe sasi e konsiderueshme e tufit.

**-Bentonitet –** Kanë përdorim të gjerë në industrinë ushqimore, si dhe për prodhimin e tullave, tjegullave, bllokave etj. mandej materiali vullkanik piroklastik, toka bujqësore është mjaft pjellore (klasa e III e bonitetit, si dhe te klasa e III-VI pjesa tjetër). mergelet shtrihen mbi pjesën bazale të serisë terciare, me të cilën ndërtohet sinklinalja.

**Flora dhe Fauna** –Ekziston një florë dhe faunë shumë e begatë, si p.sh. Flora .: flora karakterizohet me numër të madh të bimëve, sidomos të atyre të larta drusore gjethërenëse si: ahu, bungu, qarri, blini, akacia, shkoza, frashri, thana, lajthia etj. Po ashtu pothuajse, të gjitha pemët frutore të grupit faror, grupit bërthamor, arror si dhe të atyre manore - dredhëza, manaferra, mjedra etj. Gjithashtu, është mjaft e pasur me bimë barishtore të llojllojshme, të gjitha llojet e drithërave (gruri, tërshëra, elbi, thekra, misri etj.); Nga shtazët e egra takojmë : derrin, dhelprën, ujkun, lepurin, dhinë e egër, kaprrollin, macen e egër etj. Prej shpezëve të egra : pula e egër, thëllënza, skifteri, shqiponja, huti etj. Po ashtu, ka edhe zvarranikë, si: gjarpërinj, bolla etj. Bimë foragjere (jonxhe, tërfili i kuq, telishi etj.). Sa i përket faunës, po ashtu është e pasur si me kafshë të egra, ashtu edhe me kafshë të tjera, prandaj është një potencial i mirë për gjueti.

Në Karaçevë të Poshtme zhvillohen këto veprimtari: bujqësia, zejtaria (ndërtimtari, makineri dhe tregtia.

### Problemet momentale

Si probleme kryesore të fshatit dhe më të theksuara janë: mungesa e grumbullimit të mbeturinave, deponitë e egra, ndriçimi publik, ndërtimi i trotuareve përgjatë rrugëve, trajtimi i ujërave të zeza si dhe ujërave atmosferike, rregullimi i shtratit të lumit, mungesa e hapësirave të lira për rekreacion etj.

### **Kufiri momental ndërtimor**

Fshati Karaçevë e Poshtme, është vendbanim i tipit të shpërndarë. Shërbimet (shkolla, xhamia, ambulanca, stadiumi etj.) janë në qendër të fshatit. Fig. 1.



**Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Karaçevës së Poshtme**

### **Kufiri ndërtimor i propozuar**

Për shkak të ruajtjes së tokës bujqësore me bonitet mesatarisht të lartë (te klasa e III-V pjesa tjetër) dhe kompaktësimit të fshatit jemi të detyruar, që t'i vejmë kufijtë e ndërtimeve, si dhe janë dhënë mundësitë për zgjerim të kufirit ndërtimor në të ardhmën, në disa pjesë jemi detyruar që t'i ndërprejmë ndërtimet.



**Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Karaçevëa e poshtme**

### **Zhvillimet kryesore**

Si zhvillime kryesore në këtë fshat janë: asfaltimi dhe zgjerimi i rrugëve të fshatit, ndriçimi publik, ndërtimi i trotuareve përgjatë rrugëve, ndërtimi i ujësjellësit dhe trajtimi i ujërave të zeza si dhe ujërave atmosferike, rregullimi shtratit të lumit , shtrimi i rrugëve bujqësore, ndërtimi i fushave sportive, turizmi rekreativ dhe projekte të veçanta për eksplorimin e zonave arkeologjike.

## Fshati Kolloleq

### Profili i vendbanimit

Ndodhet në një luginë pranë rrugës që lidhë Hogoshtin me Rogaçicën, rreth 11 km në lindje të Kamenicës. Është vendbanim i tipit të shpërndarës, ka sipërfaqe 813 ha, në pjesën perëndimore ngriten kodrat me male që e ndajnë me Moçarin.

Numri i banorëve ( jo shënime zyrtare, por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Kolloleqi ka pasur gjithsej 281 banorë.

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 jep këta numra a shifra: 95 ndërtesa, 99 banesa, 37 banesa të pa banuara, 62 ekonomi familjare; kurse struktura e popullsisë sipas gjinisë është 91 banorë të gjinisë mashkullore, 95 të asaj femërore, si dhe gjithsej **176 banorë**.

### Tipologjia

Shtrirja e fshatit Kolloleq është e tipit shpërndarës, ku kohëve të fundit ka tentime të zvogëlimit të numrit të banorëve për shkak të shpërnguljeve në drejtim të qytetit të Kamenicës, si dhe vendeve tjera të Kosovës dhe jashtë saj. Në mes fshatit kalon rruga, e cila lidhë disa fshatra të komunës nga ato veriore me pjesën jugore. Për rreth fshatit kalon lumi i Hogoshtit, i cili shkon në drejtim të luginës që bashkohet me lumin e Desivojcës, ku së bashku derdhen në Lumin “Morava”, shërbimet janë në qendër të fshatit (shkolla, ambulanca, shitore ushqimore).

Kolloleqi ka funksion agrar dhe blektoral një funksional. Ky vendbanim shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, arsimimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. I gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes 100% shfrytëzohet nga puset, sistemi i ujësjellësit nuk ekziston, po ashtu nuk ekziston edhe sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza.

**Pasuritë natyrore të këtij fshati janë:** Bentonitet.

Shtëpitë në fshatin Kolloleq janë të ndërtuara me material mesatarisht të fortë. Në këtë fshat nuk ka objekte me rëndësi arkitektonike apo me ndonjë rëndësi të veçantë. Pasuri natyrore të këtij fshati është: toka bujqësore mjaft pjellore (klasa e II- III).

Në Kolloleq zhvillohen këto veprimtari: bujqësia dhe blegtoria .

### Problemet momentale

Si probleme kryesore në fshatin Kolloleq dhe më të theksuara janë: mungesa e kanalizimit (trajtimi i ujërave të zeza,) mungesa e ujësjellësit, mungesa e grumbullimit të mbeturinave , deponitë e egra, rrugët e pa asfaltuara në disa lagje.

### **Kufiri momental ndërtimor**

Fshati Kolloleq është vendbanim i tipit shpërndarës me elemente të zhvillimeve lineare, përgjatë rrugëve të fshatit dhe rrugës kryesore të fshatit.



**Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Kolloleqit**

### **Kufiri ndërtimor i propozuar**

Për shkak të ruajtjes së kompaktësisë së vendbanimit dhe ruajtjes së tokës bujqësore (klasa II dhe IV) jemi të detyruar që t'i vejmë kufijtë e ndërtimeve të pa kontrolluara, fig. 2.



**Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Kolloleq**

### **Zhvillimet kryesore**

Si zhvillim kryesor në këtë fshat janë: asfaltimi dhe zgjerimi i rrugëve të fshatit, ndriçimi publik, ndërtimi i trotuareve përgjatë rrugëve, trajtimi i ujërave të zeza si dhe ujërave atmosferike, rregullimi shtratit të lumit, shtrimi i rrugëve bujqësore, ndërtimi i fushave sportive, turizmi rekreativ.

## Fshati Kopërnice

### Profili i vendbanimit

Shtrihet rrëzë kodrave, të cilat ndajnë pjesën kodrinore me atë rrafshinore, rreth 9 km në pjesën verilindore të Kamenicës. Ka sipërfaqe 833 ha. Toka punuese – fusha shtrihet në jug të fshatit, që kufizohet me fshatin Kolloleq. Rëndësi të veçantë ka rruga Hogosht- Kopërnice – Kamenice. Në arat nën fshat, janë gjetur pjesë të tullave e tjegullave të ndryshme të mbetura nga kohërat e lashta, siç thuhet nga gojdhënat se ato janë nga koha ilire. Thuhet se ishte një vendbanim i madh me mbi 5.000 banorë. Me ardhjen e Bizantit u shkatërrua tërësisht. Tani mbeten vetëm gjurmët e ndryshme, si Kështjella (Kalaja), e cila ekziston edhe sot. Gjatë lavrimeve të tokave janë gjetur tulla, tjegulla, themele shtëpish e shenja të varrezave ILIRE etj.

Numri i banorëve (jo shënime zyrtare, por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Kopërnica ka pasur gjithsej 1462 banorë.

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 jep këta numra a shifra: 248 ndërtesa, 248 banesa, 43 banesa të pa banuara, 207 ekonomi familjare; ndërsa sipas gjinisë 657 banorë të gjinisë mashkullore, 601 të asja femërore dhe gjithsej **1258 banorë**.

### Tipologjia

Shtrirja e fshatit Kopërnice është e tipit dispers (të shpërndarë). Shërbimet janë në periferi të fshatit (shkolla, xhamia, etj). Kopërnica është vendbanim i tipit individual.

Kopërnica ka funksion agrar një funksional. Ky vendbanim shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, arsimimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. Gati i gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes 90% shfrytëzohet nga pusët dhe ujësjellësi i sapondërtuar. Sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza është rregulluar në tërësi, ujërat e zeza derdhen në lumin e fshatit, mungon sistemi i filtrimit.

**Pasuritë natyrore të këtij fshati janë:** kallaji, shkëmbinj gnais, shkëmbinj dollomit.

Shtëpitë në fshatin Kopërnice, janë të ndërtuara me material të fortë. Në këtë fshat objekt me rëndësi është kalaja e fshatit, e cila ndodhet në veri të fshatit, ku ka një shtrirje nga kodra deri te Lumi i “Lelenc”. Pasuritë natyrore të këtij fshati janë : guri gëlqeror dhe kuarci, peizazhet e bukura, pyje, koriet, kullosat për blegtori, toka bujqësore mjaft pjellore (klasa e II, III dhe IV e bonitetit).

Kopërnica ka një peizazh mjaft atraktiv e gjithashtu mjaft i përshtatshëm për ndërtime, ku këtë ia mundëson kontura e terrenit.

Në Kopërnice zhvillohen këto veprimtari: zejtaria (ndërtimtari, makineri, elektrik-elektroteknik, hidraulik dhe teknologji informative), bujqësia, ekziston mulliri elektrik “Prapashtica”, blegtorja, bletaria dhe tregtia.

### Relievi dhe hidrografia

Kopërnica shtrihet rreth luginave të lumenjve “Lelenc”, i cili rrjedh në pjesën lindore të lagjës së Epërme të fshatit dhe të lumit të Kopërnices, në të dy anët e të cilit shtrihen shtëpitë e lagjes së Poshtme.


Në veri kufizohet me zona kodrinore, këto kodra, që kanë pamjen e një rrafshnalte, janë të përthyera me lugje të ngushta, me lugina të formuara nga përrenj të shumtë, të cilët zakonisht kanë ujë në sasi më të madhe kur të rershurat janë të shumta.

Lumenjtë lëshohen nga pjesa veriore e fshatit, ndërsa pasi bashkohen në jug të fshatit, derdhen në lumin e Hogoshtit.

Nëpër këta dy lumenj janë ndërtuar mullinjtë, ku banorët e fshatit kanë bluar drithërat.

### **Kufiri momental ndërtimor**


Fshati Kopërnice është vendbanim i tipit shpërndarës me elemente të zhvillimeve lineare, përgjatë rrugëve të fshatit dhe rrugës kryesore të fshatit.



**Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Kopërnices**

### **Kufiri ndërtimor i propozuar**

Për shkak të ruajtjes së kompaktësisë së vendbanimit dhe ruajtjes së tokës bujqësore (klasa II dhe IV), jemi të detyruar që t'i vejmë kufijtë e ndërtimeve të pakontrolluara.



**Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Kopërnice**

### **Zhvillimet kryesore**

Si zhvillime kryesore në këtë fshat janë: asfaltimi dhe zgjerimi i rrugëve të fshatit, ndriçimi publik, ndërtimi i trotuareve përgjatë rrugëve, trajtimi i ujërave të zeza si dhe ujërave atmosferike, rregullimi i shtratit të lumit, shtrimi i rrugëve bujqësore, ndërtimi i fushave sportive, turizmi rekreativ dhe projekte të veçanta për eksplorimin e zonave arkeologjike.



## Fshati Koretin

### Profili i vendbanimit

Shtrihet 2-3 km në jug të Kamenicës me një sipërfaqe prej 1127 ha, është vendbanim i vjetër, është vend tipik rrafshinor, ku në mes të fshatit shtrihet Lumi “Kriva Reka” i cili e ndanë fshatin në dy pjesë. Emrin e ka marrë nga hyjnesha ilire e ujit Bind. Në këtë lokalitet janë ruajtur mikrotoponimet e një xhamie dhe një kishe ilire- dardane.

Numri i banorëve ( jo shënime zyrtare, por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Koretini ka pasur gjithsej **3502 banorë**.

Regjistrimi i popullsisë ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 jep këta numra a shifra: 782 ndërtesa, 794 banesa, 196 banesa të pa banuara, 598 ekonomi familjare; ndërkaq ka këtë strukturë gjinore 1742 banorë të gjinisë mashkullore, 1736 të asaj femërore, si dhe gjithsej **3478 banorë**.

### Tipologjia

Shtirja e fshatit Koretin është e tipit kompakt, është vendbanim i tipit individual.Koretini ka funksion agrar një funksional. Ky vendbanimi shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, arsimimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. Gati i gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes 95% shfrytëzohet nga ujësjellsi dhe puset. Sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza dhe atyre atmosferike është i zgjidhur me rrjete bashkohore në tërësi, ujrat e zeza derdhen në lumin Kriva Reka.

**Pasuritë natyrore të këtij fshati janë:** shkëmb argjilor, zhavorr, tufi.

Shtëpitë në fshatin Koretin janë të ndërtuara me material të fortë. Në këtë fshat nuk ka objekte me rëndësi arkitektonike apo me ndonjë rëndësi të veçant. Pasuritë natyrore të këtij fshati janë: Lumi “Kriva Reka” i cili ka burimin dhe kalon përmes këtij fshati, peizazhet e bukura, korriet, toka bujqësore një pjesë përgjatë lumit kriva reka është mjaft pjellore (klasa e II, III dhe IV e bonitetit).

Koretini ka një peizazh mjaft atraktiv dhe është mjaft i përshtatshëm për ndërtime, këtë ia mundëson relievi i terrenit.


Në Koretin zhvillohen këto veprimtari: zejtaria (ndërtimtari, makineri, elektrik-elektroteknik, hidraulik, automekanik, transport autobusazh, pompa benzine, përpunim i drurit dhe teknologji informative) bujqësia dhe tregtia.

### Problemet momentale

Si probleme kryesore në fshatin Koretin më të theksuara janë: trajtimi i ujërave të zeza, ato derdhen drejt në lumë, mungesa e grumbullimit të mbeturinave në disa lagje, deponitë e egra, rrugët e pa asfaltuara në disa lagje, ngrohtorja qendrore, shtëpia e kulturës etj.

### **Kufiri momental ndërtimor**


Fshati Koretin është vendbanim i tipit shpërndrës me elemente të zhvillimeve linear përgjatë rrugëve të fshatit dhe rrugës kryesore të fshatit



**Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Koretinit**

### **Kufiri ndërtimor i propozuar**

Për shkak të ruajtjes së kompaktësisë së vendbanimit dhe ruajtjes së tokës bujqësore (klasa II dhe IV) jemi të detyruar që 'ti vejmë kufijtë e ndërtimeve të pa kontrolluara.



**Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Koretin**

### **Zhvillimet kryesore**

Si zhvillim kryesor në këtë fshat janë: asfaltimi dhe zgjerimi i rrugëve të fshatit, ndriçimi publik, ndërtimi i trotuareve përgjatë rrugëve, trajtimi i ujërave të zeza si dhe ujërave atmosferik, rregullimi i shtratit të lumit, shtrimi i rrugëve bujqësore, ndërtimi i fushave sportive, projekte të veçanta për eksplorimin e zonave arkeologjike.

## Fshati Kostadincë

### Profili i vendbanimit

Shtrihet rreth 12 km në veri të Kamenicës, është fshat i tipit kodrinor malor me shtrirje të shpërndarë, ka sipërfaqe 526 ha. Numri i banorëve (jo shënime zyrtare por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Kostadinca ka pasur gjithsej 50 banorë.

Regjistrimi i popullsisë ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 jep këta numra a shifra: 32 ndërtesa, 32 banesa, 19 banesa të pa banuara, 48 ekonomi familjare; ndërkaq përbërja e popullsisë ka 28 banorë të gjinisë mashkullore, 20 të asaj femërore, si dhe **gjithsej 48 banorë**.

### Tipologjia

Shtrirja e fshatit Kostadincë është e tipit të shpërndarë, shërbimet janë larg nga fshati (shkolla, qendra e mjekësisë familjare) kryhen në qytetin e Kamenicës. Kostadinca është vendbanim i tipit individual. Popullsia në këtë fshat është shpërngulur në mënyrë masive, ku për një periudhë kohore 30 vjeçare është zvogëluar aq shumë, sa që kanë mbetur shumë pak, pra është afër depopullimit të plotë. Drejtimet e migrimit të popullsisë janë të brendshme dhe të jashtme. Një numër i kësaj popullate ka imigruar në qendrën lokale të kësaj komune (Kamenicë) por një numër i konsiderueshëm ka migruar në qytetet tjera të Kosovës.

Ky vendbanim, shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, arsimimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. I gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes shfrytëzohet nga burimet natyrore (krojet), sistemi i ujësjellësit nuk ekziston, po ashtu nuk ekziston edhe sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza.

Pasuritë natyrore të këtij fshati janë: shkëmbi gnais, kallaji.

Shtëpitë në fshatin Kostadincë janë të ndërtuara me material klasik.

**Flora dhe Fauna** –Ekziston një florë dhe faunë shumë e begatshme, si p.sh. flora karakterizohet me numër të madh të bimëve, sidomos të atyre të larta drusore gjethërenëse si: ahui, bungu, qarri, blini, akacia, shkoza, frashëri etj. Po ashtu pothuajse, të gjitha pemët frutore të grupit faror, grupit bërthamor, arror si dhe të atyre manore - dredhëza, manaferra, mjedra etj. Gjithashtu, është mjaft e pasur me bimë barishtore të llojllojshme, të gjitha llojet e drithërave (gruri, tërshëra, elbi, misri etj.). Nga shtazët e egra takojmë: derra, dhelpra, ujq, lepuj etj. Prej shpezëve të egra: pula e egër, thëllëza, skiftëri, huti etj. Po ashtu ka edhe zvarranikë, si gjarpërinj, bolla etj. Bimë foragjere (jonxhe, tërfil i kuq, telish etj.). Sa i përket faunës, po ashtu është e pasur si me kafshë të egra, ashtu edhe me kafshë të tjera, pra është një potencial i mirë për gjueti.

### Problemet momentale

Si probleme kryesore në fshatin Kostadincë dhe më të theksuara janë: shkolla, qendra e mjekësisë familjare, mungesa e rrugës, trajtimi i ujërave të zeza, mungesa e ujësjellësit, mungesa e grumbullimit të mbeturinave, deponitë e egra, rrugët e pa asfaltuara.

### **Kufiri momental ndërtimor**

Fshati Kostadincë është vendbanim i tipit të shpërndarë.



**Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Kostadincës**

### **Kufiri ndërtimor i propozuar**

Për shkak të ruajtjes së tokës bujqësore, kullorave dhe kompaktësimit të fshatit jemi të detyruar që t'i vejmë kufijtë e ndërtimeve,



**Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Kostadincë**

### **Zhvillimet kryesore**

Si zhvillime kryesore që i ndihmojnë ekonomisë dhe qarkullimit të mallrave në këtë fshat janë: zgjerimi i rrugëve të fshatit, rregullimi i ndriçimit publik, asfaltimi i rrugëve, ndërtimi i ujësjellësit, kanalizimi, shtrimi i rrugëve bujqësore, projekte të veçanta për ferma (blegtori).

## Fshati Kranidell

### Profili i vendbanimit

Shtrihet rreth 30 km në verilindje të Kamenicës, është fshat i tipit kodrinoro malor me shtrirje të shpërndarë , ka sipërfaqe 986 ha. Numri i banorëve ( jo shënime zyrtare, por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Kranidelli ka pasur gjithsej **239 banorë**.

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 jep këta numra a shifra: 75 ndërtesa, 75 banesa, 51 banesa të pa banuara, 24 ekonomi familjare; ndërkaq struktura e popullsisë ka këtë përbërje: 67 banorë të gjinisë mashkullore, 64 të asaj femërore, si dhe gjithsej **131 banorë**.

### Tipologjia

Shtrirja e fshatit Kranidell është e tipit të shpërndarë, shërbimet janë në qendër të fshatit (shkolla). Kranidelli është vendbanim i tipit individual. Popullsia në këtë fshat, është në shpërngulje e sipër, ku për një periudhë kohore 24 vjeçare është zvogëluar aq shumë sa që kanë mbetur shumë pak. Drejtimet e migrimit të popullsisë janë të brendshme dhe të jashtme. Një numër i kësaj popullate ka imigruar në qendrën lokale të kësaj komune (Kamenicë), por një numër i konsiderueshëm ka migruar në qytetet tjera të Kosovës, sidomos në Gjilan dhe Prishtinë.

Ky vendbanim shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, arsimimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. I gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes shfrytëzohet nga burimet natyrore (krojet), sistemi i ujësjellësit nuk ekziston, po ashtu nuk ekziston edhe sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza.

Pasuritë natyrore të këtij fshati janë: shkëmbinj granit, hekur, antimon.

Shtëpitë në fshatin Kranidell janë të ndërtuara me material klasik. Në këtë fshat nuk ka objekte me rëndësi arkitektonike.

**Flora dhe Fauna** –Ekziston një florë dhe faunë shumë e begatshme , si p.sh. flora karakterizohet me numër të madh të bimëve, sidomos të atyre të larta drusore gjethrënëse si: ahu, bungu , qarri, blini, akacia, shkoza, frashëri etj. Po ashtu pothuajse, të gjitha pemët frutore të grupit faror, grupit bërthamor, arror si dhe të atyre manore - dredhëza, manaferra, mjedra etj. Gjithashtu, është mjaft e pasur me bimë barishtore të llojllojshme, të gjitha llojet e drithërave ( gruri, tërshëra, elbi, misri etj.). Nga shtazët e egra takojmë : derrin ,dhelpren, ujkun, kaprrrollin, dhinë e egër, lepurin etj. Prej shpezëve të egra : pula e egër , thëllëza, skiftërëi, huti etj. Po ashtu, ka edhe zvarranikë, si gjarpërinj, bolla etj. Bimë foragjere ( jonxhe ,tërfil i kuq, telish etj.). Sa i përket faunës , po ashtu është e pasur si me kafshë të egra, ashtu edhe me kafshë të tjera, pra është një potencial i mirë për gjueti.

### Problemet momentale

Si probleme kryesore në fshatin Kranidell më të theksuara janë: trajtimi i ujërave të zeza, mungesa e ujësjellësit, mungesa e grumbullimit të mbeturinave , deponitë e egra, rrugët e pa asfaltuara.

\

### **Kufiri momental ndërtimor**

Fshati Kranidell është vendbanim i tipit të shpërndarë.



**Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Kranidellit**

### **Kufiri ndërtimor i propozuar**

Për shkak të ruajtjes së tokës bujqësore, kullosave dhe kompaktësimit të fshatit jemi të detyruar që t'i vejmë kufijtë e ndërtimeve.



**Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Kranidell**

### **Zhvillimet kryesore**

Si zhvillime kryesore që i ndihmojnë ekonomisë dhe qarkullimit të mallrave në këtë fshat janë: zgjerimi i rrugëve të fshatit, rregullimi i ndriçimit publik, shtruarja e trotuareve të rrugës, asfaltimi i rrugëve brenda fshatit, ndërtimi i ujësjellësit, kanalizimi, shtrimi i rrugëve bujqësore, rruga Muçivërc – Kranidell, ndërtimi i fushave sportive, projekte të veçanta për eksplorimin e zonave arkeologjike, si dhe zhvillim në përpunimin e industrisë së drurit dhe atë të metaleve.

## Fshati Kremenatë I

### Profili i vendbanimit

Shtrihet rreth 12 km në veriperëndim të Kamenicës, është fshat i tipit kodrinoro malor me shtrirje të shpërndarë, ka sipërfaqe 687 ha. Numri i banorëve ( jo shënime zyrtare, por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Kremenata i ka pasur gjithesej **180 banorë**.

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 jep këto të dhëna: 36 ndërtesa, 35 banesa, 1 banesë e pa banuar, 7 ekonomi familjare; ndërkaq struktura e popullsisë ka, 4 banorë të gjinisë mashkullore, 3 banorë të gjinisë femërore, si dhe gjithsej **7 banorë**.

### Tipologjia

Shtrirja e fshatit Kremenatë I, është e tipit të shpërndarë, shërbimet janë largë nga fshati (shkolla, qendra e mjekësisë familjare ) kryhen në fshatin Strezoc dhe qytetin e Kamenicës. Kremenata i është vendbanim i tipit individual. Popullsia në këtë fshat është shpërngulur në mënyrë masive, ku për një periudhë kohore 30 vjeçare është zvogëluar aq shumë, sa që kanë mbetur shumë pak, pra është afër depopullimit të plotë. Drejtimet e migrimit të popullsisë janë të brendshme dhe të jashtme. Një numër i kësaj popullate ka imigruar në qendrën lokale të kësaj komunë (Kamenicë), por një numër i konsiderueshëm ka migruar në qytetet tjera të Kosovës.

Ky vendbanim shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, arsimimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. I gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes shfrytëzohet nga burimet natyrore (krojet), sistemi i ujësjellësit nuk ekziston, po ashtu nuk ekziston edhe sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza. Pasuritë natyrore të këtij fshati janë: shkëmbinj dollomiti, kuarc.

Shtëpitë në fshatin Kremenatë I janë të ndërtuara me material klasik.

**Flora dhe Fauna** –Ekziston një florë dhe faunë shumë e begatshme , si p.sh. Flora karakterizohet me nr. të madh të bimëve, sidomos të atyre të larta drusore gjethërënëse si: ahuj, bungu , qarri, blini, akacia, shkoza, frashëri etj. Po ashtu pothuajse, të gjitha pemët frutore të grupit faror, grupit bërthamor, arror si dhe të atyre manore - dredhëza, manaferra,mjedra etj. Gjithashtu, është mjaft e pasur me bimë barishtore të llojllojshme, të gjitha llojet e drithërave ( gruri, tërshëra, elbi, misri etj.); Nga shtazët e egra takojmë : derrin, dhelprën, ujkun, lepurin etj. Prej shpezëve të egra : pula e egër , thëllëza, skiftërëi, huti etj. Po ashtu, ka edhe zvarranikë, si gjarpërinj, bolla etj. Bimë foragjere ( jonxhe, tërfil i kuq, telish etj.) Sa i përket faunës, po ashtu është e pasur si me kafshë të egra, ashtu edhe me kafshë të tjera, pra është një potencial i mirë për gjueti.

### Problemet momentale

Si probleme kryesore në fshatin Kremenatë I dhe më të theksuara janë: shkolla, qendra e mjekësisë familjare, mungesa e rrugës, trajtimi i ujërave të zeza, mungesa e ujësjellësit, mungesa e grumbullimit të mbeturinave, deponitë e egra, rrugët e pa asfaltuara.

### **Kufiri momental ndërtimor**

Fshati Kremenatë I është vendbanim i tipit të shpërndarë.



**Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Kremenatës I**

### **Kufiri ndërtimor i propozuar**

Për shkak të ruajtjes së kompaktësisë së vendbanimit dhe ruajtjes së tokës bujqësore (klasa II dhe IV), jemi të detyruar që t'i vejmë kufijtë e ndërtimeve të pa kontrolluara.



**Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Kremenatë I**

### **Zhvillimet kryesore**

Si zhvillime kryesore që i ndihmojnë ekonomisë dhe qarkullimit të mallrave në këtë fshat janë: rregullimi i rrugëve të fshatit, asfaltimi i rrugëve të fshatit, ndërtimi i ujësjellësit, kanalizimi, shtrimi i rrugëve bujqësore, ndërtimi i fushave sportive, projekte të veçanta për eksplorimin e zonave arkeologjike, si dhe zhvillim në përpunimin e industrisë së drurit dhe atë të metaleve.



## Fshati Kremenatë II

### Profili i vendbanimit

Shtrihet rreth 12 km në veriperëndim të Kamenicës, është fshat i tipit kodrinoro malor me shtrirje të shpërndarë , ka sipërfaqe 216 ha, Numri i banorëve ( jo shënime zyrtare por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Kremenata II ka pasur gjithesej 70 banorë.

Regjistrimi i popullsisë ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 ka dhënë shënime tepër shqetësuese, sepse janë gjetur 17 ndërtesa, të gjitha të pa banuara. Pra, struktura e popullatës është 0 banorë.

### Tipologjia

Shtrirja e fshatit Kremenata II është e tipit të shpërndarë, shërbimet janë largë nga fshati (shkolla, qendra e mjeksisë familjare, ) janë kryer në fshatin Strezoc dhe qytetin e Kamenicës. Kremenata II ishte vendbanim i tipit individual. Popullsia në këtë fshat është shpërngulur në mënyrë masive, tërësisht. Drejtimet e migrimit të popullsisë janë të brendshme dhe të jashtme. Një numër i kësaj popullate ka imigruar në qendrën lokale të kësaj komune (Kamenicë) por një numër i konsiderueshëm është shpërngulur në qytetet tjera të Kosovës.

Ky vendbanim ka shërbyer për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, arsimimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. Gjithë fshati për ngrohje ka shfrytëzuar drurin. Uji i pijes shfrytëzohet nga burimet natyrore (krojet), sistemi i ujësjellësit nuk ekziston, po ashtu nuk ekziston edhe sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza.

Pasuritë natyrore të këtij fshati janë: Shkëmb Gnais, kuarc.

Shtëpitë në fshatin Kremenata II janë të ndërtuara me material klasik.

**Flora dhe Fauna** –Ekziston një florë dhe faunë shumë e begatë, si p.sh. Flora .: flora karakterizohet me numër të madh të bimëve, sidomos të atyre të larta drusore gjethërnëse si: ahu, bungu , qarri, blini, akacia, shkoza, frashri, thana, lajthia etj. Po ashtu pothuajse, të gjitha pemët frutore të grupit faror, grupit bërthamor, arror si dhe të atyre manore - dredhëza, manaferra, mjedra etj. Gjithashtu, është mjaft e pasur me bimë barishtore të llojllojshme, të gjitha llojet e drithërave ( gruri, tërshëra, elbi, thekra, misri etj.); Nga shtazët e egra takojmë : derrin, dhelpërën, ujkun, lepurin, dhinë e egër, kaprrollin, macen e egër etj. Prej shpezëve të egra : pula e egër , thëllëza, skiftëri, shqiponja, huti etj. Po ashtu, ka edhe zvarranikë, si: gjarpërinj, bolla etj. Bimë foragjere ( jonxhe ,tërfili i kuq, telishi etj.). Sa i përket faunës , po ashtu është e pasur si me kafshë të egra, ashtu edhe me kafshë të tjera, prandaj është një potencial i mirë për gjueti.

Si probleme kryesore në fshatin Kremenata II më të theksuara jqenë: shkolla, qendra e mjekësisë familjare, mungesa e rrugës, trajtimi i ujërave të zeza, mungesa e ujësjellësit, mungesa e grumbullimit të mbeturinave , deponitë e egra, rrugët e pa asfaltuara.

## Kufiri momental ndërtimor

Fshati Kremenata II vendbanim i tipit të shpërndarë.



Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Kremenatës II

## Kufiri ndërtimor i propozuar

Për shkak të ruajtjes së tokës bujqësore, kullosave dhe kompaktësimit të fshatit jemi të detyruar që t'i vejmë kufijtë e ndërtimeve.



Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Kremenatë II.

## Zhvillimet kryesore

Si zhvillime kryesore që i ndihmojnë ekonomisë dhe qarkullimit të mallrave në këtë fshat janë: rregullimi i rrugëve të fshatit, asfaltimi i rrugëve të fshatit, ndërtimi i ujësjellësit, kanalizimi, shtrimi i rrugëve bujqësore, ndërtimi i fushave sportive, projekte të veçanta për eksplorimin e zonave arkeologjike si dhe zhvillim në përpunimin e industrisë së drurit dhe atë të metaleve.

## Fshati Krilevë

### Profili i vendbanimit

Shtrihet përgjatë Lumit "Kriva Reka", 17 km në veriperëndim të Kamenicës, është fshat i tipit kodrinor malor me shtrirje të shpërndarë lineare, ka sipërfaqe 1686 ha. Krileva është vendbanim i lashtë, më shumë se 2000 vjet. Çdo herë kishte popull shumicë iliro – shqiptar. Bënte pjesë nën mbretërinë e Dardanisë, pastaj bie nën romakët e Bizantin, Serbinë, Perandorinë Osmane dhe Italinë.

Krileva kishte: kishë, një kala qytezë, treg antik, shkritore hekuri, ka qenë e lidhur dretperdrejt me Novobërdën (Artana e sotme). Për të gjitha këto të dhëna që u përmendën, ekzistojnë gjurmët në këtë vendbanim.

Numri i banorëve sipas shënimeve zyrtare në vitin 1948 ishte 927; më 1953 kishte 991; më 1961 kishte 1098; më 1971 kishte 1177 banorë. Kurse sipas shënimeve jo zyrtare, por të dhëna nga këshillat lokale në vitin 1998 Krileva ka pasur gjithsej 1184 banorë.

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 jep këta numra a shifra: 144 ndërtesa, 144 banesa, 49 banesa të pa banuara, 96 ekonomi familjare; ndërkaq ka: 300 banorë të gjinisë mashkullore, 286 banorë të asaj femërore, si dhe gjithsej **586 banorë**.

### Tipologjia

Shtrirja e fshatit Krilevë është e tipit të shpërndarë – linear, shërbimet janë në fshat (shkolla, ambulanca, xhamia). Krileva është vendbanim i tipit individual. Popullsia në këtë fshat është shpërngulur në mënyrë të theksuar, ku për një periudhë kohore 10 vjeçare është zvogëluar dukshëm. Drejtimet e migrimit të popullsisë janë të brendshme dhe të jashtme. Një numër i kësaj popullate ka imigruar në qendrën lokale të kësaj komune (Kamenicë), por një numër i konsiderueshëm ka migruar në qytetet tjera të Kosovës si dhe jashtë Kosovës.

Ky vendbanim shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, arsimimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. I gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes shfrytëzohet nga burimet natyrore (krojet), sistemi i ujësjellësit nuk ekziston, po ashtu nuk ekziston edhe sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza, derdhen në Lumin "Kriva Reka". Pasuritë natyrore të këtij fshati janë: shkëmbinj të andezitit, antimon. Shtëpitë në fshatin Krilevë janë të ndërtuara me material mesatarisht të forta.

**Flora dhe Fauna** –Ekziston një florë dhe faunë shumë e begatshme, si p.sh. flora karakterizohet me numër të madh të bimëve, sidomos të atyre të larta drusore gjethërenëse si: ahu, bungu, qarri, akacia, shkoza, frashëri etj. Po ashtu pothuajse, të gjitha pemët frutore të grupit faror, grupit bërthamor, arror si dhe të atyre manore - dredhëza, manaferra, mjedra etj. Gjithashtu, është mjaft e pasur me bimë barishtore të llojllojshme, të gjitha llojet e drithërave (gruri, tërshëra, elbi, misri etj.). Nga shtazët e egra takojmë: derrin, dhelprën, ujkun, lepurin etj. Prej shpezëve të egra: pula e egër, thëllëza, skiftëri, huti, lejleku etj. Po ashtu ka edhe zvarranikë, si gjarpërinj, bolla etj. Bimë foragjere (jonxhe, tërfil i kuq, etj.). Sa i përket faunës, po ashtu është e pasur si me kafshë të egra, ashtu edhe me kafshë të tjera.

### Problemet momentale

Si probleme kryesore në fshatin Krilevë dhe më të theksuara janë: shkolla, qendra e mjekësisë familjare, ndotja e lumit nga miniera, trajtimi i ujërave të zeza, mungesa e ujësjellësit, mungesa e grumbullimit të mbeturinave, deponitë e egra, rrugët e pa asfaltuara nëpër lagje, hapësirat për sport dhe rekreacion, ndriçimi publik, trotuaret, rregullimi i shtratit të lumit përmes fshatit.

### **Kufiri momental ndërtimor**

Fshati Krilevë është vendbanim i tipit të shpërndarë me elemente të zhvillimit linear, me ndërtime të pa kontrolluara.



**Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Krilevës**

### **Kufiri ndërtimor i propozuar**

Për shkak të ruajtjes së kompaktësisë së vendbanimit dhe ruajtjes së tokës bujqësore dhe zonave rekreative jemi të detyruar që t'i vejmë kufijtë e ndërtimeve të pa kontrolluara



**Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Krilevë**

### **Zhvillimet kryesore**

Si projekte kryesore që i ndihmojnë zhvillimit të këtij fshati janë: projektet për kthim të banorëve, të cilët e kanë braktisur fshatin, rregullimi i infrastrukturës rrugore nëpër lagje, ndërtimi i shkolles, ndërtimi i ujësjellësit, futja e ujërave të zeza në sistem të kanalizimit nëpër të gjitha lagjet dhe trajtimi i tyre (impianetet), turizmi i gjuetisë, ofrimi i infrastrukturës për zhvillim të turizmit malor, projekte të veçanta për eksplorimin e zonave arkeologjike si dhe ruajtjen e tyre.

## Fshati Lajçiq

### Profili i vendbanimit

Shtrihet rreth 34 km në verilindje të Kamenicës, dhe në mes të fshatit kalon lumi i Desivojcës. Është fshat i tipit kodrinor malor me shtrirje të shpërndarë , ka sipërfaqe 919 ha. Numri i banorëve ( jo shënime zyrtare, por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Lajçiqi ka pasur gjithsej **467 banorë**.

Regjistrimi i popullsisë ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 ka dhenë këta numra a shufra: 57 ndërtesa, 58 banesa, 30 banesa të pa banuara, 27 ekonomi familjare, ndërkaq struktura e popullsisë është kjo: 76 banorë të gjinisë mashkullore, 84 banorë të asaj femërore, si dhe gjithsej **160 banorë**.

### Tipologjia

Shtrirja e fshatit Lajçiq është e tipit te shpërndarë, shërbimet janë në qendër të fshatit (shkolla). Fshati është vendbanim i tipit individual. Popullsia në këtë fshat është ne shpërngulje e sipër, ku për një periudhë kohore 24 vjeçare është zvogëluar aq shumë, sa që kanë mbetur shumë pak. Drejtimet e migrimit të popullsisë janë të brendshme dhe të jashtme. Një numër i kësaj popullate ka imigruar në qendrën lokale të kësaj komune (Kamenicë), por një numër i konsiderueshëm ka migruar në qytetet tjera të Kosovës, sidomos në Gjilan dhe Prishtinë.

Ky vendbanim shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, arsimimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. I gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes shfrytëzohet nga burimet natyrore (krojet), sistemi i ujësjellësit nuk ekziston, po ashtu nuk ekziston edhe sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza. Pasuritë natyrore të këtij fshati janë: shkëmbinjtë e granitit.

Shtëpitë në fshatin Lajçiq janë të ndërtuara me material klasik. Në këtë fshat nuk ka objekte me rëndësi arkitektonike.

**Flora dhe Fauna** –Ekziston një florë dhe faunë shumë e begatshme , si p.sh. flora karakterizohet me numër të madh të bimëve, sidomos të atyre të larta drusore gjethërenëse si: ahu, bungu , qarri, blini, akacia, shkoza, frashëri etj. Po ashtu pothuajse, të gjitha pemët frutore të grupit faror, grupit bërthamor, arror si dhe të atyre manore - dredhëza, manaferra, mjedra etj. Gjithashtu, është mjaft e pasur me bimë barishtore të llojllojshme, të gjitha llojet e drithërave ( gruri, tërshëra, elbi, misri etj.); Nga shtazët e egra takojmë : derrin, dhelprën, ujkun, kaprrollin (drerin), dhinë e egër, lepurin etj. Prej shpezëve të egra : pula e egër , thëllëza, skiftëri, huti etj. Po ashtu, ka edhe zvarranikë si gjarpërinj, bolla etj. Bimë foragjere ( jonxhe, tërfil i kuq, telish etj.). Sa i përket faunës , po ashtu është e pasur si me kafshë të egra, ashtu edhe me kafshë të tjera, pra është një potencial i mirë për gjueti.

### Problemet momentale

Si probleme kryesore në fshatin Lajçiq e më të theksuara janë: trajtimi i ujërave të zeza, mungesa e ujësjellësit, mungesa e grumbullimit të mbeturinave , deponitë e egra, rrugët e pa asfaltuara.

## Kufiri momental ndërtimor

Fshati Lajçiq është vendbanim i tipit të shpërndarë.



Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Lajçiqit

## Kufiri ndërtimor i propozuar

Për shkak të ruajtjes së tokës bujqësore, kullosave dhe kompaktësimit të fshatit jemi të detyruar që t'i vejmë kufijtë e ndërtimeve.



Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Lajçiq

## Zhvillimet kryesore

Si zhvillime kryesore që i ndihmojnë ekonomisë dhe qarkullimit të mallrave në këtë fshat janë: zgjerimi i rrugëve të fshatit, rregullimi i ndriçimit publik, shtruarja e trotuareve të rrugës, asfaltimi i rrugëve brenda fshatit, ndërtimi i ujësjellësit, kanalizimi, shtrimi i rrugëve bujqësore, rruga Shipashnicë e Epërme – Lajçiq, ndërtimi i fushave sportive, projekte të veçanta për eksplorimin e zonave arkeologjike, projekte të veçanta për përpunimin e drurit si dhe zhvillimin e turizmit.

## Fshati Leshtar

### Profili i vendbanimit

Shtrihet rreth 15 km në veriperëndim të Kamenicës, është fshat i tipit kodrinor malor me shtrirje të shpërndarë , ka sipërfaqe 491 ha. Numri i banorëve ( jo shënime zyrtare, por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Leshtari ka pasur gjithsej 487 banorë.

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 jep këta numra a shifra: 119 ndërtesa, 131 banesa, 48 banesa të pa banuara, 85 ekonomi familjare; ndërkaq popullsia ka këtë përbërje: 228 banorë të gjinisë mashkullore, 221 banorë të asaj femërore, si dhe gjithsej **449 banorë**.

### Tipologjia

Shtrirja e fshatit Leshtar është e tipit te shpërndarë, shërbimet janë larg nga fshati (shkolla, qendra e mjekësisë familjare, xhamia) kryhen në fshatin Strezoc. Leshtari është vendbanim i tipit individual. Popullsia në këtë fshat është shpërngulur në mënyrë masive, ku për një periudhë kohore 24 vjeçare është zvogëluar aq shumë sa që kanë mbetur shumë pak. Drejtimet e migrimit të popullsisë janë të brendshme dhe të jashtme. Një numër i kësaj popullate ka imigruar në qendrën lokale të kësaj komune (Kamenicë), por një numër i konsiderueshëm ka migruar në qytetet tjera të Kosovës, sidomos në Gjilan dhe Prishtinë.

Ky vendbanim shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, arsimimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. I gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes shfrytëzohet nga burimet natyrore (krojet), sistemi i ujësjellësit nuk ekziston, po ashtu nuk ekziston edhe sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza. Pasuritë natyrore të këtij fshati janë: shkëmbinj andeziti, antimon.

Shtëpitë në fshatin Leshtar janë të ndërtuara me material mesatarisaht të fortë.

**Flora dhe Fauna** –Ekziston një florë dhe faunë shumë e begatshme , si p.sh. flora karakterizohet me numër të madh të bimëve, sidomos të atyre të larta drusore gjethërenëse si: ahu, bungu , qarri, blini, akacia, shkoza, frashëri etj. Po ashtu pothuajse, të gjitha pemët frutore të grupit faror, grupit bërthamor, arror si dhe të atyre manore - dredhëza, manaferra, mjedra etj. Gjithashtu, është mjaft e pasur me bimë barishtore të llojllojshme, të gjitha llojet e drithërave ( gruri, tërshëra, elbi, misri etj.); Nga shtazët e egra takojmë : derrin ,dhelpren, ujkun, lepurin etj. Prej shpezëve të egra : pula e egër , thëllëza, skiftëri, huti etj. Po ashtu, ka edhe zvarranikë si gjarpërinj, bolla etj. Bimë foragjere ( jonxhe, tërfil i kuq, telish etj.). Sa i përket faunës , po ashtu është e pasur si me kafshë të egra, ashtu edhe me kafshë të tjera, pra është një potencial i mirë për gjueti.

### Problemet momentale

Si probleme kryesore në fshatin Leshtar e më të theksuara janë: shkolla, qendra e mjekësisë familjare, trajtimi i ujërave të zeza, mungesa e ujësjellësit, mungesa e grumbullimit të mbeturinave , deponitë e egra, rrugët e pa asfaltuara.

## Kufiri momental ndërtimor

Fshati Leshtar është vendbanim i tipit të shpërndarë.



Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Leshtarit

## Kufiri ndërtimor i propozuar

Për shkak të ruajtjes së tokës bujqësore, kullorave dhe kompaktësimit të fshatit jemi të detyruar që t'i vejmë kufijtë e ndërtimeve.



Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Leshtar

## Zhvillimet kryesore

Si zhvillime kryesore që i ndihmojnë ekonomisë dhe qarkullimit të mallrave në këtë fshat janë: zgjerimi i rrugëve të fshatit, rregullimi i ndriçimit publik, asfaltimi i rrugëve të fshatit, ndërtimi i ujësjellësit, kanalizimi, projekte të veçanta për përpunimin e drurit.



## Fshati Lisockë

### Profili i vendbanimit

Shtrihet rreth 16 km në veri të Kamenicës, për rreth kufirti me Serbinë dhe afër majeve më të larta të maleve të Kikës. Është fshat i tipit kodrinor malor me shtrirje të shpërndarë, ka sipërfaqe 795 ha. Numri i banorëve (jo shënime zyrtare, por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Lisocka ka pasur gjithsej 261 banorë.

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 ka dhënë këta numra a shifra: 52 ndërtesa, 52 banesa, 34 banesa të pa banuara, 18 ekonomi familjare; ndërkaq popullsia ka këtë përbërje: 54 banorë të gjinisë mashkullore, 44 banorë të gjinisë femërore, si dhe gjithsej **98 banorë**

### Tipologjia

Shtrirja e fshatit Lisockë është e tipit të shpërndarë, shërbimet janë larg nga fshati (shkolla, qendra e mjekësisë familjare, xhamia). Lisocka është vendbanim i tipit individual. Popullsia në këtë fshat është shpërngulur në mënyrë masive, ku për një periudhë kohore 24 vjeçare është zvogëluar aq shumë sa që kanë mbetur shumë pak, pra është afër depopullimit të plotë. Drejtimet e migrimit të popullsisë janë të brendshme dhe të jashtme. Një numër i kësaj popullate ka imigruar në qendrën lokale të kësaj komune (Kamenicë), por një numër i konsiderueshëm ka migruar në qytetet tjera të Kosovës, sidomos në Gjilan dhe Prishtinë.

Ky vendbanim shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, arsimimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. I gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes shfrytëzohet nga burimet natyrore (krojet), sistemi i ujësjellësit nuk ekziston, po ashtu nuk ekziston edhe sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza.

Pasuritë natyrore të këtij fshati janë: shkëmbinjtë magmatik, kallaji.

Shtëpitë në fshatin Lisockë janë të ndërtuara me material klasik.

**Flora dhe Fauna** – Ekziston një florë dhe faunë shumë e begatshme, si p.sh. flora karakterizohet me numër të madh të bimëve, sidomos të atyre të larta drusore gjethërenëse si: ahu, bungu, qarri, blini, akacia, shkoza, frashëri etj. Po ashtu pothuajse, të gjitha pemët frutore të grupit faror, grupit bërthamor, arror si dhe të atyre manore - dredhëza, manaferra, mjedra etj. Gjithashtu, është mjaft e pasur me bimë barishtore të llojllojshme, të gjitha llojet e drithërave (gruri, tërshëra, elbi, misri etj.); Nga shtazët e egra takojmë: derrin, dhelpërën, ujkun, lepurin etj. Prej shpezëve të egra: pula e egër, thëllëza, skiftëri, huti etj. Po ashtu, ka edhe zvarranikë si gjarpërinj, bolla etj. Bimë foragjere (jonxhe, tërfil i kuq, telish etj.). Sa i përket faunës, po ashtu është e pasur si me kafshë të egra, ashtu edhe me kafshë të tjera, pra është një potencial i mirë për gjueti.

### Problemet momentale

Si probleme kryesore në fshatin Lisockë e më të theksuara janë: trajtimi i ujërave të zeza, mungesa e ujësjellësit, mungesa e grumbullimit të mbeturinave, deponitë e egra, rugët e pa asfaltuara.

## Kufiri momental ndërtimor

Fshati Lisockë është vendbanim i tipit të shpërndarë.



Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Lisockes

## Kufiri ndërtimor i propozuar

Për shkak të ruajtjes së tokës bujqësore, kullosave dhe kompaktësimit të fshatit jemi të detyruar që t'i vejmë kufijtë e ndërtimeve.



Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Lisockë

## Zhvillimet kryesore

Si zhvillime kryesore që i ndihmojnë ekonomisë dhe qarkullimit të mallrave në këtë fshat janë: zgjerimi i rrugëve të fshatit, rregullimi i ndriçimit publik, asfaltimi i rrugëve brenda fshatit, ndërtimi i ujësjellësit, kanalizimi, asfaltimi i rrugëve që lidhin fshatrat Tuxhec- Gmicë – Gjyrishec- Zhujë- Lisockë- Desivojcë, projekte të veçanta për përpunimin e drurit

## Fshati Marocë

### Profili i vendbanimit

Shtrihet rreth 27 km në verilindje të Kamenicës, është fshat i tipit kodrinor malor me shtrirje të shpërndarë , ka sipërfaqe 228 ha. Numri i banorëve ( jo shënime zyrtare, por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Maroca ka pasur gjithsej **121 banorë**.

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 ka dhënë këta numra a shifra: 10 ndërtesa, 10 banesa, 1 banesë e pa banuar, 9 ekonomi familjare, ndërsa popullsia ka 32 banorë të gjinisë mashkullore, 32 banorë të asaj femërore, si dhe gjithsej **64 banorë**.

### Tipologjia

Shtrirja e fshatit Marocë është e tipit të shpërndarë, shërbimet janë në qendër të fshatit (shkolla). Fshati është vendbanim i tipit individual. Popullsia në këtë fshat është në shpërngulje e sipër, ku për një periudhë kohore 24 vjeçare është zvogëluar aq shumë sa që kanë mbetur shumë pak. Drejtimet e migrimit të popullsisë janë të brendshme dhe të jashtme. Një numër i kësaj popullate ka imigruar në qendrën lokale të kësaj komune (Kamenicë), por një numër i konsiderueshëm ka migruar në qytetet tjera të Kosovës, sidomos në Gjilan dhe Prishtinë.

Ky vendbanim shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, arsimimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. I gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes shfrytëzohet nga burimet natyrore (krojet), sistemi i ujësjellësit nuk ekziston, po ashtu nuk ekziston edhe sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza.

**Pasuritë natyrore** të këtij fshati janë: shkëmbinjtë e granitit.

Shtëpitë në fshatin Marocë janë të ndërtuara me material klasik. Në këtë fshat nuk ka objekte me rëndësi arkitektonike.

**Flora dhe Fauna** – Ekziston një florë dhe faunë shumë e begatshme , si p.sh. flora karakterizohet me numër të madh të bimëve, sidomos të atyre të larta drusore gjethërnëse si: ahu, bungu , qarri, blini, akacia, shkoza, frashëri etj. Po ashtu pothuajse, të gjitha pemët frutore të grupit faror, grupit bërthamor, arror si dhe të atyre manore - dredhëza, manaferra, mjedra etj. Gjithashtu, është mjaft e pasur me bimë barishtore të llojllojshme, të gjitha llojet e drithërave ( gruri, tërshëra, elbi, misri etj.); Nga shtazët e egra takojmë : derrin ,dhelprën, ujkun, lepurin etj. Prej shpezëve të egra : pula e egër , thëllëza, skiftëri, huti etj. Po ashtu, ka edhe zvarranikë si gjarpërinj, bolla etj. Bimë foragjere ( jonxhe, tërfil i kuq, telish etj.). Sa i përket faunës , po ashtu është e pasur si me kafshë të egra, ashtu edhe me kafshë të tjera, pra është një potencial i mirë për gjueti.

### Problemet momentale

Si probleme kryesore në fshatin Marocë e më të theksuara janë: trajtimi i ujërave të zeza, mungesa e ujësjellësit, mungesa e grumbullimit të mbeturinave , deponitë e egra, rrugët e pa asfaltuara.

### **Kufiri momental ndërtimor**


Fshati Marocë është vendbanim i tipit të shpërndarë.



**Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Marocës.**

### **Kufiri ndërtimor i propozuar**

Për shkak të ruajtjes së tokës bujqësore, kullosave dhe kompaktësimit të fshatit jemi të detyruar që t'i vejmë kufijtë e ndërtimeve.



**Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Marocë**

### **Zhvillimet kryesore**

Si zhvillime kryesore që i ndihmojnë ekonomisë dhe qarkullimit të mallrave në këtë fshat janë: zgjerimi i rrugëve të fshatit, rregullimi i ndriçimit publik, shtruarja e trotuareve të rrugës, asfaltimi i rrugëve brenda fshatit, ndërtimi i ujësjellësit, kanalizimi, shtrimi i rrugëve bujqësore, rruga Hogosht – Marocë dhe Shipashnicë e Poshtme - Marocë, ndërtimi i fushave sportive, projekte të veçanta për eksplorimin e zonave arkeologjike.

## Meshinë

### Profili i vendbanimit

Shtrihet rreth 13 km në veri perëndim të Kamenicës, është fshat i tipit kodrinoro malor me shtrirje të shpërndarë , ka sipërfaqe 807 ha, është vend i pasur me pyje si dhe xehe. Meshina është vend i njohur për resurse natyrore. Numri i banorëve ( jo shënime zyrtare, por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Meshina ka pasur gjithëj 131 banorë.

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 ka dhënë këta numra a shifra: 68 ndërtea, 69 banesa, 47 banesa të pa banuara, 22 ekonomi familjare; ndërkaq popullsia përbëhet: 58 banorë të gjinisë mashkullore, 56 banorë të asaj femërore, si dhe gjithsej **114 banorë**

### Tipologjia

Shtrirja e fshatit Meshinë është e tipit te shpërndarë, shërbimet janë larg nga fshati (shkolla, qendra e mjekësisë familjare, xhamia) . Meshina është vendbanim i tipit individual. Popullsia në këtë fshat është shpërngulur në mënyrë masive, ku për një periudhë kohore 30 vjeçare është zvogëluar aq shumë sa që kanë mbetur shumë pak. Drejtimet e migrimit të popullsisë janë të brendshme dhe të jashtme. Një numër i kësaj popullate ka imigruar në qendrën lokale të kësaj komune (Kamenicë), por një numër i konsiderueshëm ka migruar në qytetet tjera të Kosovës, sidomos në Gjilan dhe Prishtinë.

Ky vendbanim shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, arsimimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. I gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes shfrytëzohet nga burimet natyrore (krojet), si dhe puset. Sistemi i ujësjellësit nuk ekziston, po ashtu nuk ekziston edhe sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza.

**Pasuritë natyrore** të këtij fshati janë: shkëmbinj gnais, shkëmbinj graniti.

Shtëpitë në fshatin Meshinë janë të ndërtuara me material mesatarisht të fortë.

**Flora dhe Fauna** – Ekziston një florë dhe faunë shumë e begatshme , si p.sh. flora karakterizohet me numër të madh të bimëve, sidomos të atyre të larta drusore gjetëhënëse si: ahu, bungu , qarri, blini, akacia, shkoza, frashëri etj. Po ashtu pothuajse, të gjitha pemët frutore të grupit faror, grupit bërthamor, arror si dhe të atyre manore - dredhëza, manaferra, mjedra etj. Gjithashtu, është mjaft e pasur me bimë barishtore të llojllojshme, të gjitha llojet e drithërave ( gruri, tërshëra, elbi, misri etj.); Nga shtazët e egra takojmë : derrin ,dhelprën, ujkun, lepurin etj. Prej shpezëve të egra : pula e egër , thëllëza, skiftëri, huti etj. Po ashtu, ka edhe zvarranikë si gjarpërinj, bolla etj. Bimë foragjere ( jonxhe, tërfil i kuq, telish etj.). Sa i përket faunës , po ashtu është e pasur si me kafshë të egra, ashtu edhe me kafshë të tjera, pra është një potencial i mirë për gjueti.

### Problemet momentale

Si probleme kryesore në fshatin Meshinë e më të theksuara janë: rruga e pa asfaltuar, qendra e mjekësisë familjare, trajtimi i ujërave të zeza, mungesa e ujësjellësit, mungesa e grumbullimit të mbeturinave , deponitë e egra, mungesa e lokaleve për argëtim të rinisë.

## Kufiri momental ndërtimor

Fshati Meshinë është vendbanim i tipit të shpërndarë.



**Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Meshinës**

## Kufiri ndërtimor i propozuar

Për shkak të ruajtjes së tokës bujqësore, kullosave dhe kompaktësimit të fshatit jemi të detyruar që t'i vejmë kufijtë e ndërtimeve.



**Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Meshinë**

## Zhvillimet kryesore

Si projekte kryesore që i ndihmojnë zhvillimit të këtij fshati janë: hapja e rrugës së re dhe lidhja e saj me vijën Hajnoc – Kamenicë, hapja e rrugëve të reja brenda fshatit, rregullimi i infrastrukturës rrugore, agroturizmi, turizmi rural dhe turizmi i gjuetisë, ofrim i infrastrukturës për zhvillim të turizmit malor dhe projekte të veçanta për eksplorimin e zonave arkeologjike.

Si zhvillime kryesore që i ndihmojnë ekonomisë dhe çarkullimit të mallrave në këtë fshat janë: zgjerimi i rrugëve të fshatit, asfaltimi i rrugëve brenda dhe jashtë fshatit, ndërtimi i ujësjellësit, kanalizimi, projekte të veçanta për përpunimin e drurit.

## Fshati Moçar

### Profili i vendbanimit

Shtrihet 2 km në juglindje të Kamenicës, është vendbanim fushor i grumbulluar. Ka sipërfaqe 811.5 ha. Në të ka gjurmë të vendbanimit të vjetër.

Numri i banorëve (jo shënime zyrtare, por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Moçari ka pasur gjithsej 318 **banorë**.

Regjistrimi i popullsisë ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 ka dhënë këto shifra: 93 ndërtesa, 93 banesa, 63 banesa të pa banuara, 32 ekonomi familjare; ndërsa struktura e popullatës ka 70 banorë të gjinisë mashkullore, 69 të asaj femërore dhe **gjithsej 139 banorë**

### Tipologjia

Shtrirja e fshatit Moçar është e tipit shpërndarës dhe në mes të fshatit kalon përroi i Stralicës. Kohëve të fundit ka tentime të shtrirjes lineare përgjatë rrugëve, shërbimet janë në periferi të fshatit (shkolla, ambulanca) kryhen në fshatin Berivojcë. Është vendbanim i tipit individual, Moçari ka funksion agrar shumë funksional. Ky vendbanim shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, arsimimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. Të gjithë banorët e fshatit për ngrohje e shfrytëzojnë drurin. Uji i pijes shfrytëzohet nga puset, nuk ekziston sistemi i ujësjellësit. Gjithashtu, nuk ekziston edhe sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza që është i pa trajtuar, në aspektin ekologjik mungon trajtimi i tyre (gropa septike). Ujërat e zeza derdhen në proin e Stralicës e pastaj në Lumin “Kriva Reka” pa u trajtuar.

Shtëpitë në fshatin Moçar janë të ndërtuara me material klasik. Në këtë fshat ka objekte me rëndësi të veçantë arkitektonike, veçmas njihet në historinë e Kamenicës Manastiri i Moçarit nga kohët e lashta bizantine.

**Pasuritë natyrore** të këtij fshati janë: zhavorri, toka pyjore dhe kullosat.


Në Moçar zhvillohen këto veprimtari: bujqësia e blegtoria.

### Problemet momentale

Si probleme kryesore në fshatin Moçar e më të theksuara janë: trajtimi i ujërave të zeza, mungesa e grumbullimit të mbeturinave në disa lagje, deponitë e egra, rrugët e pa asfaltuara në disa lagje.

### **Kufiri momental ndërtimor**

Fshati Moçar është vendbanim i tipit shpërndarës, zhvillimet janë krejtësisht lineare përgjatë rrugës kryesore të fshatit. Shërbimet janë në periferi të fshatit.



**Fig. 1. Kufiri ndërtimor aktual i Moçarit**

### **Kufiri ndërtimor i propozuar**

Për shkak të ruajtjes së tokës bujqësore me bonitet mesatarisht të mirë, kullosave dhe kompaktësimit të fshatit jemi të detyruar që t'i vejmë kufijtë e ndërtimeve, në disa pjesë jemi detyruar që ti ndalojmë ndërtimet.



**Fig. 2. Kufijtë ndërtimor të propozuar të fshatit Moçar**

### **Zhvillimet kryesore**

Si zhvillime kryesor në këtë fshat janë: hapja dhe shtruarja e rrugës që lidhet me fshatin Berivojcë, si dhe rruga që lidhet me qytetin e Kamencës. Zgjerimi i rrugëve të fshatit, rregullimi i ndriçimit publik, shtruarja e trotuareve të rrugëve, asfaltimi i rrugëve brenda fshatit, ndërtimi fushave sportive hapësira për rekreacion, trajtimi i ujërave të zeza, grumbullimi i mbeturinave, rregullimin i përroit që kalon nëpër fshat, shtrimi i rrugëve bujqësore dhe pyjore, pyllëzimi i disa sipërfaqeve, turizmi i gjuetisë, zhvillim i blegtorisë dhe projekte të veçanta për eksplorimin e zonave arkeologjike.



## Fshati Muçivërc

### Profili i vendbanimit

Shtrihet rreth 21 km në juglindje të Kamenicës, ka sipërfaqe 709 ha.

Numri i banorëve (jo shënime zyrtare, por të dhëna nga këshillat lokale) në vitin 1998 Muçivërci ka pasur gjithsej **1575** banorë. Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në prill të vitit 2011 ka reflektuar me këta numra a shifra: 274 ndërtesa, 275 banesa, 29 banesa të pa banuara, 248 ekonomi familjare; ndërkaq popullsia ka; 807 banorë të gjinisë mashkullore, 713 banorë të asaj femërore, si dhe gjithsej **1520 banorë**.

### Tipologjia

Shtirja e fshatit Muçivërc është e tipit shpërndarës dhe në mes të fshatit kalon kanali i ujitjes i ndarë nga lumi i Desivojcës (e thirrur nga banorët si “**Vada e Mullinjve**”), ndërsa në pjesën jugore të fshatit kalojnë Lumi i Desivojcës dhe lumi i Hogoshtit. Ka një rrjet hidrografik, i cili i takon pellgut të Detit të Zi. Kohëve të fundit ka tentime të shtrirjes lineare përgjatë rrugës kryesore të fshatit dhe Rrugës së **Shqiponjave** (rruga për Kranidell). Shërbimet janë në qendër të fshatit (shkolla, xhamia, ambulanca, ofiqaria, stadiumi, stacioni i policisë, posta, stacioni i vetërejnës, kooperativa bujqësore, biblioteka, etj.). Muçivërci është vendbanim i tipit individual.

Fshati ka funksion agrar një funksional. Ky vendbanim shërben për kryerjen e disa funksioneve themelore të jetës së njerëzve: banimin, jetën në bashkësi, funksionin e punës, furnizimin, arsimimin, argëtimin, pushimin, komunikimin etj. Gati i gjithë fshati për ngrohje e shfrytëzon drurin. Uji i pijes shfrytëzohet nga puset, po ashtu në këtë fshat ekziston edhe sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza i pa trajtuar, në aspektin ekologjik mungon trajtimi i tyre (gropa septike) ujërat e zeza derdhen në lumin e Desivojcës dhe të Hogoshtit pa u trajtuar.

Shtëpitë në fshatin Muçivërc janë të ndërtuara me material të fortë. Në këtë fshat ndodhet

**Kisha e besimit të krishterë, e rrënuar** para ca vitesh. Ajo ndodhet në jug të fshatit.

**Pasuritë natyrore** të këtij fshati janë: thëngjilli, argjila, antimoni, litiumi, zhavorri.

Parashikimi i dëshiruar hapësinor për territorin e Komunës së Kamenicës në fushën e Zhvillimit ekonomik, regjenerimit duke përfshirë turizmin, rekreacionin, tregtinë dhe fushat tjera bazohet në analizën e situatës komunale dhe vizionin, parimet dhe prioritetet strategjike të cilat rezultuan nga procesi pjesëmarrës në hartimin e këtij dokumenti.

**Në këtë drejtim ekipet punuese kanë paraparë që:**

Orientimi themelor i zhvillimit të qëndrueshëm prodhues-ekonomik dhe miqësor ndaj mjedisit në Komunën e Kamenicës deri në vitin 2020 duhet të jetë i tillë që të mundësojë realizimin e qëllimeve të parapara, detyrave të zhvillimit si dhe zvogëlimin e dallimeve në pikëpamje të nivelit të zhvillimit krahasuar me komunat tjera në nivel të Kosovës dhe rajonit. Periudha e ardhshme në këtë pikëpamje, duhet të jetë kthesë dhe cilësi e re sa i përket zhvillimit të Komunës.

Orientim themelor i zhvillimit të Komunës së Kamenicës, gjatë periudhës së ardhshme duhet të jetë industrializimi i mëtejshëm, me këtë rast industria duhet të ketë ndikim të rëndësishëm si për dinamikën e rritjes së ekonomisë së përgjithshme, ashtu edhe për dispersionin e strukturës dhe të përhapjes së efekteve në një hapësirë të gjerë në pikëpamje të zhvillimit dhe të veprimtarive të tjera. Në Komunën e Kamenicës bujqësia do të jetë edhe për një kohë të gjatë veprimtari kryesore e ekonomisë. Ndonëse zhvillimi i bujqësisë në këtë komunë, do të bëhet nën kushte mjaft të ndërlikuara, kontributi i saj do të jetë mjaft i rëndësishëm. Kushtet pedologjike klimatike, ngritja e pendave dhe sistemet e parapara për ujitje, do të bëjnë të mundshme që të ndryshojë struktura e shfrytëzimit të tokës së punueshme dhe të rritet vëllimi i prodhimit bujqësor. Është e domosdoshme që në bujqësi të bëhen integritime më të mëdha, duke e lidhur kështu më shumë prodhimin me përpunimin. Partneritetet publiko private në prodhimin bujqësor, në industrinë përpunuese dhe në plasmanin e produktit, paraqesin një nga parakushtet themelore për zhvillim të bujqësisë në funksion të zhvillimit ekonomik.

**Pylltaria dhe kullosat**- zënë një vend me rëndësi sa i përket zhvillimit të ekonomisë së Komunës së Kamenicës. Pasuria pyjore duhet të shfrytëzohet racionalisht, kurse kujdesi intensiv ndaj pyjeve dhe ruajtja e tyre, si dhe pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura duhet të kontribuojë përparimit të pylltarisë. Pra, duhet të bëhet mbrojtja dhe përmasimi i sipërfaqeve të destinuara për kullosa dhe i cilësisë së tyre, që do të kontribuojë në zhvillimin e blegtorisë në komunën tonë.

**Blegtoria:** do të vazhdojë të zërë një vend të posaçëm në Komunën e Kamenicës, kur merren parasysh produktet dhe nënproduktet që merren nga bagëtia.

**Ndërtimtaria, turizmi, hoteleria, tregtia, zejtaria, energjia, sistemi bankar, transporti, telekomunikimi dhe disa veprimtari tjera shërbyese,** gjatë periudhës së ardhshme duhet të zhvillohen në mënyrë më të qëndrueshme dhe më të shpejtë, kurse shpërndarja më e barabartë e tyre në hapësirë do të kontribuojë përmirësimit të kushteve të jetesës edhe në vendbanime rurale.

Zhvillimi i ardhshëm i ekonomisë së Komunës së Kamenicës sipas dinamikës së parapara dhe me një tjetër strukturë, do të kërkojë një inkuadrim më intensiv të popullsisë së aftë për punë krahas shtimit përkatës të përhershëm të produktivitetit të punës, kështu krijohen kushte edhe për ndryshimin e strukturës socio-ekonomike të popullsisë.

Shkalla e ulët e inkuadrimin në punë të popullsisë në Komunën e Kamenicës, numri i pamjaftueshëm i punëtorëve të inkuadruar edhe në bujqësi, si dhe pamundësia që të inkuadrohet shtimi i kontingjentit punues për çdo vit, **dëshmon nevojën e udhëheqjes së një politike më aktive të inkuadrimin**, krahas shtimit përkatës të produktivitetit.

Deri në vitin 2020 duhet të kem shtimin e një kontingjenti të aftë për punë, përmes shkollimit dhe kualifikimeve adekuate, ofrimit të mundësive sidomos në sektorin privat, partneriteteve të ndryshme, zhvillimit të ekonomisë së vogël, ofertave në segmente të ndryshme të ekonomisë, si dhe një vëllim më të madh i mjeteve investive. **Politika investive duhet të mbështetet në zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese dhe ngritjen e kapaciteteve të reja**, si parakushte për zhvillim të gjithmbarshëm dhe të qëndrueshëm ekonomik .

Duhet pritur mjete nga partneritete e mundshme publiko-private, fondet kombëtare dhe ndërkombëtare, huat dhe kreditë përpos të hyrave vetanake të komunës.

Përveç me mjete investuese, duhet t'u ndihmohet edhe nga aspekti i punëve hulumtuese, hartimi i studimeve dhe i projekteve . Institucionet qendrore në këtë drejtim, duhet të japin ndihmën më të madhe. Këto janë te domosdoshme nga shkakun se Komuna e Kamenicës hyn në radhën e komunave jo mjaft të zhvilluara dhe me zhvillim të ngadalshëm.

Mirëpo as komunat ma të zhvilluara të Kosovës, zhvillimin e tyre nuk mund ta mbështesin, ekskluzivisht në zhvillimin e industrisë. Prandaj zhvillimit bujqësor duhet ti kushtojmë kujdes të veçantë, meqë tash dhe për një kohë të gjatë në zhvillimin e ardhshëm, ajo do të jetë burim kryesor i ekonomizimit.

### **3.2.1.2 ZHVILLIMI MATERIAL**

#### **3.2.1.3 Industria dhe xehetaria**

(1) Industria në pikëpamje të dinamikës dhe të intensitetit të rritës së prodhimit gjatë periudhës së ardhshme do jetë njëra ndër lëmit të rëndësishme të ekonomisë së Kamenicës, që parashihet se do të bëjë ndryshime të rëndësishme në ekonomi dhe në shoqëri. Zhvillimi dinamik i ekonomisë së gjithmbarshme nuk mund të sigurohet pa rriten e shpejta të industrisë. Ajo duhet të sigurojë, pjesën më të madhe të shtimit e të ardhurave të Komunës së Kamenicës. Industria duhet të luajë rol kryesor në arritjen e rritës së produktivitetit të punës dhe në angazhimin e popullsisë së aftë për punë.

Gjatë periudhës së ardhshme bazën e zhvillimit orientues të industrisë në Komunën e Kamenicës do ta përbëjnë kapacitetet e ndërtuara industriale gjatë periudhës së shkuar, që në pjesën ma të madhe janë privatizuar, ato që janë në ndërtim e sipër si dhe vendburimet e xeheve minerale. Në zhvillimin e ardhshëm industrial të kësaj komune, duke pasur parasysh pasurinë dhe llojllojshmërinë e lëndëve të para, ku një vend me rëndësi do të ketë industria në baze të metaloideve (përpunimi i bentonitit, i deltinës, i tufit, i kuarçitit, i kaolinit etj. pastaj industria e materialeve ndërtimore. Përveç industrisë së metaloideve, në zhvillimin e kësaj komune një vend me rëndësi do të ketë industria ushqimore e lëngjeve dhe ajo përpunuese e metalit, drurit, plastikës; kurse në perspektivë mund të llogaritet edhe në zhvillimin e industrisë në baze të metaleve me ngjyra, të prodhimeve kimike, të elektroindustrisë e disa të tjera.

Industria duhet të ketë normë më të lartë të rritës. Kjo gjatë tërë periudhës, duhet të silllet prej 10 - 12%, e që gjatë fazës së dytë të kësaj dekade (deri në vitin 2020) të jetë edhe më e madhe. Vetëm një norme e këtillë e rritës, mund të sigurojë dinamikë të nevojshme të zhvillimit ekonomik dhe shtim dinamik e të ardhurave të përgjithshme.

(2) Orientimi themelor i prodhimit industrial duhet të mbështetet në shfrytëzimin racional dhe në angazhimin e të gjitha potencialeve prodhuese, natyrore, të njeriut, shkencore dhe të tjera. Meqë zgjidhja e plotësimin të kapaciteteve racionale dhe prioritare (parësore) industriale, është një nga çështjet themelore

të orientimit prodhues dhe të politikës së zhvillimit të industrisë, atëherë paraqitet domosdoja që ky problem në Komunën e Kamenicës të shqyrtohet më hollësisht. Në këtë kontekst ti hyhet hartimit të studimeve të veçanta. Gjatë punëve hulumtuese të hollësishme, kësaj çështjeje duhet kushtuar kujdes të veçantë.

Për zhvillimin e industrisë, duhet kërkuar forma të ndryshme të bashkëpunimit, partneritete publiko private, koncesione dhe forma tjera të punës e të mjeteve, të harmonizimit të programeve të zhvillimit dhe të planeve.

Zhvillimi i mëtejshëm i industrisë së Komunës së Kamenicës duhet të mbështetet në rezultatet zhvillimit të deritashëm, por edhe në ndërtimin e kapaciteteve të reja. Nga kjo arsye mund të pritset se në zhvillimin e mëtejshëm, do të paraqiten edhe degë të reja industriale që do të plotësojnë strukturën e industrisë së Komunës së Kamenicës.

**Metalurgjia me ngjyra-** Tash për tash nuk ndeshet. Mirëpo, në bazë të rezervave të konstatuara ekzistojnë mundësitë e ndërtimit të kapaciteteve për prodhim, kurse hulumtimet e mëtejshme duhet të tregojnë, se farë mundësish ekzistojnë për koncipimin e kapaciteteve për një periudhë më të gjatë.

**Metaloidet** - Në industrinë e metaloideve tash nuk haset as një zhvillim i rëndësishëm, mirëpo bazuar në rezervat ekzistuese gjatë periudhës së ardhshme, ekzistojnë mundësitë reale për një zhvillim dinamik të industrisë së metaloideve sipas kërkesave në treg.

Në bazë të rezervave të hulumtuara, Komuna e Kamenicës, ka kushte të volitshme për eksploatimin racional dhe ndërtimin e kapaciteteve për përpunimin: e resurseve natyrore (bentoniti, argjila, tufi, kaolini, antimoni, silici, graniti, mermeri, andeziti, hekuri, çeliku, magneziti, thëngjilli, etj.). Të gjitha këto zona duhet të jenë zona të mbrojtura.

Mund të ketë prodhim të materialeve për nevoja të industrisë së materialit ndërtimor.

#### **3.2.1.4 INDUSTRIJA PËRPUNUESE**

**Industria e përpunimit të metaleve** - Në Komunën e Kamenicës veprojnë disa njësi të vogla punuese për prodhimin e konstruktiveve metalike (dyer, dritare dhe konstruksione kulmi e ndërtimi), kombinimi i llamarinës dhe hekurit në sektorin privat.

Zhvillimi i mëtejshëm i kësaj dege industriale, do të bëhet me zgjerimin e kapaciteteve tashmë të ndërtuara por edhe me ndërtimin e atyre të reja në pajtim me mundësitë dhe nevojat e tregut.

Kjo industri në të ardhmen mund të zë një vend të rëndësishëm në zhvillimin industrial të kësaj komune, meqë industria e përpunimit të metaleve ka asortiman mjaft të gjerë të prodhimit, kurse teknologjia e re krijon mundësi mjaft të gjera të aplikimit të këtyre prodhimeve, pothuajse në të gjitha degët industriale.

**Industria e përpunimit të drurit** - Në Komunën e Kamenicës veprojnë disa njësi të vogla punuese për prodhimin e produkteve të drurit: dyer, dritare, tavolina, karrige, por edhe konstruksione prej druri me të gjitha elementet konstruktive

Zhvillimi i mëtejshëm i kësaj dege industriale, do të bëhet me zgjerimin e kapaciteteve tashmë të ndërtuara por edhe me ndërtimin e atyre të reja në pajtim me mundësitë dhe nevojat e tregut.

Kjo industri në të ardhmen mund të zërë një vend të rëndësishëm në zhvillimin industrial të kësaj komune, meqë industria e përpunimit të drurit ka asortiman mjaft të gjerë të prodhimit, kurse teknologjia e re krijon mundësi mjaft të gjera të aplikimit të këtyre prodhimeve, pothuajse në të gjitha degët industriale.

**Industria e përpunimit të plastikës** - Në Komunën e Kamenicës veprojnë disa njësi të vogla punuese për prodhimin e produkteve të plastikës, kryesisht: dyer, dritare.

Zhvillimi i mëtejshëm i kësaj dege industriale do të bëhet me zgjerimin e kapaciteteve, tashmë të ndërtuara por edhe me ndërtimin e atyre të reja në pajtim me mundësitë dhe nevojat e tregut.

Kjo industri në të ardhmen mund të zërë një vend të rëndësishëm në zhvillimin industrial të kësaj komune, meqë industria e përpunimit të plastikës ka asortiman mjaft të gjerë të prodhimit dhe përdorimit kurse teknologjia e re krijon mundësi mjaft të gjera të aplikimit të këtyre prodhimeve, pothuajse në të gjitha degët industriale.

**Industria e material-ndërtimit.** - Në Komunën e Kamenicës ekzistojnë disa njësi ku prodhohet zhavorri dhe nuk kemi zhvillime tjera. Në perspektivë mund të pritet një shtim i konsiderueshëm i llojit dhe i volumit të prodhimit në industrinë e materialit ndërtimor.

Kjo do të realizohet me anë të shtimit të prodhimit në kapacitetet ekzistuese, si dhe me ndërtimin e të reja, kur për këtë gjë krijohen kushtet përkatëse. Kushtet natyrore për një zhvillim më dinamik të kësaj industrie, ekzistojnë.

Duhet bëhet zgjedhja e prodhimit, duke pasur parasysh veprimtarinë intensive të ndërtimit dhe kërkesën e përhershme, pra plasmani edhe për një kohë të gjatë nuk duhet të jetë faktor kufizues në zhvillimin e kësaj dege industriale.

**Industria e tekstilit.**- Kamenica kishte dy njësi prodhuese të tekstilit në Kamenicë dhe Crep, të cilat janë privatizuar dhe nuk funksionojnë. Në kuadrin e industrisë së komunës nuk zënë ndonjë vend të rëndësishëm, sa i përket numrit të punësuarve dhe realizimit të prodhimit. Gjatë periudhës së ardhshme, duhet pritur një zhvillim më dinamik të kësaj industrie.

**Industria ushqimore** – Në këtë komunë është deri në një masë e zhvilluar; përveç prodhimit të bukës dhe të disa nënprodukteve, kryesisht në sektorin privat kemi edhe një kapacitet për prodhimin e miellit nga drithërat e bardha (Kopërnice).

Gjatë periudhës së ardhshme, zhvillimit të kësaj industrie në këtë komunë duhet kushtuar kujdes të veçantë. Me zhvillimin më intensiv të bujqësisë dhe me ndryshimin e rëndësishëm të strukturës së prodhimit, sidomos me ndërtimin e pendës dhe sistemeve për ujtime, do të krijohen kushte më të favorshme për një zhvillim të shpejtë dhe të llojlojshëm të kësaj industrie edhe në këtë komunë.

Në të ardhmen duhet llogaritur edhe zgjerimin e kapaciteteve (të mullinjve, furrave) për prodhimin e miellit, të bukës dhe të simiteve, gjë që me ndërtimin e drithnikëve (siloseve) do të krijohen kushte më të volitshme për sigurimin, e rezervave të drithërave, pastaj të ndonjë reparti deponim, konservim por edhe për përpunimin e pemëve dhe të perimeve, si dhe të prodhimeve të tjera prej miellit. Ekziston mundësia për ndërtimin e fabrikës për përpunimin e pemëve dhe perimeve. Ndërtimi i i mëtutjeshëm i kapaciteteve dhe frigoriferëve për ruajtjen e produkteve të ndryshme do të mundësonte që bujqit me tepër të merren me perimtarin dhe pemëtarin. Ndërtimi i thertoreve me standarde dhe i frigoriferit, do të kontribuonte më mirë furnizimit të kësaj komune, si dhe zgjerimit të tregut për grumbullimin dhe konsumin e këtyre prodhimeve.


Zhvillimit të industrisë ushqimore duhet ti kontribuojë vëllimi i rritur dhe i llojlojshëm i prodhimeve bujqësore, sidomos pas ndërtimit të pendave (digave), në Kremenatë dhe Desivojcë. Struktura dhe vëllimi i prodhimeve bujqësore do të ndryshojë dukshëm (prodhimi më i madh i bimëve industriale, blegtoria e lidhur me këtë prodhimi më i madh i mishit, prodhimi i qumështit, i pemëve dhe i perimeve etj.), gjë që do të bëjë të mundshëm prodhimin bujqësor të një niveli më të lartë, që duhet të sigurojë prodhime të mjaftueshme për zhvillimin e kapaciteteve prodhuese dhe përpunuese deri te produktet finale ushqimore.

**Industria e duhanit**- Komuna e Kamenicës ka një traditë në kultivimin e duhanit, pra ekzistojnë kushte të mira për të kultivuar duhanin cilësor dhe për t'u lidhur me industrinë e duhanit në këtë rajon (Gjilan) ku ekziston fabrika, respektivisht kapacitetet për përpunimin e duhanit (duhani i fermentuar) dhe për prodhimin e fabrikateve të duhanit (cigaret).

**Industria tjetër** – Në perspektivë mund të priten të zhvillohen edhe degë të tjera industriale, të cilat tani nuk ekzistojnë në këtë komunë, siç janë përpunimi i mbeturinave të ngurta dhe inteligjente, prodhimi i briketit, elektroindustria, prodhimet e ndryshme të industrisë kimike përpunuese.

Zhvillimi i industrisë e sidomos i degëve të reja, do të varet nga suksesi i hulumtimit të tregut të lëndëve të para dhe nga plasmani i prodhimeve. Nisur nga problemi i inkuadrimit të fuqisë punuese, gjë që në këtë komunë është veçmas i theksuar, atëherë zhvillimit të degëve të reja industriale duhet kushtuar kujdes të veçantë.





Harta.37. Zonat e zhvillimit ekonomik në Komunën e Kamenicës

### 3.2.1.5 SHPËRNDARJA, DINAMIKA DHE STRUKTURA E INDUSTRIË

#### Shpërndarja hapësinore e industrisë

Edhe pse industria në këtë komunë nuk është edhe aq e zhvilluar, kemi një shpërndarje hapësinore të pa barabartë të kapaciteteve ekzistuese në tërë territorin e saj. Kryesisht, kapacitetet industriale janë të përqendruara në Kamenicë, Koretin dhe Rogaçicë.

Shpërndarja hapësinore e industrisë në komunë gjatë periudhës së ardhshme, duhet marrë parasysh mundësinë e shtrirjes së barabartë gjeografike, me qëllim të forcimit të bazës materiale në tërë tërë territorin dhe zbutjes së papunësisë, si parakusht për zbutjen e lëvizjeve migruese të popullsisë në relacion zonë rurale - qytet. Kjo do të thotë se, me rastin e zhvillimit të ardhshëm të kapaciteteve industriale, duhet vlerësuar edhe faktorët e lokacionit.

Ndonëse kriteret për faktorët e lokacionit, varen shume nga ndryshimet e kohës e hapësirës, sipas degëve të caktuara industriale dhe prodhimit të produkteve të caktuara industriale, me rastin e zgjerimit dhe ngritjes së industrisë së re, në Komunën e Kamenicës duhet pasur kujdes, sidomos ndaj këtyre faktorëve, që do të theksojmë:

- Përveç përshtatshmërisë së terrenit, duhet pasur parasysh edhe pasojat që mund të ketë lokacioni për zhvillimin e qytetit, si dhe për ndotjen e ambientit të jetesës;
- industria që kërkon transport masiv, duhet të orientohet afër rrugëve automobilistike;
- industria që kërkon konsum më të madh sasish të ujit duhet orientuar në lokacione të zonave, ku furnizimi me ujë nuk është faktor kufizues;
- zgjedhja e industrisë dhe e lokacionit të saj duhet të niset edhe nga mundësitë e sigurimit të fuqisë përkatëse të punës, duke pasur kujdes me këtë rast ndaj problemeve që mund të dalin prej kësaj;
- për industrinë që ka procese të lidhura teknologjike ose të varura duhet synuar krijimin e tërësive teknologjike dhe në përputhje me kërkesat e tilla të sigurohet edhe lokacioni i ri.

Duke marrë parasysh këta faktorë, komuna do të mundësojë zhvillimin e industrisë në zonën industriale, zonat e propozuara për industri, vendbanimet me mundësi për industri dhe hapësirat me mundësi për industri (shih hartat e më sipërme).

Varësisht nga struktura dhe madhësia e kapaciteteve në qytet, respektivisht vendbanime të caktuara duhet siguruar edhe zona për zhvillimin e organizuar të industrisë. Sipas tipit të zonave industriale të koncentruara edhe disa normativave të provuara: dendësia e inkuadrimin për një hektar, respektivisht në hapësirë për çdo të inkuadruar. Në këtë drejtim në të ardhmen do të zhvillojë zonën industriale të planifikuar dhe funksionalizuar, për aq sa është e mundur. Industria e komunës së Kamenicës në pajtim me dinamikën e paraparë të zhvillimit të prodhimit industrial do të realizojë lidhje mjaft të rëndësishme transportuese me meset, qendrat, territoret e tjera industriale të tregut në Kosovë dhe jashtë saj.

Për nga lidhjet në Kosovë në rend të parë është industria ushqimore dhe e lëngjeve, industria përpunimit të metalit, drurit, plastikës dhe e materialit ndërtimor (zhavorrit), kurse jashtë Kosovës industria e ushqimore, e lëngjeve, industria e metaleve, e metaloideve, si dhe të gjitha degët e tjera të reja që mund të zhvillohen në periudhën e ardhshme.

Lidhjet transportuese dhe vëllimi i transportit janë faktorë të rëndësishëm, prandaj rritja e paraparë e prodhimit industrial, varet edhe nga zhvillimi i kapaciteteve transportuese, si në nivel ndërkombëtar, regjional, ashtu në nivel ndër regjional, në këtë drejtim zhvillimet e parapara (autostrada Durrës-Morinë-Merdare, ajo Shkup- Prishtinë, lidhjet Kamenicë, Gjilan, Kumanovë edhe hekurudha dhe autoudha e planifikuar Ferizaj – Viti – Gjilan –Kamenicë –Bujanoc, do të zgjerojnë kapacitetet transportuese dhe lehtësojnë qarkullimin më të shpejtë dhe masiv të mallrave por edhe njerëzve.


### **3.2.1.6 BUJQËSIA**

Bujqësia në të ardhmen do të fuqizohet edhe më shumë si degë primare ekonomike dhe si e tillë do të luajë rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik.

Nga analizat e situatës në komunë dihet se, Komuna e Kamenicës ka fond të konsiderueshëm të tokës bujqësore dhe të pyjeve e kullosave që paraqesin potencial të rëndësishëm ekonomik të kësaj komunë.

Pas aprovimit të këtij plani, vendosja nën mbrojtje e tokës cilësore bujqësore dhe zhvillimi i saj, do të jenë prioritet mbi prioritete. Toka kualitative bujqësore, duhet të mbrohet në mënyrë të përpiktë nga zhvillimet e paplanifikuara, kurse zhvillimi i bujqësisë theksohet si një nga potencialet më të mëdha zhvillimore të komunës.

Zhvillimi i bujqësisë në Komunën e Kamenicës, gjatë periudhës për të cilën hartohet dokumenti, duhet të bëhet në pajtim me mundësitë reale dhe me nevojat e komunës. Struktura e trashëguar e bujqësisë, ku rolin dominues e ka prona e imtë individuale me ngastra të vogla, duhet të ndërrohet me përdorimin e masave stimuluese të bashkimit të ngastrave të prodhuesve individual, qoftë në formë partneriteti, kooperative apo ndonjë formë tjetër. Vazhdimi komasacionit, përveç tjerash është një prioritet që do të mundësojë zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë.



Harta. 37. Zonat e bujqësisë në Komunën e Kamenicës

Në disa zona do të bëhet edhe rritja e sipërfaqeve bujqësore dhe punimi i tyre (hapja e sipërfaqeve të tokës që janë të mbuluara me shkurre, shpyllëzimi i sipërfaqeve me pyje të ulëta, rrafshinat dhe bregoret e mundshme).


Intensifikimi i zhvillimit të bujqësisë, krahas investimeve kërkon edhe zoonimin e sipërfaqeve bujqësore, i cili është bërë me këtë plan (ruajtja e tokës bujqësore dhe reduktimi i shndërrimit të saj për destinacione tjera e sidomos për ndërtim, është trajtuar gjatë fazave të më hershme dhe janë planifikuar kufijtë ndërtimor të vendbanimeve, sipërfaqet të cilat nuk ndodhen brenda kufijve ndërtimor, apo kufijve që përcaktojnë ndonjë zhvillim të mundshëm jo bujqësor, do të konsiderohet si tokë bujqësore dhe do të ruhet e zhvillohet si e tillë).

Sigurimin e kuadrit profesional dhe institucioneve për trajnime dhe shkollim të mesëm të lartë, janë paraparë me këtë plan dhe janë destinuar hapësirat për institucionet e tilla (harta e shkollave në nivel komunal).

Organizim adekuat të furnizimit të bujqësisë së komunës në harmoni me kushtet në terren (pjesëve fushore nga ato kodrinore-malore) me farë, plehra artificiale, fidane etj. dhe grumbullimin e sasive të prodhuara e të gjitha produkteve në komunë

Parashikimet e mundshme të shfrytëzimit dhe strukturën e sipërfaqeve bujqësore në kushtet e përdorimit në një shkallë të caktuar të agroteknikes, kërkojnë aftësimin adekuat dhe rritjen e fuqisë punëtore që mund të marrë shifrat e disa mijëra njerëzve, që do të mund të merren në mënyre aktive me bujqësi.

Për një shfrytëzim më të plotë dhe më të mirë të sipërfaqeve, është e domosdoshme të kryhen punimet agromelioruese si dhe përmirësimi i kapaciteteve funksionale, pra janë të domosdoshme masat për parandalim të vërshimeve, meliorimi dhe pyllëzimi i brigjeve të lumenjve, pastrimi dhe mirëmbajtja, hapja e kanaleve, rregullimi prej dheu dhe ai urban janë planifikuar.



Harta.38. Masat për vërshimet dhe erozion ne Komunën e Kamenicës

Zhvillimi i bujqësisë, gjatë periudhës së ardhshme duhet të sigurojë ushqim të mjaftueshëm për popullsinë dhe fond bagëtie për nevojat e tregut vendas, të industrisë përpunuese dhe për eksport. Norma e rritës së prodhimit bujqësor deri në vitin 2020 në komunë, duhet të jetë e lartë, respektivisht të përbejë njërën ndër pjesët kryesore të normës së rritës të ekonomisë së përgjithshme. Në Komunën e Kamenicës mund të priten norma të ngjashme të rritës së prodhimit bujqësor, sikundër edhe në rajon. Mirëpo duhet të bëhen ndryshime të mëdha strukturore në favor të blegtorisë, kurse në prodhimin lavërtar në favor të bimëve industriale, kopshtare dhe të atyre foragjere, për prodhimin e perimeve dhe produkteve të hershme.

Ndonëse sipërfaqet e punueshme në Kamenicë nuk mund të zgjerohen shumë, ka mundësi që me anë të kullimit, të mbrojtjes së sipërfaqeve nga vërshimet, meliorimin e sipërfaqeve, të ujitjes nga pendat akumuluese dhe mbrojtjes së sipërfaqeve bujqësore, mandej "të bashkimit të ngastrave dhe partneriteteve me prodhuesit individualë, të shtohet qenësishëm si prodhimi lavërtar ashtu edhe prodhimi i pemëve dhe i perimeve. Gjithashtu, mund të bëhet krijimi i kushteve për investimet për pajime (mekanizim, fondi i bagëtive etje), në territorin e Komunës së Kamenicës.

**Prodhimi lavërtar** -edhe me tej duhet të rritet, ndonëse në sipërfaqe të zvogëluara. Posaçërisht ai duhet të plotësojë nevojat e sigurimit të ushqimit të përmirësuar të popullsisë, të fondit të rritur të bagëtisë dhe të industrisë përpunuese. Në një perspektive të mëtejme, do të mund të rritej shumë prodhimi i grurit dhe i misrit, në radhë të parë produktiviteti më i madh nëpër njësi të sipërfaqes bujqësore, veçanërisht duhet pritur rritje të prodhimeve industriale, kopshtare dhe të bimëve foragjere, ndërsa këtu një vend të veçantë mund të zërë prodhimi i duhanit.

**Pemët dhe perimet** në kuadrin e prodhimit bujqësor, pas bimëve industriale, duhet të shënojnë norme më dinamike të shtimit, Kjo ka të bëjë me krijimin e kushteve në sektorin privat për ngritjen e plantazheve me fidane dhe pemishteve (molla, dardha, kumbulla etj.) dhe frutave të imta(mjedra, lajthi, dredhëza etj.); pastaj ngritjen e serrave të reja, zgjerimin dhe modernizimin e atyre ekzistuese(perime gjatë tërë vitit), të cilat mund të zhvillohen në tokat me kualitet të lartë. Edhe vreshtat mund zhvillohen në komunën e Kamenicës.

Shtimit të prodhimit bujqësor do të ndihmojnë mundësitë deri tash të pashfrytëzuara, ndërtimi i pemdave në dy krahët e komunës, **ndërtimin e sistemit për ujitje** që mund të përfshijnë me mijëra hektarë sipërfaqe bujqësore, të ndërtimit të pendave për mbrojtjen nga vërshimet, duke bërë edhe hulumtimin e mundësive për investimet të reja.

**Blegtoria** - Nisur nga kushtet mjaft të volitshme natyrore dhe kushtet tjera, për shkak të prapambetjes së theksuar gjatë periudhës së shkuar me problemet e pas luftës, me qëllim të sigurimit të një zhvillimi më të qëndrueshëm dhe më të shpejtë të mbarë bujqësisë, blegtoria duhet të shënojë rritje më të shpejtë, pra prodhimi i qumështit me nënproduktet dhe i mishit, shtimi i fondit blegtorale, si dhe përmirësimi i racave të kafshëve me raca me potencial të lartë të prodhimit, sidomos për mish dhe qumësht. Në kuadrin e zhvillimit të blegtorisë duhet të kenë vendin kryesor, rritja e gjedhëve, dhenve dhe dhive.

Zhvillimit të blegtorisë do të kontribuojë edhe ngritja e fermave të bagëtive, për të cilën gjë ekzistojnë kushte. Komuna e Kamenicës ka kushte për ndërtimin e së paku një ferme për **200-300** lopë mjelëse, si dhe të një numri të madh të minifermeve për bagëti dhe ndërtimin e tertores së bimëve që përmbajnë kokrra dhe të ushqimit të përzier kafshësh, por edhe një thertore moderne. Parashikohet shfrytëzimi i mijëra hektarëve për kullosa, në rritjen e pjesëmarrjes së blegtorisë në prodhimin e përgjithshëm bujqësor, si dhe marrja e masave të riplehërimit, pastrimit dhe rregullimi të këtij resursi natyror

Edhe rritja e dinamikës së kultivimit të **shpezëve** (në sasi dhe cilësi) në komunën e Kamenicës, duhet të stimulohet dhe intensifikohet, në mënyrë që të rritet mundësia e rritjes së fondit të mishit cilësor .

**Bletaria** - Bletaria është ngushtë e lidhur me pemëtarinë, kultivimin e luleve dhe bimëve mjekësore. Për këtë veprimtari ekziston një traditë në Komunën e Kamenicës, por edhe ekzistojnë kushte të volitshme natyrore. Për shkak të florës së pasur, kualiteti i mjaltit është i cilësisë së lartë dhe për këtë arsye në të ardhmen, zhvillimi i kësaj veprimtarie do të jetë i koordinuar. Kjo veprimtari është mjaft e përhapur në komunë. Gjithashtu, kemi njohës të mirë të kësaj veprimtarie.

Bartës kryesore të prodhimit të madh bujqësor në Komunën e Kamenicës do të jetë **sektori privat**, i cili duhet të bëjë bazën e zhvillimit të ardhshëm dinamik të bujqësisë. Komuna duhet të lehtësojë, kurse sektori privat duhet të sigurojë: bazën e prodhimit, të përpunimit dhe të qarkullimit të ushqimit, mund shfrytëzohen mundësit edhe për partneritete të ndryshme; mandej

modernizimin dhe zgjerimin, por edhe zhvillimin harmonik të industrisë ushqimore, e cila do të përvetësojë finalizimin e prodhimit bujqësor në një shkallë të lartë .

Bujqësia në kushtet e ekonomisë së tregut, kërkon ndërtimin e drithnikëve (siloseve) përkatës dhe të lokalit tjetër për strehim, si dhe disa stacione grumbulluese.

Kërkesat për prodhime ushqimore për ushqimin e popullsisë nisen nga konsumi, që për nga niveli dhe struktura e të ushqyerit, gjithnjë e më shumë po i afrohet plotësisht të nevojave kryesore fiziologjike, por duke pasur parasysh edhe shprehitë tradicionale dhe mënyrën e të ushqyerit.

Konsumi i paraparë i prodhimeve ushqimore, i kushton kujdes shtimit të paraparë të konsumit personal dhe aproksimit global të prodhimit bujqësor si dhe numrit dhe strukturës së popullsisë.

Konsumi i prodhimeve nga drithërat për një banor, duhet të zvogëlohet në favor të konsumit me të madh të komponentëve të tjera më të rëndësishme për ushqim. Në ushqimin e popullsisë vend të veçantë duhet të zërë, pjesëmarrja më e madhe e pemëve, e mishit, e yndyrës, e qumështit, e vezëve, e peshkut etj.

Në Komunën e Kamenicës nuk mund të pritet të vendoset drejtpeshimi midis prodhimit dhe konsumit të prodhimeve bujqësore. Kjo varet si nga kushtet natyrore të strukturës së shfrytëzimit të tokës bujqësore, ashtu edhe nga potenciali biologjik.. Sidoqoftë prodhimi i përgjithshëm bujqësor i komunës, duhet të jetë shumë më i madh nga nevojat e përgjithshme të popullsisë.

Në territorin e komunës ka mundësi të ndërtimit të disa pishinave të peshqve , ku peshkataria do të kontribuojë përmirësimit të strukturës ushqimore të popullsisë. Përveç kësaj pas ndërtimit të pendës akumuluese, krijohen kushte për rritjen e peshkut, në radhë të parë për nevoja sportive.

### **Përkrahja e sinergjive me format tjera të veprimtarive të biznesit**

- Zhvillimi i bujqësisë organike;
- Ruajtja e bimëve mjekësore , mundësia për kultivimin e tyre dhe krijimi i hapësirave tharëse për këto bimë;
- Rregullimi i infrastrukturës bujqësore;
- Organizimi i fermerëve në bazë të veprimtarive të tyre (blegtori, pemëtari, perimtari etj.); në kooperative bujqësore dhe shitja e tyre (ekzistimi i tregut të ndërmjetëm );
- Përpunimi dhe përsosja e produkteve ushqimore, duhet të përqendrohet, në dhe prodhimin e pemëve e perimeve, feramat e qumështit, modernizimin dhe zgjerimin e pikave grumbulluese për qumësht dhe djathore me qumësht deleje;
- Sigurimi i tregut edhe në shtete të EU-së;



- Agroturizmi mund të ofrohet nga fermerët për të gjeneruar të ardhura shtesë (turistët mund të përjetojnë jetën e përditësime të fermës dhe të shijojnë një varg të produkteve lokale origjinale dhe specialiteteve);
- Rritja e aftësive në teknologjitë prodhuese dhe marketing;
- Përdorimi i sistemeve të reja informative për bujqësi dhe trajnimin e fermerëve për përdorimin e tyre;
- Stimulimi për teknologji të reja dhe shkëmbim përvojave në Kosovë dhe rajon;
- Krijimi i parkut të makinave bujqësore;
- Krijimi i markës së produkteve komunale ose regjionale.

### 3.2.1.7 PYLLTARIA

Pylltaria është dege specifike e ekonomisë, në të cilën proceset e prodhimit janë të ngadalshme dhe ato nuk mund të ndryshohen shpejt. Për këtë arsye 10 vjet të pylltarisë janë afat relativisht i shkurtër që të mund të pritëshin ndryshime të rëndësishme. Lidhur me këtë, kusht primar i zhvillimit afatgjatë të ekonomisë pyjore, në radhë të parë të prodhimit pyjor, si bazë e saj, është programimi më real i vëllimit dhe i strukturës së konsumit të prodhimit të nxjerre nga eksploatimi i pyjeve dhe shtimi i funksioneve të përgjithshme, të dobishme të pyllit. Për këtë qëllim, masat dhe ndikimi më i madh në zhvillimin afatgjatë, si të aftësisë riprodutive të pyjeve, ashtu edhe të funksioneve tjera, duhet të orientohen në:

a) Rritjen e shumëfishtë të vëllimit të punëve kultivuese pyjore (pyllëzim, kujdesje etj.).

Pasi që në mbarë territorin e komunës ndodhen afro 1500 ha sipërfaqe të zhveshura dhe se janë të përshtatshme për pyllëzim, atëherë për periudhën e ardhshme apo në fazën e parë 10 vjeçare, prioritet në pyllëzimin e këtyre sipërfaqeve duhet të kenë:

| Nr. | Zona kadastrale      | Potenciali në(ha) | Lloji I i fidaneve  |
|-----|----------------------|-------------------|---|
| 1.  | Desivojcë            | 40                | Hormoç, Bredh, Bung                                       |
| 2.  | Tërstenë             | 20                | Hormoç, Bredh, Bung                                       |
| 3.  | Velegllavë e Epërme  | 25                | Hormoç, Bredh, Bung                                       |
| 4.  | Poliçkëë             | 60                | Hormoç, Bredh, Bung                                       |
| 5.  | Rogaçicë             | 70                | Pishë e Bardhë , Pishë e zezë, Bredh Dugllazi, Plep, Bagr |
| 6.  | Hogosht              | 70                | Pishë e Bardhë , Pishë e zezë, Bredh , Plep, Bagrem       |
| 7.  | Kranidell            | 70                | Hormoç, Bredh, Bung etj.                                  |
| 8.  | Hodonoc              | 30                | Pishë e Bardhë , Pishë e zezë, Bredh Dugllazi etj.        |
| 9.  | Shipashnicë e Epërme | 40                | Pishë e Bardhë , Pishë e zezë, Bredh Dugllazi, Bagrem     |
| 10. | Kopërnica            | 70                | Pishë e Bardhë , Pishë e zezë, Bredh, Bagrem              |
| 11. | Kosadincë            | 40                | Pishë e Bardhë , Pishë e zezë, Bredh Dugllazi.            |
| 12. | Firiqevë             | 30                | Pishë e Bardhë , Pishë e zezë, Bredh Dugllazi.            |

|                          |           |    |   |
|--------------------------|-----------|----|---|
| 13.                      | Hajnoc    | 30 | Pishë e Bardhë , Pishë e zezë, Akacie, Dugllazi.  |
| 14.                      | Grizime   | 30 | Pishë e Bardhë , Pishë e zezë, Akacie.            |
| 15.                      | Stralicë  | 20 | Pishë e Bardhë , Pishë e zezë, Akacie.            |
| 16.                      | Koretinë  | 25 | Pishë e Bardhë , Pishë e zezë, Akacie , Dugllazi. |
| 17.                      | Qarakoc   | 30 | Pishë e Bardhë , Pishë e zezë, Akacie , Dugllazi. |
| 18.                      | Berivojcë | 30 | Pishë e Bardhë , Pishë e zezë, Akacie , Dugllazi. |
| 19.                      | Krilevë   | 30 | Pishë e Bardhë , Pishë e zezë, Akacie , Dugllazi. |
| <b>GJITHSEJ 760 (ha)</b> |           |    |   |

Tab.46. Pyllëzimi në Komunën e Kamenicës

Ndërsa sipërfaqet për kujdesim- mirëmbajtje të pyjeve të reja natyrale dhe pyjeve të ngritura në mënyrë artificiale sipas prioriteteve janë :

1. Masat e planifikuara në pyje

| Nr.                      | Zona Kadastrale      | Sipërfaqja në (ha) | Lloji i tretmanit      |
|--------------------------|----------------------|--------------------|------------------------|
| 1.                       | Shipashnicë e Epërme | 200                | Rrallim para komercial |
| 2.                       | Muçivërc             | 120                | Rrallim para komercial |
| 3.                       | Rogaçicë             | 115                | Rrallim para komercial |
| 4.                       | Kranidell            | 80                 | Rrallim para komercial |
| 5.                       | Kolloleq             | 100                | Rrallim para komercial |
| 6.                       | Moçar                | 50                 | Rrallim para komercial |
| 7.                       | Hodonoc              | 80                 | Rrallim para komercial |
| 8.                       | Hogosht              | 70                 | Rrallim para komercial |
| 9.                       | Krilevë              | 50                 | Rrallim para komercial |
| 10.                      | Karaçevë e Epërme    | 80                 | Rrallim para komercial |
| <b>GJITHSEJ 945 (ha)</b> |                      |                    |                        |

Tab.47. Masat e planifikuara në pyje

2. Masat që duhet merrën në pyjet e reja artificiale

| Nr. | Zona Kadastrale       | Sipërfaqja në (ha) | Lloji i tretmanit          |
|-----|-----------------------|--------------------|----------------------------|
| 1.  | Shipashnicë e Poshtme | 30                 | Pastrim ,Çlirim            |
| 2.  | Gjyrishec             | 30                 | Prashitje, Pastrim ,Çlirim |
| 3.  | Rogaçicë              | 30                 | Prashitje, Pastrim ,Çlirim |
| 4.  | Muçivërc              | 30                 | Prashitje, Pastrim ,Çlirim |
| 5.  | Karaçevë e Epërme     | 50                 | Prashitje, Pastrim ,Çlirim |
| 6.  | Moçar                 | 20                 | Prashitje, Pastrim ,Çlirim |
| 7.  | Poliçkëë              | 50                 | Prashitje, Pastrim ,Çlirim |
| 8.  | Hogosht               | 70                 | Prashitje, Pastrim ,Çlirim |

|                          |           |    |                            |
|--------------------------|-----------|----|----------------------------|
| 9.                       | Desivojcë | 50 | Prashitje, Pastrim ,Çlirim |
| 10.                      | Hajnoc    | 50 | Prashitje, Pastrim ,Çlirim |
| 11.                      | Krilevë   | 30 | Prashitje, Pastrim ,Çlirim |
| <b>GJITHSEJ 440 (ha)</b> |           |    |                            |

Tab.48. Masat që duhet merrën në pyjet e reja artificiale

- b) **Shndërrimi gradual i shkurreve në pyje të rregullta** - realizimi i këtij qëllimi mund të bëhet përmes pyllëzimeve meliorative.

Vendet apo zonat në të cilat mund të bëhen këto veprime dhe se është e domosdoshme në fazën fillestare të bëhen në këto zona:

| Nr.                      | Zona Kadastrale      | Sipërfaqja në (ha) | Lloji i tretmanit  |
|--------------------------|----------------------|--------------------|--------------------|
| 1.                       | Shipashnicë e Epërme | 10                 | Pyllzim meliorativ |
| 2.                       | Rogaçicë             | 15                 | Pyllzim meliorativ |
| 3.                       | Muqivërc             | 10                 | Pyllzim meliorativ |
| 4.                       | Moçar                | 10                 | Pyllzim meliorativ |
| 5.                       | Kamenicë             | 15                 | Pyllzim meliorativ |
| 6.                       | Kolloleq             | 15                 | Pyllzim meliorativ |
| 7.                       | Kopërnice            | 15                 | Pyllzim meliorativ |
| 8.                       | Tërstenë             | 15                 | Pyllzim meliorativ |
| 9.                       | Krilevë              | 15                 | Pyllzim meliorativ |
| <b>GJITHSEJ 120 (ha)</b> |                      |                    |                    |

Tab.49. Pyllëzim meliorativ

- c) **Shndërrimi gradual (natyral, artificial) i pyjeve të ulëta në pyje të larta** – Një veprim i tillë mund të bëhet përmes metodës së konversionit të pyjeve të ulëta në pyje të larta (me prejardhje prej farës), dhe përmes pyllëzimeve të cilat janë cekur më lartë dhe janë pjesë e këtij plani . Duhet cekur se një punë e tillë merr kohë dhe mjete financiare. Zonat në të cilat do të kishin prioritet dhe një aktivitet i tillë do të jepte rezultate janë këto :

d)

| Nr. | Zona Kadastrale      | Sipërfaqja në (ha) | Lloji i tretmanit |
|-----|----------------------|--------------------|-------------------|
| 1.  | Shipashnicë e Epërme | 50                 | Shndërrim         |
| 2.  | Rogaçicë             | 50                 | Shndërrim         |
| 3.  | Muqivërc             | 50                 | Shndërrim         |
| 4.  | Hogosht              | 50                 | Shndërrim         |
| 5.  | Hajnoc               | 30                 | Shndërrim         |
| 6.  | Kranidell            | 50                 | Shndërrim         |
| 7.  | Kopërnice            | 30                 | Shndërrim         |
| 8.  | Tërstenë             | 30                 | Shndërrim         |
| 9.  | Krilevë              | 15                 | Shndërrim         |
| 10. | Karaçevë e Epërme    | 30                 | Shndërrim         |

Tab.50.Tretmani i sipërfaqeve tokësore

**a) Mirëmbajtja intensive e pyjeve të larta e të ruajtura** – për të pasur një menaxhim dhe pyje të qëndrueshme e sidomos ato më kualitete (të larta), atëherë pyjet ekzistuese duhet të ruhen, përtrihen dhe menaxhohen në atë mënyrë, që për vitet në vijim të mbeten së paku në gjendjen e tanishme e mundësisht edhe në gjendje të avancuar. Kjo arrihet në dy mënyra:

- Menaxhimi profesional i grumbujve pyjore pa marrë parasysh presionet e jashtme për prerje të shtuar dhe
- mbrojtja nga prerjet ilegale, zjarret , sëmundjet etj.

Zonat pyjore në të cilat duhet pasur kujdes dhe angazhim maksimal profesional, me qëllim të ruajtjes dhe përmirësimit të gjendjes së pyjeve të larta (me prejardhje prej farës) janë : zonat e pyjeve të : fshatrave Desivojcë, Tërstenë, Muçivërc, Rogaçicë, Kranidell, Sedllar, Tugjec, Svircë, Hogosht, Dazhnicë, Lisockë, Zhujë, Poliçkë, Busavate, Velegllavë, Krilevë, Gragjenik,dhe kulturat pyjore në zonën e fshatrave Desivojcë, Poliçkë, Hajnoc, Muçivërc, Rogaçicë, Kranidell, Sedllar, Tugjec, Svircë, Dazhnicë, Lisockë, Zhujë, Karaçevë, Shipashnicë e Poshtme dhe e Epërme.

**Favorizimin e drurit të vlefshëm që rritet shpejtë-** si pasojë e shtimit të madh të nevojave për dru, qoftë teknik apo të zjarrit në të ardhmen duhet të mendohet në kultivimin e druve që rriten shpejt. Me qëllim që të dilte me një qëndrim se, me cilat lloje do të shkohej përveç atyre ekzistuese (ahu, bungu, pisha, akacia etj. ), atëherë mbetet obligim që me ndihmën e enteve të posaçme për pylltari të bëhen analiza të tokës dhe hulumtime për lloje të përshtatshme të druve që do të arrinin qëllimin e kërkuar më lartë për Komunën e Kamenicës. Ky proces do të ndihmohej direkt me pyllëzimet e planifikuara me lloje të analizuar dhe hulumtuara më lartë.

**b) Të sigurohet kuadri i nevojshëm profesional**

Duke u mbështetur në gjendjen e sipërfaqeve pyjore dhe në kushtet klimatike-gjeografike etj. në Komunën e Kamenicës, duhet të pritet një vëllim më i madh punimesh kultivuese-pyjore.

- Në kultivim( rrallime , pastrime etj. ) afro 200 ha/ vit;
- Shfrytëzim ( prerje kopshtore, farore ) afro 75 ha / vit;
- Në pyllëzime afro 35 ha / vit;
- Mirëmbajtje – kujdesim ( prashitje , pastrime etj.) afro 40 ha /vit;
- Në mbrojtje nga sëmundjet, zjarret, insektet afro **500 ha /vit.**

Për përparimin e pyjeve - sidomos për pyllëzimin është e nevojshme të eksplorohen të gjitha mundësitë, deri te angazhimi i fuqisë punëtore edhe me aksione vullnetare.

Për përparimin afatgjatë të fondit pyjor dhe për organizimin e administrimit të pyjeve në nivel më të lartë teknologjik, pos tjerash duhet:


- a) Të sigurohet financim permanent i investimeve në infrastrukturë (pyllëzim i sipërfaqeve të zhveshura, bonifikimi i pyjeve të degraduara, konversion i pyjeve të ulëta në të larta, ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve pyjore, etj.).
- b) Për investime ekonomike ( biologjike, teknike) të sigurohen kushte të volitshme kreditimi;
- c) Të punohen planet afatgjata menaxhuese, respektivisht bazat ekonomike pyjore, ose të bëhet revidimi i atyre që tashmë u ka skaduar afati;
- d) Të përfundojë sa më parë procedura e rregullimit të marrëdhënieve pronësoro-juridike.

(3) Vend të veçante në problemin e shfrytëzimit të fondit pyjor dhe të sipërfaqes pyjore, përgjithësisht zë orientimi në rrethanat lidhur me vëllimin e tanishëm të prerjes dhe të mënyrës së shfrytëzimit të pyjeve, edhe të atyre në pronësi private. Kjo si nga pikëpamja e balancimit dhe harmonizimit të prerjeve me rritjen, ashtu edhe nga pikëpamja e mbrojtjes me qëllim që të sigurohet ekuilibrimi biologjik-ekologjik i

ekosistemit dhe regjenerimit të rajoneve pyjore të caktuara. Këto masa duhet te aplikohen, posaçërisht pasi që vëllimi i prerjes në raport me masën e drurit, është më i madh si pasojë e prerjeve ilegale. Prerja vjetore ( legale dhe ilegale ) nuk do të duhej të ishte më e madhe se **65-70%** të rritjes së masës së drurit. Meqë llogaritet se, rritja vjetore gjer në vitin 2021 do të jetë: në pyjet shtetërore afro **206250 m<sup>3</sup>** e në ato private afro 62172 m. Prerja vjetore do të duhej te kufizohej: në pyjet shtetërore në afro 11250m<sup>3</sup>, ndërsa në ato të pronësisë private në maksimumin prej afro **3391m<sup>3</sup>** . Në këtë mënyre, vëllimi i përgjithshëm i prerjes, do të orientohet në baza reale me gjendjen e pyllit, por më tutje vëllimi i prerjes duhet të harmonizohet me rritjen. Shfrytëzimi i masës drusore do të duhej të orientohet në shfrytëzimin e drurit teknik së pari, e pastaj mbetja në dru zjarri.

Për aktivizimin e kësaj hapësire për rekreacion dhe në përgjithësi shfrytëzimin e pyjeve, masat selvikulturore, realizimin e pyllëzimeve, mbrojtjen nga prerjet ilegale, insektet, kërpudhat e posaçërisht nga zjarret pyjore dhe mirëmbajtjen e pyjeve dhe tokave pyjore është e nevojshme **të ndërtohen këto rrugë pyjore në komunën e Kamenicës.**

1. Desivojcë—Guri i Zi
2. Poliçkë---Kikë.....
3. Krilevë-- pergjat vijes administrative me Komunën e Prishtinës
4. Tugjec.



Harta.39. Pyjet në Komunën e Kamenicës

### 3.2.1.8 NDËRTIMTARIA

1. Ndërtimtaria zë vend me rëndësi në ekonominë e Komunës së Kamenicës. Ajo planifikohet të fuqizohet në kuptimin e inkuadrimin të numrit të konsiderueshëm të punësuarve në profile të ndryshme.

Funksionalisht ndërtimtaria do të vazhdojë të jetë ngushtë e lidhur me zhvillimin e të gjitha aktiviteteve ekonomike dhe joekonomike. Zhvillimi intensiv i ndërtimtarisë do të vazhdojë të jetë i kushtëzuar edhe në pajtim me kapacitetet investive për zhvillimin e ekonomisë dhe të veprimtarive sociale.

Ndërmarrjet ndërtimore të Komunës së Kamenicës, pasi që nga viti në vit kryen punë, gjithnjë e më të komplikuar, një pjesë të punëve ajo i zhvillon edhe jashtë Komunës.

Aktiviteti ndërtimor do të vazhdojë të jetë i koncentruar, kryesisht në ndërmarrjet ndërtimore private, të cilat do të punësojnë pjesën më të madhe të punëtoreve nga numri i përgjithshëm i të inkuadruarve në ndërtimtarinë e komunës, vetëm një numër shumë i vogël i kompanive publike do vazhdojnë të kryejnë punë shumë të veçanta në lëmin e ndërtimit (në fushën e infrastrukturës ujore dhe furnizimit me ujë etj.).

Fusha e ndërtimit dhe kompanitë ndërtimore do të kenë një seri detyrash, që e presin ndërtimtarinë në nivel të Kosovës edhe të komunës, andej parashihet një zhvillim më i shpejtë dhe modernizim i kapaciteteve për ngritjen e nivelit të punës në ndërtimtarinë. Bartja e një vargu punësh nga punishtja në reparte të organizuara industrialisht dhe në fabrika, duke e bërë ndërtimtarinë gjithnjë e më të pavarur nga ndikimet stinore. Një industrializim më të shpejtë të ndërtimeve, duhet pritur veçmas në fushën e ndërtimit të banesave, ku mund të sigurohen aranzhmane afatgjata, koncentrim më i madh dhe vëllim ndërtimesh.

Në këtë fushë, pritet normë më e lartë rritjeje nga norma mesatare e ekonomisë së përgjithshme, pra pritet një rritje vëllimi punësh dhe të punësuarish për disa herë. Përveç kësaj, ndërtimtaria e komunës në perspektivë, duhet të sigurojë rritjen e vëllimit të punëve edhe jashtë komunës, para së gjithash brenda Kosovës, por edhe jashtë saj.

Krahas zhvillimit të operativës ndërtimore, duhet bërë të mundshme prodhimin serik të materialit ndërtimit dhe të elementeve ndërtimore, në shume lokalitete ka lëndë të parë mjaft cilësore. Modernizimi dhe zgjerimi i kapaciteteve të tashme, si dhe ndërtimi i të rejave mund t'i plotësojnë në tërësi nevojat edhe për një territor shume me të gjerë. Nga niveli i zhvillimit dhe i efikasitetit të ndërtimtarisë, do të varet mjaft shumë realizimi i programeve për integrim rajonal dhe më gjerë.

3) Ndërmarrjet ndërtimore- janë shfrytëzuese relativisht të mëdha të hapësirës. Andej janë analizuar dhe planifikuar, hapësirat që mund të shfrytëzohen për depo, separimin e zhavorrit dhe të materialeve të tjera, për prodhimin e masës së betonit dhe të parafabrikateve nga betoni, për vendosjen dhe punën e bazave të makinave dhe të oficinave të riparimit, për punë të reparteve të ndryshme (muratoresh, armiruesish, mekanikësh, drugdhendësish, elektrikistësh, punimesh përfundimtare, etj.), për parkimin e makinave, magazina, repartet tjera dhe shërbime. Një pjesë e hapësirës për nevojat e ndërtimtarisë do të vendoset në zonën industriale, edhe në periferi të disa vendbanimeve, porse pjesa më e madhe e hapësirës është e domosdoshme të jetë në vendin ku është selia e ndërmarrjes, respektivisht e reparitit. Me rastin e hartimit të planit urban për qytetin është paraparë kjo hapësirë që të jetë në të gjitha zonat, duke respektuar standardet dhe me trajtim gjatë hartimit të planeve rregulluese për vendbanimet, ku patjetër duhen të parashihen më hollësisht nevojat dhe qëllimi i hapësirës për ndërtimtarinë (zyra kompanish dhe byro projektuese), gjë që varet nga madhësia dhe struktura e ndërmarrjeve. Këtu duhet pasur parasysh se, disa hapësira që mund të përdoren përkohësisht, kurse lokacioneve të ndryshme duhet t'u garantohet siguri përkates për punë të ndërtimtarisë.

### 3.2.1.9 Transporti, Telekomunikimi, Bartja dhe Lëvizshmëria

Zhvillimi i dëshiruar hapësitor, është ngushtë i lidhur me planifikimin e transportit dhe trafikut. Përparësitë e lëvizshmërisë, gjithnjë në rritje janë peshuar kundrejt kostove mjedisore, sociale dhe ekonomike që sistemi i transportit paraqet.

Grupet punuese dhe të gjithë aktorët e kyçur në procesin e planifikimit kanë paraparë që transporti dhe trafiku që përdoret për lëvizshmërinë e njerëzve, mallrave edhe për vendbanimet dhe qendrat tjer, të jetë i organizuar me këtë koncept: **transport të qëndrueshëm dhe inteligjent**.

Ky zhvillim do të ketë për bazë integrimin brenda dhe mes llojeve të ndryshme të transportit, shfrytëzimin e masave teknologjike dhe jo teknologjike.

Në këtë drejtim duhet të punohet në përmirësimin qashtëmërisë në hapësirat, vendet qendrore dhe nënqendrat e që është kusht kryesor për zhvillim ekonomik.

- Përmirësimi i qasjes në sistemin e transportit;
- Ngritja e sigurisë në trafik;
- Përmirësimi i gjallërisë së trafikut;
- Reduktimi i ndikimit negativ të trafikut në mjedis.

### 3.2.1.10 Komunikacioni automobilistik

Numri i të inkuadruarve do të vazhdojë të marrë pjesën kryesore në komunikacionin e përgjithshëm të komunës. Në komunikacionin automobilistik të komunës për transportin e të mirave materiale, por edhe të njerëzve barrën kryesore do të vazhdojë ta mbajë sektori privat. Përmirësimi i cilësisë si dhe shpërndarja e rrjetit rrugor, duhet të bëhet në funksion të rritjes së shpejtësisë së lëvizjes së udhëtareve dhe të mallit.

Kapacitetet ekzistuese duhet të modernizohen, fuqizohen dhe kompletohen, dhe në vazhdimësi duhet t'u përgjigjen nevojave dhe standardeve.

Numri i të gjithë tipave të automjeteve është në rritje të vazhdueshme dhe ky trend pritet të vazhdojë, aq më parë kur dihet se në këtë komunë nuk ka rrjet hekurudhor. Si detyra prioritare (parësore) janë modernizimi i rrjetit rrugor ekzistues dhe ndërtimi i tërësishëm i tij me hapjen e vijave të reja drejt kufirit me Serbinë, si dhe plotësimi me infrastrukturën e tjera të komunikacionit (serviset për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve, garazhat, stacionet e autobusëve, pompat e benzinës, ndërtesa për vendosjen e shërbimeve të caktuara etj.). Të gjitha këto do të siguronin një kapacitet më të madh të qarkullimit komunikacional dhe do të përmirësonin cilësinë e tij eksploatuese .

- Në këtë drejtim: •Ndërtimi i rrjetit të ri rrugor (1. Kamenicë – Kapi – Medvegjë, 2. Kamenicë – Krilevë – Podujevë – unazat e Kosovës, 3. Kamenicë – Hogosht – Desivojcë – Guri i Zi – Vllasë, 4. Kamenicë – Berivojcë – Koretin – Dajkoc – Muçivërc – Rogaçicë – Karaçevë e Poshtme – Muhoc, 5. Kamenicë – Bullaj – Zllatar – Prishtinë, 6. Hogosht – Lisockë – Zhujë – Shahiq – Gjyrishec – Sfvircë – Banja e Sijarinës, 7. Unaza e qytetit të Kamenicës), si dhe përmirësimi i rrjetit rrugor ekzistues me infrastrukturë përcjellëse në drejtim të Serbisë, ndërtimi i vijës hekurudhore (1. Podujevë - Kamenicë – Dheu i Bardhe – Bujanoc) me korridoret VIII-të dhe X-të.

**Trafiku urban-** në Komunën e Kamenicës , respektivisht në qytet tash për tash nuk ekziston. Ndërkaq në perspektivë me zgjerimin dhe me rritjen e qytetit, urbanizimin e vendbanimeve dhe me ndërtimin e rrugëve urbane dhe ndërrbane duhet pritur zhvillimin e tij, por që zhvillimi i paraparë ekonomiko-social dhe mjedisor do të kërkojë qarkullim më të madh dhe më cilësor të udhëtareve brenda qytetit, vendbanimeve dhe drejtë qendrave tjera komunale. Numri i të punësuarve është i konsiderueshëm por në të ardhmen duhet të rritet shumëfish.

### 3.2.1.11 Komunikacioni Hekurudhor

Parashikohet të marrë rolin e vetë në zhvillimin ekonomik, me hapjen e vijës hekurudhore Ferizaj – Gjilan dhe korridoret VIII dhe X në funksion të bartjes së të mirave materiale dhe njerëzve.



Parashikohet që edhe stacionet hekurudhore të jenë në funksionin e njëjtë dhe të afrohen sa më afër zonave industriale dhe qarkullimit të udhëtarëve.

### **3.2.1.12 Komunikacioni Telekomunikimit, PTK-së dhe operatorëve privatë**

Në perspektive numri i postave, numri i aparateve telefonike dhe i aparateve të tjera si dhe vëllimi i shërbimeve të internetit dhe kabllorë duhet të rritet shumë, kurse shërbimet e PTK-së dhe operatorëve tjerë privatë të modernizohen. Numri i të punësuarve duhet të rritet shumëfish. Mbulimi i tërë territorit të Komunës së Kamenicës me rrjet të internetit, fuqizimi i rrjetit në nivel të standardeve evropiane, vendosja e centraleve periferike, ofrimi i shërbimeve të brezit të gjerë, vendosja e antenave të reja PTK-VALA, në vendbanimet ku rrjeti ekzistues është i viteve 90-ta, duhet të vendoset rrjeti i ri, ndërtimi i objekteve postare në vendbanime. Mbulimi i tërë territorit me rrjet të telefonisë fikse, përmirësimi i rrjetit kabllor dhe ofrimi i programeve televizive HD, zhvillimi i industrisë për përfitime njerëzore, aprovimi i kornizës legale për e-Commerce dhe e-nënshkrimi; edukimi i shfrytëzuesit potencial të shërbimeve telekomunikuese në komunën e Kamenicës. Përmirësimi i kualitetit të jetës nëpërmjet qasjes në shërbimet telekomunikuese, krijimi i një ekonomie stabi le të bazuar në modele konkurruese prodhuese, duke shfrytëzuar shërbimet informative. Të vendoset sistemi integral dhe i përgjithshëm telekomunikues deri te E-qeverisja.

Zhvillimi i komunikacionit dhe i veprimtarive komunikuese të caktuara në Komunën e Kamenicës, duhet ti kontribuojnë përmirësimit të sistemit të komunikacionit e të lidhjeve në tërësi. Me modernizimin dhe rikonstrukcionin e rrugëve ekzistuese, pastaj me ndërtimin e paraparë të rrugëve automobilistike dhe të rrjetit rrugor urban e ndërurban me zgjerimin e rrjetit, shërbimeve dhe të kapaciteteve të PTK-se, do të krijoheshin mundësi të reja për transport më racional kombëtarë e ndërkombëtar, si dhe për lidhje më të mirë me territoret fqinje.

Nisur nga gjendja e tanishme dhe nga nevojat për transport masiv, atëherë komunikacionit publik duhet kushtuar kujdes të veçantë.

Organizimi i komunikacionit urban dhe ndërurban, duhet të jetë pjesë përbërëse e zhvillimit të qytetit dhe vendbanimeve të Komunës së Kamenicës.

Zhvillimi i paraparë socialo-ekonomik dhe mjedisor i komunës, gjatë periudhës së ardhshme mundëson një zhvillim shumë më të shpejtë të veprimtarisë së komunikacionit, vëllimi i shërbimeve të komunikacionit duhet shtuar, gjithashtu edhe numri i të inkuadruarve.

**Ndërtimi i hekurudhës Ferizaj--Gjilan dhe në drejtim të korridoreve VIII dhe X, mandej hapja e pikave kalimtare e doganore në drejtim të Serbisë, si dhe lidhja më e shkurtër e më e shpejtë me Prishtinën, do të rrisë mundësinë e zhvillimit të bizneseve dhe përmirësimit të jetës së qytetarëve të Komunës së Kamenicës.**

Modernizimi dhe kompletimi i infrastrukturës energjetike.

### **3.2.1.13 ZEJTARIA, TREGTIA, TURIZMI, HOTELERIA, SISTEMI BANKAR DHE DISA VEPRIMTARI TJERA SHËRBYESE**

#### **3.2.1.14 ENERGJIA**

Edhe në të ardhmen konsumi i energjisë elektrike për Komunën e Kamenicës do të mbështetet në TC në Obiliq.

Mirëpo pas analizës së gjendjes në këtë fushë, të vetëdijshëm se furnizimi i rregullt me energji ka rëndësi tejet të madhe për ekonominë, Komuna e Kamenicës, duhet të tentojë të arrijë një shkallë të furnizimit të pavarur me energji.

Burime të mundshme potenciale janë energjia alternative, nga era (Kika), biomasa (ashkla, mbeturina organike, sanë), energjia diellore dhe pa dyshim uji edhe gjeotermalet.

Janë të nevojshme studime të mëtutjeshme të fizibilitetit, të cilat duhet të përqendrohen në potenciale natyrore të zonave përkatëse.

### **3.2.1.5 ENERGJIA NGA ERA dhe AJO DIELLORE**

Duke pasur parasysh ndryshimet klimatike ne planetin e tokës dhe ngrohjen globale , gjithsesi duhet të mendojmë në mundësitë alternative të prodhimit te energjisë elektrike.

Në komunën tonë është duke u hulumtuar mundësia e prodhimit te energjisë elektrike nga era. Eksperimenti është duke u zhvilluar në Kikë, ku është duke dhënë rezultate te kënaqshme. Duhet një angazhim i madh i strukturave komunale në mënyrë që të sjellim investitorë që do të investojnë në këtë fushë.

Meqenëse, Kamenica ka kushte relativisht të mira klimatike me shumë ditë me diell, duhet të shqyrtohet mundësia e shfrytëzimit të energjisë diellore për energji termike, si dhe përfitimi i energjisë elektrike përmes paneleve fotovoltike (si qëllim afatgjatë). Në këtë kontekst është i preferueshëm shfrytëzimi i sipërfaqeve të kulmeve apo të ngjashme, me qëllim të kursimit të sipërfaqeve të lira tokësore (stimulimi i atyre që ndërtojnë objektet dhe shfrytëzojnë energjinë solare për ngrohje me lirime në përqindje nga taksat dhe pagesat për leje ndërtimi)

### **3.2.1.6 BIOMASA**

Në zonat rurale të cilat kanë nivel të lartë të prodhimitarisë bujqësore dhe pyjore, duhet të nxitet përdorimi i biomasës në mënyrë që të rriten mundësitë për energji, sidomos në fshatrat e largëta. Prodhimi i mëtutjeshëm i energjisë nga biomasa, nxitë rritjen e prodhimitarisë bujqësore dhe i ruan vlerat vendëse. Në këtë drejtim duhet të mendohet edhe energjia e mundshme nga mbeturinat

### **3.2.1.7 UJI**

Në përputhshmëri me konceptin mjedisor, si dhe duke u bazuar në faktin që ka zona të pasura me burime ujore, ndërtimi i pendave (digave) do të mundësojë edhe energjinë nga hidrocentralet, pra mund të shqyrtohet ndërtimi i hidrocentraleve të vogla. Ndërtimi i pendës dhe hidrocentralit do të ishte një alternativë dhe mundësi e qëndrueshme energjetike.

### **3.2.1.8 KURSIMI I ENERGJISË**

Në kuadër të zonave urbane e sidomos në ndërtesat që menaxhohen nga komuna dhe ato të banimit kolektiv, konceptet e energjisë të bazuara në shembujt e kontraktimit, ofrojnë forma efikase që iu mundëson autoriteteve vendëse të zbatojnë masa bashkëkohore të kursimit të energjisë (p.sh. izolimi, sistemet efikase të ngrohjes etj.). Përveç kursimit të mjeteve financiare, komuna përmes shembujve dhe përdorimit, mundet që banorëve t'u ofrojë një potencial të madh në kursim. Duhet të startojmë me ndërtimin e shtëpive PASIVE. Kjo do te thotë, të ndërtojmë objekte banimi, objekte të ofrimit te shërbimeve publike, të cilat objekte do të funksionojnë me përdorimin e energjisë alternative dhe njëherazi nuk do te kenë nevojë për sasi te mëdha te energjisë. Më shumë investime te përdoren për izolime të objekteve dhe për energji alternative. Komuna të stimulojë ndërmarrjet ndërtimore, të cilat ofrojë kësi lloji programeve te ndërtimit.

### **3.2.1.9 ZEJTARIA**

Do të vazhdojë të mbetet një fushë e rëndësishme për zhvillim ekonomik në komunën e Kamenicës, parashikohet të krijohen hapësira dhe kushte për të gjitha **Veprimtaritë zejtare** qoftë në zejtarinë prodhuese, shërbuese, artistike dhe të artizanaleve, ofrimi i kushteve në

funksion të më shumë shanse për të dalë nga tregu i vogël vendas drejt atij rajonal dhe Evropian, Planifikimi, projektimi dhe plotësimi i infrastrukturës për të rregulluar mënyrën e operimit të artizanëve, ushtrimin e aktivitetit të tyre, organizimin e zejtarisë dhe shkollimin profesional në zeytari. Dhe, në fund, por jo më pak e rëndësishme, është lënia e trashëgimisë së mjeshtërisë së punës, pjesëtarëve të tjerë të familjes apo komunitetit, Krijimi i një zyre të veçantë për zeytari e cila do të punoj në sigurimin e programeve dhe projekteve të ndryshme, zhvillimin dhe zbatimin e programeve për asistencë teknike, shërbimin, këshillimin në dobi të zejtarisë, rritjen e aftësive të sipërmarrësve, trajnimin dhe kualifikimin profesional të artizanëve, Krijimi i një shoqate të mirëfilltë zejtarësh për informim, sigurim dhe fuqizim tregu si dhe ndërtimi i zonës së zejtarëve në qytetin e Kamenicës, në nënqendrat dhe disa vendbanime specifike priten në të ardhmen e afërt.

### 3.2.1.10 TREGTIA

Do të vazhdojë të mbetet një degë prioritare e zhvillimit ekonomik të komunës (Sipas llojit dhe aktiviteteve bizneset tregtare do të vazhdojnë të kenë përqindjen më të madhe nga numri i përgjithshëm i bizneseve në Komunë),

**Tregtia me shumicë** (Depot që dhe hapësirat tjera varësisht nga natyra e artikujve) janë të zhvilluara dhe vazhdojnë të zhvillohen edhe më shumë, preferohet të jenë të vendosura në zonën industriale.

Është e zhvilluar dhe vazhdon të zhvillohet edhe **tregtia me pakicë** kjo veprimtari do të zhvillohet në qytet dhe të gjitha vendbanimet e Komunës së Kamenicës.

Në komunën e Kamenicës do të vazhdojë organizimi edhe **i tregjeve të hapura** në qytetin e Kamenicës dhe Rogaçicë, të cilat janë:

- tregu i kafshëve
- tregu me artikuj të përzier.

Do të vazhdojë me përkrahje për **tregjet e hapura ditore** publike dhe private në Komunën e Kamenicës. Parashikohet **zgjërimi i tregjeve** të hapura njëditore edhe në disa vendbanime të mëdha, si dhe plotësimi i këtyre aktuale dhe atyre të mundura me përmbajtje dhe infrastrukturë. Gjithashtu, parashihet themelimi i së paku një tregu të gjelbër të prodhuesve vendës në baza të përditshme, publik ose privat në qytet. Komuna, respektivisht drejtoria për bujqësi, duhet ti identifikojë prodhuesit vendës, në bashkëpunim me ta të krijojë një ofertë të markës (brend) komunale. Një broshurë ku prodhuesit vendës do të ketë logot e veta për produktet e veta. Kjo do të ishte një mundësi e mirë, që ato të njihen në treg. Në bashkëpunim me entitetet, të cilat i menaxhojnë tregjet, të kërkojnë që prodhuesit vendës të lirohen nga taksa e shfrytëzimit të tregut, apo ato të jenë simbolike, si dhe në treg të kenë vendin e caktuar të identifikuar me logot e prodhuesve individual. Kjo do të jetë një mundësi e mirë edhe për ndërgjegjësimin e qytetarëve për konsumimin e produkteve vendëse.

Planifikimi dhe ndërtimi adekuat i infrastrukturës në hapësirat ku zhvillohet tregtia edhe ajo transportuese, planifikimi dhe organizimi i tregjeve dhe salloneve të automjeteve, mandej planifikimi dhe ndërtimi i infrastrukturës për organizimin e panairëve. Gjithashtu, organizimi i një qendre për rritje të kapaciteteve të tregtarëve, favorizimi me politika, programe dhe projekte të prodhimit vendës për treg, stimulimi i shitjes së prodhimeve vendëse. Përkitazi për këtë, fuqizimi


i prodhuesit dhe produktit vendës dhe vendosja e konkurrencës mes tyre, do të stimulojë marrjen me prodhimtari në degë të ndryshme e që do të ndikojë në shtimin e numrit të punëtorëve në lëmin e bujqësisë.

### **3.2.1.21 TURIZMI**

**Turizmi natyror:** - Zona malore e komunës shquhet me potencial të madh, i cili do të trajtohet në mënyrë adekuate për zhvillimin e turizmit të bazuar në natyrë. Në këto zona parashikohet të zhvillohet infrastruktura dhe përmbajtjet për sporte malore, si shtigje të ecjes e shëtitje, vrapime e çiklizmi malor, kalërimi. Këto aktivitete të rekreacionit, planifikohen së bashku me shërbimet e akomodimit privat nëpër fshatra, duke ofruar me qira shtëpitë në fermat të cilat mund të sjellin të ardhura shtesë për fermerët, ku planifikohen zona vikendi. .Kjo mund të arrihet nëse ndërtohen pendat dhe nëse investohet në terrene rekreative sportive. Monumentet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, paraqesin pikat e atraksioneve turistike. (resurset të pasura natyrore, uji, dhe pyjet, biodiversiteti), trashëgimi kulturore, trashëgimi arkeologjike( si kulina në Kamenicë, kështjella në Kopërnice, Ghyrishec, si dhe mbetjet e shumë kishave të kohës ilire në vendbanime të ndryshme të Komunës së Kamenicës.

**Turizmi shëndetësor:** Ajri i pastër, mjedisi i qetë dhe peizazhet e bukura në malet e Kamenicës, veçmas në Desivojcë, Gmicë, Planicë dhe Kikë, janë të përshtatshme për zhvillimin e turizmit shëndetësor. Në këto zona mund të ndërtohet një qendër rehabilituese për sëmundjet e mushkërive.

**Turizmi rural:-** Turizmi rural është i lidhur me zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë. Në zonat e lartpërmendura, kemi edhe fermerë të zhvilluar të cilët mund të ofrojnë shërbime të akomodimit, duke dhënë me qira dhoma ose shtëpi të vogla për ata që dëshirojnë të shfrytëzojnë shërbimet cilësore të bujqësisë dhe blegtorisë, natyrës dhe gjahut. Turizmi rural mund të ketë një perspektivë të mirë, varësisht nga angazhimet tona. Duhet të themelohen shoqatat e turizmit, zyra të informacionit, broshura me oferta vendëse, pra të zhvillohet një marketing i mirë i ofertës turistike të komunës, bashkëpunime ndërkomunale dhe ndërkufitare, prandaj kjo të jetë në funksionin e të kuptuarit të turizmit si veprimtari ekonomike dhe mundësi e përfitimit.



Harta. 40. Zonat turistike në Komunën e Kamenicës

### 3.2.1.22 HOTELIERIA

Nisur nga Vizioni për të ardhmen e komunës, nga vlerat e trashëgimisë dhe resurset tjera hoteliera në funksion të zhvillimit ekonomik duhet zgjerohet dhe fuqizohet me përmbajtje, duhet të punohet që të bëhet e mundur ndërtimi me një standard dhe cilësi të lartë të objekteve hoteliere, objektet për vendosje (bujtje), si dhe objektet për ushqim e pije edhe atë sipas këtyre kategorive:

**Hotelet:** hoteli, fshat turistik, apart-hotel, fshat apartamentesh, moteli, pensioni, etj.

Kampet dhe llojet e tjera të objekteve hoteliere për vendosje si : kampi, dhomat me qira, apartamentet, hoteli-hostel për rininë, shtëpia e alpinistëve, pushimorja, bujtina, etj.

**Restorantet:** restoranti, taverna, restoranti nacional, restorant qumështi, kafeneja,

piceria, qebaptorja, kuzhina popullore, byrektorja, etj., **Baret:** bari, bar- nate , disko-bar, etj.

**Bufetë:** bufeja, birraria, bistroja, etj. **Kafenetë:** kafeneja, bar – kafeneja, kafe-ëmbëltore, etj. Kantinat dhe përgatitja e racioneve ushqimore.

#### **Kapacitete rehabilituese dhe shërues, në malësinë e Kamenicës**

Të gjitha këto do të bëhen sipas planit të zonave turistike, duke krijuar partneritete në këtë fushë dhe duke themeluar qendër informimi, trajnimi dhe këshillimi.

### 3.2.1.23 SISTEMI BANKAR

Bankat për zhvillimin e ardhshëm ekonomik të Komunës së Kamenicës, parashihen të jenë promotor, duke kredituar zhvillime të ndryshme, duke filluar nga institucionet mikrofinanciare, të cilat pritet të vazhdojnë të kreditojnë ekonomitë familjare, bizneset e vogla dhe agrobizneset. Gjithashtu, pritet mbështetje me kredi nga ana e bankave që operojnë në komunë për sektorin privat, investimet koncesionare dhe në disa raste edhe për sektorin publik, duke filluar me sektorin e energjisë rinovuese. Kosova pritet të lëvizë drejtë anëtarësimit në BE, ku në këtë drejtim edhe çdo pjesë e territorit të Kosovës. Dihet shumë mirë që në BE ka direktiva shumë të qarta për energjinë e rinovueshme (e përtritur). Është një rast i madh për Komunën e Kamenicës të bëjë investim koncesionar në këtë fushë. Bankat që operojnë këtu, veprojnë në sistem të avancuar me standarde evropiane e që shpresohet shumë të shfrytëzohen mundësitë e reja në anëtarësimin të Kosovës në FMN dhe Bankën Botërore. Tashmë, janë krijuar rrethana dhe kushte më të favorshme për kredimarrësit e depozituesit, në të kohë të njëjtë parashikohet, që në të ardhmen të kemi rritje të cilësisë dhe sasisë së shërbimeve bankare. E gjithë kjo do të përcillet me një nivel më të lartë të qëndrueshmërisë së këtij sektori, si dhe mundësive për kreditime me interesa më të ulëta edhe me paketa më të gjera në të gjitha fushat, duke filluar prej bujqësisë, industrisë deri te turizmi.

## **3.2.2.INFRASTRUKTURA , TRANSPORTI KOMUNAL, KOMUNIKIMET**

### **3.2.2.1 INFRASTRUKTURA SI SISTEM PËR ORGANIZIMIN FUNKSIONAL TË HAPËSIRËS**

Rrjeti dhe cilësia e infrastrukturës së paraparë do të paraqesë bazën e integritit hapësinor, si dhe parakushtin e parë të arritjes së zhvillimit harmonik. Lidhja integrale e infrastrukturës në hapësirë, do të jetë prioritet përmbajtjesor i Planit Zhvillimor Komunal për hapësirën e Komunës së Kamenicës. Drejtimet themelore të infrastrukturës do të iniciojnë polarizimin e potencialeve ekonomike si dhe koncentrimin e popullsisë. Drejtimet e parapara, në radhë të parë cilësia e tyre dhe rëndësia funksionale, duhet ti kontribuojnë realizimit të drejtpeshimit hapësinor dhe të përgjithshëm të Komunës së Kamenicës.

Infrastruktura në Komunën e Kamenicës, duhet të sigurojë integrimin racional territorial të ekonomisë, integrimin e hapësirës me rajonet në fqinjësi dhe në kohë e hapësirë të caktuar, të sigurojë efekte përkatëse në zhvillimin e funksioneve tjera.

### **3.2.2.2 TRANSPORTI KOMUNAL**

#### **Rrjeti dhe sistemi i infrastrukturës së komunikacionit rrugor**

Në territorin e Komunës së Kamenicës nga analizat e gjendjes në komunë, mund të shihet qartë se përbërja me rrugë rajonale e lokale, po ashtu pozicioni dhe cilësia e infrastrukturës rrugore, e bëjnë të jetë në një pozitë të pavolitshme të zhvillimit të komunikacionit, e cila parashikohet të jetë hapësira ku duhet intervenuar fuqishëm me këtë plan edhe atë me ndërtimin i rrjetit të ri rrugor: 1. Kamenicë – Kapi – Medvegjë, 2. Kamenicë – Krilevë – Podujevë – unazat e Kosovës, 3. Kamenicë – Hogosht – Desivojcë – Guri i Zi – Vllasë, 4. Kamenicë – Berivojcë – Koretin – Dajkoc – Muçivërc – Rogaçicë – Karaçevë e Poshtme – Muhoc, 5. Kamenicë – Bullaj – Zllatar – Prishtinë, 6. Hogosht – Lisockë – Zhujë – Shahiq – Gjyrishec – Svirçë – Banja e Sijarines, 7. Unaza e qytetit të Kamenicës, si dhe përmirësimi i rrjetit rrugor ekzistues me infrastrukturë përcjellëse në të gjitha drejtimet që rrjedhin nga qendra në lokale, duke përfshirë edhe trotualet, sinjalizimin horizontal, ndërtimin e rrugëve bujqësore-pyjore në çdo vendbanim etj.

#### **Zhvillimi i motorizimit**

Norma e lartë e rritjes së numrit të automjeteve nga periudha e kaluar, sidomos e veturave, do të vazhdojë edhe gjatë periudhës së ardhshme, sidomos të veturave në pronën individuale, rrita e standardit por edhe e numrit të banorëve në qytetin e Kamenicës, si dhe e disa vendbanimeve të tjera do të ndikojnë më së shumti në rritjen e numrit të automjeteve.


Parashikimet dëshmojnë se, mund të pritët që norma e rritës së automjeteve të sillët prej 8 deri 10% në vit, dhe se në këtë komunë deri në vitin 2020 do të jenë prej rreth 9000 deri 12000 automjete.

Shkalla e motorizimit do të sillej rreth 231 vetura në 1000 banorë, respektivisht rreth 4 banorë për një veturë. Shkalla e motorizimit në qendër, natyrisht mund të jetë më e madhe.

Struktura e automjeteve do të shkojë në favor të veturave, pjesëmarrja e tyre do të jetë rreth 75% nga numri i përgjithshëm i automjeteve.


#### **Objektet, pajisjet, serviset dhe cilësia e shërbimeve në komunikacion**

Gjatë periudhës së ardhshme zhvillimin e komunikacionit të kësaj komune, e kushtëzon përveç ndërtimit dhe rikonstruktimit të rrugëve edhe kompletimi i sistemit të objekteve përcjellëse të komunikacionit. Në këtë funksion janë paraparë edhe stacioni i autobusëve në Kamenicë, vend ndaljet pranë rrugëve me ndërtimin e strehëve, janë paraparë edhe ofiçinat e serviseve e të riparimeve, pompat e benzinës dhe të lyerjes, motelet e kampet e pushimit dhe të çlodhjes.



Harta.41 infrastruktura e transportit në Komunën e Kamenicës





Harta.42 Rrjeti rrugor në Komunën e Kamenicës

### 3.2.2.3 KOMUNIKIMET

#### ➤ **Komunikacioni ajror**

Transporti ajror – Në komunën e Kamenicës nuk ka aeroport, Më i afërti është aeroporti i “Sllatinës” 90 km nëse merret rruga; Kamenicë – Busavatë – Llabjan – Prishtinë - Sllatinë.

Në perspektivë nuk parashihet ndërtimi i aeroportit, prandaj edhe më tutje kjo komunë do të orientohet në aeroportin e Sllatinës por edhe atë të Shkupit.

Në Kosovë kanë ekzistuar edhe 12 fusha ajrore – aeroporte bujqësore të Aviokosovës dhe një fushë ajrore e Federatës Aeronautike e Kosovës në Dumosh. Shumë prej aeroporteve bujqësore janë në gjendje të keqe fizike dhe pa përkujdesje, ku do shohim nëse do të ruhen këto mundësi për të ardhmen e bujqësisë dhe qëllimeve tjera. Më i afërti për Kamenicën është ai i Gjilanit.

#### ➤ **Komunikacioni hekurudhor**

Në territorin e Komunës së Kamenicës nuk ekziston transport hekurudhor, stacioni më i afërt hekurudhor është stacioni në Ferizaj 60 km, vija hekurudhore Fushë Kosovë-Shkup.

Vetë fakti se, në nivel të Kosovës që nga viti 1963 nuk është ndërtuar asnjë vijë e re hekurudhore, flet mjaft për gjendjen në transportin hekurudhor.

Mungesa e stacioneve hekurudhore dhe largësia nga stacionet momentale, si dhe mosfunksionimi adekuat momental i transportit hekurudhor në nivel të Kosovës, këtë komunë e vë në pozitë shumë të pa volitshme për shfrytëzimin e transportit hekurudhor. Këtu sidomos ka të bëjë me transportin më masiv të mallrave dhe të produkteve.


Me Planë Hapësinor të Kosovës, parashihet ndërtimi i vijës hekurudhore Ferizaj – Gjilan- Ranillug –Bujanoc, që lidhet me vijën Nish-Shkup dhe më tutje drejt korridoreve të rëndësishme evropiane. Kjo vijë kalon nëpër territor të Komunës së Kamenicës, prandaj ky planë duhet të trajtojë trasenë e kësaj vije, si dhe stacionet e nevojshme nga Ranillugu deri në Kamenicë.

#### ➤ **Telekomunikimi**

Zhvillimi i **Komunikacionit të Telekomunikimit, PTK-së dhe operatorëve privat** në Komunën e Kamenicës, do të vazhdojë të mbështetet në zhvillimin integral të këtij komunikacioni në nivel të Kosovës dhe në rajon. Nisur nga gjendja e rrjetit të komunikacionit PTT, qëllimet afatgjata kah të cilat duhet synuar për zhvillimin e këtij komunikacioni të komunës, janë në perspektivë numri i postave, numri i aparateve telefonike dhe i aparateve të tjera, si dhe vëllimi i shërbimeve të internetit kabllor duhet të rritet shumë, kurse shërbimet e PTK-së dhe operatorëve tjerë privat të modernizohen. Shtrirja e fijes optike dhe mbulimi i tërë territorit të Komunës së Kamenicës me rrjet të internetit. Fuqizimi i rrjetit në nivel të standardeve evropiane, vendosja e centraleve periferike, ofrimi i shërbimeve të brezit të gjerë, vendosja e antenave të reja PTK-VALA, Në vendbanimet ku rrjeti ekzistues nuk e mbulon tërë territorin e komunës, ndërtimi i objekteve postare në vendbanime për mbulimin e tërë territorit të komunës dhe mbulimi i tërë territorit me rrjet të telefonisë fikse, si dhe kalimi nga rrjeti ajror në atë nëntokësor.

Përmirësimi i rrjetit kabllor, ofrimi i programeve televizive HD dhe vendosja e antenave televizive. Gjithashtu, propozohet që të vendosen foltore publike në të gjitha vendbanimet ku ka rrjet të telefonisë fikse, si dhe në ato ku do të shtrihet rrjeti.

këto mundësi për të ardhmen e bujqësisë dhe qëllimeve tjera, më i afërti



Harta.43. Telekomunikimi në Komunën e Kamenicës

### 3.2.24 INFRASTRUKTURA E ENERGJETIKËS

#### Rrjeti energjetik

Nga analiza e gjendjes në profil, qartë është konstatuar se rrjeti distributiv (shpërndarës) ekzistues në pjesën më të madhe është i ndërtuar para më se 35 vjetësh, që d.m.th. se, linjat ajrore janë në gjendje të keqe teknike, ndërsa kabllot që tani furnizojnë shpenzuesit janë elektrikisht të dobësuar, veçanërisht kabllot e tensionit 10kV, të shtrira në kanale pa kanalizim kabllor. Shumica e trafostacioneve janë të tensioneve 10/0.4 kV..

Duke u nisur nga gjendja ekzistuese, si dhe propozimeve arkitektonike SEE distributiv duhet të bëhet në përputhje me dy rekomandime të dhëna në vazhdim:

**REKOMANDIMET E MASTER PLANIT PER ZHVILLIMIN E SISTEMIT DISTRIBUTIV TË KOSOVËS DERI MË VITIN 2015, QË PËRFSHINË:**

- Eliminimin gradual të TS 35/10kV dhe kalimin në TS 110/20kV;
- Kalimin nga rrjeti distributiv 10kV në rrjetin distributiv 20kV;
- Zëvendësimin e TS 10/0.4kV me ata 20/0.4kV;
- Zëvendësimin i linjave ajrore 230/400V me kablllo bistek, apo edhe kablllo nëntokësorë.


**REGULLORET E IEC, IEEE DHE ANSI QË PËR PROJEKTE TË REJA NË VENDE URBANE, LINJAT E FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE DHE ATO TË RRJETIT TELEKOMUNIKUES TË NDJEKIN TË NJEJTËN TRASË DHE TË REALIZOHEN NË TËNJËJTËN KOHË.**

Rekomandimet dhe rregulloret e lartshënuara obligojnë, që SEE dhe SK të realizohen ashtu që:

në pjesët rurale të Komunës së Kamenicës, ku tani janë të ndërtuar LP 10(20)kV me shtylla druri dhe beton, duhet të planifikohet ndërtim i LP të ri, vetëm për tensione punuese 20kV në mënyrë, që gradualisht të mundësohet kalimi në tensionin 20kV.

Rrjetet e tensionit të ulët duhet të planifikohen, gjithashtu me shtylla betoni dhe me kablllo vetëmbajtëse alumini. Në këto shtylla duhet të planifikohet edhe ndriçimi publik i rrugëve.

Ndriçimi publik i rrugëve kryesore të fshatrave do bëhet me llamba nanollamba të vendosura në shtylla metalike me lartësi (8-10)m. Kycja dhe shkycja e llambave do të jetë automatike, ndërsa në kohën kur rrugët nuk janë shumë të frekuentuara (pas mesnate) llambat në mënyrë automatike do të ndizen në gjysmën e fuqisë nominale.



Harta.44. Rrjeti energjetik në Komunën e Kamenicës

### **3.2.2.5 LINJAT E VEÇANTA PËR INTERVENIM NË RRJETIN 10KV**

Duke u bazuar nga analiza e rrjetit elektrik që është bërë në terren nga ekspertët në bashkëpunim me KEK-un, është konstatuar se në disa pjesë me prioritet duhet të intervenohet dhe të kalohet nga sistemi 10KV në atë 20KV, si dhe është parë nevoja për instalimin e disa trafove në disa fshatra të Komunës së Kamenicës (shih hartën).

Rrjetet në të cilat duhet të intervenohet me prioritet dhe të kalohet nga sistemi 10KV në atë 20KV janë: Rrjeti Berivojcë – Muçivërc – Karaçevë, Berivojcë – Kamenicë – Strezoc, Berivojcë – Koretin – Topanicë – Hodonoc, si dhe përforcime të rrjetit 10KV aktual gati në gjitha vendbanimet.

### **3.2.2.6 GAZI DHE NAFTA**

#### **Rrjeti i gazpërçuesit**

Gazi energjetik në strukturën e konsumit energjetik gjithnjë e më shumë po zë vend të rëndësishëm, përdorimi i gazit për ngrohje, në industri ka përparësi të shumëfishtë dhe shpenzimet e kalorive të dobishme janë më të ulëta, ku dukshëm zvogëlojnë ndotjen e vendbanimeve.

Dikur bëhej edhe prodhimi i gazit teknik në KXEK "Kosova", mirëpo tani furnizimi i Kamenicës me gaz mund të bëhet nga gazpërçuesi Shkup – Nish, në linjën e mundshme Bujanoc - Kamenicë – Prishtinë. Varianti tjetër është, gypi ekzistues i gazsjellësit në relacionin Kosova A – Shkup, i cili ka funksionuar deri në vitin 1986 ku e ka furnizuar me gaz shkretoren në Shkup, fabrikën e çimentos në Han të Elezit dhe ngrohtoren në Prishtinë.

Linja prej Shqipërisë.

#### **Nafta**

Nga aspekti i furnizimit me naftë dhe prodhimit të naftës, edhe Kamenica si e tërë Kosova do të vazhdojë të varet nga importi i naftës dhe derivatet e saj. Importi, kryesisht do të vazhdojë të realizohet përmes transportit rrugor, përmes rrugëve magjistrale dhe rajonale por edhe rrjetit hekurudhor. Udhëzimet e BE-së për sistemin energjetik, e posaçërisht për sektorin e naftës dhe derivateve të naftës, janë të fokusuara në ndërtimin e rezervuarëve për naftë, me qëllim që të sigurohen rezervat, në rast të mungesës së furnizimit apo në rast të restriksioneve të furnizimit.

### **3.2.2.7 INFRASTRUKTURA HIDROEKONOMIKE**

#### **Infrastruktura për furnizim me ujë**

Analiza e gjendjes në komunë sa i përket infrastrukturës së ujësjellësit, është bërë nga ekipi i planifikimit së bashku me një analizë hidroekonomike ku janë analizuar nevojat për së paku 15 + vjet në kuadër të nevojave për ujë janë analizuar : nevojat për ujë të popullsisë, industrisë , bujqësisë etj. dhe është konstatuar se:

Duhet të bëhet avancimi, kompletimi dhe modernizimi i infrastrukturës së furnizimit me ujë edhe në zonat të cilat kanë rrjet të infrastrukturës së ujësjellësit, duke përfshirë edhe qytetin e Kamenicës i cili do të vazhdojë të furnizohet me ujë nga burimi i drenazhimit i vendosur nën shtratin e Lumit "KRIVA REKA", i cili bën furnizimin e pesë (5) puseve të hapura dhe tri (3) puseve të shpuara nga të cilët përmes pompave horizontale dhe zhytëse mbushet rezervuari me kapacitet prej 142 m<sup>3</sup> dhe pastaj me anë të pompave tjera bëhet distribuimi në rrjetin kryesor të ujit. Tani është në përfundim e sipër, projekti për furnizim me ujë të pijshëm në një pjesë të Lagjes "MALËSIA" në Kamenicë nga një rezervuar me kapacitet prej 300 m<sup>3</sup>.

## Stacioni i Pompimit Nr.2

Uji i pijshëm në këtë stacion vjen nga dy puse të shpuara në thellësi prej 54 m, të cilët e mbushin një pus të hapur dhe nga këtu përmes pompave horizontale bëhet distribuimi i ujit në rrjetin kryesor të qytetit.

### **Kapaciteti prodhues i ujit të pijshëm**

Kapaciteti instalues i prodhimit të ujit në Stacionin e Pompimit Nr.1 është 28 litra/sec, kurse në Stacionin e Pompimit Nr.2 është 14 litra/sec d.m.th. kapaciteti total mund të jetë 42 litra/sec. Nga kjo mund të llogaritet se bilanci vjetor i prodhimit të ujit mund të jetë 1.306.368 m<sup>3</sup> ujë. Mirëpo ky kapacitet nuk mund të arrihet asnjëherë për disa shkaqe të ndryshme, ku më kryesoret janë:


1. Mungesa e ujit të pijshëm në vendburime të ujit, sidomos gjatë stinës së verës;
2. Ndërprerja e energjisë elektrike.

### Parashikohet:

- planifikimi i zgjerimit të rrjetit të ujësjellësit dhe shtrirja e rrjetit në vendbanimet që nuk kanë sistem të furnizimit me ujë, siç shihet në hartën "Infrastruktura e furnizimit me ujë";
- ndërtimi i njëres nga pendat në lumin e Desivojcës, Kremenatë, Gjyrishec dhe infrastrukturës për furnizim me ujë të pijes, për ujitje e përdorime tjera;
- ndërrimi urgjent i gypave të cilët janë ende me azbest e çimento në zonën urbane, etj.







Harta.46. Ndjeshmëria e ujërave në Komunën e Kamenicës

### **3.2.2.8 RRJETI I KANALIZIMIT TË UJËRAVE TË ZEZA DHE ATMOSFERIKË**

#### **Infrastruktura për largimin dhe trajtimin e ujërave të përdorura**

Analiza e gjendjes në komunë sa i përket infrastrukturës së ujërave të zeza dhe atmosferikë, është bërë nga ekipi i planifikimit dhe parashikohet që në të ardhmen të kemi: sisteme të ndara të ujërave fekale dhe atmosferike në të gjitha vendbanimet, duke filluar nga qyteti i Kamenicës.

Planifikimi i funksionalizimit të disa segmenteve me rrjet të vjetër, me profil jo adekuat ose për nevoja më të gjera, duhet të bëhet edhe në vendbanimet që kanë rrjet duke filluar nga qyteti.

Trajtimi me prioritet i disa vendbanimeve me sistem gjysmë kanalizimi.

Planifikimi i lidhjeve të rrjetit, gjatë hartimit të projekteve kryesore të largimit të ujërave të zeza në nivel të vendbanimit në harmoni me kolektorin kryesor (siç shihet në hartën "Kanalizimi dhe Deponitë")

Planifikim dhe ndërtimi i kolektorit kryesor të kanalizimit në nivel komunal në drejtim të Dheut të Bardhë (Komuna e Ranillugut).


Në planin afatgjatë, në Kosovë parashihen që të ndërtohen 7 impiante për trajtimin e ujërave të zeza. Në secilin rajon nga një. Kështu që për rajonin e Gjilanit në të cilin bën pjesë Komuna e Kamenicës, parashihet ndërtimi i impiantit në Komuna Ranillugut-Dheu i Bardhë. Në këtë impiant do të shkarkoheshin ujërat e zeza të Gjilanit, Ranillugut dhe Kamenicës Mirëpo, derisa sa të gjendet mjetet për ndërtimin e këtyre impianteve, në planin afatshkurtër do të duhet që secili qytet të ndërtojë impiantin e vetë ose një gropë septike për një trajtim minimal të ujit të përdorur dhe çdo vendbanim që ka infrastrukturë të kanalizimit, të ketë së paku në dalje gropë septike, edhe lokacioni i tij të jetë i përshtatshëm që në ta ardhëm ujërat që shkarkohen në të, të mund të vazhdojnë deri në kolektorin kryesor që i transporton ato drejtë në impiantin kryesor rajonal. Parashikohet që kolektori kryesor në nivel komunal të përcjell trasenë e rrjedhave dhe të lumit, gjithashtu edhe lidhja e rrjetit kryesor. Përndryshe në rastin kur dëshirojmë që të përcjellim rrugët dhe gjatësitë më të shkurtra të disa fshatra, duhet të përdoren stacione të pompimit të cilat duhet analizuar si zgjidhje në disa aspekte.

### **3.2.2.9 RRJETI I KANALIZIMIT ATMOSFERIK**

Siç u theksua më lartë, kanalizimi atmosferik do të ketë rrjet të posaçëm.

Rrjeti në qytet: të gjitha ujërat atmosferike do të shkarkohen në Lumin "Kriva Reka" dhe në përrenjtë a përroskat më të afërta, duke shfrytëzuar rënien e terrenit ashtu që traseja e kolektorit të jetë sa më e shkurtër e duke pasur kujdes, që në këtë rrjet të kanalizimit mos të shkarkohen ujërat e zeza ose ujërat industriale etj.

Parashikohet edhe rrjeti nëpër vendbanimet tjera për ujëra atmosferike, të jetë i posaçëm ( ndarë nga rrjeti fekal) për secilin vendbanim, të funksionojë sa më shumë që është e mundur si sistem, si dhe të shkarkohen në rrjedhjet më të afërta . Ndërtimi i kanalizimeve atmosferike në çdo aks rrugor me derdhje në lumë dhe përrenjtë më të afërta.



Harta 47. Kanalizimi në Komunën e Kamenicës

### **3.2.2.10 INFRASTRUKTURA PËR MBROJTJEN E UJËRAVE DHE E DEPONIVE**


#### **3.2.2.11 Infrastruktura për mbrojtjen e ujërave nga ndotja**

Për mbrojtjen e ujit në të ardhmen është paraparë:

- Krijimi i infrastrukturës për shmangien dhe trajtimin e ujërave të përdorura dhe të ndyta prej vendbanimeve dhe industrisë;
- Mbrojtjen e ujërave nëntokësore si nga pikëpamja e evitimit të mundësisë së ndotjes, ashtu edhe nga ajo e ndërtimit të pakontrolluar dhe e rrezikimit të hapësirës (shih Hartën Hidrologjike të Kamenicës);
- Ndërtimi i infrastrukturës së deponive të përkohshme në nivel vendbanimi (pastrimi i shtretërve të lumenjve nga mbeturinat dhe hedhja e tyre e organizuar në të ardhmen);
- ndarja e rrjetit të kanalizimeve të ujërave fekale dhe atmosferike në qytet dhe vendbanime tjera;
- Ndërtimi i impiantit ose gropës septike në nivel vendbanimi për pastrimin e ujërave të zeza, si zgjidhje e përkohshme për ta penguar ndotjen e ujit;
- Vazhdimi dhe thellimi i monitorimit të shkallës së ndotjes të Lumit “Kriva Reka” dhe të gjithë lumenjtë tjerë në komunë.
- Që objektet industriale ekzistuese, ngase nuk kanë aparatet pastruese e që ndyjnë lumenjtë, brenda një afati të caktuar të instalojnë aparatet dhe ta shmangin këtë;
- Dokumentacioni investivo-teknik për industrinë e reja, duhet të përmbajë edhe vendimin e pastrimit të gjitha ujërave të përdorura e të ndyta. Puna e kapaciteteve të reja industriale, nuk duhet të lejohet pa u montuar më parë aparatet, të cilat do të sigurojnë pastrimin e ujërave të ndyta në mënyrën e duhur.

#### **3.2.2.12 Infrastruktura e Deponive të Mbeturinave**

- Vazhdimi i shfrytëzimit të infrastrukturës që e ofron deponia rajonale;
- Në nivel vendbanimi ose në dy vendbanime, është planifikuar një deponi e përkohshme me hapësira të ndara për mbeturina ndërtimore, industriale etj.
- Si alternativë e mundshme e deponisë regjionale, është planifikuar një deponi në nivelin komunal;
- Shfrytëzimi i mbeturinave për riciklim dhe mundësisë së prodhimit të energjisë;
- Trajtimi në një hapësirë të caktuar të mbeturinave inteligjente me mundësi deponimi dhe servisimi;
- Shpërndarja e shërbimit për mbledhjen e mbeturinave edhe në zonat rurale;
- Ndërrimi i mënyrës së mbledhjes dhe menaxhimit të mbeturinave;
- Janë parashikuar varrezat e kafshëve dhe mundësitë e asgjësimit masiv në raste emergjente, për shkak të sëmundjeve dhe arsyeve tjera të kafshët ose shpezët.




Harta. 48. Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Kamenicës

### 3.2.2.13 Infrastruktura për rregullimin e regjimit të ujërave

Ndërtimi i pritave apo mini pendave (digave të vogla) në të gjitha rrjedhat e lumenjve, për të penguar të gjitha valët goditëse vërshuese, pra të akumulohet uji për ta përdorur në periudhat kur është i nevojshëm (në kohërat e nxehta, kohë pas kohe të lëshohet ujë i freskët në lumë nga akumulacioni). Me këtë akumulacion mund të kontrollohet edhe sasi e ujit, gjatë kohës me të reshura të mëdha.

Rregullim i shtretërve të lumenjve me rregullim prej dheu, rregullim urban, mirëmbajtje dhe pastrim për mbrojtje nga vërshimet dhe hapja e kanaleve.



Harta. 49 Masat, mbrojtja nga vërshimet në Komunën e Kamenicës

### **3.2.3. POPULLSISË, BANIMIT, VENDBANIMEVE, ÇËSHTJEVE SOCIALE, TRASHËGIMISË KULTURORE;**

#### **3.2.3.1 ARSIMI**

Pas analizës së situatës në nivel komunal dhe njohjes së rolit të komunës së Kamenicës në sistemin edukativ, nga ai parashkollor deri tek ai i mesëm, që përveç tjerash shtrihet edhe në mirëmbajtje të infrastrukturës arsimore, e përbërë edhe nga objektet dhe pajisjet e tjera për shkollë, si teknologjia informative, transporti dhe stafi profesional arsimor, vendosjes së synimit të përbashkët nga të gjithë aktorët për një shoqëri të edukuar dhe shkolluar mirë, u konstatua se zhvillimet e ardhshme në këtë fushë duhet orientuar në kahet, të cilat qojnë drejt ngritjes së vazhdueshme.

Pra, lypset ngritja e kapaciteteve për arsimin bashkëkohor, në përmirësimin e sigurisë së nxënësve, në përmirësimin e cilësisë së arsimit, përfshirje të barabartë në arsim, ngritje e bashkëpunimit me prindër, ministrinë e arsimit, asaj të punës, shtete e institucione të ndryshme të cilat hulumtojnë edhe kërkesat e tregut. Mbrojtja dhe siguri i lokacioneve për shkolla, përmirësimi i infrastrukturës së shkollave ekzistuese dhe plotësimi me infrastrukturë përcjellëse, që vlen për tërë hapësirën e Komunës së Kamenicës, ku funksionon sistemi arsimor. Gjithashtu, duhet lejuar e krijuar kushte shkollimin privat. Mbështetur në standarde janë vlerësuar nevojat për ndërtimin e objekteve të reja shkollore me infrastrukturë përcjellëse; mandej ndërtimi edhe i objekteve sportive me qëllim të përmirësimit të kushteve për punë dhe mësim, ku në vijim po i theksojmë radhazi, të gjitha nivelet e arsimit para universitar në komunë:

#### **3.2.3.2 INSTITUCIONET PARASHKOLLORE – NIVELI 0**

Këtu përfshihen të gjitha objektet, të cilat sigurojnë shërbimet e çerdheve dhe kopshteve të fëmijëve si dhe përmirësimet e arsimit parashkollor.

#### **3.2.3.3 ÇERDHET DHE KOPSHTET**

Sipas standardeve ndërkombëtare, grupi i fëmijëve në çerdhe përbëhet nga 7-10 fëmijë.

Në bazë të vlerësimit se një fëmijë, mesatarisht i kalon dy vjet në çerdhe, një grup i fëmijëve parashihet për afërsisht 400-700 banorë, në komunën e Kamenicës planifikohen këto çerdhe (objekte të reja) në këto vendbanime: në Koretin, Topanicë, Hodonoc, Rogaçicë, Muçivërc, Shipashnicë e Epërme, Karaçevë të Poshtme, Hogosht, Kopërnice, Krilevë. Po ashtu edhe në qytetin e Kamenicës (Lagjen “Malësia”) në pjesën që është planifikuar zgjerimi i qytetit.

#### **3.2.3.4 ARSIMI PARASHKOLLOR**

Arsimi parashkollor, i cili përfshinë fëmijët prej 3-6 vjeç, sipas nenit 2.4 të Ligjit për Arsimin Parashkollor, nuk është ende i obligueshëm. Arsimi parashkollor në Komunën e Kamenicës do të organizohet brenda hapësirave të shkollave fillore e të mesme të ulëta, ose si klasë e veçantë brenda institucioneve parashkollore (fëmijët prej moshës 5-6 vjeç, aktualisht edhe ndodhen brenda hapësirave shkollore).

#### **3.2.3.5 INSTITUCIONET SHKOLLORE – NIVELI 1, 2 dhe 3**

##### **ARSIMI FILLOR DHE ARSIMI I mesëm I ULËT**

Ligji për Arsimin Parauniversitar na obligon për ofrimin e kushteve, ku “Të gjithë duhet të kenë qasje në shërbimet e arsimit”.

Prej këtyre mundësive të analizuara sidomos për fshatrat me numër të vogël të banorëve dhe zhvillim të shtrirë, planifikohet:

1. Ndërtimi i objekteve shkollore brenda zonës së mbulimit;

2. Sigurimi i transportit publik për në shkollën amë;
3. Ndërtim i shkollave (paraleleve të ndara) për nivelin e parë (fëmijët 6-12) dhe sigurimi i transportit publik për nivelin e dytë të shkollës fillore;

Drejtorja e arsimit do studiojë arsyeshmërinë edhe për disa vite të këtyre mundësive në kuptimin e zgjidhjes më racionale dhe të qëndrueshme, ku për momentin arsimit fillor dhe arsimit mesëm i ulët është duke u siguruar për të gjitha vendbanimet.

Studimi i arsyeshmërisë, do të propozojë shkollat e reja për disa zona ose transportin e organizuar, ku për momentin kemi këto propozime për shkollat fillore në këto vendbanime:

|                           |              |
|---------------------------|--------------|
| Shkolla Fillore Meshinë   | Objekt të ri |
| Shkolla Fillore Berivojcë | Objekt të ri |
| ShFMU Tugjec              | Objekt të ri |
| Shkolla Fillore Gjyrishec | Objekt të ri |
| Shkolla Fillore Novosellë | Objekt të ri |

**SHKOLLAT SPECIALE** - Në Komunën e Kamenicës nuk ka shkollë të veçantë speciale, por në ShFMU “F.S. Noli” në Kamenicë dhe në FhFMU “Metush Krasniqi” në Rogaçicë, janë krijuar klasat (nga një në secilin institucion) speciale për fëmijë me aftësi të kufizuara dhe me të meta mentale.

### 3.2.3.6 ARSIMI I MESËM I LARTË

Për numrin e paraparë të banorëve – 40224, sipas standardeve të shërbimit, nevojiten edhe së paku dy shkolla për arsimin e mesëm të lartë, ndërsa për numrin e parashikuar të banorëve në vitin 2026 (~52350) është e nevojshme edhe 1 shkollë e re.

— nevojat e sotme - 40224 : 18000 = 3.7 @4 (2 ekzist. + 2 të reja)

— nevojat deri 2026- 52350: 18000 = 4.7 @5 (2 ekzist. + 3 të reja)

\*(18000 banorë – një shkollë e mesme e lartë)

Arsimi në këtë nivel duhet të organizohet në tri shkolla, njëra është në zonën urbane të Kamenicës, kurse dy të tjera janë propozuar. Njëra prej shkollave do të jetë shkollë për arsimim profesional në lëmin e teknikës. Lokacioni i preferuar për këtë shkollë është në Rogaçicë, kurse një tjetër do të duhej të ndërtohet në nën-qendrën e Hogoshtit, njëra nga këto nën-qendra kërkon pavarësim të shkollës së mesme të lartë të Rogaçicës. Nevojat momentale për objekte të reja janë këto:

|  |             |
|--|-------------|
| Shkolla e mesme Profesionale në Rogaçicë | Objekt i ri |
| Shkolla e mesme Profesionale në Muçivërc | Objekt i ri |
| Shkolla e mesme Profesionale në Hogosht  | Objekt i ri |

Për t’iu shmangur udhëtimeve të gjata të përditshme nga zonat e largëta, mund të mendohet edhe në shërbimin e vendosjes në konvikte për nxënës të tillë.

**Sipas një analize studimore nga grupi për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, kemi konstatuar se shpenzimet e mëdha të nxënësve që krijohen gjatë udhëtimeve në shkollat larg vendbanimit, shkollës aktuale në Rogaçicë, si dhe kohës që humbet në udhëtim për në shkollë dhe anasjelltas për tri vjet me ato shpenzime do të ndërtohet një shkollë e re.**

## Profilin e gjendjes në ShFMU „Metush Krasniqi”-Rogaçicë





1. **Strategjia demografike / shpërngulja.**
2. **Faktori gjini.**
3. **Faktori hapësirë / distancë / kursimi i mjeteve materiale.**
4. **Mungesa e lokalit.**

## 1. **Strategjia demografike / shpërngulja.**


Duke e pasur parasysh faktin se në fshatin **Rogaçicë** gravitojnë numër i madh i fshatrave për rreth, atëherë është e domosdoshme dhe kërkesë e kohës që të ndërtohet një objekt shkollor për mësimin e mesëm të lartë në lokacionin e shkollës fillore “**Metush Krasniqi**” në **Rogaçicë**. Ndërtimi i këtij objekti shkollor do të jetë një nga faktorët që do t’a zvogëlonte shpërnguljen e popullatës nga fshatrat për rreth **Rogaçicës**. Këtë fakt e mbështesim në largësitë e fshatrave për rreth si : Muhoci, Breznica, Karaçeva, Shipashnica, Hodonoci, Muçivërci, Dajkoci, Kranidelli , që me Rogaçicën kanë një distancë shumë më të vogël, në krahasim me qendrat tjera si Kamenica, Gjilani etj.

## 2. **Faktori gjinor**

Funksionimi i shkollës së mesme të lartë në **Rogaçicë**, ka rritur dukshëm edhe vijimin e vajzave në këtë nivel arsimimi , mirëpo mungesa e lokalit, fatkeqësisht ka lënë një numër të madh të vajzave por edhe të meshkujve jashtë objekteve shkollore. Sepse ata a ato, në një mënyrë kanë qenë të detyruar që të regjistrohen në Kamenicë, Gjilan e gjetiu . Këtë e mbështesim në numrin e nxënësve të regjistruar në klasën e **VIII-të** nëpër këto lokalitete:

| <b>Faktori Gjinator</b> |                      |                        |                   |                         |              |                 |
|-------------------------|----------------------|------------------------|-------------------|-------------------------|--------------|-----------------|
| <b>Nr.</b>              | <b>Vendi</b>         | <b>Emri I Shkollës</b> | <b>Nr. i Ndr.</b> | <b>Numri i nxënësve</b> |              |                 |
|                         |                      |                        |                   |                         | <b>Femra</b> | <b>Gjithsej</b> |
| 1                       | Rogaçicë             | SHFMU,,M. Krasniqi"    | 3                 | 272                     | 195          | 467             |
| 2                       | Shipashnicë e Epërm. | SHFMU,,S. Misini"      | 1                 | 152                     | 148          | 300             |
| 3                       | Hodonoc              | SHFMU"XH. Ahmeti"      | 2                 | 138                     | 160          | 298             |
| 4                       | Muçivërc             | SHFMU,,17 Shkurti"     | 2                 | 119                     | 123          | 242             |
| 5                       | Karaçevë e Poshtme   | SHFMU,,A. Thaçi"       | 2                 | 109                     | 86           | 195             |
| 6                       | Karaçevë e Epërme    | SHFMU,,A. Rrustemi"    | 2                 | 85                      | 88           | 173             |
| 7                       | Shipashnicë e Posht. | SHFMU,,S. Misini"      | 1                 | 72                      | 40           | 112             |
| 8                       | Dajkoc               | SHFMU,,17 Shkurti"     | 1                 | 13                      | 14           | 27              |
| 9                       | Breznicë             | SH Fillore             | 1                 | 11                      | 10           | 21              |
| 10                      | Kranidell            | SHFMU,,17 Shkurti"     | 1                 | 8                       | 9            | 17              |
| 11                      | Muhoc                | SH Fillore             | 1                 | 8                       | 7            | 15              |
|                         |                      |                        |                   | 987                     | 880          | 1867            |

**Tabela. 51.Faktori gjinator**



Grafiku.24.Faktori gjinor %

Në bazë të këtyre shënimeve në klasën e **tetë dhe të nëntë ( VIII-të ,IX-të)** nëpër lokalitetet e lartpërmendura janë të regjistruar gjithsej **1867 nxënës** prej të cilëve **880** janë femra dhe **987** meshkuj.

Në klasën e **dhjetë ( X –të në Rogaçicë )** janë :

**Rogaçicë** : gjithsej **809 nxënës**, ku prej tyre **363** janë femra dhe **446** janë meshkuj.

Kurse në klasën e dhjetë në Rogaçicë te paralelet e ndara të : **SHMLP „Andrea Durrsaku”** dhe **Gjimnazi „Ismail Qemali”**, janë **4** paralele, ku prej tyre janë gjithsej **809 nxënës**, **363** janë femra, kurse **446** janë meshkuj.

Nga këto të dhëna të sakta, del se numri i nxënësve të mbetur jashtë bankave shkollore ose kinse janë të regjistruar tjetërkund është : gjithsej **1058** nxënës, ku prej tyre **473** janë femra, ndërsa 585 janë meshkuj. Ky krahasim rrjedh nga të dhënat e sipërpërmendura nëpër paralelet e klasës së tetë të nxënësve të regjistruar dhe në paralelet e klasës së dhjetë.

Pra, mund të përfundojmë se nëse vazhdohet kështu, atëherë shumë nxënës do të mbesin rrugëve në pamundësi për t'u regjistruar, prandaj gjithsesi duhet të parandalohet kjo dukuri. Është e domosdoshme të ndërmerren hapa vendimtar për ndërtimin e një objekti tjetër shkollor.



### **Gjendja e mjerueshme e Wc në shkollë**

### **3. Faktori hapësirë / distancë / kursimi i mjeteve materiale**

Duke pasur parasysh distancën që kanë këto fshatra me Rogaçicën siç vijon :

**Karaçevë e Epërme -----Rogaçicë = 7 km**

**Karaçevë e Poshtme -----Rogaçicë = 5 km**

**Muhoc -----Rogaçicë = 10 km**

**Breznicë -----Rogaçicë = 5 km**

**Shipashnicë e Epërme ----Rogaçicë = 6.9 km**

**Shipashnicë e Poshtme ----Rogaçicë = 4.6 km**

**Hodonoc -----Rogaçicë = 2 km**

**Muçivërc -----Rogaçicë = 3 km**

**Dajkoc---- -----Rogaçicë = 5 km**

Nga shembujt e shënuar sipër, mund të themi se faktori distancë është një nga parakushtet themelore që mundëson dhe arsyeton këtë kërkesë për ndërtimin e këtij objekti shkollor, duke marrë në konsideratë distancat e këtyre lokaliteteve edhe me qendrat tjera si p.sh. :

Karaçevë e Epërme -----Kamenicë = 25 km  
 Karaçevë e Poshtme --- Kamenicë = 23 km  
 Muhoc -----Kamenicë = 28 km  
 Breznicë -----Kamenicë = 23 km  
 Shipashnicë e Epërme ---Kamenicë = 24.9 km  
 Shipashnicë e Poshtme --Kamenicë = 22.6 km  
 Muçivërc -----Kamenicë = 21 km  
 Hodonoc -----Kamenicë = 16 km  
 Rogaçicë -----Kamenicë = 18 km  
 Dajkoc-----Kamenicë = 23km



## Mungesa e hapësirës shkollore

Duke u mbështetur në këto shënime të sakta, distanca e përgjithshme e këtyre lokaliteteve me Rogaçicën është **48.5 km**, kurse me Kamenicën është **224.5 km**, kjo rezulton në faktin se, nxënësit për të kaluar distancën prej **224.5 km** i humbin **3 orë** e më tepër, ndërsa për të kaluar distancën prej **43.5 km** nuk humbin asnjë orë.

Përveç distancës, është evident edhe kursimi i mjeteve materiale, ku çmimet momentale në relacionet e lartpërmendura janë siç vijojnë :

**Karaçevë e Epërme -----Kamenicë = 1 €**

**Karaçevë e Poshtme --- Kamenicë = 1 €**

**Muhoc -----Kamenicë = 1 €**

**Breznicë -----Kamenicë = 1 €**

**Shipashnicë e Epërme ---Kamenicë = 1 €**

**Shipashnicë e Poshtme --Kamenicë = 1 €**

**Muçivërc -----Kamenicë = 1 €**

**Hodonoc -----Kamenicë = 1 €**

**Rogaçicë -----Kamenicë = 1 €**

**Dajkoc---- -----Kamenicë = 1 €**

**Ndërsa çmimi nga këto lokalitete deri në Rogaçicë është vetëm 30 cent.**

Nga kjo del se nxënësit të cilët nuk mund të regjistrohen në Rogaçicë por shkojnë detyrimisht në Kamenicë, duhet të shpenzojnë çdo ditë nga **809 €** për udhëtim dhe nga **809 €** për ushqim , atëherë del se këta nxënës për një ditë i shpenzojnë gjithsej **1618 €** , kurse gjatë tërë vitit (**175 ditë mësimi**) shpenzojnë **283150 €**.

Nga kjo rrjedh se për **2 vjet** do të shpenzoheshin **5666300 €**, ndërsa për **3 vjet 849450 €** ...

Pra, ndërtimi i këtij objekti shkollor, do t'u mundësonte qytetarëve të kësaj ane që për një vjet t'i kursejnë **283150 €** duke marrë në konsideratë edhe faktorin kohë, që është shumë i rëndësishëm për nxënësit. Për ta treguar këtë fakt të lartpërmendur kohor, atëherë me anë të një llogaritje të përgjithshme rrjedh se : një nxënës për të udhëtuar prej lokaliteteve të lartpërmendura deri në Kamenicë, duhet të kalojë **224.5 km** në ditë d.m.th. i nevojiten **3 orë** e më tepër, ndërsa për një vjet së paku **525 orë** .

Prandaj edhe një herë po e theksojmë se, nëse ndërtohet ky objekt atëherë një nxënësi për të udhëtuar prej lokaliteteve të lartpërmendura deri në Rogaçicë që kalojnë **48.5 km** , d.m.th. do t'u nevojiteshin maksimalisht **1 orë** , ndërsa gjatë tërë vitit **48.5 orë**.

Në bazë të kësaj të dhëne del se, kursimi i përgjithshëm i kohës së një nxënësi nga këto lokalitete do të ishte **476.5 orë** .



## Kushtet e mjerushme të personelit arsimor

### 4. Mungesa e lokalit


Mungesa e një shkolle të mesme të lartë është duke e përcjellë që një kohë të gjatë këtë rrethinë, mirëpo këtë vit ka arritur kulminacionin.

Prandaj duke u bazuar në numrin e madh të nxënësve që janë duke e vijuar mësimin në lokalet e SHFMU “**Metush Krasniqi**” në Rogaçicë, në këtë vit është lejuar nga **Drejtoria Komunale e Arsimit** që procesi edukativo-arsimor në këtë shkollë të zhvillohet në **3 (tri) ndërrime** me nga **30 min.**(orë mësimore),gjë që po e pamundëson mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor, sipas plani a orarit të paraparë .

Kështu që ky orar shumë i ngjeshur po paraqet shumë vështirësi dhe pengesa për mësim normal. Prandaj mungesa e lokalit mund të shkatojë që një numër I konsiderueshëm nxënësish, të orientoheshin kah qendrat tjera për vijimin e mësimiit.ë drejtim të qendrave tjera, si dhe ikjen e kuadrove nga këto lokalitete. Kështu mund të përfundojmë se reformat në arsim, emancipim, barazi gjinore, të drejtat e njeriut etj. janë si rrjedhojë e domosdoshme e ngritjes së një objekti shkollor në Rogaçicë.







Harta.50 Hapësirat shkollore dhe sportive në Komunën e Kamenicës

### 3.2.3.8 SHËNDETËSIA

Pas analizës së situatës në nivel komunal dhe vendosjes së një synimi për një shoqëri të shëndetshme dhe të mbrojtur nga sëmundjet ngjitëse dhe ato kronike. Sigurimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kujdesit shëndetësor duke filluar nga menaxhimi i sëmundjeve kronike (hipertensioni, diabeti, astma TBC etj) deri te zvogëlimi i mortalitetit dhe morbiditetit të fëmijëve nën moshën 5 vjeçare, për popullatën është objektivi kryesor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale , ku cilësia e kënaqshme do të konsiderohet si një ndër indikatorët kryesorë që do të përcaktojnë nivelin e shërbimit edhe në periudhën e ardhshme.

Zhvillimet e ardhshme do të shkojnë në drejtim të modernizimit të sistemit dhe përshtatjen e tij me format organizative dhe standardet, suksesshme bashkëkohore Sistemi shëndetësor në Kamenicë si dhe në pjesët tjera të Kosovës do të vazhdojë të zhvillohet bazuar në “praktikën familjare” me qasje në mjekë, motra medicinale dhe në ekspertë tjerë shëndetësorë që punojnë si grup.

**Përkujdesja parësore shëndetësore:** Do të vazhdojë në bazë të konceptit të mjekësisë familjare edhe atë në sistemin si vijon:

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare(QKMF) – në qytetin e Kamenicës ,e cila do të vazhdojë të ofrojë shërbime shëndetësore 24 orë në repartin e urgjencës (Me ndarjen fizike të repartit të urgjencës nga QKMF ashtu që të mundësohet dhënia e ndihmës së parë shumë më shpejtë’ në rastet e rënda dhe pa u penguar nga pacientët e tjerë), repartet e mjekësisë familjare, reparti i stomatologjisë, reparti i gjinekologjisë, reparti i vaksinimit.

**Qendrat e mjekësisë familjare (QKMF) – duhet të jenë në Strezoc, Hogosht dhe Rogaçicë**


**QMF Rogaçicë, Hogosht dhe** ambulancat e mjekësisë familjare (AMF) – duhet të ofrojnë shërbime shëndetësore gjatë ditëve të punës edhe atë në Koretin, Topanicë, Hodonoc, Karaçevë e Poshtme, , Muçiverc, Shipashnicë e Epërme, Kopërnice, , Desivojcë, ndërsa vizita dy herë në javë bëhen në ambulancat e mjekësisë familjare në Poliçkë, Lisockë, Krilevë, Busavatë, Strezoc, Tuxhec. Për të ardhmen propozohet një ambulancë e mjekësisë familjare në lagjen urbane të qytetit “malësia” në Kamenicë.

**Në Kamenicë duhet të bëhet një qendër spitalore,** e cila mund të ofrojë edhe disa shërbime, që deri sa të realizohet do vazhdojnë të bëhen në **Spitalin Rajonal që ndodhet** në Komunën e Gjilanit me 17 reparte: Reparti i Gjinekologjisë, interne, dializa, pediatria, kirurgjia, anesteziologjia, ortopedia, urologjia, infektivi, sëmundjet e mushkërive, ndihma e shpejtë, oftalmologjia, laborator, transfuzioni i gjakut dhe materniteti.

**Komuna jonë ka vend të përshtatshëm me një ambient të mirë për një qendër spitalore rehabilitues (spitali i mushkërive) dhe rekreative si në Kikë, Kranidell, Planik dhe Gmicë.**

**Në qytetin e Kamenicës ekziston edhe shtëpia për persona me aftësi të kufizuara, ku aty me qëndrim të përhershëm janë 10 persona, me kushte dhe infrastrukturë bashkëkohore.**

- a. Qendra për rehabilitim të sëmurëve narkoman(Kamenicë);
- b. Përmirësimi i shëndetit mendor, duke zhvilluar shërbime të shëndetit mendor të bazuar në komunitet e në bashkëpunim me Qendrën e Shëndetit Mendor;
- c. Ngritja e shkallës së imunizimit;
- d. Reduktimi i sëmundjeve ngjitëse;
- e. Mirëmbajtja e objekteve, plotësimi me infrastrukturë(Kanalizimi, dhe ujësjellësi mungon në Busavatë dhe Krilevë) dhe përmbajtje(objektet përcjellëse si garazhet, depot, furrat për djegien e mbeturinave etj.).
- f. **Përkujdesja sekondare shëndetësore:** Si spitale të përgjithshme, korrespondojnë në nivelin sekondar të përkujdesjes shëndetësore, përfshirë Spitalin Universitar të Prishtinës.
- g. **Përkujdesja terciare shëndetësore:** Spitali Universitar i Prishtinës është spitali i vetëm, i cili siguron përkujdesje terciare shëndetësore.
- h. **Kujdesi privat shëndetësorë:** Ofron shërbime të ndryshme ambulatorë dhe specialistike të profileve të ndryshme diagnostike dhe terapeutike, si në Kamenicë, Hogosht, Rogaçicë, Koretin.



Harta 51. Shërbimet sociale në Komunën e Kamenicës

### 3.2.3.9 KULTURA, RINIA DHE SPORTI

#### a) KULTURA

**Për periudhën sa hartohet ky plan duhet arrihet, që oferta kulturore e Kamenicës të jetë në harmoni me mundësitë që ka Komuna e Kamenicës, si dhe kërkesat e rekomandimet si rrjedhë e procesit pjesëmarrës të planifikimit.**

**Shtëpia e Kulturës “Isa Kastrati”** në Kamenicë duhet të mirëmbahet dhe rinovohet dhe si institucion i vetëm ku zhvillohen aktivitetet kulturore, të vihet në shërbim të plotë të artistëve, teatrove, ansambleve kulturore, rinisë dhe shoqërisë civile.

Në këtë funksion duhet digjitalizuar dhe kompletuar me infrastrukturë edhe bibliotekën e qytetit.

**Shtëpi kulture duhet të ndërtohen** në: Hogosht, Koretin, Topanicë, Hodonoc, Muçivërc, Shipashnicë e Epërme, Karaçevë e Epërme .

**Biblioteka në këto vendbanime** : në Koretin, Rogaçicë, Hogosht dhe Muçivërc, ku duhet të rregullohet një hapësirë për bibliotekë, pra pos ruajtjes dhe shërbimit të librit të mundësohet edhe leximi ditor. Në të ardhmen të mendohet edhe në digjitalizimi.

**Në shkollat fillore e të mesme të ulëta (ShFMU)**, në Hogosht, Muçivërc, Rogaçicë, Hodonoc, Karaçevë e Poshtme, Petroc, Topanicë, Koretin, Kamenicë, Strezoc, Kopërnice, Tugjec, Busavatë, si dhe **në shkollat e mesme të larta** në Kamenicë, Hogosht e Rogaçicë, duhet të sigurohet nga një sallë ( klasë e madhe) ku nxënësit dhe grupet e ndryshme mund lirshëm ti zhvillojnë aktivitetet e kulturës.

**Ansamblat dhe shoqëritë funksionale “Dardana”** – Kamenicë, Klubin letrar “Nositi” – Kamenicë, Trupin e Teatrit të Qytetit – Kamenicë, SHKA “Jeta e re” – Hogosht, duhet të përkrahen mirëfilli duke krijuar infrastrukturë për funksionim normal.

Duhet përkrahen, fuqizohen e zyrtarizohen në kalendarin komunal manifestimet tradicionale **“Flaka e Janarit”**.

**Duhet të punohet për Organizmin** vjetor të panairit të librit në Kamenicë, hapjen e një shkolle për ciklin e ulët të muzikës, formimi i korit të qytetit, krijimi i klubit të artistëve për pikturë si dhe riaktivizimi i kinemasë së qytetit në Kamenicë

Me qëllim të hulumtojnë, konservojë, mbledhë, komunikojë dhe ekspozojë trashëgiminë e luajtshme për qëllime të studimit, të edukimit dhe të shijimit të saj për qytetarët e komunës dhe më gjerë; pastaj duhet themeluar **muzeun komunal në Kamenicë**.

Gjithashtu, duhet të ndërtohet një **teatër i hapur(veror)** në Kamenicë, mandej të themelohet **Galeria e Arteve** në Kamenicë, si dhe **teatri** po në Kamenicë.

#### SPORTI

Edhe në këtë fushë zhvillimet duhet jenë të tilla që ti mundësohet banorëve të komunës së Kamenicës edukim fizik, zhvillim i aftësive psiko-fizike për arritjen e rezultateve sportive në garat e të gjitha niveleve dhe të gjitha grup moshave, zhvillim të larmishëm prej sportit amator deri te ai profesionist.

Zhvillimi në të ardhmen i ofertës për sport në Komunën e Kamenicës duhet të jetë në harmoni me mundësitë që ka Komuna e Kamenicës, si dhe kërkesat dhe rekomandimet që ishin rezultat i procesit pjesëmarrës të planifikimit

Hapësirat për sport dhe rekreacion në përgjithësi, duhet të sigurohen në çdo vendbanim. Ato mund të jenë në kuadër të hapësirës së shkollave fillore si pjesë e oborrit të shkollave me shfrytëzim të organizuar jashtë orarit të procesit mësimor, ose si hapësira të veçanta e që varet e nga mundësitë dhe kërkesat.

Në mënyrë të veçantë parashikimet e dëshiruara në funksion të shtrirjes hapësinore të infrastrukturës sportive janë:

Finalizimi i **Palestrës sportive** me kapacitet deri 1500 ulëseve në qytetin e Kamenicës. Renovimi dhe zgjerimi i **stadiumit të futbollit** të madh në qytetin e Kamenicës

Rregullimi i **stadiumit për futboll** të madh në Koretin, Muçivërc, Hogosht, Karaçevë e Poshtme dhe Rogaçicë.

Ndërtimi i **një Salle sportive ne shkollën e** Rogaçicës

Ndërtimi i **salles sportive** në shkollën e Muçivërcit

Ndërtimi i **Salles sportive** në shkollën e Strezocit

Rregullimi i **sallave sportive** në shkollat fillore të Kamenicës

Rregullimi i **sallave sportive** në dy shkollat e mesme të Kamenicës

Rregullimi i **një kompleksi** për sporte në Hogosht, ku përfshihen fushat për zhvillime të ndryshme sportive.

Rregullimi i **poligonit për shenjëtari në Kamenicë dhe ne Muçivërc**

**Poligonet për ecje dhe rekreacion** Kamenicë – Koretin, Hodonoc- Rogaçicë – Muçivërc, Hogosht –Kopërnice

**Poligonet për Atletikë** Kamenicë dhe Rogaçicë

**Përkrahja e sektorit privat në zhvillimin e aktiviteteve dhe plotësimi me përmbajtje dhe standarde** në fushat ekzistuese të futbollit të vogël (Kamenicë, Strezoc, Koretin, Karaçevë e Poshtme, Topanicë, Hodonoc, Rogaçicë, Muçivërc, Hogosht, Kopërnice, Desivojcë dhe Poliçkë) dhe pishinat (Kamenicë, Shipashnicë e Epërme etj. )

**Terren sportiv** për lojra **GOLFI** në **Muçivërc**

**Hulumtimi i stazave ne vendet malore per çiklizëm dhe motoristikë(Zhujë, Shahiq, Kikë)**

**Duhet të mendohet edhe** për sportin e tenisit, peshkimit, gjuetisë, kalërimit, çiklizmit Motokrose etj.

### c) RINIA

Analiza e gjendjes në këtë fushë por edhe takimet e ndryshme kanë nxjerrë në sipërfaqe mungesën e hapësirave të mjaftueshme për të zhvilluar aktivitetet dhe veprimtaritë e tyre në lëmi të ndryshme rinore dhe rekreative, mungesën e një shkollimi adekuat në një përqindje brengosëse, kryesisht nëpër disa vendbanime të thella rurale dhe ndjekja e studimeve universitare në përqindje të vogël.

Grupmoshat rinore (pesëmbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeç) janë të ndikuara edhe nga zhvillimet negative në shoqëri, kryesisht të edukatës së pamjaftueshme dhe lakmisë së tyre për të pasur qasje në katër dukuri negative si: diskoteka – kafiteritë, alkooli - duhani, prostitucioni dhe, elemente narkotike.

Parashikimet e dëshiruara nga kjo fushë janë fillimisht:

Aktivizimi i sa ma shumë organizatave rinore dhe ngritja e bashkëpunimit me institucionet komunale, ngritja e kapaciteteve për sport dhe kulturë dhe angazhimi i sa ma shumë të rinjve në këto aktivitete. Aktivizimi i garave në fusha të ndryshme: sport, art, shkencë në shkollat fillore dhe të mesme. Hapësirat për sport dhe rekreacion në përgjithësi, duhet të sigurohen në çdo vendbanim, ku ato të shfrytëzohen edhe për aktivitete rinore. Ata mund të krijojnë edhe klubet rinore (hapësirat mund të jenë në kuadër të hapësirës së shkollave fillore) .

Parashikimet e dëshiruara hapësinore të veçanta nga kjo fushë janë:

Ndërtimi i qendrave rinore në qytetin e Kamenicës, Rogaçicë, Hogosht, Strezoc etj.

Formimi i grupeve të recitatorëve, dramatike, muzikës në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme

Hapja e një qendre për aftësim profesional të të rinjve.

Organizmi vjetor i Ditës së Rinisë.

#### 3.2.3.10 TRASHËGIMIA KULTURORE

Parashikimet e ekipeve profesionale mendojnë, se për komunën e Kamenicës pikërisht trashëgimia kulturore është një ndër elementet më të rëndësishme që do të fuqizoj identitetin e kësaj komune dhe planifikimi i së kaluarës (trashëgimisë) është po aq i rëndësishëm sa planifikimi i së ardhmes.

Andaj parashikohet që në përgjithësi kjo pasuri e trashëguar me vlera artistike, estetike, historike dhe kaakteristika tradicionale, që ilustron me llojllojshmërinë e pasur të trashëgimisë: **arkitekturore, arkeologjike, të luajtshme, arkivore dhe shpirtërore** pasi që e kemi bërë një përnjohje dhe e kemi të digjitalizuar si informatë në profil, kemi analizuar situatën në këtë fushë është konstatuar se duhet zhvillohen projekte që mundësojnë ti mbrojmë nga dëmtimet e mëtutjeshme por edhe ti zhvillojmë dhe bëjmë të mundur që këto vlera të fillojnë të shihen, preken dhe vlerësohen në dimensionin adekuat nga banorët e Kamenicës dhe vizitorët.

**Parashikimet janë që të gjitha objektet dhe vlerat të futen në listën e trashëgimisë nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme në nivel komunal, të Kosovës dhe disa edhe ndërkombëtar.**

Në mënyrë të veçantë duhet zhvilluar projekte, ashtu që vendbanimet e pasura me :

**Trashëgimi kulturore**, Kamenica, Moçari, Krileva, Kopërnica, Topanica, Rogaçica Hogoshti etj.

**Trashëgimi arkeologjike:** Lokaliteti Kulina Ilire- Kamenicë, kështjella në Kopërnice, Tyrbja e Shehut në Topanicë, Tyrbja në Rogaçicë, manastiri i Moçarit etj. shihe hartën Trashëgimia Kulturore.

|          |   |
|----------|---|
| <b>1</b> | <b>Vaganesh – Kisha e dëftimit të Shën Merisë.shek.XIV-VI,nr.v.E.K.474/55</b>                     |
| <b>2</b> | <b>Ajnovc- Manastir Burg ,shek .XIV nr.v.E.K.476/55</b>   |
| <b>3</b> | <b>Moçar-Manastir Rgjavc,shek.XIV nr.E.K .478/55</b>  |
| <b>4</b> | <b>Berivojcë- Kisha e Shën Gjonit shek.XIV-XVI,nr.v.E.K.02-338/63</b>                             |
| <b>5</b> | <b>Koretin-Nekropolë e hershme shek.VI-VIII,nr.v.E.K.02-278/70</b>                                |
| <b>6</b> | <b>Hogosht –Mbeturinat e varrit të antikës së vonë,shek.V-VI,nr.v.E.K.02-329/72</b>               |
| <b>7</b> | <b>Topanicë –Teqeja e Sheh Zenel Abedinit shek.XVIII.nr.v.E.K.02-156/80</b>                       |
| <b>8</b> | <b>Karaçevë e Epërme –Lokaliteti arkeologjik në pjesën „Ordine” shek.IV-VI,nr.v.E.K.01-130/81</b> |
| <b>9</b> | <b>Objektet e Kultit Mysliman dhe të krishterë në Komunën e Kamenicës</b>                         |

Tabela.52. Trashëgimia Arkeologjike

#### **Trashëgimi arkitekturale:**

##### Gjetjet arkeologjike

- 1.Lokaliteti arkeologjik Gjyteti në Gjyrishec
2. Lokaliteti arkeologjik në Kranidell
3. Lokaliteti arkeologjik në Topanicë
4. Lokaliteti arkeologjik në Strezoc
5. Lokaliteti arkeologjik në Busavatë

##### Kalatë

1. Kalaja e Kamenicës (Dardanës)
2. Kalaja e Kopërnices – periudha romake
3. Kalaja e Kranidellit – periudha romake

##### Objektet e kultit të krishterë

1. Manastiri në Moçar - Periudha: Romake
2. Kisha në Vaganesh
3. Kisha e vjetër romake dhe kisha e re ortodokse – Hajnoc
4. Kisha në Kamenicë (Dardanë)
5. Kisha në Domaroc

##### Objektet e kultit islam

1. Xhamia e Zajçecit
2. Xhamia Hodonocit
3. Xhamia e Kopërnices
4. Xhamia në Kamenicë (Dardanë)
5. Xhamia e Desivojcës

6. Xhamia e Zhujës
7. Teqja e Topanicës
8. Tyrbja e Dazhnicës

#### Objektet e banimit- Shtëpitë

1. Shtëpi në qytet Komuna pas vitit 1945
2. Shtëpia e Sylë Haskut Kremenatë
3. Shtëpia ku qëndroi Mulla Idriz Gjilani, për disa vjet – Ilegalisht-Gjyrishec
4. Shtëpia e Hoxhës Mahmutit – Srezoc
5. Shtëpi banimi – Moçar, periudha :Shek:XIX, Mjeshtri Popullor, Pronë private
6. Shtëpi banimi e Demush Feriz Hajdarit - Zhujë
7. Shtëpi banimi në Dazhnicë
8. Shtëpi e vjetër në Topanicë
9. Objekt banimi në Rogaçicë
10. Objekte banimi në Vriçec
11. Objekte banimi në Shipashnicë e Epërme

#### Objektet bujqësore

1. Plevicë e Shillovëve të Srezocit
2. Mulli binjak - Hogosht
3. Mulli në Shipashnicë
4. Kosh në Koretin

#### Trashëgimia e luajtshme

1. Shpata (v 1210 sipas Hixhrit)
2. Kultura krishtere Poliçkë

Numizmatikë (tërësi e monedhave të një periudhe historike)

1. NUMIZMATIKË Filipi I (244 – 249), monedha
2. Maksimianus (286 – 305), monedha
3. Gardianus III (238 – 244), monedha
4. Teodosius (379 – 395), monedha

**Trashëgimi shpirtërore** shumë e pasur në Komunën e Kamenicës duke përfshirë format e shprehjes kulturore të traditave ose të zakoneve popullore, të gjuhës, festave, riteve, valles, muzikës, këngës dhe shprehjes artistike.

Të trajtohen në harmoni me interesat publike dhe kërkesave ligjore (të mbrohen dhe zhvillohen) Ruajtja dhe kujdesi i lapidarëve në vendbanimet e ndryshme të komunës si; Kamenicë, Koretin, Rogaçicë, Hogosht, Zajçec, Gjyrishec etj.

Parashikohet zgjerim i varrezave dhe infrastruktura në vendbanimet: Koretin, Rogaçicë, Kopërnice etj.


Ndërtimi dhe mbrojtja e kompleksit të varrezave në Kamenicë.

Përmendoret e dëshmorëve të luftës së UÇK-së të futen në listën e vlerave dhe të merren nën përkujdesjen institucionale.


Parashikohet që marrëdhëniet midis pronarëve, poseduesve dhe shfrytëzuesve të trashëgimisë kulturore të rregullohen ashtu që këto vlera të mbrohen dhe zhvillohen.

Parashikohet se, duhet thelluar edhe bashkëpunimin me Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Gjilan, ashtu që evidentimin e objekteve me vlerë trashëguese në të njëjtën kohë ta bëjë edhe QRTK në Gjilan.





Harta 52. Trashëgimia arkeologjike dhe kulturore



Harta 53. Trashëgimia natyrore në Komunën e Kamenicës

## **3.2.4 MJEDISIT, PËRFSHIRË TRASHËGIMINË NATYRORE DHE RESURSET, PEIZAZHET**

Nga analiza e gjendjes në komunë e bërë nga grupet punuese sa i përket Mjedisit u konstatua se mbrojtja e mjedisit nuk është vetëm problematikë ekologjike ose teknologjike por problematikë më e thellë dhe më e gjerë që shkon drejtë dimensionit sociale e madje edhe politike. Meqenëse mjedisi përbën pjesën integrale të zhvillimit hapësinor, parashikohet që ai edhe të planifikohet e jo vetëm të merremi me eliminimin e pasojave në këtë drejtim ekipet kanë paraparë mbrojtjen e mjedisit nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve të ngurta, nëpërmjet administrimit mjedisor të tyre në çdo fazë, përfshirë krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin, për këtë arsye janë paraparë hapësirat e deponive në nivel vendbanimi dhe nivel komunale. Janë paraparë masa edhe për amortizimi të efekteve, mbrojtje dhe të ndotësve dhe kërcënuesve tjerë mjedisor si dhe masa për zhvillim kualitativ mjedisor.

### **3.2.4.1 AJRI**


- Vendosja e brezave dhe shiritave të gjelbër me kapacitete për absorbim të aerosolëve, gazrave azotike, të sulfurit dhe karbonike, metaleve të rënda për gjatë rrugëve kryesore siç shihet në hartë.
- Rivitalizimin e parqeve ekzistuese dhe ngritjen e parqeve të reja në hapësirat e identifikuar si të lira dhe të mundshme për ngritjen e këtyre parqeve
- Mbrojtja, zhvillimi e sidomos kultivimi i pyjeve të reja edhe me kapacitete për thithje të gazrave dhe ajrosolëve të ndryshme.
- Përcaktimin e kriterëve për sipërfaqet e gjelbra të detyrueshme në lejet e reja të ndërtimit, me prioritet në qytetin e Kamenicës dhe nën - qendrat
- Përmirësimin e qarkullimit rrugor për shmangien e fluksit të madh të makinave nëpër qendra të vendbanimeve, ku është e përqendruar dhe pjesa më e madhe e popullsisë;
- Pengimi i shkarkimeve të ndotësve në ajër nga Industria dhe makinat lëvizëse me vendosjen e katalizatorëve dhe rregullimeve tjera në aspektin teknik dhe largimin e të vjetrave nga trafiku.
- Shfrytëzimin e energjive alternative (kryesisht energjia diellore, rrjedhat e ujit, e erës dhe energjia gjeotermale). (Harta Masat për mbrojtjen e ajrit nga ndotja )
- Minimizimin e shfrytëzimit të automjeteve dhe shfrytëzimin e transportit publik.
- Promovimin e lëvizjeve jo të motorizuara duke planifikuar edhe stazat për çiklist dhe ecje në këmb siç shihet në hartë.
- Planifikimi i nivelit të tolerueshëm të ndotjes dhe zhurmës sidomos në zonat me veprimtari të ndjeshme (afër shkollave, spitaleve etj)
- Rikonstruktimi rrugëve (çarkoreve dhe bajpaseve në qendrën urbane, kanalizimeve dhe mënjanimi i deponive të mbeturinave që janë burim i ndotjes së ajrit nga djegiet dhe oksidimet e mbeturinave etj.

### 3.2.4.2 UJI

Nga analiza e gjendjes në komunë e bërë nga grupet punuese sa i përket cilësisë, resursit dhe burimeve Ujore është konstatuar se shqetësimi kryesor ka të bëjë me mbrojtjen e cilësisë, resursit dhe burimeve të ujit. Parashikohet edhe zhvillimi dhe menaxhimi i burimeve të ujit për plotësimin e nevojave për të sotme dhe të ardhmen.

Prandaj është parashikuar që:

- Të gjitha burimet e ujërave natyrale, dhe ujërave tjerë nëntokësorë dhe sipërfaqësor të mbrohen siç shihet në hartën hidrologjike të komunës së Kamenicës, bashkë me caktimin e zonës së mbrojtjes së obligueshme rreth burimeve, kaptazheve, rrjedhave të lumenjve dhe akumulacioneve, me regjim të caktuar të mbrojtjes, varësisht nga destinimi i objektit. Në këto zona nuk mund të ndërtohen objekte e të zhvillohen punime tjera, as të shfrytëzohet toka në mënyrën e cila rrezikon sasinë dhe kualitetin e ujit.
- Merren masat për mos lejimin e ndotjes së lumenjve, ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore nga ujërave të përdorura dhe ndyta prej vendbanimeve duke rekomanduar trajtim në dalje me gropa septike dhe forma tjera vendosja e aparateve për pastrim deri te impianti.
- Në të ardhmen është e domosdoshme të merren masa afatshkurtra dhe afatgjatë që ujërat e përdorura, të ndyta (urbane, industriale) para se të lëshohen, të pastrohen në pikëpamje fizike biologjike dhe kimike. Për këtë qëllim, është e nevojshme:
- Dokumentacioni investivo-teknik për industrinë e reja duhet të përmbajë edhe vendimin e pastrimit të të gjitha ujërave të përdorura, të ndyta. Puna e kapaciteteve të reja industriale nuk duhet të lejohet pa u montuar më parë aparatet të cilat do të sigurojnë pastrimin e ujërave të ndyta në mënyrën e duhur.
- Nevojat e popullsisë për ujë do të rriten vazhdimisht. Në periudhën e ardhshme Sigurimi i sasisë së nevojshme të ujit të shëndosh të pijes për popullsinë e kësaj komune do të jetë edhe në të ardhmen probleme serioze. Disa zgjidhje për qendrën komunale dhe vendbanimet për rreth janë paraparë edhe në këtë dokument, për sigurimin e sasive të parapara të ujit dhe të sasive plotësuese rezervë është e domosdoshme mbrojtja e disa burimeve, rrjedhave të lumenjve dhe akumulacioneve. Pas kësaj shfrytëzimi racional i ujërave në këtë komunë është detyrë me rëndësi e të gjithë faktorëve të planifikimit dhe të shfrytëzimit të ujit dhe hapësirës ..
- Parashihet mbrojtja e veçantë për burimet gurrën e Hogoshtit, gurrat e Kikës, gurrat e Planicës, gurrën e Meshinës, gurrën e Leshtarit, gurrën e Krilevës, gurrën e Busavatës në komunën e Kamenicës; për rrjedhat e epërme të terreneve të lumit të Desivojcës, Gjyrishecit, Kremenatës.
- Rreth akumulacioneve prej të cilave uji mund të shfrytëzohet për furnizimin e popullsisë, siç janë: akumulacioni i kaptazhet në lumin Kriva Reka, lumi i Desivojcës, Gjyrishecit, Kremenatës. dhe eventualisht edhe sistemi i puseve.
- Mbrojtje e veçantë e ujërave duhet ti kushtohet edhe nga përdorimi i pa kontrolluar i plehrave artificiale për bujqësi (nitratat, nitritet, fosfatet dhe nutrient tjerë).
- Mbrojtje tjetër parashikohet edhe nga mbeturina (të gjitha tipat e mbeturinave) duke planifikuar deponi që janë të organizuara dhe të cilat kanë marr parasysh këtë faktor deri te planifikimi i varrezave kolektive të kafshëve në raste emergjente.



Harta. 54. Resurset ujore në Komunën e Kamenicës

### 3.2.4.3 BIODIVERSITETI

- Pas hulumtimeve të bëra në fitodiversitetin e Kamenicës parashikohet që disa lloje të mbrohen ruhen dhe konservohen pasi që është konstatuar se ekzistojnë fitocenoza të cilat janë mjaft të begatshme dhe interesante në aspektin ekonomik, shkencor dhe mjekësor.
- Sa i përket zoodiversiteti, sipas të dhënave nga IKMN<sup>8</sup>, dhe analizave të ekipit punues territori i komunës së Kamenicës është i pasur me shtazë të egra në mesin e të cilave ka edhe lloje që konsiderohen si të rrezikuara dhe në këtë drejtim parashikohet mbrojtja e zonave ku jetojnë dhe veprojnë këto kafshë si dhe mbrojtja e tyre si specie.

#### ➤ **Humbja e Biodiversitetit në Kamenicë**

Edhe Kamenica si edhe shumica e vendeve të Kosovës po përballen me problemin e humbjes së biodiversitetit. Faktori kryesor që ka shkaktuar kërcënim serioze për ekzistencën e shumë llojeve bimore dhe shtazore padyshim është faktori njeri, ndërkaq shpyllëzimet masive, shfrytëzimi intensiv i tokës, ndotjet e ajrit dhe ujit dhe gjuetia e pakontrolluar janë vetëm disa nga faktorët tjerë që vazhdojnë të rrezikojnë biodiversitetin. Nga të gjitha këto, humbja sipërfaqeve pyjore që ka përfshirë më të madhe ekosistemin natyror është një nga problemet me emergjent për natyrën e Kamenicës. Reduktimi i sipërfaqeve pyjore dhe degradimi i vazhdueshëm i tyre ka ardhur kryesisht si pasoje e shfrytëzimit pa kritere të zonave pyjore. Si pasoje e këtyre ndikimeve rrjedh edhe kërcënimi për zhdukje të shumë llojeve bimore dhe shtazore. Kafshët e rralla në vendin tone si: ujku, derri eger, kaprrulli, dhelpra, vjedulla, dreri, dhia e egër, macja e egër, lepuri, ketri, thëllëza, shqiponja, pata e egër, lejleku etj, janë rrezikuar të pakësohen si pasojë e dëmtimit dhe ndryshimeve të habitateve të tyre, gjuetisë së pakontrolluar, varfërimit dhe degradimit të ekosistemeve, erozionit dhe shpyllëzimit. Për llojet shtazore është shqetësuese sidomos gjuetia e ushtruar gjatë periudhës së riprodhimit, ndërsa për llojet bimore grumbullimi i tyre gjatë fazës së lulëzimit, dhe nxjerrja me rrënjë.

#### ➤ **Domosdoshmëria e ruajtjes së biodiversitetit**

- Ruajtja e biodiversitetit është e rëndësishme dhe e domosdoshme për shume arsye, por me këtë rast do të përmendim vetëm disa prej tyre:
- Ruajtja e biodiversitetit është detyrim i yni moral që tui lëmë pasardhësve një mjedis po aq të pasur sa kemi trashëguar nga paraardhësit tanë,
- Çdo qenie e gjallë ka të drejtë të jetojë, ashtu si dhe vetë njeriu; qeniet e gjalla që kanë jetuar dhe evoluar në mijëra milionë vjet mund të zhduken shumë shpejt, por nuk mund të krijohen përsëri,

- Shume lloje bimore kanë vlera të jashtëzakonshme shëndetësore, andaj zhdukja e tyre do te thotë zhdukje e kësaj vlere,
- Proceset natyrore biologjike janë rregullatorët më të mirë të ruajtjes se mjedisit të pastër dhe jetës në komunën tonë,
- Biodiversiteti dhe llojlojshmëria biologjike e natyrës paraqet një potenciale të larta për zhvillimin e turizmit dhe rekreacionit te një vendi,
- Zhvillimi ekonomik i një vendi mund të sigurohen përmes ruajtjes dhe përdorimit të qëndrueshëm të pasurive natyrore e biologjike,
- **Dhe mbi të gjitha vetë jeta e njerëzimit në tokë është e varura nga biodiversiteti-shfrytëzimit te bimëve dhe kafshëve.**



- Në fushën e biodiversitetit parashihen projekte për **mbrojtjen dhe zhvillimin e zonave:** Tugjeci, Kremenata 1 dhe Kremenata 2, Krilevë, Pllanicë, Kranidell, Kikë, Guri i Zi, Lumi “Kriva Reka”, Lumi i Desivojcës dhe Lumi i Hogoshtit.
- Parashihet pasurimi i florës dhe faunës në gjithë territorin e komunës, duke specifikuar çka duhet të mbrohet dhe çka mund shfrytëzohet .
- Parashikohet një rezervat për ruajtjen e kaprrollit (*capreolus capreolus*) areali i të cilit është mjaft i rrezikuar, që do të shtrihet në zonën ndërkufitare në fshatrat Tërstenë – Desivojcë – Lajçiq – Kranidell - Sedllar etj.
- Parashikohet ruajtja e racës autoktone të buallicës dhe lopës bushe( qumështi i së cilës ka një vlerë të lartë ushqyese dhe mjekuese), kryesisht në fshatrat kufitare Tugjec, Gjyrishec, Lisock, Poliçkë, Desivojcë, Kranidell etj.

Parashikohet revitalizimi i ekosistemeve pyjore për parandalimin e shkatërrimit të habitateve të shumë llojeve bimore dhe shtazore në territorin e Komunës së Kamenicës. Duke e konsideruar të rëndësishme edhe ruajtjen e habitateve të fluturave, shpezëve mishngrënës etj. Shih hartën e biodiversitetit






#### 3.2.4.4 TOKA

Duke e konsideruar tokën si një burim thelbësor dhe kryesisht jo i renovueshëm, bazuar në analizën e grupeve punuese dhe gjerësinë e dijes dhe të kuptuarit e sistemeve të tokës dhe rolin kyç që luan toka brenda sistemit të gjerë të mjedisit, vazhdimi i humbjes së tokës do të kishte efekte shkatërruese në jetën tonë. Bujqësia, pylltaria dhe një varg aktivitetesh që janë të varura nga toka do të kërcënoheshin, deri te furnizimi me ujë dhe lëndë ushqyese për rritjen e bimëve dhe përkrahje fizike të bimëve dhe gjallesave tjera. Një varg funksionesh e lidhesh me ruajtjen e ekosistemeve.

Për shkak të kësaj gamë të gjerë të funksioneve që kryhen nga toka dhe marrëdhëniet e saj me mjedisin tjetër, komponenta e tokës nuk është konsideruar si e izoluar andej në fazën e analizës iu është kushtuar rëndësi e veçantë dhe për këtë arsye parashihet : mbrojtje fizike dhe cilësore e tokës për pos mbrojtjes së ajrit dhe ujit –parashohim edhe futjen e politikave për mbrojtjen e tokës për të siguruar "Lidhjen e humbur " në mbrojtjen e mjedisit edhe në Komunën tonë.

- Parashikohet mbrojtja në kuptimin e hapësirës së tokës dhe resurseve tokësore nga tjetërsimi për qëllime jobujqësore me kufizim të shtrirjes së ndërtimeve vetëm brenda kufijve ndërtimor të planifikuar (harta "Konceptet e zhvillimit të Vendbanimeve").
- Për të mundësuar prodhimtari të rregullt dhe të sigurt me qëllim të mbrojtjes së njerëzve, botës bimore, shtazore dhe ambientit, Parashikohet mbrojtja e tokës bujqësore nga ndotja e cila planifikohet të bëhet me:
- Mbrojtjen e tokës bujqësore nga ndotja nëpër mes të kufizimit dhe parandalimit nga bartja direkte, bartja përmes ujit dhe ajrit e matërëieve të dëmshme dhe ndërmarrja e masave për ruajtje dhe përmirësim të plleshmërisë si dhe:
- Planifikohet të ndalohet lëshuarja e lëndëve të dëmshme dhe të rrezikshme, të cilat e dëmtojnë dhe ndryshojnë aftësinë prodhuese të tokës bujqësore apo kualitetin e kulturave bujqësore dhe përdorimi jo i drejt i plehrave minerale, organike dhe mjeteve për mbrojtjen e bimëve.
- Planifikohet të bëhen në mënyra të vazhdueshme monitorimi dhe kontrolla e plleshmërisë së tokës bujqësore.
- Me këtë plan parashihet të bëhet edhe faza e dytë dhe e tretë e rregullimit të tokës bujqësore (me masa komosative: rregullimin e territorit të tokës me qëllim të krijimit të ngastrave më të mëdha dhe më të rregullta tokësore në mënyrë që të mundësohet punimi më ekonomik i tokës dhe të krijohen kushte më të volitshme për zhvillimin e vendbanimeve të karakterit bujqësor, rregullimi i kufijve me qëllim të krijimit të ngastrave të reja në formë të rregullt dhe për tu përfshi në sistemin e hidromeliorimit deri te shënimet kadastrave dhe ridefinimi i drejtës së pronësisë në parcelat e reja duke shfrytëzuar mjetin legal komasacionin).





Harta 57. Ndjeshmëria e tokës në Komunën e Kamenicës

- Parashikohen ujitje e tokës bujqësore dhe masa tjera për të ngritur shkallën e bonitetit të toka e cila ka bonitet më të ulët.
- Parashikohet mbrojtja nga vërshimet përmes rregullimit të shtretërve të lumenjve dhe përroskave (shih hartën e vërshimeve dhe erozioneve) të toka e cila ka bonitet të lartë dhe masa tjera për të mbrojtur dhe ngritur shkallën e bonitetit.
- Parashikohet në zonat të cilat janë destinime(për pos banimit)tjera dhe ndërtime të përkohshme të hartohen projekte rikultivimi të tokës bujqësore
- Parashikohet mbrojtja nga erozionet nga në shpërlarja e elementeve përbërëse të tokës, me anë të pyllëzimit dhe melorimit të zonave të degraduara. (Harta: Pyllëzimi).
- Parashikohet mbrojtja nga degradimi natyror ose ndikimi i njeriut.
- Parashikohet mbrojtja e pjellorisë natyrore të tokës, përmes qarkullimit bimorë në tokat bujqësore dhe kthimit të materieve organike (të mos digjen serrishtat ose mbetjet bimore)
- Parashikohet ri-zhvillimi i tokës në zonat e mbuluara nga deponitë.

### **3.2.4.5 MENAXHIMI I MBETURINAVE**

Nga analizat e bëra nga grupet punuese dhe aktorë tjerë është parashikuar që : që të ndërtohen deponi tranzite të mbeturinave inerte (ndërtimtarisë) gati në të gjitha fshatrat, janë planifikuar deponi tranzite të mbeturinave komunale në çdo lokalitet.

Parashikohen intervenime të vendi i deponisë së vjetër të qytetit ( rehabilitimi i zonës dhe izolim, ngjashëm është planifikuar që të bëhet edhe rehabilitim i vendit ku janë rialokuar mbeturinat e deponisë së vjetër në fshatin Koretin.

Parashikohet grumbullimi dhe trajtimi i mbeturinave që janë hedhur në mënyrë të pa kontrolluar me prioritet në brigjet e Lumit “Kriva Reka”, Lumit të Hogoshtit, Lumit të Desivojcës dhe në hapësira të ngjashme.

Parashikohet edhe në vendbanimet ku nuk ka fare menaxhim të futen në sistem të menaxhimit të mbeturinave, në vendbanimet të cilat janë pjesërisht nën sistem të menaxhimit të mbeturinave, që të futen nën menaxhim të plotë, kurse vendbanimet në të cilat bëhet menaxhimi i mbeturinave që të fuqizohet sistemi i menaxhimit përmes infrastrukturës dhe elementeve tjera përbërëse.

Qyteti për momentin e ka strategjinë për trajtimin e mbeturinave duke u bazuar në principet e kontrollit dhe vendosjes në vend të sigurt. Hedhja e mbeturinave bëhet nëpër kontejnerë të mëdhenj dhe të vegjël nëpër vende të caktuara ku me pas bëhet bartja e tyre në deponinë qendrore në afërsi të qytetit të GJILANIT. Vendi i më parshëm ku është bërë deponimi i mbeturinave është mbuluar dhe kthyer në gjendje të rikultivueshme. Problem në vete janë vajrat e ndërruara të automjeteve , gomat e vjetra, thaset e najlonit, shishet e plastikës , liri i gazrave nga automjetet e vjetruara. (shih hartën nr. 49 )

### **3.2.4.6 RADIOAKTIVITETI (JONIZUES DHE JOJONIZUES)**

Gjatë punës grupet punuese kanë trajtuar edhe informatën për vendin ku është goditur me uranium të varfëruar nga NATO gjatë luftës së fundit në Kosovë.

### **SHFRYTËZIMI I TOKËS - DESTINIMI I SIPËRFAQEVE**

Planifikimi i Përdorimit të tokës për dhjetë vitet e ardhshme në komunën e Kamenicës për grupet punuese ishte sfidë e veçantë pasi që në hapësirë duhej të bëhej trajtim, identifikim i konflikteve dhe integrim i të gjitha zhvillimeve me përcaktimin se çfarë lloje të aktiviteteve të përdorimit të tokës duhet të ndodhin dhe ku duhet të bëhen ato, duke përdorur standardet

ndërkombëtare dhe GIS-in u lehtësua procesi i vendim marrjes në kuptimin e destinimit për shfrytëzim të hapësirës dhe në këtë drejtim grupet punuese dhe grupi i ekspertëve të kyçur në këtë proces kanë parashikuar se toka në komunën e Kamenicës në masë të konsiderueshme do të vazhdojë të jetë e destinuar dhe e ruajtur për tokë bujqësore dhe tokë pyjore, pjesë tjera do të jetë e destinuar për vendbanime apo tokë ndërtimore, zona arkeologjike, varreza, gjelbërim, rrugë, deponi të mbeturinave, korridore, industri edhe të gjitha fushat dhe sektorët e nevojshëm. (Harta. Shfrytëzimi i tokës fq.33).

#### **3.2.4.7 ZONAT ME DESTINIM TE VEÇANTE NË NIVELIN KOMUNAL (TË NATYRËS, VENDBANIMET DHE ZONAT TJERA)**

Nga analizat e gjendjes të bëra nga grupet punuese nga informatat dhe analizat e bëra në terren është bërë një përcaktim i zonave për destinim të veçantë.

Parashikohet që Planica, Kika, Velegllava, Tugjeci për shkak të vlerave kulturore, turistike dhe rekreative, Tërstena dhe Zajçeci për shkak të pozitës në zonën kufitare dhe vlerave natyrore, të trajtohen si vendbanime të interesit të veçantë për komunën. Shipashnica e Epërme, Gjyrisheci dhe Kremenata për shkak të resurseve ujore të trajtohen si zona me destinim të veçantë (ndërtimi i pendave).

Parashikohet që zonat arkeologjike Kopërnica, Krileva, Topanica, Busavata, Hodonoci, Hogoshti, Gjyrisheci, Vaganeshi, Hajnoci, Moçari, Berivojca, Koretini, Karaçeva Epërme, Muçivërci, Kamenica, Kranidelli dhe Strezoci, të trajtohen si zona të interesit të veçantë të vlerave arkeologjike dhe zonës së mbrojtur.

Parashikohet që zonat e mbrojtura monumentale (varrezat, Lapidarët e Dëshmorëve), në vendbanimet Kopërnica, Topanica, Hogoshti, Gjyrisheci, Koretini, Karaçevëa e Epërme, Karaçeva e Poshtme, Kamenica, Bujnoci, Rogaçica, Poliçka, Petroci, Leshtari, Rahovica, Zajçeci, Dajkoci, Svirca, dhe Shipashnica e Epërme të trajtohen si zonat e interesit të veçantë të vlerave monumentale kulturore.

Parashikohet që zonat e mbrojtura të monumenteve të kultit fetar (kisha, xhamia, teqe dhe tyrbe), në vendbanimet Kopërnica, Topanica, Kamenica, Rogaçica, Zajçeci, Hodonoci, Desivojca, Zhuja, Dazhnica, Kika, Moçari, Vaganeshi dhe Hajnoci të trajtohen si zonat e interesit të veçantë të vlerave monumentale të kultit fetar.

Parashikohet që zonat e mbrojtura ndërtimore (shtëpi banimi dhe objekte bujqësore), në vendbanimet Kremenatë, Gjyrishec, Strezoc, Moçar, Zhujë, Dazhnicë, Kopërnice, Vriçec, Shipashnicë e Epërme, Hogosht të trajtohen si zonat e interesit të veçantë të vlerave monumentale të ndërtimore.

Parashikohet që zonat me pasuri minerale (bentoniti, kuarc, magnez, thëngjill, hekur, kallaj, nikel, plumb, argjend, mermer dhe granit) në vendbanimet Karaçevë e Poshtme, Kremenata I, Kremenata II, Vaganeshi, Muçivërci, Shipashnica e Poshtme, Sedllari, Vriçeci, Kopërnica, Busavata, Strezoci, Velegllava e Poshtme, Velegllava e Epërme, Tërstena, Desivojca, Lajçiqi, Kranidelli, Bllata, Shipashnica e Epërme dhe Rogaçica, të trajtohen si zona të interesit të veçantë për zhvillim ekonomik. (shih hartën nr. 58 Destinimi i tokës në Komunën e Kamenicës)

#### **3.2.4.8 KONTEKSTI URBAN-RURAL**

Ekipet të cilat kanë punuar në dokument kanë analizuar gjendjen (Demografike në kuptimin e shtimit të popullatës dhe shpërnguljeve, aspektin ekonomik, social dhe mjedisor) në gjitha vendbanimet e Kamenicës dhe kanë konstatuar se për të ruajtur baraspeshën urbano-rurale dhe siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe miqësor me mjedisin.

Parashikohet që duhet vepruar me prioritet në fshatrat Tugjeci, Feriqeva, Krileva, Lisocka, Poliçka, Vriçeci, Maroca, Tërstena, Desivojca, Lajçiqi, Kranidelli, Busavata. Në këto vendbanime parashihen edhe zhvillime të aspektit ekonomik, infrastrukturor etj. (shih hartat

Rrjeti rrugorë, infrastruktura rrugore, kanalizimi, ujësjellësi, telekomi, shkollat dhe objektet fetare).

Parashikohet zhvillimi përpos qytetit dhe nënqendrave si Rogaçica, Hogoshti, Strezoci edhe në të gjitha vendbanimet të bëhet bazuar në konceptin e zhvillimit kompakt të vendbanimit, të bëhet trajtimi si zona me interes të veçantë të disa vendbanimeve.

Të bëhet zgjerim i planifikuar i disa vendbanimeve në pronësi private por dhe komunale që është prezantuar në hartën e (Koncepti i zhvillimit të Vendbanimeve) Furnizim sa ma shumë që është e mundur me infrastrukturë urbane të gjitha vendbanimet.

Zhvillimi i ndërtimeve brenda kufijve të planifikuar ndërtimor parashikohet zhvillimi dhe organizimi i prodhimit bujqësor brenda zonës kadastrale të vendbanimit, por edhe zonës ndërtimore në zonat e ashtuquajtura zemra e gjelbër (agroekosistemi) Parashikohet zgjerimi me përmbajtje të industrisë në ato vendbanime që kanë interesim për këtë, ndërtimi modern i objekteve të banimit dhe objekteve tjera, renditja si duhet të veprimtarive shërbyese.

Parashikohet që gjatë ndërtimit të shtëpive e lokaliteteve të merren pëlqime ( në zonat rurale) dhe respektohen ma tepër norma specifike urbane dhe angazhimi i organeve kompetente për krijimin e një klime urbanistike sidomos për pjesët të cilat konsiderohen ende të pa prekura.

#### **3.2.4.9 TRASHËGIMIA NATYRORE**

Bazuar në të gjitha informatat të cilat janë marrë nga kjo fushë me theks të veçantë nga Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Natyrës dhe grupi punues për Shfrytëzim të Tokës dhe Mjedis ,Kjo fushë (trashëgimin natyrore) analizuar në fazë e analizës së gjendjes dhe parashikohet që: Zonat me vlera të veçanta natyrore (Planica, Kika, Velegllava, Tugjeci) të shpallën të mbrojtura, të ruhen, mbrohen dhe konservohen dhe zhvillohen me projekte kryesore sipas normave për këto zona. Parashikohet që trungjet e vjetra dhe monumente gjeomorfologjike të shpallën të mbrojtura, të ruhen sensibilizohen, mbrohen dhe konservohen. (Shih Harten nr. 55 trashëgimia natyrore)

#### **a) PEIZAZHET**

Komuna e Kamenicës është e pasur edhe me peizazhe dhe ekipet punuese kanë paraparë trajtim adekuat të laramanisë së peizazheve duke parashikuar masa dhe veprime për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e tyre:

Bukuria e peizazhit është pasuri për turizmin. Për ta mbrojtur, interventimet e njeriut në pikat skenike – pika atraktive duhet të minimizohen. Posaçërisht në zonat e dedikuara për zhvillimin e turizmit.

- Kika parashikohet që të zhvillohet dhe fuqizohet me elemente të pushimoreve dhe staza për skijim dimëror dhe veror dhe për shëtitje si dhe qendrën mjekësore për rehabilitim.
- Pllanica parashikohet që të zhvillohet dhe fuqizohet me elemente të pushimoreve dhe staza për shëtitje.
- Tugjeci parashikohet që të zhvillohet dhe fuqizohet me elemente të pushimoreve dhe staza për skijim dimëror dhe veror dhe për shëtitje si dhe qendrën mjekësore për rehabilitim.
- Lumi i Desivojcës, Hogoshtit, Kremenatës edhe në këto zona janë planifikuar rrethim i zonës dhe është planifikuar që të mos ket ndërtime të tjera.
- Peizazhet bujqësore parashikohet që këto zona të mbrohen dhe zhvillohen me rrugë që i shërbejnë, po ashtu janë paraparë staza për ecje, llojlojshmëria e produkteve bujqësore është një parakusht i rëndësishëm për mirëmbajtjen e strukturave të vogla të këtyre peizazhit.
- Livadhet dhe kullosat është paraparë që të mbjelljen e llojeve të shumta të bimëve barishtore.
- Vargmalet është paraparë që të mbrohen nga prerja e e pakontrolluar e pyjeve dhe zjarret duke penguar erozionin i cili është fenomen i cili paraqitet në zonat e zhveshura.

### **3.2.4.10 FATKEQËSITË NATYRORE DHE TË TJERA**

Në analizën e situatës janë analizuar këto fatkeqësi natyrore: Tërmetet, vërshimet, rrëshqitjet e borës, bora e madhe, era e fortë, breshri, akulli, thatësira, paraqitja masive e sëmundjeve ngjitëse të njerëzimit, të shtazëve dhe të bimëve dhe fatkeqësi të tjera, që i shkakton natyra dhe në kuadër të fatkeqësive të tjera janë analizuar fatkeqësitë e mëdha në trafikun rrugor, ajror dhe hekurudhor, zjarret, shkatërrimi i digave dhe fatkeqësitë e tjera ekologjike dhe industriale, që i shkakton njeriu me punë dhe me sjellje, gjendja e jashtëzakonshme, emergjente, temperaturat e larta, kolapsi teknik i sistemeve energjike të furnizimit me rryme, telekomunikacioni dhe teknologjisë informative, aktet e gabuara dhe mënyrat e tjera të rrezikimit masiv.

Nga grupet punuese është konstatuar se njëra ndër fatkeqësitë natyrore më sfiduese është tërmeti është parashikuar se duhet marrë masa për të lëvizur nga kultura e reagimit në kulturën e marrjes së masave për amortizim dhe minimizim të dëmeve, në këtë drejtim ekipet kanë paraparë:

- Të përgatitet rregullorja për të gjitha ndërtimet në harmoni me shkallën e rrezikut sizmik, të ndërtohet me standardet.
- Në objektet e veçanta si dhe në objektet shumëkatëshe duhet të punohen me arkitekturë a-sizmike.

#### **a) BRESHËRI**

Nga analiza e situatës është konsideruar se breshëri është një rrezik që shpesh herë rrezikon ekonominë e vendit breshëri dhe ekipet kanë parashikuar ndërtimin e stacioneve kundër breshërit në vendet ku ishin edhe më parë siç shihet në harta.

#### **b) RRËSHQITJET E BORËS, ERËRAT E FORTA DHE AKULLI**

Rrëshqitje të borës akulli dhe erërat e forta janë analizuar dhe nuk është konstatuar se paraqesin ndonjë rrezik të madh për ekonominë dhe popullatën, sido që të jetë ekipet kanë konsideruar se duhet ndërmerren masa gjatë kohës së dimrit dhe posaçërisht në zonat kodrinore- malore

#### **c) THATËSIRA**

Thatësira mund të konsiderohet si rrezik për kulturat bujqësore gjatë sezonit verorë, kryesisht gjatë muajve korrik dhe gusht kur temperaturat janë më të larta dhe të reshurat janë më të rralla por ekipet kanë parashikuar ndërtimin e pendave në Shipashnicë të Epërme, Gjyrishec dhe Kremenatë dhe një sistemi të përbërë edhe nga një numër pendash të vogla etj.

#### **q) VËRSHIMET**

Ekipet kanë konstatuar se përmytjet janë fatkeqësi elementare të cilat kërkojnë vëmendje të posaçme, pasi që paraqiten të rrezikshme për jetën e njeriut dhe sjellin dëme të konsiderueshme materiale (sipërfaqe të rrezikuara nga vërshimet janë rreth 1100-1500 ha). Të vetëdijshëm se përmytjet nuk mund të parandalohen, por dëmet e tyre mund të amortizohen dhe menaxhohen.

Ekipet kanë parashikuar hapjen e kanaleve, rregullim prej dheu, pastrim dhe mirëmbajtje, rregullim urban faza 1 dhe 2.

Si masa tjera janë paraparë eliminimi i lakesave të forta të lumit dhe menaxhimi i brigjeve të lumenjve. Mbrojtja e lumenjve nga hedhja e mbeturinave, që në këtë rast paraqesin pengesa për lëvizjen e lirë të ujit. Ndalimi i ndërtimit të objekteve të banimit si dhe atyre me karakter ekonomik buzë brigjeve të lumenjve së paku 50-100 m largësi nga shtrati i lumit (pikës ujore).

#### d) **EROZIONET**

Rajonet në të cilat erozioni ka intensitet të madh në ujë rrjedha, tokë, pyje dhe objekteve të paluajtshme, parashikohen të shpallen zona erozive ku sipas Ligjit të Ujërave të Kosovës i shpallë komuna.

Me qëllim të parandalimit të aktivitetit eroziv parashikohet të ndërmerren hapa konkret dhe të menjëhershëm siç janë:

1. Ndalimi i prerjeve dhe degradimi i pyjeve.
2. Ndalimi i mbi kullotjes
3. Ndalimi i shfrytëzimit të mirave materiale që shkaktojnë erozion,
4. Ndalimi i eksploatimit të dheut dhe rërës etj.

Si veprime anti-erozive parashikohen këto veprime hidroteknike, bujqësore dhe biologjike.

#### **Masat hidroteknike**

- Ndërtimi i terasave, gardoneve dhe pendave në shtretërit e përroskave dhe përrenjve si masa mbrojtëse hidroteknike për ta minimizuar fuqinë gërryese.
- Ndërtimi i argjinaturave në brigjet e lumenjve si masë parandaluese e gërryerjes
- Mbjellja e fidaneve pyjore në shtretërit e lumenjve
- Ndalimi i nxjerrjes së inerteve në shtretërit e lumenjve

#### **Masat bujqësore**

- Të mirëmbahen tokat bujqësore
- Të aplikohen drejtë praktikat bujqësore
- Përdorimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit të bëhet në bazë të udhëzimeve të ekspertëve
- Rritja e investimeve për mbrojtjen e tokës në brigjet e lumenjve.

#### **Masat biologjike**

- Mbrojtja e pyjeve ekzistuese nga prerjet e pa kontrolluara dhe nga zjarri
- Ndalimi i kullotjes në masivet e varfra me bimësi
- Pyllëzimi i viseve të zhveshura dhe atyre të degraduara
- Krijimi i brezave të gjelbër në ato rajone ku shkalla e erozionit është e lartë.
- Erozioni duhet të kufizohet në brigjet e lumenjve kryesor me rregullimin e shtretërve dhe mbëltime të druve që do të mbulonin brezin prej 10 m largësi nga lumi
- Shfrytëzimi i tokave bujqësore në fushat lumore të lumenjve kryesor duhet të kufizohet me kullosa të përhershme ose pyje.

**Parashikohet se me prioritet duhet bërë këto intervenime antierozive në rreth 25050 ha që rrezikohen nga erozioni i fortë dhe erozion shumë i fortë edhe atë:**

- Intervenimet anti erozive, Erozioni i dobët që shtrihet në një sipërfaqe me 11550ha: në këto vendbanime: Svircë, Velegllavë e Epërme, Desivojcë, Tërstenë, Lajçiq, Velegllavë e Poshtme, Vriçec, Sedllar, Rogaçicë, Muçivërc, Dajkoc, Topanicë, Koretin, Berivojcë, Kamenicë.
- Intervenimet anti erozive, erozioni i mesëm që shtrihet në një sipërfaqe me 15900 ha: në këto vendbanime: Velegllavë e Epërme, Desivojcë, Tërstenë, Rogaçicë, Muçivërc, Dajkoc, Qarakoc, Hodonoc, Petroc, Shipashnicë e Poshtme, Kolloleq, Kopërnice, Hogosht, Busavatë, Kamenicë, Grizime, Huboc,



Bratilloç, Strezoc, Hajnoc, Kremenatë I, Kremenatë II, Vaganesh, Leshtar, Rahovicë, Krilevë, Gragjenik, Zajçec.

- Intervenimet antierozive (kundërozive), erozioni i fortë që shtrihet në një sipërfaqe me 13500ha: në këto vendbanime: Rogaçicë, Muçivërc, Kolloleq, Kopërnice, Koretin, Berivojcë, Busavatë, Strezoc, Moçar, Stralicë, Krilevë, Petroc.
- Intervenimet anti erozive, Erozioni shumë i fortë që shtrihet në një sipërfaqe me 11550ha: në këto vendbanime: Poliçkë, Velegllavë e Poshme, Vriçec, Marocë, Hogosht, Kopërnice, Rogaçicë, Karaçevë e Epërme, Hodonoc, Svirçë, Gmicë, Shahiq, Zhujë, Lisockë, Dazhnicë, Gjyrishec, Meshinë, Feriqevë, Bratilloç, Kostadincë, Huboc, Gogolloc, Berivojcë, Busavatë,

Në bazë të analizave propozohen masat antierozive :

Ndërtimi i brezave mbrojtës në shpatijet e rrëpijshme (tatëpjetat e mëdha)

Ndërtimi i mureve rrezistuese (të qëndrueshme)

Meliorimi i kullosave

Meliorimi i pyjeve

Ndërtimi i formave tjera antierozive (kundërozive).

#### **dh) ZJARRET**

Ekipet kanë konstatuar rrezikun e përhershëm nga zjarret dhe në këtë drejtim kanë paraparë.

- Masa të pengimit të objekteve dhe pajisjeve të cilat shkaktojnë zjarr ose e ndihmojnë zjarrin në pyje dhe hapësira tjera të rrezikuara nga zjarri
- Masa të përkrahjes së objekteve dhe pajisjeve të cilat pengojnë zjarrin ose e ndihmojnë fikjen e zjarrit në pyje dhe hapësira tjera të rrezikuara nga zjarri
- Tampon zona në mes të zonave pyjore dhe zonave tjera të ndjeshme nga zjarri dhe një tampon zonë në brezin kufitar për të penguar përçimin eventual të zjarrit
- Hidrantët dhe akumulime uji në sa ma shumë pika dhe vendbanime
- Sigurim i qasjes me automjet që përdoren për fikje të zjarrit deri te çdo njësi banimi në Komunën e Kamenicës.



### **3.3.0 SHENJIMIN E ZONAVE URBANE EKZISTUESE DHE TË PROPOZUARA PËR TË ARDHMEN DHE NDËRTIMIN E ZONAVE JASHTË ZONËS URBANE DHE KUFIJVE NDËRTIMOR TË VENDBANIMEVE**

Zonë ekzistuese urbane është trajtuar : Zona urbane e qytetit të Kamenicës e trajtuar brenda zonës kadastrale të Kamenicës për të ardhmen parashihet zgjerimi i kufirit ndërtimor.

Zona urbane e propozuar për të ardhmen është: Rogaçica, Hogoshti dhe Strezoci do të hartohen planet rregulluese pasi që janë planifikuar të trajtohen si nën-qendra por edhe vendbanimet si: Hodonoci, Koretini dhe Muçivërci të trajtohen për hartimin e planeve rregulluese.

### **3.3.1 NDËRTIMIN E ZONAVE JASHTË ZONËS URBANE DHE KUFIJVE NDËRTIMOR TË VENDBANIMEVE**

Zonat në të cilat parashihen ndërtimet jashtë zonës urbane janë :

Zona Industriale Hodonoc – Domaroc

Zonat për zhvillim të industrisë

Disa zona sportive dhe rekreative (shih hartën “Shkollat dhe fushat sportive”

Pendat në Shipashnicë të Epërme, Gjyrishec dhe Kremenatë

Ndërtimet në zonat zhvillimore të bujqësisë

Vikend zonat Tugjeci, Desivojca, Pllanika, Kika, Velegllava.

Deponitë e mbeturinave.

### **3.3.2 SHËNIMI I NDËRTIMEVE TË RËNDËSISHME, PROJEKTI STRATEGJIK OSE ZONËS SË VEÇANTË TË APROVUARA NË PLANIN HAPËSINOR TË KOSOVËS OSE PLANET E ZONAVE TË VEÇANTA**

Sipas Draft Planit Hapësinor të Kosovës, janë disa zhvillime të rëndësishme të cilat prekin rajonin, ku për të cilat kemi pasur kujdes gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal siç janë traseja e hekurudhës, impianti regjional në Ranillug (Dheu i Bardhë) për trajtim të ujërave të zeza që do të shërbejë edhe për Kamenicën, Gjilanin dhe Vitinë. Në këtë drejtim kemi analizuar trasenë dhe kemi propozuar variantin më racional të trasesë për linjën hekurudhore të Ferizajt me Gjilanin nëpër territorin e Komunës së Kamenicës dhe korridoret e rëndësishme **EX-** Prishtinë- Kamenicë-Bujanoc.

Në funksion të impiantit regjional për ujëra të zeza, është planifikuar traseja e kolektorit kryesor për bartjen e ujërave të zeza në drejtim të pikës për trajtim.

### **3.4.0 SHENJIMIN E ZONAVE URBANE EKZISTUESE DHE TË PROPOZUARA PËR TË ARDHMEN DHE NDËRTIMIN E ZONAVE JASHTË ZONËS URBANE DHE KUFIJVE NDËRTIMOR TË VENDBANIMEVE**

Zonë ekzistuese urbane është trajtuar : Zona urbane e qytetit të Kamenicës e trajtuar brenda zonës kadastrale të Kamenicës për të ardhmen parashihet zgjerimi i kufirit ndërtimor. Zona urbane e propozuar për të ardhmen është: Rogaçica, Hogoshti dhe Strezoci do të hartohen planet rregulluese pasi që janë planifikuar të trajtohen si nën-qendra por edhe vendbanimet si: Hodonoci, Koretini dhe Muçivërci të trajtohen për hartimin e planeve rregulluese.

### **3.4.1 NDËRTIMIN E ZONAVE JASHTË ZONËS URBANE DHE KUFIJVE NDËRTIMOR TË VENDBANIMEVE**

Zonat në të cilat parashihen ndërtimet jashtë zonës urbane janë :

Zona Industriale Hodonoc – Domaroc

Zonat për zhvillim të industrisë

Disa zona sportive dhe rekreative (shih hartën “Shkollat dhe fushat sportive”

Pendat në Shipashnicë të Epërme, Gjyrishec dhe Kremenatë

Ndërtimet në zonat zhvillimore të bujqësisë


Vikend zonat Tugjeci, Desivojca, Pllanica, Kika, Velegllava.

Deponitë e mbeturinave.


### **3.4.2 SHËNIMI I NDËRTIMEVE TË RËNDËSISHME, PROJEKTI STRATEGJIK OSE ZONËS SË VEÇANTË TË APROVUARA NË PLANIN HAPËSINOR TË KOSOVËS OSE PLANET E ZONAVE TË VEÇANTA**

Sipas Draft Planit Hapësinor të Kosovës janë disa zhvillime të rëndësishme të cilat prekin rajonin për të cilat kemi pasur kujdes gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal siç janë traseja e Hekurudhës, Impianti regjional në Ranillug (Dheu i Bardhë) për trajtim të ujërave të zeza që do të shërbejë edhe për Kamenicën, Gjilanin dhe Vitinë. Në këtë drejtim kemi analizuar trasenë dhe kemi propozuar variantin më racional të trasesë për linjën hekurudhore të Ferizajt me Gjilanin nëpër territorin e komunës së Kamenicës dhe korridoret e rëndësishme **EX-** Prishtinë- Kamenicë-Bujanoc.

Në funksion të impiantit regjional për ujëra të zeza është planifikuar traseja e Kolektorit kryesor për bartjen e ujërave të zeza në drejtim të pikës për trajtim.



Strategjia e zhvillimit hapësinor – Hapësira e verdhë



Monumentet kulturore me status të mbrojtjes



Zonat e veçanta të mbrojtura

### **3.5.0 VLERËSIMIN E NDIKIMIT SOCIO-EKONOMIK DHE MJEDISOR TË KORNIZËS SË PROPOZUAR**

Duke ditur se korniza e zhvillimit hapësinor shpreh parashikimin e dëshiruar hapësinor për territorin e komunës

Vlerësimi i ndikimit socio-ekonomik dhe mjedisor të zhvillimeve të parashikuara hapësinore është një hapë i rëndësishëm, këto zhvillime si rezultat i procesit të planifikimit manifestohen me ndikime në jetën e njerëzve që në përgjithësi do të trajtohet si ndikim në aspektin social por këto zhvillime do kenë ndikimet e veta edhe në aspekti mjedisor dhe ekonomik. Ky vlerësim do të shtjelloj ndikimet e pritura socio ekonomike dhe mjedisore të kornizës, gjegjësisht zhvillimeve të parashikuara dhe dëshiruara hapësinore .

Sikurse në profil edhe kapitujt tjerë edhe ky vlerësimi do të bëhet bazuar në fushat tematike edhe atë në: Zhvillimin ekonomik, Infrastrukturë, Demografi dhe çështje sociale si dhe shfrytëzim të tokës dhe mjedis

Çfarëdo lloj zhvillimi që është paraparë në këto fusha tematike karakterizohet me shtrirje hapësinore, mjedisin që e rrethon dhe ndikimet doemos përqendrohen në zonën e zhvillimit të parashikimit të dëshiruar zhvillimor por marrin parasysh edhe ndërlidhjet me aktivitetet e ndryshme që zhvillohen në zonat e afërta andaj vlerësimi i zënies fizike të hapësirës(okupim i territorit) është dimension i rëndësishëm për tu vlerësuar.

#### **Ndikimet e koncepteve kryesore në ekonomi**

Koncepti kryesor i zhvillimeve hapësinore në nivel komunal është :Konceptin Policentrik me tri segmente lineare (koncepti i DIELLIT) dhe në nivel të vendbanimit kemi konceptin e vendbanimit kompakt.

**Vlerësim 1:** Në kuptimin ekonomik korniza mund të vlerësohet se është shtrirë në mënyrë racionale duke ofruar shpërndarje hapësinore ekonomike, ofrim të hapësirës për zonën industriale dhe mundësi investimesh për investitor vendor dhe të huaj, ky koncept parashikon ofrimin e shumë shërbimeve më afër qytetarit, vlerësohet se koncepti do të ofrojë ( mundësojë) vende të reja pune, mjedis cilësor edhe kosto më të lira shërbimesh.

#### **Ndikimet e koncepteve kryesore në zënien e tokës**

**Vlerësim 2:** Njëri nga prioritetet e koncepteve kryesore është mbrojtja e tokës kualitative bujqësore dhe ndalimi i ndërtimit në tokat e kategorisë II-IV. Vlerësohet se mbrojtja tokës kualitative bujqësore paraqet një parim mbi të cilin është mbështetur koncepti kryesor i zhvillimit hapësinor e që mund të konstatohet se, kemi zënie enorme të tokës për ndërtim (e trashëguar nga zhvillimet e pa planifikuara dhe pa koordinuara më herët). Në anën tjetër vlerësohet pozitive zënia minimale e tokës për ndërtim me kufijtë e rinj e posaçërisht shpallja e zonave të ngrira në akset kryesore, të cilat do të kontribuojnë për ndaljen e trendit të zënies së tokës në këto akse dhe zbatim të konceptit.

Në funksion të zënies sa më të vogël të tokës me koncept është parashikuar ndalimi i ndërtimit në tokën cilësore bujqësore përveç në rastet e përshkruara me Ligjin mbi Planifikimin Hapësinor. Pra, për kundër parashikimeve të zhvillimit kompakt në nivel vendbanimesh në parimet e dendësimit të ndërtimit vlerësohet se disa vendbanime do të vazhdojnë të zhvillohen në tokën kualitative bujqësore, sidomos në pjesën rrafshinore të territorit të Komunës së Kamenicës (edhe më herët janë shtrirë në ato zona) por përkufizimi i zhvillimit me kufij të rinj si

dhe promovimi i zemrave të gjelbra në disa vendbanime vlerësohet si racional i qëndrueshëm dhe pikë e fortë e konceptit.

#### **Ndikimet e koncepteve kryesore në aspektin mjedisor**

**Vlerësim 3:** Në fushën mjedisore koncepti zhvillimit policentrik me tri segmente lineare në nivel komunal dhe ai i zhvillimit kompakt në nivel vendbanimi vlerësohen të ndikojnë pozitivisht në cilësinë e ajrit (pasi që koncepti promovon zhvillimin kompakt dhe mundësinë e ngrohjeve.

#### **Ndikimet e koncepteve kryesore në aspektin Social**

**Vlerësim 4:** Në aspektin social koncepti zhvillimit policentrik me tri segmente lineare në nivel komunal dhe ai i zhvillimit kompakt në nivel vendbanimi vlerësohen të ndikojnë pozitivisht në cilësinë e jetës (pasi që koncepti promovon zhvillimin kompakt (organizim më të shpejt për aksione) dhe mundësin e zhvillimit e shumë aktiviteteve sociale të cilat do të kenë ndikim të drejt për drejtë në cilësinë e jetës së tij), thjesht ky koncept përfaqëson një formë më cilësore të jetesës dhe doemos siguron një shans më shumë për kohezion social (varfërisë, varfërisë ekstreme, fuqizimin e njerëzve/personave në nevojë, në rritjen e mundësive për punësim të grupeve në nevojë, në bashkëpunim me OJQ-të dhe aktorët tjerë të rëndësishëm) si dhe ri kthimin e dimensionit social të qytetarit të komunës së Kamenicës e raporteve me vetveten dhe rrethin.

#### **Fusha e Zhvillimit Ekonomik**

Në fushën e zhvillimit ekonomik janë paraparë zhvillimet në sektorët e Industrisë dhe xehetarisë, industrisë përpunuese, blegtorisë, turizmit rural dhe shërues(me theks të veçantë në shfrytëzimin e të gjitha resurseve të trashëgimisë kulturore për zhvillim ekonomik),transportit, infrastrukturës dhe bartja e lëvizshmëria, ndërtimtarisë, hotelerisë, zejtarisë, energjisë, sistemi bankarë, telekomunikimi dhe disa veprimtari tjera shërbyese.

**Vlerësim 5:** Vlerësimi i ndikimit të kornizës së zhvillimit të kësaj fushe në aspektin ekonomik do të thotë se, ofron shumë më shumë mundësi të zhvillimit të qëndrueshëm efikas dhe reflektues në kërkesat dhe ofertat, korniza ofron shumë më shumë nëse krahasohet me skenarin e bërjes asgjë por edhe nëse krahasohet me një standard të kohës, zhvillimet e analizuara dhe parashikuara shkojnë në drejtimin e plotësimit të standardeve të kohës për zhvillim të qëndrueshëm duke ofruar e paraparë edhe aktivitete gjithëpërfshirëse, shumëdimensionale dhe në funksion të zbatimit të politikave ekonomike.

Në aspektin **social** vlerësohet se zhvillimi ekonomik i paraparë me këtë kornizë do të krijojë bazat për zhvillim më të qëndrueshëm social dhe mirëqenie sociale, duke përfshirë zbutjen e varfërisë dhe të papunësisë por edhe rritjen e shansit të arsimimit dhe profesionalizimit deri te plotësimi i një kënaqësie më të madhe qytetare. Pra, në këtë dimension në aspektin **mjedisor** vlerësohet se zhvillimi ekonomik i paraparë me këtë kornizë do të krijojë bazat që aktivitetet të zhvillohen në atë mënyrë që të jenë “miqësore” ndaj mjedisit në përgjithësi dhe ndikimi i ndotjeve të ajrit, ujit, tokës të jetë në kufijtë e të tolerueshmes duke paraparë masat dhe standardet qysh nga aplikimi për zhvillim të caktuar, si dhe duke krijuar të ashtuquajturën paketë të kushteve urbane dhe hapësinore.



Në aspektin **fiziko hapësinorë** korniza vlerësohet të ketë identifikuar dhe përkufizuar vendndodhjet të mundësive zhvillimore duke parashikuar mbrojtjen e hapësirave për këto zhvillime. Gjithashtu, duke u mundur që minimumi i domosdoshëm i hapësirave të jetë në funksion të zhvillimeve jo bujqësore, në këtë funksion vlerësohet se ndikim më të madh do të ketë destinimi i hapësirës për zonën industriale për zhvillim të industrisë si dhe korridoret. Lidhur me këtë, vlerësohet lartë edhe analiza e bërë dhe e prezantuar edhe në kornizë e raporteve hapësinore por edhe fizike të zhvillimeve ekonomike.

Në fushën e zhvillimit të demografisë dhe çështjeve sociale, në kornizën e zhvillimit hapësinor nga kjo fushë janë paraparë zhvillime, si: në fushën e arsimit duke e pasuruar ofertën e arsimit dhe me kompletim të infrastrukturës në kuptimin e fuqizimit, plotësimit me përmbajtje dhe me ndërtime të reja: fushën e shëndetësisë duke ofruar edhe shërbime spitalore dhe plotësuar shërbimet aktuale; në fushën e kulturës, aktivitete në mbrojtje dhe fuqizim (kalatë dhe kështjellat, objektet e kultit, trashëgimia arkitektonike, shpirtërore, arkeologjike etj.), si dhe dhe në atë të sportit janë paraparë disa zhvillime.

**Vlerësim 6:** Vlerësimi i ndikimit të kornizës së zhvillimit të kësaj fushe në aspektin ekonomik do të thotë se ofron mundësinë e ngritjeve profesionale në fushat e ndryshme, me theks në bujqësi dhe zejтари, por edhe fushat tjera që do të reflektojnë në zhvillimin ekonomik, korniza prekë një segment të fuqishëm me aktivitete konkrete dhe tenton që oferta kulturore e Kamenicës, të jetë në harmoni me mundësitë që ka komuna e që do të kontribuoj në zhvillimin ekonomik. Pra, vlerësohet se edhe sporti në botë jep të hyra në zhvillimin ekonomik, shih për këtë edhe këto aktivitete të parapara kontribuojnë në atë drejtim, përputhshmërisht me këto synime kontribuon edhe shëndetësia. Festat dhe ditët e rëndësishme edhe aktivitetet e kësaj fushe, mund vlerësohet lirisht se janë gjithëpërfshirëse, shumëdimensionale dhe në funksion të zbatimit të politikave ekonomike.

Në aspektin **social** vlerësohet se me këtë kornizë është analizuar dhe trajtuar më së shumti ky dimension dhe vërtetë duket se, korniza e zhvillimit të kësaj fushe fuqishëm do të ndikojë në krijimin e bazave për zhvillim më të qëndrueshëm social dhe mirëqenie sociale duke përfshirë zgjerimin e shërbimeve dhe cilësisë, zbutjen e varfërisë dhe papunësisë por edhe rritjen e shansit të arsimimit dhe profesionalizimit deri te plotësimi i një kënaqësie më të madhe qytetare. Pra, në këtë dimension në aspektin **mjedisor** vlerësohet se, zhvillimi i demografisë dhe çështjeve sociale i paraparë me këtë kornizë do të krijojë bazat që aktivitetet të zhvillohen në atë mënyrë që të jenë miqësore ndaj mjedisit në përgjithësi dhe ndikimi i ndotjeve të ajrit, ujit, tokës të jetë në kufijtë e të tolerueshmes edhe se vetë fusha është miqësore por ndikimet e njeriut në ndotje janë ndër më përmbajtjesoret.

Në aspektin **fiziko hapësinor** korniza vlerësohet të ketë identifikuar dhe përkufizuar vendndodhjet të mundësive për sport, kulturë, arsim shëndetësi, ngrohje etj. si dhe duke parashikuar mbrojtjen e hapësirave për këto zhvillime.

Mu për to, vlerësohet lartë edhe analiza e bërë dhe e prezantuar edhe në kornizën e raporteve hapësinore por edhe fizike të zhvillimeve të kësaj fushe.

Në fushën e zhvillimit **Infrastrukturës** në kornizën e zhvillimit hapësinor nga kjo fushë janë paraparë zhvillime në hapjen e rrugëve dhe korridoreve të reja po ashtu edhe zgjerimin, plotësimin dhe modernizimin e infrastrukturës ekzistuese rrugore, në funksionalizimin dhe modernizimin e infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit, menaxhimit të mbeturinave, energjetike, telekomunikimit etj.

**Vlerësim 7:** Vlerësimi i ndikimit të kornizës së zhvillimit të kësaj fushe në aspektin ekonomik do të thotë se ofron mundësinë e qarkullimit të mallrave dhe njerëzve me shpejtësi ma të madhe dhe çmim më të lirë, qasje më të gjerë sidomos drejt Prishtinës dhe Serbisë, stabilizim energjetik si parakusht i zhvillimit ekonomik si dhe shfrytëzimi i mundësive të reja telekomunikuese për zhvillim ekonomik deri te shfrytëzimi i infrastrukturës së mbeturinave dhe menaxhimit të saj për vende të reja pune dhe zhvillime të caktuara përpunuese. Pra edhe kjo fushë mund vlerësohet se është gjithëpërfshirëse, shumëdimensionale dhe në funksion të zbatimit të politikave ekonomike.

Në aspektin **social** vlerësohet se, me këtë kornizë ofrohet shpejtësia e lëvizjes dhe cilësia e lëvizjes, ku vlerësohet se korniza ofron bazat e ngritjes së cilësisë së shumë shërbimeve tjera që kanë drejtpërsëdrejti ndikim në jetën. Nga kjo vlenë të përmendet se, me kornizë parashihet ndërrimi i gypave të furnizimit me ujë që janë nga azbest çimentoja, sepse në aspektin **mjedisor** vlerësohet, që zhvillimi i infrastrukturës rrugore dhe asaj hekurudhore nëse nuk merren masat adekuate, mund krijojë ndotje. Pra, për këto zhvillime janë paraparë masat shtesë si shiritat mbrojtës etj. ku edhe pjesa tjetër e infrastrukturës e paraparë në kornizë do të ketë ndikimet e veta pozitive dhe miqësore ndaj mjedisit, por vetëm nëse realizohet në harmoni me standardet e kërkuara. Nga kjo që u theksua vlerësohen të domosdoshme VNM-të e zhvillimeve të lartpërmendura.

Në aspektin **fiziko hapësinor**, korniza vlerësohet të ketë identifikuar dhe përkufizuar korridoret dhe linjat për këto zhvillime të infrastrukturës dhe është parashikuar mbrojtja e hapësirave. Prandaj për këto zhvillime vlerësohet lartë edhe analiza e bërë dhe e prezantuar edhe në kornizë e raporteve hapësinore por edhe fizike të zhvillimeve dhe sinergjive të mundshme të kësaj fushe.

Në fushën e zhvillimit **Shfrytëzimit të tokës dhe mjedisit** në kornizën e zhvillimit hapësinorë shihet qartë se, janë parashikuar të gjitha zhvillimet që shkojnë në drejtim të sigurimit të ajrit të pastër, ujit, tokës, biodiversitetit, menaxhimit të mbeturinave në funksion edhe të pengimit të ndotjes, shfrytëzimit të tokës dhe kontekstit urban – rural, trashëgimisë natyrore, peizazheve, fatkeqësitë natyrore dhe të tjera.

**Vlerësim 8:** Ndikimi i kornizës së zhvillimit të kësaj fushe në aspektin ekonomik vlerësohet të ketë ndikim direkt dhe indirekt , prandaj vlerësohet lartë shtrirja e konceptit në kornizë për të lëvizur nga kultura e reagimit në kulturën e parandalimit dhe amortizimit të fatkeqësive, që vlerësohet të jetë një përpjekje serioze për të mbrojtur jetët e njerëzve si dhe pasuritë dhe ekonomitë e tyre. Për të arritur këtë standard sigurie është i nevojshëm një angazhim cilësor dhe sasi i fuqisë punëtore, që prapë reflekton në treguesit ekonomik, ruajtja e baraspeshës urbane –

rurale dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i tokës reflekton fuqishëm në zhvillimin ekonomik, po ashtu edhe ruajta e trashëgimisë natyrore dhe peizazheve si dhe shfrytëzimi i tyre për aktivitete rekreative turistike do të ketë refleksione edhe aktivitete të kësaj fushe. E tërë kjo mund vlerësohet se, janë në funksion të zbatimit të politikave ekonomike.

Në aspektin **social** vlerësohet se, me këtë kornizë është analizuar dhe trajtuar më së shumti dimensionin i sigurisë fizike të popullatës në funksion të dimensionit social por edhe siguri i ajrit, ujit dhe tokës së pastër si kushte elementare për një cilësi jete dhe vërtet duket se, korniza e shfrytëzimit të tokës dhe mjedisit do të ndikojë në krijimin e bazave për zhvillim më të rehatshëm social dhe mirëqenie sociale, duke përfshirë zgjerimin e shërbimeve dhe të cilësisë me peizazhe dhe trashëgimi natyrore. S'ka dilema se këto veprime plotësojnë edhe një dimension të një kënaqësie më të madhe qytetare në aspektin **mjedisor**. **Shih për këto që u theksuan** vlerësohet se, zhvillimet e parapara në kornizën e shfrytëzimit të tokës dhe mjedisit do të krijojë bazat kryesore që ndikimi i ndotjeve të ajrit, ujit, tokës të jetë minimal dhe çdo herë në diagramin e rritjes së cilësisë, menaxhimi i mbeturinave të jetë cilësorë dhe të gjithë ndotësit dhe rreziqet të jenë nën masat e parandalimit, amortizimit dhe minimizimit. Pra, edhe vetë fusha është miqësore por vlerësohet se njeriu si faktor duhet të kufizohet në kuptimin e veprimeve negative, sepse analizat tregojnë se ndikimi i njeriut në prishje të baraspeshave ka qenë i madh dhe posaçërisht vlerësohet korniza për aspektet e parapara parandaluese dhe ndëshkimore .

Në aspektin **fiziko hapësinor** korniza vlerësohet të ketë identifikuar dhe përkufizuar të gjitha zonat dhe zhvillimet aktuale dhe të pritura, prandaj ka parashikuar masat për mbrojtje ,trajtim dhe kujdes për në funksion të sigurisë, cilësisë. Konsiderohet se në këtë fushë duhen masa strikte të dimensionit fizik dhe hapësinor të zhvillimeve, ku vlerësohet se raportet hapësinore por edhe fizike të zhvillimeve janë determinues i qëndrueshmërisë së kësaj fushe, andaj vlerësohet lartë se këto raporte janë analizuar mirë në këtë fushë.

## **4.0. STRATEGJITË DHE VEPRIMET PËR ZBATIM**

Kjo pjesë ofron kalimin në mes të gjendjes ekzistuese dhe kornizës hapësinore. Ajo

formulon pakon e strategjive dhe veprimeve për realizimin e qëllimeve brenda kornizës hapësinore, afatit të caktuar dhe gjendjes ekzistuese. Kjo pjesë duhet të përmbajë:

### **4.1. STRATEGJITË PËR ZBATIM DHE PLANET E VEPRIMIT TË SHOQËRUARA ME KONCEPTET HAPËSINORE OSE PARIMET; ZHV EKO, INF , DEM Ç SOC , MJEDISI**

#### **4.1.1. BUJQËSIA**

**Duke** u bazuar ne faktin se 80% qytetarëve te komunes se Kamenicës jeton jasht qytetit ,besojmë se fusha me prioritet per komunen duhet te jetë bujqësia.

Si prioritet per komunen,pra bujqësia andaj duhet te ndermarim aktivitete konkrete ne mënyrë qe te arrihet ky objektiv.

**Strategjia 1: Sa më shumë sipërfaqe e tokës bujqësore (mbrojtja dhe zhvillimi) në funksion të zhvillimit ekonomik**

- Pas aprovimit të këtij dokumenti, Drejtorja e Bujqësisë për vitet e ardhshme do te hartojë planin e punës në harmoni me kufijtë e tokës bujqësore të përcaktuara me këtë Plan
- Bazuar në hartat e mbrojtjes nga erozioni dhe ne bazë të bonitetit të tokave me qëllim të shfrytëzimit të tokës bujqësore në mënyrë efikase/adekuate dhe racionale, Drejtorja e Bujqësisë bazuar edhe në hartën” Bujqësia në Zhvillimin ekonomik” do orientojë zhvillimin e bujqësisë duke preferuar zhvillimet që do janë më rentabile sidomos për perimtari,pemëtari dhe drithëra me theks të veçantë në kulturat intensive dhe duke e përpunuar këtë hartë në nivelin e kadastrën bujqësor
- Rehabilitimi i tokës së degraduar bujqësore nga vërshimet, shfrytëzimi i pa kontrolluar i zhavorrit ,erozioni dhe rrëshqitjet si dhe rikultivimi i deponive të dikurshme legale apo ilegale , mundëson rritjen e siperfaqeve bujqësore. Duhet te bëhet konsolidimi i zonave me tokë të cilësisë së lartë bujqësore. Te gjitha keto ndryshime duhet te regjistrohen ne regjistrat katastral e qe kjo do të jetë instrument për mbrojtjen e tokës bujqësore.
- Zhvillimi i bujqësisë organike
- Ndërtimi i sistemit të ujitjes, ngritja e pendëve: në lumin e Desivojcës,Gjyrishecit dhe të Kremenatës te cilat mund përdoren për pje dhe ujitje, parandalimi i përmytjeve, si dhe shfrytëzimi i hapësirave për akumulime të vogla të ujit të cilat do të kontribuojnë në radhë të parë në mikroklima e rajoneve përkatëse (te ceken lokalitetet)

- Bashkimi i parcelave te prodhuesit individual qoftë në formë partneriteti qoftë me faza të reja komasacioni (masa e komasacionit i cili ka pasur për qëllim rregullimin e tokës bujqësore në kuadër të masave efektive për rregullimin e sipërfaqes bujqësore. Kjo masë është planifikuar të realizohet në dy faza.
- Lirimi i tokes bujqësore nga mbeturinat e automjeteve
- Fuqizimi i Drejtorisë së Bujqësisë me staf te trajnuar dhe profesional sidhe teknologji si dhe përdorimi i sistemeve të reja informative për bujqësi. Trajnimin e fermerëve për përdorimin e tyre është aktivitet i rëndësishëm për zbatimin e këtij plani.
- Duhet punohet në projekte me iniciativa të përbashkëta me sektorin privat dhe donatorët në rritjen e sipërfaqeve bujqësore dhe punimi i tyre (hapja e sipërfaqeve të tokës që janë të mbuluara me shkurre, shpyllëzimi i sipërfaqeve me pyje te ulëta, rrafshinat dhe bregoret e mundshme,pastrimi nga mbeturinat dhe kultivimi i brigjeve te lumenjëve)
- Ngritja e fidanishteve dhe pemishteve (molla, dardha, kumbulla etj.) dhe frutave të imët (mjedra, lajthi, dredhëza etj.)
- Zgjerimi i kapaciteteve të serave për kultivimin e perimeve (perime gjate tërë vitit), dhe kultivimin e luleve
- Me qëllim të sigurimit të makinave dhe teknologjisë së nevojshme bujqësore, mund të mendohet në krijimin e parkut të makinave ashtu që fermerëve të ju mundësohet një sistem i huazimit dhe shmangies së shpenzimeve te panevojshme për makinat të cilat mund të shfrytëzohen bashkërisht.

## **Strategjia 2: Blegtoria**

- Shtimi i fondit blegtoral, si dhe përmirësimi i racave të kafshëve me raca me potencial të lartë të prodhimit sidomos për mish dhe qumësht
- Blegtoria - Institucionet komunale dhe sektori privat duhet kontribuojnë edhe në ngritjen e fermave bagëtish për të cilën gjë ekzistojnë kushte ,komuna e Kamenicës ka kushte për ndërtimin e së paku disa fermave me te mdha , lopësh mjelëse, si dhe të një numri të madh të minifermave bagëtish dhe ndërtimin e tërësore se bimëve që përmbajnë kokrra të ushqimit të përzier kafshësh
- Duhet punohet në ofrimin e kushteve që prodhimi i qumështit dhe i mishit të kenë vendin e duhur në pikat e parapara me plan,në kuadrin e zhvillimit të blegtorisë, rritja e gjedhëve dhe e dhenve duhet të ketë vendin kryesor, numri i krerëve të kondicionuara duhet të rritet disa here.
- Duhet te investohet ne frigorifer per ruajtjen e qumshtit dhe produkteve te tij,si dhe për ruajtjen e mishit dhe produkteve te tij.

### **Strategjia 3: Pyjet dhe kullosat**

- Komuna duhet së bashku me Agjensionin e Pyjeve të fillojnë projektet në zonat e parapara me Plan për pyllëzim,ripyllëzim,kalim nga shkurret në pyje të rregullta dhe mirëmbajtje, meliorimi.
- Komuna në bashkëpunim me organet tjera kompetente duhet hartojë projektet për rrugët e pyjeve dhe të filloj zbatimin e tyre
- Komuna duhet marrë të gjitha masat për energjitë alternative ashtu që të ruhet masa pyjore
- Komuna duhet ti ofroj pastrimin e pyjeve industrive që mund ti shfrytëzojnë mbetjet për produkte që përdoren për nxehje
- Menaxhimi i kullotave është një halkë e rëndësishme në zinxhirin e prodhimit të ushqimit pasi me këtë plan kemi prezantua vendndodhjen dhe përkufizimin e kullotave Drejtoria e Bujqësisë do hartojë një plan propozim për menaxhim të kullotave me të cilin plan do të bëhet menaxhimi i drejtë i tyre.
- Bimësia e kullotave ekzistuese përmirësohet më bimë me vlera më të larta ushqimore për blegtorinë. Përcaktohen bashkëshoqërimet më të përshtatshme për kullotat

### **Strategjia 4: Rritja dhe Fuqizimi i Zonave Zhvillimore të bujqësisë**

- Këto zona do fillojnë të trajtohen si zona për zhvillimin intensiv dhe të larmishëm bujqësor dhe do fasilitohet procesi i përkrahjes institucionale për këto zona
- Zona brenda kufijve të përcaktuar do shfrytëzohet vetëm për bujqësi dhe veprimtari në funksion të zhvillimit bujqësorë
- Komuna do të stimuloj grumbullimin e parcelave dhe fermerëve në organizime më domethanë për zhvillime bujqësore,në kuptimin e bashkimit të sipërfaqeve dhe organizimit në kultivime të përbashkëta në forma vullnetare organizimet e tilla dhe zonat e tilla do trajtohen me statusin e zonës zhvillimore për bujqësi,këto zona mund të udhëhiqen nga bordi i pronarëve privat sipas marrëveshjes së tyre ose organizohen në kooperativa private bujqësore.

### **Strategjia 5: komuna të lehtësoj, kurse sektori privat të siguroj bazën për Industrinë Ushqimore**

- Komuna për realizimin e qëllimit të prodhimit ushqimorë për vete dhe për eksport duhet analizuar dhe prezantuar me këtë plan duhet inicioj dhe fasilitoj Projekte për stimulim,mbrojtje dhe fuqizim të Mullinjve si dhe ndërtimin e silosave në komunën e Kamenicës me përkrahje për modernizimin e teknologjive
- Duhet përkrahur zhvillimet për ngritje të kapaciteteve për deponim të drithërave dhe ngrisë kapacitete për nënprodukte të millit, iniciojë projekte për modernizim dhe zgjerim,por edhe zhvillim harmonik të industrisë ushqimore,e cila do të përvetësoj finalizimin e prodhimit bujqësorë në një shkallë të lartë

- Ngritja e kapaciteteve për deponim, përpunim dhe konservim të frutave në hapësirat e parapara në plan .
- Inicimi dhe përkrahja e projekteve me qëllim për ngritjen e kapaciteteve përpunuese për qumësht, djathë mish , frigoriferëve dhe thertoresh së paraparë me plan për të cilat duhet bërë përpjekje që sa më parë të gjendet mundësia për realizimin e këtyre kapaciteteve përpunuese me stimulim kryesisht të sektorit privatë dhe investimeve të jashtme.
- Kultivimi, Ruajtja e bimëve mjekuese dhe krijimi i hapësirave tharëse për këto bimë
- Vendosja e sa ma shumë industrive ushqimore në zonën e definuar për industri duke reflektuar vizionin e Komunes se Kamenicës për bujqësinë si sektor kryesor zhvillimor duke krijuar mundësi për përpunimin e ushqimit dhe tregtimin e produkteve lokale përmes panaireve dhe ngjarjeve ne nivel regjional.
- Komuna duhet ofruar kushte sektorit privat për zhvillimin ma intensiv dhe cilësor të industrisë së lëngjeve
- Komuna duhet luaj rolin e fasilituesit në procesin e sigurimit të shenjës CE nga ndonjë agjension i akredituar Evropian dhe fasilitoj daljen në treg Evropian
- Krijimi i një platforme të internetit për promovimin prodhimeve dhe sigurim i internetit për të gjitha bizneset sidomos në zonën Industriale.
- Identifikimi i pjesëmarrësve të mundshëm për procedimin dhe përpunimin e prodhimit bujqësor. Krijimi i një sistemi të bashkëpunimit për procedimin dhe përpunimin e ushqimit në mënyrë që të ndahet investimi për teknologjinë e nevojshme si dhe tregtimin e prodhimeve. Pjesëmarrësit e mundshëm në këtë bashkëpunim do të shfrytëzojnë bashkërisht pajisjet dhe teknologjinë e përbashkët si dhe administratën dhe marketingun.

### **Strategjia 6: Zgjerimi dhe avancimi i njohurive dhe praktikave në fushën e Bujqësisë**

- Hapja e shkollës së mesme bujqësore në hapësirat e parapara me plan
- Krijimi i kushteve për hapjen degës së Bujqësisë në shkollimin superior nga institucionet publike ose private ne regjion.
- Themelimi i qendrës për trajnim dhe aftësim të vazhdueshem në fushën e Bujqësisë dhe marketingut, qendra do të funksionoj edhe për si qendër informimi për zhvillimin bujqësor si dhe produktet dhe teknologjitë e reja me qëllim të rritjes së kapacitetit të njohurive për produkte bujqësore më cilësore, do të organizoj edhe ekskursioneve dhe vizitave në terren në regjionet ku mund të mësohen përvoja të dobishme, qoftë në Kosovë apo në shtete fqinje, me qëllim që bujqit të njoftohen me të arriturat më të fundit në këtë fushë.
- Laboratorë dhe hapësira eksperimentuese të fushës së bujqësisë për analiza dhe studime të avancimit të cilësisë dhe sasisë.

#### **4.1.2. INDUSTRIA**

##### **Strategjia 1: Industria të qëndrueshme**

Gjatë hartimit të planeve rregulluese (Detale) duhet funksionalizohet dhe fuqizohet infrastruktura për kapacitetet e ekzistuese industriale (tash më të privatizuar) së bashku me pronarët.

Shenjëzimi nga hartat në terren i zonave (vendburimeve) të xeheve minerale (hekuri, Fe) magnezitet granitet e kaolinizuara, mermerët, granitet, rërat e zhavorret, andezitet, feldshpatet, bentonitet, deltina, tufi, kuarci etj.

Kryerja e studimeve të arsyeshmërisë në këto zona.

Për të zbatuar zhvillimin e dëshiruar të industrisë duhet hulumtuar kompani që nxjerrin dhe përpunojnë xehet e njëjta nëpër botë dhe duhet kërkuar forma të ndryshme të bashkëpunimit, si partneritete publiko private, koncesione e forma tjera të punës dhe të mjeteve, të harmonizimit të programeve të zhvillimit dhe të planeve.

Hartimi i projekteve kryesore për eksploatimin dhe ndërtimin e kapaciteteve për përpunimin e (hekuri, Fe), magnezitet, granitet e kaolinizuara, mermerët, granitet, rërat e zhavorret, andezitet, feldshpatet, bentonitet, deltina, tufi, kuarci etj.

Hartimi i projekteve për përkrahje dhe fuqizim, por edhe krijim të zhvillimeve të reja në industrinë e përpunimit të metaleve, drurit, plastikës, ushqimore, të pijeve, tekstilit, duhanit etj. të gjitha në funksion të realizimit të parashikimeve (shihe hartën e industrisë dhe pasurive natyrale).

Hartimi i planit rregullues (detaje) për zonën industriale me infrastrukturë të planifikuar përkatëse dhe kyçje në rrjetin regjional rrugor e në të ardhmen edhe në hekurudhë dhe auto-udhë.

#### **4.1.3. NDËRTIMTARIA**

##### **Strategjia 1: Ndërtimtari të qëndrueshme**

Hartimi i planeve rregulluese detaje (të hollësishme) dhe projekteve ideore e kryesore për t'i vendosur në zonën industriale dhe në periferi të disa vendbanimeve, depot, hapësirat për separimin e zhavorrit dhe të materialeve të tjera, për prodhimin e masës së betonit e të para-fabrikateve nga betoni, për vendosjen e punën e bazave të makinave dhe të ofiçinave të riparimit, për punë të reparteve të ndryshme (muratorësh, armiruesish, mekanikësh, drugdhendësish, elektrikistësh, punimesh përfundimtare, etj.), për parkimin e makinave, magazina dhe repartet tjera si dhe shërbime.

Gjatë hartimit të planeve rregulluese detaje aplikimi i zonave për zyra kompanishë dhe byro projektuese. Këtu duhet pasur parasysh se disa hapësira që mund të përdoren, përkohësisht për punë të ndërtimtarisë.



#### 4.1.4. ZEJTARIA

##### **Strategjia 1: Zejtari të qëndrueshme**

Gjatë hartimit të planeve rregulluese (detaje), duhet bërë caktimi i zonave për zejtari dhe plotësimi i infrastrukturës.

Hartimi i projektit ideor dhe kryesor i një qendre zejtare në qytetin e Kamenicës dhe plotësimi i infrastrukturës.

Krijimi i infrastrukturës fizike dhe profesionale për shkollimin profesional në zejtari.

Këshillimin në dobi të zejtarisë, rritjen e aftësive të sipërmarrësve, trajnimin dhe kualifikimin profesional të artizanëve.

Përcaktimi i hapësirës për një zyre të veçantë për zejtari në Komunë.

Përcaktimi i hapësirës për një zyre të shoqatës së zejtarëve.

#### 4.1.5. TREGTIA

##### **Strategjia 1: Tregti të qëndrueshme**

Gjatë hartimit të planeve rregulluese (detaje) dhe kushteve për zhvillim, alokimi i përmbajtjeve për **tregti me pakicë** në qytet dhe në të gjitha vendbanimet e komunës së Kamenicës .

Hartimi i projekteve për fuqizim të **tregjeve të hapura** në qytetin e Kamenicës & Rogagicës.

Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore për **tregjet e hapura ditore** publike dhe private në Komunën e Kamenicës

Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore për **zgjerimin e tregjeve** të hapura një ditore edhe në disa vendbanime të mëdha.

Hartimi i projektit ideor dhe kryesor, për së paku një treg të gjelbër në baza të përditshme publik ose privat në qytet.

Hartimi i projekteve për fuqizimin e prodhuesve vendës.

Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore për tregje dhe sallone të automjeteve.

Hartimi i projekteve për organizim më të mirë të transportit dhe infrastrukturës përcjellëse.

#### 4.1.6. TURIZMI

**Strategjia 1: Promovimi i Komunës së Kamenicës si mundësi e mirë zhvillimit të sportit në përgjithësi e në veçanti sportit rekreativ dhe shëndetësor, turizmit rinor.**

**\*Promovimi i vlerave Evropiane;**

**\*Promovimi i besimeve të ndryshme, islame, ortodokse, bektashiane;**

**\*Promovimi i perdorimit të lirë të gjuhës;**

**\*Promovimi i lëvizjes së lirë në gjithë territorin e Komunës së Kamenicës;**

**\*Promovimi i traditave të etnive që jetojnë në Kamenicë;**

**\*Promovimi i kuzhinës tradicionale, shqiptare, serbë dhe romë;**

**\*Kerkesa institucionale për hapjen e kalimit kufitar mes Kamenicës dhe Komunës së Medvegjes, gjë që do të rrisë qarkullimin e njerëzve në drejtim të Banjës së Sijarinës, që rritë edhe qarkullimin e lirë të mallit dhe kapitalit.**

**\*Promovimi i trashëgimisë kulturore dhe historike**

**\*Themelimi i zyrës për promovimin e turizmit**

Gjatë hartimit të planeve rregulluese (detaje) duhet të planifikohet infrastruktura për këtë lloj turizmi në të gjithë territorin e komunës dhe menjëherë të fillojë kompletimi i infrastrukturës me masa stimuluese, (hapësira për takime, punë, konferenca ,hotele etj.).

Krijimi i një sistemi të përgjithshëm informativ turistik (hartat, fletëpalosjet, web faqja...) . Ndërtimi i zyrës së kontaktit dhe një bordi për turizëm që do ta promovonte atraksionin turistik brenda Komunës së Kamenicës. Kjo qendër po ashtu do të duhej të zhvillonte programe të vizitave dhe aktiviteteve rekreative në pika të ndryshme atraktive.

Ngritja e kapaciteteve të njohurive për turizmin përmes aktiviteteve të ndryshme, duke shfrytëzuar përvoja pozitive.

Hulumtime dhe studimeve të fuqizimit të potencialeve ekzistuese dhe të planifikuara për aktivitete turistike.

Krijimi i raporteve të mira të bashkëpunimit me zyrën regjionale për zhvillimin e turizmit si dhe me agjenci të huaja që mbështesin zhvillimin e turizmit.

Vlerësim: Zhvillimi i turizmit në Komunë ka një potencial të madh. Për zhvillimin e tij në mënyrë të qëndrueshme, është i nevojshëm një organizim i mirë në vetë qytetin e Kamenicës. Për këtë duhet punuar në krijimin e një sistemi informativ turistik, krijimin e kapaciteteve dhe përgatitje të projekteve detaje për zonat e parapara turistike komunale, ku do të jenë nën menaxhimin e një bordi lokal turistik.

### **Strategjia 2 :Trashëgimia**

Identifikimi, incizimi, përkufizimi, mbrojtja dhe zhvillimi i lokaliteteve arkeologjike vazhdon të mbetet sfida e madhe e trashëgimisë.

- Mbrojtja , konservimi, rivitalizimi dhe rikonstruktimi i strukturave dhe hapësirave kulturo historike(kështjellat, kalatë që ndodhen në komunën e Kamenicës, kishat ilire-dardane) dhe objekte tjera te kultit.
- Mbrojtja nga shkatërrimi i vlerave të trashëgimisë etnografike
- Krijimi i një identiteti të Komunës së Kamenicës
- Paisja me infrastrukturë në hapësirat arkeologjike kulturo – historike, duke marrë parasysh shfrytëzimin e këtyre vlerave dhe mbrojtjen e tyre për brezat e ardhshëm, është prapë një sfida.
- Rritja e vetëdijes për vlerat që ka Komuna e Kamenicës, si dhe futja nën mbrojtje e vlerave trashëgimore në nivel komunal dhe qendror.
- Gjenerimi i mjeteve nga vlerat e trashëgimisë është sfida e cila duhet trajtohet dhe planifikohet në detaje në të ardhmen.
- Ndërtimi i objektit muze te trashëgimisë kulturore, natyrore historike, arkeologjike dhe etnografike.

**Strategjia 3 : Promovimi i kështjellave dhe kullave në Komunën e Kamenicës Kulina –Kamenicë, Kopra-Kopërnice dhe Gjyteti-Gjyrishec etj.**

**\*Promovimi i së paku tri kështjellave në Komunën e Kamenicës**

**\*Hartimi i broshurave informative për popullatën lokale**

**\*Vendosja nën mbrojtje të komunës të këtyre objekteve dhe zonave rreth tyre**

**\*Vendosja nën mbrojtje ligjore të çdo objekti që është i rëndësishëm veçantë**

**\*Hartimi i planeve për restaurimin e tyre**

**\*Hulumtimi dhe sigurimi i mjeteve për restaurim, rindërtim, renovim, eksplorim, konservim.**

**\*shenjzimi me shenja të informacionit vendndodhja e tyre**

**\*rregullimi i infrastrukturës së nevojshme për ta lehtësuar qasjen në lokacion dhe rreth objekteve**

**\*Shfrytëzimi i tyre për nevojat e turizmit, promovim të traditës autoktone dhe vlerave historike për vizitorë dhe gjenerata të ardhshme.**

**Strategjia 4 :**

**\*Identifikimi dhe zonimi i zonave turistike**

**\*Hartimi i projekteve për zonat e turizmit: rekreativo-sportiv.**

**\* Hartimi i projekteve për turizëm shëndetësor**

**\* Hartimi i projekteve dhe caktimi i zonave për turizëm natyror**

**\* Hartimi i projekteve për caktimin e ndonjë fshati (lagjeje)**

turistik ku shtëpitë do të ruhen në formën që janë

**\*Hartimi i projekteve për shenjzimin e rrugëve malore,**

shtigjeve për ecje, për biçiklizëm, motokros, alpinizëm etj.

**\*Caktimi i zonave për kamping të kategorive të ndryshme të**

shoqërisë

**Strategjia 5 : Promovimi i vendbanimeve , për turizëm rural dhe ushqim tradicional**

**\*Caktimi i vendbanimeve**

**\* Krijimi i ofertave lokale vetanake**

**\* Krijimi i ofertave të ushqimit tradicional**

**Strategjia 6 : Promovimi i trashëgimisë arkeologjike për zhvillimin e turizmit**

**\* Identifikimi i zonave arkeologjike**

**\*identifikimi i vlerave arkeologjike**

**\* identifikimi i objekteve me vlerë arkeologjike**

### **Strategjia 7 : Krijimi i infrastrukturës turistike**

Komuna duhet ta iniciojë ndërtimin e infrastrukturës bazike turistike, duke përfshirë infrastrukturën e transportit, telekomunikimit, akomodimit dhe varësisht nga zona infrastrukturën specifike relevante për zonën ku mund të përfshihen edhe shtigjet për bjeshkatori, ecje apo kalërim, poligonin për shenjëtari si kompletimin dhe fuqizimin e infrastrukturës sidomos në zonat me vlera të shquara natyrore dhe të trashëgimisë kulturore.

Një sistem i përshtatshëm informativ për shfrytëzimin e këtij rrjeti, i përbërë prej hartave, fletëpalosjeve dhe mjeteve tjera informuese do të duhej ta përkrahte zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit në varshmëri nga resurset e ndryshme. Një web faqe për resurset dhe mundësitë turistike të Kamenicës në trajtë të ofertës do të mund të ndihmonte në tërheqjen e interesit për investime në zhvillimin e turizmit. Identifikimi dhe futja në mbrojtje e të gjitha zonave të rëndësishme të veçantë.

Bordi i turizmit do të krijojë qendrat informative turistike. Në fillim qendra informative turistike me seli në Kamenicë, e me vonë edhe në lokalitete varësisht nga interesimi i popullatës vendase.

Vlerësim: Një zhvillim i organizuar i turizmit duhet përkrahur me rrjet të duhur infrastrukturor. Lidhja e atraksioneve turistike me forma të ndryshme të vijave të lëvizjes transportit dhe qasja e lehtë krijojnë më tepër mundësi për vizita. Të gjitha lidhjet duhet të jenë të koordinuara përmes qendrës informative turistike.

### **Strategjia 8 : Mbrojtja e natyrës dhe mjedisit**

Promovimi i natyrës dhe mjedisit duhet të shfrytëzohet si resurs për turizëm. Pasi që në plan janë siguruar dhe prezantuar të gjitha të dhënat e nevojshme për lokacionet e monumenteve të mbrojtura të natyrës (bimë, gjeomamente, ujë) dhe zonave të mbrojtura natyrore. Aktiviteti i parë në këtë strategji është shenjëzimi dhe futja në mbrojtje të gjitha zonave me vlerë të veçantë natyrore.

Sigurimi i pajisjeve dhe shërbimeve të nevojshme për mbajtjen e zonave të pastra dhe të sigurt. Shfrytëzimi i zonave të mbrojtura natyrore dhe peizazheve të vlefshme në mënyrë të qëndrueshme duke u kompletuar me përmbajtje që e bëjnë të shfrytëzueshme si zona turistike, si dhe të trajtohet popullata ashtu që turizmin ta vlerësojë si aktivitet ekonomik dhe mundësi të mirë për përfitime dhe punësim. Të zvogëlohen ndikimet nga ndotja e ambientit dhe të mbrohen vlerat e këtyre zonave.

Vlerësim: Rritja e interesit për turizmin natyror është një mundësi për natyrën e shumëllojshme të Kamenicës. Andaj komuna duhet të interesohet për mënyrat e transportit që furnizojnë këto zona. Mbrojtja e natyrës së pastër dhe të sigurt mund të kontribuojë në rritjen e interesit të turistëve.

### **Strategjia 9 : Turizmi i gjuetisë**

**Duhet te kemi parasysh se në komunën tonë jeton një numer i konsiderueshëm i kafshëve te egra, që jep një mundsi të atraksioneve të ndryshme turistike përmes gjuetisë. Gjithashtu, duhet të vetëdijsohen edhe gjuetarët se gjuetia nuk duhet të shfrytëzohet vetëm për gjuajtje te kafshëve por edhe për kultivimin e tyre. Gjuetia duhet të menaxhohet mirë. Të përgatitet plani vjetor i të gjitha ngjarjeve lidhur me gjuetinë.**

Shoqata e gjuetarëve ose kompania e përzgjedhur do të jetë përgjegjëse për organizimin dhe kontrollimin, kultivimin, sigurinë, mbrojtjen e llojeve te kafshëve dhe shpezëve që janë në zhdukje. Pra krijimin e të gjitha kushteve për mbrojtjen e florës dhe faunës. Organet kompetente nga ministria dhe komuna do të jenë përgjegjëse për zhvillimin e turizmit të gjuetisë.

Në të gjitha zonat e përcaktuara për gjueti me këtë plan, do të ketë një plan menaxhues, duke përfshirë edhe zona të mbrojtura dhe rezervatet (rezervate në lokacionet Kranidell, Tërstenë) .

Ky plan duhet të përcaktojë të gjithë aktorët përgjegjës për menaxhim dhe masat e nevojshme për kultivimin e shtazëve si dhe ato të sigurisë.

Komuna në bashkëpunim të afërt me shoqatën e gjuetarëve dhe kompaninë menaxhuese duhet të aplikojë të gjitha masat për mbrojtjen e biodiversitetit të zonave të përcaktuara për gjueti.

Vlerësim: Vetëm aktivitetet e organizuara rekreative të gjuetisë mund të ofrojnë turizëm tërheqës dhe të sigurt të gjuetisë. Andaj komuna duhet të promovojë planin menaxhues për zonat e përcaktuara për gjueti.

### **Strategjia 10 : Promovimi i turizmit shëndetësor**

**Lartësia mbidetare dhe diversiteti bimor japin një mundësi të shkëlqyeshme për zhvillimin e turizmit shëndetësor.**

**\*Hartimi i broshurave për mundësitë shëruese dhe rehabilituese te Komunës se Kamenicës e në veçanti te disa vendbanimeve**

**\*Caktimi i zonave**

**\* Hartimi i projekteve dhe njoftimi i donatorëve**

**\*Te identifikohen terrenet për ecje**

**\* Pasuritë e komunës mund të shfrytëzohen në aspektin e turizmit shërues për disa sëmundje, si zemra, mushkритë, rehabilitim nga lëndime të ndryshme e tjera**

**Hartimi i projekteve te përbashkëta regjionale dhe ndërkufitare.**

**Vlerësim:** Jeta shumë dinamike në Kosovë, traumat e pasluftës, papunësia e madhe, janë elemente që shoqërojnë shumicën e qytetarëve të Kosovës, andaj komuna duhet te shikojë mundësi për rehabilitim dhe trajtim adekuat të personave. Turizmi shëndetësor është një nga bazat e turizmit. Me zhvillimin e vendit, gjithnjë e më tepër njerëz kanë nevojë për shërim në natyrë. Andaj turizmi shëndetësor në zonat e Komunës së Kamenicës, duhet të konsiderohet si potencial i madh edhe turistik.

#### 4.1.7. **HOTELERIA**

Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore sipas planit të zonave turistike për ndërtimin me një standard dhe cilësi të lartë e objekteve hoteliere, objektet për vendosje (bujtina) dhe objektet për ushqim dhe pije edhe atë sipas këtyre kategorive:

Hotelet: hoteli, fshat turistik, apartament-motele, fshat apartamentesh, moteli, pensioni, etj. Kampet dhe llojet e tjera të objekteve hoteliere për vendosje si : kampi, dhomat me qira, apartamentet, hoteli, kamping për rininë, shtëpia e alpinistëve, pushimorja, bujtina, etj. Restorantet : restoranti, taverna, restoranti nacional, restorant qumështi, kafeneja ,piceria, qebaptoja, kuzhina popullore, byrektorja, etj. Kantinat dhe përgatitja e racioneve ushqimore.

#### 4.1.8. **TRANSPORTI, TELEKOMUNIKIMI, BARTJA DHE LËVIZSHMËRIA**

Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore për shfrytëzimin masave teknologjike dhe jo teknologjike dhe krijimin e një sistemi të **transportit të qëndrueshëm dhe inteligjent**.

Hartimi i projekteve për përmirësimin e qasjes në sistemin e transportit

Hartimi i projekteve për ngritjen e sigurisë në trafik.

Hartimi i projekteve për reduktim të ndikimeve negative të trafikut në mjedis.

##### **Komunikacioni automobilistik**

Hartimi i projekteve për përmirësimin e cilësisë si dhe shpërndarja e rrjetit rrugor në funksion të rritjes së shpejtësisë së lëvizjes së udhëtarëve dhe të mallit.

Kapacitetet ekzistuese duhet modernizohen dhe në vazhdimësi duhet t'u përgjigjen nevojave dhe standardeve.

Hartimi i projekteve për modernizimi, fuqizim dhe kompletim të rrjetit rrugor ekzistues dhe hapjen e vijave të reja, si dhe plotësimi me infrastrukturën e tjera të komunikacionit (serviset për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve, garazhet, stacionet e autobusëve, pompat e benzinës, ndërtesa për vendosjen e shërbimeve të caktuara etj.).

##### **Trafiku urban**

Hartimi i projekteve për qarkullim më të madh dhe më cilësor të udhëtarëve brenda qytetit, vendbanimeve dhe drejtë qendrave tjera komunale.

Hartimi i projekteve për ngritjen e numrit të inkuadruarve në trafikun urban.

#### 4.1.9. **Komunikacioni telekomunikimit, PTK-së dhe operatorëve privat**

Hartimi i projekteve kryesore ashtu që numri i aparateve telefonike dhe i aparateve të tjera si dhe vëllimi i shërbimeve të internetit dhe kabllorëve të rritet shume, kurse shërbimet e PTK-së dhe operatorëve tjerë privat të modernizohen siç është paraparë me kornizën zhvillimore;

Hartimi i projekteve për vendosjen e antenave të reja PTK-VALA

Hartimi i projekteve për vendosjen e rrjetit të ri në vendbanimet ku rrjeti ekzistues është i viteve 90-ta;

-Hartimi i projekteve për ndërtimin e objekteve postare në vendbanimet

-Hartimi i projekteve për përmirësimin e rrjetit kabllor dhe programeve televizive në HD ;

-Hartimi i projekteve për ngritje të kapaciteteve dhe edukim të shfrytëzuesit potencial për shfrytëzimin e industrisë për përfitime njerëzore;

-Hartimi i kornizës legale për e-Commerce dhe e-nënshkrimi deri te E-qeverisja.

#### 4.1.10. **ENERGJIA**

**Strategjia 1:** Modernizimi dhe kompletimi i infrastrukturës energjetike

Zhvillimi dhe kompletimi i infrastrukturës energjetike në fushën e infrastrukturës në funksion të zhvillimit ekonomik.

**Strategjia 2: Identifikimi dhe shfrytëzimi i potencialeve për energji ripërtritëse**

Zhvillimi i studimeve të fizibilitetit për potencialet për hidro-energji nga penda e mundshme. Hartimi i projektit ideor dhe atij kryesor për hidro-energji.

Në kooperim me qeverinë negocimi për zbatimin e projektit për hidro-energji (me koncesion ose forma tjera) .

Zhvillimi i studimeve të fizibilitetit për prodhimi të energjisë për ngrohjen e qytetit të Kamenicës nga biomasa (prodhimtaria bujqësore).

Hartimi i projektit ideor dhe kryesor për prodhimi të energjisë për ngrohjen e qytetit të Kamenicës nga biomasa (prodhimtaria bujqësore) te hapësira e paraparë me plan urban. Në kooperim me qeverinë negocimi për zbatimin e projektit për ngrohjen e qytetit të Kamenicës nga biomasa (me koncesion ose forma tjera).

Konsiderimi i ashklave dhe mbetjeve të drurit për prodhimin e briketit për ngrohje.

Studime fizibiliteti dhe projekte ideore për mundësin e shfrytëzimit të energjisë diellore për energji termike, si dhe përfitimi i energjisë elektrike përmes paneleve fotovoltike (si qëllim afatgjatë).

Projekte stimuluese për ata që ndërtojnë objekte dhe shfrytëzojnë energjinë solare për ngrohje me lirime në përqindje nga taksat dhe pagesat për leje ndërtimi.

Studime fizibiliteti dhe projekte ideore për mundësin prodhimit të energjisë nga mbeturinat.

Zbatimi i pilot projekteve për mundësinë e kursimit të energjisë (p.sh. termoizolimi , sistemet efikase të ngrohjes etj).

#### 4.1.11. **SISTEMI BANKAR**

**Strategjia 1:** Bankat në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik

Hartimi i projekteve për kredi nga ana e bankave për ekonomitë familjare, bizneset e vogla dhe agrobizneset

Hartimi i projekteve për investimet koncesionare duke filluar me sektorin e energjisë rinovueshme (dihet shumë mirë që në BE ka direktiva shumë të qarta për energjinë e rinovueshme andej mund konsiderohet si një shans i madh për komunën.

Hartimi i projekteve duke marrë konsideratë mundësitë e reja me anëtarësim e Kosovës në FMN dhe Bankën Botërore ne fushat ku ata ndihmojnë (duhet hulumtohen faqet e tyre zyrtare).

Hartimi i projekteve për kreditime me interesa më të ulëta edhe me paketa më të gjera në fushat e bujqësisë, Industrisë deri te turizmi.

#### **4.1.12. NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME**

##### **Strategjia 1: përkrahja e zhvillimit të NVM -ve**

Krijimi i qendrës trajnuese profesionale për profesionistët e rinj për ngritjen e aftësive dhe ofrimin e seminareve dhe kurse për zhvillim ekonomik dhe njohuri për marketingun.

Përkrahja e ndërmarrësve të rinj përmes implementimit të “qendrës nismëtare: (inkubatorit të biznesit), ku ndërmarrjet mund të shfrytëzojnë infrastrukturën e përbashkët dhe të përfitojnë në mënyrë të ndërsjellë. Kjo qendër duhet të ofrojë:

- a. Huazimin e hapësirave për zyre dhe seminare me çmime të ulëta
- b. Qendrën e përbashkët të shitjes
- c. Këshillime mbi kontabilitetin
- d. Këshilla ligjore dhe për taksat

#### **4.1.13 STRATEGJITË DHE VEPRIMET PËR INFRASTRUKTURËN TEKNIKE**

##### **4.1.14 INFRASTRUKTURA RRUGORE**

**Strategjia 1:** Rrugët ekzistuese të asfaltuara-Përgatitja e projekteve kryesore në bashkëpunim me Ministrinë e infrastrukturës për Zgjerim në disa segmente, mirëmbajtje dhe plotësim me përmbajtje në harmoni me standardet e rrugëve ekzistuese(me prioritet segmenti Gjilan –Crep- Kamenicë, Kamenicë – Crep – Hodonoc – Hogosht , Kamenicë – Crep – Hodonoc – Karaçevë e Poshtme por edhe tjerat bazuar në hartën Infrastruktura e transportit.

**Strategjia 2:** Rrugët e pa asfaltuara - Përgatitja e projekteve kryesore nga komuna e në disa raste edhe në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës për rrugët e pa asfaltuara në harmoni me standardet dhe normat bazuar në hartën Infrastruktura e transportit

**Strategjia 3:** Rrugët të propozuara

- Shenjëzimi i traseve të këtyre rrugëve dhe ruajtja e tyre(duke pasur parasysh edhe trasenë e auto – udhës së mundur Ferizaj - Gjilan – Crep – Kamenicë e cila lidhet me autostradën Shkup-Prishtinë)
- Fillimi i projekteve ideor për këto rrugë me prioritet rruga Kamenicë – Koretin – Topanicë – Hodonoc- Rogaçicë - Muçivërc – Shipashnicë - Hogosht si dhe Kamenicë – Krilevë–Marec – Prishtinë
- fillimi i konsultimeve me përfaqësuesit e Ministrisë së Infrastrukturës për këto rrugë
- Hartimi i projekteve kryesore për këto rrugë bazuar në hartën Infrastruktura e transportit



**Strategjia 4:** Rrugët në rindërtim – vazhdimi dhe kompletimi sipas dinamikës së paraparë

Rrugët bujqësore

- Përgatitja e projekteve dhe konsultimet intensive për rrugët e pyjeve
- Vazhdimi në harmoni me zhvillimet në tokën bujqësore i projekteve të reja të rrugëve bujqësore

**Strategjia 5:** Rrugët Urbane

- Shenjëzimi (pikat gjeodezike ku shtrihet rruga) i trasave të këtyre rrugëve dhe ruajtja e tyre
- Te rrugët ekzistuese dhe të planifikuara nuk lejohet (kur lëshohen lejet) as një lloj ndërtimi që shkon në kundërshtim me funksionimin e tyre
- Fillimi i projekteve ideore për këto rrugë me prioritet në zonat e pastra (pa ndërtime brenda kufijve ndërtimor)
- fillimi i konsultimeve me përfaqësuesit e zonave por edhe informimi adekuat në Ministrinë e infrastrukturës për këto rrugë
- Hapja e këtyre rrugëve me makineri në funksion të definimit të saktë se si do të funksionojnë në të ardhmen këto rrugë, do ti ndihmonte shumë zbatimit të këtyre rrugëve
- Hartimi i projekteve kryesore për këto rrugë bazuar në hartën Infrastruktura e transportit (urban).

**Strategjia 6:** Rrugët Qarkore

- Shenjëzimi i trasave të rrugëve qarkore
- Në trasetë e rrugëve të parapara qarkore nuk lejohet as një lloj ndërtimi që shkon në kundërshtim me funksionimin e këtyre rrugëve
- Fillimi i projekteve ideore për këto rrugë
- fillimi i konsultimeve me përfaqësuesit e Ministrisë së infrastrukturës për këto rrugë
- Hartimi i projekteve kryesore për këto rrugë bazuar në hartën Infrastruktura e transportit (urban)

**Strategjia 7:** Infrastruktura përcjellëse

- Fillimi i projektit ideor për pikat ndalëse dhe stacionin e autobusëve
- Hartimi i projektit kryesore
- Thellimi i konsultimeve me përfaqësuesit e sektorit privat dhe aktorët tjerë për zbatim të projektit dhe format e zbatimit dhe menaxhimit.

#### **4.1.15 INFRASTRUKTURA HEKURUDHORE**

##### **Strategjia 1:**

- Shenjëzimi i traseve të vijave hekurudhore për versionin (me prioritet )
- Konsultime me përfaqësuesit e Ministrisë së Transportit dhe Post – Telekomit për fillimin e projektit ideor

#### **4.1.16 INFRASTRUKTURA E AKUMULIMIT DHE FURNIZIMIT ME UJË**

##### **Strategjia 1: Veprimet konkrete në renovimin e sistemit ekzistues të burimeve të ujit që momentalisht shfrytëzohen për pije dhe mbrojtjen dhe zhvillimin e burimeve të reja në funksion të furnizimit të mbarë komunës me ujë**

Hartimi i projektit për renovimin e rezervuarëve në burimet nëntoksore në Kamenicë (mbrojtja nga ujërat e ndotura gjatë reshjeve) si dhe rritja e kapacitetit nga ato që ka tani.

Shenjëzime dhe mbrojtja e hapësirave ku mund të ndërtohet penda në Kremenatë etj. Shenjëzimi dhe mbrojtja e burimeve të ujërave natyrale (shih hartën Hidrologjike të Komunës së Kamenicës).

##### **Strategjia 2. Krijimi i një sistemi funksional dhe të integruar të ujësjellësit për pije, industri dhe bujqësi në tërë territorin e komunës**

Hartimi i projektit për renovimin e rrjetit ekzistues të furnizimit me ujë në qytet – ndërrimi i gypave të vjetër të azbest çimentos në disa segmente, rritja e diametrit të gypit në disa segmente, zgjerimi i rrjetit në zonat e reja etj. (shih hartën infrastruktura e ujësjellësit urban).

Hartimi i projektit për furnizim me ujë nga një sistem që mund të jetë përmbajtësisht qendrorë, nga penda e mundshme në Kremenatë , varësisht nga rezultatet e studimit të pendës, Nga mundësit e mbulueshmërisë së planifikuar të vendbanimeve dhe sipas koncept të shtrirjes së planifikuar, kryesisht si pjesë përbërëse e vijave rrugore Hartimi i projektit për furnizim me ujë nga pusët për vendbanimet që për shkak të lartësisë më të madhe mbidetare nuk mund të furnizohen nga alternarivat e lartë përmendura me rënie të lirë dhe për shkak se sistemi i pompimit bartë një kosto shumë më të lartë.

Hartimi i projektit për furnizim me ujë për pije, ujitje dhe industri nga penda në lumin e Desivojcës.

##### **Strategjia 3. Ngritja e pendës në lumin e Desivojcës**

- Kryerja e studimit të arsyeshmërisë (fizibilitetit)
- Kryerja e projektit ideor
- Fillimi i konsultimeve dhe negociimit me sektorë e aktor të ndryshëm
- Kryerja e projektit kryesor
- Fillimi i zbatimit bashkë me të përzgjedhurit

#### **Strategjia 4. Rregullimi i regjimit të ujërave**

-Kryerja e studimit të arsyeshëmrisë së pendave në lumin e Desivojcës, Kremenatës dhe Gjyrishecit .

-Kryerja e projektit ideor

-Fillimi i konsultimeve dhe negocimit me sektorë e aktorë të ndryshëm për mundësinë e ndërtimit të këtyre pendave në funksion të rregullimit të regjimit të ujërave

-Kryerja e projektit kryesor për këto penda

-Fillimi i zbatimit bashkë me të përzgjedhurit

-Kryerja e projektit ideor për rregullimin e shtretërve të lumenjve ( rregullim me gur dhe prej dheu, rregullim urban, mirëmbajtje dhe pastrim )

-Fillimi i konsultimeve dhe negocimit me sektorë e aktorë të ndryshëm për mundësinë e fillimit të punëve në: ( rregullim me gur dhe prej dheu, rregullim urban, mirëmbajtje dhe pastrim ), ( shihe hartën “Masat për Vërshime dhe Erozion”)

-Kryerja e projektit kryesor për këto masa( rregullimi me gur dhe prej dheu, rregullim urban, mirëmbajtje dhe pastrim ), ( shihe hartën “Masat për Vërshime dhe Erozion”)

-Fillimi i zbatimit bashkë me të përzgjedhurit ( shihe hartën “Masat për Vërshime dhe Erozion”)

#### **4.1.17 SISTEMI I KANALIZIMIT DHE DEPONITË**

##### **Strategjia 1: Kompletimi i infrastrukturës së kanalizimit, përmirësimi i rrjetit ekzistues dhe ndërtimi i rrjetit të ri**

Përgatitja e projekteve për përmirësimin e rrjetit ekzistues të kanalizimit (Shihe hartën “KANALIZIMI DHE DEPONITË”)

Përgatitja e projekteve për ndërtimin e rrjetit të ri të kanalizimit në zonat ku ai mungon (me prioritet në vendbanimet ku kemi gjysmë sistem në fshatrat e komunës)

Vendosja e gropave septike në pikat e derdhjes së ujërave të zeza

Shenjzimi dhe mbrojtja e trasesë së vijës së kanalizimit për lidhje nga daljet e vendbanimeve në drejtim të kolektorit kryesor ”Lidhja e rrjetit kryesor”

Përgatitja e projekteve për lidhje nga daljet e vendbanimeve në drejtim të kolektorit kryesor ,”Lidhja e rrjetit kryesor”

Shenjzimi dhe mbrojtja e trasesë së vijës së kanalizimit për kolektorin kryesor në nivel komunal, Kamenicë – Koretin – Dheu i Bardhë ,Hogosht, Kopërnice, Kolloleq, Shipashnicë e Epërme, Shipashnicë e Poshtme , Muçivërc, Rogaçicë, Novosellë Karaçevë e Poshtme, Karaçevë e Epërme –Dheu i Bardhë (shihe hartën “KANALIZIMI DHE DEPONITË”)

Përgatitja e projektit për kolektorin kryesor në nivel komunal, Kamenicë – Koretin - Dheu i Bardhë Hogosht,Kopërnice,Kolloleq,Shipashnicë e Epërme,Shipashnic e Poshtme , Muçivërc, Rogaçicë, Novosellë, Karaçevë e Poshtme, Karaçevë e Epërme – Dheu i Bardhë në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ministrinë e Shërbimeve Publike(shih hartën “KANALIZIMI DHE DEPONITË”)

Shenjzimi dhe mbrojtja e hapësirës së mundshme për impiantin komunal për trajtim të ujërave të zeza

Te Dheu i Bardhë (Shihe hartën “KANALIZIMI DHE DEPONITË”)

Përgatitja e projektit për Impiantin e mundshëm komunal për trajtim të ujërave të zeza në Dheun e Bardhë në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ministrin e Shërbimeve Publike

(Shihe hartën “KANALIZIMI DHE DEPONITË”)

### **Strategjia 2: NDËRTIMI I SISTEMIT TË RI TË SHKARKIMIT TË UJËRAVE ATMOSFERIK**

Përgatitja e projekteve për ndërtimin e rrjetit të ri të kanalizimit atmosferik të ndarë nga kanalizimi i ujërave të zeza (në harmoni me konceptin e largimit në drejtim të rrjedhave më të afërta të përrrenjve ose lumenjve)

Çdo fshat duhet ta ketë sistemin e vet të veçantë. Ujërat atmosferik do të shkarkohen në lumin më të afërt.

Përgatitja e projekteve për ndërtimin e rrjetit të ri të kanalizimit atmosferik edhe për gjatë rrugëve.

### **Strategjia 3: NDËRTIMI I SISTEMIT TË DEPONIVE DHE MENAXHIMI ADEKUAT I TYRE**

Shenjzimi dhe mbrojtja e hapësirës së paraparë për deponi të përkohshme të mbeturinave ndërtimore dhe industriale në nivel të një ose dy vendbanimeve (shihe hartën “MENAXHIM I MBETURINAVE”)

Përgatitja e hapësirave të destinuara për deponi me rrafshim shtrim me zhavorr (me një herë pas aprovimit të planit) dhe shenjzimi deri sa të bëhen kushtet për kompletim me infrastrukturë

Përgatitja e projekteve kryesore për deponitë e përkohshme të mbeturinave ndërtimore dhe industriale në nivel të një ose dy vendbanimeve (shihe hartën “MENAXHIM I MBETURINAVE”)

Tenderimi dhe zbatimi i projekteve kryesore për deponitë e përkohshme të mbeturinave ndërtimore dhe industriale në nivel të një ose dy vendbanimeve (shihe hartën “MENAXHIM I MBETURINAVE”)

Shenjzimi dhe mbrojtja e hapësirës së paraparë për deponi të mundshme të nivelit komunal të mbeturinave ndërtimore dhe industriale me mundësi riciklimi (shihe hartën “MENAXHIM I MBETURINAVE”)

Përgatitja e projektit për deponi të mundshme të nivelit komunal të mbeturinave ndërtimore dhe industriale me mundësi riciklimi (shihe hartën “MENAXHIM I MBETURINAVE”)

Shenjzimi dhe mbrojtja e hapësirës së paraparë për deponi të mbeturinave inteligjente (elektronike)

Përgatitja e projektit për deponi të mbeturinave inteligjente (shihe hartën “MENAXHIM I MBETURINAVE”)

Krijimi i mekanizmave publik ose privat për menaxhim adekuat me këto deponi.

#### **4.1.13 FUNKSIONALIZIMI I FURNIZIMIT ME RRYMË DHE FUQIZIMI I RRJETIT TË TELEKOMUNIKIMIT**

##### **Strategjia 1: Fillimi i zbatimit të rekomandimet e Master planit për zhvillimin e sistemit distributiv të Kosovës deri më vitin 2022+**

Fillimi i eliminimit gradual të TS 35/10kV dhe kalimin në TS 110/20kV

Fillimi i kalimit gradual nga rrjeti distributiv 10kV në rrjetin distributiv 20kV

Fillimi i intervenimit me prioritet në kuptimin e kalimit nga sistemi 10KV në atë 20KV janë: Rrjeti Muçivërc-Kamenicë, Koretin – Kamenicë , Hogosht – Kamenicë , Strezoc – Kamenicë , Ropotovë – Kamenicë , Ruboc – Kamenicë si dhe përforcimi i rrjetit 10KV aktual në të gjitha vendbanimet.

Fillimi i zëvendësimit të TS 10/0.4kV me ata 20/0.4kV

Fillimi i zëvendësimit të linjave Ajrore 230/400V me kablo bistek apo edhe kablo nëntokësorë.

Shenjëzimi dhe ruajtja e linjës së re 110 kV Gjilan-Berivojcë

Fillimi i implementimit të projektit të linjës së re me erë 110 kV Kitkë- Berivojcë

Duhet përgatiten projektet ashtu që, rrjetet e tensionit të ulët duhet të planifikohen gjithashtu me shtylla betoni dhe me kablo vetëmbajtëse Alumini.

Duhet përgatiten projektet ashtu që në këto shtylla të bëhet edhe ndriçimi publik i rrugëve.

Duhet përgatiten projektet ashtu ndriçimi publik i rrugëve kryesore të fshatrave të bëhet me llamba natriumi me fuqi 400 w. Kyçja dhe shkyçja e llambave do të jetë automatike, ndërsa në kohën kur rrugët nuk janë shumë të frekuentuara (pas mesnate) llambat më mënyrë automatike do të ndizen në gjysmën e fuqisë nominale.

##### **Strategjia 2: fuqizimi dhe zgjerimi i telekomunikimit në tërë territorin e komunës**

Bashkëpunimi në funksion të rritjes të numrit të postave, numri i linjave telefonike dhe i aparateve të tjera si dhe vëllimit të shërbimeve të internetit dhe kabllorike, kurse shërbimet e PTK-së dhe operatorëve tjerë privat të modernizohen.

Përgatitja e projektit për vendbanimet ku rrjeti ekzistues është i viteve 90-ta, duhet të vendoset rrjeti i ri,

Shtrirja e rrjetit të telekomunikimit në fshatra përmes kabllorëve me fibra optike që mundësojnë lidhjen me internet dhe televizion kabllorik.

Përgatitja e projektit për vendosjen e 4 antenave të reja PTK-VALA dhe Ipko

Përgatitja e projektit për ndërtimin e objekteve postare në vendbanime

Përgatitja e projektit për mbulimin e tërë territorit me rrjet të telefonisë fikse, si dhe kalimi nga rrjeti ajror në atë nëntokësor.

Përgatitja e projektit për ofrimin e programeve televizive HD nëpërmes rrjetit kabllor

Përgatitja e projektit për vendosjen foltoreve publike në të gjitha vendbanimet ku ka rrjet të telefonisë fikse si dhe në ato ku do të shtrihet rrjeti.

#### 4.1.2 FUSHA TEMATIKE E DEMOGRAFIA DHE ÇËSHTJET SOCIALE

- STRATEGJITË DHE VEPRIMET PËR INFRASTRUKTURËN SOCIALE
- POPULLSIA, BANIMI DHE VENDBANIMI
- POPULLSIA

**Strategjia 1: Krijimi i kushteve sa më të favorshme për përmirësimin e indeksit komunal të zhvillimit njerëzor (IKZHNJ) në zhvillimin e mëtejshëm të komunës së Kamenicës**

- Përgatitja dhe zbatimi i projekteve për zhvillim të koordinuar të shtrirjes hapësinore sipas numrit të paraparë të popullsisë në të gjitha vendbanimeve të paraparë hartën”**KONCEPTI I ZHVILLIMIT TË VENDBANIMEVE TË KOMUNËS SË KAMENICËS**” mbështetur me zgjerimin e rrjeteve të infrastrukturës
- Hartimi i projekteve për shtimin e ambienteve dhe aktivitete që kanë të bëjnë me një jetë social-kulturore më të pasur.
- Projekte të integritit për komunitetet me të ardhura të ulëta dhe komunitetet që jetojnë në zonat rurale.
- Hartimi i projekteve për kompletim të cilësisë së infrastrukturës së sistemit të arsimit në të gjitha nivelet për të krijuar kushte për regjistrim në arsimim primar dhe sekondar, si dhe ngritje të shkallës së shkrim- leximit të të rriturve (mbi 15 vjeç).
- Hartimi i projekteve për kompletim të cilësisë së infrastrukturës së sistemit të shëndetësisë me ndikim edhe në rritjen e viteve të jetë gjatësisë së banorëve të Komunës së Kamenicës.
- Hartimi i projekteve për kompletim në fushën e zhvillimit ekonomik dhe ulje të varfërisë ashtu që **mirëqenia ekonomike, e matur nga të ardhurat për kokë banori të rritet.**
- Hartimi i projekteve të paraparë me këtë plan për rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta Në qytet dhe Në vendbanime tjera nëpërmjet ri-trajtimin të hapësirave aktualisht të lira ose të pashfrytëzuara, si edhe krijimit të zonave të gjelbra të reja brenda dhe për reth qytetit dhe vendbanimeve tjera.
- Të hartohen projekte për të rritur ndjeshmërinë e banoreve ndaj problemeve socialo kulturore por edhe të mjedisit në funksion të cilësisë së jetës.
- Të hartohen projekte ashtu që të fuqizohen në mënyrë strategjike kapacitetet e burimeve njerëzore në komunë në mënyrë që ti përgjigjen realizimit të këtij vizioni për të ardhmen e komunës së Kamenicës dhe të mbërrihet barazia gjinore dhe etnike.

## ➤ **BANIMI**

### **Strategjia 2: Ngritja e sasisë dhe cilësisë së banimit**

- Hartimi i planeve rregulluese duke respektuar konceptet, do të jetë në funksion të sigurimit të vëllimit të mjaftueshëm të banimit dhe për të gjitha shtresat;
- Hartimi dhe realizimi i projekteve kryesore të infrastrukturës dhe shërbimeve bazuar në hartat e infrastrukturës (ujë, kanalizim, ngrohje, parkingje, gjelbërim), në këtë dokument në fushën e banimit me qëllim të përmirësimit të cilësisë së banimit;
- Përgatitja e projekteve kryesore të përmbajtjeve publike, që ndikojnë në ngritjen e nivelit të banimit;
- Hartimi i projekteve dhe aplikimi i standardeve të hapësirave banuese dhe mirëmbajtja e strukturave ekzistuese, si dhe mënjanimin e degradimit fizik të strukturave ekzistuese të banimit e të ndërtuara pa plan.

## ➤ **VENDBANIMET**

### **Strategji 3: sigurimi që zhvillimi e ardhshëm i Komunës së Kamenicës do të bëhet në vijë me konceptin e zhvillimit hapësinor policentrik, me tri segmente lineare**

- Duhet bërë zhvillimi i vendbanimeve me konceptin e zhvillimit hapësinor **policentrik me tri segmente lineare**, segmenti i parë Kamenicë – Rogaçicë, segmenti i dytë Kamenicë – Hogosht, si dhe segmenti i tretë Kamenicë – Strezoc që ndryshe do ta quajmë edhe **“Koncepti i Diellit”**.
- Për plotësimin e rrjetit urban të vendbanimeve me funksione e përmbajtje dhe për një zhvillim më të baraspeshuar hapësinor të territorit të Komunës së Kamenicës, vlerësohet prioritare (parësore) **zhvillimi i shpejt i qytetit të Kamenicës, Rogaçicës, Hogoshtit, Strezocit** dhe disa nën – qendrave, siç janë **Koretini, Hodonoci dhe Muçivërci**, si në funksion të lidhjeve, shërbimeve, dendësimit dhe ushtrimit të funksioneve tjera plotësuese sociale, ekonomike e mjedisore.
- Tendencat e shprehura në shtimin dhe përqendrimin e popullsisë dhe rrethanat tjera, të cilat do të kenë ndikim në proceset e urbanizimit - kushtet natyrore, zhvillimi dhe kompozicioni i infrastrukturës dhe elementet tjera të ekonomisë eksterne në hapësirë, do të ndikojnë që këto procese të jenë më të theksuara në zonat rreth rrugëve të ndërtimit të rrjetit të ri rrugor (1. Kamenicë – Kapi – Medvegjë, 2. Kamenicë – Krilëvë – Podujevë – unazat e Kosovës, 3. Kamenicë – Hogosht – Desivojcë – Guri i Zi – Vllasë, 4. Kamenicë – Berivojcë – Koretin – Dajkoc – Muçivërc – Rogaçicë – Karaçevë e Poshtme – Muhoc, 5. Kamenicë – Bullaj – Zllatar – Prishtinë, 6. Hogosht – Lisockë – Zhujë – Shahiq – Gjyrishec – Svirçë – Banja e Sijarinës, 7. Unaza e qytetit të Kamenicës) si dhe përmirësimi i rrjetit rrugor ekzistues me infrastrukturë përcjellëse në drejtim të Serbisë.

- Ndërtimi i vijës Hekurudhore (1. Podujevë - Kamenicë – Dheu i Bardhe – Bujanoc) me korridoret VIII-të dhe X-të.
- Mbështetja me infrastrukturë teknike të zhvillimit policentrik dhe lehtësim të qasjes së nënqendrave, për plotë arsye dhe me këtë do të kompletohet edhe boshti tjetër kryesor urban, ku këto boshte zhvillimi dhe nënqendrat në to duhet të kenë prioritet në planifikimin hapësinor dhe urban, po ashtu zhvillimet në përgjithësi.
- Hartimi i planeve rregulluese (PRRU) për qytetin e Kamenicës dhe për vendbanimet si zona të interesit të veçantë për komunën, ku hynë vendbanimet: **Rogaçica, Hogoshti** dhe **Strezoci** për nën-qendrat ose qendrat sekondare brenda komunës, si Koretini, Hodonoci dhe Muçivërci në kuadër të së cilës mund edhe të avancohen nevojat e çdo vendbanimi gravitues si tërësi në atë nën – qendër në krahasim me këto të parapara me këtë plan.
- Hartimi i planit rregullues për zonën industriale Berivojcë dhe Topanicë-Domaroc.
- Trajtimi me prioritet i vendbanimeve afër qytetit të Kamenicës dhe atyre që gndodhen në zonat e boshteve të zhvillimit Hogosht- Rogaçicë – Kamenicë – Strezoc, si dhe vija Topanicë- Koretin – Kamenicë.
- Stimulimi i ndërtimeve brenda zonave të planifikuara.
- Monitorimi dhe moslejimi i asnjë ndërtimi jashtë kufijve ndërtimor dhe në zonat e ngrira për ndërtim.

Krijimi i një bordi për rrënim të ndërtimeve jashtë kufijve të paraparë

**Strategji 4:** Sigurimi që zhvillimet e ardhshme i vendbanimeve do të jetë në harmoni me konceptin e **vendbanimeve kompakt**.

- Për të gjitha vendbanimet që përgatisin planet rregulluese, zhvillimi kompakt i vendbanimit do të jetë detyrë e planeve rregulluese.
- Për të gjitha vendbanimet që nuk përgatiten planet rregulluese, zhvillimi kompakt i vendbanimit do të jetë detyrë e institucioneve kompetente komunale me anë të projekteve të ndryshme, por edhe masave tjera (me dhënie pëlqimi e leje për ndërtim, me nxitje stimuluese për zhvillime në zonat e zbrazëta, me mosndërtim të infrastrukturës jashtë zonave të definuara për ndërtim, përveç për funksionet e përcaktuara me nenin 17.3 të Ligjit për Planifikim Hapësinor etj.).
- Komuna është detyruar për të informuar dhe bashkëpunuar edhe me vendbanimet, të cilat kanë më pak interes për këtë koncept dhe do të marrë parasysh të gjitha mundësitë për realizimin e konceptit të vendbanimeve kompakte, si dhe mund ti përdorë të gjitha mjetet që janë në kompetencë të komunës.
- Problem i veçantë në strategjinë e zbatimit të planit sa i përket konceptit kompakt në nivel të vendbanimit, janë vendbanimet gati të zbrazura nga banorët, edhe këtu duhet të zhvillohen projekte e programe që kthimi e zhvillimi të bëhet në bërthama kompakte me synim të fuqizimit në të ardhmen.



- Respektimi i ndalimit të çfarëdo ndërtimi në zonat e ngrira për ndërtim, duke marrë të gjitha masat.
- Respektimi i zhvillimeve për qëllime bujqësore dhe jo për destinime tjera në zonat e gjelbra nëpër të gjitha vendbanimet, ku janë paraqitur nga ekspertët këto zona, duke marrë të gjitha masat për mbrojtjen e tyre.

#### ➤ **VENDBANIMET JOFORMALE**

**Strategji 5:** Sigurimi që vendbanimet joformale janë trajtuar, bazuar në udhëzuesit për rregullimin e vendbanimeve joformale të hartuar nga DPH dhe MMPH sipas Ligjit L-03/L-106 për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor 2003/14.

Veprimet vijuese janë: Rregullimi i VBJ është çështje e planifikimit hapësinor. Sigurimi i pronës, qasje në infrastrukturë adekuate, pjesëmarrje në qeverisje, mund të sigurohet përmes planifikimit hapësinor dhe urbanistik.

Deri sa është duke u hartuar ky dokument MMPH, është në fazën finale të hartimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Parandalimin dhe Rregullimin e Vendbanimeve Joformale, e cila do të japë udhëzime si do të veprohet në parandalimin dhe rregullimin e VBJ në vend.

VBJ në komunën e Kamenicës do të trajtohen në atë mënyrë që së pari do të identifikohen në PZHK dhe PZHU, do të vihen si projekte me prioritet për komunën dhe pastaj të hartohet profili dhe analiza e gjendjes së atyre VBJ, që vijon me hartimin e PRRU për ato vendbanimeve, apo me mënyra tjera të intervenimit dhe plotësime në vendbanime varësisht nga gjendja e tij.

Përgatitja e Profilit të gjendjes ekzistuese të VBJ në tërë territorin e saj, do të duhej të shërbente për përcaktimin e prioriteteve për rregullimin e VBJ, ndërsa do t'u shërbente donatorëve të mundshëm për ofrimin e informatave të nevojshme për përkrahje financiare njerëzore dhe teknike në kuadër të këtij rregullimi.

Çështjet pronësore-ekziston nevoja për angazhim intensiv të komunës për zgjidhjen e problemeve në lidhje me të drejtat pronësore. Çështjet e pa zgjidhura pronësore duhet të zgjidhen në mënyrë që të sigurohet baza ligjore për inicim të planifikimit, kadastra dhe departamentet pronësore, duhet të ofrojnë të dhëna dhe harta të përditësuara, në mënyrë që të shmangen problemet me të dhëna gjatë planifikimit.

Procesi i planifikimit –rregullimi i VBJ duhet të realizohet përmes një procesi gjithëpërfshirës, në mënyrë që pjesëmarrësve t'u mundësohet shprehja e kërkesave dhe një vendimmarrje transparente.

Bashkëpunimi me Agjensionin Kosovar të Privatizimit, me qëllim të shmangies së problemeve në raport me tokën publike nën menaxhimin e AKP, e nevojshme për vendosjen e infrastrukturës publike, sigurimin e hapësirave për shkollë, çerdhe dhe hapësirave tjera komunale.

- Gjatë hartimit të planeve rregulluese të qytetit të Kamenicës, në kuadër të detyrës projektuese për bartësin e hartimit të këtyre planeve, trajtimi i **vendbanimeve joformale Kamenica 1. Kamenica 2. Kamenica 3.** Duhet të

jetë pjesë e detyrës projektuese duke informuar edhe për cilësinë dhe shkallën e joformalitetit me theks të veçantë në planifikim të shërbimeve dhe zhvillimeve pa plan që janë karakteristikat e këtyre vendbanimeve joformale në drejtim të rregullorizimit, formalizimit dhe orientimin e zhvillimit me plane rregulluese.

- Pas hartimit të këtyre planeve edhe përcaktimi i prioriteteve për projekte, ku për zbatim duhet të merren parasysh këto VJF për rregullimin e tyre, ndërsa vendbanimet joformale do t'u shërbenin edhe donatorëve të mundshëm për ofrimin e përkrahjes së nevojshme financiare, njerëzore dhe teknike në kuadër të këtij rregullimi, pasi që rregullimi i vendbanimeve joformale është edhe prioritet Evropian.
- Një aktivitet tjetër i rëndësishëm për zbatimin e planit zhvillimor komunal sipas koncepteve të parapara, është që të merren masa dhe zhvillohen politika të tilla që të mos lejohen zona të reja joformale.

#### ➤ **ARSIMI**

### **Strategjia 1: Zgjerimi i vëllimit, përmbajtjeve si dhe rritja e cilësisë së infrastrukturës të sistemit të arsimit në të gjitha nivelet në harmoni me konceptin e zhvillimit policentrik me dy segmente lineare**

Ngritja e përmbajtjeve për edukimin parashkollor në kuadër të shkollave ose veçmas duhet paraparë në të gjitha vendbanimet.

Shenjëzimi dhe ruajtja e hapësirave të parapara me këtë plan për çerdhe, specifikuar në kornizën e zhvillimit hapësinor si dhe hartën "Hapësirat shkollore dhe Sportive".

Përgatitja e projekteve ideore dhe kryesore për çerdhe.

Shenjëzimi dhe ruajtja e hapësirave të parapara me këtë plan për shkolla fillore, specifikuar në kornizën e zhvillimit hapësinor si dhe hartën "Hapësirat shkollore dhe Sportive".

Përgatitja e projekteve ideore dhe kryesore për shkollat fillore dhe të mesme të ulëta.

Shenjëzimi dhe ruajtja e hapësirave të parapara me këtë plan për shkolla të mesme të larta, specifikuar në kornizën e zhvillimit hapësinor si dhe hartën "Hapësirat shkollore dhe Sportive".

Përgatitja e projekteve ideore dhe kryesore për shkollat të mesme të larta.

Shenjëzimi dhe ruajtja e hapësirës së paraparë me këtë plan për Fakultetin e Bujqësisë Dega në Kamenicë, specifikuar në kornizën e zhvillimit hapësinor si dhe hartën "Hapësirat shkollore dhe Sportive".

Përgatitja e projektit ideor dhe kryesor për shkollë të mesme të lartë profesionale në Rogaçicë, Hogosht, zbatimi i projektit për shkollë të mesme të lartë profesionale.

Themelimi i Degës së Fakultetit të Bujqësisë në Kamenicë.

Gjatë hartimit të projekteve të reja shkollore për ndërtim, duhet të parashihet infrastrukturë përcjellëse, ndërtimi edhe i objekteve sportive me qëllim të përmirësimit të kushteve për punë dhe mësim.

Në objektet e ndërtuara, infrastruktura përcjellëse duhet paraparë si e veçantë.

Kyçja në infrastrukturën e ujësjellësit dhe kanalizimit në të gjitha objektet shkollore, të cilat nuk janë të kyçura.

Fillimi i zbatimit të programit qeveritar për krijimin e kabineteve të informatikës dhe pajisja e tyre me kompjuterë.

Përmirësimi i sigurisë së nxënësve përmes vendosjes së sistemit mbikëqyrës dhe krijimi i shkollave multifunksionale, duke realizuar aktivitete për fëmijë, të rinjtë dhe grupet e tjera të qytetarëve.

Përfshirja e barabartë në arsim, krijimi i kushteve të favorshme për integrim të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe organizimi i formave të ndryshme për edukim të prindërve.

Menaxhimi efikas i shkollave dhe rrjetit shkollor, sipas ndryshimeve demografike dhe krijimi i sistemit të centralizuar për menaxhimin e financave të institucioneve arsimore.

Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet shkollave dhe prindërve.

Krijimi i kushteve nëpër shkolla për qëndrim ditor (krijimi i kuzhinave nëpër shkolla). Strategjia lokale për arsim (përgatitja e profileve konform kërkesave të tregut në Komunën e Kamenicës, në Kosovë dhe më gjerë.

Bashkëpunimi i mirëfilltë Komunë-Ministria e Arsimit-Ministri e Punës dhe Mirëqenës Sociale, e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Bashkëpunimi i Komunës së Kamenicës me komunitat tjera në shkëmbimin e përvojave dhe kuadrove për ngritje të cilësisë së arsimit.

Krijimi i rrethanave lehtësuese për zhvillimin e arsimit privat, ofrimi i lokacioneve për bashkëpunim me shtete dhe organizata tjera që kanë paralelet e veta nëpër botë për aftësim profesional.

## ➤ SHËNDETËSIA

### **Strategjia 1: Ofrimi i përmbajtjeve shëndetësore në vendbanime në përputhshmëri me funksionin e tyre si dhe hierarkinë**

**Përkujdesja parësore shëndetësore:** Do të vazhdojë në bazë të konceptit të mjekësisë familjare edhe atë në sistemin si vijon:

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare(QKMF) – në qytetin e Kamenicës e cila do të vazhdojë të ofrojë shërbime shëndetësore 24 orë në repartin e urgjencës (me ndarjen fizike të repartit të urgjencës nga QKMF, ashtu që të mundësohet dhënia e ndihmës së parë shumë më shpejtë në rastet e rënda dhe pa u penguar nga pacientët e tjerë), repartet e mjekësisë familjare, reparti i stomatologjisë, reparti i gjinekologjisë, reparti i vaksinimit.

Qendrat e mjekësisë familjare (QKMF) – duhet të ofrojnë shërbime shëndetësore gjatë ditëve të punës edhe atë në Koretin, Topanicë, Hodonoc, Karaçevë e Poshtme, Rogaçicë, Muçivërc, Shipashnicë e Epërme, Kopërnice, Hogosht, Desivojcë, ndërsa vizita dy herë në javë bëhen në ambulancat e mjekësisë familjare në Poliçkë, Lisockë, Krilevë, Busavatë, Strezoc, Tuxhec. Për të ardhmen propozohet një ambulancë e mjekësisë familjare në lagjen urbane të qytetit “Malësia” në Kamenicë.

**Në Kamenicë duhet të bëhet një qendër spitalore,** e cila mund të ofrojë edhe disa shërbime, që deri sa të realizohet do vazhdojnë të bëhen në **spitalin rajonal që gjendet** në Komunën e Gjilanit me 17 reparte: Reparti i Gjinekologjisë, interno, dializa, pediatria, kirurgjia, anesteziologjia, ortopedia, urologjia, infektivi, sëmundjet e mushkërive, ndihma e shpejtë, oftalmologjia, laborator, transfuzioni i gjakut dhe materniteti.

**Në qytetin e Kamenicës, ekziston edhe shtëpia për persona me aftësi të kufizuara, ku aty me qëndrim të përhershëm janë prej 10 personash, me kushte dhe infrastrukturë bashkëkohore.**

Komuna jonë ka vend të përshtatshëm me një ambient të mirë për ndërtimin.

- një qendër spitalore rehabilituese (spitali i mushkërive) dhe rekreative, si në Kikë dhe Kranidell;
- Qendra për rehabilitimin e të sëmurëve narkomanë (Kamenicë);
- Mirëmbajtja e objekteve, plotësimi me infrastrukturë (kanalizimi dhe ujësjellësi, mungon në Busavatë dhe Krilevë) dhe përmbajtje (objektet përcjellëse si garazhet, depot, furrat për djegien e mbeturinave etj.).

**Përkujdesja sekondare shëndetësore:** si spitale të përgjithshme, korrespondojnë me nivelin sekondar të përkujdesjes shëndetësore, përfshirë Spitalin Universitar të Prishtinës.

**Përkujdesja terciare shëndetësore:** Spitali Universitar i Prishtinës, është spitali i vetëm, i cili siguron përkujdesje terciare shëndetësore.

**Kujdesi privat shëndetësor:** Ofron shërbime të ndryshme ambulatore dhe specialitike të profileve të ndryshme diagnostike dhe terapeutike, si në Kamenicë, Rogaçicë.

## **KULTURA**

**Strategjia 1: Ofrimi i kushteve dhe përmbajtjeve për ruajtje, konservim dhe përdorim në vazhdimësi të qëndrueshëm të trashëgimisë kulturore.**

**Për periudhën sa hartohet ky plan, duhet të arrihet që oferta kulturore e Kamenicës të jetë në harmoni me mundësitë që ka komuna dhe kërkesat, si dhe rekomandimet që ishin rezultat i procesit pjesëmarrës të planifikimit.**

Realizimi i veprimeve dhe detyrave të pasqyruara në kornizën e zhvillimit hapësinor për këtë fushë, si dhe në përmbajtje të strategjisë mund të bëhet nëse ndërmarrim këto veprime :

- Me aprovimin e këtij plani të gjitha vlerat e shënuara në hartën e trashëgimisë merren nën mbrojtjen e komunës-shtetit;
- Parandalimin e dukurive aktuale që çënojnë trashëgiminë kulturore me masa teknike, profesionale dhe legale (të prezantuar në hartën “Trashëgimia Kulturore”);

-Shenjëzimi i zonave, objekteve dhe vlerave të trashëgimisë nga hartat në hapësirë në tërë territorin e Komunës së Kamenicës.

**Shtëpia e Kulturës “Isa Kastrati”** në Kamenicë duhet të mirëmbahet dhe rinovohet dhe si institucion i vetëm ku zhvillohen aktivitetet kulturore, të vihet në shërbim të plotë të artistëve, teatrove, ansambleve kulturore, rinisë dhe shoqërisë civile.

Në këtë funksion duhet digjitalizuar dhe kompletuar me infrastrukturë edhe bibliotekën e qytetit.

**Shtëpi kulture duhet të ndërtohen** edhe në Hogosht, Koretin, Topanicë, Strezoc, Hodonoc, Muçivërc, Shipashnicë e Epërme, Karaçevë e Epërme .

**Biblioteka në vendbanimet** :Koretin, Rogaçicë, Hogosht, duhet të rregullohet një hapësirë për bibliotekë, ku pos ruajtjes dhe shërbimit të librit të mundësohet edhe leximi ditor, ndërsa për të ardhmen të mendohet edhe në digjitalizim.

**Në SHFMU** në Hogosht, Muçivërc, Rogaçicë, Hodonoc, Karaçevë e Poshtme, Petroc, Topanicë, Koretin, Kamenicë, Strezoc, Kopërnica, Tugjec, Busavatë, si dhe në shkollat e mesme të larta në Kamenicë, Hogosht e Rogaçicë, duhet të sigurohet nga një sallë ( klasë e madhe) ku nxënësit dhe grupet e ndryshme mund lirshëm ti zhvillonin aktivitetet e kulturës.

**Duhet të punohet në organizmin** vjetor të panairit të librit në Kamenicë, hapja e një shkolle për ciklin e ulët të muzikës, formimi i korit të qytetit, krijimi i klubit të artistëve për pikturë, si dhe riaktivizimi i kinemasë së qytetit në Kamenicë.

Me qëllim të hulumtojnë, konservojë, mbledhë, komunikojë dhe ekspozojë trashëgiminë e luajtshme për qëllime të studimit, të edukimit dhe të shijimit të saj për qytetarët e komunës dhe më gjerë duhet themeluar **muzeun komunal në Kamenicë**.

**Parashikimet janë që të gjitha** objektet dhe vlerat të futen në listën e trashëgimisë nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme në nivel komunal, të Kosovës dhe disa edhe ndërkombëtar.

Në mënyrë të veçantë duhet zhvilluar projekte, ashtu që vendbanimet e pasura me :

**trashëgimi kulturore**, Kamenica, Moçari, Kopërnica, Topanica, Rogaçica, Hogoshti etj.  
**Trashëgimi arkeologjike**:Lokaliteti “Kulina Ilire” në Kamenicë, kështjella në Kopërnica, Tyrbja e Shehut në Topanicë, tyrbja në Rogaçicë, manastiri i Moçarit etj. (shihe hartën Trashëgimia Kulturore).

**Trashëgimi shpirtërore** shumë e pasur në Komunën e Kamenicës, duke përfshirë format e shprehjes kulturore të traditave ose të zakoneve popullore, të gjuhës, festave, riteve, valles, muzikës, këngës dhe shprehjes artistike.

Ngritja e lapidarëve në vendbanimet e ndryshme të komunës si: në Kamenicë, Koretin, Rogaçicë, Hogosht, Zajçec, Gjyrishec etj.

Parashikohet Zgjerimi i varrezave në fshatin Koretin, Rogaçicë, Kopërnice etj. Ndërtimi dhe mbrojtja e kompleksit të varrezave të UÇK-se në Kamenicë.

Futja nën mbrojtje, hartimi i projektit dhe restaurimi i xhamisë në fshatin **Krilevë**, Meremetimi i xhamisë në fshatin **Svircë, Zhujë**, rikonstruktimi i shtëpisë së heroit të kombit **Nuhi Berisha** në **Svircë**.

Kampanjë informuese dhe marketingu në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve komunale, në funksion të trashëgimisë dhe të imazhit të vendit me përfitime shumë dimensionale.

## **ADMINISTRATA DHE INSTITUCIONET PUBLIKE**

### **Strategjia 1: Ofrimi i kushteve dhe përmbajtjeve për administratë dhe institucione publike transparente dhe efikase**

Pasi që me kornizë të zhvillimit hapësinor si zhvillime të dëshiruara në këtë fushë janë paraparë objektet e reja për administratën komunale, si dhe mundësia e vendosjes së institucioneve komunale në këtë objekt me standarde evropiane.

- Objekti i Administratës Komunale gjendet në fazën e ndërtimit (të ish objekti i komunës para vitit 1999).
- Fillimi i decentralizimit të disa funksioneve të administratës –në qendrat sekondare dhe fillimi i zbatimit të sistemit elektronik të qeverisjes, si dhe të shërbimeve me afër qytetarëve.

### **➤ SPORTI DHE REKREACIONI**

### **Strategjia 1: OFRIMI I PËRMBAJTJEVE SPORTIVE DHE REKREATIVE NË VENDBANIME NË PËRPUTHSHMËRI ME FUNKSIONIN E TYRE, SI DHE HIERARKINË**

Zhvillimi në të ardhmen i ofertës për sport në Komunën e Kamenicës, duhet të jetë në harmoni me mundësitë që ka ajo dhe kërkesat e rekomandimet që ishin rezultat i procesit pjesëmarrës të planifikimit.

Hapësirat për sport dhe rekreacion në përgjithësi, duhet të sigurohen në çdo vendbanim. Ato mund të jenë në kuadër të hapësirës së shkollave fillore dhe të mesme të ulëta, si pjesë e oborrit të shkollave me shfrytëzim të organizuar jashtë orarit të procesit mësimor, ose si hapësira të veçanta e që varet nga mundësitë dhe kërkesat.

Në mënyrë të veçantë parashikimet e dëshiruara në funksion të shtrirjes hapësinore të infrastrukturës sportive janë:

Ndërtimi i një **palestre sportive** me kapacitet deri 1500 ulëseve në qytetin e Kamenicës (në fazën e përfundimit );

Rinovimi i **stadiumit të futbollit** të madh në qytetin e Kamenicës.

Rregullimi i **stadiumit për futboll** të madh në Hogosht, Muçivërc, Karaçevë, Koretin dhe Rogaçicë;

Rregullimi i **një salle sportive** për sporte tjera në Rogaçicë;

Rregullimi i **një kompleksi** për sporte në Muçivërc, ku përfshihen fushat për zhvillime të ndryshme sportive;

Rregullimi i **sallës sportive** në shkollën e Hogoshtit;

Rregullimi i **sallave sportive** në dy shkollat e mesme të Kamenicës;

Rregullimi i **poligonit për shenjëtari në Kamenicë, Muçivërc.**

**Përkrahja e sektorit privat në zhvillimin e aktiviteteve dhe plotësimi me përmbajtje dhe standarde** në fushat ekzistuese të futbollit të vogël (Kamenicë, Strezoc, Koretin, Topanicë, Rogaçicë, Muçivërc, Hogosht, Kopërnice, Desivojcë dhe Poliçkë) dhe pishinat (Kamenicë, Shipashnicë e Epërme etj ).

**Poligonet për ecje dhe rekreacion** Kamenicë – Koretin, Hogosht, Kopërnice, Karaçevë, Hodonoc- Rogaçicë – Muçivërc, Kikë, Tugjec dhe Planik.

**Duhet mendohet edhe** për sportin e tenisit, peshkimit, gjuetisë, kalërimit, motokrosit etj.

## ➤ RINIA

### **Strategjia 1: OFRIMI I PËRMBAJTJEVE PËR JETË RINORE**

Parashikimet e dëshiruara nga kjo fushë janë fillimisht:

Aktivizimi i sa më shumë organizatave rinore dhe ngritja e bashkëpunimit me institucionet komunale, ngritja e kapaciteteve për sport e kulturë dhe angazhimi sa më shumë të rinjve në këto aktivitete. Aktivizimi i garave në fusha të ndryshme sport, art, shkencë në shkollat fillore dhe të mesme.

- Hapësirat për sport dhe rekreacion në përgjithësi, duhet të sigurohen në çdo vendbanim të shfrytëzohen edhe për aktivitete rinore, ku mund të krijojnë edhe klubet rinore. Hapësirat mund të jenë në kuadër të hapësirës së shkollave fillore .

Parashikimet e dëshiruara hapësinore të veçanta nga kjo fushë janë:

- Ndërtimi i qendrave rinore në qytetin e Kamenicës, Rogaçicë, Hogosht, etj.
- Formimi i grupeve të recituesve, dramatike, muzikës në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme.
- Hapja e një qendre për aftësim profesional të rinjve.
- Organizmi vjetor i Ditës së Rinisë.

## ➤ QENDRAT LOKALE TË KOMUNITETIT

### **Strategjia 1: sigurimi i qendrave të komunitetit në kuadër të qendrave Lokale**

- Themelimi i qendrave të komunitetit në të gjitha qendrat lokale, ku ato mungojnë dhe vendosja e tyre në hapësira të institucioneve publike si në shkolla dhe të ngjashme për aktivitete kulturore dhe të tjera.
- Përmirësimi i qendrës së komunitetit në zonën urbane të Kamenicës me një zyre dhe hapësira në shtëpinë e kulturës, si dhe themelimi i tjerave nëpër shkollat në zonat e komunitetit.

## ➤ PAPANËSIA DHE VARFËRIA

### **Strategjia 1: minimizim të shkallës së papunësisë dhe varfërisë**

- Për ta përmirësuar këtë gjendje janë propozuar masat në kornizën e zhvillimit hapësinor për zhvillim ekonomik dhe strategjinë për zbatimin e planit në këtë fushë, pra “Demografi dhe Çështje Sociale”, është analizuar papunësia dhe varfëria; prandaj edhe dhe kërkohet ndërmarrja e masave konkrete që kanë të bëjnë me rritjen e numrit të punësuarve, rritjen e të ardhurave për kokë banori e që do të ndikojë në ngritjen e standardit jetësor.
- Përmes ngritjes së zhvillimit ekonomik dhe social mund të zvogëlohet edhe shkalla e papunësisë, prandaj kërkohet që të stimulohen dhe të përkrahen bizneset e vogla dhe të mesme, krijimi i mundësive më të mira për donator dhe sigurimi i punës stinore.
- Hartimi i projekteve dhe krijimi i kushteve për organizimin e trajnimeve profesionale sipas kërkesave të tregut.
- Ndërtimi i objekteve për raste të rënda sociale në qytet, si dhe në qendrat komunale më të mëdha.
- Hartimi i projekteve dhe krijimi i kushteve për sigurimin e punës sezonale (stinore).
- Hartimi i projekteve dhe krijimi i kushteve për përkrahje.



#### **4.1.3.0 STRATEGJITË DHE VEPRIMET PËR SHFRYTËZIMIN E TOKËS DHE MJEDISIT**

Fusha e shfrytëzimit të tokës dhe mjedisit, është fusha që përbën prioritet në planin për rregullimin, shfrytëzimin dhe zhvillimin e hapësirës, si dhe strategjia për zbatimin e këtij plani në këtë fushë është më përmbajtësorja për të ardhmen. Përkitazi për këtë, po i theksojmë aktivitetet esenciale me radhë:

##### **a) AJRI**

Strategjia 1: ajër i pastër, ndotje minimale;

Shenjzimi dhe mbrojtja gjatë zhvillimit të ndërtimeve i brezave dhe shiritave të gjelbër sipas planit.

Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore i brezave dhe shiritave të gjelbër sipas planit, si dhe fillimi i zbatimit të tyre me prioritet në Kamenicë, Rogaçicë, Koretin, Muçivërc, Hogosht.

Shenjzimi dhe mbrojtja gjatë zhvillimit të ndërtimeve të parqeve ekzistuese dhe hapësirave për parqet e reja sipas planit.

Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore për rivitalizimin e parqeve ekzistuese dhe të reja të parapara me plan, si dhe fillimi i zbatimit të tyre.

Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore për mbrojtje, zhvillim të pyjeve ekzistuese e sidomos për kultivimin e pyjeve të reja edhe me kapacitete për thithje të gazrave dhe ajrosuleve të ndryshme.

Përcaktimi i kriterëve për sipërfaqet e gjelbra gjatë hartimit të planeve rregulluese dhe lëshimit të lejeve urbane, si dhe të ndërtimit me prioritet në qytetin e Kamenicës dhe nën – qendrat.

Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore për përmirësimin e qarkullimit rrugor, për shmangien e fluksit të madh të automjeteve transportuese nëpër qendra të vendbanimeve sipas planit.

Hartimi i rregullores komunale për masat, kriteret dhe kushtet për shkarkim të ndotësve në ajër nga industria dhe makinat lëvizëse, duke obliguar vendosjen e katalizatorëve dhe rregullimeve tjera në aspektin teknik, si dhe largimin e të vjetrave nga trafiku.

Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore për shfrytëzimin e energjive alternative (kryesisht energjia diellore, te erërave, rrjedhat e ujit dhe energjia gjeotermale).

Stimulimi me lirim nga taksat deri 50 % të atyre që kërkojnë leje ndërtimi dhe shfrytëzojnë energjinë alternative .

Stimulimi me çmime dhe cilësi për shfrytëzimin e transportit publik.

Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore për stazat për çiklist dhe ecje në këmbë, siç shihet në hartë, si dhe obligimi gjatë hartimit të projekteve të rrugëve për këto përmbajtje.

Marrja e masave ndëshkimore për personat fizik dhe juridik që e tejkalojnë nivelin e tolerueshëm të ndotjes dhe zhurmës, sidomos në zonat me veprimtari të ndjeshme (afër shkollave, çerdheve, spitaleve etj).

Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore për rikonstruktim të rrugëve (qarkoreve dhe bajpaseve në qendrën urbane, kanalizimeve dhe mënjanimi i deponive të mbeturinave).

## **b) UJI**

### **Strategjia 1: Përmirësimi i cilësisë së ujit dhe hapësirave të pasura me ujë**

Shenjëzimi dhe hartimi i projekteve për mbrojtje dhe zhvillim për burimet e ujërave natyrale dhe ujërave tjerë nëntokësorë dhe sipërfaqësor, siç shihet në hartën hidrologjike të Komunës së Kamenicës, bashkë me caktimin e zonës së mbrojtjes së obligueshme dhe regjimit të caktuar të mbrojtjes.

Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore për vendosjen e gropave septike dhe pajisjeve për filtrim deri te impianti.

Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore për të montuar dhe kompletuar pajisje pastrimi të ujërave të përdorura nga industria.

Aprovimi i rregullores për ndërtimet industriale duke e obliguar vendimin e pastrimit e të gjitha ujërave të përdorura, të ndyta. Po ashtu dhe moslejimi i fillimit të shfrytëzimit pa u montuar më parë, pajisje të cilat do të sigurojnë pastrimin e ujërave të ndyta në mënyrën e duhur.

Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore për mbrojtje të veçantë për burimet, për rrjedhat e epërme të terreneve të lumit të Desivojcës, lumit të Kremenatës, lumit të Hogoshtit etj.

Hartimi i projekteve ideore dhe kryesor për akumulacionin e Desivojcës, Kremenates dhe Gjyrishecit.

Hartimi i projekteve për mbrojtje të veçantë të ujërave nga përdorimi i pa kontrolluar i plehrave artificiale për bujqësi (nitratat, nitritet, fosfatet dhe nutrient tjerë).

Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore për deponi të organizuara, varreza të kafshëve për raste emergjente si dhe mbrojtje nga mbeturinat ilegale (të gjitha llojet e mbeturinave).

## **c) TOKA**

### **Strategjia 1: Mbrojtja e cilësisë dhe sasisë së tokës.**

Përgatitja e projekteve për monitorim dhe kontroll të vazhdueshëm të plleshmërisë së tokës bujqësore.

Përgatitja e projekteve ideore dhe kryesore për mbrojtje nga vërshimet bazuar në hartat e prezantuara në kornizë në funksion të mbrojtjes dhe ngritjes edhe të shkallës së bonitetit.

Hartimi i projekteve për mbrojtje të veçantë të tokës nga përdorimi i pa kontrolluar i plehrave artificiale për bujqësi (nitratat, nitritet, fosfatet dhe nutrient tjerë).

Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore për mbrojtjen e tokës nga mbeturinat ilegale (të gjitha llojet e mbeturinave).

Të përgatiten projektet për rihvillimin e ish zonës së mbuluar nga deponitë dhe zonës ku janë alokuar mbeturinat.

Hartimi i projekteve dhe marrja e masave për mbrojtje nga erozionet nga shpëlarja e elementeve përbërëse të tokës, siç shihet në hartën e pyllëzimit.

Të përgatiten projekte, krijuar kushtet dhe mekanizma për marrjen e masave për mbrojtje nga degradimi prej ndikimeve të njeriut.

Te përgatiten projekte prioritete për djerrinat dhe tokat e cilësisë së ulët bujqësore.

## **Strategjia 2: Menaxhim i tokës**

Duhet organizuar një kampanjë informuese për qytetarët (për kufijtë e ri ndërtimor, zonat e ngrira për ndërtim dhe zonave për zgjerim të ardhshëm) me qëllim të mbrojtjes së hapësirës së tokës dhe resurseve tokësore nga tjetërsimi për qëllime jobujqësore me kufizim të shtrirjes së ndërtimeve vetëm brenda kufijve ndërtimor të planifikuar (harta “Konceptet e zhvillimit të Vendbanimeve”) si dhe zbatimin e orientimeve të zhvillimeve në zonat e planifikuara.

Përgatitja e projekteve për komosacion e rregullimit të tokës bujqësore (me masa komosative).

Përmirësimi i sistemit të kontrollit ndaj ndërtimeve të reja në komunë.

Prezantimi dhe konsolidimi i masave ndëshkuese si dhe organizimi i një kampanje njohje të banorve dhe bizneseve me këto masa.

Rritja e kapaciteteve të komunës lidhur me menaxhimin dhe kontrollin e zhvillimeve të planifikuara.

Të stimulohen dhe të vazhdohen proceset e hartimit të planeve rregulluese për të gjitha zonat e parapara me PZHK dhe PZHU.

### **c) SHFRYTËZIMI I TOKËS**

**Strategjia 1:** Sigurimi i shfrytëzimit të tokës për destinimin e planifikuar.

Informimi adekuat i administratës dhe qytetarëve për destinimet dhe kufijtë.

Zhvillimi Përkufizimi i destinimeve të parapara nga hartat në terren çoftë edhe me anën e piketimit dhe sinjalizimit për destinim të sipërfaqeve.

**Zhvillimi i planeve të niveleve më të ultë dhe projekteve ideore e kryesore për destinimet e parapara me hartën e shfrytëzimit të tokës (tokë bujqësore, pyjore, tokë e destinuar për vendbanime ose tokë ndërtimore, zonë arkeologjike, varreza, gjelbërim, rrugë, deponi të mbeturinave, korridore, industri edhe të gjitha fushat dhe sektorët e nevojshëm).**

**Zhvillimi i projekteve për të siguruar cilësi hapësinore e hapësirave publike**

Zhvillimi i mekanizmave të përcjelljes së zbatimit dhe kontrollit për tërë territorin e komunës së Kamenicës.

Ngritja e kapaciteteve njerëzore të komunës.

Zhvillimi i mekanizmave ndëshkues për shkelësit të cilët do të provonin tjetërsimin e tokës për destinime jo të parapara me këtë dokument.

### **d) ZONAT ME DESTINIM TË VEÇANTË**

**Strategjia 1:** Sigurimi që zonat me destinim të veçante në nivelin Komunal (të natyrës, vendbanimet dhe zonat tjera) të trajtohen në mënyrë adekuate.

Përgatitja e planeve përkatëse: Berivojcë, Koretin, Hodonoc, Rogaqicë, Muqiverc, Hogosht, Strezoc, Krilevë.

Përkufizimi, piketimi dhe sinjalizimi i zonave arkeologjike (të trajtuara si të interesit të veçantë për komunën).

Zhvillimi i incizimeve gjeofizike si dhe përgatitja e projektit ideor dhe atij kryesor për zhvillim për zonat arkeologjike (Lokalteti Kulina Ilire Kamenicë, kështjella në Kopërnice, Kalaja ne Kranidell etj shih harten e monumenteve arkeologjike.

Përkufizimi, piketimi dhe sinjalizimi i zonave me pasuri minerale (Bentoniti, Tufi, Graniti, Antimoni, Andezite, Thengjilli, Hekuri, Çeliku, Argjilaetj, shih harten Gjeologjike)

Zhvillimi i mekanizmave të përcjelljes së zbatimit dhe kontrollit.

Ngritja e kapaciteteve njerëzore të komunës.

Zhvillimi i mekanizmave ndëshkues.

#### **4.1.3.1 RRJETI I VENDBANIMEVE NË KONTEKST URBAN-RURAL**

**Strategjia 1:** Rrjet funksional të vendbanimeve dhe baraspeshë e zhvillimit Urbano-rurale

Zhvillimi i projekteve me prioritet në fshatrat Hogosht, Strezoc, Krilevë Berivojcë, Koretin, Hodonoc, Rogaqicë, Muqiverc, në fushat e parapara me kornizë të aspektit ekonomik, infrastrukturor etj. (Shih hartat Rrjeti rrugorë, infrastruktura rrugore, kanalizimi, ujësjellësi, telekomi, Shkollat dhe objektet fetare).

Përgatitja e planeve të Kamenicës dhe nënqendrave (Rogaqic, Hogosht, Strezoc) në funksion të rrjetit të vendbanimeve

Përgatitja e projekteve për zgjerim të planifikuar të disa vendbanimeve (Koncepti i zhvillimit të Vendbanimeve).

Përgatitja e projekteve ideore dhe kryesore për kompletim të sa ma shumë që është e mundur me infrastrukturë urbane të gjitha vendbanimet.

Përgatitja e planeve dhe rregulloreve për zhvillimin e ndërtimeve brenda kufijve të planifikuar ndërtimor.

Përgatitja e projekteve për zhvillime bujqësore në zonat e ashtuquajtura zemra e gjelbër (agroekosistemi).

Përgatitja e projekteve për zgjerimi me përmbajtje të industrisë në ato vendbanime që kanë leverdi për këtë.

Përgatitja e kushteve procedim me leje duke respektuar sa më tepër norma specifike urbane dhe angazhimi i organeve kompetente për krijimin e një klime urbanistike sidomos për pjesët të cilat konsiderohen ende të pa prekura me hartimin e planeve rregulluese dhe kushteve tjera (rregulloreve) në vendbanimet ku nuk do të përgatiten planet.

Identifikimi i të gjitha ndërtimeve ilegale.

Përgatitja e kushteve bazës ligjore për trajtim adekuat të ndërtimeve ilegale.

#### 4.1.3.2 TRASHËGIMIA NATYRORE

##### **Strategjia 1: Mbrojtje e trashëgimis natyrore**

Përgatitja e vendimeve për shpalljen si zona me vlera të veçanta natyrore (Kika, Pllanica, Tugjeci, shih hartën).

Përgatitja e vendimeve për shpalljen si të mbrojtura, të ruhen, sensibilizohen, mbrohen dhe konservohen trungjet e vjetra dhe monumente gjeomorfologjike (Shihe Hartën Trashëgimia).

Sigurimi mbrojtjes së integruar të monumenteve natyrore dhe kulturore.

##### **Strategjia 2: Mbrojtje dhe fuqizim i Peizazheve**

- Hartimi i projektit ideor dhe kryesor dhe zbatimi i tij për zonën Kike, Pllanik, Tugjec.
- Përgatitja e projektit për Lumejt.
- Masat për kufizim të ndërtimit dhe zhvillim të vendit ku bashkohen dy rrjedhat e Lumit të Desivojces, Hogoshtit dhe Krivarekes.
- Hartimi i projektit ideor dhe kryesor dhe zbatimi i tij për zonën e trenave .
- Hartimi i projekteve për funksionalizim dhe mirëmbajtje të peizazheve bujqësore.
- Hartimi dhe zbatimi i projekteve për mbjelljen e llojeve të shumta të bimëve barishtore në livadhet dhe kullosat.
- Hartimi i projekteve dhe marrja e masave ashtu që të mbrohen nga prerja e pakontrolluar e pyjeve dhe zjarret dhe projekte kundër erozionit.
- Forcimi i bashkëpunimit me MMPH
- Kufizimi i zhvillimit në zonat me tokë bujqësore cilësore si dhe në peizazhet piktoreske.

##### **Strategjia 3: Përmirësimi i cilësisë së hapësirave të gjelbra.**

Rritja e numrit të parqeve dhe hapësirave të gjelbër në vendbanimet me popullatë të dendur.

Krijimi i parkut të ri në qytetin e Kamenicës.

Krijimi i hapësirës së gjelbër përgjatë lumit të Krivarekes, Lumit të Desivojces dhe atij të Hogoshtit, mbrojtja nga veprimtaritë degraduese.

#### **e) Biodiversiteti**

##### **Strategjia 1: Zhvillimi i qëndrueshëm i biodiversitetit**

Përgatitje e projekteve për mbrojtjen ruajtjen dhe konservimin e disa llojeve të fitocenozave.

Përgatitje e projekteve për mbrojtjen e zonave ku jetojnë dhe veprojnë shtazët e egra në mesin e të cilave ka edhe lloje që konsiderohen si të rrezikuara si dhe projektet për mbrojtjen e tyre si specie.

Përgatitja e projekteve për Inventarizim të florës dhe faunës në gjithë territorin e komunës duke specifikuar çka duhet mbrohet dhe çka mundë shfrytëzohet.

Përgatitja e projektit për një rezervat për ruajtjen e kaprollit (*Capreolus capreolus*) areali i të cilit është mjaft i rrezikuar që do të shtrihet në zonën ndërkufitar në zonat e larta të fshatrave Kranidell, Tugjec, Desivojc, etj.

Projektet për ruajtjen dhe zhvillimin e racës autoktone të lopës bushe.

Përgatitja e projekteve për revitalizimin e ekosistemeve pyjore dhe për parandalimin e shkatërrimit të habitateve të shumë llojeve bimore dhe shtazore. Duke e konsideruar të rëndësishme edhe ruajtjen e habitateve të fluturave, shpezëve mishngrënës etj. Shih hartën e biodiversitetit.

Zhvillimi i mekanizmave të përcjelljes së zbatimit dhe kontrollit.

Ngritja e kapaciteteve njerëzore të komunës.

Zhvillimi i mekanizmave ndëshkues.

#### f) **Menaxhimi i mbeturinave**

**Strategjia 1:** Vëllim minimal i mbeturinave i prodhuar dhe Ri-përdorim dhe riciklim i mbeturinave.

Përkufizimi, piketimi dhe sinjalizimi i zonave të destinuara për deponi transite, varrezat e kafshëve dhe deponi të mbeturinave inteligjente.

Përgatitja e projekteve për deponi tranzite të mbeturinave inerte (ndërtimtarisë), varrezat e kafshëve në zonën kadastrale të Feriqeves, deponi të mbeturinave inteligjente në fshatin Bllatë dhe një deponi e qëndrueshme, me standarde ku bëhët edhe riciklimi i mbeturinave .

Përgatitje dhe zbatim të projektit për rehabilitim dhe dekontaminim të vendit të deponisë së vjetër të qytetit si dhe vendit ku janë rialokuar mbeturinat e deponisë së vjetër në zonen kadastrale Koretin.

**Përgatitja e projekteve për grumbullimin dhe trajtimi i mbeturinave që janë hudhur në mënyrë të pa kontrolluar me prioritet në brigjet e Lumejve dhe në hapësira të ngjajëshme.**

Përgatitja e projekteve për menaxhim dhe kontroll të komunës sa i përket mbeturinave Marrje e masave ndëshkimore.

#### **4.1.3.4 FATKEQËSITË NATYRORE DHE TË TJERA**

**Strategjia 1:**Lëvizje nga kultura e reagimit në atë të amortizimit dhe parandalimit

#### **Tërmetet**

Të përgatitet rregullorja për të gjitha ndërtimet në harmoni me shkallën e rrezikut sizmik dhe të ndërtohet me standardet.

Në objektet e veçanta si dhe në objektet shumëkatëshe duhet të punohen me arkitekturë a-seizmike.

#### **g) BRESHËRI**

Përgatitja e projekteve për ndërtimin e stacioneve kundër breshëritë në vendet ku ishin edhe më parë dhe të planifikuara (siç shihet në harta).

#### **h) RRËSHQITJET E BORËS, ERËRAT E FORTA dhe AKULLI**

Përgatitja e projekteve për ndërmarrjen masa gjatë kohës së dimrit dhe posaçërisht në zonat kodrinore- malore.

### **i) THATËSIRA**

Përgatitja e projekteve për akumulim të ujërave si pendat ne Desivojc, Gjyrishec dhe Kremena, dhe një sistemi të përbërë edhe nga një numër pendash të vogla.

### **j) VËRSHIMET**

Përgatitja e projekteve për hapjen e kanaleve, rregullim prej dheu, pastrim dhe mirëmbajtje, rregullim urban faza 1 dhe 2.

Marrja e masave për eliminimi i lavesave të forta të lumit dhe menaxhimi i brigjeve të lumenjve.

Marrja e masave për mbrojtjen e lumenjve nga hedhja e mbeturinave, që në këtë rast paraqesin pengesa për lëvizjen e lirë të ujit.

Marrja e masave për ndalimin e ndërtimit të objekteve të banimit si dhe atyre me karakter ekonomik buzë brigjeve të lumenjve sipas ligjeve ne fuqi.

### **k) EROZIONET**

Marrja e masave për shpallje të zonave erozive rajonet në të cilat erozioni ka intensitet të madh në ujë rrjedha, tokë, pyje dhe objekte dhe paluajtshme duke u bazuar sipas Ligjit të Ujërave të Kosovës nga komuna.

Marrja e masave të parandalimit të aktivitetit eroziv siç janë:

1. Ndalimi i prerjeve dhe degradimi i pyjeve.
2. Ndalimi i mbi kullotjes
3. Ndalimi i shfrytëzimit të mirave materiale që shkaktojnë erozion,
4. Ndalimi i shfrytëzimit të dheut dhe rërës etj.

Marrja e masave anti-erozive hidroteknike.

- Hartimi i projekteve për ndërtim të teracave, gardoneve dhe pendave në shtretërit e përroskave dhe përrenjve.
- Hartimi i projekteve për ndërtim të argjinaturave në brigjet e lumenjve.
- Hartimi i projekteve për mbjelle të fidanëve pyjore në shtretërit e lumenjve.
- Marrja e masave për ndalimin e nxjerrjes së inerteve në shtretërit e lumenjve.

Marrja e masave anti-erozive bujqësore.

- Hartimi i projekteve për mirëmbajtjen e tokave bujqësore.
- Marrja e masave për aplikohen e drejtë të praktikave bujqësore.
- Hartimi i projekteve për sistemin e ujitjes dhe kullimit.
- Inicimi dhe sigurimi i investimeve për mbrojtjen e tokës në brigjet e lumenjve.

Marrja e masave anti-erozive biologjike.

- Marrja e masave për mbrojtje të pyjeve ekzistuese nga prerjet e pa kontrolluara dhe nga zjarri.
- Marrja e masave për ndalimin e kullotjes në masivet e varfra me bimësi.
- Hartimi i projekteve për pyllëzim të viseve të zhveshura dhe atyre të degraduara.

- Hartimi i projekteve për krijim të brezave të gjelbër në ato rajone ku shkalla e erozionit është e lartë.
- Hartimi i projekteve për mbjelljen e drunjtëve që do të mbulonin brezin prej 10 m largësi në brigjet e lumenjve kryesor.
- Marrja e masave për shfrytëzimin e tokave bujqësore në fushat lumore të lumenjve kryesor me kullota të përhershme ose pyje.
- Hartimi i projekteve anti erozive për erozion të mesëm dhe të fortë duhet bërë në 500 - 800 ha në këto vendbanime: Topanic, Hodonoc, Rogaqic, Muçiverc, Shipashnic e poshtme dhe e eperme, Karaqeve e poshtme, Kolloleq, Qarakoc, Dajkoc, Hajnoc dhe Qyteti i Kamenices.
- Marrja e masave tjera.

Hartimi i projekteve për ndërtimin e brezave mbrojtës në shpatijet e rrëpishme.

Hartimi i projekteve për ndërtimin e mureve rrezistuse.

Hartimi i projekteve për meliorimin e kullosave.

Hartimi i projekteve për ndërtimin e meliorimin e pyjeve.

Hartimi i projekteve për ndërtimin e formave tjera antierozive.

## II) ZJARRET

- Marrja e masave të mos lejimit të ndërtimit ose futjes së standardeve aty ku është e domosdoshme për objektet dhe pajisjet të cilat shkaktojnë zjarr ose e ndihmojnë zjarrin në pyje dhe hapësira tjera të rrezikuara nga zjarri.
- Marrja e masave të përkrahjes së objekteve dhe pajisjeve të cilat pengojnë zjarrin ose e ndihmojnë fikjen e zjarrit në pyje dhe hapësira tjera të rrezikuara nga zjarri.
- Hartimi i projekteve të tampon zonave në mes të zonave pyjore dhe zonave tjera të ndjeshme nga zjarri dhe një tampon zonë në brezin kufitar për të penguar perhapjen eventual të zjarrit.
- Hartimi i projekteve dhe vendosja e sa më shumë Hidrantëve dhe akumulimeve të ujit në sa ma shumë pika dhe vendbanime.
- Hartimi i projekteve për sigurim të qasjes me automjet që përdorën për fikje të zjarrit deri te çdo njësi banimi në komunën e Kamenicës.
- Masat e kontrollit për kërcënuesit.
- Masat ndëshkuese.

### 4.4 VLERËSIMET E STRATEGJIVE BAZUAR NË KRITERET E PËRCAKTUARA ME PARIME (SHIH NENIN 2/2.2.), POLITIKA DHE LIGJE;

Duke ditur se **strategjitë dhe veprimet për zbatim** ofrojnë kalimin prej gjendjes ekzistuese drejtë kornizës së zhvillimeve të dëshiruara hapësinore. Duke formuluar pakon e strategjive dhe veprimeve për realizimin e qëllimeve brenda kornizës hapësinore, afatet të caktuar dhe gjendjes ekzistuese.

Vlerësimi i këtyre strategjive (të cilat përfaqësojnë gjithashtu një përgjigje në pyetjet se cilat aktivitete dhe hapa duhet ndërmarrë për të arritur deri te korniza e parashikuar. Për më shumë të cilat përfaqësojnë edhe një mjet për kalimin nga faza e gjendjes ekzistuese në atë të planifikuar) bazuar në kriteret e përcaktuara me parimet e



përgjithshme për zhvillim / mbrojtje si dhe politika dhe ligje është shumë hapë i rëndësishëm për të vlerësuar se me këto strategji a do të jemi të sigurt se mundë të zbatohet dokumenti.

➤ **Vlerësimi i Strategjive për zbatim nga fusha e zhvillimit ekonomik**

Matja e efektivitetit të **strategjive për zbatim nga fusha e zhvillimit ekonomik**, është shumë e rëndësishme për të deduktuar në një analizë komplete e cila do të zbulonte pikat e forta dhe pikat e dobët por edhe mundësitë dhe kërcënimet, njëherazi të aspektit hapësinor por edhe dhe të aspekteve tjera të zhvillimit në fjalë.

Vlerësimi i strategjive dhe veprimeve për realizimin e qëllimeve brenda kornizës hapësinore në fushën e zhvillimit Ekonomik: Të gjitha strategjitë e propozuara nga ekipet profesionale janë krahasuar me skenarin e mos bërjes as gjë në këtë fushë, vlerësohet se mundë të kenë edhe pikat e dobëta por në përgjithësi mundë të konsiderohen reale në kuptimin e mundësisë për zbatim, promovojnë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, kompakt dhe intensiv dhe këto strategji prezantojnë një qasje të integruar dhe strategjike, janë në respektim të ligjeve të vendit dhe nëse organet kompetente i krijojnë kushtet për realizimin e këtyre strategjive mundë të besohet se komuna e Kamenicës do jetë lider në fushën e bujqësisë dhe industrisë si dega kryesore e zhvillimit ekonomik.

Strategjitë për zbatim të dokumentit kanë parapa një numër aktiviteteve siç janë: Në vitet e ardhshme hartimi i planit të punës në harmoni me kufijtë e tokës bujqësore të përcaktuara me këtë Planë, bazuar në hartat "Bujqësia në Zhvillimin ekonomik dhe industria" orientimi i zhvillimit të bujqësisë dhe industrisë duke preferuar zhvillimet që do janë më rentabile sidomos për perimtarin, pemëtarin dhe drithëra me theks të veçantë në kulturat intensive dhe duke e përpunuar këtë hartë në nivelin e kadastrit bujqësor, Rehabilitimi i tokës së degraduar, Zhvillimi i bujqësisë organike. Ndërtimi i sistemit të ujitjes, Bashkimi i parcelave me prodhuesit individual, realizimi i fazës së dytë dhe të tretë të komasacionit, Fuqizimi i Drejtorisë së Bujqësisë me staf dhe teknologji si dhe përdorimi i sistemeve të reja informative, puna në projekte me iniciativë të përbashkëta me sektorin privat dhe donatorët, shtimi i fondit blegtoral, fillimi i projektet në zonat e parapara me Planë për pyllëzim, ripyllëzim, kalim nga shkurret në pyje të rregullta dhe mirëmbajtje, menaxhimi i kullotave, përmirësimi i bimësisë së kullotave ekzistuese, Rritja dhe Fuqizimi i Zonave Zhvillimore të bujqësisë, komuna të lehtësoj kurse sektori privat të siguroj bazën për Industrinë Ushqimore, Zgjerimi dhe avancimi i njohurive dhe praktikave në fushën e bujqësisë, zhvillim në lëmin e industrisë së Drurit, industrisë së metaleve, xehetarisë etj, si zhvillim i ekonomisë për Kamenicën.

**Vlerësim:** të gjitha aktivitetet e parapara duke filluar nga arsimimi dhe mësimi i përhershëm (përjetshëm) në bujqësi, industri , blegtori, prodhimtari të pemëve dhe perimeve, do të kontribuojnë në rritjen e vëllimit dhe krijimin prodhimeve cilësore dhe ngritjen e mundësive në marketing, mundë të vlerësohet se masat dhe aktivitetet e strategjive që kanë të bëjnë me komasacionin, apo format tjera të bashkimit të parcelave do të mundësoj shfrytëzim racional ,efikas dhe të qëndrueshëm të tokave bujqësore si dhe do të mundësojnë produkte më intensive dhe fuqizim në tregun vendor dhe ndërkombëtar, masat për ujitje, kullim dhe mbrojtje nga përmbytja në rritjen e rendimenteve, cilësisë dhe ulje të çmimeve të punës por edhe mbrojtje nga erozioni, masat në blegtori, Pyje, kullosa, zona zhvillimore bujqësore etj që janë pjesë e

strategjive për bujqësi mund ti rrisin të hyrat në GDP nga bujqësia dhe industria duke e vendosur në vitet e ardhshme bujqësinë dhe industrinë si degë kryesore e zhvillimit ekonomik dhe të mundësojnë që komuna e Kamenicës të jetë konkurruese në tregun kosovar dhe regional.

Bazuar në kriteret dhe standardet vendore por edhe ndërkombëtare aktivitete e parapara në këto strategji për zbatim të parashikimeve nga korniza zhvillimore mundë ta shtyjnë edhe qeverinë të lëviz nga politikat indirekte të përkrahjes që vërehen gjatë periudhës së kaluar (politika për bujqësinë ishin të orientuara në rehabilitim të infrastrukturës, krijimi të një mjedisi pro biznes, mbështetje të shërbimeve ndaj fermerëve, forcim institucional dhe të gjitha këto ishin të një niveli të ultë) në politika më direkte në atë të dhënës së kredive dhe grandeve që u shkojnë fermerëve Përmes qeverisë.

Për realizimin e kornizës në fushën e zhvillimit ekonomik janë paraparë edhe shumë zhvillime për të cilat edhe në kuadër të strategjisë për zbatim janë paraparë aktivitetet në vazhdim edhe atë në fushën e zhvillimit të Industrisë, Ndërtimtarisë, Zejtarisë Tregtisë, Turizmit.

**Vlerësim:** të gjitha aktivitetet e parapara do të kontribuojnë në ruajtjen e resurseve minerale, zhvillimin e projekteve për shfrytëzim si dhe në një të ardhme të afërt shfrytëzimi i bentonitit, tufit, Antimonit, Andeziteve dhe mineraleve tjera, zhvillimi i projekteve për energji Alternative (Energji me Erë), prodhimin e materialeve ndërtimore, zhvillimin e industrisë përpunuese të metalit, drurit, ngritjen e kapaciteteve intelektuale e teknologjike „Krijimi i sinergjive dhe shmangia e konflikteve të mundshme është një nga përparmit e këtyre strategjive, krijimi i zonës dhe kapaciteteve zejtare, hapësirave për tregti me shumicë dhe pakicë, tregjeve të qëndrueshme, deri te ato ditore, zonës funksionale industriale, aftësimi të vazhdueshëm, inkubator biznesi si dhe kushte për fuqizim të firmave ndërtimore, hapësira për depo sidomos në zonën industriale dhe zyra projektimi e mbikëqyrje në nën-qendrat.

Janë të parapara edhe aktivitetet konkrete në kuadër të strategjive për promovimin e Kamenicës si qytet i turizmit rinor, promovimin e Kitkes, Pllanikes, Tugjecit si vendbanime të turizmit kulturorë, rural dhe agroturizmit, promovimin e Kranidellit, Desivojces, Gmices, si vendbanime të turizmit kulturorë, rekreativ, promovimin e ndërtimit të vikend-shtëpive, promovimin e trashëgimisë arkeologjike për zhvillimin e turizmit, Krijimin e infrastrukturës turistike, mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit, turizmin e gjuetisë, promovimin e turizmit shëndetësor, Hotelarinë.

**Vlerësim:** Zhvillimi i turizmit në komunën e Kamenicës ka një potencial të madh, vlerësohet se zbatimi i aktiviteteve të parapara në kuadër të strategjisë për zbatim do të reflektoj me zhvillimin e tij në mënyrë të qëndrueshme, organizim dhe ofertë e fortë turistike. Krijim të një sistemi informativ turistik, krijim të kapaciteteve dhe krijim të një plani turistik, një rëndësi e posaçme vërehet se edhe në kornizë por edhe në strategji iu ka kushtuar mbrojtjes së natyrës dhe mjedisit dhe shfrytëzimit të këtyre vlerave për turizëm, vlerat paraqiten të rëndësishme për komunën por me zhvillimin e tyre mundë të jenë të rëndësishme për Kosovën dhe më gjerë. Rritja e interesit për turizmin natyror është një mundësi për natyrën e shumëllojshme të komunës së Kamenicës e cila synohet me këto aktivitete sipas vlerësimit, në kuadër të strategjisë vërehen projekte ideore dhe kryesore për atraksionet natyrore si dhe

mbrojtja nëpër mes të shenjzimit dhe shpalljes si vlerë e mbrojtur (konform parimeve dhe ligjeve) si dhe shfrytëzimi i trashëgimisë kulturore, arkeologjike për zhvillim të turizmit por një rëndsi në strategjitë për zbatim vrehet se i është kushtuar edhe transportit që furnizojnë këto zona dhe mbajtja e natyrës së pastër dhe të sigurt, si dhe koordinimi përmes qendrës informative turistike në qytetin e Kamenicës.

Prodhimit të produkteve ushqimore cilësore dhe marketingut të tyre për zhvillimin e agroturizmit në strategjitë për zbatim vrehet se iu ka kushtuar rëndësi si bashku me promovimin e vikend zonave në Kranidell, Desivojc, Gmic, lisocke.

Aktivitetet e organizuara rekreative të gjuetisë po ashtu janë konsideruar të rëndësishme për turizëm tërheqës dhe të sigurt të gjuetisë. Sëbashku me planin menaxhues për zonat e përcaktuara për gjueti.

Turizmi shëndetësor po ashtu konsiderohet shumë i rëndësishëm në aktivitetet e parapara duke marrë për bazë kapacitetet në Kranidell, Kike, Tugjec, si kushte të fuqishme për turizëm shëndetësor për njerëzit që kanë nevojë për shërim në natyrë.

Aktivitete tjera janë paraparë edhe për :Komunikacionin automobilistik, Trafikun urban, Komunikacionin e telekomunikimit, PTK-së dhe operatorëve privat, Modernizimi dhe kompletimi i infrastrukturës energjetike, Identifikimi dhe shfrytëzimi i potencialeve për energji ripërtëritëse, Bankat në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, përkrahja e zhvillimit të NVM –ve.

**Vlerësim:** në të gjitha aktivitetet është parapa transport efikas publik në të gjitha vendbanimet vlerësohen të kenë ndikim në cilësinë e jetës dhe mund të pengojë migrimin dhe depopullimin e zonave të largëta malore si dhe të ofrojnë shërbimet publike ndaj banorëve, mënyrat alternative të transportit vlerësohen të kontribuojnë për përmirësimin e lëvizjes dhe uljen e ndotjes. Ato, po ashtu mund të ofrojnë mundësi për referimin në natyrë si pjesë e ofertës turistike të komunës. Hapja e korridoreve të reja dhe plotësimi dhe fuqizimi i atyre ekzistuese vërehet të jetë pjesë përmbytësore e zhvillimeve të kornizës dhe strategjive dhe vlerësohet të ketë rolë në bartjen e mallrave dhe njerëzve më shpejtë, më lirë dhe në formë të qëndrueshme në funksion të zhvillimit ekonomik.

Kompletimi i infrastrukturës energjetike dhe zëvendësimi me rrjete më të avancuar si dhe hulumtim i energjive alternative vlerësohet lartë dhe shumica e aktiviteve shkojnë në këtë drejtim, bazuar në kornizë dhe strategji për zbatim, Kamenica mundë të prodhojë energji nga uji, era dhe biomasa që shihen në disa aktivitete për zbatim të dokumentit së bashku me politikën „stimulim i energjive alternative”, sidomos atyre solar me lirim nga taksat deri 70 %, që shkon në favor të parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm, plotësimi të standardit për energjinë alternative si dhe plotësimin e disa ligjeve dhe aspekteve mjedisore.

Vlerësohet se disa aktivitete kërkojnë edhe analiza më detale dhe duhet shpërndarë informata të hollësishme për metoda alternative për energji dhe konceptin e kursimit të energjisë.

Vlerësohet se furnizimi stabil me energji siguron fuqinë ekonomike në zonën industriale si dhe potenciali i energjisë ripërtëritëse zvogëlon (ose eliminon) varësinë nga furnizimi central dhe forcon pozitën e energjisë së qëndrueshme në komunë. Ndërmarrjet e specializuara parashihen që të ndihmojnë në shpërndarjen e njohurive dhe ngritjen e efikasitetit të sistemeve energjetike. Në disa aktivitete vërehet synimi i kyçësës dhe përkrahje së NVM-ve vlerësohet se biznesi i organizuar është dëshmuar si më i suksesshëm. Vlerësohet e nevojshme të përkrahen rritjen e biznesit duke ofruar kusht më të volitshëm për NVM, ngritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve dhe specializimeve dhe t’ua mundësojë personave të rinj të nisnin biznese të reja por edhe eksplorimit të mundësive nga bankat.

➤ **Vlerësimi i Strategjive për zbatim nga fusha e Demografisë dhe Çështjeve sociale**

Matja e efektivitetit të strategjive për zbatim nga fusha e Demografisë dhe Çështjeve sociale paraqet gjithashtu një hap mjaft të rëndësishëm në vlersimin edhe të seancave të realizimit.

Të gjitha strategjitë e propozuara nga ekipet profesionale edhe në këtë fushë në përgjithësi promovojnë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, kompakt dhe intensiv dhe këto strategji prezantojnë një qasje të integruar dhe strategjike janë në respektim të ligjeve të vendit dhe ofrojnë një bazë të besueshme në zbatimin e strategjive të kalimit nga gjendja momentale në atë të paraparë me kornizë.

Strategjitë për zbatim të dokumenti kanë parapa një numër aktiviteteve siç janë: Krijimi i kushteve sa më të favorshme për përmirësimin e indeksit komunal të zhvillimit njerëzor (IKZHNJ) në zhvillimin e mëtejshëm të komunës së Kamenicës, Ngritja e sasisë dhe cilësisë së banimit, sigurimi që zhvillimi e ardhshme i komunës së Kamenicës do të bëhet në vijë me konceptin e zhvillimit hapësinor policentrik me tri segmente lineare, Sigurimi që zhvillimi e ardhshme i vendbanimeve do të jetë në harmoni me konceptin e **vendbanimeve kompakt**, Sigurimi që vendbanimet joformale janë trajtuar bazuar në udhëzuesit për rregullimin e vendbanimeve joformale të hartuar nga DPH dhe MMPH, zgjerimi i vëllimit, përmbajtjeve si dhe rritja e cilësisë së infrastrukturës të sistemit të arsimit në të gjitha nivelet në harmoni me konceptin e zhvillimit policentrik me dy segmente lineare, ofrimi i përmbajtjeve shëndetësore në vendbanime në përputhshmëri me funksionin e tyre si dhe hierarkinë, ofrimi i kushteve dhe përmbajtjeve për ruajtje, konservim dhe përdorim në vazhdimësi të qëndrueshme të trashëgimisë kulturore, ofrimi i kushteve dhe përmbajtjeve për administratë dhe institucione publike transparente dhe efikase, ofrimi i përmbajtjeve sportive dhe rekreative në vendbanime në përputhshmëri me funksionin e tyre si dhe hierarkinë, ofrimi i përmbajtjeve për jetë rinore, vlerësimi i strategjive për zbatim nga fusha e infrastrukturës, minimizim të shkallës së papunësisë dhe varfërisë, sigurimi i qendrave të komunitetit në kuadër të qendrave lokale, qendrave për pleq, jetim dhe të pa strehë dhe qasje për hendikep.

**Vlerësim:** Strategjia për zbatim të këtij dokumenti nga kjo fushë siç shihet edhe nga aktivitetet kryesore të lartshënuar por edhe ato më të detajuara ofron zhvillim të koordinuar të shtrirjes hapësinore sipas numrit të paraparë të popullsisë, jetë social-kulturore më të pasur, integritet për komunitetet me të ardhura të ulëta dhe komunitetet që jetojnë në zonat informate, cilësi të infrastrukturës së sistemit të arsimit Hartimi i projekteve për kompletim të cilësisë së infrastrukturës së sistemit të shëndetësisë me ndikim edhe në rritjen e viteve të jetë gjatësisë së banorëve të Komunës së Kamenicës, ulje të varfërisë ashtu që mirëqenia ekonomike, e matur nga të ardhurat për kokë banori të rritet, sigurim të vëllimit të mjaftueshëm të banimit dhe për të gjitha shtresat, përmirësim të cilësisë së banimit, aplikimi i standardeve të hapësirave banuese, nga planet rregulluese të parapara vlerësohet se do të kemi funksionalitet dhe vendbanime kompakte, ndalim të çfarë do ndërtimi në zonat e ngrira, trajtim adekuat të vendbanimeve jo formale, vlerësohen edhe aktivitete që vijnë nga fusha e shëndetësisë si qendrën për rehabilitin, Spitalin e mushkërive (Kitk, Tugjec, Kranidell) si shumë pika të forta për shëndetësinë komunale dhe më gjerë, mbrojtja me vendim, zhvillimi dhe shfrytëzimi i vlerave të trashëguara të komunës së Kamenicës paraqet një potencial i cili duhet vlerësuar edhe si bazë për zhvillim ekonomik, muzeu i qytetit dhe teatri i hapur si determinues edhe të një simboli dhe vlerë të re për Kamenicën, vërehet se strategjia parasheh aktivitete për zbatimin e kornizës edhe në këtë fushë (Demografi dhe Çështje sociale) në ruajtjen e zonave dhe vendosjen e objekteve administrative të policisë dhe gjykatës, vlerësohen gjithashtu përpjekjet për ruajtjen e hapësirave sportive, zhvillimin e tyre dhe kompletimin për të qenë në shërbim për sportistët e rinj dhe sfidat e reja deri te themelimi i klubeve të reja, Themelimi i qendrave të komunitetit në të gjitha qendrat lokale po ashtu vërehet re si një aktivitet shumë i rëndësishëm që e fuqizon këtë strategji së bashku me hapësirat për pleq, hendikep, fëmijë jetim por edhe qasje adekuat

dhe sinjalizim për hendikep si vlerë e shtuar, ndërmarrja e masave konkrete që kanë të bëjnë me rritjen e numrit të punësuarve dhe rritjen e të ardhurave për kokë banori, që do të ndikojnë në ngritjen e standardit jetësor. Përmes ngritjes së zhvillimit ekonomik dhe social dhe zvogëlimin e shkallës së papunësisë me anë të stimulimit dhe të përkrahjes së bizneseve të vogla dhe të mesme, duke shfrytëzuar donatorët dhe sigurimin e punës sezonale vlerësohet si komponentë tije e rëndësishme e kësaj strategjie e cila kërkon angazhim nga të gjitha organet kompetente dhe nivelet për zbatim së bashku edhe me pjesët tjera të strategjisë. Strategjia vlerësohet se nuk ka parapa aktivitetet dhe obligimet të cilat pasojnë pas shpalljes së vlerave të mbrojtura ose rolin e disa mekanizmave ekzistues pasi që ligjet kanë sqaruar rolet dhe aktivitetet e tilla.

### ➤ **Vlerësimi i Strategjive për zbatim nga fusha e infrastrukturës**

Matja e efektivitetit të **strategjive për zbatim nga fusha e Infrastrukturës**, është shumë e rëndësishme.

Vlerësimi i strategjive dhe veprimeve për realizimin e qëllimeve brenda kornizës hapësinore në fushën e Infrastrukturës: Të gjitha strategjitë e propozuara nga ekipet profesionale promovojnë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, kompakt dhe prezantojnë një qasje të integruar dhe strategjike, janë në respektim të ligjeve të vendit, nëse të gjithë aktorët kompetente i krijojnë kushtet për realizimin e këtyre strategjive mundë të besohet se komuna e Kamenicës do jetë edhe në fushën e zhvillimit të infrastrukturës në një pozicion të fuqishëm duke filluar nga infrastruktura rrugore, ajo e furnizimi me ujë, largimit të ujërave të zeza dhe trajtimit të tyre, rrjetit dhe pajisjeve elektro-energjetike, sistemit të deponive, infrastrukturës hekurudhore, auto-udhës deri te infrastruktura e telekomunikimit.

Në strategjitë e kësaj fushe vihet re se në disa raste si hapa janë paraparë : përgatitja e projekteve për përmirësimin rrjeteve ekzistues, Vlerësim: ky aktivitet është parashikuar për të zbatuar segmente të caktuara të kornizës hapësinore të cilat kanë rezultuar si pasojë e mirëmbajtjes së dobët, dhe reflektojnë renovim të sistemit që është në përdorim. Andaj duhet duhet të konsiderohen intervenim, renovim afatshkurtër.

Gjithashtu haset në aktivitete të cilat kërkojnë studime arsyeshmërie, Vlerësim: përkundër se disa projekte në kornizë janë parapa si projekte të rëndësishme, janë determinuar hapësirat si një aktivitetet i rëndësishëm për zbatim kërkohet thellim në analiza, ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore për projektin kryesorë dhe në bazë të këtij studimi të arsyeshmëris të determinohen kapacitetet, vëllimet dhe zgjidhjet më racionale dhe të qëndrueshme.

Aktivitetet tjera janë shenjëzimi dhe mbrojtja e traseve të zhvillimeve për infrastrukturë, Vlerësim: është shumë e rëndësishme që përpos se janë paraparë në kornizë disa zhvillime, në strategji për zbatim parashihet shenjëzimi në teren si aktivitet i cili do të sqaroj edhe më shumë edhe ndodhjen e zhvillimit dhe do të krijoj kushtet për mbrojtje të hapësirës për atë destinim.

Përgatitja e projekteve ideore dhe kryesore shihet po ashtu një aktivitet i rëndësishëm drejtë zbatimit të kornizës,

**Vlerësim:** Edhe se me kornizë janë parapa te gjitha zhvillimet përgatitja e projekteve ideore dhe kryesore paraqet aktivitet të rëndësishëm drejt zbatimi, Andaj komuna duhet të synojë ti përgatis këto projekte konform dinamikës së duhur aktivitetet tjera janë parapa edhe konsultimet, Vlerësim: ka disa projekte që janë parapa të zhvillohen së bashku me akter tjerë qoftë nga sektori, banorët e zonave të caktuara ose me qeverinë qendrore (ministritë përkatëse), donatorët ndërkombëtar etj, për hir të zbatimit të këtyre projekteve të infrastrukturës, këto konsultime si aktivitet janë shumë të rëndësishme në kuptimin e definimit të kompetencave, përgjegjësi dhe afateve kohore bashkë me implikimet financiare për akter të ndryshëm lidhur me këto projekte (në projektet si ajo e pendave, hekurudhës, autoudhës, Largpërçuesit 110 dhe 400 kv, rrugëve regjionale, etj janë obligative).

Aktivitet tjetër drejtë zbatimit të planit në kuadër të strategjisë për zbatim është edhe: Fillimi i zbatimit,

**Vlerësim:** ky aktivitet është ndër të fundit në proces kur fillojmë pas përzgjedhjes së zbatuesit me zbatim prej rekomandimeve të Master planit për zhvillimin e sistemit distributiv të Kosovës deri më vitin 2015, zgjidhjet e përkohshme për trajtim të ujërave të zeza, rrugëve deri te hekurudha bashkë me të përzgjedhurit.

Për ta bërë të plotë këtë strategji për zbatim janë parapar edhe krijimi i mekanizmave publik ose privat për menaxhim,

**Vlerësim:** Vlerësohet se edhe ky aktivitet është mjaft i rëndësishëm për zbatim cilësor të kornizës, ky aktivitet në disa raste do të shfrytëzohet si mjet për menaxhim me kualitetin e kërkuar të projekteve dhe deri te menaxhimi i operimit psh: Të deponive të përkohshme duke krijuar edhe propozuar edhe krijimin e mekanizmave menaxhuese.

Zbatimi efektiv i Strategjisë në fushën e infrastrukturës kërkon që zhvillimet e parashikuara prej saj të përfshihen në planifikimet buxhetore trevjeçare (bazuar edhe në planin dinamik tentativë dhe vlerësimin e kapaciteteve investive), ngritjen e transparencës së procesit, informimit dhe ndërgjegjësimin të publikut, kuadrit ligjor, i politikave dhe ai operativ.

Ky dokument për nga karakteri është hapësinor dhe nuk janë analizuar procedurat si ajo e ekspropriumit dhe aspektet tjera si pjesë e strategjisë për zbatim që mundë të konsiderohet si pikë e dobët por për zbatim duhet bëhen si aktivitete.

Ligji e determinon kuartë kush është kompetent në çfarë niveli për eksproprium si dhe për kompensim për zhvillime në të gjitha fushat duke përfshirë edhe fushën e infrastrukturës.

Vlerësimi i përgjithshëm është se zbatimi i këtyre aktiviteteve të strategjisë do të na mundësoj: Sistem të integruar dhe funksional të ujësjellësit, kanalizimit fekale dhe atmosferik, elektro-energjetik, të menaxhimit të mbeturinave, telekomunikimit dhe te auto udha dhe infrastruktura e transportit hekurudhor i me përmirësim të linjave momentale dhe linja komplet të reja siç janë parapa në kornizë.

### ➤ **Vlerësimi i Strategjive për zbatim nga fusha e shfrytëzimit të tokës dhe mjedisit**

Vlerësimi i strategjive dhe veprimeve për realizimin e qëllimeve brenda kornizës hapësinore në fushën e shfrytëzimit të tokës dhe mjedisit pasi që kjo fushë përbënë prioritet në planin për rregullimin, shfrytëzimin dhe zhvillimin e hapësirës edhe vlerësimi i strategjia për zbatimin e këtij plani në këtë fushë është shumë përmbytësore për të ardhmen andej aktivitete e poshtë renditura janë esencial.

Në përgjithësi edhe në këtë fushë të gjitha strategjitë e propozuara nga ekipet profesionale promovojnë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor, kompakt dhe prezantojnë një qasje të integruar dhe strategjike janë në respektim të ligjeve të vendit (ligjet që mbulojnë fushat e mjedisit, ajrit, ujit, tokës etj).

Strategjitë për zbatim të dokumenti kanë parapa një numër aktivitete të cilat janë në funksion të sigurimit të: Ajrit të pastër dhe ndotjes minimale, Përmirësimin të cilësisë së ujit dhe hapësirave të pasura me ujë, Mbrojtja e cilësisë dhe sasisë së tokës (dhe i pastër, kontaminim minimal), Menaxhimit të tokës, Sigurimit të shfrytëzimit të tokës për destinimin e planifikuar, Sigurimit që zonat me destinim të veçante në nivelin Komunal ( të natyrës , vendbanimet dhe zonat tjera) të trajtohen në mënyrë adekuate, Rrjetit funksional të vendbanimeve dhe baraspeshë e zhvillimit Urbano-rurale, Mbrojtje e trashëgimisë natyrore, Mbrojtje dhe fuqizim i Peizazheve. Përmirësimi i cilësisë së hapësirave të gjelbra, Zhvillimi i qëndrueshëm i biodiversitetit, Vëllim minimal i mbeturinave i prodhuar dhe Ri-përdorim dhe riciklim i mbeturinave. Lëvizje nga kultura e reagimit në atë të amortizimit dhe parandalimit të fatkeqësive dhe erozionit.

**Vlerësim:** Masat dhe veprimet e cekura :Shenjëzimi dhe mbrojtja gjatë zhvillimit të ndërtimeve i brezave dhe shiritave të gjelbër, parqeve, zhvillimi i pyjeve, përmirësimi i qarkullimit rrugor, themelimi i kritereve për sipërfaqet e gjelbërta etj si pjesë të aktiviteteve për zbatim të strategjisë mundë të konsiderohen të mjaftueshme për të garantuar cilësi të ajrit ,gjithashtu masat dhe veprimet që lidhen me ujin, cilësinë dhe vendburimet mundë të konsiderohen se janë një përgjigjeje e duhur në kërkesat ligjor në funksion të sigurimit të cilësisë dhe vazhdueshmërisë së qëndrueshme të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore edhe për tokën vlerësohet se janë paraparë të gjitha aktivitetet të cilat sigurojnë ndotje minimale, pllëshmëri, riaftësim dhe menaxhim adekuat duke paraparë edhe masat e kontrollit dhe ndëshkimit edhe shfrytëzimi i tokës vërehet se është zbërthyer mirë në aktivitete që garantojnë destinimin konform nevojave të parapara, në temën e rrjetit të vendbanimeve dhe kontekstit urbano-rural vlerësohet se janë paraparë të gjitha aktivitetet për të siguruar zhvillim kompakt të vendbanimeve, rrjetë funksional, baraspeshë në këto zhvillime dhe hartim të planeve rregulluese dhe projekteve të cilat favorizojnë zonat me trende negative.

**Vlerësim:** Edhe në temën e trashëgimisë natyrore janë parapa aktivitetet që nga shpallja e zonave të mbrojtura pasi që paraqesin peizazhe dhe zona me vlera të shquar për atraksionet më të rëndësishme turistike të Komunës së Kamenicës. Dhe zhvillimi i tyre për shkak të veprimtarive si zhvillimi i turizmit dhe atyre rekreative dhe konsiderohet se janë parapa të gjitha aktivitete kryesore për të siguruar mbrojtje dhe zhvillim të qëndrueshëm të kësaj trashëgimie.Edhe për sigurimin e zonave të gjelbra është kushtuar kujdes në funksion të përmirësimit, sidomos në zonat e ndërtuara. Parqet e reja, hapësirat e gjelbra përgjatë rrjedhave ujore si dhe mbrojtja e hapësirave të lira nga zhvillimet vlerësohet se aktivitetet e parapara do të kontribuojnë në përmirësimin e mjediseve natyrore. Në fushën e Biodiversitetit janë parapa veprime që sigurojnë biodiversitet të qëndrueshëm.

Në temën e menaxhimit të mbeturinave vlerësohet se janë shtjelluar hapat kryesor në përpunimin adekuat të koncepteve dhe kornizës për këtë temë duke detajuar çdo hapë në drejtim të sigurimit të menaxhimit me deponim të përkohshme të gjitha tipeve të mbeturinave deri te ato inteligjente, trajtim dhe deri te masat e kontrollit, ndëshkimit e mekanizma menaxhuese.

**Vlerësim:** lëvizja nga kultura e reagimit pas fatkeqësive në kulturën e amortizimit dhe parandalimit gjithashtu vërehet të jetë shtjelluar në detaje të thella në të gjitha llojet e fatkeqësive duke propozuar ngritje standardi të ndërtimit dhe rregulloreve në rast të tërmetit, projekte për masa izolimi, për tampon zona dhe aktivitetet tjera.

Vlerësim: Parandalimi i erozionit po ashtu është trajtuar dhe mundë të konstatohet se janë paraparë aktivitetet që rrisin rolin e të gjithë banorëve, shfrytëzuesve të tokës bujqësore, tokave malore, pyjeve, ujërave dhe aseteve tjera natyrore. Në funksion të parandalimit të me masa të parandalimit të aktivitetit eroziv si ato: anti erozive hidroteknike,anti-erozive bujqësore, anti-erozive biologjike dhe masat tjera për mbrojtjen e resurseve natyrore si toka bujqësore, rrjedhat e lumenjve, pyjeve, peizazhit natyror por po ashtu edhe për asetet e krijuara nga njeriu, vendbanimeve, infrastrukturës rrugore dhe konsiderohet se janë parapa aktivitete të nevojshme.

#### 4.5 AFATET KOHORE, IMPLIKIMET FINANCIARE, KORNIZËN INSTITUCIONALE.

| <b>FUSHA TEMATIKE E ZHVILLIMIT EKONOMIK</b>  |  |  |  |                    |
|--|--|--|--|--------------------|
| STRATEGJIA / VEPRIMI   | IMPLIKIMI FINANCIAR (I ULËT, I MESEM, I LARTË) | HORIZONTI KOHOR / INTERVALI I PLANIFIKIMIT (AFATSHKURTËR, AFATMESEM, AFATGJATË, NË VAZHDIMËSI) | KORNIZA INSTITUCIONALE SUBJEKTI / TRUPI (KOMUNA, INVESTITORËT PRIVAT, ...) | PRIORITETI (1,2,3) |
| <b>Strategjia 1: Sa më shumë sipërfaqe e tokës bujqësore dhe mundësi (të mbrohet dhe zhvillohet) në funksion të zhvillimit ekonomik</b>  |  |  |  |                    |
| Planin e punës në harmoni me kufijtë e tokës bujqësore të përcaktuara me këtë Planë  | I ULËT   | AFATSHKURTËR   | KOMUNA   | 1                  |
| Orientoimi i zhvillimit të bujqësisë duke preferuar zhvillimet që do jenë më rentabile sidomos për perimtarit, pemëtarit dhe drithëra me theks të veçantë në kulturat intensive.               | I ULËT   | AFATMESEM  | KOMUNA   | 2                  |
| Zhvillimi i bujqësisë organike   | I MESEM  | AFATMESEM  | PRIVAT dhe INVESTITORËT  | 3                  |
| Bashkimi i parcelave me prodhuesit individual qoftë në formë partneriteti qoftë me faza të reja komasacioni  | I LARTË  | AFATSHKURTËR   | KOMUNA, PRIVAT dhe INVESTITORËT  | 2                  |
| Rritja e sipërfaqeve bujqësore dhe punimi i tyre (hapja e sipërfaqeve të tokës që janë të mbuluara me shkurre, shpyllëzimi i sipërfaqeve me pyje të ulëta, rrafshinat dhe bregoret e mundshme) | I MESEM  | AFATMESEM  | KOMUNA, PRIVAT dhe INVESTITORËT  | 2                  |
| Zgjerimi i kapaciteteve të serave për kultivimin e perimeve (perime gjate tere vitit), dhe kultivimin e luleve   | I MESEM  | NË VAZHDIMËSI  | PRIVAT dhe INVESTITORËT  | 1                  |
| Parku i makinave ashtu që fermerëve të ju mundësohet një sistem i huazimit dhe shmangies së shpenzimeve të panevojshme për makinat të cilat mund të shfrytëzohen bashkërisht.                  | I ULËT   | AFATSHKURTËR   | KOMUNA, PRIVAT   | 3                  |
| <b>Strategjia 2: Blegtoaria</b>  |  |  |  |                    |
| Shtimi i fondit blegtoarial, si dhe përmirësimi i racave të kafshëve me raca me potencial të lartë të prodhimit  | I LARTË  | AFATGJATË  | PRIVAT dhe INVESTITORËT  | 1                  |



|  |         |               |                                 |   |
|--|---------|---------------|---------------------------------|---|
| sidomos për mish dhe qumësht   |         |               |                                 |   |
| Ndërtim i fermave për kultivimin e gjedhit 400-600 krer  | I MESËM | AFATMESEM     | PRIVAT dhe INVESTITORËT         | 1 |
| Ndërtim i fermave për kultivimin e Deleve dhe Dhive 1000 - 1500 krer   | I MESËM | AFATMESEM     | PRIVAT dhe INVESTITORËT         | 1 |
| Pika e grumbullimit të qumështit dhe produkteve të tij e parapar me plan   | I ULËT  | AFATSHKURTËR  | PRIVAT dhe INVESTITORËT         | 1 |
| <b>Strategjia 3: Pyjet dhe kullosat</b>  |         |               |                                 |   |
| Pyllëzim, ripyllëzim, kalim nga shkurret në pyje të rregullta dhe mirëmbajtje  | I MESËM | AFATGJATË     | KOMUNA, PRIVAT dhe INVESTITORËT | 1 |
| Energjitë alternative ashtu që të ruhet masa pyjore  | I LARTË | NË VAZHDIMËSI | KOMUNA, PRIVAT dhe INVESTITORËT | 1 |
| Kultivimi i kullosave ekzistuese me bimë me vlera më të larta ushqimore  | I MESËM | AFATGJATË     | KOMUNA, PRIVAT dhe INVESTITORËT | 3 |
| <b>Strategjia 4: Rritja dhe Fuqizimi i Zonave Zhvillimore të bujqësisë</b>   |         |               |                                 |   |
| Krijimi i zonave zhvillimore për bujqësi   | I MESËM | AFATSHKURTËR  | PRIVAT dhe INVESTITORËT         | 1 |
| <b>Strategjia 5: komuna të lehtësoj kurse sektori privat të siguroj bazën për Industrinë Ushqimore</b>   |         |               |                                 |   |
| Përkrahje për modernizimin e teknologjive të mullinjve në komunën e Kamenicës me:  | I ULËT  | NË VAZHDIMËSI | KOMUNA dhe INVESTITORËT         | 1 |
| a) Deponim i drithërave dhe ngritja e kapaciteteve për nënprodukte të miellit, inicimi i projekte për modernizim                                     | I MESËM | AFATGJATË     | KOMUNA dhe INVESTITORËT         | 1 |
| b) Ngritja e kapaciteteve për deponim, përpunim dhe konservim të frutave në hapësirat e parapara në Planë por edhe në zonën industriale të Kamenicës | I MESËM | AFATMESEM     | KOMUNA, PRIVAT dhe INVESTITORËT | 1 |
| c) Krijimi i një platforme të internetit për promovimin prodhimeve dhe sigurim i internetit për të gjitha bizneset sidomos në zonën                  | I ULËT  | NË VAZHDIMËSI | KOMUNA dhe INVESTITORËT         | 1 |

|  |         |              |                                 |   |
|--|---------|--------------|---------------------------------|---|
| Industriale.   |         |              |                                 |   |
| <b>Strategjia 6: Zgjerimi dhe avancimi i njohurive dhe praktikave në fushën e Bujqësisë</b>  |         |              |                                 |   |
| Hapja e shkollës së mesme bujqësore në hapësirat e parapara me Planë   | I MESËM | AFATMESËM    | KOMUNA, PRIVAT dhe INVESTITORËT | 1 |
| Krijimi i kushteve për hapjen degës së Bujqësisë në shkollimin superiorë nga institucionet publike ose private në hapësirat e parapara me Planë  | I LARTË | AFATSHKURTËR | KOMUNA, PRIVAT dhe INVESTITORËT | 1 |
| Themelimi i qendrës për trajnim dhe aftësim të përjetshëm në fushën e Bujqësisë dhe marketingut  | I MESËM | AFATMESËM    | KOMUNA dhe INVESTITORËT         | 2 |
| Laboratorë dhe hapësira eksperimentuese të fushës së bujqësisë për analiza dhe studime të avancimit të cilësisë dhe sasisë.  | I LARTË | AFATMESËM    | KOMUNA, PRIVAT dhe INVESTITORËT | 3 |
| <b>INDUSTRIA</b>   |         |              |                                 |   |
| <b>Strategjia 1: Industria të qëndrueshme</b>  |         |              |                                 |   |
| Shenjzimi nga hartat në terren i zonave(vendburimeve) të xeheve minerale(bentonitit,kaolin, argjiles, i tufit, zhavorrit, i kuarçitit,thëngjilli, antimoni,hekuri, çeliku etj  | I MESËM | AFATSHKURTËR | KOMUNA dhe INVESTITORËT         | 1 |
| Kryerja e studimeve të arsyeshmërisë në këto zona  | I MESËM | NË VAZHDIMSI | KOMUNA dhe INVESTITORËT         | 2 |
| Hartimi i projekteve kryesore për eksploatimin dhe ndërtimin e kapaciteteve për përpunimin e bentonitit, kaolin, argjiles, i tufit, zhavorrit, i kuarçitit,thëngjilli, antimoni,hekuri, çeliku etj   | I MESËM | AFATSHKURTËR | KOMUNA dhe INVESTITORËT         | 1 |
| Hartimi i projekteve për hapjen e minierave dhe ndërtimin e fabrikës të kapacitetit rreth 100,000 tonë bentonit në vit   | I LARTË | AFATMESËM    | KOMUNA, PRIVAT dhe INVESTITORËT | 2 |
| Hartimi i projekteve për përkrahje dhe fuqizim por edhe krijim të zhvillimeve të reja në industrin e përpunimit të metaleve,drurit, ushqimore,të pijeve,tekstilit ,duhanit etj në funksion të realizimit të parashikimeve në korniz (shihe hartën e Industrisë dhe pasurive natyrale). | I ULËT  | AFATMESËM    | KOMUNA, PRIVAT dhe INVESTITORËT | 1 |
| Hartimit i planit rregullues për zonën industriale me infrastrukturë të planifikuar përkatëse dhe kycje në   | I MESËM | AFATSHKURTËR | KOMUNA dhe INVESTITORËT         | 1 |

|   |          |              |                                 |   |
|---|----------|--------------|---------------------------------|---|
| rrjetin regjional rrugor e në të ardhmen edhe në hekurudh dhe auto-udhë   |          |              |                                 |   |
| <b>NDËRTIMTARI</b>  |          |              |                                 |   |
| <b>Strategjia 1: Ndërtimtari të qëndrueshme</b>   |          |              |                                 |   |
| Hartimi i planeve rregulluese dhe projekteve ideore e kryesore për ti vendosur në zonën industriale dhe në periferi të disa vendbanimeve depot, hapësirat për separimin e zhavorrit dhe të materialeve të tjera, për prodhimin e masës së betontë dhe të parafabrikateve nga betoni, për vendosjen dhe punën e bazave të makinave dhe të uzinave të riparimit, për punë të reparteve të ndryshme (muratoresh, armiruesish, mekanikësh, drugdhendësish, elektrikistësh, punimesh përfundimtare, etj.), për parkimin e makinave, magazina dhe repartet tjera dhe shërbime | I MESHËM | AFATMESHËM   | KOMUNA dhe INVESTITORËT         | 2 |
| <b>ZEJTARIA</b>   |          |              |                                 |   |
| <b>Strategjia 1: Zejtari të qëndrueshme</b>   |          |              |                                 |   |
| Hartimi i projektit ideor dhe kryesor i një qendre zejtare në qytetin e Kamenicës dhe plotësimi i infrastrukturës   | I ULËT   | AFATMESHËM   | KOMUNA                          | 2 |
- Parimeve të prezantuara në kapitullin II
- Respektim të koncepteve zhvillimore
- Zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik
- Zhvillimit të qëndrueshëm Social duke respektuar edhe të aspektin demografik
- Si dhe zhvillimit Mjedisor në përputhje me natyrën e ngarkesës së mjedisit
- Respektimit të kapacitetit të ndotjes së mjedisit
- Ruajtjes dhe avancimit të resurseve natyrore, që sa më shumë ato të ripërtërihen dhe të shfrytëzohen në mënyrë racionale
- Sigurimit të mbrojtjes dhe funksionimit të papenguar të vlerave natyrore të mbrojtura së bashku me rrethinën e tyre, dhe të ruajtjes në masë të madhe të vendndodhjeve dhe vendbanimeve natyrore të llojeve të egra bimore dhe shtazore dhe të bashkësive të tyre
- Sigurimit të mbrojtjes së hapësirës së ndërtuar
- Sigurimit të kushteve për pushim dhe rekreacion të njeriut

Të gjitha këto që u përmendën më lartë kanë formuluar bazën për përcaktimin e kushteve për çështjet e shfrytëzimit të tokës dhe zhvillimit. Në këtë drejtim kemi destinuar sipërfaqet për këto shfrytëzime:

- Tokë bujqësore
- Vendbanime(zonat Ndërtimore)
- Zona me destinim të veçantë
- Zonat e mbrojtura
- Korridore Transporti
- Korridore të gjelbërimit
- Rekreacion
- Sport
- Kullosa dhe livadhe
- Pyje
- Pyllëzim
- Gurëthyes
- Rrjedha të ujit – lumenj
- Pendat
- Deponi të mbeturinave
- Varreza

## **5.2.2 KUSHTET PËR RREGULLIMIN E HAPËSIRËS**

### **5.2.2.a**

- Ndërtimi do të jetë i lejuar vetëm në zonat e destinuara për ndërtim të përcaktuara me PZHK.
- Zhvillimi në Kamenicë dhe në nën-qendrat e saj dhe zonat me destinim të veçantë duhet të rregullohen me Plane Rregulluese Urbane.
- Infrastruktura publike do të ofrohet vetëm në zonat e destinuara për ndërtim. Në zonat ku Planet Rregulluese Urbane nuk janë të miratuara, duhet zbatuar hulumtimin për kërkesat, mundësitë dhe ofrimin e infrastrukturës duke u bazuar në kushtet e planeve të niveleve më të larta.
- Ndërtimi në tokën bujqësore do të jetë i lejuar vetëm në tokën e kualitetit të ulët (e klasifikuar si klasa V-VIII), djerrina, dhe vetëm në raste të veçanta në zonat e mbrendëshme Urbane dhe Rurale – për zhvillim që përkrahin veprimtaritë bujqësore.
- Zhvillimet në hapësirën e lirë (peizazhin natyror) duhet bazuar në rregullat mjedisore për mbrojtjen e natyrës dhe peizazhit. Në mungesë të planit rregullues urban, komuna duhet të nxjerrë udhëzimet përkatëse të karakterit obligativ.
- Në zonat ku zhvillimi është i lejuar, kushtet e lokacionin duhet të përcaktojnë me sa vijon:

- (a) Formën dhe madhësinë e zonës së zhvillimit;
- (b) Mënyrën e shfrytëzimit apo përdorimit;
- (c) Rregullat e ndërtimit;
- (d) Rregullat për kyçjen në rrjetin e infrastrukturës;
- (e) Masat për mbrojtjen mjedisore dhe mbrojtjen e tërësive të trashëgimisë kulturore.

### **5.2.2. b) KUSHTET HAPËSINORE DHE URBANE**

Do të jepen në rastet kur nuk ekzistojnë planet urbane ose rregulluese. Këto kushte do të jepen bazuar në Planin Zhvillimor Komunal të Kamenicës planin e nivelit më të lartë (Planin Hapësinor të Kosovës). Këto kushte do të jepen nga komuna ,drejtorit e komunës pos në raste të veçanta kur jepet nga Ministritë kompetente. Duhet përcaktohet se cila kategori e zhvillimeve(brenda dhe jashtë kufijve ndërtimor, publik ose privat) do obligohet vetëm me kushte hapësinore dhe me pëlqim dhe cila kategori do obligohet me leje urbanistike dhe ndërtimore dhe projekt kryesor. Nëse zhvillimi bëhet në parcela në kornizën e trashëgimisë kulturore e tjera të një rëndësie të caktuar, duhet të përmbajë kushtet e institucionit kompetent për mbrojtjen e trashëgimisë ose institucionit tjetër përkatës.

Gjatë fazës së zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal të Kamenicës duhet që në harmoni me karakterin e vendbanimit dhe parametrat tjerë hapësinor për të gjitha vendbanimet për të cilat nuk planifikohet hartimi i planeve rregulluese por edhe për ato të cilat planifikohet(deri sa të përgatiten këto plane) të përgatitet Rregullorja Komunale për ndërtim, rindërtim, renovim, restaurim të përhershëm dhe të përkohshëm.

- 1) Objektet e banimit;
- 2) Objekte për turizëm;
- 3) Objektet për arsimin dhe mirëqenien sociale;
- 4) Objektet e kujdesit shëndetësor;
- 5) Objektet e kulturës;
- 6) Objektet dhe sipërfaqet për sport dhe rekreacion;
- 7) Objektet për zhvillime industriale dhe të prodhimit;

- 8) Objektet për përdorim të përzier
- 9) Zona të peizazhit – dhe zonave të gjelbërta
- 10) Tokës bujqësore;
- 11) Zonat pyjore;
- 12) Sipërfaqe të ujit në tokë
- 13) Zonat e tjera natyrore;
- 14) Sipërfaqet e infrastrukturës të transportit;
- 15) Sipërfaqe të tjera të infrastrukturës;
- 16) Sipërfaqet për mbrojtje, sanim dhe deponim të mbeturinave
- 17) Varrezat;
- 18) Objektet fetare;
- 19) Sipërfaqe rezervë;
- 20) Sipërfaqet e mineraleve dhe hapësirat e fushave ekspluatuese
- 21) Objektet dhe sipërfaqet në interes të mbrojtjes.

Në kuadër të përbërjes së kushteve hapësinore dhe urbanistike duhet jepen informatat e përgjithshme për :

Linjën e Rregullimit dhe të ndërtimit

Elementet e nivelimit

Mënyra e lidhjeve / Largësia nga objektet fqinje;

Mënyrat e parkimit / dhe numri i parkingjeve;

lidhje me transportin dhe infrastrukturën e shërbimeve.

Pjesë përbërëse e kushteve duhet të jetë edhe lartësia ,gabariti dhe qëllimi i objektit,Numri i kateve, Shkalla e nxënies së parcelës, Indeksi Ndërtimor i parcelës.

### **5.2.3 a) NDËRTESAT ME RËNDËSI PËR KOSOVËN NË KOMUNËN E KAMENICËS**

- Komuna do të vendosë nën kontroll në të gjitha zhvillimet përreth ( përgjatë) korridorit të hekurudhës së paraparë Ferizaj, Viti, Gjilan, Kamenicë Koridoret VIII dhe X sidomos pika e ndaljes në komunën e Kamenicës.
- Për të kufizuar ndikimin mjedisor – zhvillimin e pakontrolluar të gazrave të liruara dhe zhurmën, komuna duhet të zhvilloj një zonë mbrojtëse – brez të gjelbër përgjatë pjesëve të korridorit të Hekurudhës dhe Autoudhës në pjesët ku ky korridor kalon në afërsi të vendbanimeve. Distanca minimale dhe tipi i ndërtimeve janë të përcaktuara me Ligj për Rrugët Nr.2003/11, Neni 26.
- Komuna do ti vejë nën kontroll të gjitha zhvillimet në zonën e pendave në lumejt (Desivojcës, Gjyrishecit, Kremenatës).

### **5.2.2 b) ZONAT NDËRTIMORE PËR VENDBANIME**

- Zonat e ndërtimit janë të përcaktuar me Planin Zhvillimor Komunal të Kamenicës. Ndërtimi është i lejuar vetëm në zonat e përcaktuara për zhvillimin e vendbanimeve (tokën ndërtimore).
- Kufijtë e tokës ndërtimore të rinjë të planifikuar në pjesën grafike të PZHK paraqesin kufijtë absolut për zhvillimin e vendbanimeve.
- Pasi që zhvillimi në masë të madhe duhet të zë vend në vendbanimet ekzistuese, vetëm zhvillimi dhe ndërtimi plotësues duhet lejuar.

- Dendësimi i ndërtimit dhe metodat e ndërtimit për shfrytëzim më racional të tokës do të aplikohen më shpesh.
- Definicioni përkatës i veçorive dhe karakterit të ndërtesave në zonat kufizuese me peizazh të ndjeshëm ndaj ndikimit duhet përcaktuar me planet rregulluese urbane. Planet rregulluese urbane si instrument I planifikimit duhet përdorë po ashtu për të arritur përshtatshmërinë e asambleve ndërtimore me rrethinën.
- Infrastruktura dhe shërbimet duhet të ofrohen në zonat e reja për ndërtim (rryma, sistemi i kanalizimit, ai i ujit). Zhvillimi i infrastrukturës duhet ofruar gradualisht bazuar në kërkesat dhe në përputhje me mundësitë financiare të komunës. Alternativat tjera sikur partneriteti publik-privat ose skemat private të financimit duhet dakorduar me komunën. Pronari i ndërtesës duhet të paguaj taksat për infrastrukturë ndërsa mënyra e shpërndarjes duhet të elaborohet.
- Në zonat e shpallura si zona të ngrira nuk do të lejohet as një lloj ndërtimi për banim, tregti, industri as infrastrukturë që do të shërbente asaj zone, pos infrastrukturës së paraparë me PZHK.
- Në zonat e parapara për zgjerim të vendbanimeve do të bëhen projektet konkrete dhe përcaktohen kushte për ofrim në shërbim të qytetarëve.
- Në zonat e trajtuara si zemrat e gjelbërta në kuadër të vendbanimeve mundë të zhvillohen vetë veprimtari bujqësore (produktet pastra pa pesticide).

### 5.2.2 c) STRUKTURAT E NDËRTUARA JASHTË VENDBANIMEVE

- Për zonat e përcaktuara në Planin Zhvillimor Komunal si të lira nga cilido lloj i zhvillimit dhe të mbrojtura nga ndërtimi duhet garantuar.
  - a) Mbrojtjen e zonave për zhvillimin e vazhdueshëm të bujqësisë dhe pylltarisë.
  - b) Zonat me vlera të veçanta ekologjike.
  - c) Mbrojtjen e peizazhit natyror dhe lokacioneve të trashëgimisë, dhe po ashtu zonat e lidhura natyrore për rekreacion. (duke mos kundërshtuar zhvillimin e vendbanimit).
    - Jashtë zonës ndërtimore do të lejohet vetëm këto ndërtesa: (Ligji L-03/L-106 për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor Neni 16).
      - a) Ndërtesat publike për mbrojtje ose mbrojtje civile;
      - b) Ndërtesa për mbrojtje nga zjarri dhe materialet të dëmshme – eksploziv etj;
      - c) Ndërtesat për menaxhimin e resurseve ujore;
      - d) Infrastruktura;
      - e) Ndërtesa për hulumtimin dhe shfrytëzimin e materialit mineral të eksploatuar;
      - f) Rekreacion dhe turizëm rural.
        - Komuna nuk do të jetë përgjegjëse për ofrimin e infrastrukturës jashtë vendbanimeve. Bazuar në shfrytëzimin e përcaktuar të tokës, ofrimi i infrastrukturës për zhvillimin e ri do të jetë përgjegjësi e pronarëve ose ndërmarrësve.

### 5.2.3 KUSHTET PËR VENDOSJEN E VEPRIMTARIVE EKONOMIKE

- Komuna ka alokuar tokë të mjaftueshme që të përkrahë zhvillimin e biznesit i cili është i bazuar në shfrytëzimin e fuqisë punëtore vendore me kushtë nëse vendoset në hapsirat dhe zonat e parapara për këtë destinim.
- Komuna mundë të lejoj edhe ndërrimin e përkohshëm i destinimit të tokës bujqësore për zhvillim ekonomik: shfrytëzim i mineraleve sipërfaqësore, depozitë e mbeturinave, mbeturinat e industrisë së drurit, shfrytëzim të rërës, zhavorrit dhe gurëve me kusht që pas përfundimit të shfrytëzimit apo përfundimit të afatit të përcaktuar për ndërrim të përkohshëm të destinimit, tokën ta kthej në gjendjen e mëparshme (Krahas kërkesës për dhënie e lejes për ndërtime për shfrytëzim të përkohshëm të tokës bujqësore për destinime të tjera si dhe për ndërtimin e përkohshëm nga e cila vjen deri te dëmtimi

përreth i tokës bujqësore, shfrytëzuesi është i detyruar ta paraqet projektin për rikultivim i cili bëhet në pajtim me dokumentacionin teknik për ndërtim, përkatësisht investitori është i obliguar që para fillimit të kryerjes së punëve në tokën bujqësore, të largoj dhe të ruajë shtresën potencialisht të plleshme të tokës për nevoja të rikultivimit të tokës).

- Komuna do të përkrahë themelimin e Inkubatorit të biznesit për ofrimin e hapësirës për zhvillim ekonomik të bizneseve të reja me kushtë të shfrytëzimit nga bizneset fillestare.
- Komuna do të ofrojë tokë për shkollën profesionale të bujqësisë dhe qendrën informative për bujqësi me infrastrukturën e nevojshme për të. Lokacioni duhet të plotësoj të gjitha kushtet me sa i përket madhësisë së ngastrës, zonës mbrojtëse, orientimin, qasjen në sistemin e transportit publik.
- Në zonat e përcaktuara për biznes dhe industri do të lejohet vetëm ndërtimi i përmbajtjeve të pastra për prodhimtari bujqësore dhe industriale, depot, shërbimet dhe përmbajtje tregtare të cilat nuk kanë ndikim negative në mjedis.
- Lokacioni për përmbajtje të pastra të prodhimtarisë dhe shfrytëzim përkatës komercial mund të zhvillohen në kuadër të vendbanimeve vetëm nëse ato nuk shkaktojnë ndikim negativ në mjedisin që l rrethon (emisioni i gazrave, ndotja e ajrit, zhurma, trafik).
- Bizneset industriale dhe komerciale me ndotje të shprehur nuk do të lejohen kurrsesi.
- Zgjerimi i zonës së industrisë dhe biznesit vetëm nëse qëndrueshmëria e zonës është paraprakisht e dëshmuar dhe me interes të përgjithshëm, në rast të urgjencës dhe mungesës së hapësirës së përshtatshme për tu alokuar.
- Komuna do të koordinoj hartimin e planit rregullues për Zonën Industriale me zonim sensitiv, infrastrukturë përkatëse dhe lidhje me rrjetin rajonal të rrugëve bazuar në kriteret në vijim:

a) Qasje të mirë në korridoret rrugore – jo përmes vendbanimeve,

b) Disponueshmëria e tokës me çmim të ulët,

c) Minimizimi i ndikimeve të dëmshme në vendbanim dhe peizazh

d) Potenciali për zhvillim; Toka, infrastruktura përkatëse (kanalizimi, uji, rryma, komunikimet, ngrohja).

e) Maksimumi i indeksit të shfrytëzimit të ngastrës nuk duhet të tejkaloj 40% të ngastrës dhe së paku 60% e sipërfaqes duhet të jetë gjelbërim, komunikim dhe rekreacion .

- Zonat e reja ku mundë të zhvillohen disa industri duhet të dëshmojnë furnizim energjetik të vet-qëndrueshëm me prodhim të energjisë nga burimet e ripërtërishme nëse ato gjinden në afërsi të potencialit të lartë për energji të ripërtërishme.
- Vetëm ndërtimi i akomodimeve të vogla me maksimum 25 shtretër për turist në fshatra do të jetë i lejuar, nëse ata në tërësi i respektojnë kushtet mjedisore.
- Komuna do të lejojë ndërtimin e infrastrukturës që përkrahë atraksionet turistike dhe aktivitetet e rekreacionit të cilat nuk kanë asnjë ndikim negativ në mjedis – shtigjet për bjeshkatar dhe çiklistë, pikat e vizitës etj.

#### **5.2.4 KUSHTET PËR VENDOSJEN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE**

- Sipërfaqet publike të gjelbëruara në vendbanime dhe në pjesët e përfshira në Planin Zhvillimor Komunal, mundë të ndërtohen dhe mirëmbahen vetëm nëse mundësojnë ruajtjen dhe avancimin e vlerave natyrore dhe të krijuara.
- Nëse për shkak të vendosjes së veprimtarive publike, dëmtohet sipërfaqja publike e gjelbëruar, ajo duhet të kompensohet sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar nga komuna.
- Për të mbrojtur zonën e infrastrukturës me interes për komunën, një politikë e mençur do të udhëhiqet nga ana e komunës.



- Kushtet për vendosjen e objekteve publike për persona të moshuar, jetim, hendikep duhet jenë ti plotësojnë kushtet hapësinore, funksionale dhe të lëvizjes së këtyre kategorive së bashku me plotësimin e funksioneve tjera përcjellëse.
- Kushtet për zgjerimin e zonave të aktivitetit publik janë që të jenë në përputhej me funksionin e vendbanimeve – qendra kryesore, nën qendra, qendër lokale dhe fshatrat.
- Komuna duhet të alokoj hapësirë për shkolla të reja dhe institucione parashkollore me kushtet e sigurimit të brezit mbrojtës të jenë të arritshme nga transporti publik. Ngastrat e alokuara për këtë ndërtim duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
  - a) Institucionet parashkollore Sipërfaqet standarde / fëmijë
  - b) Shkollat fillore Sipërfaqet standarde / fëmijë
- Komuna mund të alokoj një ngastër të përbashkët për ndërtimin e përmbajtjeve sikur janë: edukimi, kultura, shëndetësia dhe shërbimet sociale, qendra të komunitetit. Kjo posaçërisht është e rëndësishme për nën qendrat dhe qendrat lokale.
- Zonat e destinuar për sporte dhe rekreacion duhet të jenë të furnizuara me shtigje, infrastrukturë dhe gjelbërim. Ne kuadër të këtyre zonave do të lejohet vetëm ndërtimi i objekteve të hapura dhe të mbyllura sportive, hapësira për parkim, restorante të vogla dhe dyqane që shërbejnë pajisje sportive rekreative. Maksimumi i indeksit të zënies së ngastrës guxon të kaloj 10% të sipërfaqes së ngastrës.

### **5.2.5 KUSHTET PËR VENDOSJEN E KORRIDOREVE APO TRASEVE, SIPËRFAQEVE KOMUNIKUESE DHE SISTEMEVE TJERA TË INFRASTRUKTURËS**

- Korridoret rrugore duhet të garantohen në shkallë të përshtatshme në harmoni me funksion të qendrave dhe kërkesave të nivelit të Kosovës dhe regjionale.
- Gjatë procesit të definimit të zonave të ndërtimit, duhet të dëshmohet se është shmangur kostoja e lartë në masat zhvillimore dhe mirëmbajtje. Ndërtimi duhet ti respektojë rregullativat për një ndërtim të qëndrueshëm – orientimi, kushtet klimatike etj.
- Koncepti detaj i mobilitetit (përfshire edhe transportin publik, këmbësor dhe trafikun për çiklist) për komunën e Kamenicës duhet të thellohet në elaborim. Ky koncept duhet të përcillet me plan detaj për zhvillim.
- Problemet teknike lidhur me sigurinë e rrugëve (gjerësia e rrugëve, kalimet e rrezikshme, pjerrtësia....) duhet të shmangen dhe të lehtësohen me masa të përshtatshme.
- Qasje direkte për zhvillim në rrugët kryesore (p.sh. Kategoria 1) me kufizim të shpejtësisë me më shumë se 60 Km/h nuk do të lejohet.
- Ministria e transportit dhe Post Telekomunikacionit është përgjegjëse për rrugët kryesore dhe ato regjionale. Kështu që rregulloret dhe standardet teknike janë të dhëna nga Ministria.
- Në komunën e Kamenicës, rrugët kryesore, rrugët lokale dhe rrugët të tjera duhet të dimensionohen në mënyrë që të mund të lejojnë rrjedhë të komunikacionit të sigurt për të gjitha automjetet në çfarëdo kushte atmosferike. Shtigjet e Komunikacionit duhet të respektojnë rregulloret ekzistuese. Shtigjet duhet të jenë të gjera me se paku 3.5 m'. Aty ku ka probleme janë barrierat fizike mund të paraqiten shtigjet mund të ngushtohen.
- Nëse pozita financiare e komunës nuk mund të siguroj zbatimin e rrugëve me hapësira të veçanta për këmbësorë - në zonat e banimit, është e rekomanduar që rruga duhet të përfshij shtigjet për këmbësor.
- Rruga për qasje në parcelat për ndërtim duhet të jetë minimum 3.5m' e gjere dhe max. 7.0 m'.

- Te gjitha udhëkryqet ne nivelin e terrenit duhet te sigurojnë pamje prej te gjitha drejtimeve.
- Shtigjet për çiklizëm te një drejtimi, nëse janë te ndara duhet te jene 0,8m' te gjera. Nëse hapësirat për çiklizëm janë te ndara atëherë shtegu i gjelbër duhet te jete min 0,35m'.
- Ne zonat për parkim qe shërbejnë për transportin publik , shtegu i ndaljeve të autobusëve duhet te jete 2.0 m' i gjere.

➤ **Standardet për parkim janë si ne vijim:**

- a) Shtëpi banimi për një familje(1VP/shtëpi) ne ngastër;
- b) Banimi kolektiv (1VP/njësi banimi);
- c) Banimi familjar (1VP/1 kat në ngastër apo të ngjashëm);
- d) Zyret; 1 VP në 75 m<sup>2</sup> btto zone; (12 VP/1000 m<sup>2</sup> btto);
- e) Dyqane 1 VP në 50 m<sup>2</sup> btto zone; (20 VP/1000 m<sup>2</sup> btto);
- ë) Qendër tregtare: 1 VP në 40 m<sup>2</sup> btto zone; (25 VP/1000 m<sup>2</sup> btto);
- f) Industri dhe depo: 1 VP / 5 te punësuar;
- g) Shërbime 1 VP / 3 te punësuar;
- h) Restorante 1 VP /1 tavolinë;
- i) Ndërtesa sportive: 1 VP / 20 ulëse;
- j) Shkolla dhe jetimore: 1 VP/ klasa dhe grupe te fëmijëve;
- k) Shërbimet e shëndetësisë: 1 VP /40 m<sup>2</sup> btto. (25 VP/1000 m<sup>2</sup> btto);

➤ **Ne korridorin rrugor te rrugëve kryesore regjionale, është i lejuar ndërtimi i ndërtesave ne vijim:**

1. Pompa te benzinës me dyqane, restaurant dhe përmbajtje shërbyese;
2. Larje dhe shërbime te automjeteve;

## **5.2.6 MASAT PËR MBROJTJEN E PEIZAZHEVE, VLERA VE NATYRORE DHE TËRËSIVE KULTURO-HISTORIKE**

- Vlerat e mbrojtura të natyrës mund të përdoren dhe avancohen në mënyrën e cila e mundëson mbrojtjen dhe avancimin e tyre afatgjate, në përputhje me Ligji Nr. 02/L-18 Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës.
- Në pjesën e mbrojtur të natyrës nuk mund të zhvillohen aktivitete të cilat e rrezikojnë ekuilibrin natyror, llojlojshmërinë biologjike dhe peizazhore, hidrografinë, gjeomorfologjinë, gjeologjinë, vlerat kulturore ose në çfarëdo mënyrë degradojnë cilësitë dhe veçoritë e vlerave të natyrës.
- Duhet ndërmarrë masa të veçanta për ruajtjen dhe shfrytëzimin e vlerave të mbrojtura të kulturës dhe të natyrës.
- Çdo punë për modifikim ose demolim ose ndonjë veprim konservues apo restaurues për mbulesën e jashtme të ndërtesave të përfshira në asamble ose zona konservuese arkitekturale kërkon pëlqim me shkrim nga Institucioni kompetent.
- Trashëgimi arkitektural nën mbrojtje shenjzohet qartë me një shenj të dukshme. Vendosja e materialeve reklamuese në monumentet arkitekturale, ndërtesat e asambleve

ose brenda hapësirave konservuese arkitekturale bëhet me leje të shkruar nga Institucioni kompetent.

- Ndalohet lëvizja apo zhvendosja e pjesshme ose complete e ndonjë pjese të trashëgimisë së mbrojtur arkitektural nën mbrojtje të përkohshme apo të përhershme.
- Aplikuesi i lejes në zonën arkeologjike nuk mund të marrë lejen për të filluar punën, para se të bëhet një marrëveshje me Institucionin kompetent për të ndërmarrë një studim

vlerësues të trashëgimisë arkeologjike. Sasia e kostos që paraqitet nga aplikuesi për këtë qëllim përcaktohet nga një formulë e dhënë në aktin nënligjor .

- Gjatë punëve ndërtuese, nëse bëhet ndonjë zbulim arkeologjik zbuluesi ose investitori duhet të informojë Institucionin kompetent menjëherë, por jo më vonë se sa në ditën pasuese nga koha e zbulimit. Institucioni kompetent ka të drejtë që menjëherë të ndalë punët ndërtimore të filluara dhe të ndërmarrë një studim vlerësues dhe shpëtues arkeologjik në vend për një kohë të kufizuar.
- Gërmimet arkeologjike mund të bëhen vetëm me lejen e shkruar të Institucionit kompetent. Vendimi lidhur me këtë leje jepet brenda 30 ditëve nga data e kërkesës.
- Institucioni kompetent ndërmerr masat për konservimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë së luajtshme nën mbrojtje.
- Trashëgimi kulturorë shpirtërorë në forma të ndryshme të dokumentimit dhe të regjistrimeve mbrohet, ruhet dhe promovohet në pajtim me këtë ligj dhe parimet ndërkombëtare, standardet dhe praktikat gjyqësore.
- Komuna, së bashku me Institucionet e nivelit Qendror duhet të përgatis planin menaxhues për mbrojtjen e integruar të natyrës dhe monumenteve kulturore. Plani duhet të mbroj çfarëdo zhvillimi që do të afektoj vlerat e monumenteve, përveç atyre që shërbejnë ti mbroj ato.
- Komuna së bashku me Autoritetin Kosovar të pyjeve dhe do të organizoj pastrimin sanitar të drunjëve në zonat pyjore me funksion të mbrojtjes së pejsazheve dhe mund të ofroj ato për prodhimin e briketit Komuna në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të hartoj planet rregulluese për bregun e lumit si hapësire publike që të mbroj vlerën e peizazhit.
- Komuna në bashkëpunim me institucionet përkatëse duhet mbroj vlerat historike dhe ti avancoj ato.
- Komuna në bashkëpunim me institucionet përkatëse duhet mbroj zonat historike dhe mos të lejoj as një zhvillim në ato zona që e dëmton kontekstin historik.

### **5.2.7 MËNYRA E TRAJTIMIT TË MBETURINAVE**

a) Parandalimin ose zvogëlimin i prodhimit të mbeturinave dhe karakteristikave të rrezikshme, duke përfshirë edhe zvogëlimin e sasisë së mbeturinave të prodhuara më parë, gjatë ciklit të prodhimit duhet jetë pjesë e sistemit të menaxhimit.

b) Trajtimi i mbeturinave duhet të bëhet me metoda që mundësojnë ripërdorimin e plotë ose të pjesshëm të mbeturinave.

c) Duhet konsideruar riciklimin e mbeturinave.

d) Gjithashtu duhet parë mundësinë e shfrytëzimit të vlerave të dobishme të mbeturinave (përfshirë kompostim, shfrytëzimin e mbeturinave si burim energjie etj).

e) Incenerim pa përfitim të energjisë (trajtimi termik).

f) duhet menaxhuar në atë formë që të bëhet deponimin e mbeturinave në deponi, pa shkaktuar ndikime të dëmshme në mjedis. Për objektet, vendet dhe pajisjet, për të cilat është e nevojshme Leja Ekologjike duhet kërkuar nxjerrjen e Planit për administrimin e mbeturinave:

a) kompanitë duhet të posedojnë dokumentacionin me shënime për mbeturinat e prodhuara, shfrytëzuara dhe për mbeturinat që i deponon vet ndërmarrja (llojin, përbërjen dhe sasinë e mbeturinave);

b) masat e zbatuara nga ndërmarrja, me qëllim të pakësimit të mbeturinave në procesin e punës, në veçanti pakësimin e mbeturinave të rrezikshme;

c) ndarjen e mbeturinave, në veçanti mbeturinave të rrezikshme dhe mbeturinave që përsëri mund të përdorën, me qëllim të pakësimit të mbeturinave të cilat duhet deponuar;

d) zbatimin e masave për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e njerëzve;

e) përshkrimin e mënyrave që përdoren për magazinim, trajtim dhe deponim të mbeturinave, dhe

f) çdo çështje tjetër relevante.

➤ Koncepti detaj i Menaxhimit të Mbeturinave për zonën Urbane të Kamenicës dhe nën qendrat duhet të elaborohet më detalisht në fazën e parë dhe të vazhdohet mbulimi i komplet territorit në fazën e dytë menaxhimi i mbeturinave.

➤ Mbeturinave të grumbulluara nëpër pikat e përcaktuara me planë do të menaxhohen nga kompania publike ose ndonjë kompani tjetër dhe do të drejtohen çdo javë në drejtim të deponisë regjionale e cila gjendet në Komunën e Gjilanit.

➤ Komuna duhet të paraqes një politikë për mbledhjen e materialeve të rendit të dytë si dhe për riciklimin e mbeturinave.

➤ Komuna e Kamenicës së bashku me kompaninë.

publike regjionale për menaxhimin e mbeturinave duhet të organizojnë ndarjen, mbledhjen dhe riciklimin e mbeturinave.

➤ Trajtimi i mbeturinave dhe ujërave të zeza duhet të konsiderohen me metoda më të qëndrueshme, duke u përqendruar në prodhimin e energjisë ripërtëritëse dhe biomasës në zonat e definuara si zona të mundshme për prodhimin e energjisë ripërtëritëse.

## 5.2.8 MASAT PËR PENGIMIN E NDIKIMEVE TË DËMSHME NË MJEDIS

➤ Për të penguar ndikimet e dëmshme në mjedis duhet promovuar **“Sistemin e integruar për mbrojtjen e mjedisit”** i cili i obligon autoritetet publike të bashkëpunojnë dhe koordinojnë punët mes veti për hartimin dhe zbatimin e çdo mase, standardi apo aktiviteti me qëllim të mbrojtjes së mjedisit.

➤ Duhet bërë fuqizimin e zbatimit të ligjeve dhe bëjnë inspektimin e zbatimit të ligjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territorit të Komunës së Kamenicës.

➤ Duhet të përgatiten dhe sigurohen informata për qytetarët në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin të qëndrueshëm;

➤ Askujt nuk mund të ju lëshohet leja për shfrytëzimin e resurseve natyrore pa pëlqimin mjedisor për projektin i cili duhet të përmban masat e mbrojtjes dhe rehabilitimit mjedisor.

➤ Strategjitë për menaxhimin e mbeturinave duhet të kontrollohen gjithmonë nga komuna në mënyrë që të shmangen ndikimet në mjedis.

➤ Projektet zhvillimore në shkallë prej 5 hektarëve duhet të dëshmojnë që nuk shkaktojnë ndikime (përplasje) në mjedis.

➤ Gjatë dhënies së Lejeve Urbanistike për objekte zhvillimore ekonomike, nëse është e nevojshme, në pajtim me rregullat mjedisore, të sigurohen masat parandaluese për ndikimet negative në mjedis si ndotja e ajrit dhe zhurma, vibrimet, rrezatimi, ndotja e ujit dhe ndikimet nga mbeturinat e ngurta. Vlerësimi i ndikimeve në mjedis është i nevojshëm për përmbajtjet prodhuese.

### MBROJTJA E UJIT

Me qëllim të mbajtjes në gjendje të rregullt të shtretërve dhe brigjeve, të ujërrjedhave, shtretërve të kanaleve periferike kulluese, shtretërve dhe brigjeve të akumulimeve artificiale, si dhe të digave është e ndaluar:

➤ Ndërrimi i drejtimit të ujit në lumenj dhe kanal apo të krijimi i pengesave pa të drejtën ujore;

- Nxjerrja, depozitimi i dheut, hedhja e mbeturinave, materialeve të tjera të ngurta dhe të lëngëta në ujërrjedha, akumulime dhe në brigjet e tyre;
- Ndërtimi i objekteve të tjera, të cilat nuk shërbejnë për mbrojtjen nga përmbytjet, në largësi së paku 50 metra nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve;
- Kryerja e punimeve, të cilat mund të dëmtojnë shtratin dhe brigjet e ujërrjedhave, liqeneve, shtratin e kanaleve, tuneleve, akumulimeve ose pengimi i rrjedhës së lirë të ujërave;
- Kryerja e punëve në afërsi të ujërrjedhave, akumulimeve, tuneleve, të cilat do të mund të rrezikojnë stabilitetin e objekteve mbrojtëse ose përdorimin e tyre.
- Burimet e ujit duhet të mbrohen. Gjatë dhënies së lejeve për planifikim dhe ndërtim është e

nevojshme që të rregullohen masat për mbrojtje në mënyrë që uji nëntokësor të mbrohet:

- Ndërtimi i sistemit të ujërave të zeza me elemente të papërshkueshme nga uji
- Ujërat atmosferik duhet të kanalizohen në sistem të veçantë të drenazimit
- Kujdes të veçantë duhet ti kushtohet drenazhit të ujërave atmosferike në varreza
- Në mënyrë që të mbrohet rrjedha e lumenjve, është e nevojshme të kontrollohet të gjitha shkarkimet dhe të bëhet një inventar i ndotësve.

- Ndalohet edhe përdorimi i substancave organike dhe inorganike për plehërimin e tokës dhe për mbrojtjen e bimëve në resurset ujore dhe brigje në largësi prej 25 metrash nga kufiri i bregut të ujit të klasit të parë dhe 15 metra largësi të bregut të ujit të klasit të dytë.
- Ndalohet hedhja e substancave dhe mbeturinave të cilat për shkak të vetive fizike, kimike e biologjike mund të rrezikojnë shëndetin publik, organizmat ujor dhe gjysmë ujor, vështirësojnë rrjedhjen e ujërave, rrezikojnë pajisjet ose instalimet ujore.
- Në resurset ujore, ndalohet hedhja e substancave dhe mbeturinave të rrezikshme.
- Kur mund të rrezikohen kushtet cilësore apo sasiore në zonën e mbrojtur ujore mund të ndalohen ose kufizohen aktivitetet e pronarëve apo poseduesve të tokës.

## **MBROJTJA NGA ZHURMA**

- Në mënyrë që vendbanimet të mbrohen nga tejkalimi i nivelit të zhurmës së lejuar është e nevojshme të ndërtohen pengesa dhe të zhvillohen breza të gjelbër në mes të korridoreve të automjeteve motorike dhe vendbanimeve.
- Shfrytëzuesi i pajisjeve të cilat prodhojnë zhurmë dhe vibracion, mund të vë në qarkullim ose të përdor pajisjet sipas kushteve të parapara për aplikimin e masave mbrojtëse për zvogëlimin e zhurmës dhe vibracionit, respektivisht të bënë përdorimin e impianteve, pajisjeve, makinave, mjeteve transportuese dhe aparateve të cilat lirojnë zhurmë deri në nivelin e paraparë me ligj të veçantë.
- Ndërtesat duhet të jenë të projektuara dhe e ndërtuara në mënyrë që zhurma të cilën e dëgjojnë njerëzit që banojnë në afërsi ose në ndërtesë, të jetë e atij intensiteti që nuk do ta rrezikonte shëndetin e njerëzve dhe të sigurojë qetësi dhe kushte të përshtatshme për pushim dhe punë sipas Ligjit Nr. 2004 / 15 për Ndërtim.
- Gjatë kërkesave për mbajtjen e tubimeve publike, organizimit të manifestimeve argëtuese, sportive dhe aktiviteteve tjera në vende publike të hapura ose të mbyllura, për banorët vendorë ose mysafirë, në rastet kur ekzistojnë mundësit e tejkalimit të nivelit të zhurmës së lejuar, njësitë lokale të qeverisjes, me vendim të organeve kompetente, mund të caktojnë një rrugë, një pjesë të rrugës ose pjesë të qytetit, shesh ose lokacion tjetër të përshtatshëm, për qëllime të tilla.
- Me rregulloren komunale duhet ndaluar kryerja e punëve, veprimtarive dhe aktiviteteve tjera që me zhurmë pengojnë qetësinë dhe pushimin e njerëzve, në vende të hapura ose të mbyllura nga një orar i caktuar dhe veprimtari të caktuara.

## **MBROJTJA E AJRIT**

- Në mënyrë që të bëhet mbrojtja e ajrit është e nevojshme që të gjitha burimet e ndotjes: të palëvizshme, të lëvizshme, burime të vogla të ndotjes ose difuzive të obligohen në ruajtje të cilësisë së ajrit nga ndotjet që mundë shkaktajnë gjatë veprimtarisë që ushtrojnë.
- Gjatë veprimtarisë që ushtrohet në territorin e Komunës së Kamenicës detyrohen që:
  - Të minimizojnë emisionin e ndotësve dhe kundërmimeve;
  - Të mos tejkalojnë vlerat kufitare të emisionit.
- Operatorët e burimeve të ndotjes detyrohen edhe që:
  - t'i përdorin këto burime vetëm sipas kushteve teknike dhe kushteve të vëna në lejen e integruar ose lejen mjedisore;
  - të përgatisin rregullore teknike për funksionim e burimeve të ndotjes;
  - të kryejnë monitorimin e shkarkimeve në ajër dhe të dhënat të dërgohen në Ministri sipas rregullave të parapara me akt të veçantë të cilin e nxjerr MMPH (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor).
- Operatorët e burimeve të ndotjes duhet të përgatisin listën e parametrave teknikë, operacionalë dhe masat tekniko-organizative, për burimet e ndotjes.

## **MBROJTJA E BIODIVERSITETIT**

- Meqenëse Kamenicës është e pasur me lloje të begatshme të bimëve dhe shtazëve këtë begati i mundësojnë pyje dhe peizazhe kodrinore, andaj është e nevojshme të kontrollohet gjuetia dhe shkatërrimi i habitateve të llojeve në rrezik zhdukje në mënyrë që të mbrohet zhdukja e specieve bimore dhe shtazore.
- Me qëllim të ruajtjes së disa llojeve shtazore në lumin Morava dhe rrjedhat e tij është e nevojshme pastrimi nga mbeturinat dhe ujërat e zeza. Në pyje është i nevojshëm rrethim i dhe mbikëqyrje e zonave në të cilat ekzistojnë lloje të rralla për habitatet tona.
- Për mbrojtjen e llojeve bimore është e nevojshme identifikimi i zonave të ndjeshme, ruajtja e disa llojeve mjekësore të cilat janë në rrezik zhdukje nga habitatet tona. Po ashtu është e nevojshme shpallja dhe sensibilizimi i zonave të mbrojtura, pejsazheve dhe trungjeve të vjetra të cilat kanë rëndësi shkencore, mjedisore, kulturore, historike, etj.

### **5.2.9 MASAT PËR PARANDALIMIN E NDIKIMIT NEGATIV SOCIAL**

- Komuna duhet të ofrojë infrastrukturë të nevojshme sociale (edukim, shërbim mjekësor, kulturë, sport) që të shmangët ndikimi negativ social i zhvillimit. Një seri e masave për infrastrukturë duhet të jenë sipas funksionit të vendbanimit (qendra kryesore, nën qendra, qendra lokale).
- Dendësia e vendbanimit duhet të harmonizohet dhe të jetë në pajtim me zhvillimet sociale të vendbanimit.
- **KOMUNA DO TË VLERËSOJË PROBLEMET SPECIFIKE NË LIDHJE ME VENDBANIMET JOFORMALE DHE DO TË PROPOZOJË ZGJEDHJE NË ATO VENDE KU HARTIMI I PRRU ËSHTË PRIORITET.**
- Komuna duhet të ballafaqohet me ndërtimet ilegale konform ligjit të ri mbi ndërtimet ilegale. Për këtë arsye do të krijohet një bazë e të dhënave e cila për çdo ngastër do të përmbajë informata e nevojshme në lidhje me lejen e lëshuar.

- Për ndërtesat e konsideruara si ilegale, sipas ligjit të ri mbi ndërtimet ilegale, komuna do të fillojë procedurën e legalizimit. Për procesin e legalizimit dhe lëshimin e lejeve valide për ndërtesë komuna do të kërkojë taksë.

### **5.2.9.1 MASAT PËR ZBATIMIN E PLANIT**

#### **5.2.10 a) DETYRIMI PËR HARTIMIN E PLANIT**

- Sipas ligjit plani duhet të rishikohet çdo 5 vite. Plani Zhvillimor Komunal duhet të rishikohet nëse kushtet e përgjithshme kanë ndryshuar në thelb.
- Plani Zhvillimor Urban pason Planin Zhvillimor Komunal.
- Planet Rregulluese Urbane duhet të hartohen në zonën urbanë të Kamenicës dhe për Rogaqicë, Hogosht, Strezoc, Koretin, Topanic, Hodonoc, Karaqevë, Muçiverc dhe Shipashnic e Epërme.
- Prioritet duhet ti jepet zonave ku problemet hapësimore duhet të adresohen urgjentisht. Kjo përfshin zonat ku kërkohet zhvillimi i brendshëm apo ku qyteti rritet në mënyrë të pakontrolluar dhe të paorganizuar dhe ku rigjenerimi i hapësirave publike është nevojë prioritare.

#### **5.2.10 b) APLIKIMI I MASAVE ZHVILLIMORE DHE I MASAVE TJERA**

- Përpunimi i kadastrit modern si bazë për hartimin Planeve Rregulluese Urbane dhe zhvillimin e mëtutjeshëm. Kamenicës dhe nën qendrave e zonave me interes të veçantë do ti epet prioritet.
- Kur vendoset për zhvillime, prioritet duhet të caktohen që të mbushen zhvillimet apo zgjerim gradual i zonave ekzistuese për ndërtim.
- Planet rregulluese duhet të ofrojnë masa mbrojtëse kundër zjarrit. Këto masa përfshijnë rrjetin për shuarjen e zjarrit në të gjitha pozitat e ndërtesave, qasje të lehtë për kamionët e zjarrfikësve dhe hapësirë për manovrimin e teknologjisë kundër zjarrit sipas rregullave ekzistuese për mbrojtje kundër zjarrit.

#### **5.2.10 c) REKONSTRUKTIMI I NDËRTESAVE DESTINIMI I SË CILAVE ËSHTË NË KUNDËRSHTIM ME DESTINIMIN E PLANIFIKUAR**

- Ndërtesat ekzistuese në zonat e gjelbra nuk duhet të zgjërohen sipas kategorisë së rindërtimit.
- Problemet specifike në lidhje me vendbanimet joformale do të vlerësohen dhe do të propozohen zgjidhje sipas direktivave të DUPH. Për këtë arsye duhet të krijohet një bazë e të dhënave bazuar në një kadastrë modern me informata detale për çdo ndërtesë.
- Rrënimi i ndërtesave mund të konsiderohet në ato raste ku ndërtimet ilegale nuk mund të legalizohen sipas Ligjit mbi ndërtimet ilegale.
- Komuna do të ofrojë një lokacion për ndërtimin e shtëpive të reja për njerëzit që duhen ti lëshojnë shtëpitë e tyre në rast të rrënimëve. Gjatë zbatimit të planit nëse kërkohet, ndërtesat e ndërtuara legale mund të largohen pas shpronësimit apo marrëveshjes me pronarin. Në këtë rast komuna duhet të ofrojë kompensim të mirëfilltë.

### **5.3 DISPOZITAT LIDHUR ME BASHKËPUNIM**

- Në mënyrë që të sigurohet zbatimi i planit komuna sipas procedurave ekzistuese administrative do të ndërtojë bashkëpunim të nevojshëm në mes institucioneve të ndryshme lokale dhe departamenteve, dhe institucioneve në nivelin qendror.
- Komuna sipas interesit do të ndërtojë marrëveshje bashkëpunimi me komunat fqinje dhe komunat në rajon në mënyrë që të zgjedhin çështjet e përbashkëta të rëndësishme për jetën e banorëve, pasi që komuna e Kamenicës është komunë kufitare dhe përmes

rrugëve që janë planifikuar të lidhet me rrugët në komunën e Ranillugut dhe daljes në shtetin e Serbis poashtu edhe pikat kufitare e planifikuar do ti kontribuoj këtij aspekti.

- Komuna do të bashkëpunojë me institucionet nacionale-institutet zhvillimore dhe kërkimore, që mund të kontribuojnë në procesin e zbatimit të planit.
- Komuna duhet të themelojë bashkëpunim të mirëfilltë me shoqatat e organizatave civile në mënyrë që të sigurojë procedurë transparente të procesit të planifikimit.
- Bashkëpunimi me AKP-në–Agjencia Kosovare të Privatizimit “Agjencia do të ketë autoritetin që të administrojë Ndërmarrjet në pronësi Shoqërore dhe Publike që janë regjistruar si të tilla në Kosovë (nëse apo jo ajo Ndërmarrje ka qenë subjekt i Transformimit)”.
- Komuna duhet të negociojë me AKP-në për sipërfaqet e tokës për ndërtesat Publike dhe interesat tjera që kanë qenë pjesë e trajtuar dhe destinuar me planë bazuar në ligjet dhe procedurave në fuqi për shkëmbim dhe marrëveshjeve të veçanta.
- Zbatimi i Planeve Hapësinore dhe Urbanistike do të jenë të suksesshme vetëm nëse komuna dëshmon zotim për bashkëpunim dhe besim në mes të qytetarëve të saj dhe nevojave të tyre.
- Fushata mediale do të organizohet në mënyrë që të forcohet njohuria e qytetarëve dhe të rritet mbështetja e tyre për planifikim dhe zbatimin e planeve.
- Informatat hapësinore në disponim do të vazhdojnë të digjitalizohen dhe centralizohen duke bashkëpunuar me institucionet relevante po ashtu duhet të vazhdojnë të integrohen në një bazë të dhënave GIS.
- Komuna duhet të vë në dispozicion të dhënat që do të jenë të qasshme për të gjitha drejtoritë e administratës komunale për edhe publikun, në formatin GIS nëpërmjet internetit.
- Procesi i lëshimit të lejeve për ndërtim, duke rritur bashkëpunimin dhe edhe transparencën për të gjitha grupet me interes.

#### **5.4 DISPOZITAT MBI RENDIN KRONOLOGJIK APO ETAPAT E IMPLEMENTIMIT**

- Pas miratimit të planit deri në maksimum tre muaj pas miratimit të PZHK-së, Komuna duhet ti rishikojë të gjitha politikat sektoriale në mënyrë që ti harmonizojë ato me dispozitat e Planit Zhvillimor Komunal.
- Brenda tre muajve pas miratimit final të të dy planeve Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban, Kuvendi Komunal duhet të miratojë një plan buxhetor shtesë i cili qartë paraqet se si planet e zbatuara do të financohen brenda tri viteve të ardhshme. Ky plan buxhetorë do të definojë financimin dhe procesin e hartimit

të Planeve Rregulluese dhe dokumente shtesë të politikave dhe studimet e nevojshme për zbatimin e planit.

- Komponenta fizike e planit që i ka për bazë zonat,vijat dhe koridoret fillon të zbatohet me një herë pas hyrjes në fuqi të planit.
- Hartimi i buxhetit komunal për vitet e ardhshme duhet bëhet duke u bazuar në Planin Zhvillimor Komunal.
- Të gjitha zhvillimet tjera do të bazohen në planin dinamik dhe prioritetizimet: prioritet i lartë (1), prioritet i mesëm (2), dhe prioritet i ultë (3) dhe afatet kohore (Afat shkurtër (1-3 vite), afat mesëm (3-5 vite), dhe në Vazhimsi (1-10 vite).

##### **5.4.10 ELEMENTET DHE UDHËZIMET PËR HULUMTIM TË MËTUTJESHËM**

Plani Zhvillimor Komunal ofron kornizë punuese për studime të mëtutjeshme në zhvillimin e komunës, që lehtëson zbatimin e Planit. Në vazhdim janë dhënë temat e studimit të nevojshëm në mënyrë që të vazhdohet me zbatimin e planit:



- Hulumtime në funksion të kompletimit të kadastrit për zonat që janë nën masa komasacioni
- Hulumtime në funksion të kompletimit të kadastrit nëntokësor;
- Hulumtime në funksion të kompletimit të kadastrit të ndotësve të ajrit;
- Thellim i hulumtimeve për zonat tokësore të ndotura dhe ndotësit tjerë;
- Thellim i hulumtimeve për rregullim të regjimit të Ujrave;
- Thellim i hulumtimeve për inventarizim të llojeve organike;
- Thellim i hulumtimeve për zonat me pasuri nëntokësore;
- Thellim i hulumtimeve në saktësimin e hartës së bonitetit të tokës;
- Hulumtime në Plan-konceptin për zhvillimin e turizmit;
- Hulumtime në Plan të Lëvizshmërisë dhe të trafikut;
- Hulumtime në Plan-koncept të zhvillimit ekonomik;
- Vlerësim për prodhim të energjisë alternative duke përfshirë studimin e arsyeshëmëris për zhvillimet në shkallë të vogël të biomasës, solar, erës dhe energji tjera ripërtëritëse.

## **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

### **5.6.1 HYRJA NË FUQI**

- Ky Plan do të ketë efekt 8 ditë pasi që të publikohet ne Gazetën Zyrtare të Kosovës data e fillimit.

### **5.6.2 VALIDITETI / VLEFSHMËRIA**

- Ky Plan do të jetë i vlefshëm së paku për (10) vite.

### **5.6.3 VLERËSIMI**

- PZHK do të vlerësohen rregullisht, p.sh. një herë në çdo dy vite. Gjithashtu do të konsiderohen zhvillimet aktuale dhe të dhënat demografike të tanishme, nevojat për banime dhe zhvillimet ekonomike. Vlerësimet do të përcaktojnë serinë e zbatimit të planeve të veprimit dhe strategjive.
- Procedura e rregullt e rishikimit është në periudhë prej pesë viteve.

### **5.6.4 SHTOJCAT E DOKUMENTIT**

- **Analiza e Gjendjës së Lumenjëve në Komunën e Kamenicës;**
- **Material për Sektorin e Bujqesise;**
- **Shtresëzimi i të pa Punëve në Komunën e Kamenicës;**
- **Agjenda zhvillimore**
- **Katalogu i Tërmeteve;**
- **Paraqitjet e Polimetaleve dhe Mineraleve jo Metalore në Komunën e Kamenicës;**
- **Rrejta Energjetike në Kamenicë;**
- **Shtrirja e Fshatirave të Komunës së Kamenicës;**
- **Trashëgimia e Kamenicës;**
- **Vendbanimet në Komunën e Vitisë;**
- **Vler.mes. Reshjet, Temperatura, Era, shtypja;**
- **Vlerësimi i Gjendjes në Komunë SWOT;**
- **Shfrytzimi i Tokës Kamenicë;**
- **Zhvillimi Demografik në Komunën e Kamenicës;**
- **Plani investiv i rrjetit te kanalizimit dhe te ujesjellesit per CDI-në;**

## REFERENCAT

MMPH - Instituti për Planifikim Hapësinorë, Draft Plani Hapësinor i Kosovës

1. Propozim plani hapësinor i Republikës së Kosovës i vitit 1975. Në origjinal në gjuhën serbokroate (Predlog – Prestorni Plan Socialistiçke Autonomije Pokrajine Kosovo)
2. Plani Hapësinor i Republikës së Kosovës i vitit 1973, në origjinal në gjuhën shqipe (Plani Hapësinor i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës)

### **Studimi themelor – faza B**

- Hidroekonomia
  - Bujqësia
- 2.1. Perspektiva e zhvillimit gjer në vitin 2000
  3. Plani Hapësinor Regjional

### **Studimi themelor – faza B**

- Pylltaria
  - Industria e drurit
  - Konservimi dhe rregullimi i tokave dhe rrjedhave të burimeve të vitit 1971
- 3.1. Energjetika, në gjuhën serbokroate si dhe planet hapësinore regjionale studimet themelore, në gjuhën serbokroate.
  4. Plani hapësinor Regjional i Metohisë Kosovës dhe Anamoravës.
    - materiali bazë – Studimi i masave mbrojtëse të natyrës dhe ambientit njerëzor të vitit 1976, në gjuhën serbokroate.
  5. Enti për Urbanizëm dhe Planifikim – Prishtinë: Plani Hapësinor Regjional i vitit 1977.
  6. Instituti për Planifikim Hapësinor - PGJU Shkupë 1980
  7. Enti i Statistikave të Kosovës 2006-2010.
  8. UNFPA, ESK, IOM (2001): Situata demografike, sociale, ekonomike dhe shëndeti reprodutiv në Kosovë pas konfliktit të vitit 1999. Rezultatet e anketës së ekonomive familjare, nëntor 1999- shkurt 2000. Janar 2001.
  9. Banka Botërore (2001): Vlerësimi i Varfërisë, Kosovë. Vëllimi I: Raporti kryesor, 20 dhjetor 2001. Bazuar në AMSJ 2000.
  10. ESK, UNICEF, TADEST (2002): Statistikat e Arsimit në Kosovë 2001. Versioni 2, Korrik 2002. ESK (2004): Tabela nga ADSSH 2003 - 2009.
  11. Statistikat e arsimit në Kosovë 2010/11.
  12. Statistikat e Kulturës, 2008, 2009.
  13. Statistikat e Lindjeve ne Kosove 2011
  14. Statistikat e Mirëqenies Sociale 2004-2008.
  15. Statistikat e Shëndetësisë 2010-2011.
  16. Statistikat e Standardit Jetësor 2008
  17. Statistikat e Vdekjeve ne Kosove 2011
  18. Konsumi i ekonomive familjare në Kosovë 2003-2005.
  19. Ndryshimet demografike 1948-2011.
  20. OSBE - Regjistrimet e Popullsisë 2011.
  21. Raporti i Zhvillimit Njerëzor - Kosova 2009
  22. Ligjet e Kosovës në fuqi

